# RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMIT

# Për

# "Auditimin e Përputhshmërisë" të ushtruar në Bashkinë Vlorë për periudhën 01.01.2015 – 31.12.217 dhe 4 ish- njësitë vendore Qendër Vlorë, Shushicë, Novoselë dhe Orikum për periudhën 01.01.2013 -31.07.2015"

# MAJ 2018

## Lista e shkurtimeve të përdorura në material

| | | |
|---|---|---|
| **KLSH** | - | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| **NJVQV** | - | Njësia e Vetëqeverisjes Vendore |
| **VKM** | - | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| **KM** | – | Këshilli i Ministrave |
| **IMTV** | – | Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendor |
| **ZVRPP** | – | Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. |
| **KVO** | – | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave |
| **DPZHT** | - | Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit |
| **KRRT** | - | Këshilli i Rregullim Territorit |
| **VKB** | - | Vendimi i Këshillit Bashkiak |
| **EKB** | - | Enti Kombëtar i Banesave |
| **PPV** | - | Plani Përgjithshëm Vendor |
| **AKPT** | - | Agjencia Kombëtare e Planifikim Territorit. |
| **OE** | - | Operator Ekonomik. |
| **AK** | - | Autoriteti i Konkurrencës. |
| **APP** | - | Agjencia e Prokurimit Publik. |
| **LPP** | - | Ligji i Prokurimit Publik. |
| **NJHDT** | - | Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit. |
| **DT** | - | Dokumente Tenderi |
| **KSHA** | - | Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave |
| **AB** | - | Auditi Brendshëm |
| **NJAB** | - | Njësia e Auditit të Brendshëm |

| Nr. | PËRMBAJTJA | Faqe |
|---|---|---|
| I | PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE………………………………………………… | 4-4 |
| II | **HYRJA……………………….....................................................................................** | **4-4** |
| | a- Objektivat dhe qëllimi…………………......……......................................……................. | 4-5 |
| | b- Identifikimi i çështjes………………………….....……...…......................................... | 5-5 |
| | c- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese……………………….....….................................. | 5-6 |
| | d- Përgjegjësitë e audituesve………………………………….................................................. | 6-7 |
| | e- Kriteret e vlerësimit……………………………………......................................................... | 7-8 |
| | f- Standartet e auditimit……………………………………….................................................. | 8-9 |
| III | **PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**.......................................................................................... | 9-375 |
| | III/1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm........................................ | 9-35 |
| | III/2. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm......................................................... | 35-39 |
| | III/3. Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj.). Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Hartimi i Pasqyrave financiare (bilanci kontabël) dhe inventarizimi i llogarive të pasurisë publike. Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë........................................... | 39-76 |
| | *III3.a. Mbi zbatimin e buxhetit të Bashkisë*........................................................................... | *39-43* |
| | *III/3.b. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj*............................................................................................................... | *43-49* |
| | *III/3.c. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Hartimi i Pasqyrave financiare bilanci kontabël)dhe inventarizimi i llogarive të pasurisë publike. Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë.* ............................................. | *49-76* |
| | III4. Auditim mbi prokurimin e fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime dhe ankandeve publike.......................................................................................................... | 76-176 |
| | *III/4.1. Zbatimi i kontratave të punimeve*............................................................................ | *176-241* |
| | III/5. Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe tarifave vendore........ | 241-259 |
| | *III/5.1.* Organizimi dhe funksionimi i Policisë Bashkiake................................................... | 259-262 |
| | III/6. Auditim në fushën e planifikimin dhe zhvillimit të territorit................................... | 262-291 |
| | *III/6.1 Organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)*............................................................................................................ | *291-299* |
| | III/7. Auditim mbi administrimin e Aseteve, procedurën e dhënies me qira të Aseteve të qëndrueshme në varësi të Bashkisë dhe shitja e trojeve publike........................................... | 299-371 |
| | III/8. Auditim me zgjedhje sipas analizës riskut në Ndërmarrjet dhe Institucionet në vartësi të Bashkisë, Vlorë....................................................................................... | 371-375 |
| V | **KONKLUZIONE DHE OPINIONI**……………………………………………………… | 375-407 |
| V | **REKOMANDIMET PËR PËRMISIMIN E GJENDJES.....................................................** | **407-437** |
| VI | **ANEKSE.......................................................................................................................** | |

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vijim KLSH),* auditoi Bashkinë Vlorë dhe 4 ish- njësitë vendore Novoselë, Shushicë, Orikum dhe Qendër Vlorë, sot Njësia Administrative e Bashkisë Vlorë, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1029/1, datë 09.10.2017, shtesave nr. 1029/3, datë 01.12.2017 dhe nr. 1029/4, datë 08.01.2018 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Për gjetjet e konstatuara nga audituesit, janë mbajtur 70 akte konstatimi dhe 2 akt verifikimi të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda datës 27.02.2018 dhe datës 08.03.2018 në përputhjen me afatin e auditimit sipas programit të miratuar.

Për aktet e mbajtura nga subjekti Bashkia Vlorë nuk janë paraqitur vërejtje në fazën e parë dhe nga grupi i auditimit të KLSH është përgatitur dhe dërguar Projekt Raport Auditimi me shkresën përcjellëse nr. 1029/6, datë 07.03.2018.

Në fazën Projekt Raport Auditimit, nga subjekti Bashkia Vlorë janë paraqitur vërejtje me shkresën nr. 1201/4, prot, datë 06.04.2018 (protokolluar në KLSH me nr. 1029/11prot, datë 10.04.2018), ku pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga ana e grupit të auditimit të KLSH, u morën në konsideratë ato raste për të cilat kishin mbështetje ligjore me dokumentacion, ndërsa rastet e tjera të cilat nuk gjejnë Pretendimin e duhur ligjorë, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për përmisimin e gjendjes në ecurinë e aktivitetit të tij.

Gjithashtu në zyrat e KLSH u zhvilluan takimet përmbyllëse midis grupit të auditimit dhe subjektit të audituar në datat 16.04.2018 dhe 24.04.2018, ku në përfundim për disa çështje u që u diskutuan u morën në konsideratë dhe nuk gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

## II. HYRJA.

Kontrolli i Lartë i Shtetit *(këtu e në vijim KLSH),* auditoi Bashkinë Vlorë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me "Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, zbatimin e buxhetit, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, zbatimin e kontratave të investimeve, realizimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, miratimin dhe zbatimin e planit urbanistik vendorë mbi dhënien e lejeve të zhvillimit dhe përdorimit, administrimin e Aseteve, etj.".

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27/11/2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1029/1, datë 9.10.2017, shtesave nr. 1029/3, datë 1.12.2017 dhe nr. 1029/4, datë 8.01.2018 të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 24.11.2017 deri me datë 27.02.2018, në subjektin Bashkia Vlorë për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2017 dhe njësitë vendore Novoselë, Shushicë, Orikum dhe Qendër Vlorë për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2015, u krye *auditimi "Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë financiare, vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret",* nga grupi i auditimit me përbërje: K. Gj, R. Xh. P. D, H. A, J. H, A. Z, S. M dhe I. D

**- Titullin**. Ky Raport Përfundimtar Auditimi përmbledh punën e bërë në lidhje me auditimin e përputhshmërisë në zbatimin e akteve ligjore e nënligjore të çështjeve që lidhmë me: "Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, zbatimin e kontratave të investimeve, realizimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, miratimin dhe zbatimin e planit urbanistik vendorë mbi dhënien e lejeve të zhvillimit dhe përdorimit, administrimin e Aseteve, etj.".

- **Marrësi:** Raporti Përfundimtar i Auditimi i drejtohet Kryetarit të Bashkisë Vlorë D. L, si nëpunësi autorizues për njohjen dhe vlerësimin e problemeve të konstatuara në auditimin e kryer, mbi bazën e opinionit dhe rekomandimeve të dhëna nga KLSH për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

- **Objektivat dhe qëllimi**: Objektivi i auditimit është dhënia nga grupi i auditimit e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të subjektit me kuadrin ligjor në fuqi, nëse fondet publike janë shpenzuar për qëllimin e përcaktuar dhe në përputhje me bazën ligjore, të ardhurat janë planifikuar dhe arkëtuar në nivelin e duhur dhe sipas kërkesave të gjithë kuadrit rregullator.

Për sa më sipër grupi bazohet në ISSAI 4100, 4200, ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", Manualin e auditimit të përputhshmërisë, Rregulloren e procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH, nr. 107, datë 08.08.2017 etj. Vlerësimi i evidencave të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të besueshme për nxjerrjen e konkluzioneve të drejta, objektive dhe të bazuara në fakte (ISSAI 1500), bazuar dhe në skepticizmin dhe gjykimit profesional të audituesit. Gjetjet dhe përfundimet të njihen më tej nga palët e tjera të interesuara dhe publiku, si dhe ti bëhen prezent institucionit për të marrë masa për përmirësimin e gjendjes.

Monitorimi, auditimi dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjes vendore", ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", si dhe akteve nënligjore të dala në bazë për zbatimin e tyre.

Qëllimi i auditimit është të kuptohet se deri në çfarë shkalle subjekti zbaton kuadrin rregullator në fuqi, zbulimi i shkallës së devijimeve nga standardet e pranuara dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitet të menaxhimit financiar, me qëllim që për rastet individuale të identifikuara të detyrohen personat përgjegjës të mbajnë përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë financiare, vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmisimin e situatës brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, shkronja "j' dhe nenin 30, pika 2, të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmisimin e situatës.

-**Identifikimi i çështjes.** Veprimtaria e Bashkisë Vlorë si Njësi e Vetëqeverisjes Vendore, bazohet në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Nga ana jonë, veprimtari me risk, është konstatuar momenti i bashkimit të 4 ish- njësive vendore Novoselë, Shushicë, Orikum dhe Qendër me Bashkinë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Gjithashtu me risk janë vlerësuar dhe:

-Prokurimi i fondeve publike, ku në Bashkinë Vlorë për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar gjithsej 73 procedura me fond limit 1,713,.388 mijë lekë, *nga e cila në vitin 2015 janë 12 procedura me vlerë 99,009 mijë lekë, në vitin 2016 janë 31 procedura me vlerë 861,701 mijë lekë dhe ne vitin*

*2017 janë 30 procedura me vlerë 861,701 mijë lekë.* Me risk janë vlerësuar dhe prokurimet e zhvilluara në ish- Komunën Shushicë dhe Qendër Vlorë, ku për periudhën 01.01.2013 – 31.07.2015 janë zhvilluar gjithsej 17 procedura me vlerë të fondit limit prej 88,711 mijë lekë.
-Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, duke u përqendruar kryesisht tek kontratat e hapësirave publike dhënë për plazhe private.
-Në administrimin dhe menaxhimin e Aseteve të kaluara në pronësi Bashkisë Vlorë, duke u përqendruar kryesisht tek dhënia me qira e tyre dhe mënyra e menaxhimit.
-Në planifikimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit, ku evidentohen leje të dhëna gjithsej 79 leje zhvillimi (ndërtimi).
Për këtë jemi mbështetur në hartimit e pyetësorëve të ndryshëm, si dhe kryer testime mbi transaksionet financiare, në kombinimin e intervistave, rishikimeve analitike të dokumenteve për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e veprimeve në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të veprimtarisë së subjektit të audituar.

**-<u>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</u>**: Administratori i Përgjithshëm (Nëpunësi autorizues) D. L. - Kryetar i Bashkisë Vlorë dhe (Nëpunësi zbatues) T. Z. - Drejtor i Menaxhimit Financiar, janë përgjegjës për shpenzimet e fondeve publike, administrimin e aseteve dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirë funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Administratori i përgjithshëm dhe Drejtor i Menaxhimit Financiar janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Vlorë.
Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 34, pika 6. "Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore".
Neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:
a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
b)vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.
Neni 65; "Administrata e njësisë administrative", pika 1. "Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori".

**<u>-Përgjegjësitë e audituesve të KLSH-së</u>.** Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të mund të shprehë një opinionin mbi saktësinë, vërtetësinë, rregullshmërinë e transaksioneve financiare dhe besueshmërinë e raportimit të pasqyrave financiare.
Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, sipas INTOSAI.
Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse transaksionet financiare janë në përputhje

me ligjet, të japë vlerësim të arsyeshëm nëse sistemi i kontrollit garanton kontrollin e nevojshëm për aktivitetin ekonomik dhe financiar dhe nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi.
Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesi vlerëson nivelin e kontrollit të brendshëm që është relevant në entitet, në mënyrë që të programojë procedura auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.
Gjatë kryerjes së auditimit, në mënyrë që të jepet një gjykim sa më profesional, objektiv dhe i pavarur, audituesit e grupit kanë zbatuar parimet e mëposhtme me karakter etik:
Parimin e integritetit
Parimin e pavarësisë
Parimin e objektivitetit
Parimin e shmangies së konfliktit të interesit.
Audituesit kanë planifikuar dhe kryer auditimin me qëllim për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse deri ne çfarë mase institucioni i audituar ndjek dhe zbaton kuadrin rregullator në fuqi, nëse janë zbatuar afatet dhe rregullat në konsolidimin financiar, transferimin e dokumentacionit dhe gjithë pasurisë etj. Puna e grupit të auditimit është mbështetur më shumë në evidencat e subjektit dhe më pak në sistemin e kontrollit të brendshëm.
Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi, procedura të cilat varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.
Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë në lidhje me shkallën e rregullshmërisë së aktivitetit të subjekteve të audituara me legjislacionin në fuqi.

**-Kriteret e vlerësimit**. Kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu janë referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit janë ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; -Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar; -Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik"; -UMF nr. 14, datë 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre" i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007; -Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë *pragun e materialitetit prej 2%, ku për vitin 2015 paraqitet në vlerën 31,157,554 lekë, në vitin 2016 në vlerën 41,446,786 lekë dhe në vitin 2017 në vlerën 31,750,700 lekë* për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Auditimi është kryer me zgjedhje, ku për kryerjen e tij grupi i auditimit është mbështetur në dokumentacionin ligjor të paraqitur nga subjekti i audituar, evidencat e ndryshme në format elektronik dhe të printuar, në të dhënat elektronike të prokurimeve (marrë dhe nga sistemi app.gov.al), si dhe në ballafaqimin e problemeve nëpërmjet kontakteve verbale e shkresore me subjektin e audituar.
Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:
-Llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;
-Procedurat e mekanizmave të auditimi, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;
-Nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;
-Anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimit, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;
-Ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe;
-Shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve;
-Vlerësimin me objektivitet, profesionalizim dhe paanshmëri i kundërshtive të paraqitura nga subjekti audituar.

**-Standardet e auditimit të aplikuara*:*** Auditimi u krye në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Rregulloren e Brendshme të KLSH miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 107, datë 08.08.2017, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së (Dhjetor 2015), referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si:
- ISSAI 100 – (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- Standardet e Auditimit të cilat bazohen ose janë në konsistencë me (ISSAI 400) Parimet Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
- ISSAI 4000 – 4100 "Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë";
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë";
- Si dhe në praktikat më të mira të fushës**.**

## Procedurat e auditimit.

Kontrolli aritmetik.
Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimit nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar (UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik").

Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

Konfirmim nga të tretët,

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

## III- PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

**- Informacion i përgjithshëm:** Bashkia Vlorë ka një popullsi 200547 banorë dhe 62366 familje, kjo si rezultat i reformës administrative-territoriale ku i janë përfshirë dhe 4 ish- njësi vendore tashmë njësia administrative: Ish- Bashkia Orikum, Ish Komunat Qendër Vlorë, Shushicë dhe Novoselë.

Veprimtaria e Bashkisë Vlorë bazohet në një bazë të gjerë ligjore, por ligji bazë për të është ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Parimet themelore të vetë qeverisjes vendore janë: të veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore dhe të respektojnë kushtetutën.

Auditimi i këtij subjekti është auditim i radhës, sipas planit vjetorë të miratuar në fillim të vitit 2017 nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit.

**- Objekti i këtij auditimi**: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 1320), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 "Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi", duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Ai promovon përgjegjshmëri ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre, duke identifikuar dobësitë dhe devijimet nga ligjet dhe rregulloret, si

dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm.
Mashtrimi dhe korrupsioni, për shkak të natyrës së tyre, përmbajnë elementë që janë në kundërshtim me transparencën, përgjegjshmërinë dhe administrimin e mirë.
**-Qëllimi i auditimit**: Është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes.
**- Fushëveprimi:** Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Vlorë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme auditimit të përputhshmërisë se në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi.
Auditimi ka përfshirë fushën e prokurimeve publike, veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimi i pasqyrave financiare, administrimi i Aseteve, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, dhënien e lejeve zhvillimore e të përdorimit, veprimtaria e IMT, administrimin e marrëdhënieve të punës, hartimi e zbatimi i buxhetit. Gjithashtu auditimi ka përfshirë edhe zbatimin e kontratave të punimeve, administrimin e Aseteve dhe dhënia me qira e tyre, si dhe kontrollin e brendshëm.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për te dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Vlorë.

## III/1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

- ***Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH dërguara në Bashkinë Vlorë, ish-Bashkinë Orikum dhe ish- Komunën Novoselë.***

*1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*
Nga verifikimi, rezulton se me shkresën e saj nr. 732/9 datë 19.12.2016 (prot subjekt me nr. 1339/4 datë 22.12.2016), KLSH ka dërguar në Bashkinë Vlorë rekomandimet e auditimit, ndërsa nga Bashkia Vlorë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr. 430 Prot datë 20.02.2017 (prot KLSH me nr. 732/17 datë 22.02.2017).
Pra përgjigja e Bashkisë Vlorë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë pas 62 ditësh (19.12.2016 - 20.02.2017), nga 20 ditë që ka qenë afati ligjor, në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit" nenin 15 shkronja (j) të drejtat e KLSH.
Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Vlorë është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 144 datë 18.01.2017 dhe janë ngarkuar personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

*2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për*

*raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Me shkresën nr. 148 datë, 19.12.2016 të Kryetarit të KLSH janë dërguar subjektit të audituar, Bashkisë Vlorë për zbatim rekomandimesh për të cilën duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 19.06.2017.

Bashkia Vlorë me shkresën nr. 430 prot datë 20.02.2017 është cituar gatishmëria e tyre për të raportuar brenda afatit (por nuk ka shkresa zyrtare lidhur me këtë raportim), veprime në shkelje të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika *2*.

*3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.*

- **BASHKIA VLORË**

***a*-Për Bashkinë Vlorë, nga auditimi i mëparshëm**.

- **MASA ORGANIZATIVE:**

Nga KLSh janë rekomanduar 34 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 17 masa, pjesërisht 11 masa me vlerë 231,403,558 lekë, *nga e cila arkëtuar* vlera **121,430,259 lekë** dhe në proces arkëtimi vlera 111,972,990 lekë dhe nuk janë zbatuar 5 masa organizative me vlerë 211,180,600 lekë, *respektivisht arkëtimet*:

*a. Subjekte taksë ndikimi në infrastrukturë në vlerën 24,915,259 lekë.*
*b. Nga gjobat e INUV janë arkëtuar në vlerën 150,000 lekë.*
*c. Nga gjobat e INUV janë vendosur sekuestro konservative nga Zyra e Përmbarimit 1,150,000 lekë.*
*d. Janë arkëtuar vlera 700,000 lekë, nga e cila 4 gjoba mbikëqyrësve për vlerën 200,000 lekë dhe 3 gjoba nga APP për vlerën 500,000 lekë, dy nga 200,000 lekë dhe 1 në vlerën 100,000 lekë.*
*e. Janë arkëtuar 2370 subjekte të biznesit të vogël me vlerë 94,515,000 lekë.*

Më poshtë po paraqesim rekomandimet e pazbatuara dhe ato në proces, për të cilat do kërkohet rizbatimi i tyre, si vijon:

**1.** Të merren masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pazbatuara të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të dërguara me shkresën nr. 83/7, prot, datë 27.07.2011 për shfuqizimin e 6 Lejeve të KRRT-së, dhe shpërblim dëmi nga 4 subjekte për vlerën e dëmit ekonomik **prej 2,346,060 lekë**.

***Në proces***

**2.** Të merren masa për implementimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr.. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*. **Për këtë:**

-Të rishikohet struktura organizative, me synim reduktimin e numrit të punonjësve në përputhje me mundësitë financiare të bashkisë.

-Të miratohet strategjia e riskut dhe të hapet regjistri i tij, ku të evidentohen parregullsitë dhe masat e marra për parandalimin e mashtrimit.

-Të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj., sipas

kërkesave të Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27/12/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

**3.** Titullari i njësisë publike (Kryetari i Bashkisë), të marrë masa që të zbatojë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, duke synuar vendosjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, informacioni dhe komunikimi si dhe monitorimi, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.. 10926, datë 08.7.2010.

***Në proces***

**4.** Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Vlorë, të kryhet evidentimi duke listuar elektronikisht **abonentët familjarë** për të cilët nuk janë aplikuar detyrimi për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit për periudhën 2010 – 2013 , si dhe hartojë njoftim vlerësimet në zbatim të pika 3, nenit 70, "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr.. 9920, datë 19/5/2008 *" Për Procedurat Tatimore".*

Të merren masa, të kryhen rillogaritje përkatëse dhe të arkëtohen detyrimet nga familjarët në shumën totale **129,878 mijë lekë** që sipas viteve paraqitet:

-Për vitin 2011 në shumën **45,153 mijë lekë.**

-Për vitin 2012 në shumën **47,166 mijë lekë**.

-Për vitin 2013 në shumën **37,559 mijë lekë.**

*(Listat e debitorëve të saktësohet nga Drejtoria e Taksave dhe 5 Rajonet)*

***Detyrë në proces***

**5.** Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Vlorë të merren masa për rillogaritje e detyrimeve të prapambetura nga subjektet e biznesit të vogël, klasifikuara sipas llojit dhe vlerës të detyrimit dhe të kërkojë arkëtimin e detyrimeve përkatëse. Procedurat ligjore të bëhen në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat Tatimore",* i ndryshuar, pikat 130-132 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 *"Për Procedurat Tatimore"*, i ndryshuar për vlerën **210,231 mijë lekë**, respektivisht:

-Për vitin 2011 paraqiten 1074 debitorë në shumën **50,260** mijë lekë.

-Për vitin 2012 paraqiten 1466 debitorë në shumën **73,787** mijë lekë.

-Për vitin 2013 paraqiten 1890 debitorë në shumën **86,184** mijë lekë.

*(Listat e debitorëve ndodhen pranë Drejtorisë së Taksave Vendore dhe Tarifave pranë Bashkisë Vlorë).*

***Nga verifikimi rezulton se,*** *për vitin 2011 kanë paguar 568 subjekte me vlerë 23,618 mijë lekë, për vitin 2012 kanë paguar 747 subjekte me vlerë 35,392 mijë lekë dhe për vitin 2013 kanë paguar 1055 subjekte me vlerë 35,505 mijë lekë, konkretisht pasqyra:*

| VITI | DEBITOR | | PAGUAR | | DEBI E MBETUR DERI ME 31 DHJETOR 2017 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | NR | VLERE (/000 LEKE) | NR | VLERE (/000 LEKE) | NR | VLERE (/000 LEKE) |
| **2011** | 1074 | 50,260 | 568 | 23,618 | 506 | 26,642 |
| **2012** | 1466 | 73,787 | 747 | 35,392 | 719 | 38,395 |
| **2013** | 1890 | 86,184 | 1055 | 35,505 | 835 | 50,679 |
| **Shuma** | **4430** | **210,231** | **2370** | **94,515** | **2,060** | **115,716** |

***Detyrë pa zbatuar***

**6.** Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Vlorë, bazuar në të dhëna të sakta, rakorduar me zyrën e gjendjes civile dhe verifikimin në fakt, të hartojë regjistrat për taksapaguesit familjarë, duke ndjekur dhe arkëtuar edhe detyrimet e periudhave të mëparshme si dhe të rakordojë të dhënat e regjistruara, duke i pasqyruar ato në bilancin kontabël të institucionit..

***Detyrë në proces***

**7**. Të bëhet saktësimi i gjobave të vendosura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të kontabilizohen shumat me qëllim ndjekjen dhe arkëtimin e tyre. Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e gjobave të vendosura konkretisht për vitin 2012 ndaj 13 subjekteve në shumën 325,000 lekë dhe për vitin 2013 ndaj 48 subjekteve në shumën 1,250,000 lekë, pasi sipas verifikimit asnjë nga subjektet nuk ka arkëtuar detyrimet për vendosjen e gjobave.

***Detyrë e pazbatuar***

**8.** Të merrem masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për kryerjen e kontrolleve dhe rivlerësimin e xhiros së subjekteve të cilët kanë deklaruar xhiro nën vlerën 2,000,000 lekë, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrimit mbi xhiro.

Kjo detyrë nuk është kompetencë e DTT Vlorë, pasi ky tatim administrohet nga DRT Vlorë me ndryshimet ligjore që ka pësuar ligji.

**9.** Të merren masa që në bashkëpunim me ZVRPP Vlorë, të përfundojë procesi i regjistrimit të Aseteve në administrim të Bashkisë Vlorë (sipas statusit të përcaktuar në VKM përkatëse) dhe të pasqyrohet evidenca e tyre në kontabilitet.

***Nga verifikimi rezultoi*** *se ka filluar puna për evidentimin, saktësimin dhe regjistrimin e pronave duke ju drejtuar institucioneve me shkresat, si vijon: ZVRPP me nr..963 prot datë 21.03.2014; ZVRPP me nr..963/20 prot datë 24.04.2014; ZVRPP me nr. 2988 prot, datë 14.07. 2014; ZVRPP me nr. 3973 prot, datë 26.09.2014; ZVRPP me nr. 3972 prot, datë 26.09.2014.*

*Ministria e Transportit dhe infrastrukturës nr. 4532 prot, datë 14.10.2014, Institucioneve qendrore, nivel vendor me nr. 4538 prot, datë 30.10.2014, Institucione vartëse me nr.. 4552 prot datë 14.10.2014 dhe ZVRPP me nr. 5070 prot, datë 09.12.2014*

***Në proces***

**10**. Nga ana e Bashkisë Vlorë, të ngrihet një grup pune me punonjës të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Shërbimeve Publike, dhe Njësive administrative, etj, për të kryer një evidentim dhe inventarizim të përgjithshëm për gjendjen e ndërtimeve në qytet sipas fazave, llojeve të ndërtimeve, strukturës së ndërtimeve pa leje, si dhe të krijohet data basë me të dhënat e nevojshme, me qëllim inventarizimin e secilës rrugë e lagje.

Pas hartimit të procesverbaleve, nga inspektorët për secilin rast, ti bëhen propozim me shkrim, Kryeinspektorit, për vendosjen e sanksioneve, siç përcaktohet në nenin 15 paragrafi i fundit të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”.

***Në proces***

**11.** Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me 5 Rajonet, të evidentohen të gjitha objektet të cilët kanë kryer ndërtime të kundërligjshme dhe veçanërisht 11 subjektet ndërtuese të cituara në rekomandimin nr. 16, më poshtë dhe subjektet e tjera që do rezultojnë gjatë verifikimit në teren, të cilat nuk janë pajisur me lejë zhvillimi, ndaj tyre, të vazhdojnë procedurat ligjore të parashikuara, në ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit” me ndryshime.

***Në proces***

**12.** Duke qenë se 4 subjektet ndërtuese të cilët sipas të dhënave të M.....A nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, kanë filluar e përfunduar punimet, pa u zbardhur leja e ndërtimit, në kundërshtim me nenin 51, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 *"Për urbanistikën"*, të ndryshuar dhe VKB Vlorë nr. 62, datë 26.11.2009 *"Për taksat dhe tarifat vendore"*, të ndryshuar.
Për sa sipër, mbështetur në ligjin nr.. 8485, datë 12.5.1999 "*Kodi i procedurave administrative"*, pjesa VI, kreu I dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* Kap IV,-Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin në rrugë ligjore të ardhurave të munguara në buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën **30,506,922 lekë duke llogaritur edhe kamatëvonesat,** për 4 subjekte ndërtuese.
***Nga verifikimi rezultoi se*** *nga 4 subjekte të rekomanduara në vlerën 30,506,922 lekë deri më datën 31.12.2017, është arkëtuar nga 3 subjekte vlera prej 24,915,559 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar nga subjekti " A.....N. " edhe vlera prej **5,591,663** lekë, të paraqitura hollësisht.*

***Në proces zbatimi***

**Në mënyrë analitike për secilin subjekt paraqitet si më poshtë:**
**a-**Subjekti ndërtues ***"A.....N. "*** me vendimin e KRRT, nr.. 7/61, datë 07.09.2010, me dosje në plotësim dokumentacioni, ka nisur ndërtimin **(përfunduar)** e "Godinë banimi dhe shërbimi **2-5-6-7-8 kate**, me 1 kat nëntokë, "Lagje "Kushtrimi" Vlera e llogaritur për tu paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është **5,591,663 lekë. Nuk është arkëtuar**.
**b-Subjekti ndërtues *"S.....O & G.....N"*** me vendimin e KRRT, nr.. 2/182, datë 28.09.2011,me dosje në plotësim dokumentacioni, ka nisur ndërtimin **(përfunduar**) Godinë banimi **10-11 kate**, me 1 kat parkim nëntokë. Lagje "Skelë". Vlera e llogaritur për tu paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 8,570,147 lekë. Arkëtuar 5,000,000 lekë. Arkëtuar më pak **3,570,147 lekë. Arkëtuar ne datën 03.10.2014.**
**c-Subjekti ndërtues "A.....L"** me vendimin e KRRT, nr.. 2/230, datë 28.09.2011, me dosje në plotësim dokumentacioni, ka nisur ndërtimin. Godinë banimi dhe shërbimi **2-10 kate**, me 1 kat nëntokë. Lagje "Lef Sallata". Vlera e llogaritur për t'u paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është12,218,956 lekë. Arkëtuar 50,000 lekë. Arkëtuar më pak **12,168,956** lekë. **Arkëtuar ne datën 29.09.2014**
**ç-Subjekti ndërtues** "***F.....T"*** me vendimin e KRRT, nr.. 2/52, datë 28.09.2011, me dosje në plotësim dokumentacioni, ka nisur ndërtimin **(përfunduar)** godinë banimi 5-**8-11 kate**, kati i parë pjesërisht dyqane+ 1 kat parkim nëntokë. Lagje "28 Nëntori". Vlera e llogaritur për tu paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 12,518,380 lekë, nga e cila është arkëtuar 3,342,224 lekë dhe nuk është arkëtuar shuma **9,176,156 lekë. Arkëtuar ne datën 04.09.2014.**

**13**. Nga ana e inspektoratit Ndërtimor Urbanistik në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, dhe Drejtorinë e Buxhet-Financës, bazuar në nenin 16 të ligjit nr.. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve" pikës 16 të VKM nr. 862, datë 5.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor"*(Ndryshuar me VKM nr. . 625, datë 28.7.2010)***,** VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël Publik", VKM nr.. 25, datë 20.01.2001 "Për një ndryshim në VKM nr. 248 datë 10.04.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël Publik", Udhëzimet e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 dhe nr. 26, datë 27.12.2007 "Për përgatitjen e pasqyrave financiare", Plani Kontabël Publik, klasifikimi buxhetor **-Llogaria 7 115 409, të merren masa për:**

**b.** Ndjekjen e procedurave ligjore dhe vënien në arkëtim të **51** gjobave **në vlerën 11,650,000 lekë, duke llogaritur edhe kamatëvonesat 2% në ditë**, deri në 1 muaj, bazuar në nenin 16 të ligjit nr.. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të vendosura nga ana e INUV të Bashkisë Vlorë, për periudhën 01.01.2011-18.06.2012, lista sipas ***Aneksit nr. 13***, bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të auditimit.
**c.** ndjekjen e procedurave ligjore dhe vënien në arkëtim të **131 gjobave në vlerën 51.352.000 lekë, duke llogaritur edhe kamatëvonesat 2% në ditë**, **deri në 1 muaj**, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të vendosura nga ana e INUV të Bashkisë Vlorë, për periudhën 18.06.201-31.12013, lista sipas ***Aneksit nr. 12,*** bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit.
*Nga të dhënat e paraqitura rezulton se kjo detyrë është vlerësuar, pasi kanë filluar procedurat ligjore sipas rekomandimeve të KLSH për arkëtimin e **182 gjobave në vlerën prej 63,002,000** lekë dhe deri më datën **31.12.2017** gjendja paraqitet si më poshtë:*

| Nr. | Emërtimi | Rekomanduar nga KLSH | |
|---|---|---|---|
| | | Numri | Vlera e gjobave ne lekë |
| 1 | **Me urdhër ekzekutimi** | **47** | |
| | Te ekzekutuara | 2 | 150,000 |
| | Ne sekuestro konservative | 8 | 1,150,000 |
| | Ne proces ekzekutimi | 37 | 6,800,000 |
| 2 | **Te pushuara me vendim gjykate** | **55** | 15,050,000 |
| | **Gjithsej** | | 23,150,000 |
| 4 | **Ne proces gjyqësor** | **80** | 39,852,000 |
| | **Gjoba ne total** | **182** | **63,002,000** |

***Në proces zbatimi***

**d.** Të merren masa dhe të rakordohet në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për gjendjen dhe ndjekjen e ecurisë së 67 kallëzimeve penale, të dërguara për vitet 2010 -2013.

***Detyrë e pazbatuar***

**14.** Rekomandimi nr. 22, është trajtuar tek Masa shpërblim dëmi më poshtë:, pika 6, i cili bën fjalë për **arkëtimin e qerasë së papaguar për vlerën 5,231,076 lekë,** nga subjekti "I.....D" Vlorë"**,** për ulje të sipërfaqes të objektit të dhënë me qira duke e ndarë dhe parealizuar objektin pa dokumentacion të argumentuar të bazuar me matje faktike, por në një genplan të përgjithshëm bashkëngjitur kontratës për periudhën 1 Qershor 2012-31 Dhjetor 2012.
***Nga verifikimi i korrespodencës me shkresa*** *rezulton se subjekti nga vlera e rekomanduar prej **5,231,076 lekë**, pranon 4,471,116 lekë, ky detyrim ka lindur si rezultat i ndryshimit të çmimit për metër/2 ne zbatim te VKM ne fuqi. Në zbatim të këtij rekomandimi nga Kryetari i Bashkisë Vlorë me urdhri të brendshëm nr. 15, datë 22.01.2016 "Për ngritjen e komisionit për rivlerësimin e sipërfaqes së pasurisë së paluajtshme në funksion të parkut të lojërave", është ngritur komisioni i verifikimit në terren në këtij objekt. Ky komision në datën 27.01.2016 ka hartuar procesverbalin e matjeve faktike ne funksion te parkut te lojërave shoqëruar edhe me plan vendosje bashkëlidhur, të nënshkruar edhe nga përfaqësuesi i subjektit "I....D" . N. L, ku është konstatuar se subjekti "I....D" ka në përdorim një sipërfaqe 14960 m$^2$.*

*Me vendim të KB nr. 60, datë 27.10.2016 është miratuar ndryshimi i sipërfaqes funksionale të Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës, të kontratës nr. 2964rpe/450kol, datë 4.6.2002, sipas matjeve në terren të bërë me grup pune, që ka në përdorim subjektit "I....D" (për të cilën ka rënë dakord),* ***një sipërfaqe prej 14960 m²****, ku përllogaritja e detyrimit do fillojë nga muaj Korrik 2013, veprim i cili nuk ka ndodhur. Për këtë pikë është mbajtur akt-konstatim më vetë, ku është trajtuar gjerësisht.*

***Detyrë në proces zbatimi.***

**15.** Nga ana e Bashkisë Vlorë të rizhvillohen procedurat e përzgjedhjes së inspektorëve të Policisë Bashkiake, duke zbatuar kriteret e urdhrit të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 "Për miratimin e rregullores "TIP" të policisë bashkiake dhe të Komunës", pikat 4 e 5.

***Pa zbatuar***

**15.** Nga Policia Bashkiake të merren masa për arkëtimin e gjobave të prapambetura, në të kundërtën të fillojnë ndalesat ndaj 9 personave të cilët i kanë vendosur dhe nuk i kanë arkëtuar **46 gjoba** për në vlerën **53,500 lekë**.

***Pa zbatuar***

**16.** Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk janë me efektivitet dhe kanë plotësuar afatin e përdorimit, duke përfshirë edhe (Ndërmarrjen e Shërbimeve), të përgatitet dokumentacioni për vlerësimin e efektivitetit të tyre, duke zbatuar kriteret dhe procedurat e përcaktuara në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"*, respektivisht kuadri ligjor i përcaktuar në pikat 95-119 dhe 120, për efektet ekonomike dhe financiare. Po ashtu të informohet edhe Këshilli Bashkiak mbi këto procedura.

***Nga verifikimi rezultoi se:***

*1-Është bere verifikimi fizik i mjeteve dhe janë konstatuar se ne gjendje teknike jo te mire dhe qe nuk janë ne pune për arsye te defekteve te shumta ne sisteme qe kane, janë këto mjete te Policisë Bashkiake me targa: Vl .....C, VL ....C ,VL ....C dhe VL....B tip Panda.*

*2-Nga verifikimi qe ju be këtyre mjeteve u konstatua se mjetet janë pa targa dhe dokumentacionet përkatëse (leje qarkullimi, kontroll teknik , siguracioni) dhe te gjitha mjeteve u është bërë fotografimi i tyre.*

*3-U be ne Drejtorinë e Policisë se Qarkut Vlorë denoncimi për këto mungesa.*

*4- Është aplikuar ne Drejtorinë Rajonale te Shërbimit te Transportit Rrugor Vlorë me te gjitha dokumentet përkatëse, se bashku dhe me denoncimin ne Drejtorinë e Policisë dhe te gjitha taksat e paguara për çregjistrimin e tyre dhe jemi ne fazën për ti marre ato pasi kjo drejtori te kryeje procedurat e saj.*

*5-Është nxjerre Urdhri i brendshëm Nr. 128 datë 16.12.2014"Për ngritjen e komisionit për vlerësimin e mjeteve te transportit te Policisë Bashkiake me targa Vl.....C, VL...C, VL....C dhe Vl....B".*

*6-Janë marre dhe nga një kopje te okultacionit te këtyre makinave nga DRSHTRR Vlorë dhe po përgatiten materialet e gjendjes teknike te këtyre mjeteve.*

***Në proces zbatimi***

**17**. Sipas VKM nr. 660, datë 12.09.2007 "Për transferimin e aksioneve të Shoqërive të Ujësjellësve dhe Kanalizimeve Njësive të Qeverisjes vendore", një pjesë e aksioneve të Ujësjellësit sha, Vlorë i ka kaluar Bashkisë ku edhe Këshilli Mbikëqyrëse caktohen nga Këshilli Bashkiak Vlorë. Për këtë

arsye nga ana e Bashkisë Vlorë, të përgatitet aktmarrëveshja për pagesën e taksave dhe tarifave nga popullata, së bashku me faturat ujit të pijshëm, nëpërmjet Ujësjellës sha, Vlorë, e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.
Kjo bazuar në ligjin nr. 9632,datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5,- Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, këshilli i bashkisë ose i komunës, sipas shkronjës ii) - përcakton mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agjentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjella; nenin 7, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat Tatimore"* i ndryshuar, pikës 7.1, të UMF, nr. 24, datë 02.09.2008 "*Për Procedurat Tatimore".*

***Pa zbatuar***

**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Nga verifikimi i detyrave për zbatim e pikës B-Masa shpërblim dëmi, konstatohet se nga 13 detyra me vlerë 77,180,444 lekë, janë zbatuar 7 detyra me vlerë 8,444,732 lekë ose 10.9 % e vlerës së rekomanduar, janë në proces 5 detyra me vlerë 24,325,811 lekë ose 31.5 % e vlerës së rekomanduar, *nga e cila; arkëtuar vlera 8,663,823 lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 15,661,988 lekë* dhe nuk është zbatuar një detyrë me vlerë 44,499,901 lekë ose 57.6 % e vlerës së rekomanduar.

***Në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:***

**1. Vlera 5,231,076 lekë,** nga subjekti "I.....D" Vlorë"**,** për ulje të sipërfaqes të objektit të dhënë me qira duke e ndarë dhe parealizuar objektin pa dokumentacion të argumentuar të bazuar me matje faktike, por në një genplan të përgjithshëm bashkëngjitur kontratës për periudhën 1 Qershor 2012-31 Dhjetor 2012.
***Nga verifikimi i korrespodencës me shkresa*** *rezulton se subjekti nga vlera e rekomanduar prej* ***5,231,076 lekë****, pranon 4.471.116 lekë, ky detyrim ka lindur si rezultat i ndryshimit të çmimit për metër/2 ne zbatim te VKM ne fuqi. Në zbatim të këtij rekomandimi nga Kryetari i Bashkisë Vlorë me urdhri të brendshëm nr. 15, datë 22.01.2016 "Për ngritjen e komisionit për rivlerësimin e sipërfaqes së pasurisë së paluajtshme në funksion të parkut të lojërave", është ngritur komisioni i verifikimit në terren në këtij objekt. Ky komision në datën 27.01.2016 ka hartuar procesverbalin e matjeve faktike ne funksion te parkut te lojërave shoqëruar edhe me plan vendosje bashkëlidhur, të nënshkruar edhe nga përfaqësuesi i subjektit "I....D" . N. L, ku është konstatuar se subjekti "I....D" ka në përdorim një sipërfaqe 14960 m$^2$.*
*Me vendim të KB nr. 60, datë 27.10.2016 është miratuar ndryshimi i sipërfaqes funksionale të Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës, të kontratës nr. 2964rpe/450kol, datë 4.6.2002, sipas matjeve në terren të bërë me grup pune, që ka në përdorim subjektit "I....D" (për të cilën ka rënë dakord),* ***një sipërfaqe prej 14960 m$^2$****, ku përllogaritja e detyrimit do fillojë nga muaj Korrik 2013, veprim i cili nuk ka ndodhur. Për këtë pikë është mbajtur akt-konstatim më vetë, ku është trajtuar gjerësisht.*

***Detyrë në proces zbatimi.***

**2.** Ndaj **15** operatorëve ekonomikë në vlerën **1,996,418 lekë**, për arsye se janë shpallur fitues në tenderat e zhvilluar, ndërkohë në preventivin e paraqitur në tender, si pjesë e ofertës ekonomike dhe në situacionin përfundimtar zërat e punës *"pajisje"* i kanë llogaritur me vlerën e TVSH, në kundërshtim me UKM nr.. 2, datë 08.05.2003 ,*"Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit",* i ndryshuar.

***Nga verifikimi rezulton se*** *nga vlera e rekomanduar 1,996,418 lekë është arkëtuar vlera 1,670,782 lekë dhe* ***në proces arkëtimi vlera 325,636 lekë****, konkretisht rastet:*

**2.1-** Nga operatori ekonomik "G....I" të arkëtohet v**lera 60,840 lekë,** pasi është shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 13.06.2012 për objektin "**Rikonceptim i sheshit Pavarësia Vlorë, Faza I",** me të metat e cituar më sipër.

***Nga rekomandimet e mësipërme*** *është bere vlerësimi nga Drejtoria e Shërbimeve duke zbritur vlerën e montimit te pajisjeve për këtë objekt për vitin 2011 – 2013. Nga shuma 60,840 lekë, vlera e montimit te pajisjeve është 13,251 lekë. Me shkresën nr. 3110/6 datë 31.07.2014 i është bere kërkesë për pagesën e shumes 47,589 lekë. Firmës i është bllokuar 5% i garancisë se punimeve.*

***Ne proces***

**2.2-Vlera 170,436 lekë,** pasi operatori ekonomik "Sh.....A", i shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 06.05.2011,me objekt **"**Sistemim asfaltim i bllokut te pallatet e Gorishtit**".**

***Nga rekomandimet e mësipërme*** *është bere vlerësimi nga Drejtoria e Shërbimeve duke zbritur vlerën e montimit te pajisjeve për këtë objekt për vitin 2011 – 2013. Nga shuma 170,436 lekë vlera e montimit te pajisjeve është 13,059 lekë. Me shkresën nr. 3110/10 datë 31.07.2014 i është bere kërkesë për pagesën e shumes 157,377 lekë. Nuk është arkëtuar ende. Firmës i janë bllokuar llogarite bankare.*

***Pa zbatuar***

**2.3-Vlera 40,360 lekë,** pasi operatori ekonomik "N.....I", i shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 29.03.2011, në tenderin e zhvilluar me objekt "Rikonstruksion i rrugës Vasil Talo"

***Nga rekomandimet e mësipërme*** *është bere vlerësimi nga Drejtoria e Shërbimeve duke zbritur vlerën e montimit te pajisjeve për këtë objekt për vitin 2011 - 2013 Nga shuma 40,360 lekë, vlera e montimit te pajisjeve është 7,425 lekë. Me shkresën nr. 3110/12 datë 31.07.2014 i është bere kërkesë për pagesën e shumes 32,935 lekë. Nuk është arkëtuar ende.*

***Pa zbatuar***

**2.4-Vlera 54,000 lekë,** pasi operatori ekonomik "L.....I", i shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 28.04.2011, në tenderin e zhvilluar me objekt **"**Sistemim i bllokut Bashki-Rruga Demokracia",

***Nga rekomandimet e mësipërme*** *është bere vlerësimi nga Drejtoria e Shërbimeve duke zbritur vlerën e montimit te pajisjeve për këtë objekt për vitin 2011 – 2013. Nga shuma 54,000 lekë, vlera e montimit te pajisjeve është 5,393 lekë. Diferenca për te paguar 48,607 lekë. Me shkresën nr. 3110/18 datë 31.07.2014 i është bere kërkesë për* ***pagesën e shumes 48,607 lekë. Nuk është arkëtuar ende****.*

***Në proces zbatimi***

**3. Nga 12 persona** në **shumën 64,416 lekë**, për tejkalim të normativave të konsumit karburantit sipas listës, punonjësve në Ndërmarrjen e Shërbimeve Bashkia Vlorë, lista e përcaktuar në proces verbalin nr.. 1 datë 12.03.2013 mbajtur në këtë ndërmarrje. *Trajtuar më hollësisht në pikën 15 faqen 285-288 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*.

***Nga verifikimi rezultoi*** *se deri ne datën 30.11.2014 është arkëtuar shuma prej 58,576 lekë, ne proces arkëtimi mbetet shuma prej 5,840 lekë.*

***Në proces zbatimi***

**10.** Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, nga 7 subjekte pasi nuk kanë paguar apo u është llogaritur më pak taksa e ndikimit në infrastrukturë. Në kundërshtim me nenin 51, të ligjit nr.

8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar dhe VKB Vlorë nr. 62, datë 26.11.2009 "Për taksat dhe tarifat vendore", të ndryshuar, në vlerën **3,999,025 *lekë.***
*Nga verifikimi rezulton se nga vlera prej 3,999,025 lekë arkëtuar vlera 281,600 lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 3,717,425 lekë, si vijon:*
**-Subjekti ndërtues "A.....D"** në shumën **865,709 lekë**, llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë dhe studim urbanistik.

***Pa zbatuar***

**-Subjekti ndërtues "M.....A"** në shumën **2,851,716 lekë**, llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë dhe studim urbanistik.

***Pa zbatuar***

Nga KLSH për punime të pakryera në 10 subjekte për vlerën prej 69,727,480 lekë, janë arkëtuar deri më datën 25.12.2014 nga 9 subjekte në vlerën 25,227,579 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar nga operatori ekonomik "D.....A" , për vlerë prej 44,499,901 lekë, kjo i përket punime të pakryera në zbatimin e kontratës për "Shërbimin e Pastrimit Urban të qytetit"**.**

**11.** Në ***vlerën 18,175,952 lekë,*** për punime të pakryera nga 8 operatorët ekonomikë, në kundërshtim me nenin 7, paragrafi i tretë, të ligjit nr.. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar* dhe kontratat përkatëse, ***si më poshtë:***
**-Në vlerën 451,485 lekë**, ndaj Operatorit Ekonomik "J.....S" për dëmin ekonomik e shkaktuar, për punime të pakryera në objektin "Shërbimi i Mirëmbajtjes së Gjelbërimit".
***Nga verifikimi rezultoi*** *se me shkresën nr. 3110/2 datë 31.07.2014 subjektit i është kërkuar te shpërblej demin e mësipërm. Subjekti me shkresën nr. 8 prot, datë 10.12.2014 ka kthyer një përgjigje ku e njeh detyrimin dhe kërkon pagimin e tij me këste. Deri ne këtë moment ka shlyer 200,000 lekë. Respektivisht ne datën 19.11.2014 dhe 17.12.2014.* ***Detyrimi prej 251,485 lekë do te ndalet ne muajt ne vazhdim***.

***Ne proces***

**-Në vlerën 409,850** lekë, ndaj Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "B.....D" & "C.....E" për dëmin ekonomik, për punime të pakryera në objektin "Rruga "Gjergj Araniti" në veri të kombinatit".
***Nga verifikimi rezultoi*** *se me shkresën nr. 3110/19 datë 31.07.2014 subjektit i është kërkuar te shpërblej demin e mësipërm ne vlerën 409,850. Demi është pranuar nga subjekti por ende nuk është paguar. Do vazhdojnë përpjekjet për ndalimin e shumes pasi ky subjekt ka ende lekë te pa marra nga Bashkia.*

***Pa zbatuar***

**-Në vlerën 4,028,080 lekë**, ndaj Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "L....A" & "C.....U" për dëmin ekonomik, për punime të pakryera në objektin "Sistemim i rrugës Topana – Kuzum Baba". Nga verifikimi rezultoi se me shkresën nr. 3110/10 datë 31.07.2014 subjektit i është kërkuar te shpërblej demin ne vlerën 4.028.080. Subjekti e ka hedhur ne gjyq dhe jemi ne pritje te vendimit te gjykatës.

***Pa zbatuar***

**-Në vlerën 1,492,596 lekë**, ndaj Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "Sh.....A" & "A....I" për dëmin ekonomik, për punime të pakryera në objektin "S.A. blloku i pallateve të Gorishtit".

***Nga verifikimi rezultoi*** *se me shkresën nr. 3110/11 datë 31.07.2014 subjektit i është kërkuar te shpërblej demin ne vlerën 1,492,596. Subjekti nuk i është përgjigjur këtij demi. Bashkia me shkresën nr. 5069 prot datë 09.12.2014 i është drejtuar bankave për bllokimin e llogarisë. Deri tani i është përgjigjur banka kombëtare tregtare dega Vlorë, me shkresën nr. 1878 datë 12.12.2014, duke i bllokuar nga llogaria 490,220 lekë.*

***Pa zbatuar***

**12.** Nga Bashkia Vlorë, të merren masa dhe të kërkohet e ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e demin ekonomik në vlerën **44,499,901 lekë,** nga operatori ekonomik "D.....A" , për punime të pakryera në zbatimin e kontratës për "Shërbimin e Pastrimit Urban të qytetit", veprim ky në kundërshtim me nenin 7, paragrafi i tretë, të ligjit nr.. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar***.** *Trajtuar më hollësisht në pikën 6/1-Zbatimi i kontratave, faqen 130-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Nga ana e Bashkisë Vlorë për mos zbatimin e këtij rekomandimi pretendohet se ju kemi njoftuar me shkresën nr. 4385/1 datë 10.11.2014 jemi duke shqyrtuar dhe kërkojmë kohe për ndërmarrje te veprimeve ligjore.

***Nga verifikimi rezultoi se:*** *Pavarësisht rekomandimeve te KLSH, Bashkia Vlorë edhe pse e ka kundërshtuar masën e dhënë nga KLSH, i është drejtuar subjektit "D.....A" me shkrese nr. 9393 datë 04.11.2016, duke njoftuar palën debitorë të shlyej detyrimin e konstatuar nga KLSH ndaj Bashkisë Vlorë. Në këto kushte pala paditëse "D.....A" i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë padi me objekt "Kundërshtim akti administrativ, kërkesë për shpërblim demi nr. 9393 datë 04.11.2014" te Bashkisë Vlorë ndaj D.....A .*

*Sipas vërtetimit datë 03.01.2018 çështja civile me nr. 31139-02195-84-2017, datë 19.12.2017 me palë paditëse Bashkia Vlorë, të paditur shoqëria "D.....A".*

***Detyrë në proces zbatimi***

**E. MASA ADMINISTRATIVE:**

**a. Për Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Bashkia Vlorë.**

Nga 4 mbikëqyrës të gjobitur për vlerën 200,000 lekë, është arkëtuar vlera prej 150,000 lekë dhe nuk është arkëtuar vlera 50,000 lekë (proces gjyqësor), respektivisht nuk është zbatuar vlera **50,000 lekë në ngarkim të Leonora Dhima**, në cilësinë e mbikëqyrëses së punimeve, me licencë MK 0714/1, "Për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi".

*Me shkresën nr. 3203 datë 11.08.2014 është njoftuar për gjobën prej 50,000 vendosur nga INUV. Objekti për te cilin është gjobitur është hedhur ne gjyq. Jemi te pritje te vendimit te procesit .*

***Ne proces***

**I. Për mos realizimin e taksës** së ndikimit në infrastrukturë për 3 subjekte në vlerën **9,309,088 lekë**, *si vijon:*

a-Subjekti ndërtues **"A.....D"** në shumën **865,709 lekë**, llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë dhe studim urbanistik.

***Pa zbatuar***

b-Subjekti ndërtues **"M.....A"** në shumën **2,851,716 lekë**, llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë dhe studim urbanistik.

***Pa zbatuar***

**c**-Subjekti ndërtues ***"A.....n. "*** me vendimin e KRRT, nr.. 7/61, datë 07.09.2010, me dosje në plotësim dokumentacioni, ka nisur ndërtimin **(përfunduar)** e "Godinë banimi dhe shërbimi **2-5-6-7-8 kate**, me 1 kat nëntokë, Lagje "Kushtrimi" Vlera e llogaritur për tu paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është **5,591,663 lekë.**

***Pa zbatuar***

**Evidenca përmbledhëse e realizimit të detyrave të rekomanduara (Formulari nr. 12/2)**

| Nr. | Lloji i rekomandimit | Rekomandim e gjithsej në numër | Nga këto | | | Nga rekomandimet gjithsej sa më dëm ekonomik | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Zbatuar në numër | Zbatuar pjesërisht në numër | Pazbatuar në numër | Rekomanduar | | Zbatuar (arkëtuar) | | Zbatuar pjesërisht (në proces) | | | Pa zbatuar (pa filluar zbatimi | |
| | | | | | | Peron | 000/leke | Peron | 000/leke | Peron | Arkëtuar në 000/lek | Mbetje në 000/leke | Peron | 000/leke |
| I | **BASHKIA VLORË** | | | | | | | | | | | | | |
| 1. | Masa Organizative | 34 | 17 | 11 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2. | Masa Shpërblim Dëmi | 13 | 7 | 5 | 1 | 14 | 86,489 | 7 | 8,444 | 5 | 8,664 | 15,662 | 4 | 53,808 |
| 3. | Masa Administrative | 13 | 12 | 1 | 0 | 13 | 700 | 6 | 650 | 1 | 0 | 50 | 0 | 0 |
| 4. | Masa Disiplinore | 66 | 11 | 55 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **GJITHSEJ** | **126** | **47** | **72** | **6** | **27** | **87,189** | **13** | **9,094** | **6** | **8,664** | **15,712** | **4** | **53,808** |

## b -PËR BASHKINË VLORË (KONCESIONI)

*1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

KLSH me shkresën nr. 348/10, datë 30.06.2015 ka dërguar në Bashkinë Vlorë rekomandimet e auditimit, ndërsa nga Bashkia Vlorë për zbatim e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 2627/2, datë 07.07.2015, brenda afatit 20 ditor. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Vlorë është hartuar program *(Plan veprimi)* dhe është dërguar në KLSH me shkresën nr. 2627/2, datë 07.07.2015, duke ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

*2. Realizimi i programit (Plan veprimi) dhe raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit prej 6 muaj nga data e njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, siç është përcaktuar në pikën 2 të nenit 30 ligjit nr. 154/2014,datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Vlorë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 348/10, datë 30.06.2015 dhe duhet të raportojë në KLSH Brenda 6 muajve ose brenda datës 31.12.2015 (30.06.2015 deri 31.12.2015), gjë e cila nuk është bërë nga ana e Bashkisë Vlorë, duke shkelur kërkesat e ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.

*3. Nxjerrja e akteve administrative përkatëse (urdhrat ekzekutivë për), nga Titullari i njësisë publike në lidhje me zbatimin e rekomandimeve sipas masave.*

## A. MASA ORGANIZATIVE:

**1. Rekomandimi**: Bashkia Vlorë me procedura ligjore, të revokojë kontratën e koncesionit nr. 496, datë 06.02.2015 me objekt *"Dhënia me koncesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit në qytetin*

*e Vlorës"*, deri në miratimin nga Këshilli i Ministrave të listës përfundimtare të kalimit në përdorim apo në pronësi të pasurive të paluajtshme.

***Nga verifikimi rezulton se**: Bashkia Vlorë ka vlerësuar me kujdes rekomandimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për revokimin e kontratës, vlerësim i bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën e koncesionit. Në lidhje me dispozitat e kontratës ri sjellim në vëmendje 2 aspekte të rëndësishme.*

*Së pari, kontrata e koncesionit në nenin 29 "Pagesat e mbarimit të kontratës", parashikon mënyrën e përllogaritjes së pagesave për shkak të mbarimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktual, pagesa që përbëhen nga 2 elementë : (i) kompensimi dhe (ii) penaliteti. Penaliteti në rast të mbarimit të kontratës në vitet e para të kohëzgjatjes së kontratës mund të arrij deri në 3,000,000 euro. Ky penalitet është i papërballueshëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë nëse kontrata revokohet dhe çështja gjykohet në arbitrazh. Penaliteti i përcaktuar në rast të mbarimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktor, është një element i rëndësishëm i trajtuar me shumë përgjegjësi nga Bashkia Vlorë.*

*Së dyti, kontrata e koncesionit në nenin 30 "Gjykata kompetente" parashikon se organi kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga kontrata është Arbitrazhi i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris. Rrjedhimisht është ky organ që gjykon pretendimet dhe vendos masën e dëmshpërblimit duke u bazuar në formulën e përllogaritjes së penalitetit parashikuar në nenin 29. Ky është një aspekt tjetër që duhet vlerësuar me kujdes dhe përgjegjësi në rast të mbarimit të kontratës nga ana e Bashkisë Vlorë.*

***Në proces zbatimi***

**2. Rekomandimi**: Këshilli Bashkiak Vlorë, pas konstituimit të tij, në mbledhjen e radhës, të marrë në vlerësim e trajtim të gjitha shkeljet e konstatuara nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit e të paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në përfundim të shprehet lidhur me parregullsinë e vendimeve të mëparshme, të marra nga Këshilli Bashkiak dhe konkretisht të Vendimit të KB nr. 45, datë 09.10.2014 dhe nr. 57, datë 11.12.2014.

***Nga verifikimi rezulton se:** Kryetari i Bashkisë Vlorë, Administrata e Bashkisë Vlorë, apo edhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, duke vlerësuar Rekomandimin e KLSH së organi kompetent për revokimin e kontratës në Këshillin e Bashkisë, në datën 25.08.2016 i ka paraqitur këtij këshilli relacionin përkatës për vendimmarrje. Në këtë relacion pasi trajtohet e gjithë problematika dhe Rekomandimi konkret për revokimin e kontratës dhënë në Raportin e KLSH-së, ka theksuar se është pikërisht ky këshill organi vendimmarrës, i cili duhet të analizojë dhe të vendosë për revokimin e kontratës koncesionare. Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53 pika 5 përcaktohet se "5. Rendi i ditës miratohet nga këshilli", kurse në nenin 54 ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak pika (k). Sikurse është deklaruar edhe nga vetë Kryetari i Këshillit në mbledhjen e kryer midis grupit të audituesve të KLSH dhe përfaqësuesve të administratës e të këshillit, kjo çështje është diskutuar 3 herë në këtë organ. Nga Këshilli nuk është vepruar me vendimmarrjen sipas rekomandimit të KLSH-së.*

***Detyrë në proces zbatimi***

**3. Rekomandimi**: Ministria e Ekonomisë dhe Turizmit, në referim të konstatimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në cilësinë e përfaqësuesit të pronarit shtet, të shprehet duke dhënë opinionin e saj, lidhur me parregullsitë e konstatuara në drejtim të cenimit nga Bashkia Vlorë të së drejtës të pronësisë dhe kufizimit të përdorimit të saj, si pasojë e veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe finalizuar me kontratën koncesionare nr. 496, datë 06.02.2015.

*Nga verifikimi rezulton se*: *Bashkia Vlorë me shkresën nr. 2771, datë 20.07.2015 i ka kërkuar sqarime Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Tiranë, por që deri më datën 26.11.2015 ende nuk është kthyer përgjigje për këtë shkresë nga kjo Ministri.*
*Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7132/1 prot dt. 21.09.2016, në të cilën shprehet mos vijimin e procedurave të mëtejshme.*

***Detyrë në proces zbatimi***

**C. MASA ADMINISTRATIVE**:

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurën me objekt "*Dhënia me koncesion e sistemimit dhe menaxhimit të parkimit, në qytetin e Vlorës*", si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, Agjencia e Prokurimit Publik, në mbështetje të neneve 11/c dhe 43, të ligjit nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar dhe nenit 65, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, për procedurën e sipërcituar, pas kryerjes së hetimit administrativ sipas shkresës nr. 8412/1 datë 10.07.2015, me Vendim nr. 72, datë 25.06.2015, ka dënuar me gjobë **7 persona** në shumë gjithsej **4,500.000 lekë**, respektivisht:

**1. Sh. Gj.** ish-kryetari i Bashkisë Vlorë në cilësinë e ish -Titullarit të Autoritetit Kontraktor gjobë në masën 1,000,000 lekë,

2. Të dënojë me gjobë në masën 500,000 lekë, 6 anëtarët e Komisionit Vlerësimit të Koncesionit/Partneritetit publik privat, konkretisht:

**1. A. M.** me detyrë Zv/Kryetar Bashkie, në profesionin Ing. Ndërtimi, në cilësinë e Kryetarit të komisionit të dhënies me koncesion/partneritet publik privat;

**2. I. B**, me detyrë Zv/Kryetar Bashkie, në profesionin ekonomist, në cilësinë e anëtarit të komisionit të dhënies me koncesion/partneritet publik privat;

**3. A. B.** me detyrë Zv/Kryetar Bashkie, në profesionin Ing .gjeolog, në cilësinë e anëtarit të komisionit të dhënies me koncesion/partneritet publik privat;

**4. G. Sh.** me detyrë Drejtor Infrastrukture dhe Zbatimit të Projekteve, në profesion Ing. Ndërtimi, në cilësinë e anëtarit të komisionit të dhënies me koncesion/partneritet publik privat;

**5. M. M.** me detyrë specialist transporti, në profesion Ing. mekanik, në cilësinë e anëtarit të komisionit të dhënies me koncesion/partneritet publik privat;

**6. P. Th.** me detyrë përgjegjës i njësisë së prokurimit, në profesionin Jurist, në cilësinë e anëtarit të komisionit të dhënies me koncesion/partneritet publik privat.

***Nga verifikimi rezultoi se:*** *Për gjobat e vëna me Vendim nr. 72, datë 25.06.2015, nga APP në shumë gjithsej 4,500.000 lekë, është hapur proces gjyqësor, vërtetimi datë 04.11.2015.*

***Detyrë në proces zbatimi***

- **PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE BASHKINA ORIKUM**.

*1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

KLSH me shkresën nr. 1148/6 datë 31.03.2015 (prot. në subjekt me nr. 576 datë 02.04.2015) ka dërguar në Bashkinë Orikum rekomandimet e auditimit. Nga Bashkia Orikum për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr. 599, datë 08.04.2015 (prot. KLSH me

nr. 160/10 datë 17.05.2015), ose brenda 10 ditësh. Pra përgjigja e Bashkisë Orikum për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit 20 ditor. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Orikum është hartuar program (Plan veprimi) nr. 599 datë 08.04.2015 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

*2. Realizimi i programit (Plan veprimi) dhe raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit prej 6 muaj nga data e njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, siç është përcaktuar në pikën 2 të nenit 30 ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".*

Nga verifikim rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Orikum, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 1148/6 datë, 31.03.2015 e cila është e protokolluar në Bashkinë Orikum me shkresën nr. 576, datë 02.04.201 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 02.10.2015. Pra nuk është zbatuar afati i kthimit të përgjigjes, në kundërshtim me pikën 2 e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"**.**

**A. MASA ORGANIZATIVE**:

**1. Rekomandimi**: Bashkia Orikum të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore, për zbatimin rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH, për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës 3,143,210 lekë nga K. B. në vlerën 1,571,605 lekë dhe R. M. në vlerën 1,571,605 lekë, për shkeljet e konstatuara në tendera me efekte financiare me dëm ekonomik.

***Nga verifikimi rezulton se*:** *Bashkia Orikum, ka njoftuar respektivisht me shkresat nr. 716, datë 30.04.2015, z. K. B. për të kryer ekzekutimin vullnetar të shumës prej 1.571.605 lekë, si dhe me shkresën nr. 717, datë 30.04.2015, është bërë njoftimi për znj. R. M., për ekzekutim vullnetar të shumës prej 1.571.605 lekë.*

*Subjektet e mësipërme nuk kanë kryer ekzekutimin vullnetar për masën e shpërblimit të dëmit sipas rekomandimit të KLSH, për këtë arsye, Njësia Administrative Orikum i është drejtuar me kërkesë-padi Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për detyrimin në rrugë gjyqësore, të subjekteve të sipërcituar, për të përmbushur detyrimin. Më datën 12.11.2015 është bërë regjistrimi i kërkesë padisë në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë.*

***Detyrë na proces zbatimi***

**2. Rekomandim:** Bashkia Orikum dhe Drejtoria e Zhvillimit Territorit, të marrë masa që në dorëzimin të dosjes teknike të mbikëqyrjes të punimeve, të verifikohen nëse janë plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar" si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit". Gjithashtu, nga ana e Bashkisë Orikum të merrem masa për marrjen në dorëzim të investimeve, në përfundim të afateve përkatëse, në përputhje me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktivëve në njësinë e sektorit publik".

***Detyrë e pazbatuar***

**3. <u>Rekomandim</u>**: Bashkia Orikum, duhet të rakordojë me ZVRPP Vlorë për emrat e qytetarëve, adresat dhe sipërfaqen e banimit të secilit prej pronarëve të banesave, duke bërë edhe verifikimin përkatës.

***Ne proces zbatimi***

**4. <u>Rekomandim</u>**: Bashkia Orikum në bashkëpunim me IMKT, të marrë masat për të siguruar mjetet e nevojshme, vlerësimin financiar, për ekzekutimin e vendimeve për prishje të objekteve pa leje në territorin e saj administrativ, duke aplikuar të gjitha masat administrative (gjobë, etj.), dhe të kryej kallëzim penal.

***<u>Nga verifikimi rezulton se</u>***: *Ky rekomandim i ka kaluar për kompetencë Bashkisë Vlorë, për shkak të ristrukturimit të ndodhur në bazë të ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". IKMT nuk është e përfshirë në strukturën e re të Njësisë Administrative Orikum. Kompetencat e IKMT të ish Bashkisë Orikum, i kanë kaluar IKMT së Bashkisë Vlorë.*

***Ne proces zbatimi***

**<u>B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>**.

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 08.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", pjesa e VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 20.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), nga KLSH i është rekomanduar ish kryetarit të Bashkisë Orikum G. Ç, që nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në **vlerën 2,807,380 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore dhe shkallët e gjykimit.

***<u>Nga verifikim rezulton se</u>*: *Nga vlera e rekomanduar prej 2,807,380 lekë është arkëtuar deri më datën 26.11.2015 vlera prej 1,010,060 lekë, duke mbetur pa u arkëtuar edhe vlera prej 1,797,320 lekë, nga e cila vlera prej 1,548,950 lekë, i përket shoqërisë "H....C....." e cila është në proces gjyqësor, duke mbetur pa u arkëtuar vlera prej ***248,370 lekë***.**

*Në mënyrë tabelore rekomandimet, arkëtimet dhe natyra e rasteve të mos realizimit paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:*

| Nr. | Subjekti | Natyra e Shkeljes | Rekomanduar | Arkëtuar Deri 16.11.2015 | Debitorë më datën 16.11.2015 | Në Proces Arkëtim | Në Proces Gjyqësor | Nisur Njoftime e s'kanë Paguar | Nuk Pranohen nga Subjekti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | "H....C.....' | Shpërblim dëmi për punime të pakryera në objekt prokurimi | 1,548,950 | 0 | 1,548,950 | | 1,548,950 | Njoftim datë 24/4/2015- | |
| 2 | "I.....A" | Shpërblim dëmi për punime të pakryera në objekt prokurimi | 1,002,870 | 836,000 | 166,870 | | | Njoftim datë 23/4/2015, me shkresën Nr.669 Prot | 166,870 |
| 3 | "G.....A" | Shpërblim dëmi për punime të pakryera në objekt prokurimi | 113,940 | 113,940 | 0 | | - | | |
| 4 | "A.....A" | Për përfitim të padrejtë si pasojë e llogaritjes së vlerës së paguar të TVSH | 60,120 | 60,120 | 0 | | - | Njoftim datë 23/4/2015, me shkresën Nr.671Prot | |
| 5 | Drekë Bashkia Orikum | Shpërblim dëmi | 63,500 | | 63,500 | | | | 63,500 |
| 6 | "B.....I" | Shpërblim dëmi për punime të pakryera në objekt prokurimi | 18,000 | | 18,000 | 18,000 | | | |

| Nr. | Subjekti | Natyra e Shkeljes | Rekomanduar | Arkëtuar Deri 16.11.2015 | Debitorë më datën 16.11.2015 | Në Proces Arkëtim | Në Proces Gjyqësor | Nisur Njoftime e s'kanë Paguar | Nuk Pranohen nga Subjekti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Totali** | | **2,807,380** | **1,010,060** | **1,797,320** | **18,000** | **1,548,950** | | **230,370** |

*Në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë*:

**1. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Orikum të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **1,548,950 lekë**, nga shoqëria "H....C.....", vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria "H....C.....", për punime të pa kryera në objektin "Rikonstruksion i kopshtit Mustafa Qemal Ataturku".

***<u>Nga verifikimi rezulton se</u>:*** *Është bërë njoftimi me shkresë nr. 670, datë 23.04.2015 ndaj subjektit "H.....C.....N', për të kryer pagesën në mënyrë vullnetare. Subjekti "H....C.....' ka kundërshtuar gjyqësish detyrimin e lënë nga ana e KLSh në vlerën 1,548,950 lekë. Me vendimin gjyqësor nr. 1052, datë 14.07.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, ka disponuar në favor të operatorit ekonomik "H.....C.....N". Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Bashkia Orikum, ç'ka vërtetohet nga Vendimi mbi pranimin e Ankimit, të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, datë 01.09.2015. Çështje është ne gjykatën e Apelit.*

***Detyrë në proces zbatimi***

**2. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Orikum të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **1,002,870 lekë**, nga shoqëria "I.....A", vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria "I.....A", për punime të pa kryera në objektin "Rrethimi i varrezave D.....A Fshat dhe Tragjas" – Orikum.

***<u>Nga verifikimi rezulton se</u>***: *Është bërë njoftimi me shkresë nr. 699 , datë 23.04.2015. Nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej 1,002,870 lekë, deri më datën 26.11.2015 është kryer pagesa vullnetare në Raiffeisen Bank me mandat arkëtimin datë 25/6/2015 në shumën 836,000 leke, duke mos arkëtuar edhe vlerën prej **166,870 lekë**, me pretendimin se kane derdhur TVSH shtetit.*

***Detyrë në proces zbatimi***

**3. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Orikum të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 18,000 lekë, nga shoqëria "B.....I", vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria "B.....I", për punime të pa kryera në objektin "Rrethimi i varrezave D.....A i Ri" Orikum.

***<u>Nga verifikimi rezulton se</u>:*** *Është bërë njoftimi subjektit "B.....I" , me shkresën nr. 678 prot, datë 24.04.2015. Nga ana e këtij subjekti është pretenduar se është bërë arkëtimi i shumës në rrugë bankare por nuk ka paraqitur asnjë provë në Bashkinë Orikum. Për këtë subjekt NjA Orikum, do të marrë masën e ndalesës së kësaj shume nga fondi i ngurtësuar prej 5 % (69.555 lekë)e fondit të objektit të prokurimit "Rrethimi i varrezave", në momentin e ngurtësimit të këtij fondi. Bashkangjitur fotokopje e njoftimit dhe fatura përkatëse).*

***Ne proces zbatimi***

**4. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Orikum të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 63,500 lekë, për shpenzim të paligjshëm për 1 drekë, sipas listës të 50 personave që disponohet në Bashkinë Orikum.

***<u>Nga verifikimi rezulton se</u>***: *Nga Bashkia Orikum për mosrealizimin e këtij rekomandimi pretendohet se: nuk është zbatuar pasi në Urdhër shpenzimin përkatës është saktësuar, se ky aktivitet, është realizuar për pritje zyrtare për festat e fund vitin dhe krishtlindjet e vitit 2012, me përfaqësues nga*

*mediat dhe Institucionet Shtetërore dhe nuk ekziston një listë e pjesëmarrësve, duke e bërë të pamundur arkëtimin e vlerës prej 63,500 sipas listës të 50 personave që përcaktohet në rekomandimin 6.1 të KLSH.*

***Detyre e pa zbatuar***

- **NE NJËSINË ADMINISTRATIVE NOVOSELË**

*1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".*

Nga verifikimi rezulton se KLSH, për auditimin e ushtruar në ish-Komunën Novoselë, ka dërguar në Bashkinë Vlorë rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 501/8, datë 25.07.2015, protokolluar në subjekt me nr. Datë 07.2015. Përgjigja e Bashkisë Vlorë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë me shkresën nr. 2973, datë 19.08.2015 ose brenda 20 ditëve, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Është hartuar program (Plan veprimi) nr. 2973/1, datë 19.08.2015, janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

*2. Realizimi i programit (Plan veprimi) dhe raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit prej 6 muaj nga data e njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, siç është përcaktuar në pikën 2 të nenit 30 ligjit nr.154/2014,datë 27.11.2914"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*".

Nga verifikim rezulton se përfundimet e auditimit për auditimin e ushtruar në ish-Komunën Novoselë i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Vlorë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 501/8 datë, 25.07.2015 dhe duhet të raportohet në KLSH brenda 6 muajve ose deri më datën 25.01.2016 (nga datë 25.07.2015 deri ne datë 25.01.2016). Nga Bashkia Vlorë nuk është bërë raportimi brenda këtij afati të përcaktuar (6 mujor), në kundërshtim me pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

*3. Nga verifikimi i realizimit të 3 pikave të mësipërme të programit të auditimit të KLSH, respektivisht pikat nr. 2,-realizimi i programit, pika 3-nxjerrja e akteve administrative, pika nr. 5-ndjekja e rrugëve ligjore dhe pika nr. 5- kryerja e regjistrimeve në kontabilitet rezulton të jenë realizuar si më poshtë:*

**A. MASA ORGANIZATIVE**.

Nga KLSH janë rekomanduar 25 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces 21 masa të tjera dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative.

Për arsye të reformës territoriale të ish-Komunës Novoselë, rekomandimet e mëposhtme duke filluar nga rekomandimi nr. 2-te deri 25-te, do te zbatohen nga Bashkia Vlorë.

*Ne mënyre te detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si me poshtë:*

**1. Rekomandimi**: Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë *(në të cilën përfshihet Komuna Novoselë)*, ku zyra e planifikimit të territorit të bashkisë, të marrë masa, që procesi i shqyrtimit të kërkesave për leje zhvillimore dhe leje ndërtimi, të asistohet nga këshilli teknik i ngritur për këtë qëllim, nëpërmjet dhënies së mendimit me shkrim, mbi të cilën duhet të bazohet vendim-marrja e autoritetit përgjegjës, menaxherit të njësisë vendore për ushtrimin e përgjegjësive të ngarkuara nga ligji për planifikimin e territorit.

***Detyrë e pazbatuar***

**2. Rekomandimi**: Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku zyra e planifikimit të territorit të bashkisë të marrë masa që të gjitha rastet të lejeve zhvillimore të miratuara së bashku me projektet e plota të zhvillimit të dërgohen pranë Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit, brenda afatit të miratuar në përputhje me ligjin "Për planifikimin e territorit".

***Detyrë e pazbatuar***

**3. Rekomandimi**: Ky rekomandim do të zbatohet nga Bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku zyra e planifikimit të territorit të bashkisë të marrë masa, që pas përfundimit të afatit të lejeve zhvillimore-ndërtimore dhe punimeve të ndërtimit, si dhe para se të miratohet leja e përdorimit, nga autoriteti përgjegjës për miratim të hartohet vërtetimi i përputhshmërisë mbi bazën e verifikimit nga projektuesi, supervizorit sipas akt-kolaudimit të konfirmuar edhe nga kolaudatori, ku hartuesit të shprehen, nëse ka përputhje me sipërfaqen që zë struktura e miratuar sipas lejes.

***Detyrë e pazbatuar***

**4. Rekomandimi:** Ky rekomandim do të zbatohet nga Bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku zyra e planifikimit të territorit të bashkisë të marrë masa dhe të kërkojë nga subjekti "J....O" që të paraqesë të gjithë dokumentacionin e cituar më sipër dhe të rivlerësojë ligjshmërinë e dokumentacionit duke marrë dhe masat administrative përkatëse. Po kështu, në asnjë rast të mos miratohen leje zhvillimore, ndërtimore dhe përdorimi të subjekteve kërkuese, pa plotësuar dokumentacionin e nevojshëm.

***Detyrë e pazbatuar***

**5. Rekomandim**: Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm tekniko ligjor, për regjistrimin e pasurive të pa luajtshme, të cilat me vendime të Këshillit të Ministrave kanë kaluar në pronësi të Komunës.

***Detyrë e pazbatuar***

**6. Rekomandimi**: Ky rekomandim do të zbatohet nga Bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku të merren masa për ngritjen e një komisioni të posaçëm, për kryerjen e inventarizimit fizik dhe hartimin e plan vendosjeve, saktësimin në harta në rakordim me ZVRPP në lidhje me gjendjen juridike për secilën nga pronat e përfshira në listën dhe të miratuara paraprakisht, verifikimin në terren të ndryshimeve nga përcaktimet e listës për të bërë dhe azhurnimet përkatëse në rast mospërputhjesh.

***Detyrë e pazbatuar***

**7. Rekomandimi**: Ky rekomandim do të zbatohet nga Bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku të marrë masa që të kryhet inventarizimi fizik mbi gjendjen e statusit juridik të 250.3 ha sipërfaqe tip kullota, livadhe shkëmbore me bimësi pyjore, të cilat me VKM nr. 174, datë 13.02.2008, janë transferuar në pronësi të komunës, si dhe të bashkëpunohet me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Vlorë, që të përcaktohen kategoritë, të merren hartat përkatëse me azhornimet e ndryshimeve, ku të përcaktohen kufijtë dhe plan vendosjet e tyre.

***Detyrë e pazbatuar***

**8.Rekomandim**: Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku të merren masa për sipërfaqen prej 52.9 ha të zaptuar dhe që shfrytëzohet nga fermerët, që të bëhen verifikime në terren dhe azhurnime përkatëse si dhe ndiçen procedurat e kontraktimit për

dhënien me qira të tyre. Të hapet regjistri për evidentimin e detyrimit ligjor për shumën totale **1,848,138 lekë** (taksë toke 633,680 lekë + 1,214,458 lekë tarifë qiraje). Për rastet e refuzimeve, të ndiqen procedurat ligjore, për largimin e fermerëve nga tokat e zaptuara dhe procedimin gjyqësor të tyre.
Duke u bazuar te Raporti i KLSH i vitit 2010 Nr.546/7 Prot. Datë 24.03.2010 ne te cilin është konstatuar shkelje dhënia me qira e tokave bujqësore te pandara, nga viti 2011-2014 nuk ka vazhduar vjelja e qerasë së këtyre tokave. Si rrjedhim nuk është lëshuar asnjë urdhër qe te detyroj personat qe kane marre toke me qira për derdhjen e kësaj shume.
Lista e debitorëve qe kane mare toke me qira paraqitet në pasqyrën Aneks 1, bashkëlidhur këtij akti:

***Detyrë e pazbatuar***

**9. <u>Rekomandim</u>**: Ky rekomandim do të zbatohet nga Bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), ku financa e bashkisë të marrë masa për kontabilizimin e të ardhurave që nga azhurnimi i të ardhurave në librin ditar, prerjen e artikujve kontabël për llogaritë që preken, deri në paraqitjen e gjendjeve në llogaritë e klasës 7 të ardhurave në pasqyrat financiare.
Me marrjen e dokumentacionit kontabël nga ish komuna do te kontabilizohet ne mbylljen e llogarive te vitit 2015

***Detyrë e pazbatuar***

**10.<u>Rekomandim</u>**: Ky rekomandim do të zbatohet nga Bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), e cila ta marrë masa dhe të ngrejë grup pune. në bashkëpunim me sektorin e Financës të bëjë vlerësimin dhe analizën e vlerave të paraqitura në llogaritë e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara 212-213-214-218. Po kështu të kryhet analiza e llogarisë së aktiveve të patrupëzuara 230, ku vlerat analitike e projekt-studimeve të shpërndahet dhe të përfshihen në vlerat e aktiveve të trupëzuara përkatëse.

***Detyrë në proces zbatimi***

**11.<u>Rekomandimi</u>**: Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), Zyra e Financës së bashkisë të marrë masa dhe të procedojë, sipas kërkesave ligjore për inventarët të nxjerrë jashtë përdorimi, duke kryer procesin e tjetërsimit apo të asgjësimit të shoqëruara, duke saktësuar veprimet kontabël përkatëse.

***Detyrë e në proces zbatimi***

**12. <u>Rekomandimi</u>**: Ky rekomandim do të zbatohet nga bashkia Vlorë (në të cilën përfshihet Komuna Novoselë), Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me financën e Bashkisë dhe policinë bashkiake, të kontabilizojë debitorët dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre, duke ndjekur të gjitha hapat ligjore deri në sekuestrim pasurie të subjekteve debitorë, sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur raportit auditimit.
*<u>Nga verifikimi rezulton se</u>: Lista me debitorët e taksave nuk është regjistruar në kontabilitet nuk kanë dalë njoftim vlerësimet për detyrimet tatimore dhe deri më datën 30.09.2017 gjendja e debitorëve paraqitet në pasqyrën e mëposhtme*:

| Nr. | Natyra e debitorëve | Rekomanduar KLSH | | Arkëtuar deri 30.09.2017 | | Debitorë me datë 30.09.2017 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Person | Leke | Persona | Leke | Person | Leke |
| 1 | Debitorë biznesi i vogël | | 10,764,500 | | 2.780.510 | | 7.983.990 |
| 2 | Debitorë taksa e tarifa vendore | 1732 | 80,204,500 | | 17.163.238 | 1732 | 63.041.262 |

| Nr. | Natyra e debitorëve | Rekomanduar KLSH | | Arkëtuar deri 30.09.2017 | | Debitorë me datë 30.09.2017 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Person | Leke | Persona | Leke | Person | Leke |
| | Gjithsej | | 90,969,000 | | 19.943.748 | | 71.025.252 |

Për mos njohjen e gjendjes të debitorëve të taksave dhe azhorinimin e tyre për vlerën prej 90,969,000 lekë, mos pasqyrimin e tyre ne kontabilitet, nga të cilat 60 subjekte debitorë ne vlerën prej 10,177,217 lekë dhe takës së tokës, mos evidentimi i listës së debitorëve të taksave vendore, mos zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e debitorëve, mbajnë përgjegjësi inspektorët e Drejtorisë së Taksave Bashkia Vlorë, nga momenti i bashkimit të Njësive Vendore**.**

***Detyrë në proces zbatimi***

**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**:

-Nxjerrja e akteve administrative përkatëse (urdhrat për kryerjen e ndalesave), nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), në zbatim të pikës 93, të Udhëzimit Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve.

-Ndjekja e rrugëve ligjore (Hartimi i Padive Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

-Kryerja e regjistrimeve në kontabilitet nga Nëpunësi zbatues, (pas daljes së urdhrave administrative), për vlerën e shpërblimit të dëmit dhe ndjekja e procesit të kryerjes së ndalesave në vazhdimësi.

Nga verifikimi i realizimit të pikave të mësipërme të programit të auditimit të KLSH, rezulton të jenë realizuar si më poshtë:

Nga KLSh është rekomanduar që të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative në të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbarimor, me qëllim arkëtimin e vlerës **18,684,802 lekë**.

***Nga verifikimi rezultoi se*:** *Nuk ishin kryer regjistrimet në kontabilitet dhe nga vlera e rekomanduar prej 18,684,802 lekë deri më datën 30.09.207 ishte arkëtuar shuma prej 206,850 lekë, duke mbetur pa arkëtuar edhe shuma prej 18, 477, 952 leke, nga të cilat:*

***- Janë rekomanduar nga KLSH, gjithsej vlera.....18,684,802 lekë***

*-Nga e cila: janë arkëtuar deri më datën 30.09.2017 vlera prej.....206,850 lekë*

*-Nuk janë arkëtuar deri më datën 30.09.2017.....18,477,952 lekë*

*-Janë dërguar shkresat dhe nuk ka filluar arkëtimi për persona në vlerën.....366,005 lekë*

*-Janë në proces gjyqësor 4 punonjës të administratës dhe 2 subjekte private.....13,269,196 lekë*

*-Janë pezull debitorët e tokës për vlerën.....3,313,719 lekë*

*-Nuk janë nxjerrë urdhrat tejkalimet e karburantin për 2 persona në vlerën.....1,529,032 lekë*

*Në mënyrë të detajuar realizimi i masave shpërblim dëmi paraqitet si më poshtë*:

**1. Rekomandimi**: Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti "S.....K" . për vlerën **144,200 lekë**, e përfituar padrejtësisht, si rrjedhojë e preventivimit të pajisjeve të llogaritur me gjithë vlerën e TVSH në objektin "Shkolla e re Poro komuna Novoselë".

***Nga verifikimi rezulton se**: Është bërë njoftimi dhe bllokimi i llogarive bankare me shkresën nr. 69 Prot, datë 12.11.2015, por nuk ka filluar ende arkëtimi. Sipas Bashkisë Vlorë detyrimi prej 144,200 lekë do ti mbahen ne momentin qe do te paraqesë kërkesën për ngurtësimin e fondit 5%, garancisë se objektit.*

***Detyrë ne proces zbatimi***

**2. Rekomandimi**: Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti P.....L, për vlerën **759,000 lekë**, përkatësisht nga: Sh. M. për vlerën 151,800 lekë, Sh. M. për vlerën 151,800 lekë, A. H. për vlerën 151,800 lekë, K. S. për vlerën 151,800 lekë, L. M. për vlerën 151,800 lekë, vlerë e konstatuar në tenderin me objekt "blerje 3 automjete vetëshkarkuese për nevoja të komunës Novoselë ", të cilat janë vlerësuar në kundërshtim me referencat e standarteve ndërkombëtare dhe me dokumentet e origjinës, si dhe janë marrë në dorëzim në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit dhe me kontratën nr.633/1, datë 16.5.2013, neni "detyrimet e palëve".

***Nga verifikimi rezulton se:** Detyrimet e mësipërme nuk janë arkëtuar, pasi janë në proces gjyqësor, padia e ngritur ne datë 23.10.2015 pranë Gjykatës Administrative Çështje është ne Gjykatën Administrative te Apelit, Tirane, (Vendim nr. 864 datë 17.07.2017)*

***Detyrë në proces zbatimi***

**3. Rekomandimi**: Të shlyhet vlera e dëmit për 8,996,440 lekë, pasi janë preventivuar më tepër fond limit, në objektin "Rikonstruksioni i rrugës Hidrovor Akërrni faza e II" Komuna Novoselë, përkatësisht nga:

- K. SH. për 4,498,220 lekë,
- Sh. M. për 4,498,220 lek

***Nga verifikimi rezulton se**: Vlerat e mësipërme nuk janë arkëtuar. Kërkesë padia është rrezuar nga gjykata ( vendim nr. 1234 datë 12.07.2017 ), dhe është ankimuar nga Bashkia Vlorë .*

***Detyrë në proces zbatimi***

**4.Rekomandimi**: Të kërkohet arkëtimi i dëmit nga subjekti BOE "C....O" dhe "A.....A" , për vlerën **3,164,256 lekë** , për punime të pakryera në objektin "Ndërtimi i shkollës së re 9 – vjeçare Pilo Prifti" Novoselë, sipas kontratës nr. 240, datë 13.10.2014.

***Nga verifikimi rezulton se**: Nga subjekti "*C....O*" është hapur proces gjyqësor dhe fituar sipas kërkesë padisë nr. 26 prot dt. 09.09.2015. Nga Bashkia Vlorë nuk është apeluar vendimi, veprim të cilën mban përgjegjësi D. Z. me detyrë Drejtor juridik për mos ndjekje të hallkave të tjera të procesit gjyqësor.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:***
*Me shkresën nr. 224/14, datë 17.01.2018 nga D. Z. është paraqitur kundërshti ne lidhje me pikën 4 të rekomandimit, por që nuk argumenton problemin e trajtuar, pasi nga Drejtoria Juridike nuk është hapur proces gjyqësore për vijimin e procedurave të mëtejshme.* ***Nuk merret në konsideratë.***

***Proces zbatimi***

**5. Rekomandimi**: Të kërkohet arkëtimi i dëmit për vlerën **221,805 lekë**, përfituar pagesa të paligjshme për vitin 2014-2015, përkatësisht nga këta këshilltar të komunës Novoselë, përkatësisht: A. B. për vlerën 14,310 lekë, S. T. për vlerën 14,310 lekë, Th. M. për vlerën 7,155 lekë, K. M. për vlerën 7,155 lekë, A. L. për vlerën 28,620 lekë, M. H. për vlerën 7,155 lekë, A. L. për vlerën 21.465 lekë, A. L. për vlerën 7,155 lekë, A. M. për vlerën 14,310 lekë , N. H. për vlerën 7,155 lekë, M. B.

për vlerën 7,155 lekë, Gj. L. për vlerën 14,310 lekë, M. B. për vlerën 28,620 lekë, L. J. për vlerën 14,310 lekë dhe K. M. për vlerën 28,620 lekë.
*Nga verifikimi rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar, pasi personat të cilat kanë qenë anëtarë këshilli janë larguar dhe nuk kanë adresë pune.*

***Detyrë e pazbatuar***

**6. Rekomandimi**: Bashkia Vlorë (e cila ka përfshirë komunën Novoselë nga shkrirja si njësi vendore) të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të pashlyera në shumën **3,313,719 lekë nga 39 përdoruesit**, të parcelave të marra me qira nga fondi i tokave të pandara pronë e kësaj njësie vendore, sipas aneksit nr. 1/1 bashkëlidhur raportit auditimit.
***Nga verifikimi rezulton se:*** *Bashkia Vlorë është drejtuar personave te mësipërm me shkresën nr. 3242 datë 21.08.2015 "Kërkesë për shpërblim demi", për arkëtimin e detyrimeve. Deri në datën e hartimit të këtij akti është arkëtuar vlera prej nga 42,900 lekë nga XH. L. dhe mbetet për arkëtim vlera 3,313,719 lekë***.**

***Detyrë në proces zbatimi***

**7. Rekomandimi**: Të arkëtohet vlera **117,000 lekë** nga punonjësit: Sh. M. për vlerën 37,500 lekë, K. K. për vlerën 6,000 lekë, R. H. për vlerën 22,500 lekë, SH. M. për vlerën 21,000 lekë, D. A. për vlerën 10,500 lekë, O. A. për vlerën 4,500 lekë, J. H. për vlerën 6,000 lekë dhe A. H. për vlerën 9,000 lekë, të cilët kanë përfituar dieta në mënyrë të paargumentuar.
***Nga verifikimi rezulton se*** *ky rekomandim është realizuar pjesërisht. Janë arkëtuar nga J. H.* për vlerën *6,000 leke , O. A.* për vlerën *4,500 leke D. A.* për vlerën *10,500 leke ne datën 06.11.205.*
*Pjesa tjetër është ne proces gjyqësor MA nr. 334 dt. 06.11.2015 ,MA nr. 333 dt. 06.11.2015,MA nr. 329. dt. 05.11.2015. Pra nga shuma 117,000 leke janë arkëtuar 21,000 leke dhe kane ngelur te pa arkëtuara* ***96,000 leke (****Çështje ne Gjykatën Administrative te Apelit, Tirane, Vendim nr. 864 datë 17.07.2017).*

***Detyrë në proces zbatimi***

**8. Rekomandimi**: Të arkëtohet vlera **253,500 lekë**, nga A. L. shofer 238,000 lekë dhe A. N. shofer 15,500 lekë , pasi kanë përfituar dieta mbi bazën e dokumenteve financiare të parregullta.
***Nga verifikimi rezulton se*** *ky rekomandim nuk është zbatuar, pasi personat janë ne proces gjyqësor (Ankimi Civil i dt. 23.10.2015). Çështje është ne Gjykatën Administrative te Apelit, Tirane (Vendim nr. 864 datë 17.07.2017)*

***Në proces zbatimi***

**9. Rekomandimi**: Bashkia të marrë masa që të ngrejë grup pune me specialistë përkatës dhe të bëjë ri llogaritjen e shpenzimeve për përdorimin e karburantit për Fadromë, të nxjerrë diferencat dhe të kërkojë zhdëmtimin nga personat përfitues për vlerën 981,250 lekë.
***Nga verifikimi rezulton se*** *ky rekomandim nuk është zbatuar. Dokumenti justifikues është përgatitur. Përgjegjës për këtë dem është L.D. shoferi i Fadromë, por që vlera nuk është arkëtuar*.
Nga verifikimi rezultoi se vlera prej 981,250 nuk është arkëtuar .

***Detyrë e pazbatuar***

**10. Rekomandimi**: Bashkia të marrë masa që të ngrejë grup pune me specialistë përkatës dhe të bëjë ri llogaritjen e shpenzimeve për karburant të pajustifikuar, të përdorur mbi limitin ligjor të distancave të përshkruara në fletë-udhëtimet e hartuara, për 2 automjetet me targa VL ... B dhe AA....CZ, të nxjerrë diferencat dhe të kërkojë zhdëmtimin nga personat përfitues për vlerën 547,782 lekë.

***Nga verifikimi rezulton se*** *është ngritur grupi i punës dhe është përcaktuar normativa e harxhimit te karburantit (shkresa nr.3857 prot dt. 23.09.2015), por nuk është nxjerrë vlera për zhdëmtim nga personat përgjegjës.*

***Nuk është zbatuar***

## C. MASA ADMINISTRATIVE:

Nga auditimi në komunën Novoselë për vitin 2013-2015, u konstatuan disa shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar.

KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Vlorë, që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet nga "Gjobë" deri në "Heqje e Licencës së ushtrimit të profesionit me afat," nga verifikimi rezultoi se për **3 mbikëqyrësit** e punimeve është marrë masë vendim me gjobë në masën 50,000 lekë, secili si më poshtë:

**1. Sh. M**, nën cilësinë e projektueses dhe kolaudatores, nga Kryeinspektori i IMTV Vlorë është nxjerr vendimi nr. 16 datë 30.12.2015 me nr. seri 000266 duke e gjobitur në vlerën 50,000 lekë, (bashkëlidhur fotokopje e Vendimit gjobës), por nuk ka filluar procedura për kryerjen e ndalesave.

**2. D. Q**, nën cilësinë e mbikëqyrësit dhe kolaudatores të punimeve nga Kryeinspektori i IMTV Vlorë është nxjerr vendimi nr. 17 datë 30.12.2015 me nr. seri 000267 në vlerën 50,000 lekë, bashkëlidhur fotokopje e Vendimit gjobës), por nuk ka filluar procedura për kryerjen e ndalesave.

**3. A. K.** nga Kryeinspektori i IMTV Vlorë është nxjerr vendimi nr. 18 datë 30.12.2015 me nr. seri 000268 në vlerën 50,000 lekë, bashkëlidhur fotokopje e Vendimit gjobës), por nuk ka filluar procedura për kryerjen e ndalesave.

***Nga verifikimi rezulton se****, nga ana e ish Kryeinspektorit të IMTV D. T., janë nxjerrë vendimet për penalizmin me gjobë të 3 mbikëqyrësve, por nuk është bërë i mundur kontabilizimi dhe ndjekja e procedurës për arkëtim në zbatim të akteve ligjore.*

***Detyrë e pazbatuar***

**Evidenca përmbledhëse e realizimit të detyrave të rekomanduara (Formulari nr. 12/2)**

| Nr. | Lloji i rekomandimit | Rekomandime gjithsej në numër | Nga këto | | | Nga rekomandimet gjithsej sa më dëm ekonomik | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Zbatuar në numër | Zbatuar pjesërisht në numër | Pazbatuar në numër | Rekomanduar | | Zbatuar (arkëtuar) | | Zbatuar pjesërisht (në proces) | | | Pa zbatuar (pa filluar zbatimi | |
| | | | | | | Peron | 000/leke | Peron | 000/leke | Peron | Arkëtuar në 000/lek | Mbetje në 000/leke | Peron | 000/leke |
| I | **BASHKIA VLORË** | | | | | | | | | | | | | |
| 1. | Masa Organizative | 34 | 17 | 11 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2. | Masa Shpërblim Dëmi | 13 | 7 | 5 | 1 | 14 | 86,489 | 7 | 8,444 | 5 | 8,664 | 15,662 | 4 | 53,808 |
| 3. | Masa Administrative | 13 | 12 | 1 | 0 | 13 | 700 | 6 | 650 | 1 | 0 | 50 | 0 | 0 |
| 4. | Masa Disiplinore | 66 | 11 | 55 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **GJITHSEJ** | **126** | **47** | **72** | **6** | **27** | **87,189** | **13** | **9,094** | **6** | **8,664** | **15,712** | **4** | **53,808** |
| II | **BASHKIA VLORË (KONCESIONI)** | | | | | | | | | | | | | |
| 1. | Masa Organizative | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2. | Masa Shpërblim Dëmi | 4 | 1 | 2 | 1 | 4 | 4,500 | 1 | 0 | 2 | 0 | 4,500 | 1 | 0 |
| 3. | Masa Administrative | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4. | Masa Disiplinore | 6 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **GJITHSEJ** | **10** | **7** | **2** | **1** | **4** | **4,500** | **1** | **0** | **2** | **0** | **4,500** | **1** | **0** |
| III | **NJËSIA ADMINISTRATIVE ORIKUM** | | | | | | | | | | | | | |
| 1. | Masa Organizative | 11 | 7 | 3 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2. | Masa Shpërblim Dëmi | 7 | 2 | 4 | 1 | 7 | 5,612 | 2 | 174 | 4 | 1,746 | 3,529 | 1 | 63 |
| 3. | Masa Administrative | 2 | 1 | 0 | 1 | 2 | 140 | 1 | 70 | 0 | 0 | 0 | 1 | 70 |
| 4. | Masa Disiplinore | | | | | | | | | | | | | |
| | **GJITHSEJ** | **20** | **10** | **7** | **3** | **9** | **5,752** | **3** | **244** | **4** | **1,746** | **3,529** | **2** | **133** |
| IV | **NJËSIA ADMINISTRATIVE NOVOSEL** | | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Masa Organizative | 25 | 2 | 21 | 2 | 25 | 90,969 | 0 | 0 | 1 | 19,943 | 71,025 | 0 | 0 |
| 2. | Masa Shpërblim Dëmi | 11 | 0 | 9 | 2 | 11 | 18,684 | 0 | 0 | 10 | 207 | 16,948 | 1 | 1,529 |
| 3. | Masa Administrative | 3 | 0 | 0 | 3 | 3 | 150 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 150 |
| 4. | Masa Disiplinore | 9 | 9 | 0 | 0 | | | | | | | | | |
| | **GJITHSEJ** | **47** | **11** | **30** | **7** | **38** | **109,803** | **0** | **0** | **11** | **20,150** | **87,973** | **4** | **1,679** |
| | **TOTAL I+II+III+IV** | **203** | **75** | **111** | **17** | **78** | **207,244** | **17** | **9,338** | **23** | **30,560** | **111,714** | **11** | **55,620** |

Mos zbatimi i rekomandimeve duke mos i argumentuar ato, nga nëpunësit e subjekteve të audituara, është në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit", mos regjistrimin në kontabilitet të vlerës së shpërblimit të dëmit, mos nxjerrjen e urdhrave ekzekutive administrative në lidhje me vendosjen e gjobave.

Për mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH dhe për ndjekje dhe mos realizim të planit veprimit të miratuar, mbajnë përgjegjësi:

1. T. Z. me detyra Drejtor i Menaxhimit Ekonomik.
2. L. G, me funksion Përgjegjëse e Sektorit Auditit të Brendshëm.
3. D. Z. me funksion Drejtor i Drejtorisë Juridike.
4. L .B. me funksion Drejtor i Burimeve Njerëzore.
5. A. M. me detyrë Drejtor i PZHKT.
6. K. R. me funksion K/Inspektor i IMTV.
7. M. M. me funksion Kryeinspektor i Policisë Bashkiake

Për mos njohjen e gjendjes të debitorëve të taksave dhe takës së tokës, mos evidentimi i listës së debitorëve të taksave vendore mbajnë përgjegjësi:

1. T. Z. me detyra Drejtor i Menaxhimit Ekonomik.
2. F. LL. me funksion Inspektor i borxhit tatimor.
3. A. Z. me funksion Inspektor borxhi tatimor.

Për sa sipër, kërkojmë të zbatohen, masat organizative dhe masat për shpërblim dëmi të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe të pa zbatuara akoma respektivisht: për Bashkinë Vlorë me shkresat nr. 732/9, datë 19.12.2016 (Parkimi Bashkia Vlorë); nr. 1128/58, datë 19.03.2015 (Bashkia Vlorë); nr. 1148/6, datë 31.03.2015 (ish-Komuna Orikum) dhe nr. 501/8, datë 25.07.2015 (ish- Komuna Novoselë)nr. 348/10, datë 30.06.2015; ish-Bashkinë Orikum shkresa nr. 1148/6 datë 31.03.2015 dhe ish-Komunën Novoselë shkresa nr. 501/8, datë 25.07.2015.

**Ri lihet detyrë që:**

Nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, të nxirren aktet administrative dhe të ***ri kërkohen***:

1. Arkëtimi i shpërblimit të dëmit në vlerën **167,334 mijë lekë,** *nga e cila: në proces zbatimi 111,714 mijë lekë dhe pa zbatuar në vlerën 55,620 mijë lekë*, ndaj personave përgjegjës sipas rekomandimeve të paraqitura**;**
2. Për zbatimin e masave organizative për vlerën e të ardhurave të munguara prej **211,180 mijë lekë**.

*(Gjerësisht trajtuar faqen 10-42, të Projektraport Auditimit)*

## III/2. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm.

Nga Titullari i njësisë publike si janë vendosur, përmbushur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" nëpërmjet veprimtarive efektive, efiçencë dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të

aktiveve.
Nga Titullari i njësisë publike si janë vendosur, përmbushur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", nëpërmjet veprimtarive efektive, eficencë dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.
**Sipas dokumenteve të paraqitura nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar si v**endimi i Këshillit të Bashkisë nr. 1, datë 4.02.2016, ndryshuar me vendimin nr. 10, datë 02.03.2016 "Për miratimin e strukturës dhe numrit të punonjësve", të shkresës me nr. 1425 prot., datë 22.02.2017 "Mbi deklaratën për cilësinë e kontrollit të brendshëm", të listës emërore dhe evidenca nga Drejtorie e Burimeve Njerëzore mbi emërimin e punonjësve, statusin e punonjësve, të Rregullores së funksionimit të brendshëm të Bashkisë Vlorë, **konstatohet se, nga** ana e Bashkisë Vlorë, nuk janë zbatuar plotësisht kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", përsa i përket neneve 20, 21, 22, 23, 24, 27.
Nga auditimi mbi vlerësimin e funksioneve të sistemit të menaxhimit financiar për pesë komponentët e menaxhimit financiar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollit", rezultoi:
**Mjedisi i kontrollit.** Bashkia e Vlorës, nuk ka miratuar kodin e etikës profesionale për nivelin menaxhuese dhe për punonjësit e tjerë të njësisë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
-Strukturat e Bashkisë, funksionojnë sipas detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendshme mbi: "Organizimin e veprimtarisë së punonjësve të bashkisë", miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 29.03.2012. Kjo rregullore nuk ka të përcaktuar detyra për funksionimin e Njësive Administrative të krijuara pasreformës administrative ku përfshihen inspektori i financës, inspektori i tatim taksave, inspektori i bujqësisë, etj. Rregullorja gjithashtu nuk ka përcaktuar detyra lidhur me administrimin e aseteve, dhënien me qira të tyre si dhe regjistrimin në ZVRPP në pronësi të Bashkisë Vlorë. U konstatua se struktura organizative e funksionimit të brendshëm të institucionit, është miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 10, datë 2.03.2016 e përbërë me 331 punonjës. Kjo strukturë, nuk është në përputhje me rregulloren e brendshme të Institucionit. Konkretisht në rregulloren e brendshme, ekziston Drejtorie e Tatim Taksave dhe janë përcaktuar detyra konkrete për funksionimin e saj. Në këtë rregullore, për vjeljen e tatim taksave, rregullorja parashikon strukturën dhe detyra të organizuara në nivel Drejtori, Përgjegjës të Sektorëve dhe Inspektorët sipas detyrave. Në strukturën e miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 10, datë 2.03.2016, nuk është parashikuar struktura në nivelin e Drejtorit të Tatim Taksave dhe as në niveli i përgjegjëseve të sektorit por vetëm në nivel të specialistëve të thjeshtë. Sipas kësaj strukture, Drejtori i Menaxhimit Financiar ka në vartësi 76 punonjës ku të gjithë vartësit janë në nivel specialisti ose punonjësi tjetër ndihmës përveç strukturës së Arsimit Profesional (Konviktet) të organizuar deri në nivelin e Përgjegjësit të Sektorit me 16 punonjës në vartësi të cilët varen gjithashtu nga Drejtori i Menaxhimit Financiare.
Me aktivitetin e vjeljes së tatim taksave, sipas strukturës së miratuar, janë 24 punonjës përfshi punonjësit e Njësive Administrative (Ish Komunat).
Përsa më sipër, rregullorja aktuale nuk pasqyron detyra të qarta për specialistët që ndjekin arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat lokale pasi rregullorja e funksionimit të brendshëm, i referohet një

strukture ndryshe nga ajo aktuale. Nisur nga rëndësia dhe risku për arkëtimin e detyrimeve lokale, struktura aktuale, në vlerësimi tonë, nuk jep siguri për rritjen e performancë për vjeljen e detyrimeve lokale.

Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit sipas përcaktimeve të nenit 16 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010. Në Bashkinë Vlorë, janë evidentuar që kryejnë aktivitetin e biznesit gjithsej 4547 subjekte të biznesit të vogël dhe të biznesit të madh, nga të cilët të evidentuar debitorë 2846 subjekte përfshi mbi 46 mijë familje objekt i taksave familjare, por menaxhimi i detyrimeve për tatim taksat lokale, nuk bëhet me programe elektronike specifike por në mënyrë manuale ose me programin ”Exel”.Po kështu për veprimet kontabël financiare, nuk aplikohen programe elektronike të specializuara për financën.

**Menaxhimi i riskut.** Në zbatim të kërkesave të nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, nga titullari i Njësisë Administrative, nuk është caktuar koordinatori i riskut dhe për rrjedhojë nuk janë identifikuar sistemet e kontrollit me më shumë risk sipas përcaktimeve në nenin 10 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010. Nuk është hapur regjistri i riskut dhe nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij. Megjithatë, nga Bashkia Vlorë është përpiluar vetëdeklarimi mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit, dërguar Ministrisë së Financave me shkresën nr. 1425 prot., datë 22.02.2017, në zbatim të kërkesave të nenit 18 ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

**Veprimtaritë e kontrollit**. Në zbatim të kërkesave të nenin 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, nga ana e Titullarit të Bashkisë Vlorë, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit**.** Ndarja e detyrave, bazohet në rregulloren aktuale të funksionimit të brendshëm, në zbatimin e detyrave sipas përshkrimit të vendit të punës dhe në zbatim të kërkesave ligjore. Kontrolli i transaksioneve pas faktit, ushtrohet sipas komisioneve ose grupeve të punës të ngritura nga titullari i bashkisë si dhe nga audituesit e brendshëm strukturë e cila është e përbërë me Audites dhe Përgjegjësi i tyre. Titullari i bashkisë është edhe nëpunësi autorizues, sipas kërkesave të nenit 9 të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010. Nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik sipas kërkesave të nenit 27, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, pika 2.

**Informacioni dhe komunikimi**. Në zbatim të kërkesave të nenin 23, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, informimin dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm. Përveç kësaj mënyre, informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun veçanërisht lidhur me vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Ky lloj komunikimi me shkrim ose në mënyrë elektronike është edhe për rastet e shërbimeve nga Zyra e Urbanistikës, në zbatim të kërkesave ligjore, ligji nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Megjithatë, nuk na u paraqitën rregulla të shkruara lidhur me informimin dhe komunikimin midis strukturave organizative të bashkisë, njësive administrative të saj.

**Monitorimi.** Në zbatim të kërkesave të nenin 24, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse si për marrjen në dorëzim të punimeve të kontraktuara, në rastet e identifikimit të detyrimeve për tatim taksat lokale etj. Një formë e monitorimit, është deklarata e vetëvlerësimit të sisteme të kontrollit të brendshëm. Për monitorimin e sistemeve dhe vlerësimin e funksionimit të tyre, gjatë viti 2016, ka funksionuar zyra e auditimit të brendshëm në Bashkinë Vlorë.

**III/2.a-Vlerësimi dhe aktivitetit i Auditit të brendshëm në sektorin publik.**

*III/2.a.1.-Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për Miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik";*

Bazuar në Vendimet e Këshillit të Bashkisë Vlorë për periudhën objekt auditimi është ngritur njësia e auditimit të brendshëm me 3 punonjës, nga të cilët 1(një) përgjegjës zyre dhe dy inspektor Auditi. Për vitin 2015, struktura organizative është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.53, datë 11/12/2014, ndryshuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.5, datë 13/08/2015. Për vitin 2016, struktura organizative është miratuar, me vendim të Këshillit Bashkiak nr.1, datë 04/02/2016, ndryshuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.16, datë 31/03/2016. Për vitin 2017, struktura organizative është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Nr.1, datë 31/01/2017 "Për miratimin e numrit te punonjësve te bashkisë dhe institucioneve te varësisë" miratuar në Prefekturë me shkresën nr. 330, datë 15.02.2017 dhe Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr.12, datë28.02.2017 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë dhe Institucioneve në vartësi për vitin 2017".

Me strukturën organike të Bashkisë është miratuar dhe struktura e njësisë së auditimit të brendshëm, e cila funksionon, me tre punonjës nga të cilët një përgjegjës dhe dy Auditues, të pajisur me certifikatën e Auditit të Brendshëm, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", me emërtesën "Njësia e Auditimit të Brendshëm" dhe ka si funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë Vlorë, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 114/2015 " Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 10, germa "c" si dhe nenit 64, germa "a" të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", pikat 3 dhe 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik".

*III/a.2.-Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditit të Brendshëm;*

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm është hartuar planin vjetor dhe strategjik i cili pasi e ka miratuar nga Kryetari i Bashkisë, është dërguar në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave), dhe brenda shkurtit të vitit pasardhës, është miratuar raportimi vjetor i Njësisë se auditimit të brendshëm.

Programet e auditimit për çdo subjekt të audituar janë hartuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Materialet që përmban dosja për çdo angazhimi auditimi, programi i punës, projekt raporti, raporti final, memorandumi dhe shkresa e rekomandimeve, protokollohej dhe dorëzohen në arkiv. Dosja e plote e çdo angazhimi, raportet bashkë me formularët plotësues, administrohet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm. Në çdo dosje auditimi është e dokumentuar e gjithë puna e kryer nga audituesit, që nga fillimi i misionit deri në përfundim të tij (gjurmët e auditimit). Konstatojmë se njësia e auditimit raporton drejtpërdrejt tek Kryetari i Bashkisë, tek i cili aprovohet plani strategjik, plani vjetor i punës, si dhe raportimi vjetor e periodik mbi veprimtarinë audituese si dhe mbi misionet e realizuara, bazuar në kërkesat e nenit 14 të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 " Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

*III/a.3.-Zbatimi i Programit të auditimeve në subjektet e audituara, plotësimi i dokumentacionit të auditimit në përputhje me standardet e auditimit;*

Për vitin 2015, bazuar në programet vjetore të miratuara, veprimtaria audituese e kësaj njësie i është përmbajtur planit vjetor dhe strategjik të saj, në përputhje me standardet, procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe Udhëzimin në fuqi, në fushën e Auditimit të Brendshëm. Sipas planit vjetor të auditimit dhe planit strategjik miratuar me shkrese nr.4172 prot, datë 09.10.2014, gjatë vitit 2015 janë planifikuar për tu audituar, gjithsej 11 subjekte të cilat janë realizuar audituar 100%. U përzgjodhën 11 dosje auditimi të Njësisë së Auditimit të Brendshëm, për të mbikëqyrur plotësimin e dokumentacionit të auditimit në përputhje me standardet e auditimit nga ku u konstatua se gjatë auditimit nga grupi i auditimit janë nxjerre konkluzione dhe janë dhënë rekomandime, për çdo rast auditimi, të cilat janë audituar edhe për zbatimin e tyre.
Për vitin 2016, sipas planit vjetor të auditimit dhe planin strategjik të miratuar me shkrese nr. 4271, datë 08.10.2015 janë planifikuar për tu audituar gjithsej 12 subjekte, nga të cilat janë realizuar 10 auditime. Për vitin 2016 është planifikuar të auditohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, i cili nuk është kryer. Gjithashtu ishin planifikuar të realizoheshin dy angazhime auditimi në teatrin " Petro Marko", (auditimi i plotë) dhe një angazhim në Qendra e Kulturës Turizmit Rinisë dhe Sporeve, auditimi i plotë. Me VKB është bërë bashkimi i Teatrit "Petro Marko" me Qendrën e Kulturës Turizmit dhe Sporeve në një njësi të vetme Qendra e Kulturës. Si rrjedhojë e këtij bashkimi është realizuar vetëm një angazhim auditimi. U përzgjodhën 8 dosje auditimi të NjAB, për të mbikëqyrur plotësimin e dokumentacionit të auditimit në përputhje me standardet e auditimit, nga ku u konstatua se gjatë auditimit nga grupi i auditimit janë nxjerre konkluzione dhe janë dhënë rekomandime, për çdo rast auditimi, të cilat janë audituar edhe për zbatimin e tyre. Sa më sipër konstatohet se dosjet e auditimit nuk janë inventarizuar dhe as nuk janë arkivuar në arkivin e Bashkisë.
Për vitin 2017, bazuar në planin vjetor të auditimit dhe planin strategjik miratuar me shkrese nr. 8585, datë 14.10.2016, gjatë vitit 2017 janë planifikuar për tu audituar 10 subjekte. Është planifikuar të auditohet Drejtoria Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, të cilat nuk janë për shkak se auditohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Për të arritur realizimin e planit, me miratimin e Kryetarit të Bashkisë u kryen dy angazhime auditimi në Njësitë Administrative Novosele dhe NjA. Shushicë. U përzgjodhën 10 dosje auditimi të Njësisë së AB, për të mbikëqyrur plotësimin e dokumentacionit të auditimit në përputhje me standardet e auditimit ku u konstatua se gjatë auditimit nga grupi i auditimit janë nxjerre konkluzione dhe janë dhënë rekomandime, të cilat nuk janë audituar për zbatimin e tyre.

*III/a.4.-Evadimi i materialeve të Auditit të brendshëm, në përputhje me standardet;*

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm për auditimet e ushtruara në subjektet e vartësisë pasi është hartuar Projekt raporti dhe raporti final. Me dërgimin e raportit final në subjektin e audituar, grupi i auditimit ka formuluar një përmbledhje të shkurtër të raportit, ose memorandum.
Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, së bashku me planin e veprimit, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit, veprime, të cilat përputhen me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe të kapitullit VI "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese" të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016, e konkretisht:
-Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit. Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit. Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit. Programi i

angazhimit të auditimit. Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit. Testet dhe shënimet e mbajtura nga Audituesi. Takimi i ballafaqimit përfundimtar të misionit të auditimit. Projekt raporti i auditimit të brendshëm. Raporti përfundimtar i auditimit të brendshëm. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Memo që i është dërguar titullarit të Institucionit.

*III/a.5-Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna***.**
Në njësinë e auditimit të brendshëm të Bashkisë Vlorë, Sigurimi i Cilësisë në të gjitha angazhimet e Auditimit të Brendshëm të kryera gjatë periudhës objekt auditimi është kryer nga grupi i punës që ka realizuar angazhimin e auditimit. Sigurimi i cilësisë është pjesë e procesit që bën të mundur zbatimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik" me emërtesën "Njësia e Auditimit të Brendshëm".

*(Gjerësisht trajtuar faqen 42-49, të Projektraport Auditimit)*

**III/3. Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj.). Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Hartimi i Pasqyrave financiare (bilanci kontabël) dhe inventarizimi i llogarive të pasurisë publike. Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë.**

*III/3.a. Mbi zbatimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë.*

*3.1-Planifikimi i buxhetit në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimin e planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe Pretendimimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit, për gjithë periudhën e auditimit vetëm për bashkinë e madhe .*

**Buxheti për vitin 2015**, është përgatitur me grup pune të veçantë të ngritur nga kryetari i Bashkisë dhe është miratuar në këshillin Bashkiak me vendimin nr. 1, datë 29.01.2015, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë pa vërejtje.

Mbështetja ligjore për hartimin e buxhetit: Ligji i buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015", neni 15, Udhëzimi plotësues Nr. 2, datë 19.01.2015.

*Si mangësi u konstatua*:

Buxheti është miratuar jashtë afatit ligjor pasi, referuar ligjit të buxhetit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" duhej të ishte miratuar në këshillin e Bashkisë brenda muajit Dhjetor të vitit 2014.

Buxheti tranzitor, pas reformës administrative është miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 8,datë 13.08.2015. Nga verifikimi i programit të treguesve të buxhetit tranzitor në buxhet janë programuar të ardhurat të trashëguara nga njësitë e shkrira dhe të ardhurat e parealizuara nga taksa dhe tarifat vendore në përshtatje më kërkesat e ligjit të buxhetit.

Buxheti i vitit 2016 është miratuar me VKB nr. 2, datë 04.02.29016 dhe ky është miratuar jashtë afatit ligjor.

Buxheti i vitit 2017 është miratuar me VKB nr. 3, datë 31.01.2017. Buxhetet janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë pa ndryshime. Buxheti është miratuar jashtë afatit ligjor. Realizimi buxhetit për periudhën 1.01.2015 -31.12.2017, sipas viteve paraqitet:

*000/lekë*

| Nr. llog | Emërtimi i shpenzimit | 2015 | | | 2016 | | | 2017 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plan buxheti | Fakt | % | Plan Buxheti | Fakt | % | Plan Buxheti | Fakt | % |
| 600 | Paga | 145,084 | 143,182 | 99 | 361,181 | 352,294 | 97,5 | 553,468 | 535,001 | 96.6 |
| 601 | Sigurime shoq. | 24,071 | 22,118 | 92 | 60,179 | 57,912 | 96,2 | 92,641 | 87,338 | 94.2 |
| 602 | Operative | 433,081 | 428,148 | 99 | 476,314 | 471,141 | 98,9 | 686,385 | 602,554 | 87.7 |
| 603 | Subvencion | 41,386 | 39,386 | 95 | 25,020 | 24,978 | 99,8 | 17,820 | 17,820 | 100 |
| 651 | kredi | 5,286 | 5,286 | 100 | 3,108 | 3,105 | 99,9 | 1,114 | 1,114 | 100 |
| 604 | Transf korente | 5,950 | 5,885 | 99 | 17,447 | 17,175 | 98,4 | 5,428 | 5,020 | 92.4 |
| 166 | interes | 14,961 | 14,961 | 100 | 14,962 | 14,961 | 100,0 | 14,961 | 14,961 | 100 |
| 606 | Buxh.famil | 483,340 | 481,984 | 821 | 594,448 | 594,273 | 99,97 | 600,923 | 600,923 | 100 |
| 466 | Ngurts.Gara | 258 | 2,118 | 821 | 21,117 | 21,117 | 100,0 | 5,239 | 5,239 | 100 |
| 231 | Investime | 184,737 | 182,736 | 99 | 828,862 | 191,039 | 23,0 | 999,837 | 896,442 | 89.6 |
| | Totali | **1,338,153** | **1,325,804** | **99.1** | **2,402,638** | **1,747,995** | **72,7** | **2,977,816** | **2,766,402** | **92.9** |

**Shpenzimet në total për vitin 2015**, sipas fondeve të çelura në thesar nga 1,338,153 mijë lekë u realizuan 1,325,713 mijë lekë ose në masën 99.07%. Për vitin 2016, nga 2,402,664 mijë lekë të planifikuar në fillim të vitit u realizuan 1,747,995 mijë lekë në masën 72.8%. Investimet nga 828,862 mijë lekë të planifikuar për vitin 2016 u realizuan 191,039 mijë lekë ose 23 %.
Bashkia ka trashëguar detyrime me tendencë në rritje .
*-Raportimi nga Kryetari i Bashkisë në Këshillin Bashkiak të gjendjes ekonomiko-financiare, të paktën njëherë në 6 muaj, sipas nenit 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", dhe për vitin 2016 e në vazhdim sipas nenit 64 të ligjit nr. 30/2015 dhe ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000.*
Për vitin 2017, analiza e treguesve të buxhetit është kryer për periudhën 8/mujore sipas protokollit nr. 8604/1, datë 21.09.2017.
Për të tre vitet buxhetore ndryshimet në buxhet janë bërë konform udhëzimeve për zbatimin e buxheteve të viteve ushtrimore. Ndryshimet në buxhet të cilat janë miratuar sipas rasteve dhe në Këshillin Bashkiak janë ndikuar nga mosrealizimi i të ardhurave të programuara nga taksat dhe tarifat vendore. Gjatë vitit janë bërë ndryshime në buxhet dhe nga analiza që ju bë treguesve të buxhetit u konstatua se:
Krahasuar me buxhetin fillestar nga përdorimi i të ardhurave është parashikuar të përdoret:

Përdorimi i të ardhurave 2017 në 000/ lekë

| Nr. | Shpenzimet | Plan | Fakt | % |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Paga e sigurime | 330,670 | 112,491 | 34,1 |
| 2 | Shpenzime operative | 927,807 | 352,329 | 38 |
| 3 | Investime ( 230+231) | 328,759 | 56,550 | 17.2 |
| 4 | Kredi, ndihma 604+606 | 70,925 | 19,173 | 27.03 |
| | **Totali** | **1,658,161** | **540,543** | **32.6** |

Shpenzimet operative me burim financimi nga të ardhurat e veta u realizuan  në masën 32.6%, ose nuk u realizuan në vlerë absolute me 575,478 mijë lekë. Edhe investimet e programuara me të ardhurat e Bashkisë nuk janë realizuar për 272,109 mijë lekë ose në masën 17.2 %.
Treguesi i shpenzimeve operative është 34%, ndërsa i investimeve është 17% dhe me këtë tendencë në ulje të përdorimit të ardhurave për investime pasqyron një menaxhim që shkon drejt përdorimit të ardhurave vetëm për **shpenzime korente ( Paga, sigurime ,shpenzime operative).**
Në këto kushte Bashkia duhet të marrë masa për analizën e gjendjes financiare, duke vlerësuar faktorët riskut bazë (rritjen e të ardhurave dhe uljen e shpenzimeve).

Detyrimet sipas viteve në lekë ( bilancet):

| Nr. Llog. | Emërtimi. | (2015) | 2016 | 2017 |
|---|---|---|---|---|
| 16 | Det, afat gjatë Kredi | 94,644,255 | 79,683,023 | 64,722,023 |
| | | | | |
| 16 | Det. viti 2018 kredi | - | - | 14,961,232 |
| 166 | Det. viti 2018 interes | - | - | 2,280,980 |
| 42 | Paga | 24,090,494 | 28,086,941 | 30,303,444 |
| 401 | Investime (Furnitor) | 7,839,710 | 11,964,538 | 50,264,312 |
| 431 | Tatime e taksa | 3,707,221 | 1,391,260 | 1,815,443 |
| 435 | Sig .Shoq. | 7,752,262 | 8,246,682 | 3,555,869 |
| 435 | Institucioni 16.7% | | | 6,058,672 |
| 436 | Sig Shëndetësore | 972,931 | 1,131,839 | 617,304 |
| 467 | Shërbime etj. | 88,038,130 | 280,170,728 | 426,579,359 |
| 467 | Tjera | - | - | 91,900 |
| 467 | Vendime gjyqësore | | | 104,000,000 |
| | **Totali** | | | **640,528,515** |

Edhe pse janë kryer analiza për zbatimin e buxheteve 6/mujore dhe vjetore, nuk ka ndryshuar gjendja ekonomiko-financiare, nuk është rritur realizimi i të ardhurave dhe as nuk janë ulur shpenzimet. Nuk është bërë analizë për efektet e kredisë afta gjatë në buxhetin e bashkisë që i është akorduar bashkisë që nga viti 2011, në shumën **149,672 mijë  lekë.**
Detyrimet janë rritur nga viti në vit dhe detyrimet e vitit  2017, krahasuar me detyrimet e vitit 2015 (sipas të dhënave të bilanceve) janë rritur  me 7(shtatë) herë, tregues të cilët flasin për vështirësitë financiare të buxheti të bashkisë.
Detyrimet ndaj të tretëve janë me tendencë në rritje.
Influencë negative në realizimin e treguesve financiare të vitit 2017, kanë dhënë mosrealizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të programuara për vitin ushtrimor 2017. Për pasojë Bashkia Vlorë në mbyllje të vitit ushtrimor mbart detyrime ndaj të tretëve në vlerë 640,528,515 lekë që është e detyruar për shlyerjen e tyre në afate sa më të shkurtra.

*<u>Të konsiderueshme janë detyrimet:</u>*
Për llogari të OSHEE në vlerën 67,211,277 lekë për fatura dhe kamat vonesa 2007-2015 në vlerë 10,086,013 lekë, detyrime për kredi dhe principial ndaj BKT që detyrohet ti shlyejë gjatë vitit 2018, në vlerën 17,242,212 lekë.

*Në lekë*

| Datë | Kësti mujor | Interesi | Principalit |
|---|---|---|---|
| 22.01.2018 | 4,123,219 | 648,219 | 3,475,000 |
| 06.04.2018 | 6,628,746 | 658,490 | 5,970,256 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 06.07.2018 | 2,499,500 | 458,524 | 2,040,976 |
| 08.10.2018 | 3,990,747 | 515,747 | 3,475,000 |
| **Totali** | **17,242,212** | **2,280,980** | **14,961,232** |
| **Teprica 31.12.017** | **-** | **-** | **64,722,023** |
| **% e interesit 2018** | | **3.52** | |

Në mënyrë progresive nga bashkia është likuiduar principial 184,950,157 lekë për kredinë e akorduar në vitin 2011 në vlerën 149,672,180 lekë. Në mënyrë progresive janë likuiduar interesa 37,515,629 lekë ose 25% e principalit fillestar (Kredia). Mbetet tepricë kredie vlera 64,722,023 lekë  në fund të vitit 2017.

***Konkluzion  përfundimtarë :***
*Detyrimet janë rritur nga viti në vit dhe detyrimet e vitit  2017, krahasuar me detyrimet e vitit 2015 (sipas të dhënave të bilanceve) janë rritur  me 7(shtatë) herë, tregues të cilët flasin për vështirësitë financiare të buxheti të bashkisë.*
*Detyrimet ndaj të tretëve  janë me tendencë në rritje. Influencë negative në realizimin e treguesve financiarë të vitit 2017, kanë dhënë mosrealizimi i të ardhurave të vetë bashkia për vitin ushtrimor 2017, duke mbartur detyrim ndaj të tretëve në vlerë 640,528,515 lekë që është e detyruar për shlyerjen e tyre në afate sa më të shkurtra.*

Për periudhën e audituar 3-vjeçare (2015,2016,2017), janë likuiduar interesa në vlerën 11,270,133 lekë dhe principial vlera 31,413,696 lekë. Interesat e likuiduara gjatë tre viteve të fundit në krahasim me principialin e shlyer zënë 35.8% të pricipialit të shlyer gjatë viteve të fundit.  Shlyerja e kredisë ka dhënë influencë negative në buxhet.
Për vitin 2016, janë realizuar investime nga të ardhurat e veta në vlerën 19,348 mijë lekë (përfshirë dhe të ardhurat e kredisë). Për vitin 2017, janë realizuar investime nga të ardhurat në vlerën 54,121 mijë lekë (përfshirë dhe kredinë).
Për të dy vitet e fundit 2016 - 2017, janë realizuar investime nga të ardhurat (viti 2016) në vlerë 19,348 mijë lekë  dhe (vitin 2017) në vlerën 54,121 mijë lekë. Për në vlerën 73,469 mijë lekë.
Për periudhën 2011 -2017, janë shlyer principial 84,950 mijë lekë, ndërsa interesa 37,515 mijë lekë, gjithsej 112,465 mijë lekë. Shlyerja e principalit në mënyrë progresive është më e lartë se realizimi i investimeve për të dy vitet e fundit pa marrë  parasysh interesat .
Në programet buxhetore janë programuar sponsorizimi për ujësjellës, Parkun Urban dhe futbollin. Për tre vitet buxhetore janë kompensuar Futbollit në vlerën 33,698 mijë lekë, Parkut Urban vlera 48,465 mijë lekë dhe Ujësjellësit vlera 25,700 mijë lekë.
*Subvencioni i kryer nga bashkia në favor të Parkut duhet të akordohet vetëm për diferencës e çmimit të biletës dhe jo me financim humbje .*
***Në këto kushte, Bashkia Vlorë** ka paaftësi pagues nëse nuk mbështet me fonde nga buxheti i shtetit, pasi të  ardhurat që realizon nuk mbulojnë detyrimet e prapambetura afat shkurtër.*

| EMER MBIEMER | VITI 2015 | | VITI 2016 | | VITI 2017 | | shuma | | Nj. Administrative |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Bruto | Neto | Bruto | Neto | Bruto | Neto | Bruto | Neto | |
| L. K. | 66,000 | 56,100 | 132,000 | 112,200 | 132,000 | 112,200 | 330,000 | 280,500 | Shushice |
| S. XH. | 45,000 | 38,250 | 90,000 | 76,500 | 90,000 | 76,500 | 225,000 | 191,250 | Shushice |
| M. L. | 66,000 | 56,100 | 132,000 | 112,200 | 132,000 | 112,200 | 330,000 | 280,500 | Shushice |
| XH. P | 36,000 | 30,600 | 72,000 | 61,200 | 72,000 | 61,200 | 180,000 | 153,000 | Orikum |

| EMER MBIEMER | VITI 2015 | | VITI 2016 | | VITI 2017 | | shuma | | Nj. Administrative |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Bruto | Neto | Bruto | Neto | Bruto | Neto | Bruto | Neto | |
| DH. A. | 36,000 | 30,600 | 72,000 | 61,200 | 72,000 | 61,200 | 180,000 | 153,000 | Orikum |
| U. M. | 60,000 | 51,000 | 120,000 | 102,000 | 120,000 | 102,000 | 300,000 | 255,000 | Orikum |
| E. R. | 102,000 | 86,700 | 204,000 | 173,400 | 204,000 | 173,400 | 510,000 | 433,500 | Orikum |
| N. R. | 0 | 0 | 120,000 | 102,000 | 120,000 | 102,000 | 240,000 | 204,000 | Orikum |
| V. D. | 60,000 | 51,000 | | | | | 60,000 | 51,000 | Orikum |
| | **471,000** | **400,350** | **942,000** | **800,700** | **942,000** | **800,700** | **2,355,000** | **2,001,750** | |

Janë paguar nëpërmes artikullit 602 ”Shpenzime operative“ për 9 (nëntë) punonjës të pa deklaruar në sigurimet shoqërorë në vlerën 2,001,750 lekë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, “ Për sigurimet shoqërore në republikan e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM nr. 445 datë 11.07.2012 “ Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi .

**III/2.b. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime, etj.).**

*III/2- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj., për Bashkinë)*

*III/2.1.-Hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturave organike të miratuar;*

Për vitin 2015 struktura organike është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.53, datë 11/12/2014“Mbi strukturën organizative të bashkisë dhe institucioneve vartëse, viti 2015” miratuar në Prefekturë me shkresën nr. 5594, datë 31.12.2014 me 430 punonjës përkatësisht:

Administrata me 213 punonjës, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike me 136punonjës, Teatri “Petro Marko” me 29 punonjës, Qendra e Kulturës, Turizmit, Rinise dhe Sporteve me 23 punonjës, Klubi Shumësportesh " Flamurtari" me 14 punonjës, Qendra e Zhvillimit te PAK me 8 punonjës.

Shtëpia e Fëmijës me 7 punonjës. Me vendim të Këshillit Bashkiak Nr.5, datë 13/08/2015 “Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njësive administrative” miratuar në Prefekturë me shkresën nr. 3517, datë 19.08.2015 dhe Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr.24, datë 01.10.2015 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë” struktura është miratuar me 550 punonjës.

Për vitin 2016,struktura organike është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.1, datë 04/02/2016 “Për miratimin e numrit te punonjësve të bashkisë dhe institucioneve të varësisë” miratuar në Prefekturë me shkresën nr. 864/1, datë 01.08.2016 dhe Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 10, datë 02.03.2016 “Për miratimin e strukturës organizative të bashkisë Vlorë dhe institucioneve të varësisë, 2016” struktura është miratuar me 550 punonjës. Për strukturën e vitit 2016, ka një ndryshim, me vendim të Këshillit Bashkiak nr.16, datë 31/03/2016 “Për disa ndryshime ne VKB. Nr. 1, datë 04.02.2016 “Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve të varësisë 2016″ miratuar në Prefekturë me shkresën nr. 1058, datë 14.04.2016 dhe Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 20, datë 30.05.2016 “Për disa ndryshime në VKB nr. 1, datë 04.02.2016 “ Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve të varësisë 2016” struktura është miratuar me 450 punonjës.

Për vitin 2017, struktura organike është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 31/01/2017 “Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve të varësisë” miratuar në Prefekturë me shkresën nr. 1213, datë 15.02.2017 dhe Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr.

12, datë 28.02.2017 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë dhe Institucioneve në vartësi për vitin 2017" struktura është miratuar me 493 punonjës.
Numri i përgjithshëm i punonjësve të punësuar në fakt  në Bashki në dhjetor të vitit 2015 është 318 , në dhjetor 2016 është 314, në dhjetor 2017 është 318 punonjës.
Prej janarit 2015 deri në dhjetor 2017 numri i pozicioneve në strukturën organike në administratën e Bashkisë Vlorë së bashku me katër njësitë administrative paraqiten viti 2015, janë 338 punonjës, viti 2016 janë 331 punonjës dhe viti 2017 janë 346 punonjës, është vepruar në zbatim me pikën (dh) neni nr. 54, të ligjit 139/2015. Nga krahasimi i listë pagesave rezultoi se nuk është tejkaluar struktura organizative. Bashkia po harton rregulloren për proceset dhe operacionet e punës për çdo pozicion pune. Për emërimet e reja pas reformës territoriale janë zhvilluar procedurat e konkurrimit.
U përzgjodhën për auditim dokumentet e listëpagesave për periudhën janar-dhjetor të vitit 2016 të paraqitura nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë, për respektimin e strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin, realizimi i fondit të pagave, nga ku  konstatohet se:
Struktura organike dhe niveli i pagave është miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 1, datë 4.02.2016, ndryshuar me vendimin nr. 16, datë 31.03.2016 dhe miratuar me Vendim të kryetarit të bashkisë me shkresën nr. 10, datë 02.03.2016. Sipas këtij miratimi, numri i punonjësve të miratuar, është gjithsej 550 punonjës nga të cilët për administratën e Bashkisë Vlorë, janë miratuar 331 punonjës dhe për Njësitë Vartëse të saj 219 punonjës. Në strukturën administratës së Bashkisë të miratuar me 331 punonjës, nga e cila 114 punonjës janë në pozicione të shërbimit civil (SH.C), 57 punonjës janë në pozicione mbështetës të mesëm (MB), 108 punonjës  janë në pozicione ndihmëse (ND) dhe diferenca 52 punonjës janë në pozicione të tjera. Për auditimin mbi respektimin e strukturës dhe nivelit të pagave, u përzgjodhën për auditim listë pagesat për muajin Mars Korrik dhe Dhjetor 2016 nga ku rezultoi se është respektuar struktura organike sipas miratimit me vendim të Këshillit të Bashkisë.

*III/2.2-Përcaktimi i pagave sipas klasifikimit të funksioneve dhe vendeve të punës në shërbimin civil dhe atyre me kod pune.*
Nga auditimi i listë pagesave të muajve Mars, Korrik, Dhjetor 2016, konstatohet se listë pagesat janë hartuar dhe përpiluar bazuar në listë prezencat e përpiluara për çdo muaj nga personat e ngarkuar sipas strukturës organizative.
-Për llogaritjen e shtesës së pagës për vjetërsinë në punë, nuk disponohen dokumente me shkrim të konfirmuara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për vjetërinë në punë të çdo punonjësi që është përfitues i shtesës mbi pagë për vjetërsi pune. Mungesa e të dhënave mbi vjetërsinë në punë të punonjësve, është edhe në vitet paraardhëse me pretendimin se shtesa e pagës për vjetërsi pune, është ndjekur në vite nga specialistja e pagave.
Referuar listë pagesës së muajit Dhjetor 2016, shtesa e pagës së punonjësve për vjetëri në punë është në shumën 772,973 lekë ose 4,6% e pagës bruto. Për punonjësit e punësuar gjatë vitit 2016, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk janë lëshuar vërtetime për vjetërsi në punë, por në këto raste i është dërguar Drejtorisë së Financës, vetëm fotokopje e pa noterizuar e librezës së punës.
Listpagesës punonjësve janë të firmosura vetëm nga specialistja e pagave, kurse përmbledhësja e pagave për çdo muaj, është e firmosur nga Specialistja e pagave J. M., kontabilisti H. H., Drejtori i Financës T. Z. dhe titullari kryetari i bashkisë D. L. Gjithashtu përmbledhëset e pagave sipas listë pagesave nuk është e nënshkruar nga Drejtore e Burimeve Njerëzore L .B.

U përzgjodhën për auditim emërimet e reja gjatë periudhë së vitit 2016 dhe konkretisht për rekrutimin e punonjësve në punë, përmendim praktikat në vijim të përcaktuara në:
-Urdhrat e titullarit të bashkisë përkatësisht me nr. 26, datë 24.06.2016, nr. 44, datë 5.08.2016, nr. 7, datë 24.11.2016, nr. 7, datë 22.02.2016, nr. 8, datë 22.02.2016, nr. 3, datë 28.04.2016, nr. 17, datë 15.04.2016, ku konstatohet se në urdhër nuk është përcaktuar niveli i pagës, paga bazë e lidhur me nivelin e diplomës dhe vjetërsia në punë, veprime këto në kundërshtim me pikën 6, të VKM nr.165, datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore". Po kështu edhe për punonjësit e paguar rishtas në listpagesës bazuar jo në akte emërimi por në kopjen e kontratës individuale të punës, nuk është specifikuar në këto kontrata vjetërsia në punë.
Sipas urdhër shpenzimeve të Bankës dhe listëpagesave mujore bashkangjitur, për periudhën e vitit 2015, të vitit 2016 dhe vitit 2017, u konstatua se janë paguar dy punonjës për vlerën e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar dhe për shtesën e pagës për vjetërsinë në punë, përkatësisht:
-V. Z. me detyrë specialist personeli, është paguar për periudhën korrik, gusht, shtator të vitit 2017 përkatësisht; 14 ditë për muajin korrik, 22 ditë për muajin gusht dhe 20 ditë për muajin shtator të vitit 2017, për vlerën e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar me 14,000 lekë /muaj, në fakt duhet me 10,000 lekë/muaj. Pagesa është bërë sipas llojit të diplomës Master Shkencor, ku në fakt sipas burimeve njerëzore, është paguar me vendimin nr.69, datë 17.09.2017 protokolluar me nr.8871 datë 27.09.2017 i cili i hyn në fuqi më datën 12.07.2017 me efekte prapa vepruese, me pasojë dëm ekonomik në lerën 10,306 lekë.
-A. B. me detyrë kontabiliste, është paguar për periudhën nga data 20.12.2016 deri më datën 30.11.2017, për vlerën e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar me 14,000 lekë /muaj, në fakt duhet me 11,000 lekë/muaj. Pagesa është bërë sipas llojit të diplomës Master Shkencor, ku në fakt sipas burimeve njerëzore, diploma është Bachelor, me pasojë dëm ekonomik në lerën 34,911 lekë.
Nga rillogaritje sipas urdhër shpenzimeve të Bankës dhe listëpagesave mujore bashkangjitur, u konstatua se janë paguar dy punonjës për vlerën e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar dhe për shtesën e pagës për vjetërsinë në punë, në kundërshtim me VKM nr. 586, datë 17.07.2013 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 02.07.2008, të KM "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", lidhja nr.2, dhe VKM nr.165, datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 5 ,6 dhe lidhja nr.9,me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 45,217 lekë, përkatësisht nga V. Z. vlera 10,306 lekë dhe A. B. vlera 34,911 lekë
U audituan krijimi dhe përdorimi i fondit të veçantë për vitin 2016 nga ku konstatohet se është programuar është përdorur gjithsej në vlerën 157,000 lekë, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" i ndryshuar, pika 7. Pagesat janë bërë me urdhër të titullarit të bashkisë, bashkëngjitur janë dokumentet justifikues.
Nga auditimi u konstatua se janë llogaritur dhe ndalur sipas kërkesave ligjore detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe detyrimet për tatimin mbi të ardhurat personale.

***Sa më sipër arrihet në konkluzion që:***
*Janë paguar për vlerën e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar dhe për shtesën e pagës për vjetërsinë në punë, për dy punonjës të Bashkisë, me pasojë* ***dëmin ekonomik në vlerën 45,217 lekë****.*
*Për llogaritjen e shtesës së vjetërsisë në punë të punonjësve në listë pagesat, nuk disponohen dokumente me shkrim të konfirmuara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për vjetërinë në punë të çdo punonjësi që është përfitues i shtesës mbi pagë për vjetërsi pune.*
*Mungesa e të dhënave mbi vjetërsinë në punë të punonjësve, është edhe në vitet paraardhëse me pretendimin se shtesa e pagës për vjetërsi pune, është ndjekur në vite nga specialistja e pagave.*
*Referuar listë pagesës së muajit Dhjetor 2016, shtesa e pagës së punonjësve për vjetëri në punë është në vlerën 772,973 lekë ose 4,6% e pagës bruto.*
*Në asnjë rast listë pagesat dhe as përmbledhësja e tyre nuk janë firmosur nga Drejtori i Burimeve Njerëzore,, veprime në kundërshtim me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 10, datë 02.03.2016, VKM nr. 165, datë 2.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika 6 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 69 dhe 70.*

*III/2.3-Një informacion i shkurtër për efektivitetit e reformës administrative territoriale në këtë Bashki, paraqitja në formë tabelore të gjendjes numrit të punonjësve më datën 31.12.2014, sipas ish-komunave dhe Bashkive dhe sa punonjës janë aktualisht në datën e përfundimit të auditimit, sipas strukturës të përcaktuara në organikat, veças punonjësit e administratës dhe shërbimeve, sa punonjës janë shtuar apo pakësuar, duke veçuar punonjësit e ardhur si rezultat i decentralizimit të pushtetit vendor, nga ish mjetet zjarrfikëse, administrimit ujërave, shërbimit pyjor, etj.;*
Hartimi i strukturës organizative në Bashkinë Vlorë për gjashtëmujori e parë të vitit 2015, është kryer në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil", ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar etj. dhe miratimi nga Këshilli bashkiak me VKB nr. 53, datë 11.12.2014 "Mbi strukturën organizative të bashkisë dhe institucioneve vartëse, viti 2015" e cila ishte në fuqi deri në momentin e zbatimit të Reformës Administrative Territoriale.
Për gjashtëmujorin e dytë, hartimi i Strukturës është kryer me bashkimin e 5 njësive administrative dhe krijimin e një strukture të përbashkët. Është zbatuar VKM nr.510 datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial" është miratuar në Këshillin Bashkiak VKB nr. 5, datë 13.08.2015 "Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njësive administrative" u miratua numri i administratës se bashku me njësitë administrative.
Për ish Bashkinë Orikum, struktura organike e vitit 2015 është miratuar me vendim të ish-Këshillit Bashkiak nr.2, datë 28/01/2015 "Mbi miratimin e strukturës organizative dhe pagave të bashkisë Orikum për vitin 2015"miratuar në Prefekturë me shkresën nr. 364/1, datë 05.02.2015, me 55 pozicione. Për ish- Komunën Shushicë, struktura e vitit 2015 është miratuar me vendim të ish-Këshillit të Komunës nr.2, datë 28/01/2015 "Për miratimin e strukturës organike të komunës Shushice për vitin 2015", me 32 pozicione. Për ish- Komunën Qendër, struktura e vitit 2015 është

miratuar me vendim të ish-Këshillit të Komunës nr.6, datë 18/02/2015 "Mbi miratimin e strukturës organike të Komunës Qendër për vitin 2015", me 42 pozicione. Për ish Komunën Novoselë, struktura e vitit 2015 është miratuar me vendim të Këshillit të Komunës Novoselë "Mbi miratimin e strukturës organike të Komunës Novosele për vitin 2015", me 64pozicione.
Para dhe pas Reformës Administrative Territoriale numri i pozicioneve të punës sipas Strukturave në pesë njësitë administrative vendore përkatëse paraqitet, përkatësisht para reforme 406 punonjës, pas reformës 338 punonjës.

***Sa më sipër arrihet në konkluzion që:***
*Konstatohet se numri i punonjësve para reformës administrative është 406 punonjës kurse pas reformës është 338 punonjës ose me diferencë më pak prej 68 punonjës.*

*III/2.4.-Auditim mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore për largimin nga puna, efektet financiare*;
U audituan likuidimet nëpërmjet dokumenteve të bankës për periudhën e vitit 2015,2016 dhe të vitit 2017 nga ku konstatohet se, sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë janë likuiduar përkatësisht:
Në vitin 2016 janë likuiduar vlera 530,840 lekë sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë.
Në vitin 2017 janë likuiduar vlera 2,070,880 lekë sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë.
Në vijim paraqiten pagesat e vendimeve të gjykatave të formës së prerë, të kryera për vitet 2016 dhe vitin 2017, detyrimet në total si dhe diferenca e pa likuiduar, sipas pasqyrës aneks 2.4/1.
Në të gjitha rastet e mësipërme nga administrata e Bashkisë Vlorë (Drejtoria Juridike), janë ndjekur procedurat ligjore në të gjitha shkallët e gjyqësorit, por nuk është bërë analizën e tyre për shkaktarët e këtyre veprimeve (largimin e padrejtë të punonjësve), veprime të cilat çojnë në përdorimin e fondeve me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë në **vlerën 2,601,720 lekë**.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
*Janë paguar me vendim gjykate për largim të padrejtë të punonjësve nga puna, gjithsej për vlerën **2,601,720 lekë**. Për këto procese gjyqësore të humbura, Bashkia Vlorë nuk ka analizuar shkaqet e lindjes së tyre dhe të marrë masa ndaj personave përgjegjës, veprim në kundërshtim me pikën 62 dhe 102, të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 09.01.2015 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015", pika 6.1 "Vendimet gjyqësore".*

*III/2.5.-Krijimi i Komisioneve Disiplinore (KD) dhe zbatimi i procedurave për fillimin e ecurisë masave disiplinore, ndaj nëpunësve publikë.*
Janë krijuar komisione disiplinore sipas problematikave të krijuara në strukturat organizative të Bashkisë si Urdhër i Brendshëm nr. 81, datë 26.08.2015 "Për Ngritjen e Komisionit Disiplinor në Shërbimin Civil" dhe Urdhrin e Brendshëm nr.164 datë 18.12.2015 "Për ngritjen e Komisionit Disiplinor në Shërbimin Civil" të Kryetarit të Bashkisë" Për Ngritjen e Komisionit Disiplinor në Shërbimin Civil".
Pas përfundimit të procedurës komisioni i ngritur me Urdhër i Brendshëm nr. 81, datë 26.08.2015 ka vendosur dhe ka dhënë 8 masa disiplinore për 8 punonjës të Bashkisë, konkretisht masa "Mos ngritjes ne detyre për dy vjet".
Me Urdhrin e Brendshëm nr.164 datë 18.12.2015, komisioni disiplinor ka vendosur dhe ka dhënë 5 masa disiplinore për 5 punonjës të Bashkisë konkretisht masa "Mbajtja për 1 muaj e 1/3 së pagës së plotë".

*III/2.6.-Mbi vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë në zbatim të VKM nr. 109, datë 26.02.2014" Për vlerësimin e rezultateve në punë të Nëpunësve Civilë"; i ndryshuar.*

Nga auditimi i dokumentacionit që administrohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është kryer vlerësimi i punës, në zbatim me kërkesat e VKM nr.109, datë 26/02/2014.

Gjatë vitit 2015 janë kryer vlerësimet për nëpunës civil të Bashkisë Vlorë, kurse për ish komunat nuk janë kryer vlerësime.

Gjatë vitit 2016 janë kryer vlerësimet për nëpunës civil të Bashkisë Vlorë.

Gjatë vitit 2017 janë kryer vlerësimet për nëpunës civil në nivel drejtues për 6 mujorin e parë. Aktualisht janë në proces për kryerjen e procedurave të vlerësimit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2017.

*III/2.7.-Njësia e Burimeve Njerëzore të paraqesë një listë të punonjësve në lidhje me trajtimin juridik të marrëdhënieve të punës të punonjësve civil dhe me kodin e punës.*

Sipas dokumenteve të Drejtorisë të Burimeve Njerëzore të Bashkisë, rezulton se aktualisht janë 108 pozicione në strukture nëpunësi civil, 3 punonjës janë në periudhë prove, në pritje të kryejnë trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA-s, 1 punonjës është emëruar me kontratë në gjendjen civile sipas ligjit të gjendjes civile, 238 pozicione pune (kabineti, mbështetës dhe ndihmës) janë me kontratë pune sipas Ligjit të Kodit të Punës. Janë zbatuar nenet 22, 23 dhe 24 të ligjit nr.152/2013 dhe VKM nr.243, datë 18/03/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", për punonjësit që janë pranuar në shërbimin civil. Janë zhvilluar procedurat sipas nenit 24 të këtij ligji, për kalimin në periudhë prove të nëpunësve në marrëdhënie pune të punësuar me procedura konkurrimi, për pozicionet e punës të shërbimit civil. Janë kryer trajnimet e detyrueshme pranë ASPA-s sipas nenit 24 të ligjit 152/2013 dhe të VKM-së 138, datë12/03/2014 "Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të administratës publike dhe trajnimin e nëpunësve civil". Është zbatuar neni 25, i ligjit nr.152/2013 dhe VKM nr.243, datë 18/03/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", kreu VII, për punonjësit që kanë konkurruar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele. Është zbatuar neni 26, i ligjit nr.152/2013 dhe VKM nr.242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese", Kreu III, për punonjësit që kanë konkurruar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Është zbatuar neni 67, i ligjit nr.152/2013 dhe VKM nr. 116, datë 05/03/2014 "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktuale që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit Nr.152/2013 "Për nëpunësin civil".

Janë bërë vlerësimet e rezultateve individuale në punë për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil në zbatim të nenit 62 të ligjit nr.152/2013 dhe VKM nr.109, datë 26/02/2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil" i ndryshuar me VKM Nr.252, datë 30/03/2016. Në zbatim të nenit 62 të ligjit nr.152/2013 dhe VKM-ve në zbatim të tij, në Bashkinë Vlorë vlerësimi për 6-mujorin e dytë të vitit 2017 është në proces.

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 53-64, të Projekt raport Auditimit)*

*III/3.c. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Hartimi i pasqyrave financiare (bilanci kontabël) dhe inventarizimi i llogarive të pasurisë publike. Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkulli i vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë.*

Për vitin 2015, është bërë thithja e aktivitetit të ish- Bashkisë Orikum dhe 3 ish- Komunave të përfshira në reformën administrative. Aktivitetit të bashkisë i është bashkuar dhe aktiviteti i ish - Bashkisë Orikum dhe 3 (tre) ish-Komunave Novoselë, Shushicë dhe Qendër.
-Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit sipas planit unik kontabël për institucionet (azhurnimi i tij në librat përkatës, ditar, partitar, libri i madh ose centralizator, ditari i veprimeve të ndryshme etj.)
Specialistët e Financës janë në varësi direkt të Drejtorisë Ekonomike të Bashkisë që drejtohet nga nëpunësi zbatues T. Z. Janë të punësuar 11(njëmbëdhjetë) nëpunës specialistë të financës, 2(dy)magazinier dhe 1( një) arkëtare. Bilanci është plotësuar nga specialisti i financës H. H. dhe është nënshkruar nga ana e tij, por është vepruar gabim pasi nuk është nëpunës zbatues dhe bilancet duhej të nënshkruhen nga nëpunësi zbatues, ku në rastin konkret është Drejtori Menaxhimit Ekonomik.
Specialisti H. H. nuk ka asnjë funksion por është specialist i thjeshtë dhe nuk ka autorizim nga Kryetari i Bashkisë si nëpunës autorizues. Ky veprim bie në kundërshtim germën (b),pika 2,neni 12dhe neni 15, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin".
Nuk është hartuar rregullore për ndarje ne operacioneve dhe proceseve të punës për çdo post pune të financës. Në organikë janë emëruar me emërtesë "Specialistë finance" në Njësitë Administrative Novoselë, Orikum dhe Qendër. Specialistët e financës në njësitë administrative nuk kryejnë asnjë proces pune, sipas emërtesës pasi njësitë nuk kanë buxhet dhe bilanc më vete. Funksionet e financës i kanë kaluar Bashkisë Vlorë, mbështetur në VKM nr.510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial". Ndarja e detyrave të nëpunësve të financës për vitin 2016, nuk është mbështetur në rregullore të brendshme të bashkisë.
-Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë dhe në valutë, në përputhje me disiplinën financiare;

Dokumentacioni kontabël par tre vitet 2015,2016 e 2017

| N R | Dokumente kontabiliteti | Viti 2015 | | Viti 2016 | | 2017 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr. | Vlerë | Nr. | Vlerë | nr. | Lekë |
| 1 | Arkëtime Bashkia | 8413 | 49,481,531 | 8661 | 40,870,087 | 8253 | 46,514,399 |
| 2 | Pagesa Bashki | 103 | 49,481,531 | 135 | 40,870,087 | 96 | 46,514,399 |
| 3 | Arktimeshushic | - | - | 825 | 8,569,133 | 458 | 3,641,212 |
| 4 | Pagesa Shushic | - | - | 43 | 8,569,133 | 32 | 3,641,212 |
| 5 | Arkëtime Novosele | - | - | 1462 | 17,376,281 | 1119 | 9,924,307 |
| 6 | Pagesa Novosele | | | 43 | 17,376,281 | 22 | 9,924,307 |
| 7 | Fletë hyrje B | 388 | 39,553,470 | 470 | 54,969,044 | 444 | 152,049,380 |
| 8 | Fletë dalje .Bashki | 5034 | 40,152,318 | 6043 | 53,286,030 | 5749 | 145,118,402 |
| | Urdhër shpenzime | 779 | 1,325,712,889 | 1132 | 3,495,990,778 | 1250 | 2,572,415,727 |

Në bashki funksionojnë 4 (katër) arka, nga të cilat 3(tre) arka kryejnë funksionin e arkëtimit të ardhurave dhe 1(një) arkë kryerjen e shpenzimeve. Për funksionimin e arkave nuk është hartuar rregullore e brendshme për administrimin e çelësave të kasafortave dhe transportin e lekëve nga arkat në drejtim të bankës dhe anasjelltas. Në plotësimin dhe përpunimin e dokumentacionit të arkave u konstatua se:
Mandat pagesa nr. 3, datë 27.02.2017, për 1000 lekë paguar për gjobën e tejkalimit të afatit të kontrollit teknik vjetor, K. M. për të cilën duhej të likuidohej nëpërmes bankës.

Nga arka janë kryer pagesa për fëmijët ne kopshte dhe çerdheve te garancive te arkëtuar ne forme paradhënie prej 3500 leke për fëmijë dhe e konkretisht për vitin 2015 , janë kryer pagesa 1,894,340 lekë, për vitin 2016 në vlerën 1,874,217 lekë, për vitin 2017 në 1,828,614 lekë. Këto pagesa i përkasin likuidimit të detyrimeve ndaj prindërve të fëmijëve që frekuentojnë në kopshtet dhe çerdhet. Këto veprime duhet te kryhen nëpërmjet sistemit bankar.

Mandat pagesa nr. 10, datë 12.04.2017, shpërndarë nga arka 259,250 lekë me listë pagesë, me përshkrimin ceremoni ndarje certifikatash, koncert me rastin e 7 marsit për 11 veta, orkestrës vallesh, koreograf, prezantues liberist, disenjator etj., jo në përputhje me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1173, datë 6.11.2009,"Për përcaktimin rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura". Në pikën II/2 të vendimit të mësipërm është shprehur në mënyrë eksplicite se: Titullari i institucionit urdhëron, me shkrim blerjen e shërbimit dhe të mallrave, për zhvillimin, prodhimin apo bashkëprodhimin e programeve kulturore, sociale dhe artistike nga operatorët e fushës, duke parashikuar, për çdo rast, objektin, nevojën e kryerjes së programit, fondin limit dhe përbërjen e komisionit, për ndjekjen e procedurave.

Mp. nr. 26,datë 28.07.2017 për vlerën 254,966 lekë, ndarje certifikatash "Krenaria e qytetit"

Mandat pagesa nr. 11, datë 18.04.2017, paguar nga arka me urdhër të kryetarit nr. 59, datë 29.03.2017, për vlerësimin financiarë të nxënësve cilësorë të shkollave 9-vjeçare me 3000 lekë/ muaj e të mesme të përgjithshme me 5000 lekë/muaj për Janar – Prill

Në m. P. nr.7 datë 7.07.2017, janë paguar me 704,000 lekë për nxënës cilësorë, në bazë të urdhrit nr.59, por nuk kanë tërhequr shpërblimet sipas listë pagesës 14 persona në vlerë 112,000 lekë (12 x6,000 dhe 4x10,000 = 112,000 lekë), shumë e cila nuk është arkëtuar në arkën e bashkisë por është ruajtur në arkën e bashkisë për një periudhë të gjatë deri në fund të vitit. Në fund të vitit sipas librit të arkës gjendja e arkës është paraqitur 0 (zero).

Për likuidimet e kryera nga Bashkia Vlorë për vitin 2015, janë plotësuar dhe përpunuar 779 urdhër shpenzime në vlerë 1,325,712,889 lekë. Urdhër shpenzimet janë plotësuar dhe nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues.

Për likuidimet e kryera nëpërmes degës së thesarit, për vitin 2016, janë plotësuar 1132 urdhër shpenzime me vlerë 3,495,990,778 lekë. Likuidimet e kryera janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës. Nga shpenzimet në total janë realizuar shpenzime për investime (likuiduar) 191,039,065 lekë.

Të dhënat janë të njëjtë me pasqyrën, formati nr. 5 i lëvizjes në Cash dhe të rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë. U verifikua dhe kontabilizimi dhe rezultoi i njëjtë. Është bërë përmbledhja e shpenzimeve korente dhe kapitale sipas të dhënave të kontabilitetit.

Në rastet kur është kolauduar malli komisioni shprehet se ushqimet janë sipas standarteve dhe nuk cilësojnë asnjë standarte, veprime këto në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"

Me urdhër shpenzimi nr.726 datë 17.12.2015 është likuiduar shuma 2,032,966 lek për Subjektin "P.....N" me Nipit K66910202S dhe konkretisht janë likuiduar faturat nr. 71 datë 30.06.2011 për shumën 508,240 lekë, fatura nr. 75 datë 31.07.2011 për shumën 508,242 lekë, fatura nr.78 datë 31.08.2011 për shumën 508,242 lekë dhe fatura nr. 80 datë 30.09.2011 me shumen 508,240 lekë. Nuk janë përfshirë ne kontabilitetin e njësisë Novosele

Me urdhër shpenzimi nr.727 datë 17.12.2015 është likuiduar shuma 35,838 lek për Subjektin "F.....N" për faturën nr.28 ( pa datë). Situacionin është i pa firmosur nga punonjësit e ish- komunës, por është firmosur nga Kryetari i Bashkisë Vlorë D. L. Likuidimi nuk është i mbështetur në analizën e punimeve të kryera, për çdo situacion mujor.
Me Urdhër shpenzimin nr.724 datë 14.12.2015 janë likuiduar për llogari të ish- komunës Shushicë detyrime të vitit 2012,2013, 2014 për shërbim postar në shumën 657,284 lekë pa u verifikuar për tepricën e llogarisë nr. 467 "Kreditorë të tjerë" të bilancit të vitit 2014.
Urdhër shpenzimi nr.723 datë 17.12.2015 likuiduar 934,800 lekë për blerje karburanti nga ish-komuna Shushicë, edhe pse ka faturë tatimore nr.2423 datë 25.02.2015 lëshuar nga "B.....A" dhe fletë hyrjen nr.2 datë 26.02.2015 të ish- komunës Shushicë karburanti nuk është i justifikuar me fletë udhëtimi.
Me urdhër shpenzimin nr.673 datë 07.12.2015 për vlerën 135,197 lekë likuiduar për blerje nafte nga ish- komuna Qendër për muajin korrik 2015,sipas faturës nr.15 datë 01.07.2015 për 800 litra naftë me vlerë 135.197 lekë si fletë dalja R. C., datë 01.07.2015, 80 Tollonat Naftë * 10 litra me 800 litra karburant . Nuk kuptohet firma e blerësit, nuk ka emër dhe mbiemër, po ashtu dhe fletë dalja e furnizuesit. Gjithashtu dhe fletë dalja e Komunës Qendër nuk është bashkangjitur urdhër-shpenzimit, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues për harxhimin e karburantit (fletë udhëtimet ). Karburanti (Tollonat), me thithjen e aktivitetit nga bashkia duhej të ishte dorëzuar në bashki. Përbën dëm ekonomik në ngarkim të ish-Punonjësve të Komunës sipas shpërndarjes Zyra e Bujqësisë (XH. H.) 80 litra x 169 lekë = 13,520 lekë Zyra e urbanistikës 50 litra x 169 = 8,450 lekë, Zyra e tatimeve (TH. T.) 50 litra x169 = 8450 lekë, Juristi ( H. F.) 50 litra baraz 8,450 lekë, Kryetari F. B 390 litra x 169 lekë /litri me 65,910 lekë , Zyra e Shërbimeve ( Z. M. ) 150 x 169 lekë/litri = 25,350 lekë. Total dëm ekonomik 130,130 lekë ( zbritur 1, që nuk është).
Me urdhër shpenzimin nr.710 datë 15.12.2015 është likuiduar në favor të subjektit "T.....A" shuma 190,500 lekë për faturat nr.39 datë 28.08.2015, nr. 9 datë 22.09.2015 dhe nr. 65 datë 24.11.2015 për njoftim dhe intervista. Likuidimi është bëre në kundërshtim me pikat 3,4,5 të nenit nr.40 të V.K.M nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik " dhe në kundërshtim me piken 5 të Udhëzimit nr.3 datë 27.01.2015 "Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" të Agjencisë së Prokurimit Publik.
Me urdhër shpenzimin nr.355 datë 20.05.2016 është likuiduar shuma 100.000 lekë në favor të shoqatës "SH.....E" me objekt "Projekt qendra ditore për zhvillim dhe integrim" Sipas kontratës 28.04.2016 afati i kontratës është Maj-Qershor 2016, dhe ky likuidim është bërë në kundërshtim me pikën nr.5 të Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 "Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" të Agjencisë së Prokurimit Publik.
Me urdhër shpenzimin nr. 1177 datë 31.12.2017 për vlerën 1,620,000 lekë, likuidim energji e prapambetur për llogari të Klubit të futbollit Flamurtari që i përket periudhës deri në muajin nëntor 2014. Sa sipër është likuiduar kamat vonesë, për llogari të stadiumit Flamurtari 525,634 lekë dhe kalçeto Bashkia Vlorë 525,842 lekë dhe nuk ka rakordim me O.SH.E.E dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia dhe shkaku u vonesës së likuidimit.
Për periudhën e audituar janë likuiduar në favor :
Në kontratën e lidhur datë 01.07.2014 midis Bashkisë Vlorë, përfaqësuar nga ish-Kryetari i Bashkisë Shpëtim Gjika dhe sipërmarrës "J.....A.....F....." . përfaqësuar nga TH. P., me objekt kontrate" Shërbimi i sipërfaqeve të gjelbra në qytet me afat 5(pesë vjet) me çmim kontrate 125,496,570 lekë pa

TVSH dhe 150,095,885 lekë me TVSH, me çmim vjetor pa TVSH 25,099,314 lekë dhe 30,019,177 lekë me TVSH.
Në pikën c. nenit 5 është përcaktuar se, çmimi i kontratës do jetë i ndryshueshëm. Në varësi inflacionit të Bankës së Shqipërisë dhe do bëhet shtesë në vitin buxhetor pasardhës.
Kontrata datë 01.11.2014 me "D.....A" , neni 5, çmimi i kontratës 5 vjeçare 927,406,605 lekë pa TVSH dhe me TVSH 1,112,887,926 , në një vit 185,481,321 lekë pa TVSH, ose 222,577,585 lekë me TVSH.
Në pikën c. nenit 5 është përcaktuar se, çmimi i kontratës do jetë ndryshueshëm në varësi inflacionit Bankës së Shqipërisë dhe do bëhet shtesë në vitin buxhetor pasardhës.
Likuidimet e kryera në favor të firmave private në vlerën 11,042,997 lekë, me natyrë inflacion i viteve 2014, 2015 e 2016, edhe pse janë të mbështetura në kontrata, likuidimi nuk është i justifikuar me bilancet e certifikuara nga Dega Rajonale e Tatimeve Vlorë dhe nuk është e argumentuar humbja e pësuar në tërësinë e aktivitetit të firmave private të pastrimit, të gjelbërimit, mirëmbajtjes varrezave dhe shërbimit të dekorit dhe inflacioni nuk është i likuidushëm me VKM për të gjithë ekonominë shqiptare dhe në këto kushte përbën dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Për sa është kundërshtua në pikën III/3.a., me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), se detyrimet janë 588,809,686 lekë po të zbriten principialin i kredisë, interesi, sigurimet shoqërore e shëndetësore,* ***grupi i auditimit sqaron:*** *Për kontratat shumëvjeçare me subjektet private për pastrimin e qytetit, Pastrimi, gjelbërimin, mirëmbajtje e varrezave, shërbimit të dekorit ku pretendohet se faturat janë certifikuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë dhe të pasqyruar në bilancet e shoqërive dhe se certifikimi i bilanceve kryhet nga ekspertë të jashtëm, grupi i auditimit e ka të qartë për sa pretendoni, por bashkia nuk disponon një kopje të bilancit dhe relacion të ekspertit të jashtëm i cili ka certifikuar bilancet e këtyre kontraktuesve dhe ka matur humbjet e shkaktuara si rezultat i inflacionit, për të gjithë shitjet dhe blerjet.*
*Duke qenë se, kontratat janë mbështetur në ligjin e prokurimeve dhe në dokumentet standarte të tenderimeve nuk është përcaktuar matja e humbjeve nga efekti i inflacionit nga ekspertët e certifikimeve të bilanceve të vitit paraardhës, detyrimi ndaj subjekteve private i pasqyruar në projekt raport të hiqet. Nga grupi i auditimit merret në konsideratë kundërshtia nga Bashkia e bërë në ballafaqimin e realizuar në ambientet e KLSH datë 16.04.2018 dhe vlera* ***prej 11,042,977 lekë nuk qëndron.***
*Për mënyrën e bashkimit si rezultat i reformës administrative, dokumentacioni që përshkruhet pranohet nga grupi i auditimit, por nuk është hartuar raport periodike e përfundimtarë nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim.*

- Administrimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit, sistemimi i diferencave, si dhe respektimi i dispozitave ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina;

Për vitin 2015, është ngritur komisioni i inventarizimit sipas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 13, datë 19.01.2016, për "Inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata dhe inventarit në magazinë dhe përdorim për vitin 2015". Sipas urdhrit janë ngritur 10 (dhjetë) komisione sipas objekteve dhe në pikën nr.2. të urdhrit është përcaktuar se inventari duhet të përfundojë më datë 28.02.2016.

Proces verbalet e vlerësimit nga komisionet përkatëse janë mbajtur për Bashkinë më datë 06.06.2016, jashtë afatit të përfundimit të inventarit datë 28.02.2016, për Qendrën Ekonomike datë 13.06.2016, për shkollat e mesme e konviktin e Shkollës së Mesme Industriale, datë 21.06.2016, etj. Për të gjithë objektet e inventarizuara proces verbalet e mbajtura nga komisionet e inventarit dhe të miratuara nga Kryetari Bashkisë si dhe relacionet e përpiluar nga Kryetarët e Komisioneve janë mbajtur në datë 21.06.2016, përveç të njësisë Administrative Orikum. Inventarizimi nga komisionet e ngritura është përfunduar me shumë vonesë në kundërshtim pikën nr.2,të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr.13, datë 19.01.2016, ku është përcaktuar se inventari duhej të përfundonte brenda datës 28.02.2016.
Nga krahasimi i inventarëve fizik me inventarët kontabël nuk kanë rezultuar diferenca.
Në proces verbalet e vlerësimit si mangësi u konstatua se: Amortizimi është llogaritur në grup sipas tepricave të llogarive dhe jo për çdo objekt, pasi nuk është trashëguar nga ish komunat dhe Bashkia regjistër (kartela për vitin e hyrjeve sipas emërtesave ), ku veçohen vlerësimet për Shkollën 9/vjeçare Llakatund janë vlerësuar për jashtë përdorimit:

| **Nr. llog.** | **Emërtimi** | **Data e hyrjes** | **copë** | **Çmimi** | **Vlera** |
|---|---|---|---|---|---|
| 218/1 | Karrige nxënësi | S'ka | 8 | 1440 | 11,520 |
| 218/1 | Tavalinecilkli lartë | S'ka | 9 | 4800 | 43,200 |
| 218/1 | Dërrasë e zezë | S'ka | 2 | 3360 | 6,720 |
| 218/1 | Stola Druri | S'ka | 22 | 1363,65 | 30,000 |
| 218/1 | Karrige kopshti | S'ka | 5 | 2557 | 12,785 |
| 218/1 | Tavolina nxënësi | S'ka | 1 | 10,243 | 10,243 |
| 218/1 | Dollap | S'ka | 2 | 23,341 | 46,682 |
| 218/1 | Kompjuter nxënësi | S'ka | 7 | 46,689 | 326,823 |
| | **Totali** | | | | **487,973** |

U verifikua fleta e inventarit, për kryerjen e veprimeve nga Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve dhe u konstatua se : Komisioni i përbërë nga V. P. në cilësinë e kryetarit të komisionit dhe anëtarët e komisionit H. S. dhe D. RR. kanë vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit inventarë ekonomik, pa llogaritje amortizimi të saktë për çdo artikull.
Në shkollën 9-vjeçare "Rilindja", nga komisioni i inventarizimit janë vlerësuar për jashtë përdorimit laborator kimie me vlerë 257,430 lekë (pa analizë), laborator fizike me vlerë 422,488 lekë (pa analizë), laborator biologjie 447,326 lekë. Për këto laborator nuk ka kartela (inventari i laboratorit). Në komision nuk ka asnjë specialist të fushës. Komisioni është i përbërë nga M. Z. Kryetar, anëtarët A. M. dhe A. H.
Te Shkolla e Mesme e Re, janë vlerësuar për jashtë përdorimit 5 monitor, 5 tastiera, 5 njësi qendrore dhe 3 karrige rrotulluese, pa çmim. Në rastin konkret nuk duhej të ishin vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit pa vlerësim dhe llogaritje amortizimi *(sipas pasqyrës në faqen 49-53 të Projekt raport Auditimit).*
Nga Kryetari i Bashkisë është nxjerrë urdhri nr.2936, prot datë 18.04.2016 për "Për ngritjen komisionit për nxjerrje jashtë përdorimit( asgjësim) të inventarit të imët, instalime teknike, vegla pune, inventarë ekonomik". Në përbërje të komisionit janë I. S. Dr. Përkrahjes Sociale dhe O. R. teknik ndërtimi, Q. H. inspektore e përkrahjes sociale B.....I dhe A. M. Mbështetur pika 100 e udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011" Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Komisioni ka mbajtur proces verbal datë 07.09.2016, për Bashkinë Vlorë (Qendra Ekonomike) për

llogarinë nr. 327,"Objekte inventari" në vlerë 4,593,331 lekë. Komisioni i asgjësimit ka asgjësuar inventarët pa nxjerr asnjë vlerë nga tjetërsimi i inventarëve si dhe në proces verbalet e asgjësimit nuk është përcaktuar vendi i asgjësimit. Urdhri i Kryetarit të Bashkisë për asgjësimin është nxjerrë pa përfunduar inventarizimi dhe vlerësimi i inventarëve.

Artikuj pa çmime inventar 2015 të vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit nga Bashkia .

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| Zyra Zhaneta Gjika | | | |
| 1 | Kompjuter | Cope | 1 |
| Arka Tatimet | | | |
| 1 | Kasaforte | Cope | 1 |
| Urbanistika | | | |
| 1 | Fotokopje bardh e zi Sharp | Cope | 1 |
| Shkolla Naim Frasheri | | | |
| 1 | Kavalet pikture | Cope | 2 |
| Shkolla e RE | | | |
| 1 | Monitor | Cope | 5 |
| 2 | Njësi qendrore | Cope | 5 |
| 3 | Tastiere | Cope | 5 |
| 4 | Karrige rrotulluese | Cope | 3 |
| Kopshti nr.15 | | | |
| 1 | Karrike fëmijësh me mbushje | Cope | 10 |
| 2 | Sobe ngrohje | Cope | 4 |
| 3 | Tavoline për fëmijë | Cope | 8 |
| 4 | Tavoline mësuesi | Cope | 1 |
| Kopshti nr.11 | | | |
| 1 | Fshese me korent | Cope | 1 |

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| Kopshti nr.10 | | | |
| 1 | Gardërobe | Cope | 18 |
| 2 | Rafte Dyshe | Cope | 7 |
| 3 | Tavoline | Cope | 6 |
| 4 | Karrige lëkundësi | Cope | 3 |
| 5 | Karrige te mëdha | Cope | 5 |
| 6 | Tavolina zyre | Cope | 3 |
| 7 | Trapez rrethor | Cope | 4 |
| Shkolla Ibrahim Kushta | | | |
| 1 | Karrige nxënësi | Cope | 40 |
| 2 | Tavoline nxënësi | Cope | 15 |
| 3 | Karrige mësuesi | Cope | 1 |
| 4 | Tavoline mësuesi | Cope | 1 |
| Shkolla Muco Delo | | | |
| 1 | Karrige Metalike | Cope | 4 |
| Shkolla 24 Maji | | | |
| 1 | Tastiera | Cope | 10 |
| 2 | Maus | Cope | 10 |
| 3 | Kufje me mikrofon | Cope | 1 |
| 4 | Monitor | Cope | 16 |

Janë tjetërsuar ( asgjësuar) inventarë pa çmime, pa të dhëna për vitin e hyrjes në përdorim, pa llogaritur amortizimin, pa dokumentacionin shoqërues të furnizuesit. Nga Bashkia Vlorë nuk janë marrë masa për vlerësimin me komision të veçantë dhe nuk duhej të ishin nxjerrë nga përdorimi 29 artikuj.

Gjithashtu u konstatua se: Gjatë inventarit të vitit 2015, kryer në vitin 2016, janë inventarizuar artikuj pa çmime dhe nuk janë vlerësuar me komision të veçantë për tu dokumentuar në kontabilitet e konkretisht:

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| | Zyra e kryetarit | | |
| 1 | Dush I vogël | Cope | 1 |
| | Zyra e nen/kryetarit A. B.....I | | |
| 1 | Tavoline komplet mbledhje,kompjut | Cope | 1 |
| 2 | Etazher | Cope | 1 |
| | Zyra e nen/kryetarit I.banushi | | |
| 1 | Tavoline mbledhje | Cope | 1 |
| 2 | Karrige | Cope | 6 |
| 3 | Komplet kolltuqesh | Cope | 1 |
| | Drejtoria e AseteveA.Shiko | | |
| 1 | Karrige levizese | Cope | 1 |

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| | Ndihma ekonomike | | |
| 1 | Hard Disk | Cope | 1 |
| 2 | Monitor | Cope | 1 |
| 3 | Printer Broxher | Cope | 1 |
| | Kryeinspektori | | |
| 1 | Poltron lëkure | Cope | 1 |
| 2 | Karrige me mbushje | Cope | 4 |
| 3 | Etazher | Cope | 1 |
| 4 | Komplet tavoline mbledhje,kompjut | Cope | 1 |
| | Q.K.R | | |
| 1 | Tavoline e vogël | Cope | 3 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2 | Varese rrobash | Cope | 1 |
| 3 | Kompjuter | Cope | 2 |
| 4 | Printer | Cope | 1 |
| | Zyra e re P. Thanasko | | |
| 1 | dollap etazher | Cope | 1 |
| 2 | komodine sirtar | Cope | 1 |
| 3 | Printer | Cope | 1 |
| | Shërbimet G. SH | | |
| 1 | Karrige me mbushje | Cope | 5 |
| | Zhanetagjika | | |
| 1 | Kompjuter | Cope | 1 |
| | Arka Tatimet | | |
| 1 | Kasaforte | Cope | 1 |
| | Arka Tatimet | | |
| 1 | Fotokopje bardh e zi Sharp | Cope | 1 |
| 2 | Ploterdesignjet 500 | Cope | 1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | David Tushe | | |
| 1 | Karrige Lekure | Cope | 3 |
| | Jurist K. R | | |
| 1 | Karrige Lekure | Cope | 1 |
| 2 | Karrige te zakonshme | Cope | 4 |
| 3 | Tavoline e madhe | Cope | 1 |
| | Inspektor Marjol Mustafaraj | | |
| 1 | Tavoline | Cope | 2 |
| 2 | Tavoline kompjuteri | Cope | 1 |
| 3 | Tavoline me sirtare | Cope | 1 |
| 4 | Karrige lëkure | Cope | 3 |
| 5 | Kondicioner FVPBI | Cope | 1 |

Artikuj pa çmime në inventarin e 2015, që përkasin zyrave të bashkisë dhe vlerësuar dhe janë asgjësuar

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| | Zyra Zhaneta Gjika | | |
| 1 | Kompjuter | Cope | 1 |
| | Arka Tatimet | | |
| 1 | Kasaforte | Cope | 1 |
| | Urbanistika | | |
| 1 | Fotokopje bardh e zi Sharp | Cope | 1 |
| | Shkolla Naim Frasheri | | |
| 1 | Kavalet pikture | Cope | 2 |
| | Shkolla e RE | | |
| 1 | Monitor | Cope | 5 |
| 2 | Njësi qendrore | Cope | 5 |
| 3 | Tastiere | Cope | 5 |
| 4 | Karrige rrotulluese | Cope | 3 |
| | Kopshti nr.15 | | |
| 1 | Karrike fëmijësh me mbushje | Cope | 10 |
| 2 | Sobe ngrohje | Cope | 4 |
| 3 | Tavoline për fëmijë | Cope | 8 |
| 4 | Tavoline mësuesi | Cope | 1 |
| | Kopshti nr.11 | | |
| 1 | Fshese me korent | Cope | 1 |

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| | Kopshti nr.10 | | |
| 1 | Gardërobe | Cope | 18 |
| 2 | Rafte Dyshe | Cope | 7 |
| 3 | Tavoline | Cope | 6 |
| 4 | Karrige lëkundësi | Cope | 3 |
| 5 | Karrige te mëdha | Cope | 5 |
| 6 | Tavolina zyre | Cope | 3 |
| 7 | Trapez rrethor | Cope | 4 |
| | Shkolla I.Kushta | | |
| 1 | Karrige nxënësi | Cope | 40 |
| 2 | Tavoline nxënësi | Cope | 15 |
| 3 | Karrige mësuesi | Cope | 1 |
| 4 | Tavoline mësuesi | Cope | 1 |
| | Shkolla Muco Delo | | |
| 1 | Karrige Metalike | Cope | 4 |
| | Shkolla 24 Maji | | |
| 1 | Tastiera | Cope | 10 |
| 2 | Maus | Cope | 10 |
| 3 | Kufje me mikrofon | Cope | 1 |
| 4 | Monitor | Cope | 16 |

Nga bashkia është vepruar në kundërshtim me pikën nr. 119 të udhëzimit nr. 30,datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik", pasi nuk janë përcaktuar rregulla për përcaktimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të llojeve të ndryshme të aktiveve dhe nuk është përcaktuar kufiri monetarë. Gjithashtu, komisionin e inventarit nuk e ka kryesuar nëpunësi autorizues në kundërshtim me pikën nr. 99, të udhëzimit nr. 30,datë 27.12.2011" për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Në komisionet e vlerësimi nuk kanë marrë pjesë specialistë përkatës për vlerësimin e kompjuterëve, laboratorëve etj.

Nga rakordimi që u bë nga Bashkia me DAR Vlorë gjatë periudhës së auditimit (sipas kërkesës së grupit të auditimit për periudhën 2013-2017 ) u konstatua se: DAR Vlorë prej vitesh nuk ka kërkuar konfirmime në Njësitë e Qeverisjes Vendore , Bashkia Vlorë, Bashkia Orikum, ish– Komuna Shushicë, ish – Komuna Novoselë dhe ish- Komuna Qendër. Si pasojë e këtij mosveprimi të DAR Vlorë në shumë raste nuk janë përfshirë në inventarët e shkollave furnizimet që drejtorit e shkollave kanë tërhequr në DAR Vlorë . Janë përfshirë në inventarin e shkollave në raste të veçanta nga disa drejtorë shkollash që kanë paraqitur fletë daljet e DAR Vlorë komisioneve të inventarizimit në fund të vitit ( pa u bërë hyrje në njësitë vendore). Në këto raste komisionet i kanë përfshirë në inventarin fizik në mënyrë ekstra kontabël ( pa artikull kontabël).
Nga rakordimi i kryer nga Bashkia Vlorë me DAR Vlorë (sipas kërkesës së grupit të auditimit), nuk janë përfshirë në inventarë fletë daljet e DAR Vlorë vlera prej 21,124,549 lekë, sipas pasqyrës Aneks 2/3.c bashkëlidhur Raport Auditimit.

Analizat e llogarive inventariale që ju përkasin shkollave në administrim të Bashkisë për llogaritë 214 ”Instalime, makineri, pajisje e vegla pune”, llogaria nr. 218 “Inventarë ekonomik” dhe 32” Objekte inventari”, si rezultat i mos bërjes hyrje në magazinat e njësive të shkrira, por të furnizuar në mënyrë direkt nga DAR Vlorë adresuar drejtorive të shkollave nuk e kanë të saktë inventarin kontabël. Nga Drejtoria Rajonale Arsimore Vlorë nuk janë kërkuar konfirmime për furnizimet që (kjo e fundit) i ka adresuar Drejtorive të shkollave pa kaluar nëpërmes magazinave të ish- Bashkisë Orikum, ish- Komunës Novoselë, ish- Komunës Shushicë dhe ish- Komunës Qendër. Kjo procedurë është ndjekur prej vitesh dhe pasaktësia e inventarëve kontabël dhe fizik është mbartur në bilancin e Bashkisë Vlorë. Nuk mund të krahasohet inventari kontabël me inventarin fizik, pasi inventari kontabël nuk është rritur gjatë viteve se, nuk janë bërë hyrje në njësitë vendore furnizimet e DAR Vlorë (nuk janë kontabilizuar). Sipas të dhënave Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë (sipas kërkesës të grupit të auditimit) rezultuan të pa përfshira në inventarin kontabël dhe inventarin fizik të bashkisë 26 fletë dalje që i përkasin vitit 2013-2017, në vlerën 21,124,549 lekë, për të cilën duhet të nxirret përgjegjësia ndaj personave që kanë tërhequr inventarë sipas fletë daljeve të DAR Vlorë dhe nuk i kanë bërë hyrje në magazinat e njësive vendore dhe nuk i kanë paraqitur në inventarët fizike në mbyllje të periudhave ushtrimore.
E njëjta procedurë është ndjekur dhe për kryerjen e inventarit të vitit 2016, me urdhër nr. 339, datë 18.01.2017, është ngritur komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve afat gjata dhe inventarit të magazinës dhe përdorim për vitin 2016, që janë ngritur 12 komisione. Inventarët duhet të përfundojnë brenda datës 28.02.2016. Sipas urdhrit nr. 143, datë 18.07.2017, për nxjerrje jashtë përdorimit (asgjësim) janë ngritur 5 komisione. Janë asgjësuar llogaria 327 “Inventarë i imët” 2,387,250 lekë, 214 “Instalime teknike makineri e pajisje ” 19,070,094 lekë, “Inventarë Ekonomik” 3,537,605 lekë,212 “Ndërtesa “ 420,617 lekë 213 “Rrugë rrjete e vepra “ 7,340,557 lekë 215 “Mjete Transporti” 3,384,000 lekë, 312” mallra e Materiale” 98,117 lekë inventarët e vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit nuk janë grumbulluar dhe as janë nxjerrë materiale të tjera nga asgjësimi, nuk është përcaktuar vendi i asgjësimit por janë asgjësuar nëpër vende të ndryshme. Nuk është regjistruar fletë hyrja e fundit për magazinat dhe është marrë deklaratë. Nga asgjësimi nuk është bërë hyrje asnjë material. Inventarët për çdo vit ushtrimorë janë kryer në vitin pasardhës. Inventari i vitit 2015 është kryer në vitin 2016 dhe inventari i vitit 2016 është kryer në fillim të vitit 2017, por nuk është hartuar pasqyra e bilancit.

Për inventarizimin e vlerësimin si dhe asgjësimin janë shkelur depozitat ligjore veprim në papajtueshmëri me germën ë të pikës 3 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", me pikën 35, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe germën d të pikës 15, të UMB nr. 1151, datë 16.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme", ku përcaktohet: "Procesverbalit të asgjësimit i bashkëlidhen kopja e fletëhyrjes për materialet e ndryshme të marra në ngarkim dhe fletëdalja për materialet e nxjerra jashtë përdorimit dhe të asgjësuara.

-Zbatimi i normativave të harxhimit të karburanteve të mjetet motorike apo gjeneratorët që disponon, miratimi në Këshillin e Bashkisë/Komunës për secilin tip, mjeti, mbajtja e fletë udhëtimeve, pajisje me leje qarkullimi i tyre, pagesa e taksave dhe siguracioneve vjetore *(pasqyra trajtuar në faqen 49-53, të Projekt raport Auditimit)*;

Në auditimin e ushtruar për rregullshmërinë e plotësimit dhe përpunimit të dokumentacionit të shpenzimeve për karburant u konstatua se: Nga bashkia janë përcaktuar normativat e karburantit sipas tipave të mjeteve në përdorim nga bashkia e njësitë vartëse. Nga shoferët e transportit janë plotësuar fletë udhëtimet dhe është bërë përllogaritja e harxhimit të karburantit referuar normativave të miratuar nga nëpunësi autorizues (Kryetari Bashkisë). Nga verifikimet e bëra nuk u konstatuan raste të tejkalimit të normave krahasuar me km e përshkruara sipas fletë udhëtimeve.

-Administrimi, Dokumentimi dhe marrja në dorëzim e ndihmave nga donatorët e ndryshëm;

Bashkia Vlorë, në zbatim të VKM nr. 366, datë 18.05.2016, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme shtetërore, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit", ka marrë me transferim pa shpërblim aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive qarkulluese, nga Prefektura e Qarkut Vlorë për vlerën kontabël 77,527,098 lekë.

Këto aktive janë marrë në dorëzim me komision sipas procesverbalit të datës 7.06.2016 të mbajtur midis përfaqësueseve të dy institucioneve.

Sipas aktit të marrjes në dorëzim të këtyre aseteve, janë marrë në dorëzim aktivet me vlerën kontabël në shumën totale 77,527,098 lekë të analizuara si vijon:

-Aktive të trupëzuara me vlerën kontabël ..... 69,036,548 lekë,

-Aktive qarkulluese me vlerën kontabël .....5,984,257 lekë dhe

-Aktive qarkulluese në magazinë me vlerën kontabël ..... 2,506,293 lekë.

Akti i dorëzimit, është shoqëruar me kartelat inventariale të personave përgjegjës sipas inventarizimit të kryer nga Prefekti i Qarkut Vlorë për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2015.

Transferta janë pasqyruar në pasqyrat financiare të fund vitit 2016, formati 4, nr. llogarisë 1059"Grande të brendshme në natyrë", formati 6, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve të qëndrueshme" sipas llogarive përkatëse si dhe shtesa në aktivin e bilancit sipas llogarive përkatëse.

U konstatua se marrja në dorëzim e aktiveve të trupëzuara për vlerën kontabël 77,527,098 lekë, nuk është shoqëruar me vlerën përkatëse të amortizimit të tyre për efekt të veprimeve kontabël, gjë që është në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, Qendrore dhe lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre" i ndryshuar.

-Përveç këtyre, Bashkia Vlorë ka marrë pa shpërblim, Asete të tjera si printerë, pajisje, inventarë ekonomike etj., në vlerën totale 5,753,548 lekë, të trajtuara në relacionin e pasqyrave financiare. Për

këto grande në natyrë, bazuar në fletë daljet e institucionit dhurues, janë bërë hyrje në magazinën e Bashkisë Vlorë. Konkretisht ndihma në natyrë nga:
-AKTSH .....518,400 lekë,
-Ministria e Çështjeve Sociale ..... 833,365 lekë,
-Ministria e Punëve të brendshme ..... 2,077,823 lekë,
-Drejtoria e Përgjithshme e Tatim taksave .... 286,000 lekë,
-Drejtoria Arsimore ..... 2,037,960 lekë.
Nga auditimi u konstatua se për këto furnizime në formë grandi, nuk janë bërë akte rakordimi të mbajtur midis Institucionit furnizues dhe përfituesit Bashkia Vlorë.
Konkretisht për asetet që Drejtoria Arsimore, i ka dërguar direkt në Drejtoritë e Shkollave, është prerë fletë hyrja nr. 2, datë 19.01.2016 me vlerën 2,037,960 lekë, bazuar në fletë daljen e Drejtorisë Arsimore nr. 156/1, datë 16.06.2015, pra 6 muaj më vonë.
Në këtë rast, hyrja në magazinë është bërë me vonesë në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, pikat 37, 38, 39, 42, në pikën 37 citohet: "Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes ne dorëzim te aktiveve, referuar kushteve te përcaktuara ne kontrate)".
-Administrimi i letrave me vlerë, sipas përcaktimeve në VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 "Për shtypjen e letrave me vlerë, i ndryshuar me VKM nr. 277,datë 6.4.2011 dhe VKM nr. 393, datë 18.6.2014;
Letrat me vlerë sipas llojeve dhe çmimeve janë bërë hyrje në magazinë dhe janë shpërndarë me urdhër dorëzimi personave të ndryshëm sipas funksioneve përkatëse për përdorim.
Në mbyllje të periudhave ushtrimore (viti 2015 e 2016) janë inventarizuar dhe gjendja kontabël është përputhur me gjendjen fizike. Është bërë azhurnimi në kartelat përkatëse. Në mbyllje të viti 2017, gjendja kontabël e letrave me vlerë paraqitet:

| Nr. | Letra me vlerë | Gjendje në magazinë | | |
|---|---|---|---|---|
| | | çmo | Sasi | Vlerë |
| 1 | Proverbial policie | 400 | 73 | 29,200 |
| 2 | Flete gjobe policie | 72 | 88 | 6,336 |
| 3 | Vërtetim rajoni | 200 | 30 | 6,000 |
| 4 | Vërtetim rajoni 100 lekëshe | 150 | 20 | 3,000 |
| 5 | Vërtetim rajoni 500 lekëshe | 150 | 21 | 3,150 |
| 6 | Vërtetim rajoni 1000 lekëshe | 150 | 8 | 1,200 |
| 7 | Vendim gjobe insp. Ndërtimor | 600 | 18 | 10,800 |
| 8 | Vendim pezullimi | 600 | 18 | 10,800 |
| 9 | Vendim prishje | 600 | 7 | 4,200 |
| 10 | Proces verbal pezullimi | 1800 | 12 | 21,600 |
| 11 | Proces verbal prishje objekti | 1800 | 10 | 18,000 |
| 12 | Proces verbal dënim gjobe | 1800 | 6 | 10,800 |
| 13 | Proces verbal plotësim dokumenti | 1800 | 19 | 34,200 |
| 14 | Proces verbal policia ndërtimore | 360 | 11 | 3,960 |
| 15 | Blloqe tregu | 180 | 60 | 10,800 |
| 16 | Bileta hyrje 200 lekëshe Ishulli Sazanit | 360 | 30 | 10,800 |
| 17 | Proces verbal Tatim Taksat | 400 | 54 | 21,600 |

| Nr. | Letra me vlerë | Gjendje në magazinë | | |
|---|---|---|---|---|
| | | çmo | Sasi | Vlerë |
| 18 | Proces verbal Gjendja Civile | 400 | 5 | 2,000 |
| 19 | Blloqe te kthyer pol. Ndërtimore | 600 | 4 | 2,400 |
| 20 | Autorizime për transport të lëndës drusore | - | - | - |
| | **Shuma :** | | | **210,846** |

Si mangësi u konstatua se: Nga bashkia nuk janë përdorur autorizime për transport të lëndës drusore, për përdorim nga qytetarët, megjithëse u konstatua se ka likuidime si Urdhër shpenzimi nr.1150 datë 11.12.2017 si fletë hyrja bashkëngjitur nr. 33 datë 26.05.2017, 20 (njëzet) blloqe 1680 lekë =33,600 lekë. Sipas fletë daljes nr. 3, datë 30.05.2017 janë bërë dalje po 20 (njëzet) blloqe , vërtetime pyjesh me seri 0000001- 0000600 ( 600 fije ) nënshkruar nga inxhinieri A. M. dhe në fund të vitit 2017, nuk ka kthyer blloqet e përdorura për të saktësuar inventarin fizik.
Letrat me vlerë në bilanc janë pasqyruar në llogarinë nr. 532,"Vlera të tjera", por në fakt nuk administrohen në arkën e bashkisë, por në magazinë. Nga verifikimi rezulton se janë bërë hyrje dhe dalje nga magazina. Teprica në fund të periudhave ushtrimore për çdo artikull është e njëjtë dhe inventari kontabël është i njëjtë me inventarin fizik që disponon magazina gjendje, por nuk është nuk ka një rregull të shkruar nga bashkia për qarkullimin e tyre.
Vlerësim mbi mënyrën e bashkimit të aktivitetit të ish-komunave dhe zbatimi i procedurave të caktuara në VKM nr.510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 "Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial".
-Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës për zbatimin e procedurave (Kreu II, i VKM), Vlerësimi i raportimeve periodike dhe informimi i strukturave përkatëse shtetërore, afatet ligjore në përgatitjen e Raportit të Kontrollit Operacional.
Për zbatimin e reformës administrative, me urdhër të Kryetarit Bashkisë është ngritur Komisioni për zbatimin e reformës administrative sipas urdhrit nr. 80, datë 25.08.2015 i përbërë nga N/kryetari i Baskisë, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, Drejtoresha Juridike, Drejtori i Buxhet dhe financës dhe përgjegjësja e protokoll arkivës. Në komision nuk është përfshirë Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe specialisti i TIK në kundërshtim me udhëzimin nr. 3237, datë 16.05.2015 "Për procedurat dhe afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për organizimin administrativo-territorial, pika 4. Nga grupi i punës nuk është hartuar asnjë informacion apo raport i veçantë për njësitë e shkrira ( NJSH). Nuk na u vu në dispozicion asnjë informacion i raportuar në strukturat përgjegjëse as i veçantë dhe as përmbledhës. Komisioni është mjaftuar me të dhënat e ekipit "Stara" të Ministrisë Financave i cili ka kryer funksionin udhëzues, kryesisht për sektorin e financës dhe nuk kanë lënë material të nënshkruar nga ana e tyre.
Nuk është hartuar raporti me shkrim nga komisioni i ngritur për reformën administrative.
-Vlerësimi i përmbajtjes së raportit mbi çështjet operacionale, si: strukturat administrative dhe përgjegjësitë; disponueshmëria e shërbimeve publike dhe funksioneve administrative; inventari i sistemeve të informacionit dhe kontratave të mirëmbajtjes; vlerësimi i kontrolleve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të zbatuara në sistemet e informacionit; inventari i pajisjeve të

TIK dhe marrëveshjeve të komunikimit; procedurat e arkivimit të dokumentacionit; menaxhimi i aktiveve; projektet e investimit; kontratat e shërbimeve publike; kontratat me palët e treta; çështjet gjyqësore (Shtjello në mënyrë të zgjeruar për secilën njësi shpenzuese.

Duke qenë se në komision nuk ka marrë pjesë specialist i teknologjisë dhe informacionit, nuk janë përfshirë të dhëna për njësitë e shkrira për rrjetet informatike, komunikimin elektronik. Gjithashtu nuk janë paraqitur të dhëna për arkivat e njësive, për gjendjen, kapacitetin ,dokumentacionin e arkivuar, të pa arkivuar. Për gjendjen e arkave, sigurinë e lëvizjes të hollave në bankë etj. Për arkivat në Njësinë e ish- Komunës Qendër nuk është arkivuar dokumentacioni i financës si, dokumentacioni i arkës , bankës, magazinës listëpagesat etj. Gjithashtu nuk është dorëzuar dokumentacioni financiarë me shkrim nga nëpunësit e larguar nga puna si efekt i reformës administrative. Nëpunësit e emëruar në Njësinë administrative Qendër nuk e kanë marrë dokumentacionin me firmë. Nga Komisioni i reformës administrative nuk është menaxhuar dorëzimi i dokumentacionit nga nëpunësit e larguar.

-Nëse përfshin raporti informacion të plote mbi çështjet financiare, si buxheti; aktivet afatgjata materiale; inventari; debitorët dhe të tjera të arkëtueshme; gjendja e likuiditeteve; kreditorët; shpenzimet; te ardhurat; investimet në filiale; grandet nga donatorë të huaj; financimi dhe shpenzimet e lidhura me investimet; pasqyra e rrjedhjes së parasë; pasqyra e balancave dhe ndryshimeve gjatë vitit të aktiveve të qëndrueshme; pasqyra e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme; pasqyra e ndryshimit të fondit etj.

Formulari nr. 1, i bilanceve të ish- Komunave dhe i Bashkisë për vitin 2015.

**Aktivi**

| Nr. | Emërtim | Orikum | Shushicë | Qendër | Novoselë | Totali NJ.AD | Bashkia 31.12.2015 | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 202 | Pr.estud | 25,651,500 | 3,795,000 | 18,503,000 | 12,212,760 | 60,162,260 | 42,083,200 | 102,245,460 |
| 209 | Amortiz. | -6,387,925 | -528,684 | -3,546,585 | -2,223,045 | -12,686,239 | -14,083,232 | -26,769,471 |
| 211 | Troje e T | 1,339 | | | | 1,339 | | 1,339 |
| 212 | Ob.ndert. | 105,631,349 | 52,712,766 | 56,253,642 | 69,370,100 | 283,967,857 | 373,062,738 | 657,030,595 |
| 213 | Rr.rr.v.u. | 580,472,661 | 217,181,451 | 375,515,269 | 403,288,130 | 1,576,457,511 | 912,586,124 | 2,489,043,635 |
| 214 | Ins.M.P | 1,414,888 | 11,153,966 | 9,690,955 | 23,459,662 | 45,719,471 | 100,692,290 | 146,411,761 |
| 215 | M.trasp. | 14,487,824 | - | 2,786,200 | 5,798,000 | 23,072,024 | 22,256,000 | 45,328,024 |
| 218 | Inv.EK. | 17,307,516 | 8,282,403 | 7,577,823 | 3,975,419 | 37,143,161 | 20,496,179 | 57,639,340 |
| 219 | Am | -145,619,078 | -31,622,502 | -60,923,577 | -66,058,474 | -304,223,631 | -380,068,671 | -684,292,302 |
| 231 | Sh.proc. | | 137,419,335 | 38,418,026 | 51,497,121 | 227,334,482 | 295,441,908 | 522,776,390 |
| 26 | Pjesëmarrje ne kap.vet | | | | | | 2,000,000 | 2,000,000 |
| 31 | Mat | 876,387 | | | 270,382 | 1,146,769 | 7,798,161 | 8,944,930 |
| 32 | Ob.inv | 2,846,783 | 228,765 | 811,690 | 3,053,007 | 6,940,245 | 16,575,378 | 23,515,623 |
| 4342 | Të tjera op.shteti | 5,396,130 | 6,903,725 | 5,444,283 | 4,334,449 | 22,078,587 | 204,966,416 | 227,045,003 |
| | Org.tjerashoqerore | | | | | 0 | 135,335 | 135,335 |
| 468 | Deb | 15,922,745 | 1,041,663 | 895,111 | 7,238,201 | 25,097,720 | 73,111,125 | 98,208,845 |
| 520 | D.Thes. | 15,308,974 | 3,922,292 | 13,360,652 | 12,202,092 | 44,794,010 | 38,530,692 | 83,324,702 |
| 511 | Vlera te tjera | | | | 333,000 | 333,000 | 5,777,000 | 6,110,000 |
| | **Total** | **633,311,093** | **410,490,180** | **464,786,489** | **528,750,804** | **2,037,338,566** | **1,721,360,643** | **3,758,699,209** |

**Pasivet**

| Nr. | Emërtim | Orikum | Shushicë | Qendër | Novoselë | Total Njësive AD | Bashkia 31.12.2015 | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 101 | Fonde Bazë | 596,683,244 | 261,203,165 | 407,563,528 | 453,145,941 | 1,718,595,878 | 1,105,322,273 | 2,823,918,151 |
| 105 | Fonde bazë | - | 137,419,335 | 20,064,170 | 51,497,121 | 208,980,626 | 193,219,453 | 402,200,079 |

| Nr. | Emërtim | Orikum | Shushicë | Qendër | Novoselë | Total Njësive AD | Bashkia 31.12.2015 | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 115 | Caktim fond inv | - | - | 18,353,856 | | 18,353,856 | 102,222,455 | 120,576,311 |
| 42 | Paga | - | - | 1,183,805 | | 1,183,805 | 22,906,689 | 24,090,494 |
| 401 | Furnitor | 85,400 | | | | 85,400 | 7,754,310 | 7,839,710 |
| 431 | Tatim | 129,570 | 2,499,974 | 38,661 | | 2,668,205 | 1,039,016 | 3,707,221 |
| 4341 | OPerac.Shteit | | 1,041,663 | | | 1,041,663 | 706,928 | 1,748,591 |
| 16 | Huamarrje brendshme dhe ngjash | | | | | 0 | 94,644,255 | 94,644,255 |
| 44 | Institucione tjera publike | | | | 333,000 | 333,000 | 6,029,900 | 6,362,900 |
| 435 | Sig Shoq | 46,369 | 645,313 | 337,283 | | 1,028,965 | 6,723,297 | 7,752,262 |
| 436 | SigShënd | 4,998 | | 46,807 | | 51,805 | 921,126 | 972,931 |
| 466 | Ngurtësime | 4,366,127 | 1,758,497 | 2,371,077 | 5,409,237 | 13,904,938 | 26,207,861 | 40,112,799 |
| 467 | Kreditor | 5,129,793 | 3,758,438 | 3,837,727 | 4,334,449 | 17,060,407 | 70,977,723 | 88,038,130 |
| 475 | Për tu arkëtuar | | | | 7,238,201 | 7,238,201 | 70,362,526 | 77,600,727 |
| 480 | Ardh rregullim | 15,922,745 | | | | 15,922,745 | | 15,922,745 |
| 85 | Rezultati | 10,942,847 | 2,163,795 | 10,989,575 | 6,792,855 | 30,889,072 | 12,322,831 | 43,211,903 |
| | **Totali** | **633,311,093** | **410,490,180** | **464,786,489** | **528,750,804** | **2,037,338,566** | **1,721,360,643** | **3,758,699,209** |

Janë përgatitur bilancet e njësive të shkrira Orikum, Shushicë, Qendër, Novoselë, por u konstatuan mangësi : Për aktivet e patrupëzuara nuk është hartuar një analizë e qartë për projekte të vëna në zbatim dhe inventari i projekteve të pa vëna në zbatim. Në bilancin e njësisë administrative Novoselë është paraqitur në analizë në llogarinë nr. 202, "Projekte e studime" për vlerën 9,812,760 pa emërtesë të projekteve. Nga njësitë e shkrira (NJSH) është llogaritur amortizim për projekte ndërtimore në vlerën 14,083,232 lekë, në kundërshtim me udhëzimin e KM nr.2,datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" pika C " Të ndryshme". Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara pa një analizë par çdo element (artikull), por sipas tepricave të llogarive. Në bilancet e NJSH nuk janë paraqitur në asnjë rast pronat e transferuara nga Pushteti Qendrorë në njësitë e pushtetit Vendor. Në aktivet afatgjata nuk janë përfshira në zërin "Toka dhe troje"
Në faturat e pa likuiduara mungojnë të dhëna për numrin e NIPT, debitorët nuk janë shoqëruar me të dhëna analitike, data e krijimit, shkresat me të cilat është kërkuar detyrimi, ndër vite për çdo debitorë. Nga NJSH, janë mbartur debitor në bilancin e bashkisë 25,097,720 lekë .
Për debitorët edhe pse është analiza me emra, por nuk ka analizë me vitin e krijimit, shkresat për vjeljen e detyrimit, origjina e krijimit ( nuk ka dosje debitorëve).
Janë mbartur në llogarinë nr. 467" Kreditorë të ndryshëm" në vlerën 17,060,407 lekë, të shoqëruar me fatura .
Në llogarinë nr. 480" Të ardhura për tu rregulluar" në bilancin e ish- Bashkisë Orikum është paraqitur me tepricë 15,922,745 lekë me kundra parti në llogarinë 468" Debitor në persona", ku duhej të ishte paraqitur në llogarinë nr. 475" Të ardhura për tu arkëtuar". Sistemuar nga bashkia.
Nga Policia Komunale ne asnjë rast nuk është dorëzuar dokumentacioni si: Blloqet e gjobave pa përdorura, librat e shërbimeve etj.
Në bilancet mangësi u konstatuan se:
Nga njësitë e shkrira nuk është ndjekur i njëjti standard në paraqitjen e pozicioneve financiare për kundra partinë e llogarisë debitorë. Nga njësitë e shkrira nuk është azhurnuar libri i madh apo centralizator dokumentacion që duhej të shoqëronte bilancet. Këto parregullsi bien në kundërshtim me rregullimet e parashikuara në UMF nr. 14, datë 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e

pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre" i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik" si dhe Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi grupin e punës të ngritur për reformën administrative. Gjithashtu nuk mund të shmanget nga përgjegjësia dhe Kryetari i Bashkisë D. L. i cili nuk ka përfshirë, në komision Përgjegjësin e Sektorit të Financës dhe specialistin e TIK në kundërshtim me udhëzimin nr. 3237, datë 16.05.2015 "Për procedurat dhe afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për organizimin administrativo-territorial, pika 4. Gjithashtu nuk janë kërkuar raportime për ecurinë e reformës.

Akoma nuk janë vlerësuar dhe kaluar ne kontabilitet F.....A e sportit në NJA Orikum. F.....A e klubit Sportit Orikum, është përfshirë në kontabilitet vetëm tribuna në vlerë 7,829,183 lekë, F.....A e sportit shkolla e mesme Orikum, F.....A e sportit D.....At i ri.

-Afati i përgatitjes së "Raportit të Konsoliduar të Kontrollit", bazuar në afatin ligjor brenda muajit nëntor 2015, nga Bashkia.

Grupit të Auditimit nuk ju vunë në dispozicion raporte periodike dhe as raporti përmbledhës për ecurinë e reformës administrative nga grupi i ngritur për menaxhimin e reformës mbështetur në urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 80, datë 25.08.2015.

-Auditim mbi ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit kontabël në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe zbatimi i rregullores "Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore".

Aktualisht dokumentacioni kontabël për njësitë e shkrira (NJSH), administrohet në njësitë administrative, ndërsa dokumentacioni financiarë i Bashkisë Qendër administrohet në zyrat e Qendrës Ekonomike dhe nuk është arkivuar në arkivin e Bashkisë si dokumentacioni i bankës, magazinës, arkës, pagave, ditarët e kontabilizimeve etj. që përfshijnë periudhën nga viti 2004.

Në Njësinë Administrative Novoselë dokumentacioni i financës që i përket periudhës viti 2011- 2015, administrohet në ish-Zyrën e Financës të ish-Komunës dhe nuk është arkivuar (shkresa e Njësisë Administrative nr. 259, datë 14.02.2018). Në Njësinë Administrative Qendër nuk është

Edhe nga Auditi i Brendshëm i Bashkisë Vlorë nuk është ushtruar asnjë auditim në njësitë administrative gjatë vitit 2016 -2017.

***Konkluzione përfundimtare** :*
*Në ish- Komunat Novoselë, Shushicë, Qendër, nuk janë aprovuar rregulla e procedura mbi menaxhimin e aktiveve. Nuk janë hartuar plane dhe objektiva për mekanizmat e kontrollit në lidhje me riskun e menaxhimit të aktiveve. Në inventarin e aktive afat gjata të trupëzuara mbarten artikuj pa çmime. Amortizimi është i llogaritur në nivel grupi dhe jo na mënyrë individuale për çdo artikull. Në bilancet e hartuara më datë 7.07.2015, nuk janë përfshirë toka dhe troje të transferuara nga Pushteti Qendrorë në pushtetin vendorë. Nuk administrohen rakordimet me DAR Vlorë, për furnizimet e bëra në adresë të shkollave në administrim të ish- Komunave. Mungojnë regjistrat e pronave të dhëna me qira, parregullsi të cilat janë mbartur në Bashkinë Vlorë.*

*<u>Në Bashkinë Vlorë u konstatuan parregullsi</u>*:

Pas reformës administrative nga struktura organike e Bashkisë është shkurtuar pozicioni Përgjegjësi i Sektorit të Kontabilitetit dhe drejtimin e këtij sektori e mbulon Drejtori i Financë Buxhetit dhe të

Ardhurave. Si pasojë e shkrirjes së pozicionit të punës, bilancet janë nënshkruar nga punonjës i thjeshtë i kontabilitetit, veprim në kundërshtim germën (b),pika 2,neni 12 dhe neni 15, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin". Ky veprim bie në kundërshtim germën (b),pika 2,neni 12 dhe neni 15, të ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin". Nuk është hartuar rregullore për ndarjen operacioneve dhe proceseve të punës për çdo post pune.

Likuidimet e kryera në favor të firmave private në vlerën 11,042,997 lekë, me natyrë inflacion i viteve 2014,2015 e 2016, edhe pse janë të mbështetura në kontrata, likuidimi nuk është i justifikuar me bilancet e certifikuara nga Dega Rajonale e Tatimeve Vlorë dhe nuk është e argumentuar humbja e pësuar në tërësinë e aktivitetit të firmave private të pastrimit, të gjelbërimit, mirëmbajtjes varrezave dhe shërbimit të dekorit dhe inflacioni nuk është i likuidushëm me VKM për të gjithë ekonominë shqiptare dhe në këto kushte përbën dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Sipas urdhër shpenzimit nr. 729 datë 17.12.2015 përsa është llogaritur inflacion për Mirëmbajtje Varreza dhe mirëmbajtje dekori për llogari të vitit 2014 konstatohet se: në favor të "K.....N" Vlorë për shumën 124.270 lekë. Inflacioni është llogaritur për çdo muaj, pa mbështetje ligjore.

Me urdhër shpenzimin nr. 1177 datë 31.12.2017 për vlerën 1,620,000 lekë, likuidim energji e prapambetur për llogari të Klubit të futbollit Flamurtari që i përket periudhës deri në muajin nëntor 2014. Sa sipër është likuiduar kamat vonesë, për llogari të stadiumit Flamurtari 525,634 lekë dhe kalçeto Bashkia Vlorë 525,842 lekë dhe nuk ka rakordim me OSHEE dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia dhe shkaku i vonesës së likuidimit.

Në urdhër shpenzimin nr. 1073 datë 24.11.2017, në vlerë 5,986,624 lekë për llogari të muajit Tetor është likuiduar energji elektrike për 320 kontrata, pa u regjistruar leximet e matësve të energjisë. Nga bashkia nuk janë marrë masa për të caktuar person përgjegjës për saktësimin e harxhimit energjisë sipas kontaktorëve, par të gjitha kontratat.

Për periudhën 2013-2017, nuk janë bërë hyrje në njësitë vendore furnizimet e DAR Vlorë për 26 raste në vlerë 21,124,549 lekë, që përbën dëm ekonomik.

Me urdhër shpenzimin nr. 673 datë 07.12.2015 për vlerën 194,030 likuiduar për blerje nafte nga ish-komuna Qendër për muajin korrik 2015 sipas faturës nr. 15 datë 01.07.2015 për 800 litra naftë me vlerë 135.197 lekë si fletë dalja R. C., datë 01.07.2015, 80 Tollonat Naftë x 10 litra me 800 litra karburant. Nuk kuptohet firma e blerësit, nuk ka emër dhe mbiemër, po ashtu dhe fletë dalja e furnizuesit. Gjithashtu dhe fletë dalja e Komunës Qendër nuk është bashkangjitur urdhër-shpenzimit, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues për harxhimin e karburantit (fletë udhëtimet).

Me urdhër shpenzimin nr. 710 datë 15.12.2015 është likuiduar në favor të subjektit "T.....A" shuma 190,500 lekë për faturat nr. 39 datë 28.08.2015, nr. 9 datë 22.09.2015 dhe nr. 65 datë 24.11.2015 për njoftim dhe intervista. Likuidimi është bëre në kundërshtim me pikat 3,4,5 të nenit nr. 40 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik " dhe në kundërshtim me piken 5 të Udhëzimit nr. 3 datë 27.01.2015 "Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël" të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Për mangësitë e konstatuara mbajnë përgjegjësi nëpunësi zbatues T. Z. dhe nëpunësi autorizues D. L. parregullsitë që bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë

16.07.2015 "Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial" dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Për sa është kundërshtua në pikën III/3.a., me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), se detyrimet janë 588,809,686 lekë po të zbriten principialin i kredisë, interesi, sigurimet shoqërore e shëndetësore,* ***grupi i auditimit sqaron:*** *Për efekt të zbatimit të buxhetit të vitit 2018 duhet të përfshihen detyrimet e palikujduar më datë 31 Dhjetor 2017 (shih detyrimet pasqyra 4, e bilancit) që ka të bëjë me parimin e të drejtave të konstatuara dhe detyrimet janë*
*III / 3. c. Në lidhje me delegimin e detyrave sipas urdhrit nr. 73, datë 24.07.2014" Për delegim detyrash "Është sqaruar në auditimin financiarë (gjetja nr.3), e Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 187, datë 22.12.2017 "Për auditimin e ushtruar në Bashkinë Vlorë, për rregullshmërinë financiare të aktivitetit ekonomik nga 01.01.2016-31.12.202016".*
***Vërejtjet e paraqitura me shkresës nr. 1690/1, datë 02.03.2018,*** *bërë nga ish-Kryetari i Bashkisë Orikum dhe ish-P/Financës Z. Q., ku pretendohet se rikonstruksioni i F.....Ave të sportit është përfshirë në kontabilitet edhe grupi i auditimit e pranon dhe e ka të qartë se janë përfshirë në kontabilitet, por nuk janë përfshirë vlerat e F.....Ave para rikonstruksionit dhe ne pranojmë nëse ndonjë fushë sporti është e përfshirë në kontabilitet të bëhet kujdes dhe të mos përfshihet dy herë, por dhe rikonstruksionit pa e pasur fushën nuk ka kuptim (Trashëgohet si vlerë në të ardhmen vetëm vlera e ristrukturimit).*

- **<u>Mbi auditimin e ushtruar në ish- Komuna Qendër Vlorë</u>.**

Mbështetur në proces verbalin nr. 93, datë 28.10.2015, nga specialistët e Njësisë Administrative Qendër; J. J., H. C dhe M. K, nuk është marrë në dorëzim i gjithë dokumentacioni financiarë dhe nuk është sistemuar me inventarë në arkivin e njësisë administrative. Në arkiv nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion nga ish - zyrat e komunës dhe nuk është sistemuar e inventarizuar dokumentacioni sipas zyrave (mbështetur në deklarimin datë 10.01.2018 të arkivistes Teuta Danaj).
<u>*Dokumentacioni i bankës*</u>:
Për vitin 2013, sipas likuidimeve nëpërmes Degës Thesarit janë kryer shpenzime gjithsej 102,213,871 lekë shpenzime me urdhër shpenzime nga nr. 1- 289. Shpenzimet kapitale dhe korente janë të rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë dhe rast pas rasti janë nënshkruar nga specialisti i thesarit. Edhe për vitin 2014, sipas urdhër shpenzimeve 1-135 janë likuiduar nëpërmes Degës Thesarit Vlorë 135,837,543 lekë. Për 6/mujorin e vitit 2015, janë plotësuar 163 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre) urdhër shpenzime me vlerë 51,117,774 lekë të rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë.
Dokumentacioni është plotësuar dhe nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe zbatues dhe miratuar likuidimet nga Dega e Thesarit Vlorë. Bilancet janë dorëzuar brenda afatit datë 28 Shkurt të vitit pasardhës. Të ardhurat dhe shpenzimet janë rakorduar me thesarin në mënyrë periodike dhe në mbyllje të periudhave ushtrimore ( bilancet e vitit 2014 ,2015 e 6/mujori i vitit 2015). Shpenzimet e kryera nëpërmes degës së thesarit janë të njëjta me pasqyrën e lëvizjes në Cash të bilanceve.
Në likuidimet e kryera u konstatua se: Për vitin 2014, ish - Kryetari i Komunës F. B ka kryer shpenzime nga artikulli 602 "Shpenzime operative", ne favor të tij, 75,000 lekë bonus transporti të pa mbështetur në dispozita ligjore, që përbën dëm ekonomik.

Janë kryer rregullisht inventarët par vitin 2013 e vitin 2014, nga komisionet e ngritura me urdhra të veçantë të ish- Kryetarit të Komunës .

**Si mangësi u konstatua se:**

Nga inventari i vitit 2014 të mbartur në Bashkinë Vlorë në inventarin e vitit 2015 e në vazhdim për 49 artikuj të ndryshëm që i përkasin llogarisë nr. 218" Inventarë ekonomik" me çmim 1(një) lekë për artikull, ku veçojmë 12 (trembëdhjetë) kompjuter dhe 4(katër) printer etj. inventarë që ju përkasin shkollave në administrim të ish- Komunës Qendër, Bestrovë, Panaja, Hoshtime, Babicë e vogël, Nartë Xhuherinë, Babicë e madhe dhe Kërkovë.

**Aktivet në lekë**

| Nr. | Emërtim | 2013 | 2014 | 2015 |
|---|---|---|---|---|
| 202 | Projekte dhe studime | 13,775,000 | 18,503,000 | 18,503,000 |
| 209 | Amortiz. | -2,713,950 | -3,269,040 | -3,546,585 |
| 212 | Ob.ndert. | 56,253,642 | 56,253,642 | 56,253,642 |
| 213 | Rr.rr.v.u. | 375,515,269 | 375,515,269 | 375,515,269 |
| 214 | Ins.M.P | 9,690,955 | 9,690,955 | 9,690,955 |
| 215 | M.trasp. | 5,507,600 | 2,786,200 | 2,786,200 |
| 218 | Inv.EK. | 7,577,823 | 7,577,823 | 7,577,823 |
| 219 | Am | -52,706,311 | -58,177,779 | -60,923,577 |
| 231 | Sh.proc. | 6,017,916 | 30,412,650 | 38,418,026 |
| 31 | Mat | 86,923 | 84,324 | 0 |
| 32 | Ob.inv | 811,690 | 811,690 | 811,690 |
| 4342 | Të tjera op. Shteti | 2,188,217 | 19,611,361 | 5,444,283 |
| 468 | Deb | 895,111 | 895,111 | 895,111 |
| 512 | Llog banke | 18,184,593 | 11,605,120 | 13,360,652 |
| | **Total** | **441,084,478** | **472,300,326** | **464,786,489** |

Pozicionet financiare janë mbështetur në të dhënat e kontabilitetit të pasqyruar në ditarët përkatës por nuk është vendosur kufiri monetarë për përfshirjen në inventarë ekonomik dhe në objekte inventari sipas kërkesave të udhëzimit të Ministrisë Financave .Amortizimi i projekteve për investime është llogaritur pa u mbështetur në dispozita ligjore, pasi vlera e tyre ju kalon objekteve të ndërtuar e të marra në dorëzim si Udhëzimit të KM nr.2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" pika C "Të ndryshme".

Amortizimi është llogaritur me grupe dhe jo në mënyrë individuale, për çdo artikull.

**Pasivet ne lekë**

| Nr. | Emërtim | Viti 2013 | Viti 2014 | Viti 2015 |
|---|---|---|---|---|
| 101 | Fonde Bazë | 414,693,752 | 410,671,195 | 407,563,528 |
| 105 | Fonde veta | 6,017,916 | 15,064,250 | 20,064,170 |
| 115 | Caktim fond inv | - | 15,348,400 | 18,353,856 |
| 42 | Paga | 1,564,557 | - | - |
| 401 | Furnitor | - | 1,808,268 | - |
| 431 | Tatim | 115,173 | 47,234 | 1,183,805 |
| 4341 | Operac. Shteti | | | 38,661 |
| 435 | Sig Shoq | 286,607 | 315,457 | 337,283 |
| 436 | Sig Shënd | 64,964 | 71,504 | 46,807 |
| 466 | Ngurtësime | 1,063,174 | 2,283,006 | 2,371,077 |

| Nr. | Emërtim | Viti 2013 | Viti 2014 | Viti 2015 |
|---|---|---|---|---|
| 467 | Kreditor | 156,916 | 17,368,898 | 3,837,727 |
| 85 | Rezultati | 17,121,419 | 9,322,114 | 10,989,575 |
| | **Totali** | **441,084,478** | **472,300,326** | **464,786,489** |

***Konkluzion përfundimtarë.***
*Në likuidimet e kryera nëpërmes bankës janë kryer likuidime të pa argumentuar me dokumentacion mbështetës në një rast pagesë bonos transporti par vitin 2014 në vlerë 75,000 lekë.*
*Me urdhër shpenzimin nr. 673 datë 07.12.2015 ( Në Bashki) për vlerën 135,197 lekë likuiduar për blerje nafte nga ish- komuna Qendër për muajin korrik 2015,sipas faturës nr. 15 datë 01.07.2015 për 800 litra naftë me vlerë 135.197 lekë si fletë dalja R. C., datë 01.07.2015, 80 Talone Naftë * 10 litra me 800 litra karburant . Nuk kuptohet firma e blerësit, nuk ka emër dhe mbiemër, po ashtu dhe fletë dalja e furnizuesit. Gjithashtu dhe fletë dalja nr. 31,datë 30.06.2015 e Komunës Qendër është bërë shpërndarja sipas zyrave me plan shpërndarje, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues për harxhimin e karburantit (fletë udhëtimet ). Karburanti (talonet), me thithjen e aktivitetit nga bashkia duhej të ishte dorëzuar në bashki. Përbën dëm ekonomik në ngarkim të ish-Punonjësve të Komunës sipas shpërndarjes Zyra e Bujqësisë (XH. H.) 80 litra x 169 lekë = 13,520 lekë Zyra e urbanistikës 50 litra x 169 = 8450 lekë, Zyra e tatimeve (TH. T.) 50 litra x 169 = 8450 lekë, Juristi ( H. F.) 50 litra barazi 8450 lekë, Kryetari F. B 390 litra x 169 lekë /litri me 65,910 lekë , Zyra e Shërbimeve( Z. M. ) 150 x 169 lekë/litri = 25,350 lekë. Total dëm ekonomik 130,130 lekë. ( zbritur 1, që nuk është).*
*Nga inventari i vitit 2014 të mbartur në Bashkinë Vlorë në inventarin e vitit 2015 e në vazhdim 49 artikuj të ndryshëm që i përkasin llogarisë nr. 218" Inventarë ekonomik" me çmim 1(një) lekë për artikull, ku veçojmë 12 ( trembëdhjetë ) kompjuter dhe 4( katër ) printer etj. inventarë që ju përkasin shkollave në administrim të ish- Komunës Qendër, Bestrovë, Panaja, Hoshtime, Babicë e vogël, Nartë Xhuherinë, Babicë e madhe dhe Kërkovë.*
*Amortizim i projekteve të investimeve në vlerë 2,713,950 që duhet të sistemohet , pasi është llogaritur në kundërshtim me UKM nr.2,datë 08.05.2003" Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" pika C " Të ndryshme".*
*Me personat përgjegjës të cituar në këtë akt konstatimi, është kryer ballafaqim dokumentar dhe ligjor në Bashkinë Vlorë.*

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi**:
F. B me detyrë ish- Kryetar i Komunës Qendër Vlorë (Nënpunës autorizues);
(Për mangësitë e mësipërme me personat përgjegjës është mbajtur akt-konstatimi nr. 48, datë 27.02.2018)

➢ **<u>Mbi auditimin e ushtruar në ish- Komuna Shushicë</u>**

Mbi auditimin e aktivitetit që i përket periudhës muaj Qershor 2015 dhe hartimi i bilancit të 6/mujorit parë 2015 me analizat përkatëse në mbështetje të VKM nr. 510 datë 10.06.2015" Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".
Treguesit ekonomiko – financiarë, dokumentimi, administrimi i pasurisë dhe pasqyrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve mbështetur në dokumentacionin e bankës, arkës hyrjeve dhe daljeve të magazinës,

paga pasqyrimi i inventarëve kontabël dhe fizik. Hartimi i bilanceve dhe pasqyrimi i detyrimeve ndaj të tretëve dhe vjelja e debitorëve.
Për periudhën e Audituar është plotësuar dokumentacioni sipas pasqyrës së mëposhtme në lekë:

| Nr. | Dokumente kontabiliteti | Viti 2013 | | Viti 2014 (fakt) | | 6/mujori 2015(fakt) | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr. | Lekë | Nr. | Lekë | nr. | Lekë |
| 1 | Arkëtime | 1-1639 | 6,961,620 | 1-1664 | 8,190,191 | 1-1309 | 3,794,270 |
| 2 | Pagesa | 1-65 | 6,961,620 | 1-74 | 8,190,191 | 1-20 | 3,794,270 |
| 3 | Fletë hyrje | 45 | 1,888,150 | 21 | 874,630 | 9 | 1,072,361 |
| 4 | Fletë dalje | 19 | 1,885,660 | 13 | 874,630 | 8 | 1,072,361 |
| 5 | Urdhër shpenzime | 1-214 | 106,454,873 | 1-241 | 95,665,287 | 1-130 | 29,060,173 |

Në plotësimin dhe përpunimin e dokumentacionit të arkës janë arkëtuar të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore dhe arka është kuadruar me kontabilitetin (ditarin e arkës). Nga arka nuk janë kryer pagesa të natyrë shpenzimi por, janë kryer pagesa për derdhje në bankë. Arka është kuadruar për çdo muaj dhe në mbyllje të periudhave ushtrimore. Sipas periudhave janë arkëtuar dhe derdhur në bankë, për vitin 2013 në 639 raste me vlerë 6,961,620 lekë, në vitin 2014 janë arkëtuar 8,190,191 lekë, ndërsa për vitin 2015 në vlerën 3,794,270 lekë.
Shpenzimet e realizuara në fakt në 000/lekë sipas viteve.

| Nr. | Shpenzimet | Viti 13 | Viti 14 | Viti 15 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 600,paga | 14,958,661 | 17,609,497 | 7,414,974 |
| 2 | 601,sigurime | 3,260,446 | 3,374,864 | 1,974,283 |
| 3 | 602 Operative | 7,324,572 | 6,463,807 | 2,162,043 |
| 4 | 230 shpenzime | - | 2,460,000 | - |
| 5 | 604 Transfertë br. | 386,000 | 86,281 | - |
| 6 | 606 Buxh.famil. | 39,435,725 | 24,221,725 | 15,073,788 |
| 7 | 231, investime | 38,879,125 | 28,771,010 | 537,600 |
| 8 | 466 ,garanci | 2,210,344 | 2,678,103 | 1,897,485 |
| 9 | **Totali shpenzime** | **106,454,873** | **95,665,287** | **29,060,173** |

Në plotësimin dhe përpunimin e dokumentacionit të magazinës u konstatua se dy fletë dalje të Drejtorisë Arsimore Rajonale Vlorë nr. 90, datë 12.04.2013 në vlerë 73,239 lekë , me përshkrim veprimi tërhequr nga Rudina Petanaj për llogari të shkollës 9/vjeçare Risili nuk është bërë hyrje në Komunë , por është përfshirë në inventarë ekstra kontabël. Po ashtu dhe fletë dalja nr. 91, datë 12.04.2013 marrës malli nga Lefter Gega në vlerë 73,239 lekë nuk është bërë hyrje, por është përfshirë në inventarin kontabël në mënyrë ekstra. Është ndjekur e njëjta praktikë edhe për vitet në vazhdim. Ky veprim bie në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011" Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik".

Formulari nr. 1 "Aktive" në lekë sipas viteve.

| Nr. | Emërtim | 2013 | 2014 | 2015 |
|---|---|---|---|---|
| 202 | Projekte dhe studime | 2,755,000 | 3,795,000 | 3,795,000 |
| 209 | Amortizimi | 268,613 | 444,932 | 528,684 |
| 212 | Objekte .ndërtimi | 47,760,552 | 52,712,766 | 52,712,766 |
| 213 | Rrugë rrjetet e vepra ujore | 96,792,120 | 216,643,851 | 217,181,451 |
| 214 | Instalime makineri e pajisje | 11,153,966 | 11,153,966 | 11,153,966 |
| 215 | Mjete .transporti | 601,263 | 601,263 | - |
| 218 | Inventarë ekonomik | 8,598,304 | 8,282,403 | 8,282,403 |

| Nr. | Emërtim | 2013 | 2014 | 2015 |
|---|---|---|---|---|
| 219 | Amortizim aktiveve | 21,411,778 | 26,093,353 | 31,622,502 |
| 231 | Shpenzime në proces | 232,251,270 | 137,419,335 | 137,419,335 |
| 31 | Materiale | 2,490 | - | - |
| 32 | Objekte inventari. | 280,701 | 228,765 | 228,765 |
| 4342 | Të tjera op .shteti " Debitor" | 10,247,282 | 7,898,190 | 6,903,725 |
| 468 | Debitor | 2,283,673 | 1,041,663 | 1,041,663 |
| 520 | Disponibilitete në thesar | 7,382,460 | 4,427,469 | 3,922,292 |
| 486 | Shpenzime të periudhave të ar | 1,933,838 | - | - |
| | **Total** | **400,462,528** | **417,666,386** | **410,490,180** |

Analiza e llogarisë nr. 231 shpenzime në proces është e përbërë nga 3 analiza, nga të cilat Rikonstruksion Rruga Risili Beshishit në vlerë 98,496,832 lekë, Rikonstruksion rruga Grabian 999,822 lekë , Rikonstruksion KUZ Shushicë -Llakatund 37,949,681 lekë.
Analiza e aktiveve megjithëse kuadron sipas llogarive kryesore të aktiveve afat gjata e afat shkurtra nuk kanë vitin e hyrjes dhe për pasojë dhe amortizimi është llogaritur në vlerën totale të objekteve dhe jo për çdo objekt. Llogaria nr.468 " Debitorë të ndryshëm është paraqitur në bilanci e vitit 2014 dhe 2015 me të njëjtën gjendje dhe nuk është arkëtuar asnjë lekë, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimi e MF nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14,datë, 28.12.2006,"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre", i ndryshuar. Nuk janë përfshirë në kontabilitet detyrimet për kontratat e tokave të dhëna qira për 22 raste në vlerë 1,687,890 lekë. Këto detyrime duhej të ishin përfshirë si detyrime në bilancin e 6/mujorit të vitit 2015, për pasojë nuk janë përfshirë dhe në bilancin përmbledhës të Bashkisë Vlorë që i përket vitit 2015.

-Kontrata qiraje te pa kontabilizuar, Komuna Shushic

| Nr. | Emër Mbiemër | Sasi | Çmim | Vlefta |
|---|---|---|---|---|
| 1 | R. H. | 7 | 2.870 | 20.090 |
| 2 | Q. H. | 3 | 2.050 | 6.150 |
| 3 | A. A | 2 | 2.700 | 5.400 |
| 4 | K. A. | 3 | 2.900 | 8.700 |
| 5 | K. P | 8 | 34.420 | 275.360 |
| 6 | P. L | 1 | 8.200 | 8.200 |
| 7 | E. D | 2 | 3.850 | 7.700 |
| 8 | P. N | 3 | 6.560 | 19.680 |
| 9 | Z. F | 3 | 9.500 | 28.500 |
| 10 | Dh. B. | 2 | 1.230 | 2.460 |
| 11 | H. B. | 3 | 2.700 | 8.100 |
| 12 | A. B | 1 | 12.300 | 12.300 |
| 13 | S. T. | 1 | 9.350 | 9.350 |
| 14 | N. B | 2 | 1.000 | 2.000 |
| 15 | A. H | 1 | 15.000 | 15.000 |
| 16 | T. D | Diferenc | | 42.000 |
| 17 | A. H. | 4 | 71.200 | 284.800 |
| 18 | A.Q, K. K | | | 81.450 |
| 19 | Q. P | 3 | 1.920 | 5.760 |
| 20 | D. A | 4 | 4.600 | 18.400 |

| Nr. | Emër Mbiemër | Sasi | Çmim | Vlefta |
|---|---|---|---|---|
| 21 | A. H. | 3 | 259.330 | 777.990 |
| 22 | Z. H. | | | 48.500 |
| **Totali** | | | | **1.687.890** |

Për vitin 2013, janë punësuar 6 punëtorë pastrimi të pa deklaruar në sigurimet shoqërore dhe pagesat janë regjistruar si shpenzime në artikullin 602 me pagë 9 000 lekë/ muaj .Për vitin 2013, janë kryer shpenzime gjithsejtë 648,000 lekë, të pa deklaruar në Degën e Sigurimeve Shoqërore, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në republikan e Shqipërisë" i ndryshuar dhe VKM nr. 445 datë 11.07.2012 "Par përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi .
Me urdhër shpenzimin nr. 99, datë 18.06.2015, është likuiduar në favor të privatit "B.....B" , vlera 1,897,485 lekë vlera e 5% " Garanci" , për objektin e "Ndërtim I Rrjetit të kanalizimeve , fshatrat Llakatund dhe Shushicë" sipas kontratës datë 17.09.2012 dhe përfundim objekti datë 06.01.2014 për vlerën e realizuar të kontratës 38,762,447 lekë ( 38,799,788 lekë vlera e kontratës .
Sipas proces verbalit të kolaudimit datë 06.01.2014 , I nënshkruar nga kolaudatore A. T dhe mbikëqyrësi i punimeve , proces verbalit datë 23.02.2015 "Mbi marrjen në dorëzim të përfundimtar të objektit "Ndërtim I Rrjetit të kanalizimeve, fshatrat Llakatund dhe Shushicë" I nënshkruar nga Investitori L. P ( Kryetar Komune ) dhe supervizorit "E.....M" , nënshkruar G. G dhe Sipër marrësi " B.....B" .
Sa sipër u konstatua se : Vlera e plotë e objektit Ndërtim i Rrjetit të kanalizimeve fshatrat Llakatund dhe Shushicë" 38,799,788 lekë, është pasqyruar në shpenzime në proces dhe nuk është rritur vlera e objektit në kontabilitet. Nuk janë mbyllur shpenzimet në proces, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 26, datë, 27.12.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14,datë, 28.12.2006,"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre", i ndryshuar.

Formulari nr. 2 Pasivet në lekë

| Nr. | Emërtim | Viti 2013 | Viti 2014 | Viti 2015 |
|---|---|---|---|---|
| 101 | Fonde Bazë | 146,264,005 | 266,879729 | 261,203,165 |
| 105 | Fonde veta | 232,251,270 | 137,419,335 | 137,419,335 |
| 42 | Paga | 5,040,000 | 1,315,422 | |
| 401 | Furnitor | - | - | |
| 431 | Tatim | 2,468,221 | 2,499,974 | 2,499,974 |
| 4341 | Operac. Shteti, " kreditor " | 2,383,673 | 1,041,663 | 1,041,663 |
| 435 | Sigurime Shoqërore | 2,461,061 | 1,709,504 | 645,313 |
| 436 | Sigurime Shëndetësore | 278,000 | 211,290 | |
| 466 | Garanci | 6,598,242 | 3,655,982 | 1,750,497 |
| 467 | Kreditor të tjerë | 1,933,838 | 2,162,000 | 3,758,438 |
| 487 | Të ardhura para nxjerr. Titull | - | 771,487 | - |
| 85 | Rezultati | 784,218 | | 2,163,795 |
| | **Totali** | **400,462,528** | **417,666,386** | **410,490,180** |

Në auditimin e ushtruar, për zbatimin e procedurave par bashkimin e aktivitetit të ish- Komunës Shushicë me Bashkinë e Vlorës u konstatua se:
Sipas bilancit të 6/mujorit të vitit 2015, i kanë kaluar Bashkisë Vlorë aktive 410,490,180 lekë nga të cilat: Aktive afat gjata të pa trupëzuara 3,795,000 lekë me vlerë të mbetur 3,266,316 lekë ose amortizuar 528,684 lekë. Amortizimi është llogaritur në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. nr. 2,

datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" pika C "Të ndryshme".
Aktive afat gjata të trupëzuara me vlerë 426,749,921 lekë me vlerë të amortizuar 31,622,502 lekë dhe është llogaritur amortizim në masën 7.4%. Amortizimi është llogaritur me grupe aktivesh dhe nuk është llogaritur par çdo element në veçanti, mungon viti i hyrjes për çdo aktiv.
Aktive afat shkurtra të trupëzuar kanë kaluar Bashkisë Vlorë me vlerë 228,765 lekë, debitorë në vlerë 1,041,663 lekë të pa analizuar.
Kreditorët.
Në bilancin e vitit 2015, janë mbartur detyrim ndaj Sigurimeve shoqërore që nga viti 2012 dhe nuk janë likuiduar gjatë viteve të mëparshme .
Konkluzion përfundimtarë.
Sipas bilancit të 6/mujorit të vitit 2015, i kanë kaluar Bashkisë Vlorë aktive në vlerën 410,490,180 lekë, nga të cilat: Aktive afat gjata të pa trupëzuara në vlerën 3,795,000 lekë me vlerë të mbetur 3,266,316 lekë ose amortizuar 528,684 lekë. Amortizimi është llogaritur në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" pika C- "Të ndryshme".
Amortizimi i aktiveve të trupëzuar është llogaritur me grupe aktivesh dhe nuk është llogaritur për çdo element në veçanti, mungon viti i hyrjes për çdo aktiv. Nuk janë mbyllur shpenzimet në proces, edhe pse objektet e ndërtimit janë marrë në dorëzim si "Ndërtim i Rrjetit të kanalizimeve fshatrat Llakatund dhe Shushicë" 38,799,788 lekë, është pasqyruar në shpenzime në proces dhe nuk është rritur vlera e objekteve në kontabilitet. Nuk janë pasqyruar në kontabilitet trojet pasuritë e transferuar nga Pushteti Qendror ne pronësi të ish- Komunës Shushicë dhe nuk janë vlerësuar.
**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi**:
L. P me detyrë ish- Kryetar i Komunës Shushicë (Nënpunës autorizues).
V. P. me detyrë ish- Përgjegjës i Zyrës së Financës deri me 30.09.2014 (Nënpunës zbatues);
A. P. me detyrë ish- P/Financës deri 31.07.2015 (Nënpunës zbatues).

- **Mbi auditimin e ushtruar në ish- Komuna Novosel.**

Mbi auditimin e aktivitetit që i përket periudhës muaj Qershor 2015 dhe hartimi i bilancit të 6/mujorit parë 2015me analizat përkatëse në mbështetje të VKM nr.510 datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".
Pasqyra Buxhetit Faktik në lekë

| NR | Dokumente kontabiliteti | Realizimi buxhetit | |
|---|---|---|---|
| | | 2014 | 2015 |
| 600 | paga | 22,463,426 | 9,724,147 |
| 601 | sigurime | 3,094,322 | 1,620,989 |
| 602 | Operative | 15,847,688 | 9,182,129 |
| 604 | Transferime brendshme | 600,000 | - |
| 230 | Rritja e aktiveve | 1,400,000 | 932,560 |
| 231 | Investime | 26,065,750 | 6,846,890 |
| B | **Totali shpenzime** | **69,471,186** | **28,936,715** |

Shpenzimet sipas rakordimeve me thesarin.
Hartimi i bilancit të 6/mujorit parë 2015 me analizat përkatëse në mbështetje të VKM nr.510 datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".
Treguesit kryesorë të bilancit:
Formulari nr. 1, në lekë Aktivet .

| Nr. | Emërtim | Viti 2014 | 6/ mujori 2015 | Diferenca + |
|---|---|---|---|---|
| 202 | Projekte dhe studime | 11,280,200 | 12,212,760 | 932,560 |
| 209 | Amortizimi AK të pa trupëzuara | 1,482,030 | 2,223,045 | 1,258,985 |
| 12 | Objekte ndërtimi | 33,517,734 | 69,370,000 | 35,852,266 |
| 213 | Rrugë rrjete e vepra ujore | 366,682,333 | 403,288,130 | 36,605,797 |
| 214 | Instalime makineri e pajisje | 19,961,358 | 23,459,662 | 3,498,304 |
| 215 | Mjete transporti . | 5,798,000 | 5,798,000 | 0 |
| 218 | Inventar ekonomik | 3,975,419 | 3,975,419 | 0 |
| 219 | Amortizimi | 63,229,153 | 66,058,474 | 2,829,321 |
| 31 | Shpenzime në proces | 62,910,860 | 51,497,121 | 11,413,739 |
| 31 | Materiale | 280,194 | 270,382 | -9812 |
| 32 | Objekte .inventari | 3,053,007 | 3,053,007 | 0 |
| 4342 | Të tjera op. Shtetin debitor | 6,798,250 | 4,334,449 | -2,463,801 |
| 468 | Debitor | 7,238,201 | 7,238,201 | 0 |
| 520 | Disponibilitete. Në thesar | 13,087,577 | 12,202,092 | -885,485 |
| 511 | Letra me vlerë | 432,300 | 333,000 | 700 |
| | **Total.....** | **470,304,040** | **528,750,804** | **58,446,764** |

Bilanci i 6/mujorit të parë të vitit 2015, është plotësuar mbështetur në të dhënat e ditarëve të kontabilitetit, por nuk është bërë përmbledhja e llogarive në centralizator apo në libër të madh, veprim i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin zbatues D. A. Për projektet të përfshira në llogarinë nr. 202 "Projekte e studime", në vlerën 12,212,760 lekë, është akumuluar amortizim në vlerën 2,223,045 lekë, nuk duhej të llogaritej amortizim është llogaritur amortizim, por nuk duhej të llogaritej amortizimi në vlerën progresive 1,482,030 lekë , por duhej të kalonte në vlerën e objekteve të investimeve.
Amortizimi i aktiveve afat gjata të trupëzuara është llogaritur në gupe aktivesh dhe nuk është llogaritur në mënyrë individuale për çdo aktiv. Nuk është mbajtur regjistër për aktivet, par vitin e hyrjes amortizimin e llogaritur dhe vlerën e mbetur par çdo aktiv , veprime që janë mbartur në bashki
Janë mbartur në inventarin e bashkisë artikuj pa çmim në 35 raste sipas pasqyrës :

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| Zyra e financës | | | |
| 1 | Karrige | Cope | 2 |
| Zyra e Policisë | | | |
| 1 | Dollap | Cope | 1 |
| Zyra e Bujqësisë | | | |
| 1 | Dollap | Cope | 1 |
| Zyra e Ndihmës Ekonomike | | | |
| 1 | Dollap pune | Cope | 1 |
| 2 | Karrige rrotulluese | Cope | 1 |

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| SHKOLLA Cerkovine | | | |
| 1 | Dollap | Cope | 2 |
| 2 | Banka | Cope | 25 |
| 3 | Karrige | Cope | 85 |
| 4 | Tavoline Kompjuteri | Cope | 2 |
| 5 | Kolltukë tek | Cope | 2 |
| 6 | Kolltukë | Cope | 1 |
| 7 | Tavoline vezake | Cope | 1 |
| SHKOLLA Delisuf | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 3 | Tavoline kompjuteri | Cope | 1 |
| 4 | Kompjuter dell | Cope | 1 |
| | Zyra e Pergj.sherbimeve | | |
| 1 | Kasaforte | Cope | 1 |
| 2 | Karrige rrotulluese | Cope | 2 |
| 3 | Tastiere kompjuteri | Cope | 1 |
| SHKOLLA BISHAN | | | |
| 1 | Kompjuter a xea | Cope | 1 |
| 2 | Kompjuter nxënësish | Cope | 10 |
| 3 | CPU | Cope | 9 |
| 4 | Skaner | Cope | 1 |
| 5 | Printer | Cope | 1 |
| SHKOLLA AKERNI | | | |
| 1 | Dollap | Cope | 4 |
| 2 | Tavoline Kopshti | Cope | 8 |
| 3 | Karrige | Cope | 16 |
| 1 | Printer | Cope | 1 |
| 2 | Kontejner | Cope | 1 |
| SHKOLLA e Mesme | | | |
| 1 | Kompjuter | Cope | 7 |
| 2 | Kompjuter | Cope | 2 |
| 3 | skaner | Cope | 1 |
| 4 | modem interneti | Cope | 1 |
| 5 | bateri për kompjuter | Cope | 3 |
| 6 | radiator | Cope | 1 |
| Shkolla Fitore | | | |
| 1 | Karrike poltron | Cope | 11 |
| 2 | Tavoline kompjuteri | Cope | 6 |

Për këto artikuj nuk ka të dhëna për vitin e hyrjes në magazinë, por janë përfshirë në inventarë ekstra kontabël pa kaluar nëpërmes magazinës dhe pa dokumentacion shoqërues të furnizuesit (fletë dalje) dhe nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues nuk janë marrë masa për vlerësimin e këtyre artikujve me specialistë të fushës. Është vepruar në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Për inventarët duhej të ishin vlerësuar dhe bërë hyrje në magazinë.

**Pasivet ne lekë**

| Nr. | Emërtimi i llogarive | Viti 2014 | 6/m2015 |
|---|---|---|---|
| 101 | Fonde Bazë4 | 379,836,852 | 453,145,941 |
| 105 | Fonde veta | 62,910,860 | 51,497,121 |
| 42 | Paga | 1,244,733 | - |
| 401 | Furnitor | 5,113,424 | - |
| 431 | Tatim | 42,600 | - |
| 44 | Transferta | 432,300 | 333,000 |
| 435 | Sig Shoq | 349,053 | - |
| 436 | Sig Shënd | 48,440 | - |
| 466 | Ngurtësime | 4,259,294 | 5,409,237 |
| 467 | Kreditor | - | 4,334,449 |
| 475 | Për tu arkëtuar | 7,238,201 | 7,238,201 |
| 85 | Rezultati | 8,828,283 | 6,792,855 |
| | **Totali** | **470,304,040** | **528,750,804** |

Detyrimet ndaj të tretëve janë paraqitur në llogarinë nr. 466 "Garanci dhe në llogarinë nr. 467 " Kreditor të tjerë" që ju përkasin faturave të pa likuiduara dhe garancisë punimeve për investime të shoqëruar me analiza dhe furnizimeve të pa likuiduara në llogarinë 401" Furnitorë".

Të ardhurat për t'u arkëtuar që lidhen me tarifat dhe taksat nuk janë regjistruar në pasqyrat financiare për 2015.

-Auditim mbi ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit kontabël në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe zbatimi i rregullores "Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore".

Dokumentacioni kontabël administrohet në Njësinë Administrative Novoselë, pasi nuk janë tërhequr në arkivin e Bashkisë Vlorë për mungesë ambientesh, që nga viti 2011.

***Konkluzion përfundimtarë*** .
*Nuk janë përfshirë në llogarinë e debitorëve detyrimet e prapambetura nga vitet e mëparshme, nga taksat dhe tarifat vendore. Nuk është mbajtur regjistër për aktivet, para vitin e hyrjes amortizimin e llogaritur dhe vlerën e mbetur par çdo aktiv. Bilanci i 6/mujorit të parë të vitit 2015, është plotësuar mbështetur në të dhënat e ditarëve të kontabilitetit, por nuk është bërë përmbledhja e llogarive në centralizator apo në libër të madh, veprim i cili bie në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin zbatues D. A. Janë mbartur në inventarin e bashkisë artikuj pa çmim në 35 raste , nga të cilët 21 kompjuter. Amortizimi është llogaritur në nivel grupi dhe jo me artikuj.*

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**
K. SH me detyrë Administrator NJA Novosel, në pozicionin e ish- Kryetarit të Komunës.
D. A. me detyrë ish-Përgjegjëse e Zyrës së Financës (nënpunësi zbatues), në ish-Komunën Novosel.

- **Mbi auditimin e ushtruar në ish- Bashkia Orikum**

Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. Hartimi i Pasqyrave financiare (bilanci kontabël) dhe inventarizimi i llogarive të pasurisë publike. Administrimi, ruajtja, dokumentimi dhe qarkullimi i vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë, për periudhën 01.01.2015 deri datë 07.07.2015.
U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë.

| Nr | Dokumente kontabiliteti | 6/mujori 2015 (fakt) | |
|---|---|---|---|
| | | nr. | Lekë |
| 1 | Arkëtime | 263 | 3.164.871 |
| 2 | Pagesa | 32 | 3.164.871 |
| 3 | F. Hyrje | 8 | 1.283.120 |
| 4 | F dalje | 153 | 3,013,852 |
| 5 | Urdhër shpenzime | 155 | 85.841.089 |
| | **Total Kontab** | | **85.841.089** |

U verifikua dokumentacioni që i përket periudhës 6/mujorit dhe nga arka janë plotësuar dhe përpunuar 263 mandat arkëtime par derdhje taksa dhe tarifa vendore në vlerën 3,164,871 lekë dhe janë derdhur në bakë me 32 raste . Në magazinë janë bërë hyrje në 32 raste në vlerë 1,283,120 lekë. Janë likuiduar nëpërmes bankës 85,841,089 lekë me 153 urdhër shpenzime.
Pasqyra Buxhetit Faktik në lekë

| Nr. | Realizimi buxhetit | 6m/2015 |
|---|---|---|
| 600 | paga | 15.273.643 |
| 601 | sigurime | 2.550.696 |
| 602 | Operative | 22.975.740 |
| 603 | Subvencione | 5.778.022 |
| 604 | Transferime brendshme | 178.505 |
| 606 | Buxhete familjare | 12.752.995 |
| 231 | Investime | 26.111.029 |
| 466 | Garanci | 220.459 |

| Nr. | Realizimi buxhetit | 6m/2015 |
|---|---|---|
| | **Totali shpenzime** | **85.841.089** |

Shpenzimet janë rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë dhe nga krahasimi me kontabilizimin në ditarin e shpenzimeve u gjetën të njëjta.
Janë paguar nëpërmes shpenzime ve operative shpenzime për paga bruto për 5 punonjës 2, kujdestar muzeu.
Vlerësim mbi mënyrën e bashkimit të aktivitetit të ish-komunave dhe zbatimi i procedurave të caktuara në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ”Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.
Treguesit e bilancit.

Formulari nr.1 e 2, për aktivet dhe pasivet 6/mujori i vitit 2015

| Nr. | Emërtim | Aktive në lekë | | Llog | Emërtim | Pasive në lekë | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2015 | 2014 | | | 2015 | 2014 |
| 202 | Projekte e stud. | 25,651500 | | | | | |
| 209 | Amortizim | -6,387,925 | 4,258,617 | | Fonde bazë | 596,683,244 | 590,667,949 |
| 212 | Ob .ndërtimi | 105,631,349 | 95,267,910 | 42 | Paga | - | 1,848,575 |
| 211 | Tokë troje | 1339 | 1339 | - | - | - | - |
| 213 | Rrugë,rrj ev.uj. | 580,472,661 | 565,525,062 | 401 | Furnitor | 85,400 | 85,400 |
| 214 | Ins.M.Pajisje | 1,414,888 | 1,414,888 | 431 | Tatim | 129,500 | 210,466 |
| 215 | Mjete trans | 14,487,824 | 14,487,824 | 435 | Sigurime | 46,369 | 581,761 |
| 219 | Amortizim | 145,619,078 | 130,305,140 | 436 | Sigu. Shend | 4998 | 78,966 |
| 31 | Materiale | 876,387 | 2,594,833 | 466 | Ngurtësime | 4,366,127 | 3,423,977 |
| 32 | Ob.inv | 2,846,783 | 2,866,783 | 467 | Kreditor | 5,129,793 | 7,814,348 |
| 4342 | Të tjera op. | 5,396,130 | 10,619,516 | 480 | Për rreg. | 15,922,745 | 17,318,935 |
| 468 | Debitor | 15,922,745 | 17,318,935 | 85 | Rezultati | 10,942,847 | 60,517,515 |
| 520 | | 15,308,974 | 63,941,492 | | - | - | - |
| | | 633,311,093 | 682,547,892 | | Totali | 633,311,093 | 682,547,892 |

Nuk janë pasqyruar shpenzime në proces, edhe pse nuk janë shlyer garancitë e punimeve dhe situacionet e investimeve. Janë mbyllur shpenzimet për investime pjesërisht dhe jo me përfundimin e objekteve . Është llogaritur amortizimi për projekte investimesh, por pa datë hyrje të projekteve.
Amortizimi i llogaritur në vlerën 6,387,925 lekë është në kundërshtim me udhëzimin e KM nr. 2, datë 08.05.2003 ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” pika C “Të ndryshme”, pasi vlera e projekteve i kalon objektit të përfunduar.
Në analizën e projekteve në vlerë 25,651500 që përbëhet nga 29 projekte mbartur në kontabilitet prej vitesh dhe nuk kanë emërtesa si projekt pa emër në vlerë 200,000 lekë projekt Radhim në vlerë 300,000 lekë pa emërtesë.
Për 6 /mujorin e parë të vitit 2015 ne ish -Bashkinë Orikum ne bazë te urdhrit të Kryetarit te Bashkisë nr. 92 datë 29/12/2014 u ngrit komisioni për vlerësimin për jashtë përdorimit te inventarëve ne ish-Bashkinë Orikum i përberë nga Z. Q., H Ç, B. H, E. M dhe D. D.

Me pas është marre vendim i Këshillit te Bashkisë Orikum nr. 3 datë 28.01.2015 për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale shprehur me ligjshmëri nga Prefektura me Nr. 364/1 Prot datë 05/02/2015 sipas përmbledhëses së inventarit të hartuar sipas llogarive :
Llogaria nr. 213" rrugë rrjete e vepra ujore në vlerën 799,991 lekë, llogaria nr. 218 "Inventarë ekonomik" në vlerën 114,051 lekë ,llogaria nr. 31 "Mallra e materiale" në vlerën
25.040 lekë, llogaria nr. 32 "Objekte inventari" në vlerën 20.000 lekë.
Në ish Bashkinë Orikum nuk janë përfshirë në inventarë F.....At e sportit në shkollat D.....A, Shkolla e Mesme Orikum dhe F.....A e Klubit të Futbollit Orikum.
Në datë 16/02/2015 me Urdhër nr. 10 te Kryetarit te Bashkisë u ngrit komisioni i asgjësimit përbërë nga N. H , H. C, A. Xh, R. M dhe A. N.

***Konkluzion përfundimtar**:*
*Nuk janë pasqyruar shpenzime në proces, edhe pse nuk janë shlyer garancitë e punimeve dhe situacionet e investimeve. Janë mbyllur shpenzimet për investime pjesërisht dhe jo me përfundimin e objekteve. Është llogaritur amortizimi për projekte investimesh, por pa datë hyrje të projekteve.*
*Amortizimi i llogaritur në vlerën 6,387,925 lekë është në kundërshtim me udhëzimin e KM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" pika C "Të ndryshme", pasi vlera e projekteve i kalon objektit të përfunduar. Në analizën e projekteve në vlerë 25,651500 që përbëhet nga 29 projekte mbartur në kontabilitet prej vitesh dhe nuk kanë emërtesa si projekt pa emër në vlerë 200,000 lekë projekt Radhim në vlerë 300,000 lekë pa emërtesë.*
*U konstatua një rast pa u përfshirë në inventarë 1(një) projektor në vlerë 40,580 lekë, në shkollën 9/ vjeçare Orikum tërhequr nga DAR Vlorë nga E. I që përbën mungesë inventari në Shkollën /vjeçare Orikum dhe është dëm ekonomik.*
*Në ish Bashkinë Orikum nuk janë përfshirë në inventarë F.....A e sportit në shkollat D.....A, Shkolla e Mesme Orikum dhe F.....A e Klubit të Futbollit Orikum.*
*Janë paguar 5 (pesë) punëtorë me pagë më të vogël se paga minimale gjatë vitit 2015, në vlerë 234,000 lekë të pa deklaruar në Degën e Sigurimeve Shoqërore ,veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, " Për sigurimet shoqërore në republikan e Shqipërisë" i ndryshuar dhe VKM nr. 445 datë 11.07.2012 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi.*

*(Gjerësisht trajtuar faqen 49-96, të Prorojektraport Auditimit)*

## III/4. Auditim mbi prokurimin e fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime dhe ankandeve publike.

Referuar të dhënave të regjistrimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2017, konstatohet se në Bashkinë Vlorë të dhënat mbi prokurimet e realizuara paraqitet sipas pasqyrës si vijon:

*Në lekë*

| Të dhëna mbi procedurat e prokurimit | Vitet: | | | Total 3 vite |
|---|---|---|---|---|
| | 2015 | 2016 | 2,017 | |
| Prokurime gjithsej: | 12 | 31 | 30 | **73** |
| Vlera totale : | 99,009,317 | 752,677,216 | 861,701,561 | **1,713,388,094** |
| Procedura të hapura: | 3 | 14 | 16 | **33** |
| Procedura kërkesë për propozim: | 9 | 16 | 12 | **37** |
| Procedura me NGP | 0 | 1 | 2 | **3** |

| Të dhëna mbi procedurat e prokurimit | Vitet: | | | Total 3 vite |
|---|---|---|---|---|
| | 2015 | 2016 | 2,017 | |
| Marrin pjesë Operatorë ekonomikë: | 33 | 134 | 186 | **353** |
| S`kualifikuar Operatorë ekonomikë: | 19 | 69 | 107 | **195** |
| Vlera e ofertave të fituara: | 97,558,713 | 633,107,984 | 648,970,203 | **1,379,636,900** |
| Diferenca nga fondi limit: | 1,450,604 | 119,569,232 | 212,731,358 | **333,751,194** |
| % e diferencës nga fondi limit: | 1.46% | 1.46% | 1.46% | **1.46%** |
| Procedura 1-2 pjesëmarrës | 8 | 10 | 6 | **24** |
| **Procedura të audituara shprehur në vlerë** | 95,554,312 | 731,743,884 | 813,054,215 | **1,640,352,411** |
| % ne raport me fondin limit: | 96.51% | 97.22% | 94.35% | **95.74%** |
| Nr. Procedura me shkelje pas vërejtjeve nga subjekti | 2 | 7 | 3 | **12** |
| **Shkeljet sipas natyrës janë:** | **10,955,958** | **31,916,549** | **18,346,635** | **61,219,142** |
| *-Përdorim me efekt negativ të fondeve publike* | *10,955,958* | *22,854,627* | *10,981,635* | ***44,792,220*** |
| *-Përdorimi pa efektivitet, eficencë të fondeve publike (3E)* | | *7,653,705* | *7,365,000* | ***15,018,705*** |
| *-Kamat vonesa nga mos zbatimi I kontratës* | | *1,408,217* | | ***1,408,217*** |

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (këtu e në vijim AK) Bashkia Vlorë, për periudhën nga 01.01.2015 deri më 31.12.2017 janë kryer gjithsej **73** procedura prokurimi me fond limit 1,713,388 mijë lekë, për të cilën është lidhur kontratë me vlerë 1,379,636 mijë lekë me një diferencë prej 333,751 mijë lekë ose 19.4 % e fondit limit, nga e cila: -*Në vitin 2015* janë kryer 12 procedura me fond limit 99,099 mijë lekë, kontrata të lidhura për vlerën 97,558 mijë lekë me një diferencë prej 1,450 mijë lekë ose 1.4 % e fondit limit; -*Në vitin 2016* janë kryer 31 procedura me fond limit 752,677 mijë lekë, kontrata të lidhura për vlerën 633,107 mijë lekë me një diferencë prej 119,569 mijë lekë ose 15.8 % e fondit limit; -*Në vitin 2017* janë kryer 30 procedura me fond limit 861,701 mijë lekë, kontrata të lidhura për vlerën 648,970 mijë lekë me një diferencë prej 212,731 mijë lekë ose 24.6 % e fondit limit.

Grupi i auditimit të KLSH, duke vlerësuar materialitetit dhe riskun *(vlerën më të lartë dhe numrin e ulët të pjesëmarrësve)*, nga 73 procedura prokurimi janë audituar **65** procedura me vlerë 1,613,358 mijë lekë ose 95.7 % e fondit limit të prokuruar, respektivisht: ***-Për vitin 2015*** janë audituar **10** procedura me vlerë të fondit limit 95,554 mijë lekë ose 96.5 % e fondit limit të prokuruar*;* ***-Për vitin 2016*** janë audituar **21** procedura me vlerë të fondit limit 731,743 mijë lekë ose 97.22 % e fondit limit të prokuruar; ***-Për vitin 2017*** janë audituar **21** procedura me vlerë të fondit limit 813,054 mijë lekë ose 94.35 % e fondit limit të prokuruar.

Në 61 procedurat e audituara, pas shqyrtimit nga grupi i auditimit të KLSH të vërejtjeve të paraqitura nga subjekti i audituar Bashkia Vlorë, konstatohet se **20 raste** ose 33.3 % e rasteve të audituara janë në shkelje të dispozitave e akteve ligjore e nënligjore të LPP dhe rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, si: në vendosjen e kritereve kualifikuese dhe shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kritereve të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa (a, b, c), nenin 46 pika 1, nenin 53 pika 1 dhe 4, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 66, *si më poshtë vijon:*

-**Në 6 procedura**, në hartimin e kritereve të DST janë vendosur kërkesa të paargumentuara me procedurën e zhvilluar dhe dispozitat ligjore.

-**Në 5 procedura** prokurimi, ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, duke kualifikuar si të rregullt OE me mangësi në plotësimin e kërkesave të DST, duke mos anuluar procedurat dhe shmangur përdorimin pa efektivitet, ekonomicitet dhe eficencë të fondeve të prokuruar me vlerë **15,018,705 lekë**.

-**Në 11 procedura** janë konstatuar shkelje në shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kërkesave të DST, duke skualifikuar OE me mangësi por *me çmim ofertë më të leverdishëm* se OE fitues i cili dhe ky nga ana e tij, sipas grupit të auditimit të KLSH ka mangësi në plotësimin e kritereve të DST, veprim me efekt negativ në përdorimin e fondeve publike nga mos menaxhimi i mirë i procedurës për shmangien e **vlerës 44,792,220 lekë**.
-**Në 2 procedura** është konstatuar se kontratat e zbatimit të projekteve nuk është sipas afateve të përcaktuar, duke krijuar **dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Vlorë për **vlerën 1,408,217 lekë**, në kundërshtim me kushtet e kontratës së zbatimit të punimeve.

- **Konstatime të përgjithshme**.

**a-**Vihet re se në të gjitha mungon edhe procesverbali/procesverbalet e KVO (siç kërkohet shprehimisht në pikën 5, të nenit 64, të VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e Njësisë së Prokurimit (këtu e vijim NJO) dhe të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (këtu e vijim KVO).

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me shpjegimet që paraqet subjekti Bashkia Vlorë me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me mos dokumentimin e veprimeve për hapjen e ofertave me procesverbal, nuk është bindës, kjo për faktin se në zbatim të nenit 75,-"Rregullat e prokurimit", të LPP, thuhet se: "KM brenda një muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë rregullat e prokurimit", ku në zbatim të këtij neni KM ka nxjerrë VKM përkatëse, si VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, së cilës i është referuar dhe grupi i aludimit mbi shkeljen e konstatuar.* ***Pretendimi juaj nuk qëndron.***

**b-** Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimit për periudhën 2015 – 2017, si dhe informacioni i marrë nga sektori i Njësisë së Prokurimeve Bashkia Vlorë, konstatohet se disa investime janë prokuruar pa marrë më parë miratimin për leje zhvillimi (ndërtimi) të miratuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Kryetari i Bashkisë, veprime në kundërshtim me:
ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e Territorit" i ndryshuar dhe ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni *13, 22, 29, 38, 39 pika 1, 41 pika 1,2,3, neni 43, 51 dhe neni 52*, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit.
Mos referimi në dispozitat ligjore të sipërcituara ka bërë që të mos gjej zbatim duke mos u aplikuar neni 52 "*Kundërvajtjet administrative*", pika "e", konkretisht pasqyra e investimeve pa leje zhvillimi:

| Nr. | Objekti prokuruar | Dt. Zhvillim tenderi | Fondi limit pa TVSH në 000/lek |
|---|---|---|---|
| **PROCEDURAT E VITIT 2015** | | | |
| 1 | Rikonstruksion i shkollave të qytetit të Vlorës | 18.09.2015 | 2,505,726 |
| **PROCEDURAT E VITIT 2016** | | | |
| 2 | Rikonstruksioni i rrugës Llakatund | 19.10.2016 | 12,453,218 |
| 3 | Rikonstruksion i rrugëve "Zigur Lelo" dhe "Shefit Zenaj" | 17.11.2016 | 83,283,093 |
| 4 | Rikonstruksion i godinës se Njësisë Administrative Shushice | 19.10.2016 | 8,282,579 |
| 5 | Gjelbërim ne qytet (bime dekorative) | 29.03.2016 | 4,163,610 |
| 6 | Ndërhyrje riparimi ne shkollat e Bashkisë Vlorë 2016 | 16.08.2016 | 10,001,383 |

| Nr. | Objekti prokuruar | Dt. Zhvillim tenderi | Fondi limit pa TVSH në |
|---|---|---|---|
| | **PROCEDURAT VITI 2017** | | |
| 7 | Sistemi Multifunksional "Smart City" LUNGOMARE | 13.06.2017 | 53,539,200 |
| 8 | Rikonstruksioni i kopshtit nr.7 | 01.06.2017 | 9,575,334 |
| 9 | Ndriçimi i rrugëve ne qytetin Vlorë | 12.05.2017 | 25,000,923 |
| 10 | Mbjellje bime dekorative ne Bashkinë Vlorë | 31.03.2017 | 21,101,156 |
| 11 | Rikonstruksion i rrugës "Ura tek varrezat - Risili | 15.02.2017 | 95,889,850 |
| 12 | Rikonstruksion i shkollës së mesme "Halim Xhelo", Vlorë | 30.08.2017 | 60,644,928 |

Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Drejtori i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Investimeve E. M.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me shpjegimet që paraqet subjekti Bashkia Vlorë me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me mos pajisjen me leje zhvillimi të investimeve të Bashkisë Vlorë, nuk është bindës, pasi neni 6 i VKM nr. 408, datë 13.05.2015, së cilës i jeni referuar nuk përkon me objektet që ka trajtuar grupi i auditimit, kjo për faktin se punimet që janë kryer në këto investime kanë zëra punimesh të ndryshme nga ato që trajton neni 6.* ***Pretendimi juaj nuk qëndron.***

- **Procedurat e audituara me objekt "*Blerje ushqimesh*" të vitit 2015 - 2017.**

***Nga auditimi rezultojë se:***

Në auditimin e procedurave të prokurimit për blerje ushqimesh, buke, mish dhe ushqime koloniale për kopshte, çerdhe e shkolla **për vitin 2015**, konstatohet këto fenomene në kundërshtim me LPP, *konkretisht*:

**a**-Copëzim të fondeve publike në prokurimet me objekt "*Blerje ushqimesh viti 2015 -2017"*, duke mos i grupuar në një procedura të ndarë në lote për çdo blerje, e cila do të çonte ndryshimin e llojet të procedurës (*në procedurë të hapur*) dhe rritjen e numrit të pjesëmarrësve në procedurë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 28, "*Metodat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike*", pika 2, në të cilën është përcaktuar se: "*Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara nga ky ligj*.", neni 29 "*Procedurat standartet të prokurimit*" dhe neni 29 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor Sh. Gj. dhe anëtarët e Njësisë së Prokurimit (këtu e vijim NJP): P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar, A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist); M. Z. me detyrë Specialist në Qendrën Ekonomike**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Për sa kundërshtoni në lidhje me copëzimin e fondeve për blerje ushqime, paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga NJP, Pretendimi juaj nuk shpjegon problematiken e trajtuar nga grupi i auditimit, kjo për faktin se në referencë të dispozitave të mësipërme zhvillimi me lote do të rriste përgjegjësinë e subjekteve pjesëmarrës, ku do mund të merrnin pjesë subjekte me serioze dhe jo subjekte të cilat nga verifikimi i pamjeve të dyqanit vlen për të dëshiruar në cilësinë e mallrave të ofruar. Gjithashtu sqarojmë se nga grupi i auditimit të KLSH nuk është thënë se në gjithë procedurat ka copëzim të fondeve, por ky fenomen është vetëm në procedurat e blerjes së ushqimeve, gjë për të cilën ju nuk duhet ta përgjithësoni vetë.*

*Fakti se nga grupet e tjera nuk është kapur si problem nuk do të thotë se procedurat e zhvilluara duhet të vijojnë me problematika, por në momentin që konstatohet shkelje duhet vepruar për riparimin e këtyre shkeljeve në mënyrë që procedurat të zhvillohen në përputhje me dispozitat e LPP.* ***Pretendimi për këtë pikë nuk qëndron.***

**b-** Në të gjitha procedurat me objekt prokurimi "*blerje ushqimesh"* në lidhje me vendosjen e kritereve, konstatohet se: në DT është kërkuar që të paraqitet: *Dëshmi për mjetet e transportit, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës se furnizimit , një mjet transporti". Nuk është përcaktuar asnjë kërkesë specifike për mjetin,* nuk është kërkuar mjet frigoriferik i domosdoshëm për transportin e mishit dhe nënartikujve të tij, bulmetit e vezëve si dhe për transportin e mallrave të tjerë objekt i kontratës (kjo për vitin 2016), në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 27, "*Kontratat e mallrave*", veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi NJP: P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar, A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist); M. Z. me detyrë Specialist në Qendrën Ekonomike.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Për sa kundërshtoni në lidhje me mos vendosjen si kriter "Mjet frigoriferik", paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga NJP, nuk argumenton problemin e trajtuar nga grupi i auditimit të KLSH, kjo pasi nisur nga llojit e mallrave që do tregtohen ku mund të përmendim: mish, bylmet e tjera, detyrimisht duhej specifikuar që mjeti të jetë frigoriferik.*
*Ndërsa në lidhje me pikën "c", merret në konsideratë shpjegimet e subjektit, të cilat jenë argumentuar me dokumentacion dhe bën fjalë se nuk janë përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit dhe cilësia e artikujve të kërkuar* ***Pretendimi për këtë pikë nuk qëndron.***

**c- Përllogaritja e vlerës limit të kontratës:** Preventivat janë hartuar nga Përgj/ Qendrës Ekonomike H. H për vlerën 18,407,790 lekë, në prokurime të veçanta, si: blerje mishi, sallat në vlerën 6,389,000 lekë, blerje vezë e nënprodukte në vlerën 3,938,400 lekë, blerje fruta në vlerën 3,154,700 lekë, blerje bukë në vlerën 11,254,600 lekë dhe blerje ushqime koloniale në vlerën 3,671,090 lekë.

Në përcaktimin e fondit limit është bazuar në të dhënat marrë nga kopshtet, çerdhet dhe konviktet mbi numrin e frekuentuesve dhe për kuotën është bazuar në urdhrin nr. 39, datë 01.02.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë. Ndërsa në lidhje me çmimet e aplikuara është bazuar në kontratat e mëparshme, pasi është një aktivitet në vijimësi dhe çmimet e statistikës.

**Rastet e audituara dhe me shkelje***:*

**1- Tenderi i zhvilluar me objekt**: *"Blerje mish dhe nënprodukte për kopshte, shkolla e çerdhe për vitin 2015 ",* me këto të dhëna:

| a- Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: *"Blerje mish dhe nënprodukte për kopshtet, shkollat e çerdhet për vitin 2015"*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 717, datë 23.2.2015 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 717, datë 23.2.2015<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>M. Z. me detyrë Specialist në Qendrën Ekonomike | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 28. dt. 4.3.2015<br>I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë,<br>J. P me detyrë Ish-Zv/Kryetar;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | | |

| | | |
|---|---|---|
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>6.389.000 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "B..... I " me ofertë **6,385,580 lekë** me kontratë nr. 1227, dt. 30.3.2015 me afat nga lidhja e kontratës 30.3.2015 deri dt. 31.12.2015 | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>4 mijë lekë ose 0.06 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 6.3.2015, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **2** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **1** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. ---, dt. -------;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -----, dt. ----- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Për sa kundërshtoni në lidhje me kualifikimin e padrejtë të OE "B. I", paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga anëtarët e KVO, është sqaruar me dokumentacion ligjore konstatimet e grupit të KLSH në lidhje me mos plotësimin e kritereve, si: a-Vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike; b-Nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron e viteve 2012, 2013 dhe 2014; c-Nuk paraqet certifikatë të gjendjes financiare në masën 10% të fondit limit ose (638,900 lekë); e-Nuk paraqet bilanc financiar për vitet 2011,2012 dhe 2013.* ***Pretendimi juaj merret në konsideratë.***

**2- Tenderi i zhvilluar me objekt**: *"Blerje vezë, bylmet dhe nënprodukte për kopshtet, shkollat e çerdhet për vitin 2015 "*, me këto të dhëna:

| | | |
|---|---|---|
| **a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "Blerje vezë, bylmet dhe nënprodukte për kopshtet, shkollat e çerdhet për vitin 2015"** | | |
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 502, datë 6.2.2015<br>**2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 502, datë 6.2.2015<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>M. Z. me detyrë Specialist në Qendrën Ekonomike | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 21. dt. 17.2.2015<br>I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë,<br>A. B. me detyrë Ish-Zv/Kryetar;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>3,938,400 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "E.....J " me ofertë 3,790,840 **lekë** me kontratë nr. 1292, dt. 3.4.2015 me afat nga lidhja e kontratës 3.4.2015 deri dt. 31.12.2015 | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>147 mijë lekë ose 3.7 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 20.2.2015, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **2** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **1** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. 921, dt. 9.3.2015;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. 921/1, dt. 16.3.2015 | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A- Hartimi i dokumenteve të tenderit:** DT janë miratuar me procesverbalin nr. 1, datë 6.2.2015.

**B- Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Nga OE "T. D" pas njoftimit në elektronik se është Skualifikuar për mos plotësim kriteresh, ka paraqitur ankesë (shtojca 20), pranë AK për s'kualifikimit të padrejtë, duke argumentuar dhe shkaqet.
Me shkresën nr. 970, datë 11.3.2015 është nxjerrë urdhri i brendshëm për pezullimin e procedurës deri në shqyrtimin e ankesës, dhe ngarkohen punonjësit: A. C me detyrë Drejtore e Drejtorisë Juridike Bashkia Vlorë.
Me shkresën nr. 1071, datë 18.3.2015 nga personi i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës A. C është njoftuar titullari i AK se pretendimi i subjektit nuk qëndron dhe ankesa nuk merret në konsideratë. Me shkresën nr. 921/1, datë 16.3.2015 është kthyer përgjigje subjektit "T. D" se ankesa nuk merret në konsideratë.
Konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), përbehet nga një person dhe jo në 3 (tre) anëtarë, siç përcaktohet në kreun X-Shqyrtimi i ankesave, të VKM nr. 914, datë 12.12.2014, i ndryshuar, pika 6, **veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK, Sh. Gj..**

**3- Tenderi i zhvilluar me objekt**: *"Blerje bukë për kopshte, shkolla e çerdhe për vitin 2015 "*, me këto të dhëna:

| | | |
|---|---|---|
| **a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: *"Blerje vezë, bylmet dhe nënprodukte për kopshtet, shkollat e çerdhet për vitin 2015"*** | | |
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 503, datë 6.2.2015 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 502, datë 6.2.2015<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>M. Z. me detyrë Specialist në Qendrën Ekonomike | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 19. dt. 17.2.2015<br>I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë,<br>A. B. me detyrë Ish-Zv/Kryetar;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>1.254.600 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "E.....J " me ofertë 1.208.700 **lekë** me kontratë nr. 1293, dt. 3.4.2015 me afat nga lidhja e kontratës 3.4.2015 deri dt. 31.12.2015 | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>46 mijë lekë ose 3.6 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 20.2.2015, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **2** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **1** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK-** nr. 921, dt. 9.3.2015;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. 921/1, dt. 16.3.2015 | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A- Hartimi i dokumenteve të tenderit:** DT janë miratuar me procesverbalin nr.1, datë 6.2.2015.
**B- Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Nga OE "T. D" pas njoftimit në elektronik se është Skualifikuar për mos plotësim kriteresh, ka paraqitur ankesë (shtojca 20), pranë AK për s'kualifikimit të padrejtë, duke argumentuar dhe shkaqet, por Bashkia Vlorë nr. 921, datë 9.3.2015.
Me shkresën nr. 970, datë 11.3.2015 është nxjerrë urdhri i brendshëm për pezullimin e procedurës deri në shqyrtimin e ankesës, dhe ngarkohen punonjësit: A. C me detyrë Drejtore e Drejtorisë Juridike Bashkia Vlorë.
Me shkresën nr. 1071, datë 18.3.2015 nga personi i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës A. C është njoftuar titullari i AK se pretendimi i subjektit nuk qëndron dhe ankesa nuk merret në konsideratë.

Me shkresën nr. 921/1, datë 16.3.2015 është kthyer përgjigje subjektit "T..... D" se ankesa nuk merret në konsideratë.
Konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), përbehet nga një person dhe jo në 3 (tre) anëtarë, siç përcaktohet në kreun X-Shqyrtimi i ankesave, të VKM nr. 914, datë 12.12.2014, i ndryshuar, pika 6, **veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK, Sh. Gj..**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Për sa kundërshtoni në lidhje me kualifikimin e padrejtë të OE "B..... I", paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga anëtarët e KVO, është sqaruar me dokumentacion ligjore konstatimet e grupit të KLSH në lidhje me mos plotësimin e kritereve, si: a-Nuk është plotësuar pika 2.3/a-përvoja të ngjashme, pasi nga subjekti janë paraqitur vetëm kontratat me Bashkinë Vlorë, por nuk janë të shoqëruara me vërtetim të marrësit të mallit.* ***Pretendimi juaj merret në konsideratë.***

**4- Tenderi i zhvilluar me objekt**: *"Blerje fruta, perime për kopshtet, shkollat e çerdhet për vitin 2016 "***,** me këto të dhëna:

| a- Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "Blerje fruta, perime për kopshtet, shkollat e çerdhet për vitin 2016"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 56, datë 15.3.2016 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 56, datë 15.3.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>M. Z. me detyrë Specialist në Qendrën Ekonomike | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 63. dt. 15.3.2016<br>I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë,<br>J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>2,931,800 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "E.....J " me ofertë 2,925,800 **lekë** me kontratë nr. 2973, dt. 19.4.2016 me afat nga lidhja e kontratës 19.4.2016 deri dt. 31.12.2016 | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>6 mijë lekë ose 0.20 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 25.3.2016, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **1** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **0** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. ---, dt. -------;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -----, dt. ----- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A- Hartimi i dokumenteve të tenderit:** DT janë miratuar me procesverbalin datë 15.3.2016.
**B- Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 2660, datë 07.04.2016, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë vetëm OE "E.....J" me ofertë ekonomike 2,925,800 lekë pa TVSH.
Me datë 30.03.2016 është bërë vlerësimi i ofertave të operatorëve pjesëmarrës (brenda afatit ligjor).
Me shkresën nr. 2661, datë 07.04.2016 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit. Shpallur në APP me buletinin nr. 14, dt. 11.04.2016. Me shkresën nr. 2973, datë 19.04.2016 (formular njoftim kontrate), është bërë njoftimi i APP mbi shpalljen fitues të subjektit "E.....J' me ofertë 2,925,800 lekë pa TVSH.

**-Vlerësim i operatorëve pjesëmarrës:** Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit dhe sistemin app, konstatohet se OE "E.....J", nuk i plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:

*a-Nuk përputhet xhiro e deklaruar sipas bilancit (viti 2014 për vlerën 20,701,975 lekë) me vërtetimin e lëshuar nga administrata tatimorë (nr. 1173, dt. 05.02.2016) për xhiron e viteve 2013, 2014 dhe 2015, ku për vitin 2014 kjo xhiro është për vlerën 18,107,450 lekë, pra më pak për vlerën 2,594,525 lekë (në vërtetim);*
*b-Nuk është paraqitur sigurimi i ofertës në masën 2% e fondit limit;*
**Konkluzioni:** Në këto kushte, KVO duhej të anulonte procedurë dhe zhvillonte një procedurë të re, duke ndryshuar dhe kriteret e vendosura, kjo për të rritur numrin e pjesëmarrësve në procedurë dhe zhvilluar procedura të rregullta në përputhje me LPP, duke eliminuar përdorimin **pa efektivitet, ekonomicitet të fondeve publike në vlerën 2,931,800 lekë**, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë, J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit dhe T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), mbi problemin e konstatuar nga grupi i auditimit të KLSH për kualifikim të padrejtë të OE "E.....J" të shpallur fitues nga KVO, nuk argumentohet të gjitha kërkesat të cilat grupi i KLSH i konstaton si shkelje, si vijon:*
*-Nuk sqarohet mos përputhje me të ardhurave sipas bilancit me ato të deklaruara në vërtetimin e administratës tatimore, kriter i cili nga KVO në procedura të tjera është përdorur si kriter s 'kualifikues (shiko për gjatë materialit). Gjithashtu jo me kot një nga anëtarët e KVO është ekonomist dhe jo me kot kërkohen si bilanci dhe vërtetimi mbi xhiron.*
*-Në lidhje me mos plotësimin e kriterit "sigurim ofertë 2%", është një kriter ku në procedura të tjera është përdoru si kriter s'kualifikues, si ne procedurën me objekt "Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2016".*
*-Merret në konsideratë plotësimi i kriterit të pagesës së energjisë elektrike.*
*Gjithsesi OE nuk plotëson të gjitha kërkesat dhe procedura duhej anuluar.*

**5- Tenderi i zhvilluar me objekt**: *"Blerje mish dhe nënprodukte për kopshte, shkolla e çerdhe për vitin 2016 "*, me këto të dhëna:

| a- Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **:** *"Blerje mish dhe nënprodukte për kopshtet, shkollat e çerdhet për vitin 2016"* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 69, datë 17.03.2016 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 69, datë 17.03.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>M. Z. me detyrë Specialist në Qendrën Ekonomike | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 73. dt. 18.3.2016<br>I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë,<br>J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>8,267,300 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "E.....J " me ofertë **8,266,057 lekë** me kontratë nr. 3286, dt. 28.4.2016 me afat nga lidhja e kontratës 28.4.2016 deri dt. 31.12.2016 | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>1 mijë lekë ose 0.015 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 11.04.2016, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **2** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **1** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |

| | | |
|---|---|---|
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. ---, dt. -------;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -----, dt. ----- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A- Hartimi i dokumenteve të tenderit:** DT janë miratuar me procesverbalin datë 17.03.2016.
**B- Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 3249, datë 27.04.2016, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 BOE/OE.
Nga auditimi i dokumentacionit teknik e ligjorë, rezultoi se KVO ka kualifikuar subjektin "E.....J" me ofertë ekonomike 8,266,057 lekë pa TVSH, me kritere të plotësuara (sipas KVO), por me ofertë më të ulët se bashkimi i operatorëve "E. P" me oferte 8,110,590 lekë pa TVSH.
Me datë 19.04.2016 është bërë vlerësimi i ofertave të operatorëve pjesëmarrës (brenda afatit ligjor), duke shpallur fitues OE "E.....J" me oferte 8,266,057 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 3286, datë 27.04.2016 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit. Shpallur në APP me buletinin nr. 17, dt. 30.05.2016. Me shkresën nr. 3329, datë 28.04.2016 (formular njoftim kontrate), është bërë njoftimi i APP mbi shpalljen fitues të subjektit "E.....J' me ofertë 8,266,057 lekë pa TVSH.
**-Vlerësim i operatorëve pjesëmarrës:** Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit dhe sistemin app, konstatohet se nga KVO është vlerësuar drejt për s'kualifikimit e BOE "E. P", pasi nuk plotësojnë kriteret e DST.
Ndërsa në lidhje me kualifikimin e OE "E.....J", ku sipas KVO plotëson kërkesat e DST, nga auditimi konstatohet se dhe ky OE nuk i plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:

*a-Nuk përputhet xhiro e deklaruar sipas bilancit (viti 2014 për vlerën 20,701,975 lekë) me vërtetimin e lëshuar nga administrata tatimorë (nr. 1173, dt. 05.02.2016) për xhiron e viteve 2013, 2014 dhe 2015, ku për vitin 2014 kjo xhiro është për vlerën 18,107,450 lekë, pra më pak për vlerën 2,594,525 lekë (në vërtetim);*

**Konkluzioni:** Në këto kushte, KVO duhej të anulonte procedurë dhe zhvillonte një procedurë të re, duke ndryshuar dhe kriteret e vendosura, kjo për të rritur numrin e pjesëmarrësve në procedurë dhe zhvilluar procedura të rregullta në përputhje me LPP, ose midis OE me mangësi në plotësimin e kritereve të vlerësonte kriterin kryesore *"Çmimin më të leverdishëm",* **duke shmangur përdorimin negativ të fondeve publike në vlerën 155,467 lekë**, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë, J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit dhe T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), mbi problemin e konstatuar nga grupi i auditimit të KLSH për kualifikim të padrejtë të OE "E.....J" të shpallur fitues nga KVO, nuk argumentohet të gjitha kërkesat, si vijon:*
*-Nuk sqarohet mos përputhje me të ardhurave sipas bilancit me ato të deklaruara në vërtetimin e administratës tatimore, kriter i cili nga KVO në procedura të tjera është përdorur si kriter s 'kualifikues (shiko për gjatë materialit). Gjithashtu jo me kot një nga anëtarët e KVO është ekonomist dhe jo me kot kërkohen si bilanci dhe vërtetimi mbi xhiron.*
*-Merret në konsideratë plotësimi i kriterit të pikën 2.3 të DST, kontrata të ngjashme.*

| |
|---|
| *Gjithsesi OE nuk plotëson të gjitha kërkesat dhe procedura duhej anuluar.* |

**6- Tenderi i zhvilluar me objekt**: *"Blerje bukë për kopshte, shkolla e çerdhe për vitin 2016 "*, me këto të dhëna:

| a- Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "Blerje bukë për kopshtet, shkollat e çerdhet për vitin 2016"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 58, datë 15.03.2016<br>**2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 58, datë 5.03.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes;<br>M. Z. me detyrë Specialist në Qendrën Ekonomike | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 65. dt. 15.03.2016<br>I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë,<br>J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>1,042,800 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "E.....J " me ofertë **1,042,800 lekë** me kontratë nr. 2974, dt. 19.4.2016 me afat nga lidhja e kontratës 19.4.2016 deri dt. 31.12.2016 | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>0 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 25.03.2016, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **1** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **0** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK-** nr. ---, dt. -------;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -----, dt. ----- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A- Hartimi i dokumenteve të tenderit:** DT janë miratuar me procesverbalin datë 15.03.2016.

**B- Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 2658, datë 07.04.2016, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë vetëm OE "E.....J" me ofertë ekonomike 1,042,800 lekë pa TVSH.
Me datë 30.03.2016 është bërë vlerësimi i ofertave të operatorëve pjesëmarrës (brenda afatit ligjor).
Me shkresën nr. 2659, datë 07.04.2016 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit. Shpallur në APP me buletinin nr. 14, dt. 11.04.2016. Me shkresën nr. 2974, datë 19.04.2016 (formular njoftim kontrate), është bërë njoftimi i APP mbi shpalljen fitues të subjektit "E.....J' me ofertë 1,042,800 lekë pa TVSH.

**-Vlerësim i operatorëve pjesëmarrës:** Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit dhe sistemin app, konstatohet se OE "E.....J", nuk i plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:
*a-Nuk përputhet xhiro e deklaruar sipas bilancit (viti 2014 për vlerën 20,701,975 lekë) me vërtetimin e lëshuar nga administrata tatimorë (nr. 1173, dt. 05.02.2016) për xhiron e viteve 2013, 2014 dhe 2015, ku për vitin 2014 kjo xhiro është për vlerën 18,107,450 lekë, pra më pak për vlerën 2,594,525 lekë (në vërtetim);*
*b-Nuk është paraqitur sigurimi i ofertës në masën 2% e fondit limit;*
**Konkluzioni:** Në këto kushte, KVO duhej të anulonte procedurë dhe zhvillonte një procedurë të re, duke ndryshuar dhe kriteret e vendosura, kjo për të rritur numrin e pjesëmarrësve në procedurë dhe zhvilluar

procedura të rregullta në përputhje me LPP, duke eliminuar përdorimin pa efektivitet, ekonomicitet të fondeve publike në vlerën 1,042,800 lekë pa TVSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë, J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit dhe T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), mbi problemin e konstatuar nga grupi i auditimit të KLSH për kualifikim të padrejtë të OE "E.....J" të shpallur fitues nga KVO, nuk argumentohet të gjitha kërkesat të cilat grupi i KLSH i konstaton si shkelje, si vijon:*
*-Nuk sqarohet mos përputhje me të ardhurave sipas bilancit me ato të deklaruara në vërtetimin e administratës tatimore, kriter i cili nga KVO në procedura të tjera është përdorur si kriter s 'kualifikues (shiko për gjatë materialit). Gjithashtu jo me kot një nga anëtarët e KVO është ekonomist dhe jo me kot kërkohen si bilanci dhe vërtetimi mbi xhiron.*
*-Në lidhje me mos plotësimin e kriterit "sigurim ofertë 2%", është një kriter ku në procedura të tjera është përdoru si kriter s'kualifikues, si ne procedurën me objekt "Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2016".*
*-Merret në konsideratë plotësimi i kriterit të pagesës së energjisë elektrike. Gjithsesi OE nuk plotëson të gjitha kërkesat dhe procedura duhej anuluar.*

**7- Tenderi i zhvilluar me objekt**: *"Blerje ushqime koloniale për kopshte, shkolla e çerdhe për vitin 2016 ",* me këto të dhëna:

| a- Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "Blerje ushqime koloniale për kopshtet, shkollat e çerdhet për vitin 2016"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 59, datë 15.03.2016 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 59, datë 5.03.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>M. Z. me detyrë Specialist në Qendrën Ekonomike | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 61. dt. 15.03.2016<br>I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë,<br>J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>3,679,105 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "E.....J " me ofertë **3,668,820 lekë** me kontratë nr. 2972, dt. 19.4.2016 me afat nga lidhja e kontratës 19.4.2016 deri dt. 31.12.2016 | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>11 mijë lekë ose 0.29 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 25.03.2016, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **1** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **0** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. ---, dt. -------;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -----, dt. ----- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A- Hartimi i dokumenteve të tenderit:** DT janë miratuar me procesverbalin datë 15.03.2016.
**B- Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 2662, datë 07.04.2016, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë vetëm OE "E.....J" me ofertë ekonomike 3,668,820 lekë pa TVSH.

Me datë 30.03.2016 është bërë vlerësimi i ofertave të operatorëve pjesëmarrës (brenda afatit ligjor).
Me shkresën nr. 2663, datë 07.04.2016 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit. Shpallur në APP me buletinin nr. 14, dt. 11.04.2016. Me shkresën nr. 2972, datë 19.04.2016 (formular njoftim kontrate), është bërë njoftimi i APP mbi shpalljen fitues të subjektit "E.....J' me ofertë 3,668,820 lekë pa TVSH.

**-Vlerësim i operatorëve pjesëmarrës:** Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit dhe sistemin app, konstatohet se OE "E.....J", nuk i plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:

*a-Nuk përputhet xhiro e deklaruar sipas bilancit (viti 2014 për vlerën 20,701,975 lekë) me vërtetimin e lëshuar nga administrata tatimorë (nr. 1173, dt. 05.02.2016) për xhiron e viteve 2013, 2014 dhe 2015, ku për vitin 2014 kjo xhiro është për vlerën 18,107,450 lekë, pra më pak për vlerën 2,594,525 lekë (në vërtetim);*

*b-Nuk është paraqitur sigurimi i ofertës në masën 2% e fondit limit;*

**Konkluzioni:** Në këto kushte, KVO duhej të anulonte procedurë dhe zhvillonte një procedurë të re, duke ndryshuar dhe kriteret e vendosura, kjo për të rritur numrin e pjesëmarrësve në procedurë dhe zhvilluar procedura të rregullta në përputhje me LPP, duke eliminuar përdorimin pa efektivitet, ekonomicitet të fondeve publike në vlerën 3,679,105 lekë pa TVSH, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë, J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit dhe T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1673/1, datë 05.03.2018 mbi problemin e konstatuar nga grupi i auditimit të KLSH për kualifikim të padrejtë të OE "E.....J" të shpallur fitues nga KVO, nuk argumentohet të gjitha kërkesat të cilat grupi i KLSH i konstaton si shkelje, si vijon:*
*-Nuk sqarohet mos përputhje me të ardhurave sipas bilancit me ato të deklaruara në vërtetimin e administratës tatimore, kriter i cili nga KVO në procedura të tjera është përdorur si kriter s 'kualifikues (shiko për gjatë materialit). Gjithashtu jo me kot një nga anëtarët e KVO është ekonomist dhe jo me kot kërkohen si bilanci dhe vërtetimi mbi xhiron.*
*-Në lidhje me mos plotësimin e kriterit "sigurim ofertë 2%", është një kriter ku në procedura të tjera është përdoru si kriter s'kualifikues, si ne procedurën me objekt "Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2016".*
*-Merret në konsideratë plotësimi i kriterit të pagesës së energjisë elektrike..*
*Gjithsesi OE nuk plotëson të gjitha kërkesat dhe procedura duhej anuluar.*

**8- Tenderi i zhvilluar me objekt**: *"Blerje mish dhe nënprodukte për kopshte, shkolla e çerdhe për vitin 2017 ",* me këto të dhëna:

| a- Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: *"Blerje mish dhe nënprodukte për kopshtet, shkollat e çerdhet për vitin 2017"*** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 46, datë 20.3.2017 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 46, datë 20.3.2017<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>M. Z. me detyrë Specialist në Qendrën | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 42. dt. 20.3.2017<br>A. M. me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë, J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | | |

| | | |
|---|---|---|
| | Ekonomike | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>6,038,900 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "E.....J " me ofertë 5.041.500 lekë me kontratë nr. 5838, dt. 4.7.2017 me afat nga lidhja e kontratës 4.7.2017 deri dt. 31.12.2017 | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>997 mijë lekë ose 16.5 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 30.3.2017, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **2** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **1** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. ---, dt. 18.4.2017;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**- ---, dt. 02.5.2017 | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. S'ka përgjigje | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP<br>Shkresa nr. 403/1. Datë 19.6.2017 |

**A- Hartimi i dokumenteve të tenderit:** DT janë miratuar me procesverbalin datë 20.3.2017.
**B- Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 5436, datë 20.6.2017, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë dy operatorë ekonomik, sipas pasqyrës:

| Nr. | Operatori | Oferta paraqitur | Kualifikuar PO/ ose JO | Arsyet e s'kualifikimit |
|---|---|---|---|---|
| 1. | E.....J | 5,041,500 | PO | |
| 2. | SH....I | 4,993,000 | JO | *Nuk plotëson kriterin e energjisë elektrike, pasi nuk është muaj Janar 2017; -Nuk plotëson kriterin për mjet transporti* |

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se nga dy operatorë ekonomik pjesëmarrës, sipas KVO plotëson kriteret vetëm OE "E.....J" me ofertë 5,041,500 lekë pa TVSH, më të lartë se OE i Skualifikuar "SH....I" me ofertë 4,993,000 lekë pa TVSH
Me shkresën nr. 5437, datë 20.6.2017 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit. Shpallur në APP me buletinin nr. 25, dt. 27.6.2017. Me shkresën nr. 5838, datë 4.7.2017 (formular njoftim kontrate), është bërë njoftimi i APP mbi shpalljen fitues të subjektit "E.....J' me ofertë 5,041,500 lekë pa TVSH.
Me formular ankese (shtojca 20) nr. 574/1, datë 18.4.2017, nga OE "SH....I" është paraqitur ankesë pranë AK për s'kualifikimit të padrejtë bërë nga KVO, pasi kriteret për të cilat është Skualifikuar nuk qëndrojnë sipas kritereve që ajo ka plotësuar.
Me shkresën adresuar KPP me datë 2.5.2017 (prot Bashkia nr. 3619, datë 3.5.2017), subjekti "SH....I" ka bërë ankesë në KPP për s'kualifikimit të padrejtë nga gara duke shpjeguar dhe arsyet, ku ndër të tjera thekson se: "*Nisur nga vendimi i padrejtë të KVO dhe në zbatim të nenin 63, të LPP, subjekti "SH....I" me datë 17.4.2016 bëri ankimin në AK për s'kualifikimit të padrejtë dhe kualifikim të një subjekti të parregullt "E.....J".*
Nga AK nuk është kthyer përgjigje brenda afatit 7 ditor siç përcaktohet në nenin 63 të LPP".

- **<u>Procedurat e tenderit me objekt "Ruajtja e objekteve të Bashkisë Vlorë</u>".**

**9- Tenderi me objekt:** *"Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2015"*, me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "*Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2015*"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 498, datë 06.02.2015 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 498, datë 06.02.2015<br>P. Th. me detyrë P/sek. prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt/Shëndetit Publik dhe | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 29. dt. 04.03.2015<br>I. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë,<br>A. B me detyrë ish- Zv/Kryetar Bashkisë; |
| **2. Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | | |

| | | |
|---|---|---|
| | mbrojtjes (ekonomist);<br>M. Z me detyrë specialiste finance në Drejt. Menaxhim Financiar | T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>14,931,285 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "F....M" me ofertë **14,930,987 lekë** me kontratë nr. 1210, dt. 30.03.2015 me afat deri 31.12.2015.<br>**6.1. Shtesë kontratë (pa TVSH)**<br>OE "F.....M" me vlerë 2,986,197 lekë sa 20% e vlerës fillestare, sipas kontratës nr. 6516, dt. 31.12.2016, me afat deri në realizimin e vlerës së sajë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>1 mijë lekë ose 0.01 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 05.03.2015, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **2** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **1** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK-** nr. S'ka, dt. ---;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -----, dt. ------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-**Preventivi është hartuar nga specialistët Bashkia Vlorë: H. H. në vlerën 14,931,285 lekë, nga e cila fondi i pagave në vlerën 13,573,895 lekë dhe fitimi + shpenzime të tjera 1,357,389 lekë.

**B- Hartimi i DT**: Me procesverbal datë 06.02.2015 nga anëtarët e njësisë së prokurimit (NJP), bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, ka hartuar dokumentet e tenderit dhe janë hedhur ne sistemin elektronik ne faqen e APP. Me procesverbal nr. 2, datë 4.03.2015, NJP ka bërë disa ndryshime në DST (sipas shkresës nr. 858, dt. 04.03.2015.

**C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 1167, datë 23.03.2015, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 OE, të dhënat të cilat janë paraqitur në pasqyrën si vijon:

| Nr. | Operatori Ekonomik | Oferta ekonomike | Vendimi i KVO-së kualifikohet (PO)/s'kualifikohet (JO) | Arsyet e s'kualifikimit |
|---|---|---|---|---|
| 1. | F....M | 14,930,987 | PO | |
| 2. | A.....A | 12,109,921 | JO | *-Nuk ka paraqitur dokument për taksat vendore në vende që ushtron aktivitet; -Kontrata e qirasë për vendin e selisë nuk është shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e palës qiradhënëse.* |

Me datë 13.03.2015, nga anëtarët e KVO është bërë vlerësimi në sistem dhe dërguar njoftim fituesit, ku nga 2 OE/BOE pjesëmarrës është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "F....M" me ofertë 14,930,987 lekë (pa TVSH).

**D-Shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues "F....M" me ofertë 14,930,987 lekë**, konstatohet se nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:

*a- Vërtetimi i energjisë elektrike nuk është në përputhje me VKM (parregullt), pasi nuk është përfshirë fatura kornete e muajt janar 2015, kur procedura zhvillohet në muajin mars 2015 (datë 05.03.2015);*

*b- Kontrata e qirasë për vendin e selisë nuk është shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e palës qiradhënëse,* ***kriter për të cilën është Skualifikuar dhe operatori me ofertë ekonomike më të ulët;***

c- *Në verifikimin e listëpagesave të subjektit me deklarimet e rojeve që janë të angazhuar në zbatimin e kësaj kontrate sipas deklarimeve të bërë nga vetë subjekti dhe drejtuesi teknik, konstatohet se disa prej tyre nuk janë të siguruar gjatë gjithë periudhës për të cilën është kërkuar që subjekti të deklaroje punonjësit (Janar – Dhjetor 2014), konkretisht: V. H për muajin Mars 2014; B. V për muajin Mars 2014; E. H për muajin Mars 2014; N. L për muajin Mars 2014; V. H për muajt Mars, Qershor, Tetor, Gusht, Shtator 2014; F. SH për muajt Mars, Qershor, Tetor, Gusht, Shtator 2014; F. P për muajin Mars, Qershor, 2014; A. J për muajin Mars, Qershor, Tetor, Gusht, Shtator 2014; A. N për muajin Mars, Qershor, Tetor, Shtator 2014; K. H për muajin Qershor 2014*

**Nga sa trajtuam më sipër ky OE nuk duhej të ish shpallur fitues**.

**Konkluzioni:** Duke patur parasysh se, KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE të tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave në DST, si edhe faktin që në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, gjykojmë se vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e **"**F....M" me ofertë 14,930,987 lekë pa TVSH, nuk është i drejtë dhe duhet të ishte Skualifikuar, siç është vepruar dhe me OE të tjerë.

Në këtë rast në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk plotësojnë kërkesat e DST, procedura duhej anuluar ose midis operatorëve me mangësi (të cilat mund të klasifikohen dhe si devijime të vogla (subjekti "A.....L" me ofertë ekonomike 12,109,921 lekë pa TVSH), të vlerësohej kriteri kryesor "*çmimi i leverdishëm,* veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ të fondeve publike në **vlerën 2,821,066 lekë,** në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: I. B me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë, A. B me detyrë ish- Zv/Kryetar, T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar dhe titullari i AK Sh. Gj. për miratimin e procedurës**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me konstatimin e grupit të KLSH për kualifikim të padrejtë të OE "F....M" , nuk argumentojnë në gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH, konkretisht:*

***Sqarimi:*** *Në lidhje me mos paraqitjen e saktë të vërtetimit të energjisë elektrike nga subjekti nuk është përfshirë muaj maturuar (Janar 2015), siç kërkohet në DST, pavarësisht faktin se në vërtetim shoqëria nuk ka detyrimi deri me datën e lëshimit të tij, e cila tregon se deri në këtë datë nuk ka detyrime, por duhej dhe muaj maturuar (Janar 2015), kriter të cilin KVO në procedura të tjera është përdorur si kriter Skualifikuar, si në procedurën me objekt "Rikonstruksion i kopshtit nr. 7, viti 2017", trajtuar përgjatë materialit.*

*Në lidhje me mos paraqitjen nga shoqëria të pronësisë së objektit, nuk është sqaruar dhe bie ndesh me kriterin e DST, ku thuhet se: "Dokument pronesie/qiraje te vendit/selisë ku ushtron aktivitetin shoqëria ofertuese". Shpjegimet e dhëna nuk argumentojnë faktin për të cilën grupi ngre pretendimin se shoqëria nuk plotëson kriterin, pasi në DST nuk janë kërkuar leje ndërtimi apo leje sheshi, por thuhet shprehimisht dokument pronësie që nënkupton "Certifikatë pronësie".*

*Në lidhje me mos regjistrimin e disa rojeve në listat e sigurimeve shoqërore, Pretendimi nuk është bindës, pasi jo më kot një anëtarë i KVO është ekonomist dhe jo më kot kërkohen listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe për më tepër ky kriter është kërkuar dhe në DST, ku thuhet se: "Vërtetim te*

*lëshuar nga Dega e Tatimeve/Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore se shoqëria ofertuese për vitin 2014 ka patur një numër mesatar prej 30 personash te siguruar, ku te jene te përcaktuar numri i te siguruarve për çdo muaj sipas ligjit. Këto vërtetime duhet te jene te shoqëruar edhe me listëpagesat sipas deklarimit ne sistemin e Degës se Tatimeve".*
*Është argumentuar vetëm pika (e) Nuk plotëson kriterin e sipas pikës 2.b të DST, pasi xhiro e deklaruar për vitet 2012-2013-2014 nuk është më e madhe se fondi limit, pasi është ndryshuar nga NJP.* ***Në këto kushte shpjegimet e subjekti nuk argumentojnë faktin se shoqëria plotëson kushtet për kualifikim.***

**10- Tenderi me objekt:** *"Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2016"*, me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "*Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2016*"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 40, datë 04.03.2016<br>**2. Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 40, datë 04.03.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>M. Z me detyrë specialiste finance në Drejt. Menaxhim Financiar | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 53. dt. 11.03.2016<br>A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>18,513,976 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "F.....M" me ofertë **18,513,001 lekë** me kontratë nr. 2693, dt. 08.04.2016 me afat deri 31.12.2016.<br>**6.1. Shtesë kontratë (pa TVSH)**<br>OE "F....M" me vlerë 3,702,400 lekë sa 20% e vlerës fillestare, sipas kontratës nr. 11039, dt. 30.12.2016, me afat deri në realizimin e vlerës së sajë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>1 mijë lekë ose 0.01 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 29.03.2016, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **2** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **1** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. S'ka, dt. ---;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -----, dt. ------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-**Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: H. H. në vlerën 18,513,997 lekë, nga e cila fondi i pagave në vlerën 16,971,977 lekë dhe fitimi + shpenzime të tjera 1,542,000 lekë.
**B- Hartimi i DT**: Me procesverbal datë 04.03.2016 nga anëtarët e njësisë së prokurimit (NJP), bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ka hartuar dokumentet e tenderit sipas procesverbalit të mbajtur dhe njoftimit të kontratës së bashku me një kopje të DT dhe janë hedhur ne sistemin elektronik ne faqen e APP.

**C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 2626, datë 07.04.2016, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 OE, të dhënat të cilat janë paraqitur në pasqyrën si vijon:

| Nr. | Operatori Ekonomik | Oferta ekonomike | Vendimi i KVO-së kualifikohet (PO)/s'kualifikohet (JO) | Arsyet e s'kualifikimit |
|---|---|---|---|---|
| 1. | F....M | 18,512,001 | PO | |
| 2. | A.....A | 15,963,888 | JO | *Mungon sigurimi i ofertës; -Mungon deklarata nga drejtuesi se punonjësit nuk janë të angazhuar në SHRSF të thera; -Ka paraqitur dokumentacion për dy mjete por kërkohet për 3 mjete; -Ing IT rezulton i pasiguruar; -Vërtetimi i energjisë elektrike nuk është për muajnë korrent; -Nuk ka paraqitur dokument për taksat vendore në vende që ushtron aktivitet; -Sipas vërtetimit të Drejt. Policisë së Qarkut janë 38 punonjës, por në DST kërkohen 40 punonjës.* |

Me datë 29.03.2016 është bërë vlerësimi në sistem nga anëtarët e KVO dhe dërguar njoftim fituesit, ku nga 2 OE pjesëmarrës janë kualifikuar për vlerësim 1 OE/BOE dhe fitues është shpallur **OE "F....M" me ofertë 18,512,001 lekë (pa TVSH)**, me kritere të plotësuara sipas KVO, por me ofertë ekonomike më të lartë se OE i Skualifikuar.

**D-Shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit fitues** "F....M" me ofertë 18,512,001 lekë, konstatohet se nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht: -*Sipas të dhënave të vetë subjekti (deklarimit për punonjësit dhe deklarimit të numrit të punonjësve nga organet tatimore, si dhe deklarimit të aktivitetit), këto punonjës janë të angazhuar dhe në aktivitetet të tjera ku subjekti shtrihet, si: DRKK Vlorë, Qendra "V.....A", Spitali Rajonale Vlorë, etj., i cili kryhet me të njëjtin numër punonjësish, kriter në kundërshtim me DST.*

Nga sa trajtuam më sipër ky OE nuk duhej të ish kualifikuar dhe shpallur fitues, pasi ka mangësi në plotësimin e kritereve të DST.

**E-Shqyrtimi i dokumentacionit të OE të Skualifikuar.** Nga verifikimi në sistemin app, të dokumentacion të Skualifikuar "A.....A", jo të gjitha kriteret për të cilat është Skualifikuar qëndrojnë, konkretisht:

*a-Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës, nuk është kusht s'kualifikimit, pasi në DST është shprehur në kllapa nëse është i zbatueshëm (kriter i cili në procedura të tjera është përdoru si kriter s'kualifikues);*

*b-Mungon deklarata nga Drejtuesi teknik që punonjësit nuk janë të angazhuar në SHRSF te tjera,* ***kriter i plotësuar (dokumenti)***

*c-Vërtetim për pagimin e faturës së energjisë,* ***kriter i plotësuar,*** *pasi subjekti ka paguar energjinë elektrike dhe të muajt korrent Janar 2016 dhe procedura është zhvilluar në muajnë mars 2016 (29.03.2016);*

*d-Nuk ka paraqitur dokument për tre mjete siç kërkohet në DST,* ***kriter i plotësuar,*** *pasi subjekti ka paraqitur me dokumentacion të rregull për tre mjete, konkretisht mjetet me targë (AA-------BX; AA.....HA; TR.....V);*

*e-Ing IT nuk është në listpagesës,* ***kriter i paplotësuar dhe nga OE pjesëmarrës;***

*f-Numër i punonjësve në DVP nuk është 40 siç kërkohet në DST,* ***mangësi e cila qëndron***

Pra subjekti nuk plotëson dy nga kriteret për të cilat është Skualifikuar, por që mund të klasifikohen dhe si devijime të vogla, nisur nga plotësimi i kriterit kryesore është çmimi anomalisht më i ulët dhe faktit se dhe OE i shpallur fitues ka mangësi.

**Konkluzioni:** Duke patur parasysh se, KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE të tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave

në DST, si edhe faktin që në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
Gjykojmë se vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e **"**F....M" me ofertë 18,512,001 lekë pa TVSH, nuk është i drejtë dhe duhet të ishte Skualifikuar, siç është vepruar dhe me OE të tjerë.
Në këtë rast në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk plotësojnë kërkesat e DST, procedura duhej anuluar ose midis operatorëve me mangësi (të cilat mund të klasifikohen dhe si devijime të vogla (subjekti "A.....L" me ofertë ekonomike 15,963,888 lekë pa TVSH), të vlerësohej kriteri kryesor "*çmimi i leverdishëm*", veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ të fondeve publike në **vlerën <u>2,548,113 lekë,</u>** të llogaritur si diferencë nga oferta e OE (18,512,001 – 15,963,888), në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë, J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit dhe T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me konstatimin e grupit të KLSH për kualifikim të padrejtë të OE "F....M" , nuk argumentojnë në gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH, konkretisht:*
*Merren në konsideratë shpjegimet e subjekti në lidhje me mos paraqitjen e faturave të pagesës për vitin 2016 për AKEP dhe fakti që drejtuesi teknik z. B. R nuk është i siguruar, ku sipas dokumentacioni ky drejtues teknik ka filluar punë me datë 13.8.2015, sipas QKR për ndryshim drejtuesi teknik.*
***Nuk argumentohet fakti se:*** *-Sipas të dhënave të vetë subjekti (deklarimit për punonjësit dhe deklarimit të numrit të punonjësve nga organet tatimore, si dhe deklarimit të aktivitetit), këto punonjës janë të angazhuar dhe në aktivitetet të tjera ku subjekti shtrihet, si: DRKK Vlorë, Qendra "V.....A", Spitali Rajonale Vlorë, etj., i cili kryhet me të njëjtin numër punonjësish, kriter në kundërshtim me DST. Shpjegimet e dhëna nga anëtarët e KVO nuk janë bindës, pasi këto deklarata janë bërë nga vetë shoqëria se ku punonjësit janë të angazhuar.* ***Në këto kushte nëse nuk plotësohet një nga kriteret shoqëria nuk plotëson kushtet për kualifikim.***

- **Procedurat e prokurimet me objekt: "Gjelbërim i qytetit të Vlorës + dekor + funeral".**

**11- Tenderi me objekti**: **"***Gjelbërim në qytet (bimë dekorative)"*

| **a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "Gjelbërim në qytet bimë dekorative"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 70, datë 17.3.2016 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** 70, datë 17.3.2015<br>P. TH, Jurist<br>A. SH me detyrë Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë.<br>D. XH me detyrë spec. Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër nr. 74, datë 18.3.2016<br>A. M., me detyrë Zv/Kryetar Bashkie Kryetar<br>G. Sh. me detyrë Këshilltar.<br>T. Z. me detyrë Drejt Menaxhim Financiar |
| **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** "Kërkesë më propozim" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)** 4,163,610 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)** OE "G.....M + M.....S" ne vlerën 4.160.000 lekë, sipas kontratës nr. 2934, datë 18.4.2016, dhe afat 30 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 3 mijë lekë ose 0.07% |
| **8. Data e hapjes së tenderit** 29.3.2016, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit** Me të ardhurat e Bashkisë Vlorë | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **0 OE**<br>b) Skualifikuar: **0** OE |

| | | |
|---|---|---|
| | | c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**- ka; **APP**–s'ka; **KPP-** ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me konstatimin e grupit të KLSH për kualifikim të padrejtë të OE "G.....M + M.....S" , janë argumentuar mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH me dokumentacion, konkretisht:*
*a-Nuk paraqet licencë profesionale NP-1 dhe NP-2, siç kërkohet pikën 2.3 të DST;*
*b-Subjekti "M.....S" nuk paraqet mandat pagesa për taksën vjetore 2015, pasi ka paraqitur vetëm një vërtetim që nuk ka detyrime deri me datë 26.03.2016 dhe pagesat e vitit 2016;*
*c-Subjekti 'M.....S" nuk paraqet QKL me kod II-4.*
*e KVO nuk janë bindës, pasi këto deklarata janë bërë nga vetë shoqëria se ku punonjësit janë të angazhuar.*
***Argumentet qëndrojnë.***

## 12- Tenderi me objekti: "*Mbjellje e rrepe dekorative në Bashkinë Vlorë"*

| **a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "Mbjellje e rrepe dekorative në Bashkinë Vlorë"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 31, datë 7.3.2017 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 31, datë 7.3.2017<br>P. TH, Jurist<br>A. SH Drejtoresh Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë.<br>E. L me detyrë Supervizorit Gjelbërimit të Qyteti | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 32, datë 7.3.2017<br>A. M., me detyrë Zv/Kryetar Bashkie Kryetar<br>z. A. N, me detyrë Drejt. Shërbimeve Publike.<br>T. Z. me detyrë Drejt Menaxhim Financiar |
| **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>21,101,156 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "A.....N" ne vlerën 19,977,629 lekë, sipas kontratës nr.3445, datë 26.4.2017, dhe afat 210 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>1,124 mijë lekë ose 5.32 |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>31.03.2017, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Me të ardhurat e Bashkisë Vlorë | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **3 OE**<br>b) Skualifikuar: **1** OE<br>c) Kualifikuar: **2** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**- ka; **APP**–s'ka; **KPP-** ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

**A-Përcaktimi i fondit limit:** Preventivi i punimeve është hartuar nga E. L për vlerën 21,101,156 lekë, i cili është miratuar nga ana e titullarit të AK D. L. Çmimet janë bërë mbi bazën e çmimeve të aplikuara në procedura të ngjashme në Bashkinë Vlorë dhe ofertat e marra nga subjekte që tregtojnë këtë lloj malli, si "D.....N"; "T.....I" dhe "F.....R". Janë bërë dhe specifikimet teknike të drurëve që do mbillen, duke përcaktuar trashësinë, lartësinë, ngjyrë etj.
Përcaktimi i fondit limit nuk është në zbatim të kërkesave të ligjit, pasi mungon harta e rrugëve/dhe ose shesheve se **ku do të mbillen këto pemë** dhe sa është numrin i tyre, mungon kërkesa nga sektori përkatës për kryerjen e këtij investimi (kjo për sa i përket numrit të pemëve që do mbillen), veprim në kundërshtim me nenin 59, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar; UMF nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe UMF nr. 30, datë 29.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në sektorin Publik". Kjo konstatohet dhe nga fakti se nga subjekti fitues "Alb Garden" është bërë kërkesë për shtyrje afati të përfundimit të

punimeve, pasi nga Bashkia Vlorë nuk janë përcaktuar vendet e mbjelljes së pemëve (piketat), ku konstatohet dhe pemët të vendosura në trotuar dhe të pambjella.
Veprim ky i cili tregon mos efektivitetin e përdorimit të fondeve publike në F.....A prioritare dhe kryerjen e procedurës së prokurimeve pa objekt prokurimi, vetëm duke lëvruar fondet, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP: P. Th. me detyrë Përgj/ Sektorit të Prokurimeve, A. SH me detyrë Drejt. Drejtoresh Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë dhe E. L me detyrë Mbikëqyrës i Shërbimit të Gjelbërimit dhe Dekor - funeral – sipërmarrje dhe titullari i AK D. L**.**
**Konkluzioni**: Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi zhvillimin e procedurës, konstatohet se procedura është në zbatim të LPP dhe kritereve të DST, duke kualifikuar si të rregullt OE "A.....n" me vlerë oferte 19,977,629 lekë pa TVSH.

**13. Tenderi me objekti**: *"Realizim i dekorit në Bashkinë Vlorë me rastin e festave të fund vitit 2017"*

| Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "***Realizim i dekorit në Bashkinë Vlorë me rastin e festave të fund vitit 2016***"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 204, datë 30.10.2017<br>**2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 204, datë 30.10.2017<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë<br>I. P. me detyrë Shef Kabineti | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 203. dt. 30.10.2017<br>A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>J. P me detyrë Këshilltar;<br>P. M me detyrë specialist IT Drejtoria e Burimeve Njerëzore. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>7.365.000 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "A.....R" 5,545,400 lekë me kontrate nr. 10923, dt. 24.11.2017 me afat kohore 60 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>1,820 mijë lekë ose 24.7 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 10.11.2017, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender **1** OE/BOE<br>b) S'<br>kualifikuar 0 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. --, dt. -----;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------, dt. --------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-Në dosjen e procedurës së prokurimit**, objekt auditimi, nuk administrohet asnjë dokumentacion mbi mënyrën e përllogaritjes së vlerës së fondit limit prej 7,365,000 lekë pa TVSH**.**
**B- Zhvillimi procedurës.** Me shkresën nr. 10755, datë 20.11.2017 është hartuar Raporti Përmbledhës, i cili është miratuar nga titullari i AK-së. Sipas këtij raport me datë 10.11.2017 është bërë hapja e procedurës, ku konstatohet se në të dy lotët e zhvilluara ka marrë pjesë vetëm 2 (dy) OE, konkretisht:
Operatorët pjesëmarrës Oferta pa TVSH
1. "A.....R" ..... 5,545,400 lekë
Sipas këtij raporti KVO ka kualifikuar të 2 OE si të rregullt, duke shpallur fitues OE me ofertë më të leverdishme, respektivisht OE "A.....R" 5,545,400 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 10756, datë 20.11.2017 është bërë njoftimi i fituesit "A.....R" 5,545,400 lekë pa TVSH, shpallur në buletinin nr. 47, datë 30.11.2017.
Me shkresën nr. 10923, datë 24.11.2017 është bërë formulari i njoftimit të nënshkrimit të kontratës me OE fitues, drejtuar APP.

**-Shqyrtimi i dokumentacionit**. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE të shpallur fitues nga KVO, konstatohet se ky OE nuk plotëson kriteret e DST, si më poshtë vijon:
*a-Mjeti me targë AA.....FF tip kosh nuk është i subjektit "A.....R" por i subjektit 'P.....E', për të cilën nuk disponon kontratë huapërdorje (dokumente nuk ka);*
*b-Nuk paraqet listpagesës e periudhës janar 217 - Shtator 2017, por janë listpagesës të viti 2016;*
*c-Subjekti nuk ka aktivitet sipas QKB për realizimin e zbukurimeve me dekor, kjo pasi sipas QKB";*
*d-Nuk plotëson kriterin e punimeve të ngjashme pasi kontrata me Bashkinë Vlorë nuk është shoqëruar me vërtetim përkatës të lëshuar nga kontraktori (Bashkia Vlorë< sipas kërkesa të DST.*
**Konkluzioni:** KVO nuk ka vlerësuar drejt OE fitues "K.....N", pasi nuk plotëson kërkesat e DST. Në këto kushte KVO duhet të vijonte procedurën me OE tjetër në radhë ose nëse dhe ky nuk plotëson kërkesat të anulonte procedurën dhe vijonte me procedurën të re, duke përcaktuar saktë kriteret dhe ndryshuar ato, kjo për të rritur numrin e pjesëmarrësve në procedurë, veprim i cili do çonte në përdorimin me efektivitet, eficentë dhe ekonomicitet të fondit të prokuruar **prej 7,365,000 lekë pa TVSH**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë, J. P me detyrë Këshilltar dhe P. M me detyrë specialist IT Drejtoria e Burimeve Njerëzore**.**
*Nga subjekti Bashkia Vlorë nuk janë paraqitur vërejtje në lidhje me këtë procedurë.***.**

- **Procedurat e tenderimit me objekt "*Përmisim i kushteve të Komunitetit Egjiptian".***

**14- Tenderi me objekt: "***Përmisimin i kushteve të banesës të Komunitetit Egjiptian, Vlorë", viti 2016",* me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "*Përmisimin i kushteve të banesës të Komunitetit Egjiptian, Vlorë", viti 2016*"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 85, datë 31.03.2016<br>**Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 85, datë 31.03.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>D. XH me detyrë spec në Drej.Infrast dhe Zhvillimit të Projekti | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 86. dt. 31.03.2016<br>A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>G. Sh. me detyrë Këshilltar i Kryetarit;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>12,911,329 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "C....O " me ofertë **12,856,683 lekë** me kontratë nr. 3897, dt. 18.5.2015 me afat 62 ditë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>54 mijë lekë ose 0.42 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 25.04.2016, ora 10.$^{00}$ | **9. Burimi Financimit**<br>Grande nga buxheti shtetit | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **3** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK-** nr. ---, dt. ---------;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ----, dt. ------ | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

Me shkresën nr. 422, datë 22.01.2016, Drejtoria e Shërbimeve Urbane dhe Strehimit ka shqyrtuar dhe dhënë dakortësi mbi projektin e objektit: *"Përmisimin i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian"*.

**A-**Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: Ing. S. Q, Akt. Urb. F. D, Ing. H. M, Ing. I. T, Akt. A. B, Art. F. D dhe Ing. D. C me detyrë Drejtor i PZHT dhe studio private "T....T" me Ing H. M për vlerën e projektit prej 12,911,329 lekë (pa TVSH), i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK.
**B- Hartimi i DT**: Me procesverbal datë 31.03.2016 nga anëtarët e njësisë së prokurimit (NJP), bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ka hartuar dokumentet e tenderit sipas procesverbalit të mbajtur dhe njoftimit të kontratës së bashku me një kopje të DT dhe janë hedhur ne sistemin elektronik ne faqen e APP.
Me procesverbal datë 18.04.2016 në referencë të kërkesave të DST, me datë 11.04.2016 dhe 18.04.2016 nga përfaqësuesit e Bashkisë Vlorë P. TH, D. XHj dhe A. SH. kanë qenë prezent në orën 10.$^{00}$ në sheshin e objektit: *"Përmisimin i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian"* në pritje të subjekteve që mund të kenë gjykuar për të kryer vizitë, ku janë paraqitur 3 OE; "Pese Vëllezërit", SH.....I", "B.....B".
**C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** KVO nuk ka mbajtur procesverbal për hapjen e procedurës dhe evidentimin e pjesëmarrësve në procedurë dhe dokumentacionin që ato kanë paraqitur, por është kaluar direkt në mbajtjen e raportit përmbledhës, i cili është nënshkruar nga ana e Titullarit të AK, në kundërshtim me pikën 5 e nenit 64, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP".
Sipas Raportit përmbledhës nr. 2108, datë 27.5.2015, në këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 BOE/OE, të dhënat të cilat janë paraqitur në pasqyrën si vijon:

| Nr. | Operatori Ekonomik | Oferta ekonomike | Vendimi i KVO-së kualifikohet (PO)/s'kualifikohet (JO) | Arsyet e s'kualifikimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | A.....I | 10.663.244 | JO | *Nuk ka paraqitur vërtetim për vendet e ushtrimit të aktivitetit Tiranë, Himarë dhe Durrës; -Në kontrata të ngjashme nuk ka punime elektrike, hidraulik etj.; -Nuk përmbushet kushte deri në 50% të fondit limit; -Plani i organizimit është i pa firmosur dhe vulosur; Nga tre mjete me kapacitet 3 – 7.5 ton disponon vetëm një mjet* |
| 2 | A.....N | 0 | JO | *Nuk ka dokumentacion* |
| 3 | SH.....I | 10.837.307 | JO | *Nuk paraqet plan-organizimi të punimeve në objekt; -Kamioni me targë AA....GS pa leje transporti; -Mjeti me targë AA....DR është me dokumente ta skeduara; -Artitekte Aleks Shjefni nuk figuron me listpagesës e sigurimeve, ndërsa arkitekti Elton Dish dhe Dorina Sako nuk është me dokumentacionin e kërkuar* |
| 4 | C....O + F.....A | 12.856.683 | PO | |

Me datë 05.05.2016 është bërë vlerësimi në sistem nga anëtarët e KVO dhe dërguar njoftim fituesit, ku nga 4 OE/BOE pjesëmarrës janë kualifikuar për vlerësim 3 OE/BOE dhe fitues është shpallur BOE "C....O" me ofertë 12,856,683 lekë (pa TVSH), më të lartë se BEO i Skualifikuar.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Shpjegimet që jepen nga KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me s 'kualifikimin e shoqërisë "A.....I", gjejnë Pretendimin e duhur ligjor, si vijon:*
*Në lidhje me paraqitjen e vlerës së kontratës së punimeve të ngjashme, pasi sipas të dhënave të paraqitura subjekti plotëson këtë kriter.*
*Certifikatat ISO që kërkohen sipas DST, janë të shoqëruar me faturë likuidimi, pasi sipas faturave që shoqërojnë kundërshtitë, rezultojnë se certifikatat ISO janë të shoqëruara me faturat.*

**15- Tenderi me objekt: "***Përmisimin i kushteve të banesës të Komunitetit Egjiptian, Vlorë", viti 2017"*, me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "*Përmisimin i kushteve të banesës të Komunitetit Egjiptian, Vlorë", viti 2017*"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 91, datë 11.5.2017<br><br>**Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 91, datë 11.5.2017<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>D. XH me detyrë spec në Drej.Infrast dhe Zhvillimit të Projekti | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 91. dt. 11.5.2017<br>A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>F. D me detyrë Këshilltar i Kryetarit;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>9,708,235 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "C....O " me ofertë 7.556.120 lekë me kontratë nr. 5828, dt. 4.7.2017 me afat 150 ditë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>2,152 mijë lekë ose 22.1 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 24.5.2017, ora 10.$^{\underline{00}}$ | **9. Burimi Financimit**<br>Grande nga buxheti shtetit | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **7** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **2** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **5** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. 4637, dt. 1.06.2017;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. S'ka përgjigje | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

Me shkresën nr. 341/1, datë 11.4.2017 Drejt. Shërbimeve Urbane dhe Strehimit ka shqyrtuar dhe dhënë dakortësi mbi projektin e objektit *"Përmisimin i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian"* në vlerën 11,649,882 lekë është shpallur fitues. Fondet janë miratuar nga MF me shkresën nr. 4707/1, datë 7.4.2017.
Me shkresën nr. 1992/3, datë 24.4.2017 të MF është miratuar shpërndarja e fondeve në të cilën është theksuar se ky fond është i patrashëguar dhe duhet të realizohet brenda viti 2017, në vlerën 11,649,882 lekë.
**A-**Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: Ing. S. Q dhe E. A me detyrë Drejtor i PZHT për vlerën e projektit prej 9,708,235 lekë (pa TVSH), i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK.
**B- Hartimi i DT**: Me procesverbal datë 11.5.2017 nga anëtarët e njësisë së prokurimit (NJP), bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ka hartuar dokumentet e tenderit sipas procesverbalit të mbajtur dhe njoftimit të kontratës së bashku me një kopje të DT dhe janë hedhur ne sistemin elektronik ne faqen e APP.
**C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 5440, datë 20.6.2017, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 7 BOE/OE.

Me datë 30.5.2017 është bërë vlerësimi në sistem nga anëtarët e KVO dhe dërguar njoftim fituesit, ku nga 7 OE/BOE pjesëmarrës janë kualifikuar për vlerësim 2 OE/BOE dhe fitues është shpallur OE "C.....O" me ofertë 7,556,120 lekë (pa TVSH), më të lartë se BEO i Skualifikuar.
Me shkresën datë 01.6.2017 (prot bashki nr. 4637, datë 01.6.2017) është bërë ankesë nga OE "SH....O-K.....n" me pretendimin se është Skualifikuar padrejtësisht. Nga bashkia është kërkuar informacion shtesë për të argumentuar arsyet që pretendon, gjë e cila nuk është paraqitur nga subjekti ankimuesi.
Me shkresën nr. 5441/, datë 20.6.2017 është bërë njoftimi i fituesit, nisur nga fakti se nuk janë paraqitur ankesë as në dosje dhe as në sistem, duke shpallur fitues OE "C....O" me ofertë 7,556,120 lekë (pa TVSH).

**D-Shqyrtimi i dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës.**

Në shqyrtimin e dokumentacionit të OE fitues "C....O" me ofertë 7,556,120 lekë pa TVSH, konstatohet se nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:

*a-Konstatohet se stafi teknik paga e deklaruar në kontratë nuk përputhet me pagën e deklaruar në listpagesës, ku në këtë të fundit është me vlerë më të vogël se në kontratë, konkretisht: Ing. Mjedisit E. C me kontratë nr. 135/41, datë 28.01.2016 dhe pagë 60,000 lekë/muaj është siguruar për pagën 25,000 lekë/muaj; Ing. Elektrike M. S me kontratë nr. 483/182, datë 28.01.2016 dhe pagë 50,000 lekë është 25,000 lekë/muaj; Ing. Ndërtimi A. S me kontrata nr. 136/42, datë 22.01.2016 dhe pagë 100,000 lekë/muaj është siguruar me pagë 25,000 lekë/muaj**;***

*b-Nuk ka paraqitur vërtetim mbi taksat vendore në Bashkinë Vlorë për vitin 2015, pasi subjekti ka ushtruar aktivitet në këtë njësi vendore në objektin "Përmisimin i kushteve të banesës të Komunitetit Egjiptian, Vlorë", viti 2016" me vlerë 12.8 milionë lekë me kontratë nr. 3897, dt. 18.5.2015;*

*c-Mjeku i shoqërisë L. K me kontratë nr. 248/1405, datë 12.7.2016 dhe pagesë 33,000 lekë/muaj, nga verifikimi konstatohet se i ka përfunduar afati kohorë i licencës, pasi sipas dokumentit licenca është lëshuar me datë 7.01.2011 me afat 5-vjecar, ndërkohë që tenderi mban datën 24.5.2017, pra një vit më pas*.

**Nga sa trajtuam më sipër ky BOE nuk duhej të ish kualifikuar**.

**Konkluzioni:** Duke patur parasysh se, KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE të tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave në DST, si edhe faktin që në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.
Gjykojmë se vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e OE "C....O" me ofertë ekonomike 7,556,120 lekë (pa TVSH), nuk është i drejtë dhe duhet të ishte Skualifikuar, siç është vepruar dhe me OE të tjerë.
Në këtë rast në kushtet kur OE "C....O" nuk plotëson kërkesat e DST, procedura duhej vijuar me operatorët e tjerë në garë të kualifikuar, deri në përcaktimin e OE fitues dhe që plotëson kërkesat e DST, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55**,** të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë, F. D me detyrë Këshilltar i Kryetarit dhe T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit të KLSH, se kualifikimi i OE "C....O" është i padrejtë, duke argumentuar dhe shpjeguar arsyet, sqarojmë se mangësitë e konstatuara nuk kanë sqarimet e nevojshme ligjore, konkretisht:*

***Sqarim:*** *Në lidhje kriterin e parë, mos përputhja e pagës në listpagesave me atë në kontratë, sqarojmë se jo pa qëllim një nga anëtarët e KVO është ekonomist dhe jo më kot kërkohen këto dy dokumente, për të provuar se dokumentacioni është i saktë dhe nga kryqëzimi i të dhënave nuk ka fshehje ose deformime të dhënave.*
*Nuk argumenton fakti i mos paraqitjes së vërtetimit mbi pagesën e taksave vendore në Bashkinë Vlorë, vendi ku shoqëria ushtron aktivitet dhe ka fituar disa procedura, duke pasur dhe kontrata të pambyllura. Pretendimi juaj se nuk është detyrë e KVO verifikimi nëse kjo shoqëri paguan ose jo detyrimet, nuk është bindës, pasi nga ana juaj vetëm për mos shoqërim të vërtetimit me mandat pagesat shoqëritë janë Skualifikuar nga ana juaj, duke mbajtur dy qëndrime si në rastin e shoqërisë 'A.....I'.*
*-Pretendimi që paraqisni se nuk i jeni referuar periudhës që licencës nuk është bindës, pasi ky është kriter të cilin në procedura të tjera është përdorur si element s'kualifikues, dhe nuk duhet që të jetë mjek dhe ne listpagesës, por dhe me licencë.* ***Pretendimi nuk merret në konsideratë****.*

- **<u>Procedurat e tjera të audituara për periudhën 01.01.2015 – 31.12.2017.</u>**

**16- Tenderi me objekt:** *"Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Rilinda Vlorë, viti 2015"*, me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "*Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Rilinda Vlorë, viti 2015*"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 1383, datë 10.4.2015 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 294, datë 7.11.2017<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt/Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>D. XH me detyrë spec në Drej.Infrast dhe Zhvillimit të Projekti | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 51. dt. 04.05.2015<br>A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>G. Sh. me detyrë Këshilltar i Kryetarit;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **2. Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>50,658,111 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "C....O " me ofertë 50,528,366 lekë me kontratë nr. 2181, dt. 01.06.2015 me afat 150 ditë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>129 mijë lekë ose 0.25 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 11.05.2015, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Grande nga buxheti shtetit | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **3** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **2** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. ka, dt. Paraqitur mposhtë;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ----, dt. ------ | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

Me shkresën nr. 2087, datë 16.3.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve për vitin 2015 është parashikuar fondi për financim 60,789,733 lekë, në zbatim të Vendimit të KZHR nr. 11, datë 25.02.2015.
**A-**Preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: Ing. E. A me detyrë Drejtor i PZHT dhe studio private "T....T" me Ing H. M për vlerën e projektit prej 50,816,495 lekë (pa TVSH), i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK.
**B- Hartimi i DT**: Me procesverbal datë 10.4.2015 nga anëtarët e njësisë së prokurimit (NJP), bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, janë hartuar dokumentet e tenderit dhe janë hedhur ne sistemin elektronik ne faqen e APP.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen nga anëtarët e NJP me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me vendosje si kriter të kategorisë së licencës NP3-C,* ***sqarojmë*** *se Pretendimi i paraqitur ka mbështetje ligjore dhe merret në konsideratë nga grupi i auditimit të KLSH. Konkretisht sipas shpjegimeve thuhet se: "Në VKM Nr.42, datë 16.1.2008, kategoria NP-3C e licencës përfshin "Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash". Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje".*
*Në preventivin e punimeve që ndodhet në dosje, parashikohen punime të licencave NP1, NS1, NS10, NS12, NS14, NS18, NS20 që zënë vlerën 7,6 milionë lekë pa TVSH ose 9,12 milionë lekë me TVSH. Kurse preventivi total është 60,38 milionë lekë me TVSH. Në rast së do të bëjmë zbritjen e këtyre dy shumave rezulton se punime ndërtimit që përfshihen në kategorinë NP3C janë në shumën 51,26 milionë lekë. Po ti referohemi klasifikimit paraprak të shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi në VKM nr.42 datë 16.1.2008 (lidhja 4) për punime mbi 50 milion lekë klasifikimi është germa (c).*

Nga disa OE janë bërë ankesa mbi kriteret e vendosura nga AK, të cilat po i trajtojmë si vijon:
**1. Nga subjekti "A.....N"** me shtojcën 19 (nr. 83, datë 29.4.2015.
Në përgjigjen e dhënë subjektit "A.....N" me shkresën nr. 1482/1, datë 29.4.2015 është sqaruar ndryshimi i ankesës nga arkitekt në teknik ndërtimi dhe për pikën tjetër do ndryshojë duke shtuar dokumente të tjerë që tregojnë pagesën e certifikatës.
**2. Nga subjekti "K.....N"** me shtojcën 19 (nr. 131, dt. 18.4.2015 dhe nr. 146, dt. 5.5.2015) .
Në përgjigje të ankesës paraqitur me shkresën nr. 1722/41, datë 05.05.2015, AK sqaron se disa nga kërkesat janë lapsus dhe të drejta nga subjekti të cilat do të ndryshojnë, kryesisht me zërat e punimeve, kurse të tjetër janë në përputhje me zërat e punimeve.
Në përgjigjen e dhënë subjektit "A.....N" me shkresën nr. 1482/1, datë 29.4.2015 do ndryshojë duke shtuar dokumente të tjerë që tregojnë pagesën e certifikatës.
**3. Nga subjekti "K.....T"** me shtojcën 20 (nr.., dt. 24.4.2015).
Me shkresën nr. 1640/1, datë 04.05.2015, AK i kthen përgjigje subjekti në të cilën theksohet se asnjë nga kërkesat e tij nuk është marrë në konsideratë.
**4. Nga subjekti "E.....N"** me shtojcën 20 (nr...., dt. 29.4.2015).
Me shkresën nr. 1707/1, datë 04.05.2015, AK i kthen përgjigje subjekti në të cilën theksohet se asnjë nga kërkesat e tij nuk është marrë në konsideratë.
Autoriteti Kontraktor (AK) me shkresën nr. 1708, datë 04.05.2015 ka bërë ndryshimin e kritereve (shtojcë ndryshimesh), ku është ndryshuar *nga arkitekt në teknik ndërtimi gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve.* Është ndryshuar kriteri që për certifikatat ISO *të paraqitet çdo dokument mbi pagesën (fatura TVSH ose dokumente të tjera).*
Është ndryshuar kriteri nga katalog pajisje sipas pikës "K" *është modifikuar në katalog e pajisje sipas pikës "N".*
Janë ndryshuar dhe numrat e disa zërave të punimeve, pasi kanë qenë lapsus dhe shtyhet dita e hapjes së ofertave me datë 11.05.2015.

Me shkresën nr. 1852, datë 12.05.2015, AK Bashkia Vlorë i është drejtuar AP për hapjen e ofertave të OE "C....O" dhe "A.....N", kjo pasi nuk hapen ofertat e tyre. Me shkresën nr. 6264/1, datë 18.5.2015 AP i kthen përgjigje AK Bashkia Vlorë për plotësimin kërkesës dhe hapjen e ofertave.

**C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 2108, datë 27.5.2015, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 BOE/OE.
Me datë 19.5.2015 është bërë vlerësimi në sistem nga anëtarët e KVO dhe dërguar njoftim fituesit, ku nga 3 OE/BOE pjesëmarrës janë kualifikuar për vlerësim 1 OE/BOE dhe fitues është shpallur BOE "C....O" me ofertë 50,528,366 lekë (pa TVSH), më të lartë se BEO i Skualifikuar "A.....N" me vlerë oferte 42,843,474 lekë.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit të KLSH, se kualifikimi i OE "C....O" është i padrejtë, duke argumentuar dhe shpjeguar arsyet, sqarojmë se nga subjekti janë argumentuar të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH kanë sqarimet e nevojshme ligjore, konkretisht:*
*-Në lidhje me mos paraqitjen si duhet të detyrimeve të energjisë elektrike, është paraqituar fatura sipas DST.*
*-Në lidhje me mos paraqitjen e faturave për certifikatat ISO, nga subjekti janë paraqitur faturat për 5 certifikata ISO.*
*- Në lidhje me kriterin e punimet e ngjashme, për kamionin vetëshkarkues me kapacitet 20 ton dhe vic stacionar me kartel të lëvizshme.*
*Duke qenë se të gjitha mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH janë sqaruar dhe bindës për grupin e auditimit, jemi të mendimit të ky operator nuk plotëson kriteret për kualifikim, pasi në zbatim të LPP dhe nëse ka vetëm një mangësi të vetme subjekti duhet Skualifikuar.* ***Pretendimi juaj merret në konsideratë****.*

**17- Tenderi me objekt: "***Rikonstruksion "Ura e Zvërnecit", Nartë-Vlorë", viti 2016*, me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "*Rikonstruksion "Ura e Zvërnecit", Nartë-Vlorë për vitin 2015*"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 326, datë 13.12.2016<br>**2. Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 326, datë 13.12.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>D. XH me detyrë specialiste në zyrën e prokurimeve (Ing) | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 327. dt. 13.12.2016<br>A. M. me detyrë Zv/Kryetar Bashkie.<br>F. D me detyrë Drej.Infrastruk e Zhvillimit;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>30,670,398 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "A.....J" me ofertë **27,446,183 lekë** me kontratë nr. 602, dt. 25.01.2017 me afat 90 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>3,224 mijë lekë ose 10.5 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 06.01.2017 ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **10** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **9** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. S'ka, dt. ---;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -----, dt. ------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-**Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: E. A në vlerën 30,670,398 lekë.

**B- Hartimi i DT**: Me procesverbal datë 13.12.2016 nga anëtarët e njësisë së prokurimit (NJP), bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ka hartuar dokumentet e tenderit sipas procesverbalit të mbajtur dhe njoftimit të kontratës së bashku me një kopje të DT dhe janë hedhur ne sistemin elektronik ne faqen e APP.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në sqarimet që jepni në lidhje me problemet e konstatuara, paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga anëtarët e NJP, janë argumentuar shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH në lidhje me kategorinë e licencës dhe kriteret për pajisjet mbrojtëse dhe ndihmëse, të cilat gjejnë zbatim të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 dhe udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", kreu II, pika (b).* ***Pretendimi juaj qëndron.***

**C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 463, datë 20.01.2017, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 10 OE.
Me datë 21.01.2017 është bërë vlerësimi në sistem nga anëtarët e KVO dhe dërguar njoftim fituesit, ku nga 10 OE/BOE pjesëmarrës është kualifikuar vetëm një OE, respektivisht "A.....J" me vlerë ofertë 27,446,183 lekë (pa TVSH) dhe për nga oferta ekonomike ka ofertë më të ulët se disa nga operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë.

**D-Shqyrtimi i dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës.**
**D/1. Në shqyrtimin e dokumentacionit të OE fitues "A.....J" me ofertë 27,446,183 lekë**, konstatohet se nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:

*a- Jo për të gjitha rastet kur janë paraqitur vërtetim për likuidimin e taksave vendore, të jenë shoqëruar me faturat e arkëtimit të tyre. Kështu, vërtetimi lëshuar nga Bashkia Kavajë nuk paraqet mandat arkëtim por vetëm faturë arkëtimi, vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Vlorë nr. 3188, datë 25.4.2016 është i pa saktë pasi nuk është përcaktuar viti 2016 i pagesës së detyrimeve për taksën vendore. Gjithashtu pagesat paraqitura nuk i përkasin vitit 2016 për të cilën kërkohet të kryhet pagesa. Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Shijak (nr. 26, dt. 26.4.2016) dhe Bashkia Durrës (nr. 212, datë 26.4.2016) nuk është përcaktuar se kujt vit i përkasin detyrimet. Për Bashkinë HAS nr. 173, datë 01.08.2016 nuk është shoqëruar me mandat pagesë. Bashkia Shkodër është paraqitur për vitin 2015 dhe jo vitin 2016 për të cilën kërkohet në DST.* ***Kriter i paplotësuar***
*b- Në muajin Gusht 2016, numri i punonjësve sipas vërtetimit (226 punonjës), nuk përputhet me numrin e punonjësve sipas listpagesës (174 punonjës), kriter për të cilën është Skualifikuar dhe subjekti "E.....A".* ***Kriter i paplotësuar.***
*c- Vërtetimi i lëshuar nga banka mbi gjendjen financiare nuk është brenda afati 5 ditor të kërkuar, fakt të evidentuar dhe nga vetë anëtarët e KVO.* ***Kriter i paplotësuar.***
Nga sa trajtuam më sipër ky OE nuk duhej të ish kualifikuar dhe shpallur fitues, pasi ka mangësi në plotësimin e kritereve të DST.
**<u>Konkluzioni</u>:** Nga verifikimi i ofertave të operatorëve ekonomik, rezultoi se KVO ka Skualifikuar nga gara operatorin ekonomik *me vlerë më të ulët* ("C....O" , me ofertë ekonomik 24,322,546 lekë), për mangësi të cilat mund të klasifikohen devijime të vogla, duke mos vlerësuar kriterin kryesor *"Çmimi*

*më i leverdishëm",* pasi dhe OE "A.....J" i shpallur fitues nuk plotëson të gjitha kriteret e DST, veprime të cilat kanë çuar në përdorim me efekt negativ të fondeve publike në **vlerën 3,123,637 lekë,** në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: A. M. me detyrë ish-Zv/Kryetar Bashkie, F. D me detyrë Drejt/Infrastruk e Zhvillimit dhe T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me kundërshtitë që paraqisni në shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit "A.....J", jo për të gjitha rastet paraqisni argumentet e duhura. Kështu nuk është sqaruar mos paraqitja e mandat pagesës nga taksat e Bashkisë Kavajë për të cilën nga ana juaj në raste homologe janë Skualifikuar OE në procedura e tjera (shikoni gjatë materialit). Nuk është e thënë që data në kokën e shkresës ose vërtetimit të tregojë se bën fjalë për atë vit, pasi aty mund të përshkruhen dhe vitet e tjera.*
*-Mos përputhje e numrit të punonjësve në listpagesës me atë në vërtetim është kriter skualifikues të cilin e keni përdorur dhe në raste të tjera si p.sh. s'kualifikimit i subjektit "E.....A", po kështu dhe për mos paraqitje në afat të vërtetimit mbi gjendjen financiare.*
*-**Merret në konsideratë,** se shoqëria nuk ka paraqitur ekskavator batipal 1.8 ton, pasi sipas dokumentacionit bashkëlidhur shoqëria ka paraqitur këtë mjet.* ***Pretendimi juaj qëndron pjesërisht, por që nuk plotëson kriteret për kualifikim***.

**18- Tenderi me objekt:** *"Rikonstruksion i rrugëve Zigur Lelo dhe Shefit Zenaj", viti 2016*, me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "*Rikonstruksion i rrugëve Zigur Lelo dhe Shefit Zenaj për vitin 2016*"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 275, datë 20.10.2016 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 275, datë 20.10.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>D. XH me detyrë specialiste në zyrën e prokurimeve (Ing) | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 280. dt. 26.10.2016<br>A. M. me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë;<br>z. F. D me detyrë Dre. I Zhvillimit të Infrastruk dhe Projekteve.<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **2. Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>83,283,093 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "A....N+A.....A" me ofertë **67,113,282 lekë** me kontratë nr. 109, dt. 09.01.2017 me afat 90 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>16,1701 mijë lekë ose 19.4 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 17.11.2016 ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>FZHR | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **5** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **4** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. 10476/2, dt. 14.12.2016 dhe datë 06.12.2016;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. 10403/1, dt. 14.12.2016 dhe nr. 10476/2, dt. 14.12.2016- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-**Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: E. M në vlerën 83,218,093 lekë (pa TVSH). Nga NJP nuk është mbajtur asnjë procesverbal mbi përllogaritjen e këtij fondi nëse është sipas çmimeve të manualit apo jo.

**B- Hartimi i DT**: Me procesverbal datë 20.10.2016 nga anëtarët e njësisë së prokurimit (NJP), bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ka hartuar dokumentet e tenderit sipas procesverbalit të mbajtur dhe njoftimit të kontratës së bashku me një kopje të DT dhe janë hedhur ne sistemin elektronik ne faqen e APP.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në sqarimet që jepni në lidhje me problemet e konstatuara, paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga anëtarët e NJP, janë argumentuar shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH në lidhje me kategorinë e licencës dhe kriteret për pajisjet mbrojtëse dhe ndihmëse, të cilat gjejnë zbatim të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 dhe udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin***.**

**C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 10960, datë 28.12.2016, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 5 OE.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), është bërë sqarimi i mangësive të grupit të auditimit të KLSH në lidhje me kualifikimin e parregullt të BOE "A....N + A.....A", si të rregullta, kjo shoqëruar dhe me dokumentacion shoqërues.*

*a- Në lidhje me konstatimet në pikën b) të kësaj procedure sqarojmë se subjekti "A....N" ka paraqitur në platformën app.gov.al kontratën më ing. Topograf Agron Mustafaj e cila ndodhet brenda files të titulluar "kontrata pune stafi A....N 1".*

*b-Në lidhje me konstatimet në pikën c) të kësaj procedure sqarojmë se në rastin konkret të dyja subjektet A....N+A.....A disponojnë kontratë të lidhur me mjek. Subjekti "A.....A" ka paraqitur të plotë dokumentacionin për mjekun, madje nga grupi i auditimit nuk ka asnjë konstatim për këtë fakt. Në kushtet kur në dst nuk përcaktohet që në rast bashkëpunimi secili prej operatorëve duhet të disponojë mjek, nga KVO ky kriter është konsideruar i plotë me plotësimin e kushtit nga njëri prej operatorëve. Nuk mund të hiqet shenjë barazimi më rastin e b.o.e "SH....I + SH.....I" pasi asnjëri prej tyre nuk e dispononte të plotë dokumentacionin për kriterin e mjekut.*

*c-Në lidhje me konstatimet në pikën d) të kësaj procedure për taksat vendore të subjektit "A.....A" sqarojmë se: Dokumenti i lëshuar nga Bashkia Kamëz për vitin 2015 sqaron qartësisht se ky subjekt nuk ka detyrime të pashlyera për këtë vit si pasojë e kompensimit të detyrimeve. Pavarësisht se shkresa e paraqitur nuk e ka emrin "vërtetim", ky dokument i ka të gjitha elementët për tu klasifikuar si i rregullt pasi mban numrin e protokollit, është nënshkruar nga titullari i institucionit, mban stemën e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Kamëz. Nuk ekziston asnjë ndryshim midis vërtetimeve dhe kësaj shkrese për të plotësuar kriterin se subjekti "A.....A" i ka shlyer këto detyrime vendore.*

*Në Bashkinë Lezhë, vërtetimi i lëshuar për vitin 2015 është shoqëruar me mandat arkëtimi, por nuk ka paraqitur faturë për shlyerjen e detyrimit prej 6,247 lekë. Kjo shumë në fakt nuk është detyrim por gjobë për vonesë likuidimi.*

*Referuar ekstraktit historik të subjektit adresa në Pogradec është hapur në dt.26.05.2016, për pasojë nuk mund të paguajë taksat vendore për vitin 2015.*

*Nga grupi i auditimit është konstatuar se nuk ka paraqitur vërtetim për Bashkinë Korçë (nr. çështjes 43, dt. 26.5.2016 në QKR). Referuar ekstraktit historik kjo adresë është hapur me vend ushtrimi aktiviteti në Proptisht, Pogradec. Fjala e parë dhe në rastin konkret "Korçë" në ekstrakt në çdo rast nënkupton Qarkun,*

*dhe më pas përcaktohet vendi i ushtrimit të aktivitetit. Në rastin konkret subjekti "A.....A" e ka paraqitur dokumentacion e kërkuar për të provuar se ka shlyer detyrimet në Bashkinë Pogradec për vitin 2016.*
*Nga grupi i auditimit është konstatuar se nuk ka paraqitur vërtetim për Bashkinë Elbasan (nr. çështje 41, dt. 1.10.2015). Edhe në këtë rast vlen i njëjti argument si në Bashkinë Korçë. Referuar ekstraktit historik kjo adresë është hapur me vend ushtrimi aktiviteti në Qukës. Fjala e parë dhe në rastin konkret "Elbasan" në ekstrakt në çdo rast nënkupton Qarkun, dhe më pas përcaktohet vendi i ushtrimit të aktivitetit. Referuar ndarjes territoriale në Republikën e Shqipërisë, Qukësi është Njësi Administrative e Bashkisë Përrenjas. Në rastin konkret subjekti "A.....A" e ka paraqitur dokumentacion e kërkuar për të provuar se ka shlyer detyrimet në Bashkinë Përrenjas për vitin 2015. Njëkohësisht ky subjekt ka paraqitur edhe taksat për Bashkinë Përrenjas për vitin 2016.* ***Pretendimi i paraqitur qëndron.***

**19. Tenderi me objekt**: *"Rikonstruksion i shkollës së mesme "Ali Demi", Bashkia Vlorë", viti 2016*

| **a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "Rikonstruksion i shkollës së mesme "Ali Demi", Bashkia Vlorë"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr.208, datë 04.8.2016 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr.208, datë 04.8.2016<br>P. TH, Jurist<br>A. SH Ekonomiste<br>D. XH Ing. Ndërtimi | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr.209, datë 04.8.2016<br>A. M., me detyrë Zv/Kryetar Bashkie Kryetar<br>F. D me detyrë Drejt. Shërbimeve Publike.<br>T. Z. me detyrë Drejt Menaxhim Financiar |
| **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>166,229,482 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>BOE "C....O + F.....A" me vlerë 165,534,546 lekë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>695 mijë lekë ose 0.4% |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>29.8.2016, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>KZHR (buxhet shteti) | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **8 OE**<br>b) Skualifikuar: **7** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**- ka; **APP**–s'ka; **KPP-** ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

Me Vendimin nr. 25, datë 18.4.2016 të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve (KZhR), është miratuar financimi i projektit "Rikonstruksion i shkollës së mesme "Ali Demi", Bashkia Vlorë", në shumën 199,475,379 lekë (nga të cilat, 93,237,690 lekë për vitin 2016 dhe diferenca për vitin 2017). Me shkresën nr. 5275, datë 23.5.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, i njoftohet Bashkisë Vlorë çelja e këtij fondi nga ana e Ministrisë së Financave.

**A-Hartimi i dokumenteve.** Më datë 04.8.2016, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në sqarimet që jepni në lidhje me problemet e konstatuara, paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga anëtarët e NJP, janë argumentuar shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH në lidhje me kategorinë e licencës dhe kriteret për pajisjet mbrojtëse dhe ndihmëse, të cilat gjejnë zbatim të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 dhe udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin***.**

**Zbatimi procedurës:** Më datë 29.8.2016, ora 10:00 janë hapur ofertat e OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, me ofertat përkatëse. Në këtë procedura ëkanë mërrë pjesë 9 OE/BOE.

Me shkresën nr. 7534, datë 19.9.2016, BOE "K.....A" - "A.....I" – "S.....F" ka paraqitur ankesë pranë AK-së në lidhje me s 'kualifikimin e tij.
Me shkresën nr. 7696, datë 26.9.2016, "G.....N" ka paraqitur ankesë pranë AK-së në lidhje me s 'kualifikimin e tij.
Me urdhrin nr. 239, datë 26.9.2016 është caktuar shqyrtimi i ankesës së BOE "K.....A" - "A.....I" – "S.....F" , si edhe të OE "G.....N" në lidhje me s 'kualifikimin e tyre.
Ankesat nuk janë pranuar (kthimi i përgjigjeve është në datë 26.9.2016).
Theksojmë se vendimi i Komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesave nuk duhet të jetë në formë rekomandimi, por në formën një vendimi (shiko pika 6, germa "ç" e nenit 78 të VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik").

Në datë 03.10.2016 BOE "K.....A" - "A.....I" – "S.....F" ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP).
Në datë 07.10.2016 OE "G.....N" ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.
Në datë 14.10.2016 AK-ja ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë KPP-së.
Me shkresën nr. 844/1, datë 04.11.2016, është përcjellë vendimi nr. 844/2016 i KPP-së. Në vendim rrëzohet ankesa e BOE "K.....A" - "A.....I" – "S.....F" dhe nuk merret në shqyrtim ankesa e "G.....N" , me arsyetimin se ishte paraqitur jashtë afateve ligjore.

Më datë 10.11.2016 është hartuar Raporti Përmbledhës, i cili është miratuar nga titullari i AK-së. Po atë datë është ngarkuar edhe Formulari i Njoftimit të Fituesit në SPE. Kontrata është nënshkruar më datë 18.11.2016 dhe Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar është i datës 18.11.2016.
Më datë 24.11.2016 OE "G.....N" ka paraqitur një kërkesë-padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Me vendimin nr. 2968, datë 06.07.2017, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë dhe pranimin e arsyeve të s'kualifikimit të vendosura nga KVO-ja.

**Nga kontrolli i dokumentacionit të paraqitur nga OE pjesëmarrës.** Nga shqyrtimi i argumenteve të përmendura nga KVO-ja, si edhe nga procesi i ankesave, gjykojmë se:
Në lidhje me kualifikimin BOE "C....O" & "F.....A" , vlerësojmë se është bërë në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, si edhe të standardit të ndjekur edhe për OE të tjerë, pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.
*Konkretisht*:
- Në germën "c" të pikës 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, te DST-ja, është kërkuar: "*Një çertifikatë të gjendjes financiare, që provon se i ka mundësitë financiare për realizimin e kontratës, në vlerën 10% të fondit limit, nga një ose më shumë banka, të lëshuar brenda 5 ditëve nga dita e tenderit*".
Gjithashtu, në pikën 3 të nenit 74, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në lidhje me BOE parashikohet se: "*Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*".
Sipas kontratës së bashkëpunimit nr. 4575 Rep., datë 24.8.2016, pjesëmarrja e OE në bashkëpunim është sipas përqindjes: OE "C....O" – 33% dhe "F.....A" – 67 %
Sa më sipër, OE "C....O" duhet të kishte paraqitur një çertifikatë financiare në vlerën jo më të vogël se 5,485,573 lekë të lëshuar brenda 5 ditëve nga dita e tenderit (siç kërkohej në DST). Duke qenë se dita e tenderit ishte datë 29.8.2016 (5 ditët), vërtetimi bankar duhej të ishte marr Jo më vonë se data

25.8.2016. Vërtetimi bankar i paraqitur nga OE "C....O" (nga Intesa San Paolo Bank) në vlerën 10,079,000 lekë i datës 24.8.2016. **Pra, është i pavlefshëm, sipas interpretimit të kërkesës së vendosur nga vetë AK-ja në DST**.

- Në germën "d" të pikës 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, te DST-ja, është kërkuar: "*Vërtetim se i ka shlyer taksat vendore për vitin 2014, 2015, 2016 të shoqëruar me faturën përkatëse të pagesës*".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE "F.....A" , rezulton se megjithëse janë paraqitur vërtetime për pagesat e taksave vendore nga të gjithë adresat e ushtrimit të aktivitetit, mungojnë faturat përkatëse të pagesës, për komunat Petrelë dhe Farkë (për vitin 2014 dhe 2015) dhe Bashkia Tiranë (viti 2014). Për komunën Farkë është paraqitur vetëm një faturë (në fakt, Urdhër Xhirim) e vitit 2014, por që ka të bëjë me një shpërblim dëmi dhe Jo me tarifa të taksave vendore. **Rrjedhimisht, edhe kjo pikë nuk është përmbushur nga BOE fitues**.

- Në lidhje me dëshmitë për mjetet dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t`i vihen në dispozicion OE, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, parashikuar në pikën 11, te 2.3 Kapaciteti teknik, ndër të tjera kërkohet: "*kokore minimumi 120 copë*", vërejmë se:

OE "C....O" ka paraqitur një faturë tatimore (TVSH) me nr. 191, datë 21.10.2014, ku në zërin nr. 3 është përcaktuar "kokore", copë 100, me vlerë 700 lekë pa TVSH. Nuk rezulton të ketë fatura të tjera ku të përcaktohen kokore.

Në faturën nr. 205, datë 02.8.2016, zëri nr. 7 përcakton vetëm "strukturë sinjalistikë", copë 33, me vlerë 200 lekë. Edhe pse në sqarimin e dhënë nga OE "C....O" thuhet se ky zë i referohet kokoreve, nuk ka asnjë bazë të vlefshme që ta mbështes këtë pohim. Aq më tepër që çmimi për këtë zë është më shumë se 3 herë më i vogël se çmimi i blerjes së kokoreve në faturën e parë (nr. 191, datë 21.10.2014).

OE "F.....A" , përmend faturën nr. 3703, datë 23.1.2015 (në fakt është deklaratë doganore), ku artikulli identifikohet si "strukturë për sinjalistikë rrugore", por nuk ka asnjë bazë për të besuar se ky përshkrim i referohet kokoreve (minimumi, duhej të ishte shoqëruar me një faturë Invoice nga firma italiane). Nga ana tjetër, në sitin e shoqërisë italiane nga e cila është marr ky mall (*ŵŵŵ*.zucchinimacchine.it), nuk rezulton se kjo shoqëri tregton artikuj të tillë, por vetëm makineri dhe mjete industriale pune (nuk del asnjë zë në katalogun në ŵebsite, për artikuj si kokore).

**Konkluzioni:** Duke patur parasysh se, AK-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE të tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave në DST, si edhe faktin që, në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Gjykojmë se vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e BOE "C....O" & "F.....A" **nuk është i drejtë dhe duhet të ishte Skualifikuar,** siç është vepruar dhe me OE të tjerë. Në këtë rast procedura duhej anuluar dhe zhvilloje procedurë tjetër duke reflektuar në ndryshimin e kritereve më të favorshme, në rritjen e numrit të pjesëmarrësve dhe paraqitjen e ofertave të leverdishme, ose midis OE me mangësi të vlerësonte kriterin kryesorë *"Çmimi më i leverdishëm"* të subjektit "G.....N" me ofertë 150,975,236 lekë, duke shmangur përdorimin me efekt negativ të fondeve publike të prokuruar **në vlerën 14,559,310 lekë**, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: A. M. me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë, F. D me detyrë Dre. Zhvillimit të Infrastruk dhe Projekteve dhe T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet qe paraqisni me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018, në lidhje me kualifikimin e padrejtë të BOE "C....O + F.....A", nuk argumentojmë problemet e trajtuara nga grupi i auditimit të KLSH, pasi nga ana jonë është trajtuar problemi kualifikimit të padrejtë të këtij BOE "C....O + F.....A", për faktin se nuk plotëson kriteret dhe nuk është marrë me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë, mbi shqyrtimin e ankesave të OE të Skualifikuar padrejtësisht.* ***Pretendimi nuk qëndron.***

**20. Tenderi me objekt**: *"Rikonstruksion i rezervuarit Kallfet + kanali ujitës – Skema ujitëse Armen – Llakatund (rehabilitim i pjesshëm)"*

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "***Rikonstruksion i rezervuarit Kallfet + kanali ujitës – Skema ujitëse Armen – Llakatund (rehabilitim i pjesshëm)***"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 114, datë 20.04.2016<br>**2. Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 114, datë 20.04.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe Mbrojtjes;<br>D. XH me detyrë Specialiste në DPZHT | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 115. dt. 20.04.2016<br>A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>G. Sh. me detyrë Këshilltar i Kryetarit të Bashkisë;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>24,525,047 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "B.....3" me ofertë 23,935,004 lekë me kontratë nr. 4537, dt. 6.6.2016 me afat 65 ditë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>590 mijë lekë ose 2.4% |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 16.05.2016, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit** Buxheti shtetit me shkresën nr. 2083/1, dt. 16.2.2016 | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **2** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **1** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. --, dt. -----;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------, dt. --------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-**Me shkresën nr. 2124, datë 23.03.2016 Kryetari i Bashkisë Vlorë i është drejtuar MBZHRAU mbi problematikat e konstatuara në kanalet ujitëse e kullues.
Me shkresën nr. 2327/1, datë 12.4.2016 është akorduar fondi prej 30,070,000 lekë me TVSH për objektin: *"Rikonstruksion i rezervuarit Kallfet + kanali ujitës – Skema ujitëse Armen – Llakatund (rehabilitim i pjesshëm)",* ndërkohë që vlera e projektit të hartuar nga Bordi i Kullimit Fier në Bashkinë Vlorë është 50,922,963 lekë me TVSH. Projekti është hartuar nga specialistet e bordit të kullimit fier Ing. M. A, Ing. E. K dhe Ing. A. V.
Me shkresën nr. 2083/1, datë 16.02.2016 të MF (Ministrisë së Financave) është bërë çelja e fondeve për vitin 2016 për vlerën 30,070,000 lekë me TVSH.

**B- Hartimi i dokumenteve:** Më datë 20.04.2016 Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në sqarimet që jepni në lidhje me problemet e konstatuara, paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga anëtarët e NJP, janë argumentuar shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH në lidhje me kategorinë e licencës dhe kriteret për pajisjet mbrojtëse dhe ndihmëse, të cilat gjejnë zbatim të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 dhe udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin.*

**21. Tenderi me objekti**: *"Blerje pajisje (kompjuter, printer dhe fotokopje) për Bashkinë Vlorë, viti 2016"*

| Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "***Blerje pajisje (kompjuter, printer dhe fotokopje) për Bashkinë Vlorë, viti 2016***"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 147, datë 19.5.2016<br>**2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 147, datë 19.5.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH dhe detyrë Drejt. Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë.<br>P. M me detyrë Specialist IT në Drejtoria e Burimeve Njerëzore | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 150. dt. 20.5.2016<br>I. B me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>J. P me detyrë Këshilltar;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>3.016.946 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "P.....E " me ofertë 2.840.050 lekë me kontratë 5893, datë 14.7.2016 afat 10 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>176 mijë lekë ose 5.8 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 6.6.2016, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender **2** OE/BOE<br>b) Skualifikuar 0 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **2** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK-** nr. --, dt. -----;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------, dt. --------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**Zbatimi i kontratës.** Referuar në realizimin e kushteve të kontratës nr. 5893, datë 14.07.2016, rezulton se malli është marrë në dorëzim me hyrje në magazinë me FH nr. 16, datë 13.09.2016, sipas faturës tatimore nr. 3562, datë 31.07.20016 dhe likuiduar me urdhër shpenzimin nr. 715, datë 26.09.2016. Bashkëlidhur dokumentacionit mungon urdhri i titullarit të AK për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, ne kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"**.**
Bashkëlidhur është akt-kolaudimi datë 6.9.2016 shoqëruar me specifikimet teknike të materialeve si dhe akt dorëzimi datë 6.9.2016, i nënshkruar nga punonjësit V. Z. dhe P. M. Sipas këtij komisioni malli është sipas specifikimeve teknike të kërkuar nga DST.
Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se malli nuk është lëvruar sipas kushteve të kontratës me datë 24.7.2016 por është lëvruar me datë 31.7.2016 (konfirmuar nga fatura e TVSH nr. 3562, dt. 31.7.2016), pra me 7 (shtatë) ditë vonës, për të cilën nuk janë llogaritur penalitetit (kamat vonesat) në vlerën **95,426 lekë** (3,408,060 x 4/1000 * 7 ditë), vlerë e cila konsiderohet dem në buxhetin e bashkisë Vlorë dhe ngarkon me përgjegjësi subjektin "P.....E" për likuidim të penalitetit**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në sqarimet që jepni në lidhje me problemet e konstatuara, paraqitur me shkresën nr. 1695/1, datë 06.03.2018 nga anëtarët e NJP, mbi mos aplikimin e kamat vonesave për mos paraqitje në afat të mallit nuk është argumentuar me dokumentacion shoqërues, pasi referuar të dhënave të faturave malli është paraqitur me vonesë siç është pranuar dhe nga vetë subjekti se fatura është paraqitur me vonesë.* ***Pretendimi juaj nuk qëndron.***

**22. Tenderi me objekti**: *"Rikonstruksion kopshti nr. 13, Bashkia Vlorë, viti 2016"*

| Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "***Rikonstruksion kopshti nr. 13, Bashkia Vlorë, viti 2016***"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 54, datë 11.03.2016 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 54, datë 11.03.2016 | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 1852. dt. 11.3.2016 |

| | | |
|---|---|---|
| **2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH dhe detyrë Drejt. Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë.<br>D. XH me detyrë Specialist Drejtoria e Infrastrukturës. | A. M. me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>G. Sh. me detyrë Këshilltar;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>11,011,343 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "S.....R + J.....I " me ofertë 8.284.555 lekë me kontratë 2935, datë 18.4.2016 me afat 60 ditë.<br>**6.1. Shtesë kontrate:** nr. 6089, dt. 20.7.2016 në vlerë 1,640,465 lekë dhe afat 30 ditë nga lidhje e kontratës | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>2.727 mijë lekë ose 24.7 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 24.3.2016, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender **6** OE/BOE<br>b) Skualifikuar 2 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **4** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. 73, dt. 21.3.2016;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. 2121/1, dt. 23.3.216 | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-** Preventivi është hartuar nga Ing. S. Q në vlerën 13,213,612 lekë me TVSH, ku në përllogaritjen e çmimeve është marrë për bazë VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizës teknike të tyre".

**B-**Më datë 11.3.2016, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ankesës dhe përgjigjes së dhënë nga ana e Bashkisë Vlorë, konstatohet se jo për të gjitha rastet e kundërshtimit Bashkia ka të drejtë ligjore për vendosjen e kritereve, konkretisht:
*a-Kriteri që subjektet duhet të paraqesin pagesën e taksave vendore të tremujorit të parë 2016 shoqëruar me mandat pagesë.* Kjo kërkesë është e tepërt pasi siç dihet afati për pagesën e taksave vendore është 20 prill, ndërsa procedura zhvillohet në muajin Mars 2016 (dt. 24.3.2016), pra afati për pagesën e këstit të parë nuk ka ardhur. Gjithashtu shoqërimi në mandat pagesë është e tepërt, pasi vetëm vërtetimi është mëse i mjaftueshëm.
*b-Vendosja si kriter s 'kualifikues mjete me karroceri fikse të tonazhit nga 2.5 – 5 ton,* duket si kërkesë pa argumentuar, pasi mund të jenë mjete të njëjtin tonazh por me karroceri të lëvizshme (me krik), e cila kryhen të njëjtën procedurë pune si mjetet me karroceri fikse;
Qartësisht, këto kritere të vendosura duken që **nuk janë** në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar.
Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP i përbërë nga: P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar, A. SH dhe detyrë Drejt. Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë dhe D. XH me detyrë Specialist Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në sqarimet që jepni në lidhje me problemet e konstatuara, paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), mbi vendosjen e kritereve në kundërshtim me ligjin, ju bëjmë me dije se argumentet e paraqitura nuk janë bindës dhe mbështetur në ligj, pasi:*

*-Nga ana juaj thuhet se në lidhje me konstatimet në pikën e parë sqarojmë se data 20 prill për pagesën e taksave vendore është afati maksimal që i lejohet subjekteve për shlyerjen e detyrimeve, pas së cilit fillon aplikimi i penaliteteve. Në cilën dispozitë ligjore/nënligjore është bazuar konstatimi i grupit të auditimit se ndërsa procedura zhvillohet në muajin Mars 2016 (dt. 24.3.2016), pra afati për pagesën e këstit të parë nuk ka ardhur??!!!!.*
***Sqarimi:*** *Në argumentet që jepni dhe pyetja që bëni jeni ju që duhet të përgjigjeni se cila është ajo bazë ligjore që e detyrimi subjektit të likuidojë detyrimet paradhënie, pra para datës 20 prill që është afati ligjorë i bërjes së pagesë. Kështu subjekti ka të drejtë të likuidojë detyrimet siç përcaktohet në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 15 pika 4, ku thuhet se: "Pagesat e kësteve të tatimit kryhen te bankat e nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare për llogari të administratës tatimore, brenda datave 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti. ....*"
***Ndërsa në lidhje me*** *kriteri që subjektet duhet të paraqesin pagesën e taksave vendore të tremujorit të parë 2016 shoqëruar me mandat pagesë, nuk është bërë asnjë sqarim.*

Gjithashtu konstatohet se për shqyrtimin e ankesave nga Titullari i AK, **nuk është** ngritur grupi i shqyrtimit të ankesave, por i është lënë përsëri NJP e cila ka hartuar ato, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, kreu X-*Shqyrtimi i ankesave*, neni 78, pika 2, ku thuhet se;

*"Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojnë vazhdimin e procedurës, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas parashikimeve të LPP-së"*, dhe pika 6- *Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm*, ku thuhet se: *" a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm.* **.** *Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës.*
*Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave"***.**

**C- Zhvillimi procedurës.** Me shkresën nr. 2781, datë 12.4.2016 është hartuar raporti përmbledhës i cili është miratuar nga ana e titullarit të AK, mbi procedurën e ndjekur.
Sipas këtij raporti, konstatohet se kanë marrë pjesë në procedurë 4(katër) OE.
Sipas të dhënave të KVO, rezulton se dokumentacion teknik e ligjorë i paraqitur nga OE pjesëmarrës janë kualifikuar 6 OE dhe janë Skualifikuar 2 OE.
Më datë 01.04.2016 është bërë vlerësimi i dokumentacionit nga KVO, ku si fitues është shpallur BOE "S.....I + J.....I" me ofertë ekonomike 8,284,555 lekë pa TVSH, më të ulët se OE të kualifikuar por më të lartë se OE "SH.....I' i Skualifikuar.
Me shkresën nr. 2782, datë 12.4.2016 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit, shpallur në buletinin nr. 15, datë 18.4.2016.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në argumentet që paraqiten nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), janë bindës për grupin e auditimit, pasi nuk janë shoqëruar me argumente ligjorë.*
*-Argumenton kriterin "Mjetet me kapacitet nga 3.5 – 5 ton që kërkohen sipas DST.*

*-Në lidhje me mangësitë e kategorive të licencës së shoqërisë "J.....I", sipas fashikullit ku është depozituar licenca dhe atij që ju paraqisni në vërejtjet tuaja, konstatohet se mungon kategoria NP-12/A dhe NS-8/A, por sipas kontratës së bashkëpunimit, shoqëria "J.....I" nuk ka këto punime.*
*-Sqaron problemin e mos plotësimit të kriterit "Nuk ka paraqitur deklaratë ku të deklaroje paraprakisht se di të bëjë tokëzimet dhe unifikimet e pajisjeve elektrike", pasi paraqet dokumentacion shoqërues.*
***Pretendimi juaj qëndron dhe kualifikimi është i saktë.***

**23. Tenderi me objekti**: *"Rikonstruksion i godinës Njësia Administrative (NJA) Shushicë, viti 2016"*

| Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "***Rikonstruksion i godinës Njësia Administrative (NJA) Shushicë, viti 2016"***"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 265, datë 7.10.2016<br><br>**2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 265, datë 7.10.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH dhe detyrë Drejt. Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë.<br>D. XH me detyrë Specialist Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 267. dt. 11.10.2016<br>A. M. me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>F. D me detyrë Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>8.282.579 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "M.....I" me ofertë 5.907.135 lekë me kontratë 10284, datë 06.12.2016 me afat 60 ditë.<br>**6.1. Shtesë kontratë** me nr. 3765, dt. 9.5.2017 në vlerën 1,080,150 lekë dhe afat 15 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>2,375 mijë lekë ose 28.6 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 19.10.2016, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender **14** OE/BOE<br>b) Skualifikuar 11 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **3** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. , dt. ---;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ---, dt. ------ | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**Zbatim i kontratës.** Sipas kontratës nr. 10284, datë 6.12.2016 afati për përfundimin e punimeve është 60 ditë kalendarike, nga data e nënshkrimit të kontratës ose deri me datë 18.6.2016.
Referuar dokumentacionit në dosje, subjekti me datë 06.01.2017 ka paraqitur shkresën nr. Ekstra, për zgjatje afati për faktin se gjatë zbatimit të punimeve për shkak të kushteve atmosferike deri me datë 20.01.2017. Me shkresën nr. 61/1, datë 10.01.2017 të titullarit të AK është bërë miratimi i zgjatjes së afatit të punimeve deri me datë 01.02.2017. Me datë 17.03.2017 subjekti sipërmarrës i punimeve "M.....I" ka paraqitur njoftimi për përfundimin e punimeve.
Sipas të dhënave të mësipërme punimet nuk kanë përfunduar në afatin e caktuar në kontratën nr. 10284, datë 6.12.2016 dhe shtesës së afatit (shkresa e Bashkisë Vlorë nr. 61/1, datë 10.01.2017), deri me datë 01.02.2017, pra punime jashtë afatit për 47 ditë kalendarike.
Sipas të dhënave të financës, ndaj subjektit është likuiduar detyrimi me datë 21.3.2017 në shumën 6,982,932 lekë për vlerën e situacionit të punimeve të kryera.
Ndajë subjektit "M.....I" nuk është llogaritur penaliteti për mos përfundimin në afat të punimeve sipas nenin 34 pika 34/1 e kontratës në masë 4/1000, si më vijon: (6,982,932 lekë vlerë objekti x 4/1000 x 47 ditë vonesë) = **1,312,791 lekë,** si dëm ekonomike në buxhetin e Bashkisë Vlorë**,** për të cilën

ngarkohet me përgjegjësi: mbikëqyrësit të punimeve V. G (përfaqësues e subjektit "P..... C.....n") dhe subjekti "M.....I" si personi përgjegjës për mos përfundimin e punimeve dhe kthimin e kamatës.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Argumentet që jepen me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me mos aplikimin e penaliteteve nga mos përfundimi i punimeve në afat nga subjekti "M.....I", nuk argumentojnë problemin e trajtuar, kjo pasi nga ana juaj kundërshtitë nuk janë shoqëruar me dokumentacion shoqërues. Kështu sipas dokumentit që grupi i KLSH ka audituar afati është shtyre deri me datë 01.02.2017.* ***Pretendimi juaj nuk qëndron.***

Grupi i projektimit bazuar në kërkesën e subjektit "M.....I" dhe mbikëqyrësit të punimeve V. G, si dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, kolaudojmë se objekti ka nevojë për ndërhyrje, duke miratuar dhe preventivin e punimeve sipas çmimeve të manualit.

Me urdhër prokurimi nr. 88, datë 9.5.2017 nga ana e titullarit të AK është kërkuar zhvillimi i procedurës për fondin shtesë 0,080,150 lekë pa TVSH. Procedura do jetë "*Negocim pa botim paraprak".* Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet mbikëqyrësi i punimeve, Drejt. Zbatimit të Projekteve, Drej. Infrastrukturës dhe zbatimit të projekteve dhe sipërmarrësi "M.....I".

Nga ana e titullarit të AK është lidhur kontratë me subjektin nr. 3765, dt. 9.5.2017 në vlerën 1,080,150 lekë dhe afat 15 ditë me sipërmarrësin "C....O".

**24- Tenderi me objekt:** *"Rikonstruksion i rrugës "Ura tek varrezat-Risli",* me këto të dhëna:

| **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :** "*Rikonstruksion i rrugës "Ura tek varrezat-Risli*" | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 11, datë 20.01.2017 (shkresa nr. 461, dt. 20.01.2017)<br>**2. Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 11, datë 20.01.2017<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>A. M. me detyrë Drejt. PZHT (ING) | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 12. dt. 20.01.2017<br>A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>F. D me detyrë Drejt. Infrastrukturës dhe zhvillimit të projekteve;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>95,889,850 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "SH.....I " me ofertë **58,655,000 lekë** me kontratë nr. 2180, dt. 20.03.2017 me afat 90 ditë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>37,234 mijë lekë ose 38.8& |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 15.02.2017, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>FZHR | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **18** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **15** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **3** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. --, dt. -----;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------, dt. --------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

Me shkresën nr. 17585, datë 28.12.2016 të Ministrisë së Financave është dërguar VKM nr. 925, datë 21.12.2016 mbi çeljen e fondeve për objektin: "Rikonstruksion i rrugës "Ura tek varrezat-Risli", në vlerën 115,067,820 lekë (me TVSH).

**A-**Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: Ing. I. T për vlerën e projektit prej 94,009,657 lekë (pa TVSH), i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet e paraqitura nga Bashkia Vlorë me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me mos rëndimin e fondit limit në vlerën 324,922 lekë, si rezultat i mos aplikimit si duhet të çmimeve të manualit, sqarojmë se shpjegimet e subjekti argumentojnë problemin e trajtuar nga grupi i KLSH, për të cilën është paraqitur dhe dokumentacion ligjore, si vijon:*

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | FUNIME ASFALTIMI | | | | | |
| 1 | 3.213 | Asfaltim me penetrim 8cm, me 2 shtresa, me makineri | m2 | 1619 | 130 | 162 | 1911 |
| 2 | 3.214 | Asfaltim me penetrim 8cm, me 1 shtresa, me makineri | m2 | 1253 | 100 | 125 | 1478 |
| 3 | 3.215 | Asfaltim me penetrim 6.5cm, me 2 shtresa, me makineri | m2 | 1221 | 98 | 122 | 1440 |
| 4 | 3.216 | Asfaltim me penetrim 6.5cm, me 1 shtresa, me makineri | m2 | 916 | 73 | 92 | 1081 |
| 5 | 3.217 | Perpunim siperfaqsor me 2 shtresa granil | m2 | 625 | 50 | 63 | 738 |
| 6 | 3.218 | Perpunim siperfaqsor me 1 shtresa granil 5~15mm | m2 | 307 | 25 | 31 | 362 |
| 7 | 3.219 | Perpunim siperfaqsor me 1 shtresa granil ~ 5mm | m2 | 181 | 14 | 18 | 214 |
| 8 | 3.220 | Shtresë binderi me granil guri kave, 3cm, me krah | m2 | 733 | 59 | 73 | 865 |
| 9 | 3.220/1 | Shtresë binderi me granil gur kave,3cm,me makineri | m2 | 749 | 60 | 75 | 883 |
| 10 | 3.221 | Shtresë binderi me granil guri kave, 4cm, me krah | m2 | 954 | 76 | 95 | 1126 |
| 11 | 3.221/1 | Shtresë binderi me granil gur kave,4cm,me makineri | m2 | 969 | 78 | 97 | 1143 |
| 12 | 3.222 | Shtresë binderi me granil guri kave, 5cm, me krah | m2 | 1172 | 94 | 117 | 1383 |
| 13 | 3.222/1 | Shtresë binderi me granil gur kave,5cm,me makineri | m2 | 1190 | 95 | 119 | 1404 |
| | | ANALIZA TEKNIKE TE PEJA | | | | | |

*<u>Pretendimi merret në konsideratë dhe vlera prej 324,922 lekë nuk qëndron.</u>*

## 25- Tenderi me objekt: *"Sistemi Multifunksional "Smart City", LUNGOMARE", viti 2017*

| **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "*Sistemim Multifunksional "Smart City", LUNMGOMARE*"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 94, datë 17.5.20017 (shkresa nr. 4059, dt. 17.5.2017)<br>**2. Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 94, datë 17.5.20017<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>F. D me detyrë Drej.Infrastrukturës së Zhvillimit të Projekteve;<br>J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 95. dt. 17.5.2017<br>A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>A. M. me detyrë Drejt. PZHT (ING);<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>53,539,200 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "C.....S " me ofertë 52,891,000 lekë me kontratë nr. 5995, dt. 10.07.2017 me afat 120 ditë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>648 mijë lekë ose 1.2% |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 13.6.2017, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>FZHR | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **3** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. --, dt. -----;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------, dt. --------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

Me shkresën nr. 5417/2, datë 08.5.2017 të Ministrisë së Financave, i njoftohet Bashkisë Vlorë çelja e fondit për projektin "Sistemi Multifunksional "Smart City", LUNGOMARE", me vlerë në total 64,247,040 lekë.

Vihet re se, në dosje mungon shkresa ku të jetë marr miratimi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKShI), siç kërkohet në germën "d" të pike 3, të VKM-së nr. 703, datë 29.10.2014 "Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit"**.**

Preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: Ing. J. P për vlerën e projektit prej 53,539,200 lekë (pa TVSH), ku si referencë ka marrë ofertat e paraqitura nga 3 subjekte të ndryshme, konkretisht nga subjekti "S....O" për vlerën 53,614,167 lekë pa TVSH, subjekti "A.....E' me vlerë 53,465,000 lekë dhe subjekti "G.....T" me vlerë 53,538,433 lekë.

Konstatohet se në dosje nuk ka asnjë dokument për të argumentuar përzgjedhjen e këtyre operatorëve, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 36 pika 4, paragrafi 2.

Gjithashtu 2 nga këto subjekte referuar të dhënave të QKR mbi aktivitetin (fushën e veprimtarisë), nuk plotësojnë kriterin për realizimin e këtij investimi, pasi subjekti "A.....E" nuk ka veprimtari të këtij lloji ku F.....A e veprimtarisë është:

*"Administrimi, menaxhimi dhe shërbime te ngjashme për ndërtesa sociale, të bizneset dhe banimit. Prodhimi I materialeve te ndërtimit dhe atyre inerte te gjitha llojeve, import eksporti i materialeve te para dhe produkteve Gjysmë te gatshme si dhe tregtimi i materialeve te ndërtimit. Aktivitet ne fushën e ndërtimit te gjitha llojeve duke përfshirë këtu ndërtime për qëllime banimi, ndërtime me karakter social, kulturor, industrial, kanalizime, rehabilitime rrugësh, ndërtimin e tyre etj., por gjithnjë duke mos u kufizuar vetëm ne to dhe ne përputhje me legjislacionin ne këtë fushe. Aktivitet ne fushën e tregtisë se bareve, restoranteve e hotelerisë duke përfshirë këtu te gjitha ambientet argëtuese ne funksion te tyre si disko, klube nate e lojëra te ndryshme argëtuese ne funksion te tyre. Import eksport dhe shitblerje me shumice e pakice te mallrave industriale, metale me ngjyre dhe te zeza, mallrave ushqimore, blegtorale, bujqësore, materialeve te para, materialeve drusore dhe mobilieve por pa u kufizuar vetëm ne këto. Shitje me pakice te karburanteve te gjitha llojeve. Veprimtari ne fushën e turizmit, me qellim ngritjen e hoteleve dhe fshatrave turistike te pushimit, plazheve qendrave te argëtimit brenda e jashtë vendit, te blejë, te marre me qira te ndërtojë apo te nxisë ndërtimin e tyre duke vepruar ne këtë fushe e vetme apo me partnere te tjerë Ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve te komunikimeve elektronike publike dhe shërbimeve me vlere te shtuar. Ofrimin e lojërave argëtuese e kuiceve televizive, konkurseve etj.*

Ndërsa subjekti "G.....T" plotësoj një pjesë të kërkesave të preventivit, respektivisht: *".....Tregti me shumice dhe pakice si dhe ofrimi i shërbimeve te Pajisjeve të vëzhgimit dhe sigurisë…."*, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP: P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar, F. D me detyrë Drej.Infrastrukturës së Zhvillimit të Projekteve dhe J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet e paraqitura nga anëtarët e NJP me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje mos dokumentimin dhe përzgjedhjen e ofertuesve si dhe faktin se nga 3 OE vetëm njëri plotëson kushtet për të dhënë informacion (oferta) mbi shërbimet që do kryhej Bashkia Vlorë. Pretendimi që përdorni se ju i referoheni nenit 59 të LPP, nuk argumenton faktin e përzgjedhjes së gabuar të subjekteve, pasi në procedurë duhet të marrin pjesë ato subjekte që e kanë këtë aktivitet. Gjithashtu referenca juaj ka lidhje me zhvillimin e procedurës, kurse grupi i auditimit trajton problemin e përcaktimit të çmimit dhe përzgjedhjes së OE në dhënien e ofertave.*
*–Merret në konsideratë problemi i konstatuar nga grupi i KLSH në lidhje me vendosjen e kritereve kualifikues, pasi nga NJP janë argumentuar ligjërisht si janë vendosur ato. Mangësi e konstatuara nga KLSH në lidhje me kritere të rënduara nuk qëndron***.**

**26- Tenderi me objekt:** *"Rikonstruksion i kopshtit nr. 7, viti 2017",* me këto të dhëna:

| **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "*Rikonstruksion i kopshtit nr. 7, viti 2017*"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 97, datë 19.05.2017 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër nr. 97, datë 19.05.2017 P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër nr. 98. dt. 19.05.2017 A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë, F. D me detyrë Drejt. Infrastrukturës dhe |
| **2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | | |

| | | |
|---|---|---|
| | A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>D. XH me detyrë Specialiste ne Sek. Prokurimeve. | zhvillimit të projekteve;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>9,575,334 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "A.....I " me ofertë **7,376,761 lekë** me kontratë nr. 6174, dt. 14.07.2017 me afat 90 ditë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>2,199 mijë lekë ose 22.9 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 01.06.2017, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **10** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **7** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **3** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK-** nr. --, dt. -----;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------, dt. --------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-**Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se projekt/preventivi është hartuar nga subjekti privat Ing. A. G me lic. Nr. K 0366/3 për vlerën 9,575,334 lekë pa TVSH.
**B- Hartimi i DT**: Me procesverbal datë 19.05.2017, anëtarët e njësisë së prokurimit (NJP), bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 kanë hartuar dokumentet e tenderit sipas procesverbalit të mbajtur dhe njoftimit të kontratës së bashku me një kopje të DT dhe janë hedhur ne sistemin elektronik ne faqen e APP.

**C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** KVO nuk ka mbajtur procesverbal për hapjen e procedurës dhe evidentimin e pjesëmarrësve në procedurë dhe dokumentacionin që ato kanë paraqitur, por është kaluar direkt në mbajtjen e raportit përmbledhës, i cili është nënshkruar nga ana e Titullarit të AK, veprime në kundërshtim me nenin 64, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP" pika 5.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet e paraqitura nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje mos plotësimin e kritereve nga shoqëria "A.....I" sipas grupit të auditimit të KLSH, sqarojmë se shpjegimet e dhënë janë pasqyruar me dokumentacion ligjor nga shoqëria për plotësimin e kritereve , si vijon:*
*a-Në lidhje me pikën e parë sqarojmë se në dokumentet e tenderit janë kërkuar "Auto vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës dhe transportues deri 3,5 ton" 2 copë. Subjekti "A.....I" ka paraqitur mjetin me targë TR.....I , i konstatuar i rregullt nga grupi i auditimit, si dhe mjetet me targë AA.....BD me kapacitet 3.5 – 7 ton dhe VL.....C me kapacitet 7.5-18 ton. Referuar lejes së qarkullimit të mjetit me targë AA.....BD përcaktohet se pesha e mjetit pa ngarkesë është 4730 kg, kurse pesha e mjetit me ngarkesë është 7490 kg. Nga diferenca e këtyre dy peshave del se kapaciteti mbajtës dhe transportues i këtij mjeti është 2760 kg, pra e plotëson kushtin e përcaktuar në kriterin e kualifikimit që të jetë deri në 3,5t.*
*b-Në lidhje me pikën e dytë sqarojmë se në dokumentet e tenderit është kërkuar "1 (një) ing. Mekanik profili termoteknikë". Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri ka qenë për shkak të punimeve të parashikuara në preventiv që përfshin kategorinë NS – 12A e licencës "Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit " Subjekti "A.....I" ka paraqitur kontratën e lidhur me Ing. Mekanik Helidon Janina i cili është i profilizuar në inxhinieri mekanike për industrinë e cila në vetvete përfshin pajisjet industriale, konstruktimin dhe dizajnimin, proceset e përpunimit në industri (materialeve dhe*

*ushqimore), etj. Bazuar në këto sqarime është e qartë se për këtë procedurë prokurimi detyrat e profilit termoteknikë mund të kryhen edhe nga profili inxhinieri mekanike për industrinë, pasi në fakt pajisjet ngrohjes e të kondicionimit që do të montohen janë industriale.*
*c-Në lidhje me pikën e tretë dhe të katërt sqarojmë se edhe pse subjekti ka paraqitur vërtetim për Bashkitë Kurbin dhe Selenice, nga verifikimi i ekstraktit historik të QKR-së rezulton se për vitin 2017 (vit që janë kërkuar taksat vendore të jenë paguar) nuk ka vend të ushtrimit të aktivitetit. Fakti që ka paraqitur vërtetime nga këto dy njësi vendore nuk përbën shkak për KVO që të bëjë s'kaulifikimin për këtë shkak. Adresa Himarë është hequr nga QKR në datë 06.06.2016, kurse adresë në Bashkinë Durrës nuk rezulton të ketë patur. Për pasojë KVO nuk mund të s'kualifikoje një operator ekonomik mbi bazën e shkaqeve të paqena apo të kërkojë të sjellë pagesën e detyrimeve për vende ku nuk ushtron aktivitet tregtar.* ***Argumentet qëndrojnë.***

**27. Tenderi me objekt**: *"Rikonstruksion i shkollës së mesme "Halim Xhelo", Vlorë".*

| **Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "***Rikonstruksion i shkollës së mesme "Halim Xhelo", Vlorë***"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 165, datë 4.8.2017<br>**2. Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 165, datë 4.8.2017<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe Mbrojtjes;<br>A. M. me detyrë Drejt. DPZHT | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 166. dt. 4.8.2017<br>A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>F. D me detyrë Drejt. I Zhvillimit të Projekteve;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>60,644,928 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "I.....I " me ofertë 59.426.171 lekë me kontratë nr. 11011, dt. 30.11.2017 me afat 180 ditë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>1,218 mijë lekë ose 2 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 30.8.2017, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>FZHR. Financim 2 vjeçar. Viti 2017 në vlerën 39,907 mijë lekë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **8** OE/BOE<br>b) Skualifikuar 7 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. 7981, dt. 19.9.2017; nr.7985, dt.19.9.2017<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**- ---, dt.5.10.2017 | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. 7981/, dt. 25.9.2017 dhe nr. 7985/1, dt. 25.9.2017 | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP<br>Shkresa nr. 709/1, dt. 26.10.2017 |

**A-Hartimi i preventivit.** Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: Ing. E. A dhe M. K. për vlerën e projektit prej 61,684,067 lekë (pa TVSH), i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK. Nga krahasimi i çmimeve sipas preventivit me çmimet sipas manualit, konstatohet se çmimet janë sipas manualit, kryesisht ato me numër analize.
Me vendim nr. 15, datë 21.3.2017 të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve është miratuar fondi për objektin e mësipërm në vlerën 72,781,508 lekë, nga e cila financuar në vitin e parë 2017 në vlerën 29,112,603 lekë. Miratuar me shkresën nr. 3278/2, datë 21.4.2017 nga MF (Drejtoria e Buxhetit).

**B- Hartimi i dokumenteve.** Më datë 4.8.2017, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.
Vihet re se, në vendosjen e disa kritereve NjP nuk ka argumentuar si duhet arsyet, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", konkretisht:

-*Vërtetim se i ka shlyer taksat vendore për vitin 2017 te shoqëruar me faturën përkatëse te pagesës*. Kërkesa për paraqitjen e mandat pagesës**,** është e pakuptimtë, kërkesë tej kritereve të përcaktuara në LPP, pasi AK që lëshon vërtetimet e mban vetë përgjegjësinë mbi vartësinë e dokumentit. në kundërshtim me nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, paragrafi 2.

-*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) ekspert zjarrfikës te pajisur me certifikatën përkatëse, kontrate pune në bazë të ligjit nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" dhe udhëzimet përkatëse.* Nga ku rezulton se kërkesa e autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e një ekspert zjarrfikës, shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës, në kuptim të nenit 46 pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

-*Formularët e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*. Sa më sipër kërkesa për liste pagesat të jenë shoqëruar me formularët e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe TAP, sqarojmë se është një kërkesë e fryrë dhe e tejkaluar e LPP, pasi nga vetë organet tatimore, bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.23, datë 09.12.2014, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", të dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në të cilin në pikën 10, "Të tjera".

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP: P. TH me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar, A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe Mbrojtjes dhe A. M. me detyrë Drejt. DPZHT.

**C-Zhvillimi procedurës.** Më shkresën nr. 10524, datë 15.11.2017 është hartuar raporti përmbledhës, në të cilën është parashtruar e gjithë procedura e ndjekur nga KVO dhe KSHA. Kanë marrë pjesë në këtë procedurë 8 OE/BOE. Më datë 12.9.2017 është bërë vlerësimi i ofertave dhe janë njoftuar operatorët pjesëmarrës mbi rezultatet.

Me datë 19.9.2017, nr. 7981, shoqëria "I.....I', ka paraqitur ankesë (shtojca 20) për kualifikim të pa drejtë të BOE "E.....A + A.....N" dhe "C....O", duke argumentuar dhe arsyet.

Me datë 19.9.2017, nr. 7985, shoqëria "J.....K, ka paraqitur ankesë (shtojca 20) për s 'kualifikim të pa drejtë nga procedura, duke shpjeguar dhe kundër argumentet**.**

Me shkresën nr. 8574, datë 21.9.2017 nga titullari i AK miratuar urdhri brendshëm nr. 186, datë 21.9.2017 për shqyrtimin e ankesës së shoqërive, pezullimin e procedurës deri në shqyrtimin e tij dhe ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës (këtu e vijim KSHA) i përbërë nga D. Z., J. Gj dhe A. P.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, KSHA me shkresën nr. 7985/1, datë 25.9.2017 ka kthyer përgjigje shoqërisë "J.....K" se pretendimet dhe në se qëndrojnë, KVO në s 'kualifikim ka paraqitur dhe kritere të tjera të cilat nuk plotësohen.

Me shkresën nr. 7981/2, datë 29.9.2017 KSHA ka kthyer përgjigje shoqërisë I.....I për kualifikim të pa drejtë të BOE "E.....A + A.....N" dhe "C....O", në të cilën sqarohet se pretendimet e shoqërisë I.....I nuk qëndrojnë.

Me shkresën nr. 7981/1, datë 25.9.2017 të KSHA i është kthyer përgjigje titullarit të AK se pretendimet e ngritura nga shoqëritë I.....I dhe "J.....K" nuk qëndrojnë dhe duhet të vijohet me tej me procedurën.
Me datë 5.10.2017 shoqëria I.....I ka bërë ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik (këtu e vijim KPP) (njoftuar Bashkia Vlorë me prot nr.1559, dt. 5.10.2017 dhe prot nr. 9253, dt. 6.10.2017), duke parashtruar dhe pretendimet përkatëse.
Me shkresën nr. 9302/1, datë 11.10.2017 të Bashkisë Vlorë (AK), është kthyer përgjigje KPP mbi vendimin nr. 1559/1, datë 6.10.2017 (dërgim dokumentacioni shoqërues të procedurës dhe pezullim procedure deri në shqyrtimin e tij).
Me shkresën nr. 709/1, datë 26.10.2017 të KPP është përcjellë vendimi nr. 709/2017 datë 26.10.2017, në të cilën thuhet se: *"Të pranohet ankesa e operatorit I.....I si e Drejtë dhe ligjore, të anulojë vendimin e KVO për kualifikim të BOE "A.....N + E.....A" dhe OE "C....O" për mos përmbushje të kritereve".*
Me shkresën nr. 10099, datë 3.11.2017 të AK i është kërkuar Agjencisë së Prokurimit heqjen e pezullimit për vendimin e KPP dhe vijimin e procedurave.

Në përfundim të shqyrtimit të ankimeve, KVO ka shpallur fitues OE I.....I me vlerë oferte 59,426,171 lekë pa TVSH, më të lartë se operatorët e tjerë pjesëmarrës, duke Skualifikuar operatorë me ofertë më të ulët por në respektim të vendimit të KPP nr. 709/2017 datë 26.10.2017
Me shkresën nr. 10523, datë 15.11.2017 është hartuar formulari i njoftimit të fituesit për subjektin I.....I me vlerë oferte 59,426,171 lekë pa TVSH, shpallur në buletinin nr. 47, datë 30.11.2017. me shkresën nr. 11011, datë 30.11.2017 është bërë formulari i njoftimit të nënshkrimit të kontratës me OE fitues dhe lidhur kontrata nr. 11011, datë 30.11.2017.

**Shqyrtimi i dokumentacionit të ofertuesve.** Nga verifikimi në sistem i dokumentacion të operatorit të shpallur fitues I.....I, konstatohet se dhe ky OE nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:
*a- Nuk rezultojnë në listpagesës e sigurimeve shoqërore (F. B dhe K. S sipas kontratës datë 5.6.2017).*
*b- Për disa specialist të stafit teknik, paga sipas kontratës nuk përputhet me pagën në listpagesës dhe se nuk janë aktiv gjatë gjithë periudhës, respektivisht: Ing. Hidroteknik E. K në muajnë korrik ka vetëm 10 ditë pune nga 22 ditë; -Ing. Gjeodet D. P sipas kontratës datë 6.6.2017 për muajnë korrik ka vetëm 10 ditë pune nga 22 ditë; -Ing. Gjeolog P. N sipas kontratës paguhet 40,000 lekë/muaj në listpagesës është paguar 33,000 lekë (dek rrem); -Ing. Gjeolog P. N sipas kontratës paguhet 40,000 lekë/muaj në listpagesës është paguar 33,000 lekë (dek rrem); -Ing. Arkitekt TH. N sipas kontratës paguhet 40,000 lekë/muaj në listpagesës është paguar 33,000 lekë (dek rrem);*
***c-** Nga verifikimi i bilanceve financiare të viteve 2015 dhe 2016, konstatohet se pasqyra e të ardhurave të bilancit të vitit 2015 është në vlerën 204,471,901 lekë, ndërsa nga pasqyra e të ardhurave të bilancit të vitit 2016 në ushtrimin paraardhës 2015, të ardhurat paraqiten në shumën 218,973,627 lekë, pra më pak në vlerën 14,501,726 lekë, gjë e cila tregon se bilancet nuk janë reale dhe të sakte **(deklarim i rrem).***

**Referuar të dhënave të mësipërm ky OE nuk duhej kualifikuar.**

Sipas vendimit nr. 709/2017, datë 26.10.2017 të KPP, operatori "C....O" sipas ankesës së subjektit I.....I nuk plotëson kriterin: *"Një dokument (çertifikatë) nga organet të akredituara ku të vërtetojë që boja hidromat*

*është bojë ekonoligjike (ECO në përputhje me standartet).* Nga verifikimi në sistem ky dokument është i njëshmen me atë që ka paraqitur dhe operatori fitues.

**Konkluzioni:** Duke patur parasysh se, AK-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE të tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël (ka dhe kritere të ngjashme qe janë Skualifikuar OE me ofertë më të ulët), të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave në DST, si edhe faktin që në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Gjykojmë se vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e OE I.....I me vlerë oferte 59,426,171 lekë pa TVSH, nuk është i Drejtë dhe duhet të ishte Skualifikuar, siç është vepruar dhe me OE të tjerë.

Në këtë rast në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk plotësojnë kërkesat e DST, procedura duhej anuluar ose midis operatorëve me mangësi (të cilat mund të klasifikohen dhe si devijime të vogla, si subjekti "C....O"), të vlerësohej kriteri kryesor "*çmimi i leverdishëm*", duke lejuar përdorim me efekt negativ të fondeve publike në **vlerën 4,550,786 lekë,** në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55**,** veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: anëtarët e KVO i përbërë nga: A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë, F. D me detyrë Drejt. I Zhvillimit të Projekteve dhe T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet e paraqitura nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje mos plotësimin e kritereve nga shoqëria I.....I sipas grupit të auditimit të KLSH, sqarojmë se jo të gjitha mangësitë janë e evidentuara janë argumentuar, kështu:*

***Gjejnë argument shpjegimet*** *në lidhje me pikën e parë, pasi në platformën app.gov.al ndodhet i ngarkuar një fashikull i titulluar "sig shoq shend 2017", ku nga klikimi i tij hapet një dokument me 10 faqe që përmban formularin e pagesës bashkë me faturën për periudhën janar – maj 2017, si dhe me pikën e tretë pasi në platformën app.gov.al ndodhen të ngarkuar dokumentacion edhe për inxhinierin e ndërtimit V. M. Në këto kushte edhe pse ing. L. M i ka përfunduar kontrata e paraqitur, por që figuron e në listëpagesat, subjekti I.....I ka paraqitur dokumentacion për dy inxhinierë ndërtimi, çka e rrëzon konstatimin e grupit të auditimit.*

***Nuk gjejnë argument*** *kërkesat e tjera që kanë lidhje me:*

*d- Nuk rezultojnë në listpagesës e sigurimeve shoqërore (F. B. dhe K. S. sipas kontratës datë 5.6.2017).*

*e- Për disa specialist të stafit teknik, paga sipas kontratës nuk përputhet me pagën në listpagesës dhe se nuk janë aktiv gjatë gjithë periudhës, respektivisht: Ing. Hidroteknik E. K në muajnë korrik ka vetëm 10 ditë pune nga 22 ditë; -Ing. Gjeodet D. P sipas kontratës datë 6.6.2017 për muajnë korrik ka vetëm 10 ditë pune nga 22 ditë; -Ing. Gjeolog P. N sipas kontratës paguhet 40,000 lekë/muaj në listpagesës është paguar 33,000 lekë (dek rrem); -Ing. Gjeolog P. N sipas kontratës paguhet 40,000 lekë/muaj në listpagesës është paguar 33,000 lekë (dek rrem); -Ing. Arkitekt TH. N sipas kontratës paguhet 40,000 lekë/muaj në listpagesës është paguar 33,000 lekë (dek rrem);*

*-Nga verifikimi i bilanceve financiare të viteve 2015 dhe 2016, konstatohet se pasqyra e të ardhurave të bilancit të*

*vitit 2015 është në vlerën 204,471,901 lekë, ndërsa nga pasqyra e të ardhurave të bilancit të vitit 2016 në ushtrimin paraardhës 2015, të ardhurat paraqiten në shumën 218,973,627 lekë, pra më pak në vlerën 14,501,726 lekë, gjë e cila tregon se bilancet nuk janë reale dhe të sakte. Sqarojmë se për disa*

*nga këto kritere janë përdoru si skualifikues në disa procedura nga ana juaj, të cilat gjejnë pasqyrim përgjatë materialit, si mos përputhje e xhiros së bilancit me të ardhurat sipas vërtetimit të administratës tatimore.*
*Gjithashtu prezenca si anëtar i KVO i një ekonomisti dhe kërkesa për listpagesës dhe kontratë jo paqëllim kërkohen, por të verifikohen nëse deklarimet e subjekti janë të sakta ose jo në të gjitha nivelet.*

**28. Tenderi me objekt**: *"Ndriçimi i rrugëve në qytetin Vlorë".*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "***Ndriçimi i rrugëve në qytetin Vlorë"* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 70, datë 18.4.2017<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 70, datë 18.4.2017<br>P. TH Jurist<br>A. SH Ekonomiste<br>F. D Ing. Ndërtimi | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 69, datë 18.4.2017<br>A. M Kryetar<br>J. P Anëtar<br>T. Z. Anëtar |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>25,000,923 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>24,949,484 lekë, sipas kontratës nr. 4611, dt. 01.6.2017 Dhe afat 30 ditë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>51,439 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>12.5.2017, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e Bashkisë Vlorë | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **3 OE**<br>b) Skualifikuar: **2** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**- s'ka; **APP**–s'ka; **KPP- s'**ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

Projekti është hartuar nga Ing. F. D në vlerën 25,000,923 lekë.
Në dosje mungon një dokument që të vërtetojë miratimin e këtij investimi (nga Këshilli Bashkiak në rastin konkret, meqë është një investim i kryer me të ardhurat e vetë Bashkisë Vlorë).

Me urdhrin e prokurimit nr. 70, datë 18.4.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, caktohet Njësia e Prokurimit për zhvillimin e tenderit me objekt: "Ndriçim i rrugëve në qytetin Vlorë", me fond limit 25,000,923 (*njëzetë e pesë milionë e nëntëqind e njëzetë e tre*) lekë pa TVSH.

Me urdhrin nr. 69, datë 18.47.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, caktohet Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO). Bie në sy që, urdhri për ngritjen e KVO-së ka dal para urdhrit të prokurimit (*edhe shkrese e urdhrit të KVO-së është protokolluar përpara, konkretisht 2 numra të protokollit përpara shkresës të protokolluar për urdhrin e prokurimit*). Nuk kuptohet përse, përsa kohë që KVO-ja emërohet vetëm pasi është iniciuar një procedurë prokurimi dhe asnjëherë përpara.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet e paraqitura nga anëtarët e NJP me shkresën nr. 1696/1, datë 06.03.2018 në lidhje me vendosjen e kritereve, konstatohet se nga subjekti është bërë Pretendimi ligjore, si vijon:*
*Njësia e Prokurimit ka vendosur në dispozicion të grupit të auditimit tabelën me zbërthimin e orëve të punës, bazuar në preventivin e hartuar për këtë tender. Konkretisht në përfundim të këtyre analizave dalin 5882.25 orë pune punëtori dhe 738.4 orë punë makineri, shuma këto të pjesëtuara për afatin prej 30 ditor të kryerjes së punimeve dalin 27 (24,5+3) të punësuar, si dhe inxhinierët që do të angazhohen përbëjnë numrin prej 30 personash të kërkuar në DST.*

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 6 | 3An /et | F.V Elektroda tokezimi te zinguara 50x3mm, L=1.5m | cope | 136 | 714 | 97,058 | 0.4 | 54.4 | 0 | |
| 6 | 7 | An1 | F.V Pusete plastike 30x30x30 me kapak | cope | 136 | 635 | 86,365 | 0.6 | 81.6 | 0 | |
| 7 | 8 | 2.a-118 | F.V Panel metalik i kompletuar per komandimin e ndricimit | cope | 4 | 22260 | 89,039 | 0.95 | 3.8 | 0 | |
| 8 | 9 | An5 | F.V Kabell bakri i tensionit te ulet Fror, S=3x1.5mm2 (mosseten-ndri | ml | 789 | 59 | 46,923 | 0.1 | 78.9 | 0 | |
| 9 | 10 | **An.6** | F.V Kabell bakri i tensionit te ulet FG7, S=5x16mm2 | ml | 115 | 816 | 93,895 | 0.45 | 51.75 | 0 | |
| 0 | 11 | An16 | F.V Kabell AL i tensionit te ulet NA2XY S=4x16mm2 | ml | 3,944 | 232 | 914,377 | 0.3 | 1183.2 | 0 | |
| 1 | 12 | 2.481/5 | F.V Percjelles bakri i izoluar per tokezimin e shtyllave S=10mm2 | ml | 176 | 116 | 20,402 | 0.07 | 12.32 | 0 | |
| 2 | 13 | AN | F.V Kapikorde CU D.10 M10 | cope | 176 | 35 | 6,209 | | 0 | 0 | |
| 3 | 14 | An7 | F.V Tub plastik dyshtresor me diameter d=63mm | ml | 3,400 | 85 | 289,000 | 0.12 | 408 | 0 | |
| 4 | 15 | An-6 | F.V Tub plastik I ngurte d=250mm per bazamentet e shtyllave | ml | 136 | 840 | 114,240 | 0.3 | 40.8 | 0 | |
| 5 | | | **Shuma IV** | | | | **10,492,317.04** | | 5882.25 | 738.4 | |
| 6 | | | **Shuma I-IV** | | | | **25,000,922.92** | | 735.28125 | 92.3 | |
| 7 | | | **20% T.V.SH** | | | | **5,000,184.58** | | 30 | 30 | dite pune |
| 8 | | | **TOTALI** | | | | **30,001,107.50** | | 24.509375 | 3.0766667 | |
| 9 | | | | | | | | | | | |

Sipas procesverbalit nr. 2, datë 12.5.2017 me datë 12.05.2017 në orën 10.$^{\underline{00}}$ për paraqitjen e mostrave për çdo shtyllë dhe ndriçues të parashikuar në preventiv, ku është paraqitur vetëm subjekti "E.....L"

Nuk ka një procesverbal për hapjen e ofertave nga KVO-ja, por nga Raporti Përmbledhës i KVO-së rezulton se ato janë hapur në datë 12.05.2017, ora 10:00. Sipas këtij raporti kanë marrë pjesë në procedurë 3 OE/ BEO.

Vlerësimi i ofertave është bërë me datë 8.5.2017 dhe dërguar për njoftim tek subjektet pjesëmarrës. Sipas këtij raport nga 3 OE/ BEO pjesëmarrës, janë Skualifikuar 2 të cilët për nga vlera është më e ulët se OE i shpallur fitues "E.....L" me ofertë ekonomike 24,949,484 lekë, *konkretisht*:

Shoqëria "**S.....K**" është Skualifikuar për këto mangësi**:** *Nuk plotëson kriterin e punonjësve me dëshmi kualifikimi, prej 4 punonjësit, pasi ka paraqitur vetëm 3 veta; -Nuk paraqet pune të ngjashme; -Nuk paraqet dokumentacion për autovinç (mungon leja qarkullimit, siguracioni dhe kolaudimi i mjetit).*
Nga verifikimi rezulton se këtë mjet subjekti e ka paraqitur të shoqëruar me gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe për të cilën pretendohet se nuk është *paraqitur në ditën dhe orën e caktuar për prezantimin e Produkti.*
Shoqëria "**J.....I + S.....R**" është Skualifikuar për këto mangësi**:** -*Subjekti "A.....R" nuk ka paraqitur vërtetim për taksat vendore 2017; -Nuk paraqet pune të ngjashme, sipas pikës 1/a; -Nuk është paraqitur në ditën dhe orën e caktuar për prezantimin e produkti;*
Nuk rezulton të ketë patur ankesa për procesin e vlerësimit.

Raporti Përmbledhës dhe Njoftimi i Fituesit janë bërë në datë 08.5.2017 (10 ditë nga data e mbylljes së ri-vlerësimit). Kontrata dhe Formulari i Njoftimit të Kontratës janë të datës 29.5.2017, kurse në Buletin është publikuar më datë 5.6.2017 (nr. 22).

**Shqyrtimi i dokumenteve të operatorit fitues.** Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin app dhe dosje n e shoqërisë "**E.....L**", konstatohet se nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:
*a- Nuk paraqet grafikun e punimeve, sipas pikës 2.2/H të DST.*
***b-*** *Nga 4 elektricistë që kërkohen sipas pikës 2.2/F të DST, ku thuhet se "OE duhet të ketë të stafin e tij punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të lëshuar nga ISHTI ose institucione të tjera ekuivalente të akredituara,* ***kontrata pune të vlefshëm*** *si dhe të figuroje në listpagesës e shoqërisë (4 punonjës). Nga shoqëria janë paraqitur 4 elektricist me kontratë pune (P. K me kontrata datë 4.4.2017, A. O me kontratë datë 4.01.2017, E. K me kontratë 4.4.2017 dhe M. D me kontratë 4.01.2017). Në verifikimin e listëpagesave, rezulton se vetëm dy prej tyre janë të regjistruar (A. O me*

*kontratë datë 4.01.2017 dhe M. D me kontratë 4.01.2017), ndërsa dy elektricistët e tjera nuk janë të regjistruar (P. K me kontrata datë 4.4.2017, A. O me kontratë datë 4.01.2017 dhe E. K me kontratë 4.4.2017).* ***Në këto kushte ky kriter nuk është plotësuar.***

**Konkluzioni:** Duke patur parasysh se, AK-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE të tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave në DST, si edhe faktin që në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, gjykojmë se vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e OE "E.....L" me ofertë ekonomike 24,949,484 lekë pa TVSH, nuk është i Drejtë dhe duhet të ishte Skualifikuar, siç është vepruar dhe me OE të tjerë.

Në këtë rast në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk plotësojnë kërkesat e DST, procedura duhej anuluar ose midis operatorëve me mangësi (të cilat mund të klasifikohen dhe si devijime të vogla, si subjekti "S.....K"), të vlerësohej kriteri kryesor "*çmimi i leverdishëm*", duke lejuar përdorim me efekt negativ të fondeve publike në **vlerën 6,430,849 lekë,** në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55**,** veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: anëtarët e KVO i përbërë nga: A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë, J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit dhe T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet e paraqitura nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje mos plotësimin e kritereve nga shoqëria "E.....L" sipas grupit të auditimit të KLSH, sqarojmë se nuk janë argumentuar nga KVO, pasi në listëpagesat respektive të trajtuara në material dy elektricist nuk janë të siguruar. Gjithashtu nga subjekti mungon grafiku i punimeve, ku në procedura të tjera është përdoru si kriter s'kualifikues.* ***Argumentet nuk qëndrojnë****.*

**29- Tenderi me objekt:** *"Shtrim me bar sintetik i minifushës së futbollit"*, me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "*Shtrim me bar sintetik i minifushës së futbollit D.....At i Ri për vitin 2016*"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 89, datë 7.9.2015<br>**2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 89, datë 7.9.2015<br>P. Th. me detyrë P/sek. prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>D. XH me detyrë specialiste në zyrën e prokurimeve (Ing) | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 90. dt. 7.9.2015<br>A. M. me detyrë Zv/Kryetar Bashkis;<br>A. M. me detyrë Dre. PZHT.<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>3,336,000 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "2.....N" me ofertë **3,330,000 lekë** me kontratë nr. 4760, dt. 22.10.2015 me afat 15 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>6 mijë lekë ose 0.17 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 18.9.015 ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Buxheti Shtetit | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **3** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. ----, dt. ----;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ---, dt. ------ | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-** Me vendim të Këshillit Bashkiak Orikum nr. 9, datë 30.4.2015 është vendosur pakësim i fondit të objektit: *"Ndërtim i rrugës lagjja Kodër" nga vlera 3,807 mijë lekë parashikuar në muajnë prill 2015 dhe transferuar e kësaj shume në muajnë maj 2015.*
*Shtim grup 00. Prog 0430 kapitulli 5. Artikulli 231 në shumën 3,807 mijë lekë (ndërtim tapeti i fushës së minifuitbollit D.....At i Ri).*
Ky vendim është konfirmuar dhe nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2138, datë 7.5.2015 dhe bërë shtesë në regjistrin e prokurimeve me shkresën nr. 840, datë 18.5.2015, adresuar app.

Me vendim të KM nr. 525, datë 27.9.2017 është miratuar fondi për objektin *"Skema ujitëse, rezervuar Kallafe, Sherishtë, Kaninë, Alikokë"* (prot Bashkia Vlorë nr. 9009, datë 29.9.2017), me vlerë 10,000,000 lekë.
Preventivi është hartuar nga shoqëria "G.....L" me përfaqësues ligjor Ing. G. S dhe Ing. L. H në vlerën 11,340,580 lekë me TVSH, ku në përllogaritjen e çmimeve është marrë për bazë VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizës teknike të tyre".

**B-**Më datë 11.8.2017, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

**C- Zhvillimi procedurës.** Me shkresën nr. 4201, datë 6.10.2015 është hartuar raporti përmbledhës i cili është miratuar nga ana e titullarit të AK, mbi procedurën e ndjekur. Sipas këtij raporti, konstatohet se kanë marrë pjesë në procedurë 4 (katër) OE.
Sipas të dhënave të KVO, rezulton se dokumentacion teknik e ligjorë i paraqitur nga OE pjesëmarrës janë kualifikuar 2 OE dhe janë Skualifikuar 2 OE.
*OE e Skualifikuar sipas KVO kanë këto mangësi:*

**1-Operatori "C.....M "** me ofertë ekonomike 2,880,000 lekë pa TVSH.
*-Në licencat e paraqitura mungon kategoria NS-10; -Nuk është paraqitur mjet traktor me furçë.*

**2-Operatori** "**S.....K** " me ofertë ekonomike 2,925,000 lekë pa TVSH.
*-Nuk disponon kategoritë e licencës; -Nuk paraqet kontratën për punimet e ngjashme; -Nuk është paraqitur mjet traktor me furçë.*

Më datë 28.9.2015 është bërë vlerësimi i dokumentacionit nga KVO, ku si fitues është shpallur OE "2.....N" me ofertë ekonomike 3,330,000 lekë pa TVSH, me ofertë ekonomike më të lartë se operatorët e Skualifikuar.
Me shkresën nr. 4202, datë 6.10.2015 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit, shpallur në buletinin nr. 40, datë 12.10.2015. Me shkresën nr. 4760, datë 22.10.2015 është bërë njoftimi i APP mbi fituesin.

**Shqyrtimi i procedurës.** Nga verifikimi në sistem dhe në dokumentacionin në dosjen e subjektit fitues, mbi procedurën e ndjekur nga KVO për shpalljen fitues të OE "2.....N" me ofertë ekonomike 3,330,000 lekë pa TVSH, konstatohet se dhe ky OE nuk i plotëson kriteret e DST dhe nuk duhej të ishte shpallur fitues, konkretisht:
*a-Nuk është paraqitur vërtetimi nga administrata tatimore për numrin e punonjësve për periudhën janar – dhjetor 2014, por është paraqitur vetëm për periudhën janar – korrik 2015. Sipas pikës "D" të DST; b- Ing. Ndërtimit K. D me kontratë pune nr. 728/452, datë 15.6.2014 dhe afat 5 vjet, nuk është*

*siguruar për kohën e plotë gjatë gjithë periudhës, pasi vetëm në muajnë maj, qershor dhe korrik 2015 është siguruar për 22 ditë pune, ndërsa në muajt e tjerë janar – dhjetor 2014 dhe janar prill 2015 varjon nga 2 deri në 3 ditë pune; Gjithashtu Ing. Gjeodet A. L me kontratë nr. 2063/1029, datë 22.10.2010 për muajit shkurt – korrik 2015 nuk rezulton në listpagesës e shoqërisë, dhe për muajt e tjerë nuk është siguruar për kohën e plotë gjatë gjithë periudhës. Kështu në muajnë janar – dhjetor 2014 dhe janar 2015 varjon nga 2 deri në 3 ditë pune;*
*c-Nuk paraqet punime të ngjashme, pasi kontrata datë 7.10.2014 që ka paraqitur me ish-Komunën Hore-Vranisht" përfaqësuar nga S. P dhe JV "2.....N + J.....I" për objektin: "Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Hore-Vranisht, Komuna Vranisht" në vlerën 38,015,646 lekë, nuk përputhet me objektin e prokurimit, kjo se referuar situacionit të punimeve në asnjë zë nuk korrespondon me zërat e objektit të prokuruar nga Bashkia Vlorë. Gjithashtu në këtë kontratë ka qenë JV, dhe nuk pasqyrohet asnjë dokument se sa është përqindja e punëve për secilin subjekt.*
**Konkluzioni:** Duke patur parasysh se, AK-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE të tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave në DST, si edhe faktin që në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, gjykojmë se vendimi i marrë nga KVO për kualifikimin e OE "2.....N" me ofertë ekonomike 3,330,000 lekë pa TVSH, nuk është i Drejtë dhe duhet të ishte Skualifikuar, siç është vepruar dhe me OE të tjerë.
Në këtë rast në kushtet kur asnjë nga OE pjesëmarrës nuk plotësojnë kërkesat e DST, procedura duhej anuluar ose midis operatorëve me mangësi (të cilat mund të klasifikohen dhe si devijime të vogla, si subjekti "C.....M"), të vlerësohej kriteri kryesor "*çmimi i leverdishëm*", duke lejuar përdorim me efekt negativ të fondeve publike në **vlerën 450,000 lekë,** në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55**,** veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: anëtarët e KVO i përbërë nga: A. M. me detyrë Zv/Kryetar Bashkis; A. M. me detyrë Dre. PZHT dhe T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet e paraqitura nga anëtarët e KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje mos plotësimin e kritereve nga shoqëria "2.....N" sipas grupit të auditimit të KLSH, sqarojmë se nuk janë argumentuar nga KVO me dokumentacion ligjore, kështu:*
*Nga KLSH është konstatuar mos paraqitja e vërtetimit të numrit të punësuarave dhe jo mos paraqitja e listpagesave.*
*Në lidhje me mos plotësimin e kontratave të ngjashme, argumentet e paraqitura nuk shpjegojnë mangësinë e konstatuar nga grupi i KLSH, pasi situacionin i paraqitur nuk i përket kësaj kontrate dhe për më tepër vlerat e këtyre zërave që ju paraqisni nuk plotësojnë nivelin e të ardhurat prej 40 % të vlerës së fondit limit.* ***Argumentet nuk qëndrojnë****.*

**30. Tenderi me objekt**: *"Rehabilitim i rrugëve Ramize Gjebrea – Gjon Bocari, Loti I", Bashkia Vlorë"*

| **a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Rehabilitim i rrugëve Ramize Gjebrea – Gjon Bocari, Loti I", Bashkia Vlorë" | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr.240, datë 26.09.2016 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër nr.240, datë 26.09.2016 | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër nr.248, datë 28.09.2016 |

| | | |
|---|---|---|
| **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | P. TH, Jurist<br>A. SH Ekonomiste<br>D. XH Ing. Ndërtimi | A. M., me detyrë Zv/Kryetar Bashkie Kryetar<br>F. D me detyrë Drejt. Shërbimeve Publike.<br>T. Z. me detyrë Drejt Financiar |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>67,037,038 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>Subjekti "B.....3" me vlerë 49,494,900 lekë. Kontrata nr. 9177, datë 03.11.2016 dhe afat përfundimi 12 ditë (ose 4 muaj).<br>6.1. Shtesë kontrate nr. 4547, dt. 30.5.2017 në shumën 9,861,951 lekë, me afat 15 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>**17,543** mijë lekë ose 26% |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>19.10.2016, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>GRANDE (buxhet shteti) | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **5 OE**<br>b) Skualifikuar: **3** OE<br>c) Kualifikuar: **2** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK-** nr. 7425/29.9.2016; nr. 7831/5.10.2016; nr. 30.9.2016; nr. 8397/10.1.0.2016; **APP**–s'ka; **KPP**-ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. 7425/1, dt. 5.10.2016; nr. 783/1, dt. 5.10.2016; nr. 2180/1, dt. 7.10.2016 dhe nr. 8397/1, dt. 12.10.2016 | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

**A-**Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: E. M në vlerën 67,037,038 lekë (pa TVSH). Nga NJP nuk është mbajtur asnjë procesverbal mbi përllogaritjen e këtij fondi nëse është sipas çmimeve të manualit apo jo.

**B-Hartimi i dokumenteve të tenderit.** Më datë 26.09.2016, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në sqarimet që jepni në lidhje me problemet e konstatuara, paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga anëtarët e NJP, janë argumentuar shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH në lidhje me kategorinë e licencës dhe kriteret për pajisjet mbrojtëse dhe ndihmëse, të cilat gjejnë zbatim të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 dhe udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin***.**

Në lidhje me vendosjen e kritereve, nga OE të ndryshëm janë bërë ankesa, si vijon: Me datë 29.09.2016 OE "A.....I"; -Me datë 28.09.2016 OE "A....O"; -Me datë 30.09.2016 OE "H....K"; -Me datë 10.10.2016 OE "H.....I" në lidhje me rëndimin e kritereve në DST. Në përgjigjen e dhënë nga AK (Bashkia Vlorë) me shkresën nr. 8397/1, datë 12.10.2016, **nuk është marrë** në konsideratë ankesa e OE, ku nga NJP është mbajtur procesverbali nr. 2, datë 12.10.2016 në të cilën sqarohet se asnjë nga ankesat e OE nuk janë të argumentuara dhe nuk kundërshtojë kriteret e DST, pasi janë të mbështetura në LPP dhe VKM nr. 42.

Vihet re që procesverbalet e NjP-së nuk janë protokolluar. Sjellim në vëmendje se, në përputhje me nenin 18, "Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", duhet të bëhet protokollimi i të gjithë procesverbaleve.

Konstatohet se për shqyrtimin e ankesave nga Titullari i AK, **nuk është** ngritur grupi i shqyrtimit të ankesave, por i është lënë përsëri NJP e cila ka hartuar ato, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, kreu X-*Shqyrtimi i ankesave*, neni 78, pika 2, dhe pika 6- *Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm***.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në argumentet që paraqiten nga grupi i anëtarëve të NJP me shkresën nr. 1545/1, datë 5.3.2018, nuk sqarohet problemi i mos ngritjes së komisionit të shqyrtimit të ankesës, pasi nuk mund që i njëjti komision që ka bërë kriteret si rivlerësojë ankesat, veprim në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014, kreu X-Shqyrtimi i ankesave, neni 78, pika 2,.* ***Pretendimi nuk qëndron.***

**31. Tenderi me objekti**: *"Lyrje shkolla e kopshte në Bashkinë Vlorë, viti 2016"*

| Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "***Lyrje shkolla e kopshte në Bashkinë Vlorë, viti 2016, viti 2016***"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 198, datë 29.7.2016<br>**2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 198, datë 29.7.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH dhe detyrë Drejt. Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë.<br>D. XH me detyrë Specialist Drejtoria e Infrastrukturës | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 199. dt. 29.7.2015<br>A. M. me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>F. D me detyrë Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>6.500.235 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "C....O " me ofertë 4.072.890 lekë me kontratë 7078, datë 30.8.2016 afat 60 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>2,428 mijë lekë ose 37.3 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 10.08.2016, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE<br>b) Skualifikuar 0 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **4** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. --, dt. -----;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------, dt. --------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-**Preventivi është hartuar nga Ing. D. XHj për vlerën 6,500,235 lekë pa TVSH, sipas çmimeve të manualit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në argumentet që paraqiten nga grupi i anëtarëve të NJP me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), është sqaruar fakti se kjo procedurë rezulton në regjistrin e prokurimeve, ku paraqitet në nr. 42 të regjistrit të parashikimeve të vitit 2016.* ***Pretendimi merret në konsideratë.***

**B-**Më datë 19.5.2016, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

**32- Tenderi me objekt:** *"Rikonstruksion i rrugëve Xhelbro Gjika, Veledin Kollozi dhe i bllokut të banimit mbas Conadit (faza e I), Bashkia Vlorë", viti 2016"*, me këto të dhëna:

| a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **:** "*Rikonstruksion i rrugëve Xhelbro Gjika, Veledin Kollozi dhe i bllokut të banimit mbas Conadit (faza e I), Bashkia Vlorë", viti 2016*" | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 222, datë 08.09.2016<br>**2. Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 222, datë 08.09.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist);<br>D. XH me detyrë spec në Drej.Infrast dhe | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 223. dt. 08.09.20165<br>A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>F. D me detyrë Drejt. Infrastruk dhe zhvillim projektesh;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |

| | | |
|---|---|---|
| | Zhvillimit të Projekti | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>81,142,684 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "A.....J " me ofertë **64,030,710 lekë** me kontratë nr. 9211, dt. 03.11.2016 me afat 88 ditë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>17,112 mijë lekë ose 21.9 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 04.10.2016, ora 10.$^{\underline{00}}$ | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e Bashkisë Vlorë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **7** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **5** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **2** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- *nr. 7425, dt. 14.9.2016; nr. 7438, dt. 14.9.2016; nr. 7468, dt. 15.9.2016 dhe nr. 7715, dt. 26.9.2016*;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. *nr. 7425/1, dt. 26.9.2016; nr. 7438/1, dt. 26.9.2016; nr. 7468/1, dt. 26.9.2016 dhe nr. 7715/1, dt. 26.9.2016* | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-**Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: Ing. E. A me detyrë Drejtor i PZHT dhe D. H për vlerën e projektit prej 81,142,684 lekë (pa TVSH), i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK.

**B- Hartimi i DT**: Me procesverbal datë 08.09.2016 nga anëtarët e njësisë së prokurimit (NJP), bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ka hartuar dokumentet e tenderit sipas procesverbalit të mbajtur dhe njoftimit të kontratës së bashku me një kopje të DT dhe janë hedhur ne sistemin elektronik ne faqen e APP.

Me procesverbal datë 19.09.2016 në referencë të kërkesave të DST, me datë 04.10.2016 dhe datë nga përfaqësuesit e Bashkisë Vlorë P. TH, D. XHj dhe A. SH kanë qenë prezent në orën 10.$^{\underline{00}}$ në sheshin e objektit *"Rikonstruksion i rrugëve Xhelbro Gjika, Veledin Kollozi dhe i bllokut të banimit mbas Conadit (faza e I), Bashkia Vlorë"* në pritje të subjekteve që mund të kenë gjykuar për të kryer vizitë, ku janë paraqitur 4 OE; "A.....I", "B.....3", "A.....n", "R.....A", "J.....y", "B.....S", "SH.....I" dhe 'A.....J".

*a-Është kërkuar që vërtetimi i taksave vendore të shoqërohet me mandat pagesa, kërkesë kjo e fryrë dhe paargumentuar, pasi ekzistenca e vërtetimit është mëse e mjaftueshme, siç kërkohet dhe për vërtetimi i pagesës së energjisë elektrike.*

*b-Shoqërimi i listëpagesave me formularët e pagimit të pagesave është një kërkesë e fryrë, pasi paraqitja e formularë ESIG 25 të konfirmuara nga administrata tatimorë është mëse e pranueshme dhe listëpagesave.*

*c-Vërtetimi i lëshuar nga Njësia Administrative (NJA) është i panevojshëm, pasi me riorganizimin e pushtetit vendore të drejtën e lëshimit të dokumenteve zyrtare e ka vetëm Bashkia qendrore dhe jo NJA, kriter ky i ekzagjeruar.*

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP i përbërë nga P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), A. SH me detyrë Drejt/Shëndetit Publik dhe mbrojtjes (ekonomist) dhe D. XH me detyrë spec në Drej.Infrast dhe Zhvillimit të Projekti.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në sqarimet që jepni në lidhje me problemet e konstatuara, paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga anëtarët e NJP, mbi vendosjen e kritereve në kundërshtim me ligjin, ju bëjmë me dije se argumentet e paraqitura nuk janë bindës dhe mbështetur në ligj, pasi: Në lidhje me kriteret për faturat shoqërues të taksave vendore dhe formularët e pagimit të pagesave të sigurimeve shoqërore është ekzagjeruar dhe*

*të fryra, pasi paraqitja e vërtetimit të pagesës dhe listpagesave është dokument tërësisht ligjore dhe bindës për subjektin pjesëmarrës.* ***Pretendimi juaj nuk qëndron.***

Nga verifikimi i dosjes, konstatohet se disa nga OE kanë bërë ankesa në lidhje me kriteret e vendosura nga NJP, të cilat po i trajtojmë më poshtë vijon: - **Subjekti "A.....J"** ka bërë ankesë sipas formularit (shtojca 19) datë 14.9.2016 (prot subjekt nr. 7425, dt. 14.9.2016); - **Subjekti "B.....3"** ka bërë ankesë sipas formularit (shtojca 20) datë 13.9.2016 (prot subjekt nr. 7438, dt. 14.9.2016).
Me shkresën nr. 7438/1, datë 26.09.2017, AK Bashkia Vlorë kthen përgjigje subjekti se asnjë nga kërkesat nuk merret në konsideratë.
**Subjekti "A....O K.....N"** ka bërë ankesë sipas formularit (shtojca 20) datë 14.9.2016 (prot subjekt nr. 7468, dt. 15.9.2016); **-Subjekti "R.....A"** ka bërë ankesë sipas formularit NR. 92 datë 20.9.2016.
Me shkresën nr. 7715/1, datë 26.9.2016, AK Bashkia Vlorë kthen përgjigje subjekti se asnjë nga kërkesat nuk merret në konsideratë.
Me procesverbal datë 26.09.21016 të mbajtur në Bashkinë Vlorë, NJP thekson se asnjë nga OE që kanë bërë ankesë nuk kanë të drejtë në kërkesat e tyre dhe se asnjë prej tyre nuk është ankuar në APP mbi këto kritere, duke qenë dakord me vendimmarrjen e Bashkisë Vlorë, në rolin e AK.

Në ankimimit e OE mbi kërkesat megjithëse nga AK janë bërë sqarimet, disa prej tyre duhet të ishin marrë në konsideratë për ndryshimin e tyre kjo për të rritur numrin e pjesëmarrësve në procedura, pasi janë të rënduara dhe nuk janë përdorur në procedura të tjera të së njëjtës natyrë me vlera të njëjta ose të ndryshme, procedura të cilat janë trajtuar në akt-konstatimet e mbajtur nga grupi i KLSH, konkretisht; *Vendosja e "arkitekti" dhe kategori së licencës NP-12B.*
Ky kritere si dhe ato për të cilat jemi shprehur në fillim janë të paargumentuara dhe mbështetje ligjore, duke ndikuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve në tender, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP.

Konstatohet se për shqyrtimin e ankesave nga Titullari i AK, **nuk është** ngritur grupi i shqyrtimit të ankesave, por i është lënë përsëri NJP e cila ka hartuar ato, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, kreu X-*Shqyrtimi i ankesave*, neni 78, pika 2**.**

**C-Zhvillimi i procedurës së prokurimit:** Sipas Raportit përmbledhës nr. 8856, datë 25.10.2016, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 7 BOE/OE.
Me datë 18.10.2016 është bërë vlerësimi në sistem nga anëtarët e KVO dhe dërguar njoftim fituesit, ku nga 7 OE/BOE pjesëmarrës janë kualifikuar për vlerësim 5 OE/BOE dhe fitues është shpallur **OE "A.....J" me ofertë 64,030,710 lekë (pa TVSH)**, i cili plotëson kriteret sipas KVO dhe kriterin kryesor *"Çmimi anomalish më i ulët"* se operatorët e tjerë pjesëmarrës të kualifikuar ose jo.
**Konkluzioni:** Nga verifikimi i dokumentacion në lidhje me shpalljen fitues të OE "A.....J", konstatohet se KVO ka vepruar në përmbushje të kërkesave të DST dhe dispozitave ligjore të LPP **.**

**33. Tenderi me objekt**: *"Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruga T. Jonuzi, Demokracia, J. Kilica, etj., viti 2017"*

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "Rikualifikim i bllokut kufizuar nga rruga T. Jonuzi, Demokracia, J. Kilica, etj., viti 2017"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 328, datë 13.12.2016 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 328, datë 13.12.2016<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 329. dt. 13.12.2016<br>A. M me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>F. D me detyrë Drejt. I Zhvillimit të Projekteve; |
| **2. Lloji i Procedurës -"***HAPUR*" | | |

| | | |
|---|---|---|
| | A. SH me detyrë Drejt. Shëndetit Publik dhe Mbrojtjes;<br>J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit | T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>26,700,425 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "C....O " me ofertë 17,595,826 lekë me kontratë nr. 749, dt. 30.01.2017 me afat 90 ditë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>9,105 mijë lekë ose 34% |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 06.01.2017, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>**a)**Pjesëmarrës në tender **11** OE/BOE<br>b) Skualifikuar 10 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK-** nr. --, dt. -----;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. -------, dt. --------- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

Kontrata është nënshkruar më datë 30.01.2017 dhe Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar është i datës 30.01.2017 me nr. 749, datë 30.01.2017.

**A-**Nga auditimi dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se preventivi është hartuar nga specialistët e Bashkisë Vlorë: Ing. E. A me detyrë Drejtor i PZHT dhe D. H për vlerën e projektit prej 26,700,425 lekë (pa TVSH), i cili është miratuar nga ana e Titullarit të AK.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në sqarimet që jepni në lidhje me problemet e konstatuara, paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga anëtarët e NJP, janë argumentuar shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH në lidhje me kategorinë e licencës dhe kriteret për pajisjet mbrojtëse dhe ndihmëse, të cilat gjejnë zbatim të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 dhe udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin***.**

**34. Tenderi me objekt**: *"Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Ismail Qemali", "Rruga Hasan Kushta", "Rruga Gjergj Araniti" dhe "Bulevardi Gjergj Kastrioti"*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "***Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Ismail Qemali", "Rruga Hasan Kushta", "Rruga Gjergj Araniti" dhe "Bulevardi Gjergj Kastrioti""* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 33, datë 07.3.2017<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 33, datë 07.3.2017<br>P. TH *Jurist*<br>A. SH *Ekonomiste*<br>E. A *Ing. Ndërtimi* | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 34, datë 07.3.2017<br>A. M Kryetar<br>F. D Anëtar<br>T. Z. Anëtar |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>141,512,090 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>97.600.000 lekë | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>43.912.090 lekë |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>31.3.2017, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Buxheti i shtetit | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **9 OE**<br>b) Skualifikuar: **6** OE<br>c) Kualifikuar: **3** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK-** s'ka; **APP**–s'ka; **KPP- s'**ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

Me Vendimin nr. 8, datë 13.2.2017 të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve (KZhR), është miratuar financimi i projektit "Rikualifikim urban i sheshit Livadhja", në shumën 42,019,247 lekë (planifikuar e

gjitha për vitin 2017), ku me shkresën nr. 2456/3, datë 06.03.2017 të Ministrisë së Financave i njoftohet Bashkisë Vlorë çelja e këtij fondi.
Me urdhrin e prokurimit nr. 33, datë 07.3.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, caktohet Njësia e Prokurimit për zhvillimin e tenderit me objekt: *"Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Ismail Qemali", "Rruga Hasan Kushta*", *"Rruga Gjergj Araniti" dhe "Bulevardi Gjergj Kastrioti"*, me fond limit 141,512,090 (*njëqind e dyzetë e një milionë e pesëqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë*) lekë pa TVSH.
Me urdhrin nr. 34, datë 07.3.2017 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, caktohet Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO). Më datë 07.3.2017, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.
Nuk ka një procesverbal për hapjen e ofertave nga KVO-ja.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në argumentet që paraqiten nga KVO me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), është argumentuar fakti i hapjes së procedurës sipas afateve ligjore, ku argumentohet se: Nuk qëndron ky konstatim dhe po japim pamje të raportit që gjenerohet nga sistemi për të provuar se kur është kryer veprimi në sistem nga secili prej anëtarëve të KVO.*

| Opening details | | |
|---|---|---|
| Tender type | Procurement officer | Opening date |
| Final Tender | Fatjon Devollaj | 3/31/2017 10:53 AM |
| | Taulla Zanaj | 3/31/2017 10:55 AM |
| | Adrian Musta | 3/31/2017 10:55 AM |

| Evaluation details | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Offers | | | |
| Tender: | OFFER-6345/28032017 | "SHKELQIMI 07" | Score | Evaluation Date |
| Evaluation type: | Participation criteria | | | |
| Criterion type: | Personal Situation | | | |

*Nga kjo foto duket qartë se hapja e ofertave është kryer në datën 31.03.2017 respektivisht në orët 10.53 AM, 10.55AM, 10.55 AM.*
*Ne lidhje me konstatimin e dyte për këtë pike, sqarojmë se nuk ka asnjë vlerësim te dyte për këta operatore, pasi për pasoje do te gjeneroheshin nga sistemi dy raporte, ndërkohë që gjenerohet vetëm.* ***Pretendimi juaj merret ne konsideratë****.*

**35. Tenderi me objekti**: *"Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Çamëria", "Pelivan Leskaj", "Bulevardi Pavarësia, "K. B-P. S"*

| Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "***Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Çamëria", "Pelivan Leskaj", "Bulevardi Pavarësia, "K. B-P. S"* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 172, datë 11.8.2017 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 172, datë 11.8.2017<br>P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH dhe detyrë Drejt. Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë.<br>A. M. me detyrë Drejtor i PZHT. | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 173. dt. 11.8.2017<br>A. M. me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>F. D me detyrë Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **2. Lloji i Procedurës -"***Hapur*" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>76,090,881 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "SH..... 07 " me ofertë 49,000,020 lekë me kontratë 9602, datë 18.10.2017 dhe afat 120 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>30,090 mijë lekë ose 39.5 % |

| | | |
|---|---|---|
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 11.9.2017, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>KZHR | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender **12** OE/BOE<br>b) Skualifikuar 6 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **6** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK-** nr. , dt. ---;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ---, dt. ------ | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-** Me vendim të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve (KZHR) nr. 12, datë 21.3.2017 është miratuar fondi për objektin *"Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Çamëria", "Pelivan Leskaj", "Bulevardi Pavarësia, "K. B-P. S"* (prot Bashkia Vlorë nr. 2524, datë 29.3.2017), me vlerë 79,814,507 lekë, nga e cila financim për vitin 2017 në vlerën 39,907,254 lekë.
Preventivi është hartuar nga specialistët e Drejtorisë së PZHT Ing. E. A, dhe D. H. në vlerën 76,090,881 lekë me TVSH, ku në përllogaritjen e çmimeve është marrë për bazë VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizës teknike të tyre".

**B-**Më datë 11.8.2017, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.
Vihet re se, në vendosjen e disa kritereve NjP nuk ka argumentuar si duhet arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", konkretisht:

*a-Shoqëritë duhet që vërtetimin e taksave lokale të vitit 2017 të jetë i shoqëruar me mandat pagesë, kërkesë kjo e ekzagjeruar, pasi vërtetimi është mëse i mjaftueshëm dhe dokument ligjore (pika 2.2/d e DST).*

*b-Paraqitja e formularëve të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore është ekzagjeruar, pasi është mëse e mjaftueshme listpagesës dhe vërtetimi që nuk kanë detyrime për sigurimet shoqërore lëshuar nga administrata përkatëse;*

Sa më sipër, për përcaktimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, është vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c, duke shkaktuar pabarazi të operatoreve ekonomikë, **ç**`ka ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar, A. SH dhe detyrë Drejt. Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë dhe A. M. me detyrë Drejtor i PZHT.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet e dhëna nga NJP në lidhje me vendosjen e kritereve, paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nuk qëndrojnë ku një pjesë e shpjegimeve janë dhënë në tenderin me objekt "Rehabilitim i rrugëve Ramzie Gjebrea – Gjon Bocari, Loti I, Bashkia Vlorë".*
*Ndërsa në lidhje vendosjen e kategorive të licencave NP-4C dhe NP-12B, janë argumentuar të cilat gjejnë zbatim të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 dhe udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin.* ***Pretendimi juaj qëndron pjesërisht.***

**36. Tenderi me objekti**: *"Skema ujitëse, rezervuar Kallafe, Sherishtë, Kaninë, Alikokë"*

| **Zhvillimi i Procedurës me objekt : "***Skema ujitëse, rezervuar Kallafe, Sherishtë, Kaninë, Alikokë"* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 199, datë 23.10.2017 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 172, datë 11.8.2017 | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 199. dt. 23.10.2017 |

| | | |
|---|---|---|
| **2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar<br>A. SH dhe detyrë Drejt. Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë.<br>A. M. me detyrë Drejtor i PZHT. | A. M. me detyrë Zv/Kryetar Bashkisë,<br>F. D me detyrë Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve;<br>T. Z. me detyrë Drejt. Menaxhimit Financiar. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>11,340,580 lekë<br>Vlera prej 10,000,000 lekë do financohet nga buxheti shtetit | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "L.....I + C....O " me ofertë 7,541,227 lekë me kontratë 10789, datë 21.11.2017 dhe afat 45 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>3,799 mijë lekë ose 33.5 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 3.11.2017, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Buxheti Shtetit + të ardhurat e bashkisë | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE<br>b) Skualifikuar 2OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **2** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK-** nr. , dt. ---;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP-**s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ---, dt. ------ | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**A-** Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 27.9.2017 është miratuar fondi për objektin *"Skema ujitëse, rezervuar Kallafe, Sherishtë, Kaninë, Alikokë"* (prot Bashkia Vlorë nr. 9009, datë 29.9.2017), me vlerë 10,000,000 lekë.
Preventivi është hartuar nga shoqëria "G.....L" me përfaqësues ligjor Ing. G. S dhe Ing. L. H në vlerën 11,340,580 lekë me TVSH, ku në përllogaritjen e çmimeve është marrë për bazë VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizës teknike të tyre".

**B-**Më datë 11.8.2017, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.
Vihet re se, në vendosjen e disa kritereve NjP nuk ka argumentuar si duhet arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", konkretisht:
*a-Kërkesa nga NP se shoqëritë duhet që vërtetimin e taksave lokale të vitit 2017 të jetë i shoqëruar me mandat pagesë, është një kërkesë e ekzagjeruar, pasi vërtetimi është mëse i mjaftueshëm dhe dokument ligjore (pika 2.2/d e DST).*
*b-Paraqitja e formularëve të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore është ekzagjeruar, pasi është mëse e mjaftueshme listpagesës dhe vërtetimi që nuk kanë detyrime për sigurimet shoqërore lëshuar nga administrata përkatëse;*
Sa më sipër, për përcaktimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, është vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, Neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa a, b dhe c, duke shkaktuar pabarazi të operatoreve ekonomikë, ç`ka ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga P. Th. me detyrë P/sek. Prokurimeve (jurist), Kryetar, A. SH dhe detyrë Drejt. Drejtoria e shëndetit publik dhe Mbrojtjes konsumatorë dhe A. M. me detyrë Drejtor i PZHT.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet e dhëna nga NJP në lidhje me vendosjen e kritereve, paraqitur me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), gjejnë argument disa prej tyre të cilat nuk janë pasqyruar në Raportin Përfundimtar dhe sqarimet janë paraqitur në tenderin me objekt "Rehabilitim i rrugëve Ramzie Gjebrea – Gjon*

*Bocari, Loti I, Bashkia Vlorë" dhe "Rikualifikim i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Çamëria", "Pelivan Leskaj", "Bulevardi Pavarësia, "K. B-P. S". Është argumentuar kriteri i 5 manovratorë dhe vërtetimin e përvojës së mëparshme veç të tjerash është kërkuar paraqitja edhe e aktit të marrjes ne dorëzim* ***Pretendimi juaj qëndron pjesërisht****.*

**Shqyrtimi i procedurës.** Nga verifikimi në sistem dhe në dokumentacionin në dosjen e subjektit fitues, mbi procedurën e ndjekur nga KVO për shpalljen fitues të OE "L.....I + C....O" me ofertë ekonomike 7,541,227 lekë pa TVSH, konstatohet se procedura e ndjekur është në zbatim të dispozitave të LPP**.**

*(Gjerësisht problemet e mësipërme janë trajtuar në faqet 96-177, të Projekt raport Auditimit)*

- **Auditimi i procedurave të prokurimit në ish-Komunën Qendër Vlorë (sot NJA Qendër, Bashkia Vlorë).**

Nga ana e Autoritetit Kontraktor (*këtu e në vijim AK*) ish- Komuna Qendër Vlorë (sot NJA Bashkia Vlorë), për periudhën nga 01.01.2013 deri më 31.07.2015 janë kryer **12** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 53,266 mijë lekë, nga e cila në citin 2013 janë 4 procedura me fond limit 30,127 mijë lekë, në vitin 2014 janë 6 procedura me fond limit 20,515 mijë lekë dhe 6 mujorin e parë 2015 janë 2 procedura me fond limit 2,624 mijë lekë, si vijon pasqyra:

| Nr. | Objekti prokuruar | Fondi limit pa TVSH në 000/lek | Operatori fitues | Vlera ofertës fitues pa TVSH në 000/lek | Diferenca nga fondi limit në 000/lek | Audituar | Pa Audituar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **PROCEDURAT E VITIT 2013** | | **30,127** | | **25,901** | **4,226** | **22,211** | **8,333** |
| 1 | Blerje karburanti | 2,400 | B.....A | 2,400 | 0 | 2,400 | |
| 2 | Pastrim I zonave urbane | 2,083 | M.....R | 2,483 | -400 | 2,500 | 0 |
| 3 | Hartimi I P.P. Vendor | 8,333 | T.P.Development | 5,000 | 3,333 | 0 | 8,333 |
| 4 | Rikons Shkolla 9-vjecare Bestovë | 17,311 | NDËRTUSI | 16,018 | 1,293 | 17,311 | |
| **PROCEDURAT E VITIT 2014** | | **20,515** | | **19,320** | **1,195** | **20,515** | **0** |
| 1 | Shërbime pastrimi | 2,500 | M.....R | 2,483 | 17 | 2,500 | 0 |
| 2 | Karburant | 2,100 | B.....A | 2,100 | 0 | 2,100 | |
| 3 | Rikonstruksion rrugë Kërkovë | 9,666 | LEON KONS | 9,066 | 600 | 9,666 | |
| 4 | Rik Rrugë Varreza Xhyreinë | 2,083 | B.....I | 1,994 | 89 | 2,083 | |
| 5 | Pastrim kanale Bujqësore | 1,666 | B.....I | 1,194 | 472 | 1,666 | |
| 6 | Pastrim I zonave urbane | 2,500 | M.....R | 2,483 | 17 | 2,500 | |
| **PROCEDURAT E 7/MUJORIT/2015** | | **2,624** | | **2,479** | **145** | **1,666** | **958** |
| 1 | Pastrim kanale Bujqësore | 1,666 | B.....I+Fatior 2001 | 1,617 | 49 | 1,666 | |
| 1 | Blerje karburanti | 958 | Raimonda Ceno | 862 | 96 | | 958 |
| **12** | **SHUMA 2013 + 2014 + 2015** | **53,266** | **0** | **47,700** | **5,566** | **44,392** | **958** |

Nisur të dhënat e pasqyrës, grupi i auditimit të KLSH, nga **12** procedura prokurimi auditoi **10** procedura me vlerë të fondit limit 44,392 mijë lekë ose 83.3 % e fondit të prokuruar. Në procedurat e prokurimeve të zhvilluara në këtë njësi vendore kanë marrë pjesë **28** OE/BOE nga të cilët janë Skualifikuar **15** OE/BOE.

Në auditimin e këtyre procedurave, u konstatuan në **8** raste veprime dhe mosveprime në mos përputhje me dispozitat e ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, të VKM nr. 01,

datë 10.01.2007, i ndryshuar me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publike", si më poshtë vijon:

-Njësia e prokurimit (NJP) nuk ka përgatitur e hartuar asnjë raport të hollësishëm në lidhje me korrektësinë dhe cilësinë e realizimit të suksesshëm të kontratave të lidhura me operatorët ofertat e të cilëve janë shpallur fituese, ndërsa duhet theksuar se në të gjitha kontratat e përpiluara dhe të miratuara nuk është emëruar me shkrim dhe nuk është përcaktuar personi, ose struktura organizative përgjegjës në emër të palës për të ndjek realizimin e kontratës, veprim në mospërputhje me Kreu IX "*Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës*", neni 77 "*Mbikëqyrja e kontratës*" pikat (3), (4) të parashikuar në çdo kontratë neni përkatës "*Përfaqësimi palëve*", **për këtë ngarkohet me përgjegjësi NJP.**

Në mënyrë të detajuar sipas rasteve të audituara kemi*:*

**1. Tenderi me objekt:** *"Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Bestovë, ish Komuna Qendër, vit 2013"*

| | | |
|---|---|---|
| **a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Bestovë, ish Komuna Qendër, vit 2013"** | | |
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 1093/1, datë 26.10.2012<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 1093/1, datë 26.10.2012<br>H. F. me detyrë ish- Jurist<br>XH. H me detyrë ish- Zv/Kryetar dhe P/Bujqësie<br>I. S. me detyrë sekretare/arkiviste | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 1198/1, datë 03.12.2012<br>E. B, me detyrë Spec. Ing ndërtimi NJA Qendër<br>A. R. me detyrë ish- Zv/Kryetar.<br>TH. T me detyrë ish- P/Zyrës Taksave |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>17,311,041 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** BOE Ndërtusi + B.....B, me ofertë 16,721,730 lekë, sipas kontratës nr. 117, dt. 11.02.2013, me afat 45 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 590 mijë lekë ose 3.4% |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>08.12.2012, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Grande + Ardhura | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **9 OE**<br>b) Skualifikuar: **7** OE<br>c) Kualifikuar: **2** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**- nr. 60, dt. 20.12.2012 dhe nr. S'ka, dt. 20.12.2012; **APP**–s'ka;<br>**KPP- nr.** S'ka, dt. 03.01.2013 | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK Shkresa nr. Nr. 1283/1, dt. 24.12.2012; nr. 1289/1, dt. 24.12.2012 | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP Nr. 1354/3, dt. 22.01.2013 |

**-Hartimi i fondit limit:** Me shkresën nr. 5464/4, datë 08.11.2012 të Ministrisë së Arsimit, Vendimin nr. 8, datë 05.10.2012 të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve (FZHR), si dhe shkresës së MF nr. 15845/6, datë 26.10.2012 "Akordim të investimeve nga FZHR" për vitin 2012, është miratuar çelja e fondeve për objektin "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Bestovë", ku për vitin 2012 është në vlerën 2,077,325 lekë.

Me shkresën nr. 1138/1, datë 12.11.2012 nga ana e Titullarit të AK F. B është urdhëruar ngritja e komisionit të llogaritjes së fondit limit, i përbërë nga H. F, E. G. dhe C. M., kjo në zbatim të nenit 7, të LPP, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar kreu II-*"Rregullat e përgjithshme",* pika 2 germa "ç" dhe urdhrit të MF nr. 92, datë 29.12.2011 "Për gjurmët standarte të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë".
Komision në mbështetje të këtij urdhri dhe buxhetit të vitin 2014, si dhe projekt-preventivit të përgatitur në zbatim të VKM nr. 708, datë 12.10.2011 "Për manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike", vendosi që për objektin "*Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare*

*Bestovë*", të hartoj fondin limit për vlerën 17,311,041 lekë pa TVSH. Preventivi është hartuar nga Ing. A. G.

**-Hartimi i dokumenteve.** Më datë 15.11.2012, Njësia e Prokurimit (NJP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit. Në vendosjen e disa kritereve NJP nuk ka argumentuar si duhet arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 të VKM-së nr. 01, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, *konkretisht*: Është kërkuar kategori licencë NP-3/B, ku referuar zërave të preventivit nuk justifikon këtë kategori punimi e cila i përkon vlerës 21-50 milionë lekë, kur i gjithë fondi limit është në vlerën 17 milionë lekë.
Seti i dokumenteve nuk është nënshkruar nga anëtarët e NJP, por vetëm nga njëri prej tyre, për të cilën nuk identifikohet se kush është, pasi vetëm ka nënshkruar pa emër, në kundërshtim me pikën 2/b, të VKM nr. 01, datë 10.01.2007, i ndryshuar, ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP i përbërë nga H. F. me detyrë jurist, X. H me detyrë Zv/Kryetar Komune dhe I. S..
**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 08.12.2012 është bërë hapja e procedurës ku është verifikuar pjesëmarrja e ofertuesve në tender, ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 4 BOE/OE.

Me procesverbalin e datës 19.12.2012 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të BOE/OE pjesëmarrës në këtë procedurë, ku të dhënat janë evidentuar në pasqyrën e mësipërme.
Sipas të dhënave të pasqyrës, KVO nga 9 operatorë pjesëmarrës plotësojnë kushtet për kualifikim 2 OE, *konkretisht:* "N.....I V + B.....B" me vlerë oferte 16,721,730 lekë dhe "K..... A....." me ofertë 16,873,750 lekë, oferta më të larta se ofertat e OE të Skualifikuar nga KVO**.**
Me procesverbal datë 19.12.2012 është bërë njoftimi i pjesëmarrësve në këtë procedurë. Me vendim nr. 5, datë 19.12.2012 të KVO është shpallur fitues BOE "N.....V+ B.....U" me vlerë oferte 16,721,630 lekë (pa TVSH), si më leverdishme se OE tjetër i kualifikuar.
-Me formularë ankese (shtojca 19), nga subjekti "L.....N" është bërë ankesë në lidhje me s 'kualifikimin e tij, duke kundërshtuar vendimin e KVO për kriteret për të cilat është Skualifikuar.
-Me formularë ankese (shtojca 19), nga subjekti "E.....N" është bërë ankesë në lidhje me s 'kualifikimin e tij, duke kundërshtuar vendimin e KVO për kriteret për të cilat është Skualifikuar.
Nga dokumentacioni në dosje, konstatohet se nga ana e Titullarit të AK nuk është ngritur komisioni për marrjen në shqyrtim të ankesave dhe nuk është bërë pezullimi i procedurës deri në shqyrtimin e tij, veprime në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, kreu IX, pika 1-*Ankesa në AK*, germa "ç".
**Veprime të cilat ngarkojë me përgjegjësi: Titullarin e AK F. B..**

Me shkresën nr. 1283/1, datë 24.12.2012 nga AK i është kthyer përgjigje OE "L.....N" se kërkesa e tij nuk merret në konsideratë. Gjithashtu me shkresën nr. 1289/1, datë 24.12.2012, nga AK i është kthyer përgjigje OE "E.....N" se kërkesa e tij nuk merret në konsideratë.
Me datë 24.12.2012 nga KVO është hartuar dhe dërguar për miratim Raporti Përmbledhës, i cili është miratuar në kundërshtim me kreun V, pika 4/gj të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, në të cilën parashikon se: "*Komisioni i vlerësimit pas përfundimit të afateve të ankimimit përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon për miratim titullarit të AK",* pra nuk janë respektuar afatet për pritjen e ankesave të mundshme pranë KKP, pasi nga subjekti "L.....N" është paraqitur ankesë me datë 03.01.2013, në kundërshtim me nenin 63, të LPP, veprime

të cilën ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK F. B. dhe anëtarët e KVO; A. R. me detyrë Zv/Kryetar dhe TH. T me detyrë P/Zyrës Taksave.

Me shkresën datë 24.12.2012, KVO kërkon nga titullari i AK miratimin e procedurës, ku me shkresën datë 27.12.2012, ku nga ky i fundit është bërë miratimi i procedurës, duke kualifikuar BOE "N.....V+ B.....U" me ofertë 16,721,730 lekë pa TVSH në vend të parë dhe në vend të dytë OE "K.....A' me ofertë 16,873,750 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 1354/1, datë 03.01.2013 të APP është kërkuar pezullimi i procedurës, pasi OE "L.....N" ka bërë ankesë për s 'kualifikimin të padrejtë, dhe i është kërkuar AK dërgimi i dokumentacionit.
Me shkresën nr. 1354/1, datë 22.01.2013, KPP njofton mbi vendimin e marrë në lidhje me ankesën e OE "L.....N", ku arrin në konkluzionin se nga dy kritere për të cilat është Skualifikuar, njëri qëndron, pasi operatori nuk ka depozituar licencën ku ka kategorinë e punimeve NP-12/A, ndërsa kriteri tjetër në lidhje me mos paraqitjen e certifikatës së punimeve të ngjashme, pretendimet e subjektit qëndrojnë, pasi certifikatat janë. Nisur nga fakti se nuk plotëson një nga kërkesat dhe në zbatim të nenit 46, germa "a", të LPP, operatori nuk kualifikohet. Me datë 28.01.2013 është bërë formulari i njoftimi i firmës fitues BOE "N.....V + B.....U" me ofertë 16,721,730 lekë pa TVSH për lidhjen e kontratës.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e paraqitura nga ish-punonjësit e Komunës Qendër me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), është bërë i mundur sqarimi i problemeve të paraqitura nga ana e grupit të auditimit në lidhje me kualifikimin e shoqërisë "L.....N".* ***Pretendimi juaj merret ne konsideratë.***

**2- Në tenderin e zhvilluar me objekt "***Blerje karburanti, viti 2013***"**, me të dhënat e regjistruara:

| **a.** Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "blerje karburant viti 2013"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 2/1, datë 04.1.2013<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>nr. 2/1, datë 04.1.2013<br>z. H. F. me detyrë jurist<br>X. H me detyrë Zv/Kryetar<br>I. S. me detyrë ish sekretare | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 220/1, datë 8.3.2013<br>E. B, me detyrë P/Zyrës Urbanistike<br>A. R. me detyrë Zv/Kryetar.<br>TH. T me detyrë P/Zyrës Taksave |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>2.400.000 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** subjekti "B.....A me ofertë 11.25 % dhe 17.5 lek/litri (2,400,000 lekë), sipas kontratës nr. ---, dt. 01.4.2013, me afat deri 31.12.2013. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 0 mijë lekë ose 2.9 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>13.03.2013, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e Komunës Qendër + grande | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **1 OE**<br>b) Skualifikuar: **0** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK-** s'ka; **APP**–s'ka; **KPP-** ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

-Në regjistrin e parashikimit të prokurimeve i dërguar për botim në APP është parashikuar të realizohet prokurimit me objekt "*blerje karburant për nevojat e ish-Komunës Qendër Vlorë, viti 2013*" me fond limit 2,400,000 lekë pa TVSH me procedurës "*tender i hapur*".
**-Hartimi i dokumenteve.** Më datë 15.2.2013, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 13.3.2013 është bërë hapja e procedurës ku është verifikuar pjesëmarrja e ofertuesve në tender, ku është konstatuar se kanë marrë pjesë OE "B.....A" me marzh fitimi 11.25 % dhe 17.5 lekë/litri pa TVSH.
Me procesverbalin e datës 20.3.2013 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës në këtë procedurë.
Sipas të dhënave, KVO konstaton se OE pjesëmarrës plotëson kushtet për kualifikim ("B.....A" me marzh fitimi 11.25 % dhe 17.5 lekë/litri pa TVSH)**.**
Me vendim datë 20.3.2013, KVO vendosi të shpall fitues OE ("B.....A" me marzh fitimi 11.25 % dhe 17.5 lekë/litri pa TVSH.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e paraqitura nga ish-punonjësit e Komunës Qendër me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me problemet e trajtuara nga grupi i auditimit mbi kualifikimin e padrejtë të OE "B.....A" sqarojmë se janë sqaruar nga subjekti në vërejtjet e paraqitura, pasi sipas VKM nr. 170, datë 25.04.2002 funksionin e dhënies së licencave e ka njësitë vendore për të cilën subjekti është pajisur me lejen nr. 01, datë 04.03.2013.* ***Pretendimi juaj merret ne konsideratë.***

### 3. Tenderi me objekti: *"Pastrim i Zonave Urbane, vit 2013".*

| **a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "***Pastrim i Zonave Urbane, vit 2013***"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr.117/1, datë 14.2.2013<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>nr. 117/1, datë 14.2.2013.<br>H. F. me detyrë jurist<br>X. H me detyrë Zv/Kryetar<br>I. S. me detyrë ish-Sekretare Kryetari | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 2081/1, datë 6.3.2013<br>E. B, me detyrë P/Zyrës Urbanistike<br>A. R. me detyrë Zv/Kryetar.<br>TH. T me detyrë P/Zyrës Taksave |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>2.083.333 lekë pa TVSH | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** subjekti "M.....R" me ofertë<br>2,002,400 lekë, sipas kontratës nr. ---, dt. 01.4.2013, me afat 150 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 81 mijë lekë ose 3.8% |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>11.3.2013, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e komunës | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **3 OE**<br>b) Skualifikuar: **2** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**- s'ka; **APP**–s'ka; **KPP**- ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

**-Hartimi i fondit limit:** Me shkresën nr. 115/1 datë 11.2.2013nga ana e Titullarit të AK F. B është urdhëruar ngritja e komisionit të llogaritjes së fondit limit, ky komision është i njëjtë me komisionin e NJHDT, kjo në zbatim të nenit 7, të LPP, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar kreu II-*"Rregullat e përgjithshme",* pika 2 germa "ç" dhe urdhrit të MF nr. 92, datë 29.12.2011 "Për gjurmët standarte të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë", i përbërë nga H. F., E. G. dhe Z. M..
Komision në mbështetje të këtij urdhri dhe projekt-preventivit të përgatitur në zbatim të VKM nr. 708, datë 12.10.2011 "Për manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike", vendosi që për objektin "*Pastrim i Zonave Urbane, vit 2013*", të hartoj fondin limit për vlerën 2,083,333 lekë pa TVSH.
**-Hartimi i dokumenteve.** Më datë 13.2.2013, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 13.3.2013 është bërë hapja e procedurës ku është verifikuar pjesëmarrja e ofertuesve në tender, ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 3 BOE/OE.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e paraqitura nga ish-punonjësit e Komunës Qendër me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), është bërë i mundur sqarimi i problemeve të paraqitura nga ana e grupit të auditimit në lidhje me kualifikimin e shoqërisë "M.....R".* ***Pretendimi juaj merret ne konsideratë.***

**4. Tenderi me objekti**: *"Rikonstruksion i rrugës së varrezave Xhyherinë, ish Komuna Qendër, vit 2014"*

| | | |
|---|---|---|
| **a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "***Rikonstruksion i rrugës së varrezave Xhyherinë, ish Komuna Qendër, vit 2014***"** | | |
| **1. Urdhër Prokurimi** nr.879, datë 18.8.2014<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** "Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** nr. 879, datë 18.8.2014.<br>z. H. F. me detyrë jurist<br>X. H me detyrë Zv/Kryetar<br>G. M. me detyrë | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër nr.1017, datë 17.9.2014<br>E. B, me detyrë P/Zyrës Urbanistike<br>A. R. me detyrë Zv/Kryetar.<br>TH. T me detyrë P/Zyrës Taksave |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)** 2.083.333 lekë pa TVSH | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** subjekti "B.....I" me ofertë 1,994,704 lekë, sipas kontratës nr. 1114, dt. 6.10.2014, me afat 45 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 89 mijë lekë ose 4.2% |
| **8. Data e hapjes së tenderit** 22.9.2014, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit** Të ardhurat e komunës | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **2 OE**<br>b) Skualifikuar: **1** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**- s'ka; **APP**–s'ka; **KPP-** ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP _____ |

**-Hartimi i fondit limit:** Me shkresën nr. 876, datë 18.8.2014 nga ana e Titullarit të AK është urdhëruar ngritja e komisionit të llogaritjes së fondit limit, ky komision është i njëjtë me komisionin e NJHDT, kjo në zbatim të nenit 7, të LPP, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar kreu II-*"Rregullat e përgjithshme",* pika 2 germa "ç" dhe urdhrit të MF nr. 92, datë 29.12.2011 "Për gjurmët standarte të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë".
Komision në mbështetje të këtij urdhri dhe projekt-preventivit të përgatitur në zbatim të VKM nr. 708, datë 12.10.2011 "Për manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike", vendosi që për objektin "*Rikonstruksion i rrugës së varrezave Xhyherinë, ish Komuna Qendër, vit 2013*", të hartoj fondin limit për vlerën 2,082,665 lekë pa TVSH.

**-Hartimi i dokumenteve.** Më datë 28.8.2014, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.
**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 22.9.2014 është bërë hapja e procedurës ku është verifikuar pjesëmarrja e ofertuesve në tender, ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 2 BOE/OE.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e paraqitura nga ish-punonjësit e Komunës Qendër me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), është bërë i mundur sqarimi i problemeve të paraqitura nga ana e grupit të auditimit në lidhje me kualifikimin e shoqërisë "B.....I".* ***Pretendimi juaj merret ne konsideratë.***

**5. Tenderi me objekt**: *"Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë, ish Komuna Qendër, vit 2014"*

| **a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "***Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë, ish Komuna Qendër, vit 2014"* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 579, datë 03.06.2014<br><br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr.579, datë 03.06.2014<br>H. F. me detyrë jurist<br>X. H me detyrë Zv/Kryetar<br>G. M. me detyrë | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr.677, datë 27.6.2014<br>E. B, me detyrë P/Zyrës Urbanistike<br>A. R. me detyrë Zv/Kryetar.<br>TH. T me detyrë P/Zyrës Taksave |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>9,666,667 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** subjekti L.....N me ofertë<br>9,066,666 lekë, sipas kontratës nr. 837, dt. 06.08.2014, me afat 90 ditë ose 3 muaj. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>600 mijë lekë ose 6.2% |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>04.07.2014, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Grande + Ardhura | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **4 OE**<br>b) Skualifikuar: **3** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK-** s'ka; **APP**–s'ka; **KPP-** ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

**-Hartimi i fondit limit:** Me shkresën nr. 567, datë 30.05.2014 nga ana e Titullarit të AK është urdhëruar ngritja e komisionit të llogaritjes së fondit limit, ky komision është i njëjtë me komisionin e NJHDT, kjo në zbatim të nenit 7, të LPP, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar kreu II-*"Rregullat e përgjithshme",* pika 2 germa "ç" dhe urdhrit të MF nr. 92, datë 29.12.2011 "Për gjurmët standarte të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë".
Komision në mbështetje të këtij urdhri dhe projekt-preventivit të përgatitur në zbatim të VKM nr. 708, datë 12.10.2011 "Për manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike", vendosi që për objektin "Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë", të hartoj fondin limit për vlerën 9.666,667 lekë pa TVSH. **Preventivi është hartuar nga Ing. A. G**.

**-Hartimi i dokumenteve.** Më datë 04.06.2014, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.
Me shkresën nr. 597, datë 09.06.2014 është kërkuar anulimi i procedurës me Pretendimin se në Buletinin nr. 23, datë 09.06.2014 nuk është botuar Njoftimi i Kontratës. Me formularin njoftim kontratë datë 09.06.2014 data për zhvillimin e procedurës është datë 04.07.2014, sipas Buletinit nr. 24 (02.06.2014)
**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 04.07.2014 është bërë hapja e procedurës ku është verifikuar pjesëmarrja e ofertuesve në tender, ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 4 BOE/OE.
Me procesverbalin e datës 04.07.2014 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të BOE/OE pjesëmarrës në këtë procedurë, ku të dhënat janë evidentuar në pasqyrën e mësipërme. KVO nga 4 operatorë pjesëmarrës plotëson kushtet për kualifikim OE "L.....N" me ofertë 9,066,666 lekë pa TVSH**.**
Me vendim datë 10.07.2014, KVO vendosi të shpall fitues OE "L.....N" me vlerë ofertë 9,023,795 lekë pa TVSH. Me shkresën datë 10.07.2014 është bërë njoftimi i klasifikimit të pjesëmarrësve mbi procedurën e zhvilluar.
Me datë 17.07.2014 nga KVO është hartuar dhe dërguar për miratim Raporti Përmbledhës, në të cilën janë përshkruar të gjitha fazat e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Ky raport është miratuar nga Titullari i AK (i cili nuk ka firmosur vetë, pasi është me p/përpara) me shkresën datë 17.07.2014.
Me shkresën datë 21.07.2014 është bërë njoftimi i OE për lidhjen e kontratës

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e paraqitura nga ish-punonjësit e Komunës Qendër me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), është bërë i mundur sqarimi i problemeve të paraqitura nga ana e grupit të auditimit në lidhje me kualifikimin e shoqërisë "L.....N".* ***Pretendimi juaj merret ne konsideratë.***

**E-Zbatimi i kontratës.** Referuar të dhënave të kontratës nr. 837, datë 06.08.2014 të lidhur midis ish Komunës Qendër të përfaqësuar nga F. B. dhe subjektit "L.....N", konstatohet parregullsi, kryesisht në kushtet e veçanta të saj. Kështu sipas kontratës vlera është 11,396,185 lekë. Në ofertën e paraqitur nga subjekti dhe shpallur fitues është përfshirë vlera e projektit prej 318,247 lekë dhe vlera e mbikëqyrësit prej 249,385 lekë, **gjithsej për vlerën 567,632 lekë,** e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e ish komunës, dhe për këto vlera nuk duhet të financohet subjekti pasi punimet janë kryer nga të tjerë dhe për këto vlera kryhen procedura të tjera prokurimeve me vlera të vogël sipas fondeve përkatës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publike", i ndryshuar dhe ligjin nr. 8402, datë 19.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7.
Në kushtet e veçanta të kontratës në nenin 3 të saj thuhet se: *Mbikëqyrësi i punimeve që do të zgjidhet nga vetë OE.*
Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi; preventivin e projekti Ing. A. G, titullari i AK për nënshkrimin vlerë e projektit, si dhe subjektin "L.....N" **për përfitimin e padrejtë të vlerës së projektit dhe mbikëqyrësit prej <u>567,632 lekë</u>.**

**6. Tenderi me objekt:** *"Pastrim i kanaleve bujqësore, vit 2014"*

| **a.** Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "Pastrim i kanaleve bujqësore, vit 2014"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr.874, datë 15.8.2014 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** nr. 874, datë 15.8.20142014<br>H. F. me detyrë jurist<br>X. H me detyrë Zv/Kryetar<br>G. M. me detyrë | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr.960, datë 5.9.2014<br>E. B, me detyrë P/Zyrës Urbanistike<br>A. R. me detyrë Zv/Kryetar.<br>TH. T me detyrë P/Zyrës Taksave |
| **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>1.666.667 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** subjekti "B.....I me ofertë 1.194.150 lekë, sipas kontratës nr. 1065, dt. 25.9.2014, me afat 150 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>472 mijë lekë ose 28.3 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>19.9.2014, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e Komunës Qendër | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **2 OE**<br>b) Skualifikuar: **1** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK-** s'ka; **APP**–s'ka; **KPP-** ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

**-Hartimi i fondit limit:** Me shkresën nr. 869, datë 13.8.2014 nga ana e Titullarit të AK është urdhëruar ngritja e komisionit të llogaritjes së fondit limit, ky komision është i njëjtë me komisionin e NJHDT, kjo në zbatim të nenit 7, të LPP, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar kreu II-*"Rregullat e përgjithshme",* pika 2 germa "ç" dhe urdhrit të MF nr. 92, datë 29.12.2011 "Për gjurmët standarte të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë". Preventivi është hartuar nga Ing. XH. H.

**-Hartimi i dokumenteve.** Më datë 04.06.2014, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 11.9.2014 është bërë hapja e procedurës ku është verifikuar pjesëmarrja e ofertuesve në tender, ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 2 BOE/OE.
Me procesverbalin e datës 11.9.2014 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës në këtë procedurë, ku të dhënat janë evidentuar në pasqyrën e mësipërme. KVO nga 2 operatorë pjesëmarrës plotëson kushtet për kualifikim OE "B.....I" me ofertë 1,194,150 lekë pa TVSH.
Me vendim datë 11.9.2014, KVO vendosi të shpall fitues OE "B.....I" me ofertë 1,194,150 lekë pa TVSH. Me shkresën datë 11.9.2014 është bërë njoftimi i klasifikimit të pjesëmarrësve mbi procedurën e zhvilluar.
Me datë 18.9.2014 nga KVO është hartuar dhe dërguar për miratim Raporti Përmbledhës, në të cilën janë përshkruar të gjitha fazat e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Me shkresën datë 18.9.2014 nga Kryetari i KVO është kërkuar miratimi i raportit nga ana e titullarit të AK. Ky i fundit me shkresën nr. 1021, datë 18.9.2014 ka miratuar raportin përfundimtar dhe procedurën duke shpallur fitues OE "B.....I" me ofertë 1,194,150 lekë pa TVSH**,** si operator i vetëm i rregullt nga dy pjesëmarrësit.
Me shkresën datë 18.9.2014 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit, shpallur në buletinin nr. 38, datë 22.9.2014. Me shkresën datë 22.9.2014 është bërë njoftimi i fituesit.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e paraqitura nga ish-punonjësit e Komunës Qendër me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), është bërë i mundur sqarimi i problemeve të paraqitura nga ana e grupit të auditimit në lidhje me kualifikimin e shoqërisë "L.....N".* ***Pretendimi juaj merret ne konsideratë.***

**7-Në tenderin e zhvilluar me objekt "***Blerje karburanti, viti 2014*", me të dhënat e regjistruara:

| **a.** Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "blerje karburant viti 2014"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 465/1, datë 13.5.2014<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** "Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** nr. 465/1, datë 13.5.2014<br>H. F. me detyrë jurist<br>XH. H me detyrë Zv/Kryetar<br>G. M. me detyrë | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër nr. 582, datë 4.6.2014<br>E. B, me detyrë P/Zyrës Urbanistike<br>A. R. me detyrë Zv/Kryetar.<br>TH. T me detyrë P/Zyrës Taksave |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)** 2.100.000 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** subjekti "B.....A me ofertë 7.02 % dhe 6.49 lek/litri (2,100,000 lekë), sipas kontratës nr. 804, dt. 31.7.2014, me afat deri 31.12.2014. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 0 mijë lekë ose 0 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit** 4.7.2014, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit** Të ardhurat e Komunës Qendër + grande | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **2 OE**<br>b) Skualifikuar: **1** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK-** s'ka; **APP**–s'ka; **KPP-** ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

**-**Në regjistrin e parashikimit të prokurimeve i dërguar për botim në APP është parashikuar të realizohet prokurimit me objekt "*blerje karburant për nevojat e ish-Komunës Qendër Vlorë, viti 2014*" me fond limit 2,100,000 lekë pa TVSH me procedurës "*tender i hapur*".

**-Hartimi i dokumenteve.** Më datë 15.2.2013, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 9.6.2014 është bërë hapja e procedurës ku është verifikuar pjesëmarrja e ofertuesve në tender, dhe është konstatuar se ka marrë pjesë vetëm OE "B.....A" pa ofertë.
Me procesverbalin e datës 9.6.2014 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës në këtë procedurë, ku të dhënat është konkluduar se nuk ka fitues, pasi OE i vetëm i paraqitur nuk ka ofertë.
Me shkresën nr. 598, datë 9.6.2014, titullari i AK ka anuluar procedurën për mungesë pjesëmarrje dhe mos plotësim dokumentacioni.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e paraqitura nga ish-punonjësit e Komunës Qendër me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), është bërë i mundur sqarimi i problemeve të paraqitura nga ana e grupit të auditimit në lidhje me kualifikimin e shoqërisë "L.....N".* ***Pretendimi juaj merret ne konsideratë.***

**8. Tenderi me objekti**: *"Pastrim i Zonave Urbane, vit 2014"*

| | | |
|---|---|---|
| **a.** Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "***Pastrim i Zonave Urbane, vit 2014***"** | | |
| **1. Urdhër Prokurimi** nr.477/1, datë 14.5.2014<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>nr. 463/1, datë 12.5.2014.<br>H. F. me detyrë jurist<br>XH. H me detyrë Zv/Kryetar<br>G. M. me detyrë | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr.584, datë 5.6.2014<br>E. B, me detyrë P/Zyrës Urbanistike<br>A. R. me detyrë Zv/Kryetar.<br>TH. T me detyrë P/Zyrës Taksave |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>2.500.000 lekë pa TVSH | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** subjekti "M.....R" me ofertë 2,483,100 lekë, sipas kontratës nr. 687, dt. 30.06.2014, me afat 31.12.2014. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 17 mijë lekë ose 0.68% |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>10.06.2014, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e komunës | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **2 OE**<br>b) Skualifikuar: **0** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**- s'ka; **APP**–s'ka; **KPP-** ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

**-Hartimi i fondit limit:** Me shkresën nr. ---, datë 13.5.2014 nga ana e Titullarit të AK është urdhëruar ngritja e komisionit të llogaritjes së fondit limit, ky komision është i njëjtë me komisionin e NJHDT, kjo në zbatim të nenit 7, të LPP, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar kreu II-*"Rregullat e përgjithshme",* pika 2 germa "ç" dhe urdhrit të MF nr. 92, datë 29.12.2011 "Për gjurmët standarte të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë".
Komision në mbështetje të këtij urdhri dhe projekt-preventivit të përgatitur në zbatim të VKM nr. 708, datë 12.10.2011 "Për manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike", vendosi që për objektin "*Pastrim i Zonave Urbane, vit 2014*", të hartoj fondin limit për vlerën 2,500,780 lekë pa TVSH.

**-Hartimi i dokumenteve.** Më datë 14.5.2014, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 16.6.2014 është bërë hapja e procedurës ku është verifikuar pjesëmarrja e ofertuesve në tender, ku është konstatuar se kanë marrë pjesë 2 BOE/OE.

Me vendim datë 16.6.2014, KVO mbi bazën e çmimit më të ulët klasifikojë në vend të parë OE "SH....A" me ofertë 2,299,372 lekë pa TVSH dhe në vend të dytë OE "M.....R" me ofertë 2,483,100 lekë pa TVSH.
Me shkresën datë 16.6.2014 është bërë njoftimi i operatorëve pjesëmarrës.
Me shkresën nr. 30, datë 17.6.2014 (prot subjekt nr. 640, datë 18.6.2014), operatori "SH....A" pasi është njohur me faktin se është shpallu fitues në procedurën "*Pastrim i zonave urbani*", ku sipas DST është kërkuar kryerja e shërbimit për një afat një vjeçar, ndërsa në ofertën e paraqitur nga ana jonë është pasur parasysh se shërbimi është deri me datë 31.12.2014. pra oferta është deri me 31.12.2014 dhe jo afat njëvjeçar. Në këto kushte ka bërë kërkesë për tërheqje nga konkurrimi.
Me datë 18.6.2014 nga KVO është hartuar dhe dërguar për miratim Raporti Përmbledhës, në të cilën janë përshkruar të gjitha fazat e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Me shkresën datë 18.6.2014 nga Kryetari i KVO është kërkuar miratimi i raportit nga ana e titullarit të AK. Ky i fundit me shkresën nr. 652, datë 23.6.2014 ka miratuar raportin përfundimtar dhe procedurën duke shpallur fitues OE "M.....R" me ofertë 2,483,100 lekë pa TVSH, si operator i vetëm i rregullt nga dy pjesëmarrësit.
Me shkresën datë 23.6.2014 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit, shpallur në buletinin nr. 30, datë 30.06.2014. Me shkresën datë 30.06.2014 është bërë njoftimi i fituesit.
Nga verifikimi në sistem dhe dosje i DST, në lidhje me zbatimin e afateve të punimeve, konstatohet se nuk është një vit nga data e lidhjes së kontratës, siç pretendohet nga subjekti por është deri në fund të vitit 2014. Pra Pretendimi i përdorur nga subjekti për tu tërhequr nga gara është i pavërtetë, në kundërshtim me nenin 49, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, KVO duhet të kërkonte sekuestrimin e garancisë së ofertës në masën 2% ose **50,000 lekë**, **dëm ekonomik.**

**9. Tenderi me objekt:** *"Pastrim i kanaleve bujqësore, vit 2015"*

| | | |
|---|---|---|
| **a.** Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "Pastrim i kanaleve bujqësore, vit 2015"** | | |
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 595, datë 12.5.2015 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** nr. 595, datë 12.5.2015<br>H. F. me detyrë jurist<br>XH. H me detyrë Zv/Kryetar<br>G. M. me detyrë | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 737, datë 16.6.2015<br>E. B, me detyrë P/Zyrës Urbanistike<br>A. R. me detyrë Zv/Kryetar.<br>TH. T me detyrë P/Zyrës Taksave |
| **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>1.666.667 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** subjekti "B.....I + F.....N" me ofertë 1.617.200 lekë, sipas kontratës nr. 800, dt. 29.6.2015, me afat 150 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>49 mijë lekë ose 2.9 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>15.6.2015, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e Komunës Qendër | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **2 OE**<br>b) Skualifikuar: **1** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**- s'ka; **APP**–s'ka; **KPP-** ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

**-Hartimi i fondit limit:** Me shkresën nr. 858, datë 11.5.2015 nga ana e Titullarit të AK është urdhëruar ngritja e komisionit të llogaritjes së fondit limit, ky komision është i njëjtë me komisionin e NJHDT, kjo në zbatim të nenit 7, të LPP, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar dhe urdhrit të MF nr. 92, datë 29.12.2011 "Për gjurmët standarte të auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë".

**-**Procedura e prokurimit nuk është evidentuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2015 i dërguar për botim në APP apo as në regjistrat shtesë/pakësim. Kjo procedura prokurimi e pa parashikuar në fondet për tu prokuruar dhe realizuar është në mospërputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, Kreu I "*Organizimi i prokurimit publik*", neni 4 "*Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik*", pika (1; 2; 3; 4; 5), neni 7 "*Raportimi i realizimeve të prokurimit publik*", pika (1; 2; 3) me Udhëzimi nr. 2, datë 27.01.2015 "*Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik Regjistrit të Realizimeve të Prokurimit Publik*", për këtë ngarkohet me përgjegjësi NJP: H. F. me detyrë jurist, XH. H me detyrë Zv/Kryetar dhe G. M. me detyrë**.**

**-Hartimi i dokumenteve.** Më datë 14.5.2015, Njësia e Prokurimit (NjP) ka hartuar procesverbalin nr. 1, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit.

**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 15.6.2015 është bërë hapja e procedurës, ku është konstatuar se kanë marrë pjesë BOE/OE "B.....I + F.....I" me ofertë ekonomike 1,617,200 lekë pa TVSH. Me procesverbalin e datës 16.6.2015 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës në këtë procedurë, ku të dhënat janë evidentuar në pasqyrën e mësipërme.
Sipas të dhënave, KVO konstaton se BOE pjesëmarrës plotëson kushtet për kualifikim ("B.....I + F.....I" me ofertë 1,617,200 lekë pa TVSH**).**
Me vendim datë 16.6.2015, KVO vendosi të shpall fitues OE "B.....I + F.....I" me ofertë 1,617,200 lekë pa TVSH.
Me datë 17.6.2015 nga KVO është hartuar dhe dërguar për miratim Raporti Përmbledhës, në të cilën janë përshkruar të gjitha fazat e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Me shkresën datë 17.6.215 nga Kryetari i KVO është kërkuar miratimi i raportit nga ana e titullarit të AK. Ky i fundit me shkresën nr. 768, datë 18.6.2015 ka miratuar raportin përfundimtar dhe procedurën duke shpallur fitues OE "B.....I + F.....I" me ofertë 1,617,200 lekë pa TVSH**,** si operator i vetëm i rregullt nga dy pjesëmarrësit.
Me shkresën datë 24.6.2015 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit, shpallur në buletinin nr. 25, datë 29.6.2015. Me shkresën datë 29.6.2015 është bërë njoftimi i fituesit.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e paraqitura nga ish-punonjësit e Komunës Qendër me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), është bërë i mundur sqarimi i problemeve të paraqitura nga ana e grupit të auditimit në lidhje me kualifikimin e shoqërisë "L.....N".* ***Pretendimi juaj merret ne konsideratë.***

*(Gjerësisht trajtuar në faqet 177-200, të Projekt Raport Auditimit)*

- **Auditimi i procedurave të prokurimit në ish- Komunën Shushicë (sot NJA Shushicë, Bashkia Vlorë).**

Referuar të dhënave të marra në ish- Komunën Shushicë, konstatohet se për periudhën 01.01.2013 – 30.07.2015 janë kryer **10** procedura prokurimi me fond limit 38,511 mijë lekë, për të cilën është lidhur kontratë me vlerë 37,851 mijë lekë me një diferencë prej 660 mijë lekë ose 98.2 % e fondit limit, si më poshtë vijon:

| Nr. | Objekti prokuruar | Dt. Zhvillim tenderi | Fondi limit pa TVSH në 000/lek | Operatori fitues | Vlera ofertës fitues pa TVSH në | Diferenca nga fondi limit në | Audituar | Pa audituar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | 000/lek | 000/lek | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **PROCEDURAT E VITIT 2013** | | | **35.169** | | **34.544** | **625** | **35.169** | **0** |
| 1 | Ndërtim I rrjeti të kanalizimeve Llakatund dhe Shushic | 15.8.2012 | 32.669 | B.....B | 32.333 | 336 | 32.669 | 0 |
| 2 | 1.Rik.rruge Llakatund - Grabian | 8/5/013 | 833 | N.....I | 832 | 1 | 833 | |
| 3 | 2.Blerje karburant | 18/3/013 | 1.667 | B.....A | 1.379 | 288 | 1.667 | |
| **PROCEDURAT E VITIT 2014** | | | **2.881** | | **2.848** | **33** | **2,050** | **798** |
| 1 | Blerje karburant | 19/3/014 | 276 | B.....A | 276 | 0 | | 276 |
| 2 | Blerje karburant | 5/7/014 | 400 | B.....A | 400 | 0 | | 400 |
| 3 | Blerje kanc.detrghent etje. | 15/5/014 | 23 | A.....A | 23 | 0 | | 23 |
| 4 | Blerje kanc.detergj.etjera | 28/8/014 | 99 | A.....A | 99 | 0 | | 99 |
| 5 | Blerje projekti | 5/12/014 | 2.083 | N.....I | 2.050 | 33 | 2,050 | 0 |
| **PROCEDURAT E 7/MUJORIT/2015** | | | **461** | | **459** | **2** | **0** | **459** |
| 1 | Blerje pomp centifugale | 29/06/015 | 450 | P.....R | 448 | 2 | | 448 |
| 2 | Blerje bojra kompterike | 8/4/015 | 11 | A. F. | 11 | 0 | | 11 |
| **10** | **TOTAI** | | **38.511** | | **37.851** | **660** | **37,219** | **1,275** |

*(Të dhënat janë hedhur nga grupi i auditimit të KLSH)*

Nisur të dhënat e pasqyrës, grupi i auditimit të KLSH, konstatohet se janë zhvilluar gjithsej 10 procedura prokurimi, nga të cilat 4 procedura me vlerë të madhe, një procedurë shtesë kontrate 20% (*kërkesë me propozim)* dhe 5 procedura janë me vlerë të vogël. Nga grupi i auditimit, u audituar të 4 procedurat me vlerë të lartë ose 96.6 e fondit limit.
Në procedurat e prokuruar kanë marrë pjesë **12** OE/BOE, nga të cilët janë Skualifikuar **7** OE/BOE.
Në auditimin e këtyre procedurave u konstatuan veprime dhe mosveprime në mos përputhje me dispozitat e ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, të VKM nr. 01, datë 10.01.2007, i ndryshuar me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publike", si më poshtë vijon:

-Nga ana e titullarit të AK nuk është bërë ndarja e detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe të zyrtarëve të përfshirë në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesit, veprim ky në kundërshtim me shkronjën "a", pika 1, Kreu V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014**.**

**-**Njësia e prokurimit (NJP) nuk ka përgatitur e hartuar asnjë raport të hollësishëm në lidhje me korrektësinë dhe cilësinë e realizimit të suksesshëm të kontratave të lidhura me operatorët ofertat e të cilëve janë shpallur fituese, ndërsa duhet theksuar se në të gjitha kontratat e përpiluara dhe të miratuara nuk është emëruar me shkrim dhe nuk është përcaktuar personi, ose struktura organizative përgjegjës në emër të palës për të ndjek realizimin e kontratës, veprim në mospërputhje me Kreu IX "*Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës*", **për këtë ngarkon me përgjegjësi ish- titullarin e AK L. P.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë që paraqiten në anëtarët e NJP ish- Komuna Shushicë me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), datë 26.02.2018, sqarojmë se grupi i auditimit të KLSH ka marrë në konsideratë faktin e mos pasjes së përgjegjësi në lidhje me monitorimin e kontratës në ato procedura ku ai ka qenë evident, të cilat janë reflektuar në Projekt raport.*

Në mënyrë të detajuar sipas rasteve të audituara kemi*:*

**1. Tenderi me objekt:** *"Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve, fshatrat Llakatund dhe Shushicë"*

| **a.** Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "***Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve, fshatrat Llakatund dhe Shushicë***"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 43, datë 17.7.2012<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** nr. 44, datë 17.7.2012<br>D. RR me detyrë P/Administratës;<br>A. P. me detyrë ish-Shef finance;<br>U. C. me detyrë Juriste | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 46, datë 3.8.2012<br>V. P. me detyrë ish-shef finance;<br>N. Q. me detyrë P/Taksave;<br>B. SH. me detyrë topograf në zyrën e bujqësisë |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>32,669,379 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** subjekti "B.....B me ofertë 32.333.156 lekë, sipas kontratës nr. 393, dt. 17.9.2012, me afat 300 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 336 mijë lekë ose 1.02 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>15.8.2012, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Grande | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **7 OE**<br>b) Skualifikuar: **5** OE<br>c) Kualifikuar: **2** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**- s'ka; **APP**–s'ka; **KPP**- ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

**-Hartimi i fondit limit:** Preventivi i punimeve është hartuar nga specialistët e ish- Komunës Shushicë Ing. N. B. dhe E. I. për vlerën 34,010,220 lekë pa TVSH.
Nga krahasimi i çmimit të disa zërave të preventivit me çmimet e manualit VKM nr. 407, datë 27.6.2012 "Për miratimin e manualeve teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike", i ndryshuar.
Konstatohet se disa zëra punimesh nuk janë sipas çmimeve të manualit, pasi janë preventivuar më tepër fond limit në **vlerën 1,158,300 lekë pa TVSH, duke shkaktuar dëm ekonomik** ndaj buxhetit të njësisë vendore si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve gjatë hartimit të projekt-preventivit.
Kjo vlerë jepet sipas tabelave të mëposhtme:

**Tabela 1**

| Nr. Analiza | Zëri i punimeve | Njësia | Sasia në preventiv | Çmimi i preventivit | Çmim i sipas manualit | Diferenca ne + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Çmim | Vlera |
| | | | | | | | |
| 2.261 | Mbushje me shtresë rëre tuba pcv-je të brinjëzuara | $m^3$ | 1100 | 1,703 | 1,626 | 77 | 84,700 |
| 2.258 | Mbushje kanali me zhavorr, pjesë e asfaltuar | $m^3$ | 1600 | 1,900 | 1,229 | 671 | 1,073,600 |
| | | | | | | **Shuma** | **1,158,300** |

Siç shihet, fondi limit është rritur në vlerën **1,158,300 lekë pa TVSH**, duke preventivuar më tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve të miratuara me VKM nr. 407, datë 27.6.2012 "Për miratimin e manualeve teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike", i ndryshuar gjatë hartimit të projekt-preventivit, në kundërshtim me ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu I, neni 3, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi grupin e punës për hartimin e preventivit: Ing. N. B. dhe E. I..

**-Hartimi i dokumenteve.** Nga NJP nuk është mbajtur procesverbal me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit, por është procedurat e DST,

veprim në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V-*Zhvillimi procedurës,* pika 2 "*Hartimi i dokumenteve të tenderit*" germa (a), ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP: D. RR me detyrë P/Administratës, A. P. me detyrë ish- Shef finance Tetor 2014 – Korrik 2015. Prokurimesh dhe U. C. me detyrë Juriste**.**

**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 15.8.2012 është bërë hapja e procedurës ku është verifikuar pjesëmarrja e ofertuesve në tender, sipas pasqyrës:

| Nr. | Operatori Ekonomik | Oferta ekonomike | Vendimi i KVO-së kualifikohet (po)/s'kualifikohet (jo) | Arsyet e s'kualifikimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | F.....I | 32.501.565 | PO | |
| 2 | B.....B | 32.333.156 | PO | |
| 3 | S.....I | 29.370.400 | JO | *Vërtetimet për pagesat e sig shoqërore dhe taksë vendore janë jashtë aftit 3 mujor; -mjeti me targë AA724AK nuk ka kontroll teknik* |
| 4 | B.....N + C.....J | 28.747.293 | JO | *Vërtetimet për pagesat e sig shoqërore dhe taksë vendore janë jashtë aftit 3 mujor; -mjetet kamion me dok jo të sakta* |
| 5 | E.....A + B.....N | 20.890.640 | JO | *Vërtetimet për pagesat e sig shoqërore dhe taksë vendore janë jashtë aftit 3 mujor; -mungon vërtetimi i deponimit të mjeteve nga noteri; -mjetet me targë AA136; TR8935M, TR7469L, TR9749J,TR9218L, nuk kanë dokumentacion të rregullt* |
| 6 | E.....L + A....N | 24.464.819 | JO | *Vërtetim sigurime i subjektit Eni dt. 16.20.2012; -vërtetim taksave vendore për 2010 është dt. 19.3.2010; vërtetim sig shoq Glavenica dt. 27.3.2012; vërtetim taksave nga A....N dt. 21.2.2012; vërtetim sig "A....N" dt. 7.5.2012; -vërtetim taksa VITI 2012 "Glavenica" DT. 2.4.2012; -vërtetim taksa vend "Eni/L" është dt. 9.4.2012; -mjeti me targë KR8539A; KR8539A; KR8702A dhe LU2761 nuk kanë dokumentacion e rregullt* |
| 7 | P.....R | 21.782.225 | JO | *Vërtetimi nga tatimet është i datës 3.5.2012; -vërtetimi i taksave vendore dt. 22.10.2010; -mungon vërtetimi i deponimit të mjeteve nga noteri (vërtetimit jashtë afatit 3 mujor)* |

Me procesverbal datë 28.8.2012 është bërë vlerësimi i dokumentacionit teknik e ligjorë të OE pjesëmarrës, ku në përfundim nga 7 OE janë Skualifikuar 5 OE dhe kualifikuar 2 OE por me ofertë më të lartë se operatorët e Skualifikuar.
Në përfundim KVO ka shpallur fitues OE "B.....B" me ofertë 32,333,156 lekë pa TVSH më të ulët se operatori tjetër i kualifikuar, por më të lartë se operatorët e Skualifikuar.
Me vendim nr. 01, datë 28.8.2012 KVO nga 7 BOE/OE ka Skualifikuar 5 BOE/OE dhe kualifikuar 2 BOE/OE, duke shpallur fitues OE "B.....B" me ofertë 32,333,156 lekë pa TVSH.
Me nr. 384, datë 4.9.2012 nga KVO është hartuar dhe dërguar për miratim Raporti Përmbledhës. Me shkresën nr. 385, datë 4.9.2012 është hartuar raporti vlerësuar i nga Kryetari i KVO dhe me shkresën nr. 382, datë 4.9.2012 nga Kryetari i KVO është kërkuar miratimi i raportit nga ana e titullarit të AK. Ky i fundit me shkresën nr. 382/1, datë 4.9.2012 ka miratuar raportin përfundimtar dhe procedurën duke shpallur fitues OE "B.....B" me ofertë 32,333,156 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 383, datë 4.9.2012 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit, shpallur në buletinin nr. ---, datë 17.09.2012. Me shkresën nr. 394, datë 17.9.2012 është bërë njoftimi i fituesit.

**<u>-Shqyrtimi i dokumentacionit :</u>**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit të kualifikuar "B.....B", në dokumentacionin e depozituar në dosje dhe sistemin APP, konstatohet se dhe ky operator ekonomik nuk i plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:

*a-Nuk paraqet vërtetim për likuidimin e taksave vendore për adresën "Lagj. Bishanaku, rruga "Skënderbeu nr. 8", Bashkia Fier", sipas çështjes nr. CN-767902-05-12, datë 08.05.2012, pra subjekti ka aktivitet dhe në Bashkinë Fier, për të cilën nuk është marrë vërtetim për taksat vendore, siç kërkohet në pikën 2.1.5 të DST, ku thuhet: "Vërtetim të lëshuar nga Bashkia/Komuna* ***pranë së cilës është regjistruar për taksën e taksave*** *vendore vitet 2010,2011,2012;*

*b-Vërtetimi për taksën vendore të lëshuar nga ish- Komuna Libofsh për vitet 2012, 2011, nuk është respektuar afati 3 mujore nga momenti zhvillimit të procedurës, konkretisht: për vitin 2010 me datë 07.07.2010, për vitin 2011 ka datën 15.12.2011 dhe për vitin 2012 me datë 17.2.2012,* ***ku për të njëjtën mangësi janë skualifikuar 5 operatorët pjesëmarrës dhe me oferta më të ulët.***

*c-Vërtetimi i sigurimeve shoqërore për vitet 2011-2012, nuk është respektuar afati 3 mujor nga momenti i zhvillimit të tenderit, konkretisht: nr. 1099, datë 12.8.2011 (viti 2011) dhe nr. 3406, datë 23.2.2012 (viti 2012);* ***ku për të njëjtën mangësi janë Skualifikuar 5 operatorët pjesëmarrës dhe me oferta më të ulët.***

*d-Nuk plotëson numrin mesatar të punonjësve prej 45 punonjës për vitet 2010. Sipas të dhënave subjekti për vitin 2010 ka një mesatare prej 28.1 punonjësish. Gjithashtu numri i punonjësve sipas vërtetimit të lëshuar nga tatimet nuk përputhet me numrin e punonjësve sipas listpagesës, konkretisht për muajin prill sipas vërtetimit janë 23 punonjës ndërkohë sipas listpagesës janë 22, për muajin Qershor sipas vërtetimit janë 30 punonjës ndërkohë sipas listpagesës janë 27 punonjës;*

*e-Vërtetimi për deklarimin e numrit të siguruara nuk është brenda afatit 3 mujorë nga momenti i zhvillimit për vitet 2010-2011-2012, konkretisht: nr. 5642, datë 17.12.2010; nr. 530, datë 01.02.2011; nr. 3447, datë 01.06.2011; nr. 4107, datë 28.7.2011; nr. 5933, datë 27.101.2011 dhe nr. 669, datë 14.2.2012.*

*Nga sa trajtuam ky OE nuk duhej kualifikuar si fitues.*

**Në lidhje me auditimin e OE të skualifikuar "S.....I" me ofertë ekonomike 29,370,400 lekë pa TVSH.**

Sipas KVO ky operator është skualifikuar pasi vërtetimet për sigurimet shoqërore e shëndetësorë janë jashtë afatit 3 mujor dhe autoboti me targë AA.....AK nuk ka dokumente të rregullt.

Nga verifikimi i bërë në sistemin elektronik të APP mbi dokumentacionin e këtij subjekti, konstatohet se pretendimet e KVO nuk qëndrojnë, pasi subjekti i plotëson këto kritere, konkretisht:

*a-Subjekti ka paraqitur vërtetimet brenda afatit ligjorë (3 mujorë) të kërkuar në DST, konkretisht vërtetimet me nr. 928, datë 31.5.2012, nr. 1144, datë 10.8.2012 dhe nr. 4832, datë 15.6.2012.*

*b-Sipas deklarimit të bërë për mjetet dhe dokumentacionit përkatës, subjekti ka deklaruar 3 mjete autobot nga 1 që është kërkuar dhe këto me dokumentacion të rregullt, konkretisht mjeti me targë AA.....BX; BR.....A dhe BR.....B.*

Nga sa trajtuam ky operator është skualifikuar padrejtësisht

**Konkluzioni:** Pavarësisht sa më sipër, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, grupi i auditimit konstaton se, **AK nuk duhej të kishte nënshkruar kontratën** me OE "B.....B" me ofertë 32,333,156 lekë pa TVSH, në kushtet kur nuk plotëson kriteret për kualifikim, si dhe ka arsye për s 'kualifikim nga KVO.

Vlen të theksohet se, AK në rastin konkret ka mbajtur qëndrime me dy standarte dhe në shkelje të legjislacionit të prokurimit publik (sqaruar hollësishëm më sipër).
KVO ka Skualifikuar nga gara operatorin ekonomik *me vlerë më të ulët* "S.....I" me ofertë 29,370,400 lekë, për mangësi të cilat **nuk qëndrojnë**, duke shkaktuar **dëm ekonomik në buxhetin e ish- Komunës Shushicë në vlerën 2,962,756 lekë**.
Referuar sa më sipër, titullari i AK, nuk duhej të kishte bërë miratimin e raportit përmbledhës (miratuar nr. 382/1, datë 4.9.2012), miratim ky i cili ka sjellë si pasojë vazhdimin me hapat e mëtejshëm të prokurimit, pra me nënshkrimin e kontratës përkatëse, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: V. P. me detyrë ish-shef finance Janar 2013 – Tetor 2014, N. Q. me detyrë P/Taksave, B. SH. me detyrë topograf në zyrën e bujqësisë dhe titullari i AK L. P**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Nga subjekti Bashkia Vlorë (ish- Komuna Shushicë) në kundërshtitë e paraqitura me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1028/11, datë 10.04.2018), nuk është argumentuar asnjë nga problemet e trajtuara nga grupi i KLSH dhe materiali mbetet i pandryshuar.*

## 2. Tenderi me objekt: *"Rikonstruksion i pjesshëm i rrugës Risilisë"*

| | | |
|---|---|---|
| **a.** Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "***Rikonstruksion i pjesshëm i rrugës Risilisë***"** | | |
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 04, datë 9.4.2013<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit**<br>"Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>nr. 4/1, datë 9.4.2013<br>U. C. me detyrë Juriste D. RR me detyrë P/Administratës;<br>A. P. me detyrë ish-Shef finance; | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 4/2, datë 9.4.2013<br>N. Q me detyrë shef. Kadastre.<br>V. P. me detyrë ish-shef finance;<br>B. SH. me detyrë topograf në zyrën e bujqësisë |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>833,333 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** subjekti "N.....V" me ofertë 832,352 lekë, sipas kontratës nr. 210, dt. 28.5.2013, me afat 15 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 1 mijë lekë ose 0.12 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>08.5.2013, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit**<br>Të ardhurat komuna | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **2 OE**<br>b) Skualifikuar: **1** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK-** s'ka; **APP**–s'ka; **KPP-** ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. _____ | **13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP<br>_____ |

**-Hartimi i fondit limit:** Preventivi i punimeve është hartuar nga specialistët e ish- Komunës Shushicë topograf. Bardhyl Shyti për vlerën 833,333 lekë pa TVSH.
**-**Procedura e prokurimit nuk është evidentuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2015 i dërguar për botim në APP apo as në regjistrat shtesë/pikësime. Kjo procedura prokurimi e pa parashikuar në fondet për tu prokuruar dhe realizuar është në mospërputhje me VKM nr. 01, datë 10.01.2007 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, **ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK L. P.**

**-Hartimi i dokumenteve.** Nga NJP nuk është mbajtur procesverbal me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit, por është procedurat e DST, veprim në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik", Kreu V-*Zhvillimi procedurës*, pika 2 "*Hartimi i dokumenteve të tenderit*" germa (a), ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP: D. RR me detyrë P/Administratës, A. P. me detyrë me detyrë ish- Shef finance Tetor 2014 – Korrik 2015 dhe U. C. me detyrë Juriste**.**

**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 13.5.2013 është bërë hapja e procedurës ku është verifikuar pjesëmarrja e ofertuesve në tender, sipas pasqyrës:

| Nr. | Operatori Ekonomik | Oferta ekonomike | Vendimi i KVO-së kualifikohet (po)/s'kualifikohet (jo) | Arsyet e s'kualifikimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | N.....V | 832.352 | PO | |
| 2 | S.....K | 577.881 | JO | *Vërtetimi bankar është jashtë afatit të kërkuar në DST (tenderi dt. 13.5.2013 dhe vërtetimi ka dt 6.5.2013)* |

Nga të dhënat konstatohet se procedura nuk është hapu në datën e caktuar (datë 08.5.2013), por është hapur me datë 13.5.2013 (datë 5 ditë vonesë), për të cilën në dosje dhe sistemin APP nuk ka asnjë Pretendimim për këtë fakt, veprim në kundërshtim me Kreun V-*Zhvillimi i procedurës*, pika 3-*Dorëzimi i ofertave*, germa (a), ku thuhet:

"*Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e tenderit brenda afatit kohor, të përcaktuar në këto dokumente si afati i fundit për dorëzimin e ofertave. Menjëherë pas skadimit të afatit përfundimtar, komisioni për vlerësimin e ofertave fton përfaqësuesit e operatorëve ekonomikë të paraqesin ofertat/propozimet e tyre, të mbyllura në zarf ose verifikon ato që janë dorëzuar më parë në njërën nga mënyrat e parashikuara në dokumentet e tenderit*".

Me vendim nr. 4/3, datë 21.5.2013, KVO ka skualifikuar OE "S.....K" me arsyetimin e paraqitur më pasqyrë dhe ka kualifikuar OE "N.....V" me ofertë 832,352 lekë pa TVSH, pasi plotëson kriteret e DST.
Me shkresat nr. 199, datë 21.5.2013 është bërë njoftimi i subjekteve pjesëmarrës për rezultatet e zbatimit të procedurës.
Me shkresën nr. 200, datë 21.5.2013 është hartuar Raporti Përmbledhës dhe raporti vlerësuar nga KVO, dërguar për miratim tek titullari AK.
Me shkresën nr. 200/1, datë 21.5.2013 nga Kryetari i KVO kërkohet miratim tek titullari AK. Ky i fundit me shkresën nr. 200/2, datë 21.05.2013 ka bërë miratimin e procedurës, duke shpallur fitues OE "N.....V" me ofertë 832,352 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 197, datë 21.5.2013 është plotësuar formulari i njoftimit të fituesit, shpallur në buletinin nr. --- datë 27.5.2013. Me shkresën nr. 394, datë 17.9.2012 është bërë njoftimi i fituesit.
**-Shqyrtimi i dokumentacionit:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit të kualifikuar "N.....V", në dokumentacionin e depozituar në dosje dhe sistemin APP, konstatohet se dhe ky operator ekonomik nuk i plotëson të gjitha kërkesat e DST, konkretisht:
*a-Vërtetimi i bankës është jashtë afatit 5 ditorë të kërkuar në DST. Kështu nga subjekti është paraqitur vërtetimi me datë 08.05.2013, ndërkohë që tenderi është zhvilluar me datë 13.5.2013, pra një ditë jashtë afatit.* ***Për këtë fakt është skualifikuar OE "S.....K" me ofertë me të ulët se OE "N.....V" i kualifikuar.***

**Konkluzioni:** Lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, grupi i auditimit konstaton se, AK nuk duhej të kishte nënshkruar kontratën me OE "N.....V" me ofertë 832,352 lekë pa TVSH, në kushtet kur nuk plotëson kriteret për kualifikim, si dhe ka arsye për s 'kualifikim nga KVO.
Vlen të theksohet se, AK në rastin konkret ka mbajtur qëndrime me dy standarte dhe në shkelje të legjislacionit të prokurimit publik (sqaruar hollësishëm më sipër).
KVO ka Skualifikuar nga gara operatorin ekonomik *me vlerë më të ulët* "S.....K" me ofertë 577,881 lekë, për mangësi të cilat nuk i plotëson dhe operatori i kualifikuar, duke shkaktuar **dëm ekonomik në buxhetin e ish- Komunës Shushicë në vlerën 254,471 lekë**.
Referuar sa më sipër, titullari i AK, nuk duhej të kishte bërë miratimin e raportit përmbledhës (miratuar nr. 200/2, datë 21.05.2013), miratim ky i cili ka sjellë si pasojë vazhdimin me hapat e mëtejshëm të prokurimit, pra me nënshkrimin e kontratës përkatëse, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: N. Q me detyrë shef. Kadastre, V. P. me detyrë ish-shef finance Janar 2013 – Tetor 2014, B. SH. me detyrë topograf në zyrën e bujqësisë dhe titullari i AK L. P**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Nga subjekti Bashkia Vlorë (ish- Komuna Shushicë) në kundërshtitë e paraqitura me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1028/11, datë 10.04.2018), nuk është argumentuar problemi mbi kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "N.....V", problemet e trajtuara nga grupi i KLSH dhe materiali mbetet i pandryshuar.*

**3- Në tenderin e zhvilluar me objekt "***Blerje karburanti, viti 2013***"**, me të dhënat e regjistruara:

| **a.** Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "blerje karburant viti 2013"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 3, datë 7.2.2013<br>**2. Lloji i Procedurës së Prokurimit** "Tender i hapur" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** nr. 3/1, datë 7.2.2013<br>U. C. me detyrë Juriste D. RR me detyrë P/Administratës;<br>A. P. me detyrë ish-Shef finance; | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër nr. 3/2, datë 12.3.2013<br>N. Q me detyrë shef. Kadastre.<br>V. P. me detyrë ish-shef finance;<br>B. SH. me detyrë topograf në zyrën e bujqësisë |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)** 1.655.000 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH),** subjekti "B.....A me ofertë 11.25 % dhe 20 lek/litri (1.379.167 lekë), sipas kontratës nr. 114, dt. 01.4.2013, me afat 01.01.2013 - 31.12.2013. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** 276 mijë lekë ose 16.6 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit** 183.2013, ora 10:00 | **9.Burimi Financimit** Të ardhurat e Komunës + grande | **10.Operatoret Ekonomike**<br>**a)** Pjesëmarrës ne tender: Numër **1 OE**<br>b) Skualifikuar: **0** OE<br>c) Kualifikuar: **1** OE |
| **11.Ankimime**<br>**AK**- s'ka; **APP**–s'ka; **KPP**- ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK Shkresa nr. _____ | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KPP _____ |

**-Hartimi i fondit limit:** Vlera e karburantit e përllogaritur dhe programuar për tu prokuruar nuk është e argumentuar me analizë të hollësishme referuar mbi; sasinë e karburantit gazoil gjendje në magazinë datë 31.12.2012; me analizë mbi numrin e mjeteve apo agregateve (*motogjenerator, kaldaja, etj.*) në qarkullim e gjendje pune inventar, mbi sasinë e kilometrave të përshkruara nga mjetet në qarkullim dhe orë/pune të kryera nga agregatet për periudhën raportuese paraardhës, mbi normativën e konsumit litra/100 km për mjetet dhe orë/pune për agregatet e miratuar me Vendim të Këshillit të Komunës, mbi gjendjen teknike të çdo tip mjeti e agregati, mbi viti prodhimit të mjetit e agregatit. Përsa i përket

vlerës së përllogaritur për naftë nuk është evidentuar çmimi i parashikuar, ndërsa nuk ka analizuar e krahasuar në përllogaritje edhe çmimi i kontratës së realizuar më parë. Në këto kushte veprimet në lidhje me përllogaritjen dhe Pretendimimin e vlerës limit të njoftimit të kontratës lidhen direkt me përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike të parashikuara nga neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, germat (a); (b) të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar dhe janë në mospërputhje me dispozitën e parashikuar nga VKM nr. 01, datë 10.01.207 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, Kreu II "*Rregullat e Përgjithshme të prokurimit*" pika 2 germa "c", për këtë ngarkohet me përgjegjësi Komisioni përcaktimit specifikimeve teknike e përllogaritjen e vlerës limit të njoftimit të kontratës U. C. me detyrë Juriste D. RR me detyrë P/Administratës; A. P. me detyrë me detyrë ish- Shef finance Tetor 2014 – Korrik 2015**.**

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë që paraqiten në anëtarët e NJP ish- Komuna Shushicë me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), në lidhje me mos Pretendimimin e fondit limit të procedurës "Blerje karburanti", nuk argumentojnë problemin e trajtuar nga grupi i KLSH, pasi:*
*Struktura që përcakton fondin limit në mungese të një komisioni tjetër është NJP, dhe ky fond duhet të përcaktohet në referencë të mjeteve që ish- Komuna ka në dispozicion dhe sasisë së karburanti që harxhon çdo mjet.* ***Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë****.*

**-Hartimi i dokumenteve.** Nga NJP nuk është mbajtur procesverbal me qëllim përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe përcaktimin e kritereve të kualifikimit, por është procedurat e DST, veprim në kundërshtim me VKM nr. 01, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V-*Zhvillimi procedurës,* pika 2 "*Hartimi i dokumenteve të tenderit*" germa (a), ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP: D. RR me detyrë P/Administratës, A. P. me detyrë Ins. Prokurimesh dhe U. C. me detyrë Juriste**.**

**-Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal datë 18.3.2013 është bërë hapja e procedurës ku është verifikuar pjesëmarrja e ofertuesve në tender, ku është konstatuar se kanë marrë pjesë OE "B.....A" me marzh fitimi 11.25 % dhe 20 lekë/litri pa TVSH.
Me procesverbalin e datës 18.3.2013 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës në këtë procedurë.
Sipas të dhënave të pasqyrës, KVO me vendim nr. 3, datë 18.3.2013 ka shpallur fitues operatorin "B.....A" me marzh fitimi 11.25 % dhe 20 lekë/litri pa TVSH (*vendimi nuk është nënshkruar nga V. P.).*
**<u>Konkluzioni</u>:** Në procedurën e ndjekur nga KVO nuk ka shkelje të dispozitave të LPP

### 4. Tenderi me objekt *"Blerje projekti i rrugës Llakatund Bunavi – Bestrov, faza e parë*".

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt **: "***Blerje projekti i rrugës Llakatund Bunavi – Bestrov, faza e parë***"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 22, datë 19.11.2014 | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 23, datë 19.11.2014<br>D. RR me detyrë ish P/Administrate<br>K. L. me detyrë ish Inspektore taksash;<br>G. H me detyrë ish- Jurist | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 24, datë 19.11.2014<br>N. Q me detyrë shef kadastre.<br>B. SH me detyrë topograf.<br>A. P. me detyrë me detyrë ish- Shef finance Tetor 2014 – Korrik 2015 |
| **2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë me propozim*" | | |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>2,083,000 lekë. | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "N.....V" me ofertë 2,050,000 lekë me | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)** |

| | | |
|---|---|---|
| | kontratë nr. 551, dt. 23.12.2014 me afat **15 ditë**. | -33,000 lekë ose 1.05% |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 5.12.2014, ora 12.$^{oo}$ | **9. Burimi Financimit**<br>Nga të ardhurat e Komunës | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender **1** OE/BOE<br>b) Skualifikuar **0** OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **1** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. --, datë ====;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ----, datë ----- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

Nga dokumentacioni në dosje konstatohet se nuk ka asnjë dokument që tregon nevojën e blerjes së këtij projekti si dhe nuk ka asnjë detyrë projekti për këtë segment rrugorë të hartuar nga ish- zyra e urbanistikës. Gjithashtu procedura e ndjekur për zhvillimin është në kundërshtim me nenin 29 germa (d) dhe nenin 35 të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, pasi nuk duhej procedurë "*Kërkesë me propozim*" por duhej "*Konkurs projektimi*", **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: titullarin e AK**.

Në vendosjen e kritereve, konstatohet se nuk janë të argumentuara dhe në mbështetje te VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar si dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi",* konkretisht:
*a-Janë kërkuar kategori licence me niveli të lartë të ardhurash, ku sipas verifikimit të dokumentacionit të subjektit pjesëmarrës janë të njëjtat kategori që ka dhe operatori i vetëm pjesëmarrës, si: NP-1/C, NP-4/D, NP-7/B etj.*
*b-Janë kërkuar kategori licence që nuk kanë lidhje me projektin, si: NP-5/B (punime nëntokësore, ura e vepra arti), NP-6/A (diga dhe tunele hidroteknik), NP-9/A (ndërtim nënstacion, kabina tensioni të lartë), NS-8/B (ndërtime parafabrikat beton arme), etj.*
*c-Është kërkuar një numër punonjësish prej 20 veta, numër ky i paargumentuar kur bëhet fjalë për një projekt i cili realizohet vetëm nga specialitet e fushës sipas punimeve që parashikohen në projekt ose stafi teknik prej 8 vetash.*
**Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: Anëtarët e NJP; D. RR me detyrë ish P/Administrate, K. L. me detyrë ish Inspektore taksash dhe G. H me detyrë ish- Jurist.**

**Zhvillimi procedurës:** Me procesverbal datë 5.12.2014 nga KVO është bërë hapja e procedurës dhe verifikimi i operatorëve pjesëmarrës në këtë procedurë, kjo në prani të gjithë anëtarëve të komisionit. Nga verifikimi, konstatohet se në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm OE "N.....V" me vlerë oferte 2,050,000 lekë pa TVSH, i cili nuk kishte gabime aritmetike.
Me procesverbal datë 5.12.2014, KVO bëri vlerësimin e dokumentacionit teknik dhe ligjorë, nga ku vendosi të kualifikojë si të rregullat dokumentet e OE "N.....V" me vlerë oferte 2,050,000 lekë pa TVSH.
Me shkresën nr. 553, datë 26.12.2014 është mbajtur raporti përmbledhës në të cilën është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit.
Me shkresën nr. 553, datë 26.12.2014 nga Kryetari i KVO është hartuar raporti vlerësues.
Me vendim të KVO nr. 25, datë 5.12.2014 është shpallur fitues OE "N.....V" me vlerë oferte 2,050,000 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 554, datë 26.12.2014, nga kryetari i KVO është përcjellë për miratim procedura tek titullari i AK.

Ky i fundit me shkresën nr. 554/1, datë 26.12.2014 ka bërë miratimin e procedurës duke shpallur fitues OE "N.....V" me vlerë oferte 2,050,000 lekë pa TVSH. Me datë 22.12.2014.

**-Shqyrtimi i procedurës.** Nga verifikimi në dosjen e subjektit dhe sistemin APP, konstatohet se operatori i vetëm pjesëmarrës dhe shpallur fitues, **nuk plotëson të gjitha kërkesat e DST,** konkretisht:

*a-Vërtetimi i energjisë elektrike nuk është i rregullt, pasi nuk përfshin faturën e muajt korrent Tetor 2014, kur procedura është zhvilluar me datë 5.12.2014, në kundërshtim me Vendimit të ERE-s nr. 109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë", ku thuhet se: klienti do të paguaj detyrimin e përcaktuar mujor të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe ku është rasti kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë elektrike, jo me vonë se ditën e fundit kalendarik të muajt pasardhës të ati të faturuar"*

*b-Stafi teknik i kërkuar në DST (Ing. Hidro G. D, Ing. Mjedisi/Kimist N. Th, Ing. Gjeodet B. C, etj.), nuk është i siguruar gjatë gjithë periudhës në listpagesës e muajve Janar – Tetor 2014, pasi nuk ka 22 ditë pune. Gjithashtu pagesa në listpagesës (32,000 lekë) nuk përputhet me pagesat sipas kontratave e cila varjon nga 50,000 – 70,000 lekë/muaj (**deklarim i rrem), si dhe një pjesë e tyre nuk ka licencë zbatimi dhe projektimi.** Konkretisht stafit teknik është:*
*G. D me kontratë nr. 481/242, datë 22.03.2008 dhe pagës 50,000 lekë. **Nuk ka licencë zbatimi**;- TH. GJ. me kontratë 791/592, datë 1.8.2007 si Ing. Elektrik. Person fizik i licencuar dhe nuk është i siguruar në listpagesës e subjektit, duke mos plotësuar kriterin e DST pika 2 germa (ii), ku thuhet se: "Listëpagesat e punonjësve për muajnë Janar – Nëntor 2014 të konfirmuar nga Administrata Tatimore në të cilën **duhet të jenë të përfshirë dhe Stafi teknik. Nuk ka licencë zbatimi dhe projektimi; -**A. Z. me kontratë 609/992, datë 11.6.2012, Ing. Gjeodet me pagesë*
*50,000 lekë. **Nuk ka licencë zbatimi dhe projektimi; -**N. Th me kontratë nr. 607/593, datë 29.5.2012, Ing. Kimist me pagesë 50,000 lekë; **Nuk ka licencë zbatimi dhe projektimi** B. C. me kontratë datë 3.8.2012 dhe pagës 48,600 lekë;-R. Z. me kontratë nr. 824/805, datë 27.7.2012, arkitekt dhe pagës 50,000 lekë; **Nuk ka licencë zbatimi dhe projektimi** M. K. me kontratë nr. 512/843, datë 16.5.2012. Ing. Mekanik dhe pagesë 70,000 lekë; -P. GJ. me kontratë nr. 598/976, datë 9.6.2015, Ing. Topograf dhe pagës 70,000 lekë. **Nuk ka licencë projektimi.***

**Konkluzioni:** Lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, grupi i auditimit konstaton se, **AK nuk duhej të kishte nënshkruar kontratën** me OE "N.....V" me ofertë 2,050,000 lekë pa TVSH, në kushtet kur nuk plotëson kriteret për kualifikim, si dhe ka arsye për s 'kualifikim nga KVO.

Referuar sa më sipër, titullari i AK, nuk duhej të kishte bërë miratimin e raportit përmbledhës (miratuar nr. 554/1, datë 26.12.2014), miratim ky i cili ka sjellë si pasojë vazhdimin me hapat e mëtejshëm të prokurimit, pra me nënshkrimin e kontratës përkatëse, por duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte një procedurë të re me kërkesa më të favorshme dhe për operatorët e tjerë ekonomik, kjo për të rritur numrin e pjesëmarrësve, veprim të cilat kanë çuar në mos përdorimin me efektivitet, eficence dhe ekonomicitet të vlerës së fondit limit **prej 2,083,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: N. Q me detyrë shef. Kadastre, A. P. me detyrë ish- Pëgj. Finance Tetor 2014 – Korrik 2015, B. SH. me detyrë topograf në zyrën e bujqësisë dhe titullari i AK L. P.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:** Nga subjekti Bashkia Vlorë (ish- Komuna Shushicë) në kundërshtitë e paraqitura me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1028/11, datë*

*10.04.2018), nuk është argumentuar problemi mbi kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "N.....V", problemet e trajtuara nga grupi i KLSH dhe materiali mbetet i pandryshuar.*

**Zbatimi i kontratës.** Nuk ka urdhër të titullarit të AK për marrjen në dorëzim të projekti, si dhe nuk është paraqitur asnjë dokumentacion për të.
Sipas dokumentacionit në dosje me fletë hyrje nr. 10, datë 31.12.2014 projekti është bërë hyrje në vlerën 2,460,000 lekë me TVSH, i cili është likuiduar totalisht me urdhër shpenzimin nr. 241, datë 30.1.2014 në vlerën 2,460,000 lekë me TVSH, pra likuiduar e gjithë vlera sipas faturës tatimore nr. 242, datë 29.12.2014. Likuidimi i vlerës së projekti prej 2,460,000 lekë është në kundërshtim me nenin 12, pika 12,1 të kontratës nr. 551, datë 23.12.2014 (kushtet e veçanta), ku thuhet se: "*Garancia e kontratës do të zhbllokohet 1(një) vit pas përfundimit të projekti",* **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish- shefin e financës z. A. P. me detyrë ish-shef finance**.
Gjithashtu referuar kontratës së lidhur midis subjektit dhe ish- Komunës Shushicë, konstatohet se **kjo procedurë është paracaktuar**, pasi kontrata mban datën 23.12.2014 me nr. 551, ndërsa procedura ka përfunduar me datë 26.12.2014 (*shkresën nr. 553, datë 26.12.2014 është mbajtur raporti përmbledhës. Me shkresën nr. 553, datë 26.12.2014 është hartuar raporti vlerësues. Me vendim të KVO nr. 25, datë 25.12.2014 është shpallur fitues OE "N.....V" me vlerë oferte 2,050,000 lekë pa TVSH. Me shkresën nr. 554, datë 26.12.2014, nga kryetari i KVO është përcjellë për miratim procedura tek titullari i AK. Me shkresën nr. 554/1, datë 26.12.2014 ka bërë miratimin e procedurës duke shpallur fitues* OE "N.....V" me vlerë oferte 2,050,000 lekë).
Të gjithë këto shkresa tregojnë se procedura është zhvilluar më vonë se është lidhur kontrata me subjektit, pra kemi një paracaktim të procedurës për fetusin shpallur, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: N. Q me detyrë shef. Kadastre, A. P. me detyrë ish- Pëgj. Finance Tetor 2014 – Korrik 2015, B. SH. me detyrë topograf në zyrën e bujqësisë dhe titullari i AK L. P.

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 200-2011 të Projekt raport Auditimit)*

- **Auditimi i procedurave të prokurimit në ish-Komunën Novosel (sot NJA Novosel, Bashkia Vlorë) .**

-Nga ana e titullarit të AK nuk është bërë ndarja e detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe të zyrtarëve të përfshirë në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesit, veprim ky në kundërshtim me shkronjën "a", pika 1, Kreu V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, **ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK K. SH.**

-Emërimi i anëtarëve të Njësisë së Prokurimit nuk është me nivel me arsim të lartë dhe për asnjë moment nuk vërtetohet me trajnimet e ndryshme që këto anëtarë mund të kenë kryer, veprime në kundërshtim me germën (b) pika 1, Kreu V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar me VKM nr. 914 datë 29.12.2014, ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK.

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se për periudhën 01.01.2015 – 30.07.2015 janë kryer 2 procedura prokurimi me fond limit 4,530,766 lekë, sipas pasqyrës poshtë:

| Nr. | Objekti prokuruar | Dt. Zhvillim | Lloj | Fondi limit |
|---|---|---|---|---|

| | | tenderi | procedure | pa TVSH në 000/lek |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Rik. rrugë të brendshme fshati Fitore | 10.4.2015 | KP | 3,333,333 |
| 2 | Rik. rrugë të brendshme fshati Fitore II | 18.5.2015 | KP | 1,197,433 |
| ***Shuma blerje me Vlera te mëdha*** | | | | ***4,530,766*** |

*(Të dhënat janë hedhur nga grupi i auditimit të KLSH)*

Nisur të dhënat e pasqyrës, grupi i auditimit të KLSH auditoi 2 procedurat e prokurimit me vlerë të lartë, si më poshtë vijon:

**1. Tenderi me objekti**: *"Rikonstruksion i rrugëve të brendshme fshati Fitore".*

| Zhvillimi i Procedurës me objekt **: "***Rikonstruksion i rrugëve të brendshme fshati Fitore"***"** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi** nr. 20/1, datë 19.3.2015<br>**2. Lloji i Procedurës -"***Kërkesë propozim*" | **3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit**<br>Urdhër nr. 20/1, datë 19.3.2015<br>O. A. me detyrë specialist Kontrolli në terren NJA Novosel<br>J. H. me detyrë specialist protokoll arkivës NJA Novosel<br>L. M. me detyrë ish- Punonjës i Policisë së Komunës | **4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhër nr. 28, datë 26.3.2015<br>Sh. M. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Urbanistikës<br>D. A. me detyrë specialist ndihmës shoqërore NJA Novosel<br>A. H. |
| **5. Fondi Limit (pa TVSH)**<br>3,333,333 lekë | **6. Oferta fituese (pa TVSH)**<br>OE "S.....K " me ofertë 2.318.550 lekë me kontratë ---, datë 15.5.2015 me afat 30 ditë. | **7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)**<br>1,198 mijë lekë ose 35.9 % |
| **8. Data e hapjes së tenderit**<br>Datë 10.4.2015, ora 10.oo | **9. Burimi Financimit**<br>Të ardhurat e komunës | **10. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender **11** OE/BOE<br>b) Skualifikuar 2 OE/BOE,<br>c) Kualifikuar **9** OE/BOE |
| **11. Ankimime**<br>**AK**- nr. , dt. 24.4.2015---;<br>**APP**–s'ka/ka;<br>**KPP**-s'ka/ka | **12. Përgjigje Ankesës** nga AK<br>Shkresa nr. ---, dt. 27.4.2015- | **13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP<br>Shkresa nr..... datë |

**Zhvillimi procedurës.** Me procesverbal nr. 1, datë 26.3.2015 është bërë njoftimi i 5 OE në procedurën kërkesë me propozim me objekt: *"Rikonstruksion i rrugëve të brendshme fshati Fitore",* respektivisht "S.....K", "C....O", "A.....g", "S.....i" dhe "S.....K".

Me procesverbal nr. 2, datë 10.4.2015 është bërë hapja dhe vlerësimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, procesverbal i cili në fund do ju vihet në dispozicion pjesëmarrësve.

Sipas këtij procesverbali në këtë procedurë kanë marrë pjesë 11 OE, ku është Skualifikuar një dhe kualifikuar 10 OE.

| Nr. | Operatori ekonomik/ Bashkim operatorëve | Oferta ekonomike | Kualifikuar / ose Skualifikuar (PO/JO) | Argumente s 'kualifikimin |
|---|---|---|---|---|
| 1. | A.....O | 2.662.000 | PO | |
| 2. | SH.....I | 2.555.700 | PO | |
| 3. | SH.....I | 0 | JO | *Nuk ka paraqitur oferte ekonomike* |
| 4. | C....O | 3.252.500 | PO | |
| 5. | E.....T | 2.710.200 | PO | |
| 6. | F.....I | 2.408.950 | PO | |
| 7. | I.....A | 2.135.900 | PO | |
| 8. | L.....I | 2.340.250 | PO | |

| Nr. | Operatori ekonomik/ Bashkim operatorëve | Oferta ekonomike | Kualifikuar / ose Skualifikuar (PO/JO) | Argumente s 'kualifikimin |
|---|---|---|---|---|
| 9. | S.....O | 2.318.550 | PO | |
| 10. | S.....K | 2.230.140 | PO | |
| 11. | Z.....O | 2.712.700 | PO | |

Me shkresën nr. REF-Nr.20/1, datë 05.05.2015 është hartuar raporti përmbledhës nga KVO, ku nga 11 OE plotësojnë kriteret e dokumentacionit teknik dhe financiare 10 OE dhe nuk plotëson 1 (një). Konstatohet se vlerësimi i ofertave nga KVO nuk është bërë brenda afatit ligjorë të përcaktuar (15 ditë nga momenti i hapjes), por është bërë **me 10 ditë vonesë,** veprim në kundërshtim me nenin 66-*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar ku thuhet se: *" Kohëzgjatja e procedurës nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla*", veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO: Sh. M. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Urbanistikës, D. A. me detyrë specialist ndihmës shoqërore NJA Novosel dhe A. H. me detyrë specialist në Drejt. Pronave Publike NJA Novosel.

KVO ka Skualifikuar dhe OE "I.....A" me vlerë 2,135,900 lekë për faktin se paraqet një vlerë anomalisht e ulët, për të cilën KVO nuk ka kërkuar sqarim nga shoqëria në lidhje me ofertën, në zbatim të nenin 53, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar,
Nisur nga vlera e ofertës të OE të mbetur në garë, KVO ka shpallur fitues OE "S.....K" me ofertë 2,230,140 lekë pa TVSH, më të ulët se OE e mbetur, por më të lartë se OE "I.....A". Ky raport është nënshkruar vetëm nga ana e Kryetarit të KVO; Sh. M. dhe jo nga anëtari tjetër, në kundërshtim me nenin 68-*Raporti përmbledhës*, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar.
Me shkresën datë 27.4.2015 të Kryetarit të KVO; Sh. M. është njoftuar titullari i AK mbi shqyrtimin e ankesë, në të cilën theksohet se nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit për analizën e çmimeve, KVO vendosi të bëjë rivlerësimin e tenderit.
Me formularë ankesë (shtojca 20) datë 24.04.2015, subjekti 'I.....A", ka paraqitur ankesë për s 'kualifikim të padrejtë, me pretendimin se ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët. Në këtë ankesë sqaron se nga AK nuk më është kërkuar sqarim në lidhje me ofertën anomalisht të ulët për të cilën bashkëlidhur po paraqes dhe analizën e zërave të punës për Pretendimimin e ofertës.
Me urdhër nr. 1, datë 27.4.2015 të titullarit të AK, është urdhëruar pezullimi i procedurës deri në shqyrtimin e ankesës, për të cilën ngarkon për shqyrtim anëtarët e KVO, gjë e cila është në kundërshtim me Kreun X-*Shqyrtimi i Ankesave*, neni 78-*Ankesat në autoritetin kontraktor (AK)*, pika 6 shkronja (a), të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK.
Me vendim nr. 2, datë 5.5.2015 titullari i AK ka miratuar raportin përfundimtar të KVO. Me shkresën nr. , datë 5.5.2015 është bërë njoftimi i fituesit, shpallur në buletinin nr. 18, datë 11.5.2015. -Me shkresën nr. 99, datë 15.5.2015 është bërë njoftimi i kontratës dhe lidhur kontrata me subjektin "I.....A" me ofertë 2,135,900 lekë pa TVSH.

**D-Shqyrtimi i procedurës.** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në dosjen e procedurës dhe sistemin app, konstatohet se s 'kualifikimin i OE "I.....A" me ofertë ekonomike 2,135,900 lekë pa TVSH nuk është i drejtë, pasi subjekti megjithëse ka paraqitur analizë e zërave të preventivit, oferta e paraqitur nuk është anomalish e ulët, si vijon:
Mo = (2,662,000 + 2,555,700 + 3,252,500 + 2,710,200 + 2,408,950 + 2,135,900 + 2,340,250 + 2,318,550 + 2,230,140 + 2,712,700) / 10 = 2,532,689
ZM = 80% X 2,532,689 = 2,061,151
O = 2,135,900 > 2,061,151
**Në këto kushte oferta e paraqitur nuk është anomalish e ulët (vlerësim i gabuar i KVO)**
**Konkluzioni:** Në vlerësimin dhe shpalljen fitues të procedurës, KVO nuk ka vlerësuar drejt ofertën e paraqitur nga OE "I.....A" me ofertë 2,135,900 lekë, duke e Skualifikuar si ofertë anomalishit të ulët dhe kualifikuar OE "S.....K" me ofertë 2,230,140 lekë, ose më shumë se OE "I.....A" për vlerën **94,240 lekë, e cila konsiderohet dëm ekonomik** në buxhetin e ish-Komunës Novosel, në kundërshtim me në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 1 "Objekti dhe qëllimi" pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), Neni 2 "Parimet e përzgjedhjes" germa (a), (b) dhe (c), dhe me Nenet 46, 53 dhe 55, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO i përbërë: Sh. M. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Urbanistikës, D. A. me detyrë specialist ndihmës shoqërore NJA Novosel dhe A. H. me detyrë specialist në Drejt. Pronave Publike NJA Novosel dhe K. SH.

**E-Zbatim i kontratës.** Sipas kontratës nr. 99, datë 15.5.2015 afati për përfundimin e punimeve është 30 ditë kalendarike, nga data e nënshkrimit të kontratës ose deri me datë 15.6.2015.
Referuar dokumentacionit në dosje, sipërmarrësi i punimeve me datë 15.6.2015 ka bërë njoftimin për përfundimin e punimeve, pra brenda afati të përcaktuar në kontratë.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Nga subjekti Bashkia Vlorë (ish- Komuna Novosel) në kundërshtitë e paraqitura me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1028/11, datë 10.04.2018), nuk është argumentuar problemi mbi kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "S.....K" dhe problemet e tjera të trajtuara në këtë procedurë, problemet e trajtuara nga grupi i KLSH dhe materiali mbetet i pandryshuar.*

## ➢ Auditimi i procedurave të prokurimit në ish- Bashkinë Orikum (sot NJA Orikum, Bashkia Vlorë).

Referuar të dhënave të marra nga ish- Bashkia Orikum, konstatohet se për periudhën 01.01.2015 – 30.07.2015 janë kryer **2** procedura prokurimi me fond limit 20,412,676 lekë, sipas pasqyrës poshtë:

| Nr. | Objekti prokuruar | Dt. Zhvillim tenderi | Lloj procedure | Fondi limit pa TVSH në lek |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Gjelbërim i segmenti rrugor Pashaliman-Orikum-Llogara | 5.01.2015 | HAPUR | 17,970,255 |
| 2 | Shtrim me bare sintetik F.....A minifuitbollit Orikum | 30.3.2015 | HAPU | 2,442,421 |
| | **Shuma blerje me Vlera te madhe** | | | **20,412,676** |

*(Të dhënat janë hedhur nga grupi i auditimit të KLSH)*

**1. Tenderi me objekti**: *"Gjelbërim i segmenti rrugor Pashaliman-Orikum-Llogara".*

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:***
*Në shpjegimet e dhëna nga subjekti audituar (ish-Bashkia Orikum), paraqitur me shkresën nr. 1122/2, datë 12.02.2018, sqarojmë se problemet e trajtuara nga grupi i auditimit të KLSH mbi kualifikimin e pa drejtë të BOE "B.....3" + "J.....a" + "B.....l" nuk qëndrojnë, pasi subjekti nga ana e tij ka argumentuar me dokumentacion ligjorë të gjitha mangësitë e konstatuara nga KLSH, se nuk janë dhe kualifikimi i këtij BOE është në përputhje me kërkesat e DST.* ***Pretendimi i paraqitur merret në konsideratë.***

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 201-2015 të Projekt raport Auditimit)*

## III/4.1 ZBATIMI I KONTRATAVE TË PUNIMEVE.

*Projekti*
Projekti për këtë investim është hartuar nga studio e projektimit *"T.....N"* dhe parashikon zëra punimesh për rikonstruksionin e aksit rrugor, punime trotuari, vepra arti si dhe punime ndriçimi.
*Kontratat*
Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE *"SH.....I"* , me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 5586/6 datë 11.02.2016, me përfaqësues ligjor SH. K. si dhe me drejtues teknik të objektit ing. E. Q. Punimet në objekt janë kryer sipas kontratës me nr. 2180 prot., datë 20.03.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE me vlerë të kontratës 70,386,000 lekë me TVSH dhe me afat zbatimi kontrate 3 muaj nga dita e lidhjes së kontratës. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas Urdhrit me nr. 2181 prot., datë 20.03.2017 të Titullarit të AK, me nr. 41 datë 20.03.2017, është caktuar ing. I. T me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh ndërtimi MK.2569 datë 09.03.2015. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 7512 prot., datë 04.09.2017 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me ing. N. V. përfaqësues ligjor i subjektit *"D.....S"* me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh ndërtimi MK.1676/4 datë 25.01.2016 me vlerë të kontratës 25,440 lekë.
*Zbatimi i punimeve*
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dosja teknike paraqitet me mangësitë si më poshtë:

- Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit i datës 22.03.2017 rezulton i pa firmosur nga ana e Titullarit të AK Bashkia Vlorë apo përfaqësues të autorizuar të tij;
- Procesverbali i fillimit të punimeve i datës 22.03.2017 rezulton i pa firmosur nga ana e Titullarit të AK Bashkia Vlorë apo përfaqësues të autorizuar të tij;

Sipas njoftimeve përkatëse, punimet kanë filluar me datë 22.03.2017 dhe kanë përfunduar me datë 22.06.2017, pra në një afat kohor prej 3 muajsh. Punimet janë kolauduar më datë 08.09.2017 dhe objekti është marrë në dorëzim përkohësisht në datë 08.09.2017. Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara e të likuiduara si dhe atyre të kryera në fakt rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuara nga Autoriteti Kontraktor me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **8,186,306 lekë pa TVSH**. Gjatë inspektimit në terren të punimeve të maskuara, në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve dhe përfaqësuesve të KLSH – së, nga 9 sondazhe të kryera për shtresat nën paketën asfaltike, rezultoi se nuk janë respektuar zërat e parashikuar të punimeve, të përcaktuara këto në projektin dhe preventivin kontratës së sipërmarrjes apo ndryshimeve

të miratuara nga Autoriteti Kontraktor. Sipas zërave të situacionit përfundimtar dhe atyre që paraqiten në librezën e masave, shtresat mbajtëse të rrugës duhet të jenë si më poshtë:
**- 8 cm** mbushje me çakëll për të gjithë gjatësinë e aksit (saktësisht gjatësia prej 2788 ml);
**- 27 cm** mbushje me çakëll e gur guroreje në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri për të gjithë gjatësinë e rrugës (saktësisht gjatësia prej 2933 ml);
**- 15 cm** çakëll mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri për të gjithë gjatësinë e rrugës si dhe tre degëzimet;
**- 15 cm** stabilizant për të gjithë gjatësinë e rrugës si dhe tre degëzimet;
**- 8 cm** stabilizant për dy bankinat, për një gjatësi prej 5169 ml dhe gjerësi 0.8 ml;
Pra, në total, kjo paketë parashikon një trashësi me çakëll (50 cm) dhe me stabilizant (15 cm) në total prej 65 cm nga kuota e gërmimit. Në fakt, nga verifikimi në terren i punimeve të përfunduara rezultoi se (kjo të paktën për sondazhet e kryera) shtresat mbajtëse të rrugës janë realizuar direkt mbi rrugën ekzistuese pa kryer punimet e gërmimit sipas profilave tërthorë të paraqitur në librezën e masave. Gjithashtu, nuk është respektuar paketa me trashësi 65 cm por janë realizuar dy zëra të ndryshëm nga ata të parashikuar, një shtresë me zhavorr lumi me trashësi mesatare e cila varion nga 5 cm në jo më shumë se 20 cm si dhe një shtresë me stabilizant me trashësi e cila varion nga 5 cm në jo më shumë se 10 cm. Këto ndryshime nuk janë reflektuar në asnjë prej dokumenteve që përmban dosja teknike duke likuiduar volumet e gërmimit, shtresës së çakllit me t=50 cm dhe shtresës së stabilizantit me t=15 cm kur në fakt janë kryer punime me një shtresë mesatare me zhavorr lumi me t=20 cm dhe një shtresë mesatare stabilizanti me t=10 cm. Pra nga një paketë prej 65 cm është kaluar në një paketë shtresash me jo mi shumë se 30 cm. Për të gjithë gjatësinë e aksit (referuar përsëri 9 sondazheve të kryera) nuk janë kryer punime gërmimi të rrugës ekzistuese por vetëm në kanale dhe për zgjerim rruge. Kjo, rezultoi nga fakti se në të gjitha sondazhet e kryera u gjet e pa gërmuar shtresa e asfaltit (apo rërës bituminoze) e cila ka qenë ekzistuese, pra përpara kryerjes së investimit, çka do të thotë se shtresat e zhavorrit dhe e stabilizantit janë realizuar direkt mbi rrugën ekzistuese dhe jo pas realizimit të gërmimeve. Nga ana e grupit të auditimit rezultoi praktikisht e pamundur përcaktimi i saktë i diferencave në volume pune të pakryera lidhur me gërmimin. Gjithashtu, nisur nga fakti se në situacion përfundimtar janë pasqyruar volume pune në gërmim më pak nga ato të librezës së masave, për këtë zë nuk u përllogaritën diferenca në volume pune të pakryera.
Konstatohet se zërat e situacionit përfundimtar, nga mënyra se si paraqiten bien në kundërshtim logjik dhe teknik. Referuar prerjeve të seksioneve tërthore të gërmimeve, ky volum pune është pasqyruar si i kryer për ndërtimin e kasonetës së rrugës, ndërkohë që zëri *"Mbushje me çakëll në trupin e rrugës"* pretendohet të jetë përdorur për mbushjen e gropave. Në fakt, nëse kemi gërmim kasonete në trup rruge (kasonetë për shkak të prerjes tërthore), nuk mund të kemi njëkohësisht mbushje gropash. Zërat e mësipërm me çakëll dhe stabilizant i referohen një shtrese me 50 cm çakëll (8 cm + 27 cm + 15 cm) dhe me 15 cm stabilizant kur në fakt, gjatë inspektimit në objekt në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve kjo paketë shtresash nuk rezultoi në asnjë rast nga 9 sondazhet e kryera të kryera nga të dyja anët e rrugës. Nga materiali fotografik i ndodhur në dosjen teknike si dhe në materialet e sjella me observacion si dhe ato të njohura në takimin ballafaques përfundimtar (takimi i mirëkuptimit) konstatohet se aksi rrugor ka patur praninë e gropave të thella.
Nga sa më sipër arrihet në konkluzionin se libreza e masave është një dokument i cili nuk pasqyron punimet faktike të kryera në objekt dhe materialet mbushës të këtyre gropave nëse janë çakëll apo zhavorr kjo nuk mund të përcaktohen pa sondazhe nëpërmjet procesit të karrotazhit. Ajo që është fakt

dhe që konstatohet në sondazhet e kryera është se nën paketën asfaltike nuk ka 50 cm çakëll dhe 15 cm stabilizant por ka jo më shumë se 20 cm shtresë me zhavorr dhe jo më shumë se 10 cm stabilizant (apo çakëll + stabilizant).

Siç duket dhe në materialet fotografike më poshtë, materiali i përdorur për shtresat nën rrugë është zhavorr dhe jo çakëll guroreje apo mbeturinë kave. Gjithashtu, disa nga materialet fotografike (nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3) tregojnë për realizimin e shtresave të rrugës mbi atë ekzistuese pa kryer paraprakisht punime gërmimi pasi nga prerja e rrugës rezultoi prania e asfaltit ekzistues (apo asfaltit bituminoz):

Foto nr. 1

Foto nr. 2

Foto nr. 3

Foto nr. 4

Foto nr. 5

Foto nr. 6

Për sa i përket punimeve të kryera për trotuaret u konstatua se nuk janë respektuar detajet e projektit të zbatimit duke u likuiduar volume pune të pakryera në fakt. Konkretisht, u konstatua se shtresa me zhavorr, e parashikuar për tu realizuar me 20 cm nën pllakat e trotuareve, në fakt është realizuar me trashësi mesatare jo më shumë se 10 cm. Gjithashtu nën trotuar nuk është realizuar shtresa me stabilizant me trashësi t=10 cm. Pllakat e trotuarit sipas projektit të zbatimit dhe situacionit përfundimtar janë paraqitur me trashësi 6 cm kur në fakt rezultuan me trashësi 5.5 cm. Këto fakte rezultuan në 4 sondazhe të kryera gjatë inspektimit në terren në prani të mbikëqyrësit të punimeve si dhe përfaqësuesve të KLSH – së. Konkretisht rezultoi si më poshtë:

Foto nr. 7

Foto nr. 8

Tabela nr. 1

| Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Vol. | Vlera |
| **I. PUNIME SHTRESASH RRUGORE** | | | | | | | |
| Mbushje me çakëll e gur guroreje në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri | $m^3$ | 800 | 4356.1 | 4356.1 | 0 | 4356.1 | 3,484,800 |
| Shtresë çaklli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri | $m^2$ | 420 | 24325.8 | 21050.8 | 21050.8 | 3,275 | 1,375,500 |
| | | | | | | **Total** | **4,860,300** |

Të argumentuara këto si më poshtë:

- Mbushje me çakëll e gur guroreje në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri

Situacioni përfundimtar pasqyron në total për të gjithë gjatësinë e rrugës volumin prej 4356.1 $m^3$ mbushje me çakëll e gur guroreje në trupin e rrugës. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike *(gjatësi x gjerësi x lartësi)* 2933.4 ml x 5.5 ml x 0.27 ml. Në fakt, nga verifikimi në terren i punimeve në prani të mbikëqyrësit të punimeve rezultoi se ky volum pune nuk është kryer. Në asnjë rast nuk rezultoi të kishte një shtresë çaklli përgjatë aksit rrugor me trashësi të shtresës h=27 cm. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 4356.1 $m^3$ mbushje me çakëll.

- Shtresë çaklli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri

Situacioni përfundimtar pasqyron në total për të gjithë gjatësinë e rrugës si dhe tre degëzimet volumin prej 24325.8 $m^2$ shtresë çaklli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri. Libreza e

masave paraqet në mënyrë të analitike volumin prej 21,050.8 $m^2$ shtesë çaklli. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 3275 $m^2$ shtresë me çakëll.

Si rrjedhojë e mos ndryshimit të zërave në situacionin përfundimtar sipas punimeve të kryera në fakt, pra duke ruajtur çmimet për punime shtresash me çakëll t=15 cm dhe stabilizant me t=15 cm e duke mos i ndryshuar këto çmime për punime me shtresë zhavorri t=20 cm dhe shtresë stabilizanti me t=10 cm për punimet e rrugës si dhe duke mos ndryshuar çmimin nga shtresë me zhavorr me t=20 cm në shtresë me t=10 cm për punimet e trotuarit, i janë likuiduar tepër në vlerë sipërmarrësit të punimeve shumë prej **3,326,006 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Konkretisht tabela:

Tabela nr. 2

| Zëri i punimeve | Njësia | Sasia në preventiv | Çmimi i preventivit | Çmimi faktik | Diferenca ne + | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Çmim | Vlera |
| **I. PUNIME SHTRESASH RRUGORE** | | | | | | |
| Shtresë çaklli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri | $m^2$ | 21050.8 | 420 | 300 | 120 | 2,526,096 |
| Shtresë stabilizanti t=15 cm përhapur e ngjeshur me makineri | $m^2$ | 20473.1 | 320 | 300 | 20 | 409,460 |
| **II. PUNIME NDËRTIMI NË TROTUAR** | | | | | | |
| Shtresë zhavorri lumi t=20 cm | $m^2$ | 2603 | 300 | 150 | 150 | 390,450 |
| | | | | | **Shuma** | **3,326,006** |

Të argumentuara këto si më poshtë:

- Shtresë çaklli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri

Situacioni përfundimtar pasqyron në total për të gjithë gjatësinë e rrugës si dhe tre degëzimet volumin prej 24325.8 $m^2$ shtresë çaklli mbeturinë kave me t=15 cm. Libreza e masave paraqet në mënyrë të analitike volumin prej 21,050.8 $m^2$ shtesë çaklli. Në fakt, siç u shpjegua edhe më sipër ky zë nuk është realizuar me çakëll por me zhavorr lumi me trashësi nga 10 cm në jo më shumë se 20 cm (mesatarisht 15 cm). Duke bërë korrigjimet përkatëse dhe duke marrë si referencë çmimin e ofertuar nga vetë sipërmarrësi për këtë zë (zëri me nr. analize 3.205/2 *"Shtresë zhavorr lumi t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri"*, tek punimet e trotuareve) rezulton se janë likuiduar më tepër në vlerë si rrjedhojë e diferencës së çmimit të zërit të parashikuar dhe atij të kryer në fakt, konkretisht mes çmimit 420 lekë/$m^2$ të ofertuar për shtresë çakllit me t=15 cm dhe 300 lekë/$m^2$ për zërin e kryer në fakt për këtë pjese me t=20 cm. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi vlera prej 2,526,096 lekë.

- Shtresë stabilizanti t=15 cm përhapur e ngjeshur me makineri

Situacioni përfundimtar pasqyron në total për të gjithë gjatësinë e rrugës si dhe tre degëzimet volumin prej 20473.1 $m^2$ shtresë stabilizanti me t=15 cm. Libreza e masave paraqet në mënyrë të analitike volumin prej 20473.7 $m^2$ shtesë stabilizanti. Në fakt, siç u shpjegua edhe më sipër ky zë nuk është realizuar me stabilizant me t=15 cm por me trashësi jo më shumë se 10 cm. Duke bërë korrigjimet përkatëse dhe duke marrë si referencë çmimin e ofertuar nga vetë sipërmarrësi për këtë zë (zëri me nr. analize 3.212/b *"Shtresë stabilizanti t=10 cm"*, tek punimet e trotuareve) rezulton se janë likuiduar më tepër në vlerë si rrjedhojë e diferencës së çmimit të zërit të parashikuar dhe atij të kryer në fakt, konkretisht mes çmimit 320 lekë/$m^2$ të ofertuar për shtresë stabilizanti me t=15 cm dhe 300 lekë/$m^2$ për zërin e kryer në fakt për këtë pjese me t=10 cm. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi vlera prej 409,460 lekë.

- Shtresë zhavorri lumi t=20 cm

Situacioni përfundimtar pasqyron në total volumin prej 2603 $m^2$ shtesë me zhavorr nën trotuar. Libreza e masave paraqet në mënyrë të analitike të njëjtin volumi. Në fakt, nga verifikimi në terren i punimeve në prani të mbikëqyrësit të punimeve dhe përfaqësuesve të KLSH – së, në 4 sondazhe, rezultoi se ky zë është kryer me një trashësi mesatare t=10 cm por dhe jo me trashësi t=20 cm sa pasqyrohet në librezën e masave, situacionin përfundimtar dhe projektin e zbatimit. Duke bërë korrigjimet përkatëse dhe duke marrë si referencë çmimin e ofertuar nga vetë sipërmarrësi për këtë zë rezulton se janë likuiduar më tepër në vlerë si rrjedhojë e diferencës së çmimit të zërit të parashikuar dhe atij të kryer në fakt, konkretisht mes çmimit 300 lekë/$m^2$ dhe 150 lekë/$m^2$ (300 lekë/$m^2$/2). Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi vlera prej 390,450 lekë.
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën **8,186,306 lekë pa TVSH**, sipërmarrësit të punimeve si rrjedhojë e punimeve të pakryera apo prej mos ndryshimit të zërave të situacionit përfundimtar sipas zërave faktik të kryer në objekt, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
-Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve ***ing. I. T*** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.

-Nga ana e kolaudatorit të punimeve ***ing. N. V.*** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3.

Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. nr. 7512 prot., datë 04.09.2017.
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, *Ing. I. T* si dhe nga ana e kolaudatorit të punimeve, *Ing. N. V.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 dhe Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me këtë objekt nga subjekti janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 3048/1, datë 20.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/12, datë 23.04.2018), nga mbikëqyrësi ing. I. T.*
***Pretendimi i subjektit:***
*Për sa më sipër firmosja e këtyre proceseve mbasi është depozituar si dokumentacion në Bashki nga ana e Sipërmarrësit dhe Mbikëqyrësit të punimeve duhet të ishte realizuar nga personat përgjegjës të institucionit mbi mbarëvajtjen e dokumentacioneve teknike, për të cilat ajo është e pranishme. Kjo duhet të jetë një lapsus teknik nga ana e institucionit.*
***Përgjigja:*** *Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë pasi aktet e pa firmosura rezultuan të ishin pjesë e dosjes teknike të dorëzuar nga sipërmarrësi e të kontrolluar nga mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve. Observacioni nuk merret në konsideratë.*
***Pretendimi i subjektit:*** *Sipas sondazheve të kryera nga ana juaj dhe mos njoftimin në objekt për verifikim dhe kontroll të punimeve te mbikëqyrësit të objektit parashtroj sa më poshtë:*

*- Së pari vëmë re në objekt që traseja e rrugës është e paçedueshme dhe e padëmtuar nga makineritë e rënda të ndërtimit që kalojnë në këtë segment rrugë me tonazh tepër të lartë .*
*- Ngjyra e asfaltit është e njëjtë me ngjyrën e përfundimit të punimeve.*
*Pesha në aks e lëvizjes në këtë segment rruge, të ndërtuar nga shoqëria sipërmarrëse është me e madhe se N=50 Ton. Duke kaluar të gjithë kamionët që punojnë në qytetin e Vlorës, duke përfshire këtu edhe rrugën e Lumit të Vlorës, rezulton që nuk ka asnjë lloj dëmtimi të sipërfaqes së asfaltuar, së bashku me nënshtresat si dhe bankinave përkatëse, edhe pse mjetet e*
*rënda kalojnë një gomë në bankinë. Janë vendosur të gjitha nënshtresat e rrugës sipas projektit dhe akoma edhe 20 % me shumë se vlera e preventivit të kontratës. Janë bërë gërmimet për zgjerimin dhe profilimin e të gjithë sipërfaqes së rrugës. Kjo rrugë ka patur rreth 70 % të sipërfaqes së saj gropa të thella dhe të pakalueshme për mjetet e vogla – veturat etj. Gërmimet që janë bërë nga sipërmarrësi janë arritur në aftësi mbajtëse në tokë të fortë me sigmë δ=2.5 dk N/m$^2$. Këtu janë të gjitha sasitë e mbushjes me gurë kave dhe mbushje me çakëll për rrugën ku në bazë të thellësive të paraqitura është marrë një lartësi mesatare mbi gërmimin në trupin e rrugës dhe jo ato pretendimet që deklaroni ju. Deri këtu që po ju sqaroj jemi në profilimin e gropave në trupin e rrugës. Gërmimet që janë bërë nga sipërmarrësi janë arritur në aftësi mbajtëse, në tokë të fortë me sigmë δ=2.5 dk N/m$^2$. Pas kësaj është urdhëruar kompania e ndërtimit nga ana ime si mbikëqyrësi i objektit, që të filloj me paketën e rrugës. Të gjithë nënshtresat e rrugës janë kryer me çakllin e kavës së gurores së Drashovicës. Në momentin me furnizim me çakëll nga Drashovica, gjithashtu na u kërkua nga investitori Bashkia Vlorë dhe Njësia Administrative të mbushnim të gjithë sipërfaqen e rrugës prej 5 km që lidh fshatin Risli me fshatin Xhyherinë. Kjo rrugë ishte një rrugë bujqësore për bagëtinë dhe aty janë hedhur mbi 10.000 m$^3$ çakëll dhe pas kësaj ka filluar puna ne kantier, sepse u be bllokimi i rrugës për kryerjen e punimeve ne Risli dhe i gjithë trafiku u devijua në këtë segment tjetër të rrugës të punuar nga shoqëria e ndërtimit me kosto ndërtimi dhe punë zero. Shoqëria nuk kishte arsye të merrte çakëll në lumë, kur në një distance 5 km larg kishte guroren, në distance më të afërt se lumi. Citojmë unë nën cilësinë e mbikëqyrësit në këto momente me intereson aftësia mbajtëse e të gjithë materialeve që janë përdorur në objekt. Si rendiment i kësaj me sipër unë si mbikëqyrës kam përfituar një sipërfaqe rruge të paçeduar në asnjë vend dhe të pa rrudhosur në asnjë vend, ku siç përmenda më sipër kemi lëvizje të mjeteve me tonazh të madh me peshë në aks me N > 50 Ton.*
***Përgjigja:*** *Lidhur me pretendimin tuaj për mos njoftim, sqarojmë se kjo nuk ishte e nevojshme pas kontaktimit direkt me ju ditën në të cilën u krye inspektimi në objekt në prezencën tuaj. Të dhënat e pasqyruara në librezë masash dhe në situacion janë kontradiktore dhe nuk paraqesin faktin. Edhe vetë emërtimet e punimeve*
***Pretendimi i subjektit:*** *Trotuari ka shtresën e zhavorrit të lumit, shtresën e stabilizantit si edhe shtresën e betonit dhe mbi ketë shtresë janë vendosur pllakat e parapërgatitura me trashësi t=6 cm. Për të gjitha volumet te realizuar ne vepër janë 20 % më shumë të të gjithë zërave të punimeve sesa vlera totale. Për këtë kemi realizuar dhe kemi kërkuar Bashkisë Vlorë me shkresën Nr. 2608/17 Prot. Datë.26.08.2017 me lenden kërkesë për shtesë fondi deri ne 20 % të vlerës së kontratës. (Punime të kërkuara nga vetë institucioni). Është shtruar pothuajse në të dyja anët e trotuarit dhe bankinës, tubo Ø 315 korrogato në sasi prej 837 ml e cila nuk ka qenë e parashikuar në projekt por e nevojshme dhe e rëndësishme në objekt për tu vendosur e cila nuk është marrë asnjë lek nga shoqëria sipërmarrëse.*
***Përgjigja:*** *Lidhur me volumet e punimeve të realizuara tepër në masën 20 % sqarojmë se kjo praktikë nuk i është vënë në dispozicion grupit të auditimit dhe nuk merret në konsideratë si argument pasi për*

*aq kohë sa nuk ka marrë miratim nga AK si dhe për aq kohë sa nuk ka ndryshim projekti, në kushte të tilla nuk ka gjurmë auditimi. Për sa i përket shtresës me zhavorr ky volum rezultoi se në të gjitha sondazhet se ishte jo më shume se 10 cm. Për këtë arsye observacioni juaj nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë.*
*Grupi i auditimit merr në konsideratë kundërshtitë lidhur me trashësinë e shtresës së pllakave pas saktësimit të detajit të tyre si dhe për shtresën me stabilizant nën trotuar pas krahasimit të kostos me materialit të përdorur në fakt dhe atij të pasqyruar në librezë masash dhe ne situacionin përfundimtar.*
*Grupi i auditimit merr në konsideratë kundërshtitë si dhe argumentet e dhëna pas ballafaqimit në takimin e mirëkuptimit lidhur me përdorimin e çakllit për mbushjen e gropave sipas zërit me nr. analize An. 164/1a "Mbushje me çakëll në trupin e rrugës".*
*Grupi i auditimit merr në konsideratë kundërshtitë si dhe argumentet e dhëna pas ballafaqimit në takimin e mirëkuptimit lidhur me shtresën e stabilizantit pas Pretendimimit të përdorimit të kësaj sasie materiali edhe në pjesën nën bankinat dhe sipas pjerrësisë së seksionit tërthor*

**2. Objekti "Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian", Vlorë.**

Preventivi i përdorur në përcaktimin e fondit limit të investimit është hartuar nga ing. I. T, ing. D. Ç. dhe ing. S. Q. Investimi parashikon ndërhyrjen nëpërmjet prishjes dhe rikonstruktimin e disa banesave të 33 familjeve të komunitetit Egjiptian, sipas pasqyrës Aneks 4/1 bashkëlidhur Raport Auditimit.

Sipas relacionit të hartuar nga grupi i punës, projekti për këtë investim synon përmirësimin e kushteve të jetesës së këtij komuniteti e konkretisht ndërhyrjen në punimet e çative, hidroizolimin e soletave, shmangien e lagështisë, heqjen dhe vendosjen e dyerve dhe dritareve si dhe në disa raste rikonstruksionet e tualeteve. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet si më poshtë:

-Procesverbali i fillimit të punimeve rezulton i pa firmosur nga ana e përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor;

-Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit rezulton i pa firmosur nga ana e përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor;

-Mungon licenca e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve;

-Mungon plan – organizimi i punimeve;

Lidhur me zbatimin e punimeve, në prani të përfaqësuesve të KLSH, mbikëqyrësit të punimeve, përfaqësuesit të Bashkisë Vlorë dhe ZH. V. përfaqësuese e këtij komuniteti, gjatë inspektimit në terren të 15 banesave nga 33 në total u konstatua se në të çdo njërën prej tyre punimet ishin me mangësi si dhe me diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt. U konstatua se në disa raste dritaret ishin të pasilikonuara në konturet anësore të mureve, në shumë raste shtresa e katramasë nuk ka mbuluar faqet vertikale të soletës duke u bërë kështu shkak për krijimin e lagështisë dhe amortizimin në një kohë shumë të shkurtër të punimeve të suvatimit dhe lyerjes së jashtme dhe asaj të brendshme.

Disa nga problemet e konstatuar tregohen si më poshtë:

Lavapjata e vendosur inoks dhe jo porcelan në banesën e Besie Jaçe

Plasaritjet e mureve të ndërtuara rishtazi në banesën e z. Nihat Jaçaj

Punimet e d/alumin të realizuara në banesën e P. N.

Punimet e h/izolimit të realizuara në banesën e P.N. të cilat nuk mbulojnë të gjithë konturin e soletës

Punimet e h/izolimit të realizuara në banesën e F. Ç. të cilat nuk mbulojnë të gjithë konturin e soletës

Pamje të ambienteve me lagështi në banesën e P.N.

Gjithashtu, nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar si dhe volumeve faktike të matura në terren rezultuan diferenca si më poshtë:

Tabela nr. 4

| Nr. | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Vol. | Vlera |
| | **BUKURIE BYLYSHI nr. 1** | | | | | | | |
| | BANESA | | | | | | | |
| 1 | Transport mbeturinash | $m^3$ | 496 | 4.59 | 4.59 | 1.81 | 2.78 | 1,379 |
| 2 | Heqje dyer/dritare | $m^2$ | 99 | 6.83 | 6.83 | 5.5 | 1.33 | 132 |
| 3 | F.V derë d/alumini pa xham, me mbushje d/alumini | $m^2$ | 10,900 | 4.48 | 4.48 | 3.73 | 0.75 | 8,175 |
| 4 | F.V dritare d/alumini tek xham | $m^2$ | 8,422 | 2.36 | 2.36 | 1.74 | 0.62 | 5,222 |
| | | | | | | | **Shuma 1** | **14,907** |
| | **BESNIK DOKO nr. 2** | | | | | | | |
| | BANESA | | | | | | | |
| 1 | Prishje çatie ekzistuese | $m^2$ | 198 | 7 | 7 | 0 | 7 | 1,386 |
| 2 | F.V Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla marseljeze | $m^2$ | 2,972 | 7 | 7 | 0 | 7 | 20,804 |
| 3 | Ndërtim tavani me pllaka gipsi 60 x 60 | $m^2$ | 1,982 | 11.52 | 11.52 | 9.3 | 2.22 | 4,400 |
| 4 | Shtresë me pllaka grezë porcelanato | $m^2$ | 1,982 | 12.21 | 12.21 | 9.3 | 2.91 | 5,768 |
| 5 | Prishje suvaje | $m^2$ | 99 | 48.34 | 48.34 | 15 | 33.3 | 3,301 |
| 6 | Suva brenda mur tulle h-4 m me pompë, llac i përzierë M 25 | $m^2$ | 496 | 48.34 | 48.34 | 15 | 33.3 | 16,537 |
| 7 | Bojë hidroplastike | $m^2$ | 149 | 61.96 | 61.96 | 31 | 31 | 4,613 |
| 8 | F.V ndriçues tavanor fluoreshent | copë | 1,486 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1,486 |
| 9 | F.V çelësa priza të nulifikuar 10 A | copë | 496 | 2 | 2 | 0 | 2 | 992 |
| 10 | F.V tub plasmasi ϕ 11 – 13 mm | ml | 19 | 12.2 | 12.2 | 0 | 12.2 | 232 |

| Nr. | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Vol. | Vlera |
| | TUALETI | | | | | | | |
| 1 | Heqje dyer dritare | $m^2$ | 99 | 3.95 | 3.95 | 1.88 | 2.07 | 205 |
| 2 | F.V derë d/alumini pa xham, me mbushje d/alumini | $m^2$ | 10,900 | 3.61 | 3.61 | 1.53 | 2.08 | 22,672 |
| 3 | Suva brenda mur tulle h-4 m me pompë, llac i përzierë M25 | $m^2$ | 496 | 30.39 | 30.39 | 23.7 | 6.69 | 3,318 |
| | | | | | | | **Shuma 2** | **85,713** |
| | **MYSLYM LAMCE nr. 4** | | | | | | | |
| 1 | F.V tjegulla marseljeze | $m^2$ | 1,486 | 32.45 | 32.45 | 13 | 19.5 | 28,903 |
| 2 | Prishje suva e brendshme | $m^2$ | 99 | 129.2 | 129.2 | 0 | 129 | 12,791 |
| 3 | Suva brenda mur tulle h-4 m, me pompë llac i përzierë M 25 | $m^2$ | 496 | 129.2 | 129.2 | 0 | 129 | 64,083 |
| | | | | | | | **Shuma 4** | **105,777** |
| | **ALKETA LAMCE nr. 5** | | | | | | | |
| 1 | Hidroizolim me emulsion bituminoz dhe dy shtresa karton katrama | $m^2$ | 990 | 45.99 | 45.99 | 35.42 | 10.6 | 10,464 |
| 2 | Shtresë me lustër çimento | $m^2$ | 347 | 45.99 | 45.99 | 35.42 | 10.6 | 3,668 |
| | | | | | | | **Shuma 5** | **14,132** |
| | **STEFAN SADIKU nr. 7** | | | | | | | |
| | TUALETI | | | | | | | |
| 1 | F.V derë d/alumini pa xham, me mbushje d/alumini | $m^2$ | 10,900 | 2.94 | 2.94 | 1.4 | 1.54 | 16,786 |
| 2 | F.V dritare d/alumini | $m^2$ | 8,422 | 1.11 | 1.11 | 0.72 | 0.39 | 3,285 |
| | | | | | | | **Shuma 7** | **20,070** |
| | **ANEST JAHO nr. 8** | | | | | | | |
| | BANESA | | | | | | | |
| 1 | Shtresë me pllaka grezë porcelanato | $m^2$ | 1,982 | 59.06 | 59.06 | 56.9 | 2.16 | 4,281 |
| 2 | Suva brenda mur tulle h-4 m, me pompë llac i përzierë M 25 | $m^2$ | 496 | 29.69 | 29.96 | 0 | 29.7 | 14,726 |
| 3 | Bojë hidroplastike | $m^2$ | 168 | 29.69 | 29.96 | 0 | 29.7 | 4,988 |
| | TUALETI | | | | | | | |
| 1 | F.V Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjegulla marseljeze | $m^2$ | 2,972 | 11.59 | 11.59 | 7 | 4.59 | 13,641 |
| | | | | | | | **Shuma 8** | **37,816** |
| | **RESHAT JACE nr. 22** | | | | | | | |
| | Mur tulle të plotë për tualet | $m^3$ | 9,908 | 0.82 | 0.82 | 0.6 | 0.22 | 2,180 |
| 2 | Shtresë me pllaka grez porcelanato ne tualet | $m^2$ | 1,982 | 4.62 | 4.62 | 4 | 0.62 | 1,229 |
| | | | | | | | **Shuma 22** | **51,719** |
| | **BESIE JACE nr. 23** | | | | | | | |
| 1 | Shtresë lustër çimento 1:2 | $m^2$ | 347 | 18.82 | 18.82 | 0 | 18.8 | 6,531 |
| 2 | Shtresë me pllaka grez porcelanato | $m^2$ | 1,982 | 18.82 | 18.82 | 15.5 | 3.32 | 6,580 |
| 3 | Ndërtim tavani me pllaka gipsi | $m^2$ | 1,982 | 17.32 | 17.32 | 14.08 | 3.24 | 6,422 |
| 4 | Lavapjatë importi porcelani | copë | 7,000 | 1 | 1 | 0 | 1 | 7,000 |
| | | | | | | | **Shuma 23** | **26,532** |
| | **NIHAT JACAJ nr. 24** | | | | | | | |
| 1 | Mur me tulla të plota në lartësi deri në 3 m me llac të përzier M 25 | $m^3$ | 9.908 | 4 | 4 | 1.7 | 2.3 | 23 |
| 2 | Prishje suvaje (jashtë + brenda) | $m^2$ | 99 | 88.8 | 88.8 | 79.6 | 9.2 | 911 |
| 3 | Suva brenda mur tulle h-4 m me pompë, llac i përzierë M 25 | $m^2$ | 496 | 44.83 | 44.83 | 37.2 | 7.63 | 3,784 |
| 4 | Shtresë lustër çimento 1:2 | $m^2$ | 347 | 12.9 | 12.9 | 0 | 12.9 | 4,476 |
| 5 | Shtresë me pllaka grez porcelanato | $m^2$ | 1,982 | 12.9 | 12.9 | 11.84 | 1.06 | 2,101 |
| 6 | F.V lavaman porcelani importi me mishelator | copë | 7,000 | 1 | 1 | 0 | 1 | 7,000 |

| Nr. | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Vol. | Vlera |
| | | | | | | | **Shuma 24** | **18,295** |
| | **GËZIM HAMZARAJ nr. 29** | | | | | | | |
| | BANESA | | | | | | | |
| 1 | Shtresë me pllaka grez porcelanato | $m^2$ | 1,982 | 27.75 | 27.75 | 22 | 5.75 | 11,397 |
| | TUALETI | | | | | | | |
| 1 | Shtresë lustër çimento 1:2 t=20 mm t=20 mm | $m^2$ | 247 | 9.19 | 9.19 | 0 | 9.19 | 2,270 |
| 2 | F.V derë d/alumini pa xham, me mbushje d/alumini | $m^2$ | 10,900 | 6.76 | 6.76 | 1.6 | 5.16 | 56,244 |
| 3 | F.V dritare d/alumini tek xham | $m^2$ | 8,422 | 2.32 | 2.32 | 0.5 | 1.82 | 15,328 |
| | | | | | | | **Shuma 29** | **85,238** |
| | **KAMBER HAMZARAJ nr. 30** | | | | | | | |
| 1 | Dritare d/alumini tek xham | $m^2$ | 8,422 | 4.04 | 4.04 | 3.3 | 0.74 | 6,232 |
| 2 | Suva brenda mur tulle h-4 m me pompë me llac i përzierë M-25 | $m^2$ | 496 | 4.01 | 4.01 | 0 | 4.01 | 1,989 |
| | | | | | | | **Shuma 30** | **8,221** |
| | **LUAN LICAJ nr. 31** | | | | | | | |
| 1 | Shtresë lustër çimento 1:2 t=20 mm | $m^2$ | 347 | 38.07 | 38.07 | 0 | 38.1 | 13,210 |
| 2 | Shtresë me pllaka grez porcelanato | $m^2$ | 1,982 | 38.07 | 38.07 | 34.76 | 3.31 | 6,560 |
| 3 | Suva e zakonshme fasade mur tulle h-8 m | $m^2$ | 891 | 100.7 | 100.7 | 88.5 | 12.2 | 10,870 |
| 4 | Hekur betoni $\phi > 10$ mm | kg | 99 | 130 | 130 | 0 | 130 | 12,870 |
| | | | | | | | **Shuma 31** | **43,511** |
| | **PARIME NANXA nr. 32** | | | | | | | |
| 1 | Shtresë me pllaka grez porcelanato | $m^2$ | 1,982 | 14.16 | 14.16 | 13.5 | 0.66 | 1,308 |
| 2 | F.V Dritare d/alumini tek xham | $m^2$ | 8,422 | 5.5 | 5.5 | 2.25 | 3.25 | 27,372 |
| | | | | | | | **Shuma 32** | **28,680** |
| | **FATMIR CERCIZI nr. 33** | | | | | | | |
| | BANESA | | | | | | | |
| 1 | Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama | $m^2$ | 990 | 45.46 | 45.46 | 42 | 3.46 | 3,425 |
| 2 | Shtresë lustër çimento 1:2 | $m^2$ | 347 | 45.46 | 45.46 | 42 | 3.46 | 1,201 |
| 3 | Shtresë me pllaka grez porcelanato | $m^2$ | 1,982 | 36.88 | 36.88 | 33.1 | 3.78 | 7,492 |
| 4 | F.V duralumin plastik me dopjo xham | $m^2$ | 17,836 | 1.68 | 1.68 | 0 | 1.68 | 29,964 |
| | TUALETI | | | | | | | |
| 1 | Shtresë lustër çimento 1:2 | $m^2$ | 347 | 4.56 | 4.56 | 0 | 4.56 | 1,582 |
| 2 | Prishje çatie dhe tavani | $m^2$ | 198 | 19.85 | 19.85 | 9 | 10.9 | 2,148 |
| 3 | Çati vendi e zakonshme HD – 8 m, mbuluar me tjegulla marseljeze | $m^2$ | 2,972 | 19.85 | 19.85 | 9 | 10.9 | 32,246 |
| | | | | | | | **Shuma 33** | **78,059** |
| | | | | | | | **Total** | **618,671** |

BUKURIE BYLYSHI nr. 1

Diferenca prej 14,907 lekë rezulton nga krahasimi i volumeve të paraqitura në projektin e miratuar të zbatimit me volumet e paraqitura në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar.

BESNIK DOKO nr. 2

Gjatë verifikimit në terren të punimeve të përfunduara rezultoi se nuk janë kryer punime për prishjen dhe rikonstruksionin e çatisë. Diferenca rezultuan në punimet për banesën, e konkretisht ne dhomën e gjumit në të cilën nuk janë suvatuar të 4 faqet e mureve si dhe likuiduar tepër volumet e punës për ndriçimet dhe tavanet e gipsit. Gjithashtu për ambientin e tualetit janë situacionuar tepër punimet për dyert dritaret si dhe ato te suvatimit të mureve.

MYSLYM LAMCE nr. 4

Diferenca prej 105,777 lekë rezultoi nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacion dhe në librezën e masave si dhe punimeve faktike të kryera në këtë banesë.

ALKETA LAMCE nr. 5

Diferenca prej 14,132 lekë rezultoi nga krahasimi i volumeve të paraqitura në projektin e miratuar të zbatimit me volumet e paraqitura në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar.

STEFAN SADIKU nr. 7

Diferenca prej 20,070 lekë rezultoi nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacion dhe në librezën e masave si dhe punimeve faktike të kryera në këtë banesë.

ANEST JAHO nr. 8

Diferenca prej 37,816 lekë rezultoi nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacion dhe në librezën e masave si dhe punimeve faktike të kryera në këtë banesë.

RESHAT JACE nr. 22

Nga krahasimi i volumeve të paraqitura në librezën e masave si dhe atyre të konstatuara na fakt rezultuan mospërputhje. Konkretisht dimensionet e soletës së realizuar me hidroizolim rezultuan me dimensione 11.1 ml x 5.05 ml ose në total sipërfaqja prej 56 $m^2$. Banesa rezultoi me lagështi të ardhur prej soletës dhe punimeve jo cilësore të hidroizolimit. U konstatua gjithashtu se hidroizolimi nuk është realizuar i tillë që të mbulojë me karton katrama edhe faqet e vertikale të soletës duke u bërë shkak për praninë e lagështisë dhe amortizimin e banesës. Gjithashtu gjatë përllogaritjeve të volumeve të punës për muraturën e tullës nuk janë përllogaritur zbritjet për efekt të derës së tualetit. Diferenca rezultuan edhe në volumet e shtresave me pllaka.

BESIE JACE nr. 23

Nga krahasimi i volumeve të paraqitura në librezën e masave si dhe atyre të konstatuara na fakt rezultuan mospërputhje. Konkretisht dimensionet e brendshme të banesës rezultuan 4.7 m x 3.2 m dhe jo 4.85 m x 3.88 m sa pasqyron libreza e masave për zërat *"Shtresë me pllaka grez porcelanato"* dhe *"Ndërtim tavani me pllaka gipsi"*. Gjithashtu për zërin e fundit nuk janë zbritur volumet për efekt të traut në mes të soletës. Shtresa me lustër çimento me t=2 cm nën pllaka rezulton se është parashikuar nën zërin *"Shtresë me pllaka grez porcelanato"* sipas zërit me nr. analize 2.267/a (shiko analizën sipas manualit teknik të çmimeve në fuqi). Gjithashtu rezultoi së banesa nuk është pajisur me lavaman porcelani me mishelator.

NIHAT JACAJ nr. 24

Nga krahasimi i volumeve të paraqitura në librezën e masave si dhe atyre të konstatuara na fakt rezultuan mospërputhje. Konkretisht volumet e murit të tullës për rrethimin nën çati (me h=0.5 ml nga një krah dhe h=1 ml nga krahu i rrugës, si dhe duke zbritur volumin e brezit=0.9 $m^3$) rezulton se është 1.7 $m^3$ dhe jo 4 $m^3$ sa pasqyrohet në mënyrë direkte dhe të pa detajuar në librezën e masave. Gjithashtu rezultoi së banesa nuk është pajisur me lavaman porcelani me mishelator. Pjesa e murit mbi derën e hyrjes në banesë rezultoi e plasaritur dhe brenda periudhës së garancisë objekti është amortizuar në një kohë shumë të shkurtër. Gjithashtu u konstatua prani e lagështisë si pasojë e pranisë së ujërave të ardhur nga çatia. Sa më sipër tregon për mungesën e cilësisë së punimeve të realizuara nga firma sipërmarrëse në këtë banesë dhe domosdoshmërinë e ndërhyrjes emergjente për riaftësimin dhe krijimin e kushteve minimale për banim.

GËZIM HAMZARAJ nr. 29

Nga krahasimi i volumeve të paraqitura në librezën e masave si dhe atyre të konstatuara na fakt rezultuan mospërputhje. Konkretisht rezultoi se nuk janë kryer punime për hidroizolimin e soletës së tualetit me dy shtresa karton katrama. Gjithashtu, diferenca rezultuan edhe për zërat *"Shtresë me pllaka*

*grez porcelanato"*, *"Shtresë lustër çimento 1:2 t=20 mm t=20 mm"*, *"F.V derë d/alumini pa xham, me mbushje d/alumini"* dhe *"F.V dritare d/alumini tek xham"*.

KAMBER HAMZARAJ nr. 30

Nga krahasimi i volumeve të paraqitura në librezën e masave si dhe atyre të konstatuara na fakt rezultuan mospërputhje. Konkretisht rezultuan diferenca për zërat *"F.V dritare d/alumini tek xham"* dhe *"Suva brenda mur tulle h-4 m me pompë me llac i përzierë M-25"*.

LUAN LICAJ nr. 31

Nga krahasimi i volumeve të paraqitura në librezën e masave si dhe atyre të konstatuara na fakt rezultuan mospërputhje. Konkretisht rezultuan diferenca për zërat *"Shtresë lustër çimento 1:2 t=20 mm"* dhe *"Shtresë me pllaka grez porcelanato"*, *"Suva e zakonshme fasade mur tulle h-8 m"* dhe *"Hekur betoni $\phi$ > 10 mm"*. Diferenca e shtresës me lustër çimento rezulton si pasojë e përfshirjes në situacion të këtij zëri si punime më vete kur punimet për shtresën e pllakave e kanë të përfshirë shtresën niveluese.

PARIME NANXA nr. 32

Nga krahasimi i volumeve të paraqitura në librezën e masave si dhe atyre të konstatuara na fakt rezultuan mospërputhje. Konkretisht dimensionet e soletës së realizuar me hidroizolim rezultuan me dimensione 5 ml x 3.5 ml ose në total sipërfaqja prej 17.5 $m^2$. Banesa rezultoi me lagështi të ardhur prej soletës dhe punimeve jo cilësore të hidroizolimit. U konstatua gjithashtu se hidroizolimi nuk është realizuar i tillë që të mbulojë me karton katrama edhe faqet e vertikale të soletës duke u bërë shkak për praninë e lagështisë dhe amortizimin e banesës. Gjithashtu, fashaturat e derës së brendshme rezultuan të jenë të pa suvatuara, dera e dhomës së ndenjes me material d/alumini rezultoi e pa fiksuar në mur. Diferenca rezultuan edhe në zërat *"Shtresë me pllaka grez porcelanato"* dhe *"F.V Dritare d/alumini tek xham"*. Sa më sipër tregon për mungesën e cilësisë së punimeve të realizuara nga firma sipërmarrëse në këtë banesë dhe domosdoshmërinë e ndërhyrjes emergjente për riaftësimin dhe krijimin e kushteve minimale për banim.

FATMIR CERCIZI nr. 33

Nga krahasimi i volumeve të paraqitura në librezën e masave si dhe atyre të konstatuara na fakt rezultuan mospërputhje. Konkretisht volumi i punës i realizuar me hidroizolim rezultoi 42 m2 dhe jo 45.4 m2 sa pasqyron situacioni përfundimtar. Diferenca rezultuan edhe në zëra të tjerë për punimet e banesës dhe asaj të tualetit.

Gjithashtu, referuar amortizimit të punimeve për banesat e inspektuara, nga ana e grupit të auditimit për efekt të amortizimit të punimeve në një kohë shumë të shkurtër nga data e përfundimit të tyre, do të konsiderohen si volume pune i pakryer të gjitha zërat e punimeve të konstatuara me mangësi të theksuara për sa i përket cilësisë së tyre. Konkretisht:

1. Punimet e suvatimit në banesën e N. J. – vlera 22,236 leke pa TVSH;
2. Punimet e d/alumin të realizuara në banesën e P.N. – vlera 80,547 leke pa TVSH;
3. Punimet e suvatimit në banesën e F. Ç. – vlera 84,262 lekë pa TVSH;
4. Punimet e bojatisjes në banesën e F. Ç. – vlera 29,634 lekë pa TVSH;

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim, rezultoi se, të paktën për objektet e inspektuara nuk janë arritur më së miri objektivat e këtij investimi si dhe i janë likuiduar sipërmarrësit të punimeve volume pune të pakryera në fakt në vlerën 835,350 lekë pa TVSH me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve *ing. F. B.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.

Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4433 prot. datë 01.06.2016.
Nga ana e kolaudatores së punimeve *ing. D. Q.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3.

Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 6098 prot. datë 21.07.2016.
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, *Ing. F. B.* si dhe nga ana e kolaudatores së punimeve, *Ing. D. Q.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3 udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 "*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave* "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit""*, pika 4, paragrafi 4 ku përcaktohet dokumentacioni i nevojshëm i dosjes teknike.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me këtë objekt nga subjekti janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 3048/1, datë 20.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/12, datë 23.04.2018),nga mbikëqyrësi F. B. përfaqësues ligjor i subjektit "H.....K" dhe nga kolaudatorja e punimeve, znj. D. Q., përfaqësuese e "T....T" .*
***Pretendimi i subjektit:***
*Duam të theksojmë faktin se punimet për rikonstruksionin e këtyre banesave por edhe kontrolli është kryer në kushte shumë të vështira. Komunikimi dhe bashkëpunimi me këta banorë është pothuajse i pamundur për shkak të pakënaqësive të lindura mes investitorit dhe këtij komuniteti, për arsye se të gjithë kërkojnë që banesat e tyre të bëheshin të reja pasi rikonstruksioni i banesave të tyre si dhe perceptimi që kanë nuk i kuptojnë ato çfarë janë parashikuar në projekt – preventiv dhe për shkak të arsimit të tyre...Nga ana jonë dhe e sipërmarrësit në bashkëpunim me investitorin është bërë përpjekja maksimale për të plotësuar sa më shumë nevojat e tyre gjithmonë brenda preventivit dhe fondit të caktuar për secilin por duke kompensuar volume të tjera nga njëra familje në tjetrën. Duke qenë se banesat e tyre janë tejet të amortizuara dhe të ndërtuara me materiale shumë të dobëta referuar edhe fondit të akorduar, rikonstruksioni i pjesshëm i tyre nuk ka sjellë rezultate fort të dukshme dhe mbylljen e shumë problemeve që ato banesa kanë. Nga ana jonë dhe e sipërmarrësit këtij komuniteti i kemi qëndruar afër duke ju marrë pëlqimin për çdo lloj materiali të përdorur si për dyert e duraluminit, llojin e derës, me gjysmë mbushje, gjysmë xham apo të gjithë mbushjen kolorin dhe dimensionet e pllakës, format e lavamanëve dhe lavapjatave, llojet e bolierëve, ngjyrat e lyerjes së banesave e shumë gjëra të tjera të prodhuara dhe të vendosura vetëm sipas kërkesave të çdo familjeje.*
***Përgjigja:***
*Pretendimet tuaja lidhur me vështirësitë në komunikim me banorët nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi këto argumente i shmangen konstatimeve dhe nuk justifikojnë mangësitë e konstatuara nga grupi i auditimit gjatë inspektimit në objekt në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, përfaqësueses së këtij komuniteti ZH. V. si dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. F. B. Për sa i përket ndryshimeve brenda vlerës totale të preventivit kjo qëndron por nga ana e grupit të auditimit është*

*konstatuar se ndryshimet nuk janë bërë duke marrë në konsideratë ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu II, neni 4 ku përcaktohet se:*
*"Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre. Ato duhet të plotësojnë kërkesat që kanë të bëjnë me:*
*1. rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike;*
*2. sigurinë nga zjarri;*
*3. **higjienën, shëndetin dhe mjedisin**;*
*4. **sigurinë në përdorim**;*
*5. **mbrojtjen nga zhurmat**;*
*6. **kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë**."*
*Nga auditimi nuk rezultoi asnjë shkresë apo korrespondencë zyrtare për të konkretizuar Pretendimimet tuaja lidhur me vështirësitë përgjatë zbatimit të punimeve, të cilat edhe në rast se do të kishte të tilla, përsëri nuk do të justifikonin as cilësinë e dobët, as punimet e amortizuara dhe as diferencat në volume pune të likuiduara por të pa kryera në fakt. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë e si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit. Lidhur me Pretendimimet mbi diferenca në volume pune ato nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nga inspektimi në objekt i punimeve të përfunduara në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve F. B., përfaqësuesve të KLSH, përfaqësues se këtij komuniteti si dhe vetë banorëve rezultoi sa përshkruhet në aktkonstatim, në projektraport si dhe në këtë raport përfundimtar auditimi.*

**3. Objekti "Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian – 2017", Vlorë.**

Preventivi i përdorur në përcaktimin e fondit limit të investimit parashikon ndërhyrjen nëpërmjet prishjes dhe rikonstruktimin e disa banesave të 20 familjeve të komunitetit Egjiptian.

Lidhur me zbatimin e punimeve, në prani të përfaqësuesve të KLSH, kolaudatorit të punimeve F. B. si dhe ZH. V përfaqësuese e këtij komuniteti, gjatë inspektimit në terren të 10 banesave nga 19 në total (një më pak nga 20 të parashikuara pasi një banor ka refuzuar rikonstruksionin) u konstatua se në çdo njërën prej tyre punimet ishin me mangësi, me diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt por mbi të gjitha u konstatua një mungesë e theksuar në cilësinë e punimeve gjë e cila ka sjellë amortizimin e një pjese prej tyre në një kohë shumë të shkurtër. Konkretisht u konstatua se:

1. Në disa raste dritaret ishin të pasilikonuara në konturet anësore të mureve;
2. Shtresa e katramasë nuk është silikonuar në bashkimin e saj me muret vertikale të parapetit duke u bërë kështu shkak për krijimin e lagështisë dhe amortizimin në një kohë shumë të shkurtër të punimeve të suvatimit dhe lyerjes së jashtme dhe asaj të brendshme;
3. Në shumë raste u konstatua se, edhe pse nën shtresën e shtresës së hidroizolimit ka qenë parashikuar dhe situacionuar shtresa me beton për dhënien e pjerrësisë së nevojshme, përsëri soletat rezultojnë të kenë krijuar gropa ujëmbledhëse duke u bërë shkak për pranin ë lagështisë në banesa;
4. Bolierët e dusheve rezultuan me kapacitet 80 litër nga 100 litër që janë parashikuar dhe pasqyruar në situacion përfundimtar;

5. U konstatuan punime suvatimit, lyerje, veshje pllakash apo punime elektrike të lëna përgjysmë;

Sa më sipër tregon mungesën e vëmendjes ndaj këtij investimi si nga ana e firmës sipërmarrëse, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve por edhe të vetë Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë për marrje në dorëzim të punimeve me këto mangësi të theksuara. Disa nga problemet e konstatuar tregohen si më poshtë në materialet fotografike:

Letra e katramasë e pa silikonuar me parapetin e murit në shtëpinë e B. M. (rast i përsëritur edhe në familje të tjera)

Tub fleksibël i bolierëve të dushit i tendosur duke u bërë shkak për daljen e tij jashtë funksionit në një kohë shumë të shpejtë

Punime suvatimi të lëna përgjysmë dhe telefon dushi

jo funksional i vendosur sipër lavamanit në tualet në banesën e Nj. Z.

Punime jo cilësore të h/izolimit të soletës të cilat kanë sjellë praninë e lagështisë në banesën e M. D.

Punime elektrike të lënë përgjysmë në banesën e M. D.

Pamje të ambienteve me lagështi në tualetin e D. D.

Bolier dushi 80 litër kur situacioni dhe specifikimet përcaktojnë një bolier 100 litër (i përsëritur në të gjitha rastet)



Punime jo cilësore në realizimin e pllakave të shtrimit dhe veshjeve duke mos respektuar fugat (i përsëritur pothuajse në të gjitha rastet)

Punime jo cilësore në realizimin e shtresës me beton për pjerrësi nën shtresën e katramase për hidroizolim.

Gjithashtu, nga krahasimi i volumeve të paraqitura në situacionin përfundimtar si dhe volumeve faktike të matura në terren rezultuan diferenca si më poshtë:

Tabela nr. 6

| Nr. | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Vol. | Vlera |
| | **BINO MERKO** | | | | | | | |
| | BANESA | | | | | | | |

| Nr. | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Vol. | Vlera |
| 1 | Mur me tulla të lehtësuara dopjo deri në 3 metra me llac të përzierë M25 | $m^3$ | 7,727 | 2 | 2 | 1.2 | 0.8 | 6,182 |
| | TUALETI | | | | | | | |
| 2 | F.V bolier 100 l importi | copë | 10,909 | 1 | 1 | 0 | 1 | 10,909 |
| | | | | | | | **Shuma 1** | **17,091** |
| | **MIKEL DINE + DORJAN DINE** | | | | | | | |
| 2 | Hidroizolim me emulsion bituminoz dhe një shtresë katrama | $m^2$ | 455 | 122 | 122 | 101.8 | 20.2 | 9,191 |
| 3 | Shtresë me pllaka grez porcelanato | $m^2$ | 1,818 | 57 | 57 | 55 | 2 | 3,636 |
| 4 | F.V bolier 100 l importi | copë | 10,909 | 1 | 1 | 0 | 1 | 10,909 |
| | | | | | | | **Shuma 2** | **60,594** |
| | **PETRIT BANAJ** | | | | | | | |
| | BANESA | | | | | | | |
| 1 | Hidroizolim me emulsion bituminoz dhe një shtresë katrama | $m^2$ | 455 | 44 | 44 | 40 | 4 | 1,820 |
| 2 | Mur me tulla të lehtësuara dopjo deri në 3 metra me llac të përzierë M25 | $m^3$ | 7,727 | 1.3 | 1.3 | 0.8 | 0.5 | 3,864 |
| | Suva brenda mur tulle h-4 m me krahë, llac i përzierë M25 | $m^2$ | 636 | 66.6 | 66.6 | 20 | 46.6 | 29,637 |
| | TUALETI | | | | | | | |
| 2 | Soleta të plotë b/a C 20/25, t=10 cm, h-4 m | $m^3$ | 11,818 | 0.8 | 0.8 | 0.6 | 0.2 | 2,364 |
| 3 | Suva e zakonshme fasade mur tulle – 8 m (për parapet) | $m^2$ | 636 | 36 | 36 | 0 | 36 | 22,896 |
| 4 | Shtresë me pllaka grez porcelanato | $m^2$ | 1,818 | 3.7 | 3.7 | 0 | 3.7 | 6,726 |
| 5 | F.V ËC allafrënga importi | copë | 7,273 | 1 | 1 | 0 | 1 | 7,273 |
| 6 | F.V bolier 100 l importi | copë | 10,909 | 1 | 1 | 0 | 1 | 10,909 |
| | | | | | | | **Shuma 3** | **85,489** |
| | **HEKTOR KOVACI + FETI KOVACI** | | | | | | | |
| 1 | Shtresë me pllaka grez porcelanato | $m^2$ | 1,818 | 60.42 | 60.42 | 57.95 | 2.47 | 4,490 |
| 2 | Çati vendi e zakonshme HD-8 m, mbuluar me tjegulla marseleze | $m^2$ | 2,909 | 33.36 | 33.36 | 0 | 33.36 | 97,044 |
| 3 | Veshje me pllaka majolike | $m^2$ | 1,818 | 5.01 | 5.01 | 0 | 5.01 | 9,108 |
| 4 | F.V bolier 100 l importi | copë | 10,909 | 1 | 1 | 0 | 1 | 10,909 |
| | | | | | | | **Shuma 4** | **121,551** |
| | **SHEGA ZEQO** | | | | | | | |
| | Shtresë me pllaka grez porcelanato | $m^2$ | 1,818 | 47 | 47 | 0 | 47 | 85,446 |
| | Plintuese pllakë grez | $m^2$ | 227 | 48 | 48 | 0 | 48 | 10,896 |
| | | | | | | | **Shuma 5** | **96,342** |
| | **ALTIN HYSO + BAJRAM HYSO** | | | | | | | |
| 2 | Shtresë betoni C 12/15 (për pjerrësitë e soletës h=5 cm) | $m^3$ | 6,364 | 6.53 | 6.53 | 0 | 6.53 | 41,557 |
| 3 | Veshje me pllaka majolike | $m^2$ | 1,818 | 15 | 15 | 13 | 2 | 3,636 |
| 4 | F.V bolier 100 l importi | copë | 10,909 | 2 | 2 | 0 | 2 | 21,818 |
| | | | | | | | **Shuma 6** | **67,011** |
| | | | | | | | **Total** | **411,220** |

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim, rezultoi se, të paktën për objektet e inspektuara nuk janë arritur më së miri objektivat e këtij investimi si dhe i janë likuiduar sipërmarrësit të punimeve volume pune të pakryera në fakt në vlerën 411,220 lekë pa TVSH me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrëses së punimeve *ing. XH. D.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.

-Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve;
Nga ana e kolaudatorit të punimeve *F. B.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3.

-Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve;
Nga ana e mbikëqyrëses së punimeve, *Ing. XH. D.* si dhe nga ana e kolaudatorit të punimeve, *F. B.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3 dhe udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 "*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave* "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit""*, pika 4, paragrafi 4 ku përcaktohet dokumentacioni i nevojshëm i dosjes teknike.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me këtë objekt nga subjekti janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 3048/1, datë 20.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/12, datë 23.04.2018),nga mbikëqyrësja ing. XH. D. përfaqësuese ligjore e subjektit "XH.....R" dhe nga kolaudatori i punimeve, F. B., përfaqësues i "H.....K"* .
***Pretendimi i subjektit:***
*Duam të theksojmë faktin se punimet për rikonstruksionin e këtyre banesave por edhe kontrolli është kryer në kushte shumë të vështira. Komunikimi dhe bashkëpunimi me këta banorë është pothuajse i pamundur për shkak të pakënaqësive të lindura mes investitorit dhe këtij komuniteti, për arsye se të gjithë kërkojnë që banesat e tyre të bëheshin të reja pasi rikonstruksioni i banesave të tyre si dhe perceptimi që kanë nuk i kuptojnë ato çfarë janë parashikuar në projekt – preventiv dhe për shkak të arsimit të tyre...Nga ana jonë dhe e sipërmarrësit në bashkëpunim me investitorin është bërë përpjekja maksimale për të plotësuar sa më shumë nevojat e tyre gjithmonë brenda preventivit dhe fondit të caktuar për secilin por duke kompensuar volume të tjera nga njëra familje në tjetrën. Duke qenë se banesat e tyre janë tejet të amortizuara dhe të ndërtuara me materiale shumë të dobëta referuar edhe fondit të akorduar, rikonstruksioni i pjesshëm i tyre nuk ka sjellë rezultate fort të dukshme dhe mbylljen e shumë problemeve që ato banesa kanë. Nga ana jonë dhe e sipërmarrësit këtij komuniteti i kemi qëndruar afër duke ju marrë pëlqimin për çdo lloj materiali të përdorur si për dyert e duraluminit, llojin e derës, me gjysmë mbushje, gjysmë xham apo të gjithë mbushjen kolorin dhe dimensionet e pllakës, format e lavamanëve dhe lavapjatave, llojet e bolierëve, ngjyrat e lyerjes së banesave e shumë gjëra të tjera të prodhuara dhe të vendosura vetëm sipas kërkesave të çdo familjeje.*
***Përgjigja:*** *Pretendimet tuaja lidhur me vështirësitë në komunikim me banorët nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi këto argumente i shmangen konstatimeve dhe nuk justifikojnë mangësitë e konstatuara nga grupi i auditimit gjatë inspektimit në objekt në prezencë të përfaqësuesve të KLSH, përfaqësueses së këtij komuniteti ZH. V. si dhe mbikëqyrësit të punimeve F. B. Për sa i përket ndryshimeve brenda vlerës totale të preventivit kjo qëndron por nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se ndryshimet nuk janë bërë duke marrë në konsideratë ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998*

*"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu II, neni 4 ku përcaktohet se:*
*"Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre. Ato duhet të plotësojnë kërkesat që kanë të bëjnë me:*
*1. rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike;*
*2. sigurinë nga zjarri;*
*3. **higjienën, shëndetin dhe mjedisin**;*
*4. **sigurinë në përdorim**;*
*5. **mbrojtjen nga zhurmat**;*
*6. **kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë**."*
*Nga auditimi nuk rezultoi asnjë shkresë apo korrespondencë zyrtare për të konkretizuar Pretendimimet tuaja lidhur me vështirësitë përgjatë zbatimit të punimeve, të cilat edhe në rast se do të kishte të tilla, përsëri nuk do të justifikonin as cilësinë e dobët, as punimet e amortizuara dhe as diferencat në volume pune të likuiduara por të pa kryera në fakt. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë e si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.*
*Lidhur me diferencat në volume përgjigjet e grupit të auditimit janë sipas rasteve:*
*<u>Banesa e B. M.</u>*
*Lidhur me mbylljen e murit me dimensione 100 cm x 250 cm dhe t=25 cm, nuk rezultoi të kishte ndryshim projekti apo detaj teknik lidhur me këtë zë, ndaj pretendimi juaj nuk qëndron;*
*Lidhur me punimet për bolierin nga inspektimi në objekt për këtë banesë nuk rezultoi të kishte bolier 100 litër sa përshkruhet në librezë masash dhe në situacion përfundimtar ndaj dhe ky volum pune është konsideruar si volum pune i pakryer. Kërkesa e familjes për një bolier më të vogël dhe nuk është argument dhe nuk justifikon mungesën e kryerjes së zërave të paraqitur në situacion përfundimtar. Për sa i përket diferencës në çmim që ju përmendni, kjo diferencë nuk qëndron pasi nga studimi i analizës ka një diferencë në çmimin e furnizimi të bolierit 100 l dhe atij 80 l. Konkretisht këto çmime janë përkatësisht 9,800 lekë (bolieri 100 l) dhe 9,500 lekë (bolieri 80 l);*
*<u>Banesa e M. D. + **D. D.**</u>*
*Lidhur me punimet e hidroizolimit me 1 shtresë karton katrama, argumentet tuaja nuk merren në konsideratë pasi nga inspektimi në objekt rezultoi sa përshkruhet në akt konstatim. Gjithashtu për sa i përket tualetit, ky objekt rezultoi i pa veshur me shtresë karton katrama në pjesën e soletës duke u bërë shkak edhe për praninë e lagështisë siç është pasqyruar edhe ne materialet fotografike mësipërme. Ndërkohë, sipas observacionit të sjellë nga ana juaj, soleta e këtij tualeti është pasqyruar si e veshur me karton katrama.*
*Lidhur me punimet e bolierit të dushit, vlen i njëjti argument i përdorur në rastin e mësipërm.*
*Grupi i auditimit merr në konsideratë kundërshtitë lidhur me punimet e zërit "Mur me tulla të lehtësuara dopjo deri në 3 metra me llac të përzierë M25";*
*<u>Banesa e P. B.</u>*
*Lidhur me zërin "Hidrolizolim me emulsion bitumi dhe një shtresë katrama", nga inspektimi në objekti rezultoi volumi prej 40 $m^2$ (5.6 ml x 7.2 ml) dhe jo 44.17 $m^2$ (8.18 ml x 5.4 ml);*
*Lidhur me zërin "Mur me tulla të lehtësuara dopjo deri në 3 metra me llac të përzierë M25" rezultoi në total volumi prej 0.8m3 pasi për pjesën e tualetit nuk janë kryer punime murature tulle;*

*Lidhur me zërin "Suva brenda mur tulle h-4 m me krahë, llac i përzierë M25" gjatë matjeve në objekt rezultoi volumi i kryer me suvatime brenda prej 20 $m^2$.*
*Lidhur me punimet e tualetit rezultoi soleta është kryer me dimensione 2.65 ml x 2.85 ml x 0.08 ml, ose volumi prej 0.6 $m^3$ dhe jo me dimensione 2.9 ml x 2.8 ml x 0.1 ml ose volumi prej 0.8 $m^3$ sa ju pretendoni;*
*Lidhur me punimet e suvatimit për muraturën e tullës së tualetit ky volum pune rezultoi i pakryer në fakt. Gjithashtu dimensionet e përmendura nga ana juaj në observacion për tualetin nuk lidhen me dimensionet reale te tualetit;*
*Lidhur me punimet e pllakave të tualetit ky volum pune rezultoi i pakryer në fakt duke u lënë në gjendjen ekzistuese e duke raportuar si punime të kryera volumin prej 3.7 $m^2$;*
*Lidhur me punimet e "F.V ŴC allafrënga importi" ky volum pune rezultoi i pakryer në fakt;*
*Lidhur me punimet e bolierit të dushit, vlen i njëjti argument i përdorur në rastet e mësipërme.*
*Për sa më sipër pretendimet tuaja për këtë banesë nuk qëndrojnë;*
*<u>Banesa e **H. K. + F. K.**</u>*
*Diferencat në volume të këtyre dy banesave rezultuan nga matjet në total të volumeve të kryera për të dyja banesat dhe duke i krahasuar këto volume me shumën e volumeve për po këto dy banesa në situacionin përfundimtar.*
*Lidhur me punimet e bolierit të dushit, vlen i njëjti argument i përdorur në rastet e mësipërme.*
*Për sa më sipër pretendimet tuaja për këtë banesë nuk qëndrojnë;*
*<u>Banesa e **Sh. Z.**</u>*
*Diferencat në volume për këtë banesë rezultuan nga inspektimi në objekt ku nuk ishin kryer punime për shtrimin me pllaka dhe plintues me pllakë grez;*
*Për sa më sipër pretendimet tuaja për këtë banesë nuk qëndrojnë;*
*<u>Banesa e **A. H. + B. H.**</u>*
*Diferencat në volume të këtyre dy banesave rezultuan nga matjet në total të volumeve të kryera për të dyja banesat dhe duke i krahasuar këto volume me shumën e volumeve për po këto dy banesa në situacionin përfundimtar. Për sa i përket shtresës me beton për pjerrësinë e soletës ky volum pune është konsideruar si volum pune i pakryer për shkak të gjendjes së konstatuar gjatë inspektimit të punimeve të përfunduara. Soleta rezultoi me grumbullime uji në mes të sipërfaqeve çka tregon për punime të pakryera lidhur me pjerrësinë e soletës. Pretendimimet tuaja mbi përdorimin e shtresës së betonin nën pllaka nuk merren në konsideratë pasi ky ndryshim nuk është shoqëruar me praktikën përkatëse të ndryshimit të zërit të punimeve. Lidhur me punimet e bolierit të dushit, vlen i njëjti argument i përdorur në raste e mësipërme.* ***Për sa më sipër pretendimet tuaja për këtë banesë nuk qëndrojnë****.*

**4. Objekti *"Sistemi Multifunksional Smart City Lungomare"*, Vlorë.**

*<u>Projekti</u>*

Projekti për këtë investim është hartuar nga J. P me detyrë Këshilltar i Kryetarit të Bashkisë Vlorë dhe ka patur si objektiva të përgjithshëm:

- Ndërtimin dhe përgatitjen e infrastrukturës pasive dhe aktive të telekomunikacionit për një zgjidhje *"Smart City"* përgjatë shëtitores Lungomare;
- Ndërtimin e një sistemi Ẅi – Fi në pikat me dendësi të lartë përdorimi nga publiku dhe ato që frekuentohen nga turistët nëpërmjet teknologjive multifunsionale përgjatë shëtitores Lungomare;

- Vendosjen e stolave *"Smart"* përgjatë shëtitores Lungomare;
- Module të karikimit të telefonave *"Smart"* për qytetarët dhe turistët përgjatë shëtitores Lungomare;
- Vendosjen e kamerave me cilësi të lartë përgjatë shëtitores Lungomare;
- Përgatitjen e infrastrukturës ekzistuese për projektet e ardhshme *"Smart City"*;

*Kontratat*

Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE *"C.....SS"* , me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 7110 datë 18.11.2014 si dhe me përfaqësues ligjor G. L.. Kontrata është lidhur sipas aktit me nr. 5995 prot., datë 10.07.2017 mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë të përfaqësuar nga Titullari D. L. dhe OE me vlerë të kontratës 63,469,200 lekë me TVSH, me afat zbatimi kontrate 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se përllogaritja e vlerës limit të kontratës është bërë duke marrë tre oferta nga tre subjektet *"A.....E"* , *"G.....T"* dhe *"S....O"* duke përdorur si çmime për preventivin e fondit limit mesataren e çmimeve të ofertuara nga këto tre oferta. Konstatohet se, nga ana e njësisë së prokurimit, gjatë përllogaritjes së vlerës së fondit limit të investimit, është përzgjedhur për të marrë ofertë nga një subjekt tregtar *(A.....E me NIPT K.....D)* i cili nuk rezulton se tregton produkte të ngjashme me ato të preventivit dhe as nuk ofron asistencë teknike. Pas kërkesës së bërë nga audituesit drejtuar hartuesve të preventivit dhe anëtarëve të njësisë së prokurimit, lidhur me analizën e bërë për çdo zë, kjo referuar strukturës së kostos e cila përllogarit një çmim total të çdo zëri sipas tabelës nr. 1, nuk u dha asnjë Pretendimim apo sqarim lidhur me faktin se cilat kanë qenë proceset e punës që do të përfshihen nën zërat e paraqitur në preventiv. Konkretisht nuk u argumentuan:

- Cili është çmimi i blerjes së produkteve të përfshira në preventiv;
- Sa është kostoja e transportit;
- Sa është kostoja e montimit të pajisjeve;
- Cilat janë proceset e punës që duhet të kryhen për shtrimin e linjës së fibrës optike;
- Cilat janë proceset e punës që duhet të kryhen për shtrimin e kabllove;

Në këto kushte nga ana e NJ.P nuk janë marrë masa për zbatimin e Vendimi Nr. 514, datë 15.08.2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3, 9 dhe pika 11.

Tabela nr. 9

| PRODUKTI | NJËSIA | PUNTORI | | | TRANSPORT | | | MAKINERI | | | MATERIAL | | | SHUMA | SHP.PL 8% | FITIMI 10 % | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ml | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Sp + p | o.p | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Sigurime shoqërore 16.7% | lekë | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Transport | t*km | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Makineri | o.p | | | | | | | | | | | | | | | | |
| material | ml | | | | | | | | | | | | | | | | |

Domosdoshmëria e një analize të tillë lind, jo vetëm prej pasqyrimit me transparencë dhe Pretendimimit të çmimit të vendosur për ml fibër optike por edhe prej faktit se këtë rast kemi të bëjmë me punime ndërtimit, kjo për aq kohë sa edhe operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit u është kërkuar që të kenë licencë për zbatim punimesh sipas kategorive të nevojshme.

Nga sondazhet e bëra në treg nga audituesit gjatë afatit të auditimit, rezultoi se, për të njëjtat produkte çmimet e ofertuara nga subjekte që operojnë në këtë treg janë deri në 20 herë më të ulëta nga çmimet e vendosur në preventivin e fondit limit përfshirë këtu edhe vendosjen e tyre në objekt. Nga ofertat e marra nga subjekte të ndryshme rezultuan çmimet pa TVSH si me poshtë:

Tabela nr. 10

| Emërtimi i produktit | Njësia | Subjekti tregtar dhe çmimet e marra nga audituesit nga sondazhet | | | | Çmimi i preventivit të fondit limit | Raporti maksimal Çmim preventivi/çmim tregu |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Subjekti 1 | Subjekti 2 | Subjekti 3 | Subjekti 4 | | |
| Fibër Optike 48 SM e armuar | ml | 200 | 112.5 | 200 | | 1,708 | **15** |
| Kabllo 3x2.5 | ml | | | 120 | 92 | 1,908 | **20** |
| Rack 42U | copë | - | 60,000 | 39,000 | | 124,000 | **3** |
| UPS | copë | - | | 56,000 | | 391,667 | **7** |

Siç shihet edhe nga tabela më sipër, nga krahasimi i këtyre çmimeve rezultojnë diferenca të konsiderueshme të cilave edhe nëse hartohet një analizë kostoje, duke përfshirë këtu, transportin e materialeve, fuqinë punëtore, të ndryshme që dalin gjatë zbatimit, 8 % shpenzime plotësuese si dhe 10 % fitim, përsëri çmimi i pasqyruar në preventivin e përdorur për hartimin e fondit limit është i pajustifikuar.

Në preventivin e miratuar është përcaktuar për zërin *"Kabllim elektrik"* një çmim prej 1,908 lekë/ml. Në fakt, nga sondazhet e kryera për zërin FROR 450/750V 3 x 2.5 $mm^2$, rezulton se çmimi/ml për këtë produkt varion nga 92.1 lekë/ml në 120 lekë/ml. Gjatë verifikimit në terren të punimeve në prani të mbikëqyrësit të punimeve dhe përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor u konstatua se vendosja e këtyre kabllove është kryer në kanale dhe tubacione ekzistuese të investimeve të mëparshme përgjatë aksit të Lungomares (me përjashtim të rasteve kur tubat kanë patur nevojë për pastrim). Pra e thënë ndryshe në këtë rast, nëse do të kryenim një analizë kostoje bazuar në çmimin mesatar të tregut për këtë produkt (kabllin 3 x 2.5 $mm^2$) dhe volumeve të punimeve të kryera në fakt rezulton se do të kishim një çmim për *"F.V Kablli 3 x 2.5 $mm^2$"* si më poshtë:

Tabela nr. 11

| Analizë | F.V kabllo 3x2.5 | ml | 1 | PUNTORI | | | MATERIAL | | | Shuma | 8% | 10% | Çmimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Sp + p | o.p | | 0.5 | 185 | 93 | | | | | | | |
| | Shtese mbi paga 16.7% | leke | | 93 | 0.167 | 15 | | | | | | | |
| | Kabëll | m | | | | | 1.01 | 106 | 107.1 | | | | |
| | Te ndryshme | leke | | | | | 0.011 | 107 | 1.2 | | | | |
| | Shuma : | | | | | 108 | | | 108.2 | 216.19 | 17.29 | 21.62 | **256** |

Vetëm si rrjedhojë e rritjes fiktive të çmimit të zërit *"Kabllim elektrik"* nga 256 lekë/ml në 1,908 lekë/ml, rezulton se është nisur një procedurë prokurimit me një fond prej 6,608,000 lekë pa TVSH më tepër nga të cilat vlera 5,959,800 lekë pa TVSH *(6,608,000 - 648,200)* përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore dhe ngarkon me përgjegjësi J. P, P. TH dhe F. D nën cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

*Zbatimi i punimeve*

Referuar kërkesave teknike lidhur me stolat inteligjentë kërkohet që materiali i përdorur për këta stola të jetë i tillë që të mos ndryshket. Në fakt nga verifikimi në terren rezultoi se stolat ishin të ndryshkur në disa raste:

Foto nr. 1

Foto nr. 2

Referuar kërkesave teknike lidhur me zërin *"Rack 42U së bashku me aksesorët"* është kërkuar që kjo pajisje të jetë me ngjyrë Ral 9005 (e zezë) dhe në pjesën e pasme me brima për mundësi ajrimi. Në fakt nga verifikimi i në terren rezultoi se kjo pajisej është vendosur me ngjyrë blu dhe pjesa e pasme është vendosur jo sipas kriterit për ajrimin, duke mos përmbushur kështu kërkesat e paraqitura nga AK për këtë zë në preventiv.

Foto nr. 3

- Referuar kërkesave teknike lidhur me zërin *"Rrjet fibër optike 48 SM"* është kërkuar që kjo fibër të jetë e armuar, me fije alumini, outdoor (për përdorime të jashtme) për të krijuar siguri gjatë montimit të saj nën tokë nga brejtësit apo nga agjentë të ndryshëm. Në fakt nga verifikimi në terren i punimeve rezultoi se fibra optike e vendosur nuk është me fije alumini duke mos përmbushur kështu kërkesat e paraqitura nga AK për këtë zë në preventiv i cili ka një vlerë prej 17,280,000 lekë me TVSH dhe që përfaqëson më shumë se 27 % të vlerës së kontratës së sipërmarrjes.
Konkretisht, në preventivin e miratuar është përcaktuar për zërin *"Rrjet fibër optike 48 SM"* një çmim prej 1,708 lekë/ml. Specifikimet për këtë produkt kanë kërkuar që fibra optike të jetë me 48 SM (48 Single Mode), e armuar me fije alumini, për përdorim të jashtëm dhe në përputhje me standardet profesionale të fibrës optike. Në fakt, gjatë verifikimit në terren të punimeve të përfunduara rezultoi se fibra e përdorur nuk ishte e armuar me fije alumini ashtu siç kërkohet dhe përcaktohet në specifikimi duke mos përmbushur kështu kërkesat e paraqitura nga AK për këtë zë në preventiv. Gjatë verifikimit në terren të punimeve në prani të përfaqësuesve të KLSH – së, mbikëqyrësit të punimeve dhe përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor u konstatua se vendosja e fibrës optike, me përjashtim të një gjatësie prej jo më shumë se 500 ml e cila është realizuar duke shtruar linja tubacioni të reja në trotuar apo në rrugë, pjesa tjetër e saj ose gjatësia prej 7500 ml, është vendosur në pusetat ekzistuese përgjatë akseve rrugore.

Si rrjedhojë e faktit se gjatë zbatimit të punimeve ka patur ndryshime mes specifikimeve të produkteve të kërkuara me ato të përdorura në fakt, nga ana e grupit të auditimit u kryen sondazhe në treg për çmimin e produktit fibër optike 48 SM të përdorur në objekt nga ku rezultuan çmime deri në 15 herë më të ulëta se ai i ofertuar nga sipërmarrësi por edhe nga çmimi i paraqitur në preventivin e fondit limit të hartuar nga preventivuesi. Sqarojmë këtu se, pavarësisht faktit se zëri i preventivit parashikon çmimin/ml përfshirë këtu blerjen, transportin, vendosjen në vepër dhe të gjitha aksesorët shtesë, çmimi nga blerja e produktit (mesatarisht 171 lekë pa TVSH/ml) në kushtet kur linja nëpër të cilën fibra do të kalojë është në puseta ekzistuese, nuk mund të arrijë në asnjë mënyrë një çmim prej 1,708 lekë/ml ose 10 herë më tepër pasi kjo rritje e çmimit nuk justifikohet me proceset e punës që do të kryhen për shtrirjen e linjës. Madje edhe referuar fuqisë punëtore me të cilën OE është paraqitur në tender, ditarit të punimeve dhe afatit të parashikuar në realizimin e kontratës, kostoja e shtrirjes së linjës përfshirë të gjithë elementët e mundshëm të strukturës së kostos nuk është deri në 10 herë më tepër se sa çmimit i produktit *Fibër Optike*.

Lidhur me rritjen fiktive në një vlerë prej 9,184,000 lekë pa TVSH *{(1,708 lekë/ml – 560 lekë/ml) x 8000 ml)}* ngarkohet me përgjegjësi (jo në dëm ekonomik) J. P, P. TH dhe F. D nën cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

Duke përllogaritur çmimin/ml të zërit *"F.V fibër optike 48 SM"* të kryer në fakt nëpërmjet një analize kostoje të mbështetur në çmimet e tregut për këtë produkt kemi:

Tabela nr. 12

| Fibër optike e armuar 48 SM | ml | Punëtori | | | Materiale | | | | Shp. Plotësuese | Fitim | Çmim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sp + p | op | 1 | 185 | 185 | | | | | | | |
| Shtese mbi paga 16.7% | leke | 185 | 0.167 | 31 | | | | | | | |
| Fibër optike | m | | | | 1.01 | **171*** | 173 | | | | |
| Te ndryshme | leke | | | | 0.5 | 173 | 86.4 | | | | |
| **Shuma :** | | | | **216** | | | **259** | **457** | **38** | **47** | **560** |

*171 lekë/ml Është marrë çmimi mesatar nga ofertat e marra nga tre subjekte që operojnë në këtë treg dhe që janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit*

Nga krahasimi i çmimit të rezultuar nga analiza e mësipërme *(560 lekë/ml)* me çmimin e vendosur në preventivin e fondit limit (1800 lekë/ml) rezulton se ka një diferencë prej 1,240 lekë/ml e cila ka sjellë si pasojë një dëm ekonomik në vlerën 9,920,000 lekë pa TVSH *{(1800 lekë/ml – 560 lekë/ml) x 8000 ml}*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e mosrespektimin të specifikimeve të zërave të parashikuar në preventiv e të paraqitur në situacionin përfundimtar.

**Si përfundim rezulton se**, në mënyrë fiktive, janë preventivuar tepër në fond limit të paktën vlera 15,792,000 lekë pa TVSH si pasojë e rritjes së çmimeve të përdorua për zërat e preventivit i cili ka qenë përcaktues i fondit limit të vënë në dispozicion. Dëmi i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 15,879,800 lekë pa TVSH rezulton të jetë i ndarë në 5,959,800 lekë pa TVSH në ngarkim të anëtarëve të njëjësisë së prokurimit për rritje fiktive me pasojë dëm ekonomik dhe në vlerën 9,920,000 lekë pa TVSH në ngarkim të firmës sipërmarrëse të punimeve si rrjedhojë e mosrespektimit të zërave dhe specifikimeve të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

-Nga ana e anëtarëve të njësisë së prokurimit *J. P, P. TH dhe F. D* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9.
Nga ana e mbikëqyrëses së punimeve *V. G.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.

-Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve;
Nga ana e kolaudatorit të punimeve *F. B.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 .

-Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve;
Nga ana e mbikëqyrëses së punimeve, *V. G.* si dhe nga ana e kolaudatorit të punimeve, *F. B.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 dhe udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me këtë objekt nga subjekti janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 3048/1, datë 20.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/12, datë 23.04.2018),nga mbikëqyrësja V. G., përfaqësuese ligjore e subjektit "P....C.....N" .*
***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri Njolla ndryshku në stola*
*Stolat janë furnizuar në përputhje me kërkesat e tenderit. Si pasojë e dëmtimeve me natyrë vandaliste, vetëm në dy stola u verifikuan njolla ndryshku (jo me shume se 4 apo 5 pika të vogla), te cilat në kuadër të mirëmbajtjes dhe garancisë, janë eliminuar nga operatori ekonomik që në momentin e verifikimit të tyre. Kujtojmë që operatori ekonomik kujdeset për të gjithë elementët e sistemit të implementuar nëpërmjet monitorimit elektronik si dhe me vizita periodike mujore në terren.*
***Përgjigja:*** *Pretendimet tuaja lidhur me njollat në stola nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nga verifikimi në terren i punimeve të përfunduara rezultoi sa përshkruhet në aktin e konstatimit, në projektraport si dhe në këtë raport përfundimtar auditimi. Observacioni nuk merret në konsideratë.*
***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri Në lidhje me ngjyrën e Rackut*
*Racku është furnizuar me dy versione portash, me portë të plotë dhe me portë me vrima. Porta prej xhami të temperuar lejon monitorimin vizual të funksionimit të pajisjeve dhe montohet në pjesën ballore të Rackut. Porta e pasme me vrima montohet në rastet kur në salle ka të instaluar sistem klimatizimi profesional. Duke qenë se në këtë sallë nuk ka një sistem kondicionimi, vendosëm të montohet portën e plotë.*
***Përgjigja:*** *Pretendimet tuaja lidhur me mos respektimin e specifikimeve teknike të Rack – ut nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi Pretendimimet nuk sjellin fakte shtesë dhe nuk justifikojnë konstatimet. Observacioni nuk merret në konsideratë.*

***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri Fibër optike*

*Akti i konstatimit citon në mënyrë të pasaktë specifikimin teknik të mbështjelljes së kabllit. Shprehjen: "E Armuar, fije alumini", në aktin e konstatimit është e shkruar "e armuar me fije alumini", duke i ndërruar kuptimin specifikimit teknik të kabllit. Në specifikimin teknik të kërkuar, fjala "fije alumini" nuk është përcaktor i fjalës pararendëse, por qëndron me vete. Shenja e pikësimit "," e vendosur midis, e ndan qartazi këtë kuptim. Interpretimi i saktë gjuhësor i specifikimit është që kablli duhet të jetë i armuar dhe të ketë një fije alumini (apo metali tjetër). Për barazi çmimi dhe karakteristikash teknike të transmetimit të informacionit dhe të rezistencës izoluese të kabllit, u vendos që të përdoret kablli i armuar, me fije dielektrike prej najloni. Në vijim po paraqesim strukturën e kostos së çmimit të paraqitur në formularin e çmimit të ofertës për zërin e fibrës optike. Kujtojmë që procedura e prokurimit nuk blen produktin fibër optike, por prokuron furnizim dhe vendosje të fibrës optike në kontekstin e një kompleksiteti shërbimesh, me terma "çelësa në dorë". Specifikimet teknike nuk përcaktonin projekt të qartë zbatimi. Në këtë kuadër, detyra e eksplorimit të mundësisë më të mirë për implementim ra mbi operatorin ekonomik. Elementet që përbejnë koston e furnizimit dhe vendosjes së fibrës optike janë:*

*1. Studimi i fizibilitetit të tre alternativave të gjurmës së kabllit optik;*
*2. Eksplorimi i gjendjes së tubacioneve përgjatë tre gjurmëve të mësipërme dhe dokumentimi i gjurmës fituese;*
*3. Studim dhe Dokumentim i nevojës për kanalizime të reja duke minimizuar riskun e dëmtimeve të mundshme të infrastrukturave të tjera nëntokësore në këto segmente;*
*4. Makineri dhe pajisje për hapjen e kanalizimeve të reja, shtrimin e tubave përkatës dhe kthimin e situatës në gjendjen e mëparshme;*
*5. Fuqi punëtore e specializuar e në shtrirjen e fibrës optike;*
*6. Shpenzime dieta dhe hotelerie për personelin e angazhuar;*
*7. Hapje, pastrim, zhbllokim dhe rivendosje në gjendjen e mëparshme e tubacioneve apo kanalizimeve të vjetra të Bashkisë Vlorë në pjesën dërrmuese të gjatësisë së tyre (mbi 75% të gjatësisë).*
*8. Fuqi punëtore e angazhuar me punimet civile për lirimin e tubacioneve apo kanalizimeve;*
*9. Puseta të reja përgjatë shëtitores Lungomare, në formën dhe rifiniturën artistike të shëtitores. 10. Elementet e nevojshëm për degëzimin e fibrës optike, (gusha DOME, material izoluese, tubacion, gërmime dhe kthime ne gjendjen e mëparshme shtesë, mbi 2600 ml fibër optike degëzuese me 4 fije mbi sasinë prej 8000ml të paraqitur në FCO);*
*11. Pajisjet dhe elementet e nevojshëm për terminimin e fibrës optike në pajisjet qendrore dhe në pajisjet fundore;*
*12. Kabllot e vijimësisë së linkeve optike në pajisje fundore dhe në pajisjet qendrore;*
*13. Ngjitje (splicing) e fibrës optike ne secilën puset, pajisje fundore (stola) dhe në pajisjet qendrore (Rack);*
*14. Adaptorët optik të transmetimit të sinjalit optik me shpejtësi transmetimi 1 gigabajt për sekondë në fibër single mode, të aftë të përçojnë sinjalin në distancë deri në 40km;*
*15. Kabllimin adaptues për ushqimin e kamerave dhe akses pointeve të shpërndara në terren;*
*16. Barabanet e fibrës optike (kablli);*
*16. Transporti, magazinimi dhe ruajtja e fibrës optike në magazine dhe në terren me roje me tre turne për 4 muaj;*
*17. Kosto shtesë për arsye të punimeve në orare të vona me qëllim mos pengimin e lëvizjes së njerëzve apo automjeteve në zonat e punës;*

*18. Kosto e gatishmërisë për shërbim dhe suport me help desk me termat 24/7 375*
*19. Kosto administrative dhe fitimi i kompanisë.*
*Në koston e zërit që ka të bëjë me furnizimin dhe vendosjen e fibrës optike paraqitur në formularin e çmimit të ofertës, vlera e kabllit* ***optik në vetvete zë vetëm 10 % te tij çmimit të paraqitur****.*
*Kostoja e fibrës Corning model "ALTOS® Loose Tube Dielectric Armour Outdoor Cable 4x12 E9 SMF-28e+® ITU G652.D LT 2.3" është rreth 10% me e lartë se kostoja e fibrës optike me fije metalike pasi kjo e dyta përbën rrezik për induktim dhe transmetim elektriciteti.*

***Përgjigja:*** *Së pari sqarojmë se, referuar ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 8, citohet se: "...****zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik****...". Gjithashtu, referuar Udhëzimit nr. 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu I, Pika 7 citohet se: "Sipërmarrësi nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij". Për rrjedhojë, nga ana juaj si mbikëqyrëse e kontratës së sipërmarrjes nuk janë marrë masa për zbatimin e punimeve konform kërkesave ligjore të përshkruara më sipër, specifikimeve teknike shoqëruese si dhe kontratës së shërbimit të mbikëqyrjes. Për sa i përket argumenteve tuaja të dërguara me observacion, ku keni bërë një interpretim gjuhësor dhe gramatik të konstatimeve të bëra nga grupi i auditimit ato nuk merren në konsideratë për shkak se ky lloj interpretimi është jashtë kontekstit të çështjes e aq më tepër një interpretim i tillë siç është ai lidhur me shprehjen e cituar nga ana juaj: "...Interpretimi i saktë gjuhësor i specifikimit është që kablli duhet të jetë i armuar dhe të ketë një fije alumini* ***(apo metali tjetër)****...". Shprehja "të ketë një fije alumini" dhe "apo metali tjetër" është një interpretim jo vetëm i pasaktë por i që i shmanget fakteve dhe konstatimeve. Në këtë perifrazim tuajin nuk ka asnjë argument apo fakt shtesë lidhur me sa është konstatuar nga auditimi. Prania e fijeve të aluminit është kërkuar në kategorinë* ***Mbështjellja*** *dhe fakt është që mbështjellja e 48 fijeve të fibrës optike të përdorur nuk ka fije të tilla (alumini) dhe nuk ka as mbështjellëse alumini. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se pjesë e DST – ve ka qenë edhe projekti dhe specifikimet teknike të hartuara nga ing. J. P dhe të miratuara nga Titullari, projekt ky i cili nuk ka pësuar ndryshime deri në fund të zbatimit të kontratës së sipërmarrjes së punimeve. Sipas Udhëzimit nr. 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu I, Pika 3.4 citohet se: "Sipërmarrësi, brenda një afati të pranuar nga palët paraqet kërkesë-propozimet për korrigjime, plotësime apo përmirësime në projekt dhe për mungesat e pasaktësitë, ligjore a kontraktuale të dokumentacionit të dorëzuar. Kërkesë-propozimet i paraqiten mbikëqyrësit nga sipërmarrësi, gjatë zhvillimit të punimeve, sa herë që gjykohet e arsyeshme prej tij.". Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe materialet shtesë të dërguara me observacion nuk rezulton të ketë patur një praktikë të tillë (kërkesë + miratim). Për sa i përket aktiviteteve të përmendur nga ju si pjesë përbërëse e kostos së punës për metër linear fibër optike të vendosur sqarojmë se observacioni, jo vetëm që nuk trajton një analizë konkrete kostoje sipas Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" por konstatohet se një pjesë e këtyre aktiviteteve janë detyrë e sipërmarrësit gjatë zbatimit të punimeve të cilat përfshihen në ato që quhen Shpenzime Të Drejtpërdrejta dhe Shpenzime të Përgjithshme dhe Fitimi.*
*Grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë Pretendimimet lidhur me ngjyrën e Rack – ut si dhe licencën e antivirusit pas sqarimeve të sjella me observacion dhe konfirmimit të afatit 3 vjeçar të licencës së programit*

**5. Objekti *"Rikonstruksion i shkollës së mesme Ali Demi"*, Vlorë.**

*Kontratat*

Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues BOE *"C....O"* me përfaqësues ligjor Diana L....A dhe nr. licence për zbatim punimesh NZ..... datë 21.10.2016 dhe *"F.....A"* me përfaqësues ligjor Shkëlqim F.....A me nr. licence për zbatim punimesh NZ. ..... datë 14.05.2015. Kontrata është kryer në bazë të aktit me nr. 9762 prot., datë 18.11.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe BOE me vlerë të kontratës 198,761,455 lekë me TVSH, me afat zbatimi kontrate 9 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 10390 prot., datë 07.12.2016, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me F. B. përfaqësues ligjor i subjektit *"H.....1"* me vlerë të kontratës 822,816 lekë me TVSH. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 9425 prot., datë 12.10.2017 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me D. Q. përfaqësuese ligjore e subjektit *"T....T"* me vlerë të kontratës 15,600 lekë.

*Zbatimi i punimeve*

Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara e të likuiduara si dhe atyre të kryera në fakt rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuara nga Autoriteti Kontraktor me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 7,339,830 lekë pa TVSH.

Tabela nr. 13

| Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Vol. | Vlera |
| **II. PUNIME NDËRTIMI** | | | | | | | |
| Punime prishjeje dhe çmontimi | | | | | | | |
| Transport vertikal i mbeturinave të ndërtimit | $m^3$ | 1,500 | 1746 | 1746 | 0 | 1746 | 2,619,000 |
| Punime shtresash | | | | | | | |
| Shtresë me lustër çimento 1:2 t=2 cm nën pllaka | $m^2$ | 350 | 3303 | 3303 | 187 | 3116 | 1,090,600 |
| Punime suvatimi dhe veshje | | | | | | | |
| Suvatim me grafjato h>4 m | $m^2$ | 1,100 | 994 | 3449 | 0 | 994 | 1,093,400 |
| Punime dyer dritare | | | | | | | |
| F.V dritare alumini termik me dopjo xham termik | $m^2$ | 25,200 | 781 | 781 | 760 | 21 | 529,200 |
| Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm termik | $m^2$ | 28,300 | 106.3 | 106.3 | 98.2 | 8.15 | 229,230 |
| F.V dyer d/alumini plastike me dopjo xham | $m^2$ | 16,000 | 37.2 | 37.2 | 0 | 37.2 | 595,200 |
| **III. PUNIME NDËRTIMI (Sistemimi dhe terreni)s** | | | | | | | |
| Cilindrim shtresash me rul | $m^2$ | 50 | 2278 | 2278 | 0 | 2278 | 113,900 |
| Shtresë stabilizanti t=15 cm | $m^2$ | 650 | 2278 | 2278 | 1700 | 578 | 375,700 |
| Shtresë me rërë kuarci me ngjyrues, t=1 cm | $m^2$ | 1,200 | 2278 | 2278 | 1700 | 578 | 693,600 |
| | | | | | | **Total** | **7,339,830** |

- Transport vertikal i mbeturinave të ndërtimit

Situacioni përfundimtar pasqyron në total volumin prej 1746 $m^3$ transport vertikal mbeturinash. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, transporti i mbeturinave është bërë nën zërin me nr. A-1.18 me nr. analize 2.37/5a *"Transport i mbeturinave me auto deri 5 km"* dhe situacionimi i transportit si zë më vete konsiderohet si volum pune i pakryer. Një transport i tillë brenda kantierit të ndërtimit është volum pune fiktiv pasi referuar specifikimeve teknike saktësohet se pas

prishjeve materialet e rezultuara nga to, janë të përcaktuara për tu dërguar në vendin e miratuar për grumbullim, çka do të thotë se pas prishjes materialet duhen grumbulluar në pikën e grumbullimit të tyre. Pra, kurrsesi nuk mund të ketë dy transporte materiali brenda (aq më tepër kur i njëjti çmim prej 1,500 lekë/$m^3$ jepet edhe për transport 5 km edhe për transport vertikal me jo më shumë se 20 m). Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 1746 $m^3$ transport vertikal materialesh.

-Shtresë me lustër çimento 1:2 t=2 cm nën pllaka

Situacioni përfundimtar për kontratën bazë pasqyron në total volumin prej 3303 $m^2$ shtresë me luster çimento nën pllaka. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt punimet e shtresës me pllaka për volumin prej 3116 $m^2$ janë realizuar sipas zërit me numër analize 2.267/a *"Shtrese me pllaka grez porcelanato"* i cili përfshin edhe punimet e shtresës 2 cm nën pllaka. Për rrjedhojë, rezulton se janë përfituar tepër nga sipërmarrësi i punimeve volumi prej 3116 $m^2$ shtresë më lustër çimento nën pllaka.

-Suvatim me grafjato h>4 m

Situacioni përfundimtar për kontratën bazë pasqyron në total volumin prej 994 $m^2$ suvatim me grafjato. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike volumin prej 3449 $m^2$. Në fakt punimet e veshjes me fasadë me polisterol kompakt janë realizuar sipas zërit me numër analize 2.358/b *"Veshje fasade me polisterol jeshil t=5cm + rrjete + suva."* i cili përfshin edhe punimet e suvatimit me grafjato. Për rrjedhojë, rezulton se janë përfituar tepër nga sipërmarrësi i punimeve volumi prej 994 $m^2$ suvatim me grafjato.

-F.V dritare alumini termik me dopjo xham termik

Situacioni përfundimtar për kontratën bazë pasqyron në total volumin prej 781 $m^2$ dritare d/alumini. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, nga verifikimi në terren i punimeve të dritare rezultoi volumi prej 760 $m^2$. Për rrjedhojë, rezulton se janë përfituar tepër nga sipërmarrësi i punimeve volumi prej 21 $m^2$ dritare d/alumini.

-Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm termik

Situacioni përfundimtar për kontratën bazë pasqyron në total volumin prej 106.3 $m^2$ fasade xhami strukturale. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, nga verifikimi në terren i punimeve të fasadës rezultoi volumi prej 98.2 $m^2$. Për rrjedhojë, rezulton se janë përfituar tepër nga sipërmarrësi i punimeve volumi prej 8.15 $m^2$ fasade xhami strukturale.

-F.V dyer d/alumini plastike me dopjo xham

Situacioni përfundimtar për kontratën bazë pasqyron në total volumin prej 37.2 $m^2$ dyer d/alumini plastike. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, nga verifikimi në terren i punimeve të dyerve rezultoi se ky volum pune nuk është kryer. Për rrjedhojë, rezulton se janë përfituar tepër nga sipërmarrësi i punimeve volumi prej 37.2 $m^2$ dyer d/alumini plastike.

-Cilindrim shtresash me rul

Situacioni përfundimtar pasqyron në total volumin prej 2278 $m^2$ cilindrim shtresash me rul. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, punimet e shtresave (stabilizanti) janë kryer sipas zërave të cilët kanë të parashikuar edhe punimet për rulimin. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 2278 $m^2$ cilindrim shtresash me rul.

-Shtresë stabilizanti t=15 cm

-Shtresë me rërë kuarci me ngjyrues, t=1 cm

Situacioni përfundimtar për kontratën bazë pasqyron në total volumin prej 2278 $m^2$ shtresë stabilizanti dhe shtresë me rërë kuarci. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në

fakt, nga verifikimi në terren i punimeve rezultoi volumi prej 1700 $m^2$. Për rrjedhojë, rezulton se janë përfituar tepër nga sipërmarrësi i punimeve volumi prej 578 $m^2$ për secilën nga këto dy shtresa.
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën 7,339,830 lekë pa TVSH sipërmarrësit të punimeve si rrjedhojë e punimeve të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
-Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve *F. B.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.

-Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 10390 prot., datë 07.12.2016.
Nga ana e kolaudatores së punimeve *ing. D. Q.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12 dhe udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika.

-Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 9425 prot., datë 12.10.2017.
Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, *F. B.* si dhe nga ana e kolaudatores së punimeve, *Ing. D. Q.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 dhe udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me këtë objekt nga subjekti janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 3048/1, datë 20.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/12, datë 23.04.2018),nga mbikëqyrësi F. B. përfaqësues ligjor i subjektit "H.....K" dhe nga kolaudatorja e punimeve, znj. D. Q., përfaqësuese e "T.....T" .*
***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri: Transport vertikal i mbeturinave të ndërtimit*
*Të gjitha punimet e prishjes që i korrespondojnë zërave të punimeve nga A-1.1 deri te zëri A-1.16 të preventivit bazë dhe situacionit përfundimtar, që janë realizuar në objekt, në bazë të matjeve faktike dhe hartimit të librezës së masave janë punime të cilat krijojnë mbeturina ndërtimi në të gjithë ambientin e shkollës, në ndërkate edhe tarrace. Referuar analizës teknike të çmimit (INSTAT) 2.37/5a "Transport i mbeturinave me auto deri në 5 km", rezulton se nuk është i përfshirë ky proces pune dhe si i tillë nga ana e preventivuesit dhe projektuesit është parashikuar si zë me vete, e shprehur me përshkrimin "Transport vertikal i mbeturinave te ndërtimit" duke hartuar dhe analizën përkatëse të çmimit (An). Shkolla e rikonstruktuar në total është 100 m e gjatë dhe për të shkuar deri në pikën e grumbullimit ndër kate kryhet procesi i punës transport i mbeturinave me karro dore dhe me tej nga kjo pikë bëhet ngarkimi në vinç dhe zbriten në piken e depozitimit në objekte. Pra nuk kemi të bëjmë me dy transporte brenda objektit pasi 'Transporti me auto deri 5 km', referuar analizës teknike të çmimit me nr. analize 2.37/5a konsiston në ngarkimin me fadromë në auto dhe më tej transportin e tyre deri në pikën e caktuar nga investitori. Në lidhje me pretendimin se çmimi për të dy transportet është i njëjtë, ju sqarojmë se kjo nuk është e vërtet pasi preventivuesi ka dhënë çmime të ndryshme për të dy zërat, ku transporti vertikal i mbeturinave referuar analizës së preventivuesit është me çmimin 292 leke/$m^3$ ndërsa transporti me auto deri në 5 km referuar analizës së INSTAT është 319 leke/$m^3$. Nga ana e*

*sipërmarrësit është ofruar çmimi i ofertës që nuk ka asnjë lidhje logjike të mos jetë i njëjtë pasi ka të drejtë të ofrojë çfarëdo lloj çmimi, pra nuk do të thotë se meqenëse kanë çmime të njëjta është një proces i vetëm pune. Objekti i rikonstruktuar është i pozicionuar në qendër të qytetit dhe materialet e ndërtimit nuk mund të hidhen me lopata në ajër. Madje ato trajtohen me ujë duke u spërkatur për të mos krijuar ndotje të ambientit dhe ngarkohen në kosha të mbyllur e zbriten me vinç.*

***Përgjigje:*** *Pretendimi juaj mbi situacionimin e transportit të materialeve brenda kantierit nuk merret në konsideratë pasi referuar Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", Kreu II, paragrafi, germa B, pika 7 përcaktohet se: Shpenzimet e paparashikuara në zërat e punës dhe në shpenzimet e drejtpërdrejta* ***përfshijnë****: zgjedhja e kampioneve, të rifiniturave, lagia, mirëmbajtja dhe mbrojtja e punimeve nga shiu e ngricat pas kohës normale të punës,* ***pastrimi dhe sistemimi i objektit e sheshit të ndërtimit, para dhe gjatë marrjes në dorëzim etj****. Nga sa më sipër si dhe referuar specifikimeve teknike të zërave të prishjeve pretendimet nuk qëndrojnë e si të tilla nuk merren ne konsideratë.*

***Pretendimi i subjektit****: Zëri: Shtrese me luster çimento 1:2 t=2 cm nen pllaka*

*Duke qenë se objekti ka qenë i shtruar me pllaka çimentoje si dhe deformime të mëdha të shtresave, mbas heqjes së tyre është hedhur shtresë termoizoluese me polisterol t=10 cm, për këtë arsye nuk mund të realizohet nivelimi dhe fërkimi i saj me helikopter pasi ky material në përbërje ka polisterolin kokrrizor i cili nuk mund të krijojë nivelim të saktë për shtrimin e pllakave si dhe nuk realizohet ngjitja e pllakës me këtë material. Nga ana e preventivuesit në të gjithë objektin është parashikuar shtresë luster çimento e cila ka qenë variabël në lidhje me trasheshin, me qëllim që të krijonte një sipërfaqe të lëmuar ku materiali koll siguron një lidhje shumë të mirë me lustrën e çimentos. Referuar analizës teknike nr. analize 2.264 "Shtresë me luster çimento 1:2 t=2 cm nën pllaka" të dhënë nga INSTAT (analizat bashkëngjitur) është volum pune i kryer me vete jashtë çdo volume tjetër pune.*

***Përgjigje:*** *Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi referuar manualit teknik të çmimeve në fuqi, konkretisht zërit me nr. Analize 2.267/a sipas të cilit është kryer volumi prej 3116 $m^2$ shtresë me pllaka rezulton sa përshkruhet në aktin e konstatimit, në projekt raport si dhe në këtë raport përfundimtar auditimi. Gjatë hartimit të aktit të konstatimit është bërë një ngatërresë mes zërit 2.267/b me zërin 2.267/a, por pa cenuar padrejtësisht vlerën e dëmit ekonomik të shkaktuar prej likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.*

*Observacioni nuk merret në konsideratë.*

***Pretendimi i subjektit****: Zëri: Suvatim me grafjato h>4 m*

*Suvatimi me grafjato 994 $m^2$ e pasqyruar ne librezën e masave nuk është suvatimi, për të cilën ju jeni referuar analizës 2.358/b "Veshje fasade me polisterol jeshil t=5 cm + rrjete + suva". Suvatimi me grafjato konsiston në suvatimin e faqeve të brendshme të dritareve, kollonetave dhe punimeve të tjera të cilat nuk janë realizuar me veshje fasade me polisterol, kjo përbën volumin e realizuar me emërtimin, suvatim me grafjato pasi paturat dhe kollonetat nuk mund të vishen me polisterol jeshil për arsye se zvogëlon sipërfaqen e dritës si dhe nuk realizohet mbërthimi i dritareve dhe vetratave dhe si i tillë është proces pune i realizuar më vete dhe jo i përfshirë në zërin e punës që ju pretendoni, kjo referuar analizës teknike të çmimit në nr. analize 2.308/a të INSTAT. Interpretimi juaj nuk mund të pranohet dhe nuk kemi të bëjmë me asnjë dëm ekonomik*

***Përgjigje:*** *Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi referuar manualit teknik te çmimeve në fuqi, konkretisht zërit me nr. Analize 2.358/b rezulton sa përshkruhet në aktin e konstatimit, në projekt raport si dhe në këtë raport përfundimtar auditimi.*

*Konkretisht, materiali i përfshirë në analizë është suva për grafjato dhe në asnjë pjesë të analizës nuk përmendet përdorimi i kësaj sasie materiali për faqet e brendshme të dritareve, kollonetat apo punime të tjera siç ju pretendoni. Përdorimi i suvasë për grafjato është për 1 $m^2$ veshje fasade me polisterol dhe nuk shprehet për paturat e dritareve.*
*Observacioni nuk merret në konsideratë.*
***Pretendimi i subjektit**: Zëri: F.V dritare alumini termik me dopjo xham termik*
*Të ndodhur para faktit ku audituesit pretendojnë se kanë konstatuar një diferencë në këtë volum, ne shkuam përsëri në objekt dhe rimatëm një për një sipërfaqet e çdo dritareje, nga rimatjet na rezultojnë në sasinë 781 $m^2$ sa dhe është pasqyruar në librezën e masave dhe të situacionuar në situacionin përfundimtar.*
***Përgjigje:** Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nga inspektimi në objekt i punimeve në prani të mbikëqyrësit të punimeve rezultoi sa përshkruhet ne aktkonstatim, në projektraport si dhe në këtë raport përfundimtar auditimi.*
*Observacioni nuk merret në konsideratë.*
***Pretendimi i subjektit**: Zëri: Veshje fasade me xham struktural i pathyeshëm termik*
*Nga rimatjet faktike në vend na rezultojnë se janë realizuar 106.3 $m^2$ fasade xhami struktural.*
***Përgjigje:** Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nga inspektimi në objekt i punimeve në prani të mbikëqyrësit të punimeve rezultoi sa përshkruhet ne aktkonstatim, në projektraport si dhe në këtë raport përfundimtar auditimi.*
*Observacioni nuk merret në konsideratë.*
***Pretendimi i subjektit**: Zëri: Dyer d/alumini plastike me dopjo xham*
*Ky volum i përket dyerve të vendosura në tualete dhe i realizuar në masën 37.2 $m^2$.*
***Përgjigje:** Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nga inspektimi në objekt i punimeve në prani të mbikëqyrësit të punimeve rezultoi se tualete nuk kishte dyer d/alumini plastike dhe me xham dopjo.*
*Observacioni nuk merret në konsideratë.*
***Pretendimi i subjektit**: Zëri: Cilindrim shtresash me rul*
*Cilindrimi i shtresave në preventiv dhe në ofertën e sipërmarrësit i përket analizës 3.198 të manualit të çmimeve të INSTAT dhe është cilindrim i kasonetes dhe si i tille është realizuar nga ana e sipërmarrësit para se të hidhen nënshtresat e tjera dhe nuk ka lidhje me rulimin e këtyre nënshtresave.*
***Përgjigje:** Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi i ditarit të punimeve, si dhe emërtimit të zërit rezulton se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me kasonetë dhe njëkohësisht shtresat e realizuara e kanë të përfshirë volumin e punës për cilindrim.*
*Observacioni nuk merret në konsideratë.*
***Pretendimi i subjektit**: Zëri: Shtresë stabilizanti;*
*Shtresë me rërë kuarci me ngjyrues, t=1 cm*
*Nga rimatjet faktike na rezultuan se volumet e kryera për secilën shtresë është 2278 $m^2$ dhe jo 1700 $m^2$.*
***Përgjigje:** Pretendimet tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nga inspektimi në objekt i punimeve në prani të mbikëqyrësit të punimeve rezultoi sa përshkruhet ne aktkonstatim, në projektraport si dhe në këtë raport përfundimtar auditimi.* ***Observacioni nuk merret në konsideratë***

**6. Objekti *"Rehabilitimi dhe riasfaltimi i disa rrugëve kryesore të qytetit të Vlorës"*, Bashkia Vlorë.**

*Projekti*

Projekt – preventivi për këtë investim është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të bashkisë Vlorë dhe parashikon një vlerë prej 149,962,193 lekë me TVSH, vlerë kjo e cila ka shërbyer edhe si përcaktuese e fondit limit të vënë në dispozicion të investimit. Investimi synon ndërhyrje sipërfaqësore dhe riparime në 20 akse rrugore kryesore të qytetit të Vlorës.

*Kontratat*

Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues BOE *"C.....Y R.....A 2008"* me nr. licence në zbatim NZ..... datë 19.02.2015 dhe *"A.....I K.....N"* të përfaqësuar këta nga OE *"C.....Y R.....A 2008"* . Punimet në objekt janë kryer në bazë të kontratës për punë publike me nr. 10951 prot., datë 27.12.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe BOE me vlerë të kontratës 108,224,716 lekë me TVSH, me afat zbatimi kontrate 3 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit dhe me periudhë garancie 1 vit nga data e kolaudimit të punimeve. Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratës së lidhur me OE është 41,737,477 lekë me t.v.sh ose gati 28 % më pak se fondi limit. Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 10697 prot., datë 29.12.2016 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me R. N. përfaqësuese ligjore e subjektit mbikëqyrës *"R.....N 95"* me vlerë të kontratës 31,200 lekë me TVSH. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se:

-Njoftimi për fillimin e punimeve nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi është bërë sipas aktit me nr. 230 prot., datë 16.01.2017;

-Aktet e dorëzimeve të shesheve të ndërtimit për të gjitha akset rrugore rezultojnë të jenë të pa firmosura nga AK apo përfaqësues të tij;

-Sipas procesverbalit të mbajtur mes sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit, punimet janë ndërprerë me datë 17.01.2017 për shkak të temperaturave të ulëta nën zero.

-Sipas shkresës me nr. 274/1 prot., datë 20.01.2017 është miratuar nga Titullari shtyrja e afatit të punimeve deri me datë 01.02.2017;

-Sipas procesverbalit përkatës të mbajtur mes sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit punimet kanë filluar me datë 01.02.2017.

-Leja infrastrukturore e objektit ka dalë sipas aktit me nr. 732 prot., datë 22.02.2017 dhe me nr. 105 datë 22.02.2017;

-Sipas aktit me nr. 3758 prot., datë 08.05.2017 është bërë një amendament kontrate mes Titullarit të AK Bashkia Vlorë dhe përfaqësuesit të BOE mbi zgjatjen e afatit të punimeve deri me datë 22.07.2017;

-Pas kërkesës së sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit është mbajtur një tjetër amendament kontrate për shtyrjen e afatit deri me datë 30.09.2017 duke pezulluar punimet për periudhën 24.07.2017 – 01.09.2017;

-Sipas aktit me nr. 4926 prot., datë 06.06.2017 është miratuar nga Titullari i AK zëvendësimi i aksit rrugor *"Janaq Kilica"* – "*Fabrika e Tullave"* l = 825 m me vlerë 11,272,115 lekë pa TVSH me akset rrugore *"Rruga Mifol, degëzim lagje dhe sheshi përpara varrezave L=752 ml + 260 ml + Sheshi në hyrje të rrugës+ sheshi përpara varrezave"* me vlerë 10,795,200 lekë pa TVSH;

-Sipas shkresës me nr. 8971 prot., datë 29.09.2017 të bërë nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve është njoftuar Autoriteti Kontraktor Bashkia Vlorë për përfundimin e punimeve;

Deri më sot që hartohet ky procesverbal rezulton se janë likuiduar me Urdhër Shpenzimet përkatëse dy situacione pjesore sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 14

| Situacioni | Data e faturës ekonomike | Vlera me t.v.sh e faturës ekonomike | Nr. i faturës ekonomike | Urdhër - shpenzimi | | Vlera e likuiduar me TVSH |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nr. | Datë | |
| Nr. 1 | 02.05.2017 | 55,000,000 | 746 | 381 | 09.05.2017 | 55,000,000 |
| Nr. 2 | 21.06.2017 | 41,416,630 | 749 | 661 | 28.07.2017 | 37,506,568 |
| *Total likuiduar* | | | | | | **92,506,568** |

Pas kërkesës së sipërmarrësit dhe asaj të mbikëqyrësit të punimeve ardhur në Bashkinë Vlorë me nr. 3561 prot., datë 02.05.2017 për likuidimin e situacionit nr. 1 është likuiduar ky i fundit sipas Urdhër Shpenzimit përkatës. Në fakt konstatohet se në këtë situacion janë likuiduar volume pune të pakryera në fakt në momentin e likuidimit në vlerën 6,290,112 lekë me TVSH. Kjo konstatohet nga fakti se gjatë inspektimit në objekt në prani të mbikëqyrësit punimet në aksin "*Rruga KOSOVA L=336 ml"* nuk kishin përfunduar dhe ishte kryer vetëm një skarifikim pjesor. Në situacionin pjesor nr. 2, për këtë aks rrugor, volumet e punës janë zbritur nga vlera 6,290,112 lekë me TVSH në 416,863 lekë me TVSH. Gjithashtu me zbritje nga situacioni nr. 1 në atë numër 2 rezultojnë edhe zëra të tjerë, kryesisht volumet e punës për vijëzimet e rrugës, punime këto të cilat janë në vlerën 1,881,449 lekë me TVSH. Nga sa më sipër rezulton se është favorizuar padrejtësisht sipërmarrësi i punimeve nëpërmjet likuidimit të parakohshëm të punimeve në vlerën 7,754,698 lekë me TVSH si dhe janë hartuar dokumente fiktive dhe që nuk kanë paraqitur realitetin dhe punimet faktike në momentin e dorëzimit të tyre për likuidim. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi mbikëqyrësen e punimeve R. N..
Për sa i përket zërave të preventivit në të gjitha akset e ndërhyra rezulton se është situacionuar e likuiduar si zë më vete vlera e punimeve prej 323,577 lekë pa TVSH për transportin e 2813.7 $m^3$ materiale të dala nga skarifikimi i shtresave asfaltike kur ndërkohë, zëri An *"Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri"* ka të përfshirë vetë transportin.
Nga inspektimi rezultoi gjithashtu, se nga ana e firmës sipërmarrëse, mbikëqyrësit të punimeve por edhe nga vetë AK nuk janë marrë masa për ngritjen e kuotave të pesetave në rrugë. Në rastet e konstatuara dhe te evidentuara si problematike rezultoi si më poshtë:

Sipas amendamentit të dytë të mbajtur mes AK Bashkia Vlorë dhe sipërmarrësit të punimeve punimet duhet të kishin përfunduar me datë 30.09.2017. Në fakt, konstatohet se njoftimi nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi për përfundimin e punimeve i cili është bërë sipas shkresës me nr. 8971 prot., datë 29.09.2017 është fiktiv dhe nuk pasqyron realitetin pasi punimet në objekt nuk kanë përfunduar në këtë datë. Konkretisht punimet në aksin "*Rruga KOSOVA L=336 ml"* dhe *"Rruga Enver Jaho, Mumin Selami dhe Odhise Paskali"* nuk kanë përfunduar dhe dosja teknike, edhe pas më shumë se një muaj nga data e njoftimit të përfundimit të punimeve nuk është dorëzuar. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit nuk rezulton të këtë amendament shtesë në afat për realizimin e punimeve dhe njëkohësisht as njoftim ndaj sipërmarrësit për aplikimin e penaliteteve për vonesa në

përfundimin në afat të punimeve. I përllogaritur, rezulton se penaliteti prej 1,613,760 lekë i pa aplikuar ndaj sipërmarrësit është si më poshtë:

Tabela nr. 16

| Situacioni | Data e faturës ekonomike | Vlera pa t.v.sh e faturës ekonomike | Vlera e pakryer përtej afatit të kontratës | Penaliteti/ditë Vlera x 4 / 1000 | Ditë përtej afatit të miratuar (30.09.2017) | Penaliteti |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. 1 | 02.05.2017 | 45,833,333 | - | - | - | - |
| Nr. 2 | 21.06.2017 | 34,513,858 | - | - | - | - |
| Sit. Përfundimtar | - | 9,840,072 | 9,840,072 | 39,360 | 41 | 1,613,760 |
| | | | | | **Shuma** | **1,613,760** |

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, mbi likuidimin e parakohshme të punimeve në vlerën 7,754,698 lekë me TVSH, likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në vlerën 323,577 lekë pa TVSH si dhe mos marrjen e masave për aplikimin e penaliteteve për vonesat ne vlerën 1,613,760 lekë ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësja e punimeve R. N.

**Konkretisht**:

-Nga ana e mbikëqyrëses së punimeve *R. N.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.

-Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 10697 prot., datë 29.12.2016. Udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 "*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit""*, pika 4, paragrafi 4 ku përcaktohet dokumentacioni i nevojshëm i dosjes teknike;

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me këtë objekt nga subjekti janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 3048/1, datë 20.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/12, datë 23.04.2018), nga mbikëqyrësja R. N., përfaqësuese ligjore e subjektit "R.....96" .*

***Pretendimi i subjektit:***

*Në manualin nr. 3 VKM nr. 629 datë 15.07.2015 për zërat shtresë binderi dhe shtresat e asfaltobetonit nuk përfshihet transporti i tyre që në rastin më të mirë është mbi 5 km. Objekti në fjalë duke qenë punë publike, Bashkia Vlorë parashikon në preventiv transport material ndërtimi deri në 5 km kur në fakt nyjet e asfaltobetonit në të gjithë vendin janë jashtë qendrave të banuara ose mbi 10 km. Të njëjtin problem kanë edhe materialet e tjera të ndërtimit që duhen në objekt.*

***Përgjigja:***

*Pretendimet tuaja lidhur me diferencat në volume nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit. Pretendimimet nuk sjellin fakte shtesë dhe nuk i përmbahen konstatimeve në aktkonstatim. Konkretisht, lidhur me likuidimin e volumeve të punës për transportin e materialeve të rezultuara nga skarifkimi rezulton sa përshkruhet në aktkonstatim, në projektraport si dhe në këtë raport përfundimtar auditimi.*

***Pretendimi i subjektit:***

*Kontraktuesi ka përfunduar punimet në këtë datë (30.09.2017) duke zbritur rrugën Kosova, për të cilën Kryetari i Bashkisë Vlorë kërkoi që për këtë rrugë të bëhej ndryshim projekti për arsye të problemeve me përmbytjet e vazhdueshme të saj, kanalizimet e ujërave të zeza, tubacioneve të ujit të pijshëm të amortizuara si dhe me ndryshimin e trashësisë së shtresave pasi në këtë rrugë kalojnë automjete të*

*tonazhit mbi 40 ton që ngarkohen e shkarkohen në Portin e Vlorës. Megjithatë kontraktuesi për një periudhë 60 ditore ka lenë pa punë gjithë mjetet asfaltoshtruese në kantier në dispozicion kur të vendoste Bashkia Vlorë. Kjo shkaktoi një humbje të konsiderueshme për Kontraktuesin por që ishim të detyruar të prisnim Urdhrin e Titullarit të Bashkisë Vlorë për ndryshim projekti, ose kjo rrugë të zbritej nga kontrata pasi kishin përfunduar rrugët e tjera. Në këto kushte duke qenë punë publike në interes të Bashkisë Vlorë e cila administron qytetin, mbikëqyrësi i punimeve nuk mund të propozonte penalitete, kur do të ishte e kundërta që duhet ti përgjigjeshim detyrimeve ndaj Kontraktorit për vonesat në lënien pa punë të makinerive të asfaltobetonit të cilat kanë kosto orare tepër të lartë. Pas zgjidhjes nga Bashkia Vlorë, u dha Urdhër që shtresat e asfaltobetonit nga 4 cm në projekt të zbatohen 8 cm sipas projektit të rishikuar të AK.*

***Përgjigja:***

*Për sa i përket pretendimit tuaj se vonesa në përfundimin në afat të punimeve ka ardhur prej ndryshimeve në projekt dhe në preventiv, ky argument jo vetëm që nuk shoqërohet me dokumentacionin përkatës por njëkohësisht bie ndesh me njoftimin e bërë nga ana Juaj si mbikëqyrës i punimeve sipas aktit me nr. 8971 prot., datë 29.09.2017 (prot. i Bashkisë Vlorë). Sipas këtij citohet se: " ... Mbikëqyrësi i punimeve "R.....N – 95", pasi kontrolloi punimet, njofton përfundimin e tyre me datën 29.09.2017. Sa më sipër kërkojmë nga Autoriteti Kontraktor, Investitori Bashkia Vlorë të kryhen procedurat e kolaudimit për hartimin e Procesverbalit të Kolaudimit dhe certifikatës së Përkohshme së marrjes në dorëzim të punimeve...". Pra, referuar kësaj shkrese argumentet tuaja të sjella me observacion bien në kundërshtim me sa u citua më sipër pasi në këtë shkresë jo vetëm që konfirmohet përfundimi i punimeve me datë 29.09.2017 por edhe se objekti është gati për kolaudim. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë e si të tilla nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.*

*Grupi i auditimit merr në konsideratë observacionet lidhur me rakordimin e volumeve në situacionin përfundimtar duke zbritur diferencën prej 475,390 lekë nga dëmi ekonomik në ngarkim të firmës sipërmarrëse por duke lënë përgjegjësinë e likuidimit për punime të pakryera në fakt në momentin e likuidimit.*

**7.Objekti *"Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë"*, Vlorë.**

*Kontratat*

Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE *"L.....N"* me përfaqësues ligjor G.M. dhe nr. licence për zbatim punimesh NZ..... datë 16.06.2014. Kontrata është kryer në bazë të aktit me nr. 837 prot., datë 06.08.2014 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ish – Komuna Qendër e përfaqësuar nga ish Titullari F. B OE me vlerë të kontratës 11,396,185 lekë me TVSH e cila nuk përcakton afat zbatimi kontrate.

Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit është bërë nga N. M. me të cilën nuk disponohet kontratë përkatëse për këtë shërbim.

*Zbatimi i punimeve*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se një pjesë e akteve janë të pa firmosura nga përfaqësues te ish – Komunës. Gjithashtu, në dosjen teknike të paraqitur nuk rezulton te ketë akt kolaudimi dhe akt marrje në dorëzim të punimeve të përfunduara.

Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara e të likuiduara si dhe atyre të kryera në fakt rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në

përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuara nga Autoriteti Kontraktor me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 881,745 lekë pa TVSH.

Tabela nr. 17

| Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Vol. | Vlera |
| **IV. PUNIME GËRMIMI E MBUSHJEJE** | | | | | | | |
| Gërmim dheu makineri seksion i lire | $m^3$ | 123 | 1200 | 1200 | 1,026 | 174 | 21,402 |
| Gërmim dheu kanal | $m^3$ | 460 | 140.8 | 140.8 | 112 | 28.8 | 13,248 |
| Mbushje me çakëll pas mureve | $m^3$ | 505 | 509.6 | 509.6 | 478.8 | 30.8 | 15,554 |
| **V. PUNIME KONSTRUKSIONI** | | | | | | | |
| Betonim muri b/a vertikal t=40 cm M-250 | $m^3$ | 12,600 | 112 | 112 | 102.4 | 9.6 | 120,960 |
| F.V hekur betoni periodik | ton | 117,010 | 13.02 | 13.02 | 12.8 | 0.22 | 25,742 |
| **VI. PUNIME SHTRESASH** | | | | | | | |
| Shtresë çaklli e ruluar t=40 cm | $m^3$ | 535 | 134.5 | 134.5 | 105.7 | 28.8 | 15,408 |
| **VII. PUNIME THEMELE TË THELLA** | | | | | | | |
| F.V hekuri për pilota me makineri | ton | 117,010 | 15.07 | 15.07 | 14.2 | 0.87 | 101,799 |
| | | | | | | **Total** | **314,113** |

-Gërmim dheu makineri seksion i lire

Situacioni përfundimtar pasqyron në total volumin prej 1200 $m^3$ gërmim dheu në seksion të lirë. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, referuar detajeve të librezës së masave rezulton se janë pasqyruar me gabime përllogaritjet e volumeve pasi sipërfaqja e seksionit tërthor të gërmimit është 12.8 $m^2$/ml *{(2.18+5.15) x 3.5/2}*. Për një gjatësi prej 80 ml rezulton volumi i gërmuar prej 1,026 $m^3$. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 174 $m^3$ gërmim dheu.

-Gërmim dheu kanal

Situacioni përfundimtar pasqyron në total volumin prej 140.8 $m^3$ gërmim materiali për kanal duke iu referuar gërmimit për themelin e murit. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, referuar materialit fotografik të ndodhur në dosjen teknike rezulton se gërmimet për themelin e murit janë bërë me një gjerësi jo më shumë se 3.5 ml. Për një gjatësi prej 80 ml rezulton volumi i gërmuar prej 112 $m^3$. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 28.8 $m^3$ gërmim dheu.

-Mbushje me çakëll pas mureve

Situacioni përfundimtar pasqyron në total volumin prej 509.6 $m^3$ mbushje me çakëll pas mureve. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, referuar detajeve të librezës së masave rezulton se janë pasqyruar me gabime përllogaritjet e volumeve pasi sipërfaqja e seksionit tërthor të gërmimit është 5.985 $m^2$/ml *{(1.78+1.64) x 3.5/2}*. Për një gjatësi prej 80 ml rezulton volumi i gërmuar prej 478.8 $m^3$. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 30.8 $m^3$ mbushje me çakëll pas mureve.

-Betonim muri b/a vertikal t=40 cm M-250

Situacioni përfundimtar pasqyron në total volumin prej 112 $m^3$ beton për mure. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, referuar materialit fotografik të ndodhur në dosjen teknike (beton – format e përdorura për muret) rezulton se lartësia e murit është bërë në një lartësi jo më shumë se 3.2 ml. Për një gjatësi prej 80 ml rezulton volumi i gërmuar prej 102.4 $m^3$. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 9.6 $m^3$ beton për muret.

-F.V hekur betoni periodik

Situacioni përfundimtar pasqyron në total volumin prej 13.08 ton hekur betoni. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, konstatohet se projekti i zbatimit nuk ka pësuar ndryshime të miratuara për këtë diferencë nga 12.8 ton në 13.02 ton e aq më tepë kur nuk ka ndryshuar as sasia e betonit të përdorur (112m$^3$). Në kushte të tilla, kur nuk ka patur ndryshime të miratuara nga projektuesi apo ndryshim në volume të betonit, rezulton se volumi i punës së realizuar me këtë zë është 12.8 ton. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 0.22 ton hekur.

-Shtresë çaklli e ruluar t=40 cm

Situacioni përfundimtar pasqyron në total volumin prej 134.5 m$^3$ shtresë me çakëll duke iu referuar mbushjes me çakëll në pjesën nën themelin e murit. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, referuar materialit fotografik të ndodhur në dosjen teknike rezulton se gërmimet për themelin e murit janë bërë me një gjerësi jo më shumë se 3.5 ml. Për një gjatësi prej 80 ml rezulton volumi i mbushur me çakëll prej 105.7 m$^3$. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 28.8 m$^3$ mbushje me çakëll.

-F.V hekur për pilota me makineri

Situacioni përfundimtar pasqyron në total volumin prej 15.07 ton hekur betoni. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtin volum pune. Në fakt, konstatohet se projekti i zbatimit nuk ka pësuar ndryshime të miratuara për këtë diferencë nga 15.07 ton në 14.2 ton sa parashikon projekti i zbatimit, aq më tepë kur nuk ka ndryshuar as sasia e betonit të përdorur (110 m$^3$). Në kushte të tilla, kur nuk ka patur ndryshime të miratuara nga projektuesi apo ndryshim në volume të betonit, rezulton se volumi i punës së realizuar me këtë zë është 14.2 ton. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 0.87 ton hekur.

Konstatohet se në situacionin përfundimtar i janë likuiduar sipërmarrësit të punimeve përveç zërave të punimeve të ndërtimit edhe zërat si më poshtë:

Tabela nr. 18

| Nr. | Emërtimi | Vlera pa TVSH |
|---|---|---|
| 1 | Vlera e projektit | 318,247 |
| 2 | Mbikëqyrje e kolaudim punimesh | 249,385 |
| | **SHUMA** | **567,632** |

Në fakt, projekti i zbatimit është hartuar nga *"M.....N"* me ing. A. G, mbikëqyrja e punimeve është kryer nga N. M. kurse për kolaudimin nuk disponohet asnjë dokument. Përfshirja në situacionin e firmës sipërmarrëse i vlerës së projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar, sipas të cilit formati i miratuar i preventivit dhe situacionit është si më poshtë:

Tabela nr. 19 **Situacioni**

| Nr. | Nr. analize | Emërtimi i punimeve | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlefta |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| **Shuma** | | | | | | |

| | |
|---|---|
| **TVSH** | |
| **Shuma** | |
| **Pajisje** | |
| **Shuama** | |

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën 881,745 lekë pa TVSH sipërmarrësit të punimeve si rrjedhojë e punimeve të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
-Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve *N. M.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.

-Nga ana e mbikëqyrëses së punimeve *N. M.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 dhe pika 4, paragrafi i katërt germa l dhe udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pikat 8.1 dhe 8.3.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me këtë objekt nga subjekti janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 3048/1, datë 20.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/12, datë 23.04.2018),nga mbikëqyrësja N. M. dhe F. SH. përfaqësues ligjor i firmës sipërmarrëse.*
***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri gërmim dheu makineri seksion i lirë*
*Nga matjet faktike të bëra në terren rezulton se sipërfaqja e seksionit tërthor të gërmuar është 15 m2/ml dhe kjo është e paraqitur grafikisht dhe në detajin bashkëlidhur librezës së masave. llogaritjet analitike të paraqitura në librezën e masave janë në përputhje me detajin e prerjes tërthore.*
***Përgjigja:***
*Pretendimet tuaja lidhur me diferencat në volume për këtë zë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi sipërfaqja e seksionit tërthor sipas detajeve të librezës së masave është 12.8 $m^2$/ml {(2.18+5.15) x 3.5/2}. Pra lartësia është 3.5 ml dhe jo 4.1 sa ju pretendoni. Kjo konfirmohet edhe në skicën e sjellë në observacion. Observacioni nuk merret në konsideratë.*
***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri Gërmim dheu kanal*
*Referuar matjeve të bëra në terren, të cilat janë paraqitur dhe detajin bashkëlidhur librezës së masave përmasat e seksionit tërthor të gërmimit janë (4.4 ml x 0.4 ml)*
***Përgjigja:***
*Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi materiali fotografik konfirmon me saktësi atë çka përshkruhet në aktkonstatim lidhur me këtë zë. Observacioni nuk merret në konsideratë.*
***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri Mbushje me çakëll pas mureve*
*Sipërfaqja e seksionit tërthor është 6.37 m2/ml. Sipërfaqja e seksionit tërthor {(1.78+1.71) x 3.5/2} + {(1.64+1.71) x 0.6/2} - (1.2 x 0.5).Në detajin e paraqitur mungojnë disa nga përmasat e nevojshme për llogaritjen e sipërfaqes.*
***Përgjigja:***

*Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton sa përshkruhet në aktin e konstatimit dhe observacioni nuk sjell fakte shtesë. Observacioni nuk merret në konsideratë.*

***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri Betonim muri b/a vertikal t=40 cm M-250*
*Zëri F.V hekur betoni periodik*

*Referuar matjeve të bëra në terren, të cilat janë paraqitur dhe detajin bashkëlidhur librezës së masave përmasat e seksionit tërthor të gërmimit janë (4.4 ml x 0.4 ml). Nuk mund ti referohemi materialit fotografik pasi nuk mund të merret informacioni i kërkuar, për të llogaritur volume të sakta për këtë zë punimesh.*

***Përgjigja:*** *Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi materiali fotografik konfirmon me saktësi atë çka përshkruhet në aktkonstatim lidhur me këtë zë. Observacioni nuk merret në konsideratë.*

***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri Betonim muri b/a vertikal t=40 cm M-250*
*Zëri F.V hekur betoni periodik*
*Zëri Shtresë e ruluar çaklli t=40 cm*

*Referuar matjeve të bëra në terren, të cilat janë paraqitur dhe detajin bashkëlidhur librezës së masave përmasat e seksionit tërthor të gërmimit janë (4.4 ml x 0.4 ml). Nuk mund ti referohemi materialit fotografik pasi nuk mund të merret informacioni i kërkuar, për të llogaritur volume të sakta për këtë zë punimesh.*

***Përgjigja:*** *Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi materiali fotografik konfirmon me saktësi atë çka përshkruhet në aktkonstatim lidhur me këtë zë. Observacioni nuk merret në konsideratë.*

***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri F.V hekur për pilota me makineri*

*Në këtë rast është gabuar në sasinë e hekurit të parashikuar për tu përdorur në preventivin fitues, pasi volumi i hekurit i nevojshëm për të realizuar punimet e parashikuara në projektin e zbatimit është më i madh.*

***Përgjigja:*** *Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi observacioni nuk është shoqëruar me informacion të detajuar shpjegues lidhur me sasinë e hekurt si dhe me informacion shtesë nga ana e projektuesit. Ndryshimi i sasisë së hekurit pa ndryshuar sasinë e betoni dhe projektin është i paargumentuar. Observacioni nuk merret në konsideratë.*

***Pretendimi i subjektit:*** *Vlera e Projektit*
*Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve*

*Këto zëra janë parashikuar nga projektuesi dhe janë përfshirë në strukturën e preventivit për të cilin është bërë oferta dhe nëse është shkelje ligjore kjo nuk është përgjegjësi as e mbikëqyrësit dhe as e sipërmarrësit. Vlerat përkatëse për të dy zërat e mësipërm janë situacionuar në situacionin përfundimtar, i janë kaluar sipërmarrësit të punimeve dhe me to janë paguar firma projektuese dhe firma e mbikëqyrjes. Observacioni nuk merret në konsideratë.*

***Përgjigja:*** *Pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi observacioni nuk është shoqëruar me informacion të detajuar shpjegues lidhur me pagesat e kryera ndaj projektuesit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve..* ***Argumentet nuk merret në konsideratë***.

**8. Objekti *"Ndriçimi i rrugëve në qytetin e Vlorës",* Bashkia Vlorë.**
*Projekti*

Projekti për këtë investim është hartuar nga V. H me nr. licence EZ..... dhe parashikon zëra punimesh për punime ndriçimi në katër akse rrugore. Preventivi i hartuar nga ing. F. D parashikon një vlerë prej 30,001,107 lekë me TVSH, vlerë kjo e cila është përdorur për caktimin e fondit limit të procedurës së prokurimit.

*Kontratat*

Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE *"E.....L C.....M"* , me nr. licence për zbatim punimesh NZ. ..... datë 21.10.2016, me përfaqësues ligjor J. S. Punimet në objekt janë kryer sipas kontratës me nr. 4611 prot., datë 01.06.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE me vlerë të kontratës 29,939,381 lekë me TVSH, me afat zbatimi kontrate 30 ditë pune nga dita e lidhjes së kontratës dhe me afat garancie punimesh 1 vit nga data e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve. Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratës është 51,438 lekë pa TVSH ose 0.2 % më pak. Mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas Urdhrit me nr. 4611/1 prot., datë 01.06.2017 të Titullarit të AK me nr. 111 datë 01.06.2017, është caktuar *"D.....-E"* me B. D me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh ndërtimi MK..... datë 05.05.2016. Kolaudimi i punimeve të ndërtimit, sipas Urdhrit me nr. 11594 prot., datë 22.12.2017 të Titullarit të AK me nr. 241 datë 22.12.2017, është caktuar *"R.....N 95"* me R. N. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh ndërtimi MK..... datë 29.05.2017.

*Zbatimi i punimeve*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet në objekt kanë filluar me datë 01.06.2017 dhe kanë përfunduar me datë 22.12.2017. pas kolaudimit të punimeve me datë 27.12.2017 objekti është marrë përkohësisht në dorëzim me datë 27.12.2017.

Nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit lidhur me volumet e punës të situacionuara e të likuiduara si dhe atyre të kryera në fakt rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuara nga Autoriteti Kontraktor me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 374,580 lekë pa TVSH.

Tabela nr. 20

| Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Vol. | Vlera |
| **"RRUGA FEJZO GJOMEMA" "HEKTOR SHYTI"** | | | | | | | |
| F.V tub plastik i ngurtë d=250 mm për bazamentet e shtyllave | ml | 980 | 75 | 75 | 0 | 75 | 73,500 |
| **"RRUGA PELIVAN LESKAJ"** | | | | | | | |
| F.V tub plastik i ngurtë d=250 mm për bazamentet e shtyllave | ml | 980 | 82 | 82 | 0 | 82 | 80,360 |
| **"RRUGA KOSOVA"** | | | | | | | |
| F.V tub plastik i ngurtë d=250 mm për bazamentet e shtyllave | ml | 980 | 82 | 82 | 0 | 82 | 80,360 |
| **"RRUGA DEMOKRACIA"** | | | | | | | |
| F.V tub plastik i ngurtë d=250 mm për bazamentet e shtyllave | ml | 980 | 136 | 136 | 0 | 136 | 133,280 |
| | | | | | | **Total** | **374,580** |

Të argumentuara këto si më poshtë:

-F.V tub plastik i ngurtë d=250 mm për bazamentet e shtyllave

Situacioni përfundimtar pasqyron për të katër akset rrugore përkatësisht gjatësitë e tubave për bazamentet e shtyllave prej 75 ml rruga *"RRUGA FEJZO GJOMEMA" "HEKTOR SHYTI"*, 82 ml *"RRUGA PELIVAN LESKAJ"*, 82 ml *"RRUGA KOSOVA"* dhe 136 ml *"RRUGA DEMOKRACIA"*. Libreza e masave paraqet në mënyrë direkte të njëjtat volume pune. Në fakt, nga analiza e çmimit të

zërave për furnizimin dhe vendosjen e shtyllave rezulton se punimet e tubave plastik të ngurtë me d=250 mm për bazamentet e shtyllave janë parashikuar nën vet punimet për shtyllat. Rrjedhimisht, volumet e punës për tubat janë likuiduar një herë si të kryer si zë më vetë dhe një herë gjatë furnizimit dhe vendosjes së shtyllës, kur në fakt janë kryer vetëm një herë. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 375 ml plastik të ngurtë me d=250 mm.
Në mënyrë të përmbledhur, për këtë investim rezulton se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve në vlerën 374,580 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të pakryera në fakt, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
-Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve *B. D* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.

-Nga ana e kolaudatores së punimeve *R. N.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12 dhe udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3.

-Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, *B. D* si dhe nga ana e kolaudatores së punimeve, *R. N.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me këtë objekt nga subjekti janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 3048/1, datë 20.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/12, datë 23.04.2018),nga mbikëqyrësi B. D.*
***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri Furnizim vendosje tub plastik i ngurtë 250 mm për bazamentin e shtyllave*
*Konstatimi juaj në lidhje me situacionimin dy herë të zërit të punimeve 'Furnizim vendosje tub plastik i ngurtë 250 mm për bazamentin e shtyllave' ne rrugën Fejzo Gjomema, Hektor Shyti, Pelivan Leskaj dhe Kosova nuk qëndron pasi nuk bazohet në preventivin e projektit të zbatimit/ofertën e paraqitur në tender dhe kontratën e punimeve. Konstraktuesi "E.....L" nuk e ka situacionuar dy herë zërin e punimeve 'Furnizim dhe vendosje tub plastik i ngurtë d=250 mm për bazamentin e shtyllave' pasi ky zë i punimeve nuk është i përfshirë nën zërin 'F.V Shtyllë cilindrike H=8 ml, me dy nivele D1 89 dhe D2 125, e zinkuar dhe e lyer me bojë elektrostatike në temperaturë 200', gjë që është një lapsus i projektuesit dhe preventivuesit me veçimin e tij. "E.....L" ka paraqitur këtë zë më vete në ofertë, kontaktim dhe zbatim. Ndarja nga projektuesi në preventiv të punimeve nuk çon automatikisht në dublim të tij në situacionim, për arsye se ky zë nuk është përfshirë në çmimin e zërit 'F.V vendosje tub plastik i ngurtë d=250 mm për bazamentin e shtyllave'*
***Përgjigja:*** *Pretendimet tuaja lidhur me zërin 'Furnizim dhe vendosje tub plastik i ngurtë d=250 mm për bazamentin e shtyllave' nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se punimet e tubit plastik janë parashikuar në realizimin e zërit 'F.V Shtyllë cilindrike H=8 ml, me dy nivele D1 89 dhe D2 125, e zinkuar dhe e lyer me bojë elektrostatike në temperaturë 200' dhe situacionimi i tubave plastik si zë më vetë bën që të kemi një zë pune të*

*situacionuar dy herë por të kryer në fakt një herë. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë e si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.*
***Grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë argumentet pas rivendosjes së shtyllave të konstatuara në mungesë gjatë inspektimet në objekt të punimeve të përfunduara***.

**9. Objekti *"Rikonstruksion Godina e Kopshtit nr. 7",* Bashkia Vlorë.**

*Kontratat*

Në përfundim të procedurës së prokurimit është shpallur fitues OE *"A.....I"* , me nr. licence për zbatim punimesh NZ. 1916/28 datë 07.06.2017, me përfaqësues ligjor A.....I. Punimet në objekt janë kryer sipas kontratës me nr. 6174 prot., datë 12.07.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE me vlerë të kontratës 8,852,113 lekë me TVSH, me afat zbatimi kontrate 3 muaj dhe me afat garancie punimesh 1 vit nga data e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve. Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit është bërë nga *"P....C.....N"* me V. G. me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh ndërtimi MK..... datë 13.06.2016 me të cilin është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi sipas aktit me nr. 6176 prot., datë 14.07.2017 me vlerë të kontratës 25,200 lekë me TVSH. Kolaudimi i punimeve të ndërtimit është bërë nga *"N.....O"* me E. N me të cilin është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi sipas aktit me nr. 10651 prot., datë 17.11.2017 me vlerë të kontratës 21,600 lekë me TVSH. Sipas aktit me nr. 6528/2 prot., datë 31.07.2017 është lidhur kontrata shtesë për vlerën 1,767,917 lekë me TVSH me afat 15 ditë nga dita e lidhjes së kontratës.

*Zbatimi i punimeve*

Nga i volumeve të punës të situacionuara e të likuiduara si dhe atyre të kryera në fakt rezultuan diferenca në volume me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën 8,771 lekë pa TVSH.

Tabela nr. 21 Kontrata Bazë

| Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Vol. | Vlera |
| **PUNIME PËR SISTEMIMIN E JASHTËM** | | | | | | | |
| Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km | $m^3$ | 220 | 39.87 | 39.87 | 0 | 39.87 | 8,771 |
| | | | | | | **Total** | 8,771 |

Të argumentuara këto si më poshtë:

-Transport mbetje ndërtimi dheu me auto deri në 6 km

-Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km

Situacioni përfundimtar pasqyron në total volumet prej 63.98 $m^3$ transport deri në 6.0 km dhe 39.87 $m^3$ transport deri në 5 .0 km, material ky i rezultuar nga prishjet. Libreza e masave paraqet në mënyrë analitike të njëjtat volume. Në fakt, referuar numrit të analizës për të gjitha materialet që kanë dalë nga punimet e prishjeve rezulton se transporti i tyre është përfshirë në vetë zërat e punimeve të prishjes. Konkretisht, në zërat me nr. analize 2.426/4 dhe 2.426/3, sipas manualit të VKM nr. 629 datë 15.07.2015 *"Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre"* rezulton se këta zëra punimesh kanë të përfshirë edhe transportin e materialit të prishur. Për rrjedhojë, i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve volumet prej 25.63 $m^3$ transport deri në 6.0 km dhe 39.87 $m^3$ transport deri në 5.0 km.

Në mënyrë të përmbledhur, për këtë investim rezulton se i janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve në vlerën 8,771 lekë pa TVSH si rrjedhojë e punimeve të pakryera në fakt, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
-Nga ana e mbikëqyrëses të punimeve *V. G.* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.

-Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6176 prot., datë 14.07.2017.
Nga ana e kolaudatorit të punimeve *E. N* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12 dhe udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3.

-Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 10651 prot., datë 17.11.2017.
Nga ana e mbikëqyrëses së punimeve, *V. G.* si dhe nga ana e kolaudatorit të punimeve, *E. N* nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr.1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 .

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me këtë objekt nga subjekti janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 3048/1, datë 20.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/12, datë 23.04.2018),nga mbikëqyrësja V. G. përfaqësuese ligjore e subjektit "P....C.....N" .*
***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri me nr. Analize 2.308/a Suvatim me grafjato h>4 m;*
*Pas prishjes se suvatimit të fasadës (parashikuar në preventiv) është ribërë suvatimi i fasadës si kusht teknik zbatimi i domosdoshëm para veshjes termike. Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm+rrjetë+suva. Për të mos ndryshuar zërin e punimeve nga suvatim me grafjato në suva e zakonshme fasade mur tulle që në manual janë në çmimin e njëjtë për njësi mbajtëm emërtimin e preventivit të ofertuar (bashkëngjitur analiza).*
*Përgjigja: Observacioni merret në konsideratë*
***Pretendimi i subjektit:*** *Zëri me nr. Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km*
*Çmimi për transportin përfshirë në analizat e çmimeve të punimeve të prishjes sipas numrit të analizave të mëposhtme 2.426/4, 2,426/3, 2.426, An – 4 dhe 2.426/2 është përllogaritur për transport të këtyre mbetjeve (nga katet e ku janë gjeneruar këto mbetje) në një pikë grumbullimi në sheshin e ndërtimit.*
***Përgjigje:*** *Pretendimi juaj mbi situacionimin e transportit të materialeve brenda kantierit nuk merret në konsideratë pasi referuar Udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", Kreu II, paragrafi, germa B, pika 7 përcaktohet se: Shpenzimet e paparashikuara në zërat e punës dhe në shpenzimet e drejtpërdrejta: zgjedhja e kampioneve, të rifiniturave, lagia, mirëmbajtja dhe mbrojtja e punimeve nga shiu e ngricat pas kohës normale të punës, pastrimi dhe sistemimi i objektit e sheshit të ndërtimit, para dhe gjatë marrjes në dorëzim etj.* ***Nga sa më sipër si dhe referuar specifikimeve teknike të zërave të prishjeve pretendimet nuk qëndrojnë e si të tilla nuk merren ne konsideratë***

**10. Për rregullshmërinë në zbatimin e punimeve me objekt** "Rikualifikimi i bllokut të banimit të kufizuar nga rrugët "Tasim Jonuzi", "Demokracia", "Janaq Kilica", "Rruga e Paqes".

Dosja e zbatimit të punimeve "Rikualifikimi i bllokut të banimit të kufizuar nga rrugët "Tasim Jonuzi", "Demokracia", "Janaq Kilica", "Rruga e Paqes". Operatori Ekonomik fitues "C....O" me nr. Licence NZ .....

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| a.Zbatimi i Kontratës Punimeve *"Rikualifikimi i bllokut të banimit të kufizuar nga rrugët "Tasim Jonuzi", "Demokracia", "Janaq Kilica", "Rruga e Paqes"* | | | | |
| 14.Lidhja e kontratës<br>Nr. 749, Datë 30.01.2017 | 15.Vlera e kontratës (me TVSH) 21,114,991 lekë | | 16.Likuiduar dt 25.07.2017 Lekë 21,114,991 | |
| 17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt.....<br>-Vlera me TVSH 21,114,991 lekë<br>-Vlera pa TVSH 17,595,826 lekë | 18.Afati i kontratës në dite<br>Parashikuar 3 muaj Zbatuar 180 ditë | | 19.Zgjatja e kontratës me 90 ditë Shkresa (Amendamenti) nr. 3430/1, datë 27.04.2017. | |
| 20. Mbikëqyrësi i punimeve<br>H.....K | Licenca Nr..... | Kontrata Nr 1175Prot datë 13.02.2017, 42,000 lekë me TVSH | Likuiduar .....lekë) | Pa likuiduar .....lekë) |
| 21. Kolaudatori i punimeve<br>Emri Mbiemri<br>R.....A | Licenca Nr ..... | Nr 6890 Prot, datë 04.08.2017 | Likuiduar (lekë) | Pa likuiduar ( lekë) |
| 22.Akt Kolaudimi datë 10.08.2017 | 23.Akt i marrjes në dorëzim dt. 10.08.2017 | | 24. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë<br>(për mallrat) | |

I. - Nga auditimi i dosjes së zbatimit u konstatua si më poshtë:
- Nuk administrohet leja e ndërtimit të objektit.
-Fillimi i punimeve është njoftuar me shkresën nr. 1175/1, datë 13.02.2017 të kontraktorit drejtuar Autoritetit Kontraktor.
- Me shkresën datë 13.02.2017, është bërë dorëzimi i plotë i sheshit të ndërtimit me aktin e nënshkruar nga sipërmarrësi i punimeve dhe mbikëqyrësi i punimeve.
- Me shkresën nr. 3430, datë 26.04.2017, sipërmarrësi i punimeve i ka kërkuar AK shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve më Pretendimin se nuk është liruar plotësisht sheshi i ndërtimit.
- Me shkresën nr. 3430/1, datë 27.04.2017, është bërë amendimin i kontratës për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve, duke shtyrë këtë afat për një periudhë 90 ditore, deri në datën 30.07.2017.
Me procesverbalin e datës 03.05.2017, janë miratuar nga titullari i AK ndryshimet në preventivin e objektit me tabelën e punimeve që shtohen dhe punimeve që hiqen, brenda vlerës së preventivit.
- Libri i masave nuk është plotësuar në zbatim të Udhëzimit të nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pasi në dimensionet e zërave metrike, janë të paplotësuar.

Nga auditimi në terren dhe krahasimit të librit të masave me situacionin përfundimtar, u konstatuan diferenca në volume pune, të cilat janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

| Nr | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi | Sasia Situacion | Sasia Fakt | Diferenca Sasi | Diferenca Lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I | Punime prishje | | | | | | |
| 2 | Transport mbeturinash nga prishjet | m3 | 500 | 150 | 0 | 500 | 75,000 |
| II | Punime gërmimi, zbankimi dhe ndërtim shtresash rrugore auto | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | FV bordura parafabrikat 20x35 cm | ml | 1250 | 2274 | 1890 | 384 | 480,000 |
| 6 | Beton bazament kunete C7/10 t=10 cm me pjerrësi | m3 | 6667 | 93.36 | 75.6 | 17.76 | 118,406 |
| III | Punime gërmimi, zbankimi dhe ndërtim vend parkimesh me pllaka bari | | | | | | |
| 1 | Gërmim dheu ne ekskavator zingjir 1m3, ne kanale me gjeresi më të madhe se 2m | m3 | 833 | 525,5 | 315,3 | 210,2 | 175,097 |
| IV | Punime gërmimi, zbankimi dhe ndërtim trotuar këmbësorësh me kufizime nga gjelbërimi | | | | | | |
| 1 | Gërmim dheu ne ekskavator zinxhir 1m3, ne kanale me gjeresi më të madhe se 2m | m3 | 833 | 2140,5 | 1210,2 | 930,3 | 774,940 |
| II | Punime gërmimi, zbankimi dhe ndërtim shtresash rrugore auto | Njësia | Çmimi i ofertës | Sasia | Çmimi i manual | Diferenca e cmimit | Diferenca lekë |
| 3 | FV bordura parafabrikat 20x35 cm | ml | 1250 | 1890 | 959 | 291 | 549,990 |
| | DIFERENCA | | | | | | 2,173,433 |
| | T.V.SH | | | | | | 434,686 |
| | SHUMA TOTALE | | | | | | 2,608,120 |

Këto diferenca në volume, janë të argumentuara si më poshtë:

**I/2. Transport mbeturinash nga prishjet**. Në librin e masave paraqiten 182.25 m, si shumë të tre prodhimeve aritmetike (700x600x300 + 300x250x150 + 500x300x300), të cilat janë abstrakte dhe të paargumentuara. Për pasojë ky volum pune është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e ardhur nga mbikëqyrësi i punimeve F. B dhe kolaudatorja e punimeve R. M, me nr. ....., datë 21.03.2018 citohet:*
***Sqarojmë****: Ne lidhje me Pretendimin tuaj se, janë abstrakte dimesionet e vendosura ne librezën e masave ,ju bëjmë me dije se dimensionet ne librezën e masave per këtë proces pune, janë te shprehura ne cm ( ne mënyrë te qarte e dukshme se kemi te bëjmë me një gabim/lapsus njerëzor) por totali i volumit është i shprehur ne m3.Perkatesishte ne librezën e masave dimensionet janë; 700*600*300 =126 m3 ; 300*250*150=11.25 m3 ; 500*300*300 = 45m3,pra ne total janë realizuar 182.25 m2 transport mbeturinash. Nga ana e sipërmarrësit janë raportuar 150 m3 transport mbeturinash ,pra nuk ka asnjë m3 përfitim me tepër. Nuk kemi te bëjmë me dem ekonomik dhe si rrjedhim argument juaj është i papranueshëm nga ana jone.*
*Përgjigje: Në observacion është shpjeguar vetëm pjesa "abstrakte" dhe jo pjesa "e paargumentuar "e cituar në projekt raportin tonë. Përmasat e vendosura në librin e masave nuk argumentohen, pasi tregojnë që janë masive dheu, e cila nuk është e mundur.* ***Argumentet e sjella nuk merren në konsideratë****.*

**II/3. FV bordura parafabrikat 20x35 cm.** Në librin e masave është vendosur sasia e bordurave prej 1890 ml, ndërkohë që është situacionuar sasia prej 2274 ml. Diferenca prej 384 ml është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e ardhur nga mbikëqyrësi i punimeve F. B dhe kolaudatorja e punimeve R. M, me nr. 2126/1, datë 21.03.2018 citohet:*

*Sqarojmë: Nga rimatjet faktike te kryera ne objekt rezultojnë se janë 2274 ml F.V bordure 20*35 dhe jo sa është vendosur ne librezën e masave. Shifet qarte se gjate hartimit te librezës se masave janë bere lapsuse njerëzore ,gjë qe shpesh ndodhe dhe nga ana e audituesve te KLSH-se, te cilat nuk janë vene re as nga supervizori dhe kolaudatori i objektit pasi nga matjet faktike kane rezultuar sipas situacionit përfundimtar, shoqëria sipërmarrëse nuk ka përfituar asnjë ML me tepër , nuk ka dem ekonomik dhe nuk mund te pranohet nga ana jone.*
*Përgjigje:*
*Edhe pse është bërë kundërshtimi i librit të masave të sjella nga sipërmarrësi dhe të konfirmuara nga vet mbikëqyrësi, duke i quajtur gabime njerëzore, në observacion nuk është sjellë asnjë dokument shtesë (librezë masash) ku të vërtetohet vendosja e volumit të situacionuar të bordurave.*
***Argumentet e sjella nuk merren në konsideratë**.*

**II.6. Beton bazament kunetë C7/10 t=10 cm me pjerrësi**. Në librin e masave paraqiten 93.36 m3, si shumë e betonit për kunetë 75.6 m3 dhe beton për lulishte 17.16 m3 (74 ml x 0.2 m x 1,2 m). Nga verifikimi në vend nuk rezulton të jetë bërë betonim me këto përmasa. Për pasojë volumi prej 17.76 m3 është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:** Në kundërshtitë e ardhur nga mbikëqyrësi i punimeve F. B dhe kolaudatorja e punimeve R. M, me nr. 2126/1, datë 21.03.2018 citohet:*
*Sqarojmë: Betonim kunete është quajtur dhe betonim per muret e betonit per te krijuar lulishten e cila ka dimensionet (7.4 *0.20*1.2) m x 2 cope =17.76 m3 betoni, pra ne total sasia e realizuar nga sipërmarrësi është 93.36 m2 betonim. Vihet re qarte dhe ne fotot e zbatimit te punimeve per vendet ku janë kryer këto betonime. Pra nuk kemi asnjë m3 përfitim me tepër nga ana e shoqërisë sipërmarrëse nuk kemi te bëjmë me asnjë dem ekonomik e per pasoje nuk mund te pranojmë Pretendimimin tuaj.*
***Përgjigje**: Nga argumentet e sjella në observacion, nuk është sqaruar dimensioni (lartësia) 1.2 m, i cili është i pamundur të ekzistojë në fakt në lulishten e paraqitur në librin e masave dhe observacion.*
***Argumentet e sjella nuk merren në konsideratë**.*

**III/1. Gërmim dheu ne ekskavator zinxhir 1m3, ne kanale me gjeresi më të madhe se 2m**. Në librin e masave është llogaritur 1051 m2 sipërfaqe (e padetajuar) me trashësi 0.5 m. Në preventivin e punimeve, nënshtresat janë me trashësi 30 cm dhe gërmimi duhej llogaritur për këtë trashësi, pasi nga verifikimi në terren nuk ka ndryshim të kuotës së projektit nga kuota ekzistuese. Nga rillogaritja, gërmimi duhet të ishte në sasinë 1051m2 x 0.3 m = 315.3 m3, ose 210 m3 më pak se situacioni, vlera e të e cilës është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:** Në kundërshtitë e ardhur nga mbikëqyrësi i punimeve F. B dhe kolaudatorja e punimeve R. M, me nr. 2126/1, datë 21.03.2018 citohet:*
*Sqarojmë: Sipërfaqja e gërmimit është sipërfaqja e vendparkimit te makinave jashtë trupit te rrugës, e cila është 1051 m2 dhe thellësia e gërmimit është 50 cm, ne totale është realizuar 525.5 m3 gërmim, duhet te sqarojmë se vendet e parkimit te makinave janë ne pozicionet jashtë trupit te rrugës te cilat kane qene te zëna nga ndërtimet pa leje te qytetareve ku kuota ± 0.00 e objekteve është shume here me e larte se gërmimi, i se cilave është kryer pas punimeve te prishjes se këtyre objekteve dhe është realizuar ne thellësinë 50 cm, qe duket qarte ne fotot e objektit, pjesë e dokumentacionit te dosjes.*

*Shoqëria sipërmarrëse nuk ka përfituar asnjë m3 me tepër, nuk jemi dakort me Pretendimin tuaj, nuk ka dem ekonomik.*
*Përgjigje: Nga argumentet e sjella në observacion dhe dokumentet shtesë (fotot), nuk vërtetohet thellësia e gërmimit e paraqitur në librin e masave, si dhe nuk është detajuar sipërfaqja e gërmuar (1051 m2).* ***Argumentet e sjella nuk merren në konsideratë****.*

**IV.l Gërmim dheu ne ekskavator zinxhir 1m3, ne kanale me gjeresi më të madhe se 2m**. Në librin e masave është llogaritur volume prej 2150 m3 (i padetajuar) dhe sipërfaqe shtresë zhavorri 4034 m3. Në preventivin e punimeve, nënshtresat janë me trashësi 30 cm dhe gërmimi duhej llogaritur për këtë trashësi, pasi nga verifikimi në terren nuk ka ndryshim të kuotës së projektit nga kuota ekzistuese. Nga rillogaritja, gërmimi duhet të ishte në sasinë 4034 m2 x 0.3 m = 1210.2 m3, ose 930.3m3 më pak se situacioni, vlera e të e cilës është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e ardhur nga mbikëqyrësi i punimeve F. B dhe kolaudatorja e punimeve R. M, me nr. 2126/1, datë 21.03.2018 citohet:*
*Sqarojmë: Volumi i gërmimit faktik është sipas profileve tërthor te realizuar mbas gërmimit, profile te cilat janë bashkëngjitur librezës se masave, ku tregohen pozicionet ne te cilat është realizuar ky zë pune dhe te shënuar qarte dhe ne planimetrin e objektit me sasinë e gërmimit ne m3 per çdo pozicion, ku vende thellësia e gërmimit shkon nga 50-120 cm. Kjo ka ndodhur per arsye te prishjes se objekteve te qytetareve te cilat duken qarte dhe ne foto, por e tregon gjendjen ekzistuese dhe mbas kryerjes se këtij procesi pune. Pretendimi juaj se kemi sipërfaqe me shtrese zhavorri 4034 m2 nuk mund te sjell rezultatin e nxjerr nga ana juaj per thellësinë 30 cm. Nga ana e sipërmarrësit nuk ka asnjë m3 te përfituar me tepër dhe nuk ka asnjë dem ekonomik, argument juaj nuk mund te pranohet nga ana jone.*
*Përgjigje: Nga argumentet e sjella në observacion dhe dokumentet shtesë (fotot), nuk vërtetohet thellësia e gërmimit e paraqitur në librin e masave, si dhe nuk është detajuar sipërfaqja e gërmuar (2150 m2). Nga ana jonë është cituar sipërfaqja e zhavorrit, pasi gërmimi është bërë për hedhjen e shtresave të bazës dhe sipërfaqja e kësaj shtrese është edhe sipërfaqja e gërmuar.* ***Argumentet e sjella nuk merren në konsideratë.***

**II/3. FV bordura parafabrikat 20x35 cm**. Në preventiv është planifikuar bordura 20x35 cm, ndërsa nga verifikimi në terren rezulton se janë vendosur bordura 15x25 cm, të cilat në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit (nr.anal.3. 617) rezulton me çmimin 959 lekë/ml. Diferenca e çmimit prej 291 lekë/ml është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e ardhur nga mbikëqyrësi i punimeve F. B dhe kolaudatorja e punimeve R. M, me nr. 2126/1, datë 21.03.2018 citohet:*
*Sqarojmë: Objekti është brenda bllokut te banimit, nga ana e sipërmarrësit objekti filloi dhe rreth 800 ml bordure u vendosen ne dimensione 25*35 ,dhe pikërisht ne rrugën Tasim Jonuzi. Te ndodhur para presionit te qytetareve ku lartësitë e bordurave ishin te mëdha çka sillte problem per qarkullimin e mjeteve te qytetareve ,ku qarkullohet me mjete autovetura u ra dakort me investitorin te zëvendësoheshin me bordure 12*25 ,me te njëjtin çmim te ofertuar nga subjekti. Volumi i bordurave është sipas situacionit përfundimtar ,nuk ka asnjë ml te përfituar nga ana e sipërmarrësit ,nuk përben dem ekonomik dhe nuk mund te pranohet nga ana jone.*

*Përgjigje: Në aktkonstatim nuk kemi cituar përfitim në volum nga ana e sipërmarrësit, por kemi cituar që janë vendosur bordura që nuk përkojnë me ato të kërkuara në preventiv dhe të ofertuara nga sipërmarrësi. Për pasojë, çmimi i tyre duhej negociuar, duke marrë në konsideratë atë të manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit.* ***Argumentet e sjella nuk merren në konsideratë.***

Pas kërkesës së sipërmarrësit të punimeve me nr. 33 prot., datë 26.04.2017 për shtesë kontrate, me shkresën nr. 9474, datë 13.10.2017 të AK, është bërë kontratë punimesh (shtesë) "Rikualifikimi i bllokut të banimit të kufizuar nga rrugët "Tasim Jonuzi", "Demokracia", "Janaq Kilica", "Rruga e Paqes", me vlerë kontrate 4,222,995 lekë (përpikmërisht 20% e vlerës së kontratës bazë) dhe me afat të përfundimit të punimeve 15 ditë nga lidhja e kontratës. Sipas relacionit, kjo shtesë është bërë për shkak të punimeve që janë shtuar nga prishja e ndërtimeve pa leje (3 ndërtime, me sipërfaqe 65 m2) dhe sistemimi i sipërfaqeve që dalin të lira nga këto prishje. Preventivi i kontratës shtesë ka dy zëra pune, të papërfunduara me kontratën bazë dhe konkretisht "Pllaka betoni me hapësira për bar" 800 m2 dhe "Trotuar me 6 cm beton me pllaka" 2015.33 m2. Kjo shtesë kontrate është e paargumentuar dhe në kundërshtim me nenin 36 germa 2/dh e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në kundërshtitë e ardhur nga mbikëqyrësi i punimeve F. B dhe kolaudatorja e punimeve R. M, me nr. 2126/1, datë 21.03.2018 citohet:*
***Sqarojmë****: Ne lidhje me Pretendimin se kontrata shtese e bere nga investitori per ndërtimin e sipërfaqeve te trotuareve është e paargumentuar, sqarojmë se investitori ne zbatim te ligjit i ka kërkuar subjektit sipërmarrës realizimin e një shtese kontrate e cila ka te beje me përfundimin e punimeve dhe vënien e objektit ne shfrytëzim, duke e shoqëruar këtë me projektin si dhe relacionin ,ne te cilin shprehet qarte domosdoshmëria e kryerjes se kësaj kontrate shtese midis palëve, si rrjedhoje argument juaj është i papranueshëm pasi çdo gjë është bere me argument teknik nga investitori, per domosdoshmërinë e shfrytëzimit te objektit.*
***Përgjigje****: Nga ana jonë është evidentuar fakti se pikërisht në relacionin teknik që ju citoni, shkaqet për të lidhur kontratë shtesë nuk janë ato që reflektohen me zëra pune në preventivin e kësaj kontrate, në të cilën janë vendosur punimet e pakryera me kontratën bazë.* ***Argumentet e sjella nuk merren në konsideratë.***

**Përsa sipër konkludojmë**:
Në zbatimin e punimeve të këtij objekti ka mangësitë e mëposhtme:
- Nuk administrohet leja e ndërtimit
- Janë certifikuar punime të pakryera në vlerën 2,608,120 lekë
- Është bërë shtesë kontrate në masën 20% të vlerës së kontratës bazë, pa argumente teknikë.

**Ngarkohen me përgjegjësi**:
Shoqëria C....O , në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve
Shoqëria "H.....K" , në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve
R.....A, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkelje të Kreut I, pikave 3.3, 4, 17 dhe kreut II, pika 3 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve" i ndryshuar, të nenit 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe nenin 36 germa 2/dh e VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

**11. Për rregullshmërinë në procedurën e zbatimit të punimeve me objekt** *"Rikonstruksion i rrugëve "Xhebro Gjika", "Veledin Kollozi" dhe blloku banimit mbas "CONAD" (Faza I)".*
Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i rishikuar, situacion përfundimtar, libri masave etje.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

| a.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 14.Lidhja e kontratës bazë<br>Nr. 9211. Dt.03.11.2016<br>midis Bashkisë Vlorë dhe sipërmarrësit "A.....J" | 15.Vlera e kontratës (me TVSH) 76,836,852 lekë | | 16.Likuiduar deri dt 14.08.2017<br>72,995,009 lekë me TVSH | |
| 17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt 14.08.2017<br>-Vlera me TVSH 76,836,852 lekë<br>-Vlera pa TVSH 72,995,009 lekë | 18.Afati i kontratës në dite<br>Parashikuar 120 ditë Zbatuar 247 ditë.<br>Fillimi punimeve: 07.11.2017<br>Përfundimi punimeve: 14.08.2017 | | 19. Leje zhvillimore për punimet e objektit me Vendim Nr.144 datë 04.11.2017 të Kryetarit të Bashkisë. | |
| 20. Mbikëqyrësi i punimeve "P....C.....N" , | Licenca<br>Nr: Licenca<br>Nr: MK ..... | Kontrata Nr. 9360<br>Prot.....datë 07.11.2016 | Likuiduar<br>(.....lekë) | Pa likuiduar<br>(.....lekë) |
| 21. Kolaudatori i punimeve "D.....S" , përfaqësuar nga N. V.. | Licenca<br>Nr:<br>MK ..... | Kontrata Prot.....datë<br>Nr.9471, 13.10.2017 | Likuiduar<br>(.....lekë) | Pa likuiduar (..... lekë) |
| 22.Akt Kolaudimi<br>Datë 20.10.2017 | 23.Akt i marrjes në dorëzim dt 20.10.2017 | | 24. Fletë Hyrja Nr.... datë .....lekë<br>(për mallrat) | |

-Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve "P....C.....N" është bërë kërkesë me Nr.37 datë 30.03.2017 për miratimin ndryshim volumesh në disa punime të objektit, bashkëlgjitur kësaj kërkese është paraqitur dhe relacioni ndryshimeve të volumeve.
-Është rishikuar projekti dhe është bërë preventivi i ripunuar, duke shtuar disa zëra të rinj, i shoqëruar me procesverbalet dhe tabelat e punimeve që shtohen dhe hiqen, ku vlera e preventivit të ripunuar ka mbetur 76,836,852 lekë me TVSH. Procesverbali i ndryshimit të volumeve është miratuar në datën 13.04.2017.
-Për punimet të cilat janë shtuar dhe nuk janë përfshirë në preventivin e ripunuar të kontratës bazë, janë përfshirë në preventivin e kontratës shtesë me Nr..... datë 13.04.2017, nënshkruar midis Bashkisë Vlorë dhe sipërmarrësit "A.....J" , me vlerë 15,301,325 lekë me TVSH, me afat përfundimi punimesh 30 ditë. Punimet e kontratës shtesë kanë përfunduar në datë 12.05.2017.
-Nga mbikëqyrësi i projektit është janë bërë tre kërkesa për zgjatje të afatit të punimeve, përkatësisht në datë 09.01.2017, 10.03.2017 dhe 28.04.2017 dhe janë bërë dy amendamente kontrate midis Autoritetit Kontraktor dhe sipërmarrësit, përkatësisht amendament Nr..... datë 16.03.2017 për zgjatje afati punimesh me 53 ditë. Amendament kontrate Nr..... datë 02.05.2017 për zgjatje afati punimesh deri në datën 15.08.2017.
Nga verifikimi në terren dhe dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit u konstatua se nuk janë kryer punime të cilat rezultojnë të paguara në situacionin përfundimtar me vlerë 2,026,635 lekë me TVSH. Përkatësisht për:
**Zërin A.I.1** Skarifikim asfalti. Sipërfaqja e skarifikimit të asfaltit është paguar në situacion 1451 m2. Në librezën e masave është pasqyruar 2051 m2 skarifikim, ku është llogaritur edhe rruga "Xhebro Gjika" (3.5m x 325m = 1137m2), por faktikisht kjo rrugë është gërmuar në gjithë trupin e saj, fakt i cili është pasqyruar dhe në librezën e masave dhe projekti ne rishikuar. Vlera e diferencës prej 537 m2, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Zërin A.I.2** Frezim asfalti. Sipërfaqja e frezimit të asfaltit është paguar në situacion 3500 m2. Në librezën e masave është pasqyruar 3501 m2 frezim, ku është llogaritur edhe rruga "Veledin Kollozi" (328m x 9.5m = 3116m2), por faktikisht kjo rrugë është frezuar në gjerësinë 9m (pasqyruar në projektin e rishikuar), ndërsa gjerësia tjetër është gërmuar për vendosjen e nënshtresave. Vlera e diferencës prej 164 m2, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
**Zërin A.I.2** Transport materiale ndërtimi deri 5km. Ky volum është paguar në situacion 968 m3. Në librezën e masave është llogaritur edhe transporti i materialeve të sakrifikuara në rrugën "Xhebro Gjika" dhe frezimi në rrugën "Veledin Kollozi". Diferenca e transportit është 537 m2 x 0.12m + 164m2 x 0.05m= 72,64 m3 . Vlera e diferencës prej 72,64 m3, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
**Zërin A.II.8** Profili me binder me granil gur kave me makineri. Sasia e profilimit me binder është paguar në situacion 484,7 ton. Në librezën e masave është llogaritur profilimi i rrugës "Veledin Kollozi" ne në gjatësi 328m dhe gjerësi 9.2m. Duke llogaritur gjerësinë e rrugës 12m dhe gjerësinë 9.2m. Nga projekti konstatohet se trupi i rrugës është gërmuar dhe mbushur me nënshtresa cakull dhe stabilizant nga të dy anët me 1.5m, dhe trupi i rrugës e cila është frezuar është 9m. Për këtë sasia e profilimit për rrugën "Veledin Kollozi" llogaritet 328m x 9m x 0.08m x 2ton/m3 = 472.3 ton . Gjithashtu duhet të zbritet edhe sasia e zënë nga 27 puseta me sipërfaqje 1.44m2 secila (6.2 ton gjithsej). Diferenca e profilimit është 18.6 ton. Vlera e diferencës prej 18.6ton, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
**Zërin A.II.9** N/shtrese binderi 6cm me granil gur kave me makineri. Sipërfaqja e shtresës së binderit t= 6cm është paguar në situacion 10248 m2. Ndërsa nga verifikimi në terren dhe projektit të azhurnuar u konstatua se nuk është zbritur sasia e 115 pesetave në të tre rrugët, me sipërfaqje 1.44 m2 secila. Duhet të zbritet sasia e zënë nga pusetat me sipërfaqje 115 copë x 1.44 m2 = 165.6 m2. Diferenca e shtresës së binderit t=6cm është 165.6 m2. Vlera e diferencës prej 165.6 m2, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
**Zërin II.3** Shtrese kaluese asfalto beton shtrese 4cm mbi sipërfaqje totale te rruge (pa kuneten gjeresi 0,5). Sipërfaqja e shtresës së asfaltobetonit t= 4cm është paguar në situacion shtesë në sasinë 4450 m2. Nga verifikimi në terren dhe i projektit të azhurnuar u konstatua se nuk janë realizuar me shtresë kaluese asfaltobetonit degëzimi 1,2, 4, 6 ,7 majtas me sipërfaqje 36.9m2, 39.6, 26.9 m2, 50.8 m2, 24.3 m2 dhe degëzimet 2 dhe 4 majtas me sipërfaqje 52.6m2 dhe 46.7m2. Gjithashtu nuk janë zbritur edhe 115 puseta x 1.44m2 = 165.6m2 = Diferenca totale e sipërfaqes së shtresës së asfaltobetonit është 434.4 m2 , vlerë e cila është përfituar më tepër nga sipërmarrësi.
**Zërin VII.1** Tabela tetëkëndore normal A-B 90-30. Në situacion janë paguar 26 copë tabela, ndërkohë nga verifikimi në terren u konstatua se janë vendosur gjithsej 4 tabela. Diferenca është 22 tabela. Vlera e diferencës për 22 tabela është përfituar më tepër nga sipërmarrësi.
**Zërin VII.2** Vijëzim me bojë bikomponente. Në situacion është paguar 207,7 m2 vijëzim me bojë bikomponente. Nga verifikimi në terren u konstatua janë realizuar 7.5m2, 10m2, 4m2 dhe 5m2 vijëzime në rrugën Xhebro Gjika, ndërsa në rrugët e tjera nuk konstatohet se janë realizuar vijëzime për këmbësorë. Diferenca është 181.2 m2 . Vlera e diferencës prej 181.2 m2 është përfituar më tepër nga sipërmarrësi.
**Zërin D.I.1** Vendosje mbështetëse. Në situacion ky zë punimi është paguar për 151 copë, ndërkohë nga verifikimi në terren u konstatua se nuk janë vendosur mbështetëse në stolat e betonit. Diferenca prej 151 copë është përfituar më tepër nga sipërmarrësi.

**Zërin D.I.2** Ndenjëse beton arme të parafabrikuara + shtrese dërrase. Në specifikime teknike ky zë punimi është parashikuar të realizohet me beton dhe shtresë dërrase, nga verifikimi në terren u konstatua se ky zë punimi nuk është realizuar. Këtij zë punimi i është hequr vlera e sipërfaqes së dërrasës duke iu referuar zërit 2.279. Shtrese dërrasa FM 2.5cm me çmim 1795 lekë/m2 të Manualit 2 të çmimeve të vitit 2015. Duke konsideruar dimensionet e stolit 2.2m x 0.4m dhe mbingritjen 10 cm, sipërfaqja e shtresës së dërrasës për 1 stol është 1m2. Gjithsej janë 51 stola. Vlera e rillogaritur e 1 stoli është 18247 m2 . Diferenca e prej 91,545 lekësh për 51 stola, është përfituar më tepër nga sipërmarrësi.
**- Zërin Bordurë trotuari e derdhur në vend** .Situacioni përfundimtar pasqyron në total për të tre akset e ndërhyra volumin prej 24 m3 beton për bordurë kufizuese. Libreza e masave paraqet në mënyrë të analitike volumin prej 2.72 m3 beton. Në fakt, nga verifikimi në terren i punimeve bordurat e betonit rezultuan me dimensione 20 cm x 25 cm dhe jo 20 cm x 30 cm sa pasqyrohet në librezën e masave. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 3.6 m3 beton për bordurë.
**Zërin F.V morsetë tokëzimi shtylle**. Situacioni përfundimtar pasqyron në total për të tre akset e ndërhyra volumin prej 77 copë morseta tokëzim shtylle. Libreza e masave paraqet në mënyrë të direkte volumin prej 77 copë morseta. Në fakt, nga analiza e zërave në situacion rezulton se janë likuiduar dy herë volume për morseta, një herë sipas zërit me nr.1 "3.An/53 F V shtylla metalike për ndriçim, H=7m, d=160mm" dhe një herë sipas zërit me nr. 2 "AN. F.v morsetë tokëzimi shtylle". Pra në total janë pasqyruar sipas zërave 3 morseta kur në fakt janë realizuar 2 të tilla. Për rrjedhojë janë përfituar tepër nga sipërmarrësi volumi prej 77 copë morseta tokëzimi.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në lidhje me këtë objekt, në datë 21.03.2018 me Nr.prot 2131/1 është dorëzuar observacion nga mbikëqyrësi i punimeve, V. G, përfaqësuese e "P....C.....N" .*
*1.Pretendimi i subjektit: Zëri "Skarifikim shtrese asfalti" është parashikuar që në preventiv fitues në sasinë 4200m2. Ne skarifikuam në rrugën Xhebro Gjika, ku ju thoni se nuk është bërë, por në fakt është skarifikuar edhe në këtë rrugë. Mbas skarifikimit të asfaltit rezultoi se rruga nuk kishte qëndrueshmëri. Për këtë u ra dakort që të ndërhytë në trupin e rrugës Xh. Gjika, sipas paketës të paraqitur në projektin e azhornuar.*
*Përgjigje: Ky pretendim nuk merret në konsideratë, sepse për të konstatuar mungesën e qëndrueshmërisë të rrugës, mund të kryheshin disa sondazhe në sipërfaqe të vogla të gërmuara, ose në pjesën ku ishte parashikuar të gërmohej, dhe nuk ishte e nevojshme të sakrifikohej gjithë rruga për të konstatuar mungesën e qëndrueshmërisë.*
*Përgjigje: Përsa i përket pretendimit për zërin "Frezim asfalti", ky pretendim nuk qëndron sepse gjerësia e rrugës ekzistuese dhe gjerësia rrugës së zgjeruar është paraqitur në projekt, dhe nuk mund të ketë mbivendosje të gërmimit dhe frezimit të asfaltit.*
*2.Pretendimi i subjektit: Zëri "Profili me binder me granil gur kave me makineri". Theksojmë se 328mx9mx0.08x2.2ton/m3=519.5 ton, pesha specifike e binderit është 2.2ton/m3.*
*Përgjigje: Ky printimin nuk merret në konsideratë, sepse vet kontraktori në librezën e masave ka paraqitur si peshë specifike të binderit 2 ton/m3, ku kontraktori ka patur kohën e mjaftueshme për ta korrigjuar. Gjithashtu nuk janë zbritur edhe sipërfaqet e pesetave, të cilat nuk janë profiluar.*
*3.Pretendimi i subjektit: Për zërin "N/shtrese binderi 6cm me granil gur kave me makineri" dhe zërin "Shtrese kaluese asfalto beton shtrese 4cm mbi sipërfaqje totale te rruge (pa kuneten gjeresi 0,5)", sipërfaqet e pesetave janë zbritur sipas librezës së masave, ku theksojmë se sipërfaqja e një pesetë është s=3.14x0.32=0.2826m2.*

***Përgjigje**: Ky pretendim nuk merret në konsideratë, sepse në sipërfaqen e pusetës nuk llogaritet vetëm kapaku i gizës, por llogaritet dhe pjesa mbështetëse prejt betoni, e cila nuk asfaltohet. Edhe sipas projektit të azhornuar, sipërfaqja e pusetës është 1.44m2.*

*4.Pretendimi i subjektit: Zëri: Bordurë e derdhur në vend pas trotuarit (themel e xokol betoni C 12/15) Kjo bordurë e derdhur pas trotuarit është 20 cm x 30 cm mesatare pasi sipas terrenit ka vende që është 20 cm x 25 cm, 20 cm x 35 cm dhe 20 cm x 40 cm. Ne kemi marrë një mesatare 20 cm x 30 cm.*
*Zëri: F.V morseta tokëzimi shtylle*
*Ky zë është paraqitur më vete në preventivin tenderues dhe për pasojë firma zbatuese ka konkurruar me një çmim më të ulët për zërin "F.V shtyllë metalike për ndriçim, H=7 ml d=160 mm" duke patur parasysh edhe zërin me vete F.V morestë tokëzimi shtylle pasi kështu e ka realizuar projektuesi. Pra çmimin e "F.V shtyllë metalike për ndriçim, H=7 ml d=160 mm" e ka ndarë në dy pjesë*
***Përgjigje**: Pretendimet tuaja lidhur me diferencat në volume nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi Pretendimimet nuk sjellin fakte shtesë dhe nuk justifikojnë konstatimet. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë e si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.*

Në tabelën mëposhtme paraqitet vlera e dëmit ekonomik për punime të pakryera:

| | **Rikonstruksion i rrugëve "Xhebro Gjika", "Veledin Kollozi" dhe blloku banimit mbas "CONAD" (Faza I)** | **Njësia** | **Çmimi** | **Sasia Situacion** | **Sasia Faktike** | **Diferenca** | **Diferenca** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Zëri | Emërtimi | | Lekë | Njësi | Njësi | Sasi | Lekë |
| A.I | Punime prishje | | | | | | |
| 1 | Skarifikim asfalti | m2 | 136 | 1451 | 914 | 537 | 73.032 |
| 2 | Frezim asfalti | m2 | 110 | 3500 | 3336 | 164 | 18.040 |
| 2 | Transport materiale ndërtimi deri 5km | m2 | 218 | 968 | 895,4 | 72,64 | 15.836 |
| | | | | | | | |
| A.II | Punime gërmimi zbankimi dhe ndërtim shtresash rrugore auto | | | | | | |
| 8 | Profili me binder me granil gur kave me makineri | ton | 8890 | 484,7 | 466,1 | 18,6 | 165.361 |
| 9 | N/shtrese binderi 6cm me granil gur kave me makineri | m2 | 1390 | 10248 | 10082,4 | 165,6 | 230.184 |
| | Bordurë e derdhur në vend pas trotuarit (Themel e xokol betoni C 12/15) | m3 | 7,491 | 24 | 20.6 | 3.4 | 25.469 |
| | F.V morsetë tokëzimi shtylle | copë | 1,231 | 77 | 0 | 77 | 94,787 |
| | Situacion i punimeve shtesë | | | | | | |
| | Punime gërmimi zbankimi dhe ndërtim shtresash rrugore auto | | | | | | |
| 3 | Shtrese kaluese asfalto beton shtrese 4cm mbi sipërfaqje totale te rruge (pa kuneten gjeresi 0,5) | m2 | 1105 | 4450 | 4006,6 | 443,4 | 489.957 |
| | | | | | | | |
| | Punime sinjalistikë rrugore | | | | | | |
| An97 | Tabela tetëkëndore normal A-B 90-30 | copë | 9076 | 26 | 4 | 22 | 199.672 |
| An142 | Vijëzim me bojë bikomponente | m2 | 1320 | 207,7 | 26,5 | 181,2 | 239.184 |
| | Punime gjelbërimi dhe dekorimi | | | | | | |
| 1 | Vendosje mbështetëse | copë | 214 | 214 | 0 | 214 | 45.796 |
| | | | | | Çmimi i ri | Diferenca çmim | |
| 2 | Ndenjëse beton arme të parafabrikuara + | copë | 20042 | 51 | 18247 | 1795 | 91.545 |

| | Rikonstruksion i rrugëve "Xhebro Gjika", "Veledin Kollozi" dhe blloku banimit mbas "CONAD" (Faza I) | Njësia | Çmimi | Sasia Situacion | Sasia Faktike | Diferenca | Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | shtrese dërrase. | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | DIFERENCA | | | | | | 1,688,863 |
| | T.V.SH | | | | | | 337,772 |
| | SHUMA TOTALE | | | | | | 2,026,635 |

Tabela 1 Vlera e dëmit ekonomik për punime të pakryera

Si përfundim sipërmarrësi "A.....J" ka përfituar më tepër vlerën 2,026,635 lekë me TVSH (1,688,863 pa TVSH), për punime të pakryera, në kundërshtim pikën 5.1 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve" i ndryshuar dhe Ligjin 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", dhe ngarkohet me mbikëqyrësi i punimeve V. G, përfaqësues i "P....C.....N" dhe kolaudatori i punimeve N. V., përfaqësues i "D.....S" .

**12. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve të kontratës** *"Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë", rezultoi si vijon:*

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë "C....O" , u konstatua se:

Janë likuiduar tepër në vlerën 282,180 lekë (1,415,900 x 20%) si pasojë e përfshirjes në situacionin e punimeve të TVSH-së së pajisjeve Kalorifer në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, me VKM Nr. 514, datë 15.08.2007, me UKM Nr. 1, datë 16.06.2011, ku përcaktohet se formati i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimet e lartpërmendur parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar TVSH-në, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet.

Nga auditimi në terren për verifikimin e realizimit të zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike të zbatimit, rezultojnë diferenca në volume zërash në shumën 202,764 lekë.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes 1:** | Diferenca në volume në realizimin e punimeve si dhe dëm për shkak të përfshirjes së TVSH në pajisjet. |
| **Situata:** | Nga auditimi i dokumentacionit justifikues dhe zbatimit në fakt të punimeve të ndërtimit. |
| **Kriteri:** | Kontrata, preventivi , situacioni dhe verifikimi në objekt kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Efekt negativ duke rritur vlerën e kontratës. |
| **Shkaku:** | Mos realizim 100 % i volumeve për disa zëra punimesh dhe mos njohje e legjislacionit mbi TVSH e pajisjeve të përfshira në situacion. |
| **Rëndësia:** | I lartë. |
| **Rekomandime:** | Të merren masa nga Bashkia Vlorë, që ti kërkojë operatorit ekonomik "C....O" , duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës 484,944 lekë, të përfituar tepër për punime të pakryera dhe për përfshirjen e TVSH-së për pajisjet e situacionuara në zbatimin e kontratës me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja". |

**A. Mbi nënshkrimin e kontratës së zbatimit dhe shërbimit të mbikëqyrjes.**

- Zbatimi i punimeve është realizuar sipas kontratës me Nr. prot. 2181, datë 01.06.2015 me objekt; "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë" e lidhur ndërmjet Operatorit Ekonomik "C....O" me seli në Fier, përfaqësuar nga Administratori D... L....A dhe Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari Sh. Gj.. Vlera e kontratës është 50,528,366 Lekë pa TVSH ose 60,634,039 lekë me TVSH. Shoqëria "C....O" është e pajisur me licencë me nr. NZ....., datë 03.06.2013 me drejtues ligjor D... L....A.

Afati i përfundimit të punimeve është 5 muaj, nga data e lidhjes së kontratës. Garancia e punimeve është parashikuar 12 muaj duke filluar nga data e marrjes në dorëzim provizore.

- Mbikëqyri i punimeve civile për objektin "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë" është ngarkuar V. G me licencë profesionale me Nr. MK ....., datë 13.06.2016.
- Për kolaudimin e punimeve për objektin "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë" është lidhur kontrata me nr. prot. 1221, datë 22.02.2016 ndërmjet shoqërisë "H.....K 11" me NIPT L19008502B, me administrator F. B., me licencë MK. ....., datë 16.11.2016 dhe investitorit Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L.. Vlera e kësaj kontrate është 57,581 lekë me TVSH.

Nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga sipërmarrësi i punimeve mbi zbatimin e kontratës, është mbajtur dokumentacioni si vijon:

- Akti mbi dorëzimin e sheshit të ndërtimit me datë 25-26.06.2015
- Procesverbal mbi akt piketimin në objekt me datë 27.06.2015
- Procesverbali mbi fillimin e punimeve me datë 26.06.2015.
- Deklarata teknike e sipërmarrësit pa datë
- Njoftim për përfundimin e punimeve me datë 29.02.2016 (C.....O ).
- Relacion teknik përfundimtar me datë 29.02.2016 (Mbikëqyrësi i punimeve "P....C.....N ").

Me datë 26.10.2015 zbatuesi i punimeve i drejtohet AK dhe për dijeni me objekt, mbi shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me Pretendimimin se nuk është liruar plotësisht sheshi i ndërtimit dhe me datë 29.10.2018 mbikëqyrësi i punimeve "P.....N" i drejtohet AK me shkresë mbi shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me Pretendimimin se nuk është liruar plotësisht sheshi i ndërtimit.

Autoriteti Kontraktor me shkresën me nr. prot. 4933/1, datë 05.11.2015 ka miratuar afatin e shtyrjes së përfundimit të punimeve për 4 muaj.

- Akti i kolaudimit për objektin "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë" është mbajtur me datë 15.03.2016 dhe është nënshkruar nga zbatuesi i punimeve, nga sipërmarrësi i punimeve "C....O" , m administrator D.... L....A, nga kolaudatori shoqëria "H.....K 11" , me administrator F. B, nga mbikëqyrësi i punimeve, shoqëria "P....C.....N" me administrator V. G
- Punimet e objektit "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë" janë marrë në dorëzim, me datë 15.03.2016 sipas certifikatës së përkohshme të marrjes në dorëzim dhe është nënshkrua nga zbatuesi i punimeve, nga mbikëqyrësi i punimeve, nga kolaudatori si dhe nga Autoriteti Kontraktor.

A.1 Grupi i projektimit të projektit.

Projekti i zbatimit për objektin "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë" është hartuar nga projektues "T....T" për (Instalimet h/sanitare dhe kanalizimet; instalimet e mbrojtjes kundra zjarrit; instalimet elektrike) të miratuar nga kryetari i Ak SH. GJ. Projekti arkitektonik, konstruktiv, plani i sistemimit; planimetria e Palestrës; është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Vlorë i përbërë nga :Urb. D. S; Ark. A. B; ing. Konstrk. E. A; D. H; ing. Elektrik. M. H dhe ing. Gjelbërimi. F. M.

**A.2 Miratime leje zhvillimore/ndërtimi, mjedisore, etj.**
Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, u konstatua se për zbatimin e objektit "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë", ka leje ndërtimi lëshuar me datë 23.02.2015 e vlefshme deri me datë 31.12.2015. Me shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 4 muaj, u konstatua se në dosje nuk ka leje ndërtimi të rinovuar për zbatimin e objektit "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë", veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" pika 4.
B. Nga auditimi mbi disbursimet rezulton.
Nga auditimi i dokumentacionit mbi disbursimet e punimeve të ndërtimit të realizuar sipas kontratës me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë" rezulton se është hartuar situacioni përfundimtar me vlerë 10,551,144 lekë me TVSH
C. Mbi verifikimin e kryerjes të punimeve në objekt dhe dokumentacionit teknik të zbatimit:
Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultojnë diferenca për punime të pakryera në vlerën prej 558,384 lekë me TVSH.

Pretendimimi i kësaj diference në kryerjen e punimeve, detajohet si vijon:
**VII Punime bojatisje**.
Zëri 6 Lyrje e mureve të brendshme me hidromat h=1,5 cm.
Preventivi bazë pasqyron 1289 m2 lyrje me hidromat me çmim 200 lekë. Situacioni përfundimtar, pasqyron 1289 m2 lyrje me hidromat gjithsej. Libri i masave pasqyron 1289 m2 lyrje me hidromat gjithsej.
Në fakt, nga verifikimi i realizimit të këtij zëri në objekt, si dhe nga libreza e masave, rezulton se lyrja me hidromat është realizuar me h= 1.4 m dhe jo me h=1.5 m siç është përcaktuar në projektin e zbatimit dhe në specifikimet teknike. Realizimi i zërit me h =1.45 m nga përllogaritja e bërë nga grupi i auditimit kushton 157,80 lekë [(162,600 m2 x 1.45 m : 1.5 m). Si rrjedhim për sa më sipër është situacionuar më tepër duke përfituar në vlerën 6,504 lekë [(5,420 m2 x 1.2 (20 % TVSH)] nga zbatuesi i punimeve shoqëria "C....O" .

**C. Sistemim i jashtëm**.
Zëri 2 (3.211) Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur makadan.
Preventivi bazë pasqyron 1490 m2 shtresë çakëlli me çmim 150 lekë. Situacioni përfundimtar, pasqyron 1490 m2 shtresë çakëlli gjithsej. Libri i masave pasqyron 1490 m2 shtresë çakëlli gjithsej.
Në fakt, nga verifikimi i realizimit të këtij zëri në objekt, rezulton se realizimi i shtresës së çakllit është realizuar me t=10 cm dhe jo me t=20 cm siç është përcaktuar në projektin e zbatimit dhe në specifikimet teknike. Realizimi i zërit me h =1.45 m nga përllogaritja e bërë nga grupi i auditimit kushton 111,750 lekë (223,500 m2 x 0.10 m : 0.20 m). Si rrjedhim për sa më sipër është situacionuar më tepër duke përfituar në vlerën 134,100 lekë me TVSH [(111,750 m2 x 1.2 (20 % TVSH)] nga zbatuesi i punimeve shoqëria "C....O" .
**C. Sistemim i jashtëm**.
Zëri 8 (2.261) Nën shtresë rëre nën tubo.
Preventivi ofertues pasqyron 19 m3 nënshtresë rëre me çmim 1200 lekë. Situacioni përfundimtar, pasqyron 19 m3 nënshtresë rëre gjithsej. Libri i masave pasqyron 19 m3 nënshtresë rëre gjithsej.

Në fakt, nga auditimi i dokumentacionit teknik, nuk asnjë fotografi apo procesverbal si punim i maskuar që të vërtetojë realizimin e këtij zëri. Si rrjedhim, nga shoqëria "C....O" . është përfituar padrejtësisht vlera prej 27,360 lekë me TVSH [22,800 m3 x 1.2 (20% TVSH-ja)].

**E. Punime për palestrën e re**.

Zëri 36 (2.37/a) Transport dheu me auto 5 km.

Preventivi pasqyron 50 m3 transport dheu me çmim 1500 lekë. Situacioni përfundimtar, pasqyron 50 m3 transport dheu gjithsej. Libri i masave pasqyron 50 m3 transport dheu të detajuar në mënyrë analitike.

Në fakt, nga auditimi konstatohet se janë gërmuar vetëm 38 m3 gërmim dheu dhe jo 50 m3. Diferenca prej 12 m3 është situacionuar më tepër dhe si rrjedhojë nga shoqëria "C....O" është përfituar padrejtësisht vlera prej 21,600 lekë me TVSH [12 m3 x 1500 lekë x 1.2 (20% TVSH-ja)].

Zëri 13 (An) F.V Pulsant alarmi antizjarr 220 V, 10 A.

Preventivi ofertues pasqyron 3 copë pulsant alarmi anti zjarr me çmim 1000 lekë. Situacioni përfundimtar, pasqyron 3 copë pulsant alarmi anti zjarr gjithsej. Libri i masave pasqyron 3 copë pulsant alarmi antizjarr gjithsej.

Në fakt, nga auditimi në objekt, u konstatua që ky zë punimi nuk është realizuar fare.

Prandaj, nga shoqëria "C....O" . është përfituar padrejtësisht vlera prej 3600 lekë me TVSH [3000 m3 x 1.2 (20% TVSH-ja)].

**H. Punime të Kaldajës**

Zëri 1 (An) F.V Tubacion i nxjerrjes së tymrave oxhaku Ø 300 mm + pajisjet fiksuese.

Preventivi ofertues pasqyron 1 copë tubacion i nxjerrjes së tymrave me çmim 8,000 lekë. Situacioni përfundimtar, pasqyron 1 copë tubacion i nxjerrjes së tymrave gjithsej. Libri i masave pasqyron 1 copë tubacion i nxjerrjes së tymrave gjithsej.

Në fakt, nga auditimi në objekt, u konstatua që ky zë punimi nuk është realizuar fare.

Si rrjedhim, nga shoqëria "C....O" . është përfituar padrejtësisht vlera prej 9,600 lekë me TVSH [8,000 m3 x 1.2 (20% TVSH-ja)].

Zëri nga 1 deri 7 (An) F.V Kaloriferët

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjen teknike, si preventiv i ripunuar si dhe situacioni përfundimtar, rezulton se pajisjet Kaloriferë janë llogaritur me TVSH, duke i konsideruar punime ndërtimi punimet e furnizimit dhe të vendosjes së kaloriferëve.

Kjo lloj strukture e preventivit dhe e situacionit përfundimtar në këtë formë bie ndesh me legjislacionin në fuqi, konkretisht me:

- UKM Nr. 2, datë 08.05.2003 "Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", Kreu I/I "Klasifikimi i punimeve të ndërtimit", germa "A", paragrafi i fundit, pasi të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat në përfshirjen e punimeve të ndërtimit, ku përcaktohet se: "Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat";

ii) VKM Nr. 514, datë 15/8/2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8, ku përcaktohet se: "Analizat teknike do të përgatiten në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Kreun I të udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 të Këshillit të Ministrave, .....".

- UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 1, germa "c", paragrafi i fundit, ku përcaktohet se: "Preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha vëllimet e

punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit në përputhje me pikën 3.1 (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi);

Ky format i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimin e lartpërmendur parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar TVSH-në, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet. Pra nuk ka më TVSH për pajisjet, pasi si rubrikë për efekt të llogaritjes së kostos janë zë më vete, duke u përfshirë mbrapa TVSH-së. Po me këtë udhëzim është miratuar edhe paraqitja e zërave të punimeve dhe pajisjeve në miratimin e strukturës së situacionit që paraqitet për likuidim.
- Si pasojë e përfshirjes në situacion të TVSH-së janë likuiduar tepër në vlerën 282,180 lekë me TVSH (1,415,900 x 20%).
Si përfundim, janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve shoqëria "C....O" në vlerën 282,1800 lekë si rrjedhojë e përfshirjes së TVSH-së së pajisjeve Kalorifer në situacionin e punimeve, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Vlorë.

**Grupi i auditimit arrin në përfundimin se:**
**Vlera 484,944 lekë** me TVSH është shkelje financiare me dëm efektiv ndaj buxhetit të Bashkisë Vlorë dhe duhet të zhdëmtohet nga shoqëria "C....O" me drejtues ligjor L....A.
Sa më sipër janë në papajtueshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, dhe nenin 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve V. G.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH.*** *Sqarim mbi kundërshtitë e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve "P....C.....N" ., përfaqësuar nga V. G. dhe nga kolaudatori "H.....K 11" përfaqësuar nga F. B. me nr. prot. 2129/1, datë 21.04.2018 mbi akt konstatimin nr. 68, datë 16.03.2018, grupi i auditimit të KLSh-së pasi e lexoi me kujdes sqaron si vijon:*
*Se pari: Grupi i auditimit merr në konsideratë Pretendimimin mbi zërin 5. F.V pllaka drenuese ku në pjesën e trotuareve është ndërhyrë nga Bashkia Vlorë me realizimin e një projekti të ri, duke e hequr vlerën prej 37,440 lekë.*
*Se dyti: Grupi i auditimit merr në konsideratë Pretendimimin mbi zërin 4. "Vendosje fashe dërrase MDF në muret e brendshme me h =15 cm" se është thjeshtë vendosje fashe dhe ka të bëjë vetëm me punëtori, duke e hequr vlerën prej 36,000 lekë.*
*Përsa i përket observacionit për zërat e tjerë të punimeve, grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë sepse nga ana juaj nuk janë paraqitur argumente bindëse, Diferencat e volumeve janë konstatuar nga kontrolli fizik në objekt. Gjithashtu me kuadrin aktual ligjor dhe nënligjor pajisjet nuk mund të përfshihem me TVSH.*

**13. Mbi auditimin e zbatimit të punimeve të kontratës** *"Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë" Vlorë.*
Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë" Vlorë, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë "C....O" , u konstatua se: Nga auditimi në terren për verifikimin e realizimit të zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike të zbatimit, rezultojnë diferenca në shumën 585,400 lekë.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes 1:** | Diferenca në volume në realizimin e punimeve. |
| **Situata:** | Nga auditimi i dokumentacionit justifikues dhe zbatimit në fakt të punimeve të ndërtimit. |
| **Kriteri:** | Kontrata, preventivi , situacioni dhe verifikimi në objekt kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Efekt negativ duke rritur vlerën e kontratës për punime të pa kryera |
| **Shkaku:** | Mos realizim 100 % i volumeve për disa zëra punimesh. |
| **Rëndësia:** | I lartë. |
| **Rekomandime:** | Të merren masa nga Bashkia Vlorë, që ti kërkojë operatorit ekonomik "C....O" , duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës 585,400 lekë, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë". |

**A. Mbi nënshkrimin e kontratës së zbatimit dhe shërbimit të mbikëqyrjes**.

- Objekti i mësipërm është realizuar sipas kontratës me Nr. prot. 1850, datë 07.03.2017 me objekt; "Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë" Bashkia Vlorë e lidhur ndërmjet Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë "L.....I & C....O" me seli në Fier përfaqësuar nga shoqëria "C....O" përfaqësuar nga Drejtuesi Ligjor & Teknik F. A dhe Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari D. L. Vlera e kontratës është 8,792,620 Lekë pa TVSH ose 10,551,144 lekë me TVSH.

Afati i përfundimit të punimeve është 3 muaj, nga data e lidhjes së kontratës. Garancia e punimeve është parashikuar 12 muaj duke filluar nga data e marrjes në dorëzim provizore.

- Mbikëqyri i punimeve civile për objektin "Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë" do të jetë z. I. T sipas urdhrit të brendshëm me nr. 37 (nr. prot. 1893, datë 08.03.2017) me licencë profesionale me Nr. MK 2569, datë 09.03.2015.

- Për kolaudimin e punimeve për objektin "Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë" është lidhur kontrata me nr. prot. 4422, datë 26.05.2017 ndërmjet shoqërisë "H.....K 11" me NIPT L.....B, me administrator ing. Xhesila Myzyri, me licencë MK. 2018/12, datë 30.03.2017 dhe investitorit Kryetari i Bashkisë Vlorë D. L.. Vlera e kësaj kontrate është 24,000 lekë pa TVSH.

Me datë 07.03.2017 nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga sipërmarrësi i punimeve mbi zbatimin e kontratës, është mbajtur dokumentacioni si vijon: (Akti mbi dorëzimin e sheshit të ndërtimit; Procesverbal mbi akt piketimin në objekt dhe Procesverbali mbi fillimin e punimeve ).

Sipërmarrësi i punimeve me datë 05.05.2017 ka bërë deklaratën teknike mbi përfundimin e punimeve sipas projektit të zbatimit, KTZ dhe kontratës.

Me datë 05.05.2017 sipërmarrësi njofton mbikëqyrësin e punimeve mbi përfundimin e punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve njofton Autoritetin Kontraktor mbi përfundimin e punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve me datë 05.05.2017 ka hartuar relacionin teknik përfundimtar

- Procesverbali i kolaudimit është mbajtur me datë 30.5.2017 dhe është nënshkruar nga zbatuesi i punimeve, nga sipërmarrësi i punimeve BOE "L.....I & C....O" , nga kolaudatori shoqëria "H.....K 11", nga mbikëqyrësi i punimeve, person fizik I. T si dhe është miratuar nga Autoriteti Kontraktor, përfaqësuar nga kryetari D. L., N/kryetari A. M. dhe Drejtori i financës dhe buxhetit T. Z..

- Punimet e objektit "Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë" janë marrë në dorëzim, me datë 30.05.2017 sipas certifikatës së përkohshme të marrjes në dorëzim dhe është nënshkrua nga zbatuesi i punimeve, nga mbikëqyrësi i punimeve, nga kolaudatori si dhe nga Autoriteti Kontraktor.

**A.1 Grupi i projektimit të projektit**.

Projekti i zbatimit për objektin "Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë" është hartuar nga projektues "R.....N 95" me licencë Nr. ..... Grupi projektues përbëhet nga: projektues R. N.; ing. Ana Naipi; ing. Irkas Axhami dhe ing. Topograf, Kujtim Alliu.

**A.2 Miratime leje zhvillimore/ndërtimi, mjedisore, etj.**

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, u konstatua se në dosje nuk ka leje ndërtimi për zbatimin e objektit "Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë", veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" pika 4 ku citohet se: " ... Për çdo objekt që ndërtohet, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve administrojnë në kantier dokumentacionin teknik të mëposhtëm:

a) lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi, i cili e ka këtë të drejtë".

**B. Nga auditimi mbi disbursimet rezulton**.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi disbursimet e punimeve të ndërtimit të realizuar sipas kontratës me objekt "Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë" rezulton se është hartuar situacionet si vijon: (Situacioni nr. 1 me vlerë 7,189,471 lekë me TVSH; Situacioni nr. 2 me vlerë 2,513,949 lekë me TVSH; Situacioni nr. 3 me vlerë 847,724 lekë me TVSH si dhe Situacioni përfundimtar me vlerë 10,551,144 lekë me TVSH).

C. Mbi verifikimin e kryerjes të punimeve në objekt dhe dokumentacionit teknik të zbatimit:

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultojnë diferenca për punime të pakryera në vlerën prej 585,400 lekë pa TVSH.

**Pretendimimi i kësaj diference në kryerjen e punimeve, detajohet si vijon**:

Zëri 7 (3.158/a) Transport dhera nga gërmimi deri në 5 km.

Preventivi ofertues pasqyron 5069 m3 transport dheu me çmim 260 lekë + 443.6 m3 transport dheu që shtohen, ose 5512.60 m3 gërmim dheu gjithsej. Situacioni përfundimtar, pasqyron 5512.60 m3 gërmim dheu gjithsej. Libri i masave pasqyron 5512.60 m3 gërmim dheu gjithsej.

Në fakt, nga verifikimi i bërë në librezën e masave, si dhe nga përllogaritja e bërë rezulton që ky zë punimesh është realizuar në volumin 4294.94 m3 (2780 m3 zëri 2 + 612 m3 zëri 3 + 48. m3 zëri 4 + 853.65 m3 shtesë gërmim dheu trajtuar me fondin rezervë ) gërmim dheu dhe jo 5512.66 m3.

Diferenca prej 1217.72 m3 gërmim dheu është situacionuar më tepër në mënyrë të padrejtë duke përfituar më tepër 379,928 lekë me TVSH(1217.72 m3 x 260 lekë x 1.2(20 % TVSH)) nga zbatuesi i punimeve shoqëria "L.....I & C....O" .

Zëri 8 (2.258) Shtresë zhavorri nën beton.

Preventivi ofertues pasqyron 202.10 m3 shtresë zhavorri me çmim 1330 lekë gjithsej. Situacioni përfundimtar, pasqyron 202.10 m3 shtresë zhavorri gjithsej. Libri i masave pasqyron 202.10 m3 shtresë zhavorri gjithsej.

Në fakt, nga auditimi i zbatimit të punimeve në objekt rezulton që ky zë punimesh nuk është realizuar fare, si dhe nuk vërtetohet kryerja e këtij zëri me dokumentet që ndodhen në dosjen teknike. Nuk është mbajtur procesverbal si punim i maskuar për realizimin e tij, nuk ka asnjë fotografi që të tregojë kryerjen e tij. Nga verifikimi në objekt u konstatua se nuk është realizuar ky zë. Prandaj, nga shoqëria

"L.....I & C....O" është përfituar padrejtësisht vlera prej 322,551 lekë me TVSH [202.10 m3 x 1330 lekë x 1.2 (20% TVSH-ja)].

**Grupi i auditimit arrin në përfundimin se**:
Vlera 585,400 lekë pa TVSH është shkelje financiare me dëm efektiv ndaj buxhetit të Bashkisë Vlorë dhe duhet të zhdëmtohet nga shoqëria "L.....I & C....O" me drejtues ligjor F. A.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Sqarim mbi kundërshtitë e bërë nga mbikëqyrësi i punimeve Ing. I. T dhe nga kolaudatori i punimeve shoqëria "H.....K 11" përfaqësuar nga F. B. me datë 20.03.2018 mbi akt konstatimin nr. 69, datë 16.03.2018. Grupi i auditimit të KLSh-së pasi e lexoi me kujdes sqaron si vijon:*
*Se pari: Lidhur me pretendimin se Ju kundërshtoni Pretendimin që volumet e gërmimit janë të dokumentuara me matje faktike dhe azhurnim para fillimit të punimeve gjë e cila është e pasqyruar në seksionet tërthore të librezave të masave po ashtu dhe në procesverbalet e punimeve dhe në materialin fotografik që ndodhet në dosjen përfundimtare të objektit, keni dhëne një opinion jashtë problematikës së konstatuar nga grupi i auditimit. Ju kujtojmë se nuk bëhet fjalë për gërmime por për volum pune të pakryer për transportin e dherave nga gërmimi. Nga kontrolli në objekt u konstatua se dheu i gërmuar nuk është transportuar por është hedhur në anë të kanalit, prandaj sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsiderate.*
*Se dyti: Nga kontrolli në objekt u konstatua se zëri "shtresë zhavorri nën beton" nuk është realizuar sipas detajit të paraqitur, pra dokumentimi me procesverbalin e punimeve të maskuara për rastin konkret nuk pasqyron kryerjen e tij, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.*

*(Gjerësisht trajtuar në projekt raportin mbi zbatimin e punimeve nga faqja 1 deri në faqen 38, prot subjektin Bashkia Vlorë nr. 9276/6, datë 26.03.20218)*

## III/5. Auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave dhe tarifave vendore. Organizimi dhe funksioni i Policisë Bashkiake.

*III/5.1.1.-Krijimi i strukturave për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.*
*III/5.1.1.-Krijimi i strukturave për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.*
*Në auditimin e kryer mbi krijimin e strukturave për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, konstatohet se:*
Për vitin 2015 struktura organizative e zyrës së tatim taksave dhe tarifave vendore është miratuar me miratimin e strukturës organike të bashkisë e cila është miratuar, me vendim të Këshillit Bashkiak nr.53, datë 11/12/2014"Mbi strukturën organizative të bashkisë dhe institucioneve vartëse, viti 2015" miratuar në Prefekturë me shkresën nr. 5594, datë 31.12.2014 struktura është miratuar me 430 punonjës. Për vitin 2016 struktura organizative e zyrës së tatim taksave dhe tarifave vendore është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.1, datë 04/02/2016 "Për miratimin e numrit te punonjësve të bashkisë dhe institucioneve të varësisë" miratuar në Prefekturë me shkresën nr. 864/1, datë 01.08.2016. Për vitin 2017, struktura organizative e zyrës së tatim taksave dhe tarifave vendore është miratuar me miratimin e strukturës organike të bashkisë e cila është miratuar, me vendim të Këshillit Bashkiak nr.1, datë 31/01/2017 "Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve të varësisë" miratuar në Prefekturë me shkresën nr. 1213, datë 15.02.2017 dhe Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr.12, datë 28.02.2017 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë dhe

Institucioneve në vartësi për vitin 2017" struktura është miratuar me 493 punonjës, nga e cila struktura organizative e zyrës së tatim taksave dhe tarifave vendore është e përbërë nga 26 (njëzet e gjashtë) punonjës, sipas aneksit bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit.
Administrimi i taksave e tarifave vendore është bërë në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisje vendore"; të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" me ndryshime dhe paketave fiskale të miratuara nga Bashkia me VKB sipas viteve, respektivisht:
Për vitin 2015 me VKB Nr. 44, datë 28.12.2015 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë", për vitin 2016 me VKB Nr. 10, datë 04.02.2016 "Për disa ndryshime ne VKB nr.44 datë 28.12.2015 "Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave në territorin e Bashkisë Vlorë" Nr. 17, datë 31.03.2016, "Për disa ndryshime ne VKB nr.44 datë 28.12.2015 "Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave në territorin e Bashkisë Vlorë" dhe për vitin 2017 me VKB Nr. 2, datë 31.01.2017 "Për disa ndryshime ne VKB nr.44 datë 28.12.2015 "Për miratimin e sistemit te taksave dhe tarifave ne territorin e Bashkisë Vlorë". Të gjitha këto vendime sipas viteve respektive janë miratuar nga ana e Prefektit të Qarkut Vlorë.

*III/5.1.2.-Parashikimi, realizimi dhe përdorimi i taksave vendore sipas llojeve, rezervat në planifikim.*
Në auditimin e kryer mbi parashikimin, realizimin dhe përdorimin e taksave vendore sipas llojeve, rezervat në planifikim, rezulton se:
-Për vitin 2015, programimi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 852,417 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 421,479 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 430,938 mijë lekë, ose 49%. Për vitin 2016, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 1,146,132 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 573,645 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 572,487 mijë lekë, ose 50%. Për vitin 2017, programi i të ardhurave nga tatimet taksat dhe tarifat vendorë, është miratuar në vlerën 1,133,737 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 616,185 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 517,552 mijë lekë, ose 54%. Detyrimet debitorë të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2015 janë në vlerën 255,355 mijë lekë nga 2663 subjekte, me 31.12.2016 janë në vlerën 244,705 mijë lekë nga 2668 subjekte me 31.12.2017 janë në vlerën 193,002 mijë lekë nga 2197 subjekte. Detyrimet debitorë të taksës së tokës bujqësore gjendje me 31.12.2015 janë në vlerën 84,107 mijë lekë nga 7931 familje, më 31.12.2016 janë në vlerën 27,706 mijë lekë nga 8901 familje, më 31.12.2017 janë në vlerën 86,378 mijë lekë nga 17366 familje. Të dhënat e mësipërme flasin për një performancë jo të mirë të nivelit të arkëtimeve nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë.
Në vijim paraqitet evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve dhe ndryshimet gjatë periudhës së viteve 2015,2016 dhe vitin 2017.

Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2017.

| Nr | Lloji Biznesit | Viti | Gjendja Në fillim | Regjistrime Reja | Mbyllur Aktivit | Gjendja në fund të Vitit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Biznesi Vogël | 2015 | 2263 | 713 | 476 | 2727 |
| | | 2016 | 2748 | 379 | 432 | 2934 |
| | | 2017 | 2875 | 324 | 345 | 2820 |
| 2 | Biznesi Madh | 2015 | 724 | 9 | 20 | 911 |
| | | 2016 | 823 | 15 | 18 | 827 |
| | | 2017 | 817 | 13 | 9 | 823 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| (1+2) | Gjithsej | 2015 | 2987 | 722 | 496 | 3638 |
| | | 2016 | 3571 | 394 | 450 | 3761 |
| | | 2017 | 3692 | 337 | 354 | 3643 |

Sa më sipër konstatohet se numri i bizneseve gjendje në fillim të çdo viti ka ardhur duke u rritur për çdo vit nga viti 2015 deri në vitin 2017, regjistrimet e reja të bizneseve janë në rënie nga viti në vit kurse bizneset që kanë mbyllur aktivitetin janë në rënie. Në formë tabele planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për periudhën e viteve 2015,2016 dhe vitin 2017, paraqitet në aneks të veçantë në fund të projekt raportit. U përzgjodhën për auditim dokumentet e realizimit të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, saktësia e pasqyrimit të ardhurave sipas llojit, për vitin 2016, paraqiten, në pasqyrën në fund të projekt raportit. Realizimi i të ardhurave është në nivele të ultë. Programuar të ardhura nga tatim taksat gjithsej 1,146 mijë lekë, realizuar 573,645 mijë lekë ose në masën 50%. Ndikim të madh në mos realizimin e të ardhurave nga tatim taksat lokale, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila është programuar në masën 384,687 mijë lekë, realizuar në masën 37,748 mijë lekë ose 10%. Mosrealizimi është në masën (384,687 mijë lekë - 37,748 mijë lekë)= 346,939 mijë lekë, me ndikim në mosrealizim në masën 32%. Të ardhurat janë rakorduar me Degën e Thesarit çdo muaj dhe në mënyrë progresive përfshi fund vitin 2016.

*-Sipas dokumenteve të paraqitura nga arkiva e ish Komunës Shushicë sot Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Vlorë, në auditimin e kryer për realizimin e të radhuarve nga taksat dhe tarifat vendore, konstatohet se janë lidhur kontrata qiraje për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore e kullosore, konkretisht janë lidhur dy kontrata qiraje me shoqërinë "D.....A" përkatësisht një kontratë qiraje në vitin 2009 dhe një kontratë qiraje në vitin 2010.
Nënkontratën e qirasë të datës 15.06.2009 të lidhur midis palëve Ish- Komunës Shushicë përfaqësuar nga ish Kryetari I Komunës L. P dhe shoqërisë "D.....A" përfaqësuar nga D.....A me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe prej 3,07 ha ose 30,700 m² nga fondi pyjor/kullosor, ngastra nr.361, me afat për 10 vjet, vlera vjetore e qirasë është 15 lekë/m²/vit.
Në kontratën e qirasë të datës 20.09.2010 të lidhur midis palëve Ish- Komunës Shushicë dhe shoqërisë "D.....A" përfaqësuar nga A. D me objekt dhënie me qira të një sipërfaqe prej 2,05 ha ose 20,500 m² nga fondi pyjor/kullosor i ish Komunës Shushicë ngastra nr.361, me afat për 15 vjet, vlera vjetore e qirasëështë40,000 lekë/ha/vit për sipërfaqen prej 20,000 m² ose 2ha dhe 330,000 lekë/ha/vit për sipërfaqen prej 500 m² ose 0,05 ha.
Në auditimin e kryer të dy kontratave të dhënies me qira konstatohet se nuk është aplikuar e saktë tarifa lekë/ha/vit e konkretisht:
-Tarifa 15 lekë/m²/vit nuk është e saktë që është përcaktuar në kontratën e datës 15.06.2009 e cila citohet se është bazuar në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", ku në fakt në këtë vendim përcaktohet ndryshe. Sipas lidhjes nr.2 tarifat për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor publik, pika 5 "Për nxjerrje dhe prodhim materialesh inerte për ndërtim, tregti, qëllime industriale ose përpunuese, direkt nga sipërfaqja (karrierë) me afat 6-10 vjet, është 370,000 lekë/ha/vit.
-Tarifa 40,000 lekë/ha/vit për sipërfaqen prej 20,000 m² ose 2ha dhe tarifa 330,000 lekë/ha/vit për sipërfaqen prej 500 m² ose 0,05 ha, nuk është e saktë që është përcaktuar nënkontratën e datës 20.09.2010, e cila citohet se është bazuar në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", ku në fakt në këtë vendim përcaktohet ndryshe. Sipas lidhjes

nr.2 tarifat për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor publik, pika 6. "Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë), me afat 6-10 vjet", është 440,000 lekë/ha/vit.
Nga subjekti për llogari të ish- Komunës Shushicë është arkëtuar vlera 500,000 lekë nëpërmjet Bankës Credins me urdhër xhirim nr. serie 139961 datë 22.06.2009, gjithashtu është arkëtuar vlera 947,500 lekë nëpërmjet Bankës Credins me urdhër xhirim nr. serie 139972 datë 11.10.2010.
Nga përllogaritjet e kryera bazuar në kontratat e qirasë për sipërfaqen e dhënë dhe tarifave të përcaktuara në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhjes nr.2 tarifat për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor publik, pika 5 "Për nxjerrje dhe prodhim materialesh inerte për ndërtim, tregti, qëllime industriale ose përpunuese, direkt nga sipërfaqja (karrierë) me afat 6-10 vjet, është 370,000 lekë/ha/vit, rezulton se për periudhën 15.06.2009 deri 31.12.2010 detyrimi është 1,135,900 lekë, arkëtuar gjatë periudhës vlera 500,000 lekë, diferenca e pa arkëtuar rezulton 1,203,850 lekë.
Nga përllogaritjet e kryera bazuar në kontratat e qirasë për sipërfaqen e dhënë me qira dhe tarifave të përcaktuara në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhjes nr.2 tarifat për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor publik, pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë), me afat 6-10 vjet, është 440,000 lekë/ha/vit, rezulton se për periudhën 01.01.2011 deri 31.12.2017 detyrimi është 6,314,000 lekë, arkëtuar gjatë periudhës vlera 947,500 lekë, diferenca e pa arkëtuar rezulton 5,366,500 lekë.
Për të dy kontratat për të gjithë periudhën nga data e lidhjes së kontratës që është 15.06.2009 deri më 31.12.2017, sipërfaqja, afati I kontratave, data e lidhjes së kontratave, tarifa që është aplikuar, tarifa që duhet të aplikohet, detyrimi vjetor, detyrimi për gjithë periudhën, arkëtimet gjatë periudhë dhe diferenca për tu arkëtuar paraqiten, në pasqyrën në vijim:
Pasqyra e detyrimeve për shoqërinë "D.....A" periudha qershor 2009-31.12.2017.

| Nr | Emër Mbiemër | sip ha | Afati vite | kontrata | Është | Duhet | Detyrimi | Detyrimi për periudhën : | Arkëtuar | Dif lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | tarifa/ha/vit | tarifa/ha/vit | Vjetor | 15.6.09-31.12.2010 | | |
| 1 | "D.....A" | 3.07 | 10 | 15.06.09 | 15 lek/m²/vit | 370,000 | 1,135,900 | 1,703,850 | 500,000 | 1,203,850 |
| | | | | | | | | 01.01.2011-31.12.17 | | |
| 1 | "D.....A" | 2 | 15 | 20.09.10 | 40,000 | 440,000 | 880,000 | 6,160,000 | | |
| | | 0.05 | 15 | 20.09.10 | 330,000 | 440,000 | 22,000 | 154,000 | | |
| | | | | | | | | 6,314,000 | 947,500 | 5,366,500 |
| | **TOTALI** | | | | | | | **8,017,850** | **1,447,500** | **6,570,350** |

Si përfundim për subjektin "D.....A" për të dy kontratat e qirasë së lidhur me ish Komunën Shushicë, në total detyrimi është në vlerën 6,570,350 lekë, i cili paraqitet në pasqyrën e mëposhtëm, sipas aneksit nr.5/2, bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
*-Nga ish Komuna Shushicë dhe Bashkia Vlorë, nuk është aplikuar saktë tarifa vjetore lekë/ha/vit për sipërfaqen pyjore dhe kullosore të dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit për qëllime biznesi, për*

*nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë), me afat 6-10 vjet, tarifa vjetore është 440,000 leke/ha/vit në territor tokë Inproduktive, si dhe nuk është kryer arkëtimi i plotë i detyrimit nga shoqëria "D.....A" sipas aneksit nr.5/2, në shkelje të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", pika 2, lidhja nr. 2, pikat 5; të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", pika 2, lidhja nr. 2, pikat 6, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Vlorë* ***në vlerën 6,570,350 lekë.***

**Ngarkohen me përgjegjësi**:

L. P me detyrë, ish Kryetar i Komunës Qendër, për periudhën e vitit 2013, të vitit 2014 deri 31.07.2015.

B. Q me detyrë, ish Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave, për periudhën e vitit 2013, deri 30.09.2015, dalë në pension.

V. P. me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave, për periudhën 01.10.2014 deri 31.07.2015.

*-Sipas evidencës së paraqitur nga specialiste e transportit lidhur me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e bashkisë Vlorë dhe në Njësitë Administrative në vartësi, u audituan për arkëtimin e taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Vlorë, për periudhën e viteve 2015, 2016 dhe vitit 2017, të ish Bashkisë Orikum, të ish Komunës Shushicë dhe ish Komunës Qendër Vlorë, për periudhën janar-dhjetor viti 2013, janar-dhjetor 2014, janar-korrik 2015.

Në auditimin e kryer, mbi auditimin legjislacionit të taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të këshillit bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë karburanti, (autorizime), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", si dhe të VKM nr.170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 ndryshuar VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 10, konstatua se:

Nga zyra shërbimeve sektori i transportit, nuk janë pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe as nuk janë arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, në shkelje të VKM nr.170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 10. Në aneksin nr.5/3 paraqiten subjektet sipas vendndodhjes ku ushtrojnë aktivitetin e tyre të biznesit sipas Njësive Administrative, nipti përkatës dhe vlera e tarifës së pa likuiduar për çdo subjekt.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***

*Nga ana e Bashkisë Vlorë, të ish Bashkisë Orikum, të ish Komunës Novoselë, të ish Komunës Shushicë dhe ish Komunës Qendër Vlorë, nuk kanë vepruar për të pajisur subjektet, me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve*

*djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe as nuk janë arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, të trajtuara në aneksin nr.5.3 në shkelje të VKM nr.170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 10, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Vlorë, në vlerën 2,900,000 lekë, përkatësisht:*
*-Njësia Administrative Bashkia Vlorë vlera 1,600,000 lekë*
*-Njësia Administrative ish Bashkia Orikum vlera 200,000 lekë*
*-Njësia Administrative ish Komuna Qendër vlera 200,000 lekë*
*-Njësia Administrative ish Komuna Novoselë vlera 700,000 lekë*
*-Njësia Administrative ish Komuna Shushicë vlera 200,000 lekë*

**Ngarkojnë me përgjegjësi**:
M. M. me detyrë specialiste e transportit në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve për periudhën e vitit 2015, vitit 2016 dhe vitin 2017.
G. Ç. me detyrë, ish Kryetar i Bashkisë Orikum, periudha 01.01.2013-31.07.2017.
F. B. me detyrë, ish Kryetar i Komunës Qendër, periudha 01.01.2013-31.07.2015.
TH. T. me detyrë, ish P/Zyrës së Taksave Qendër, periudha 01.01.2013-31.07.2015.
L. P me detyrë, ish Kryetar i Komunës Shushicë, periudha 01.01.2013-31.07.2015.
B. Q me detyrë, ish P/Zyrës Tatim Taksave,01.01.13-30.09.15, dalë në pension.
V. P. me detyrë ish P/Zyrës Tatim Taksave, periudha 01.10.2014 deri 31.07.2015.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Shpjegimet e paraqitura me shkresën nr.1201/4 prot. datë 06.04.2018 protokolluar në KLSH me nr.1029/11 prot, datë 10.04.2018 të paraqitur nga D. L., M. M., G. Ç., F. B., z. TH. T., L. P, B. Q dhe z. V. P., ku citoni se:*
*..... nuk janë pajisur me licencë asnjë prej 6 këtyre subjekteve, pasi kanë pasur mangësi në dokumentacion duke ju është kthyer përgjigje për plotësim dokumentacioni.*
*..... nuk janë pajisur me licencë asnjë prej 3 këtyre subjekteve, pasi kanë pasur mangësi në dokumentacion duke ju është kthyer përgjigje për plotësim dokumentacioni.*
*.....sjellim në vëmendje ...se Drejtoria e Infrastrukturës dhe zbatimit të Projekteve nuk i ka pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, pasi këto subjekte kanë mangësi në dokumentacion, të cilët nuk i kanë plotësuar edhe mbas takimeve dhe konsultimeve me vetë subjektet.*
*-**Nga grupi i auditimit shpjegimet e dhëna**, nuk merret në konsideratë pasi subjektet ushtrojnë aktivitet dhe janë aktiv në QKB. Për subjektet që kanë dokumentacion të rregullt dhe janë pajisur me autorizim apo licencë duhet të kishin likuiduar tarifën përkatëse. Për të gjithë subjektet që janë me mangësi në dokumentacion nuk duhet të ushtrojnë aktivitet. Meqenëse ata janë në punë në aktivitet dhe për rrjedhojë duhet të likuidojnë edhe tarifën përkatëse, krahas plotësimit të dokumentacionit, bazuar kjo në kërkesat dhe përcaktimet e VKM nr.170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i*

*ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 10.*

*-Bazuar në dokumentet e evidencave të paraqitura nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë, për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi me fondet e buxhetit të shtetit, me fonde të zhvillimit të rajoneve dhe me fonde nga të ardhurat e veta të Bashkisë për periudhën e vitit 2015, të vitit 2016 dhe për periudhën janar-dhjetor 2017 konstatohet se:

-Nga subjektet e ndërtimit është ushtruar aktivitet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në objekte të ndryshme të cilat paraqiten në tabelën trajtuar në akt konstatim dhe në projekt raportin e auditimit ku paraqiten data e zhvillimit të prokurimit të objektit, data e dorëzimit të objektit për punimet të cilat janë përfunduar, nipti i shoqërisë si dhe adresat përkatëse të subjekteve.

Konstatohet se gjatë periudhës së vitit 2015, të vitit 2016 dhe të vitit 2017 kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit 36 subjekte të cilat kanë adresë dytësore dhe janë me seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe të Njësive Administrative. Nga inspektorët e taksave dhe tarifave vendore Bashkia Vlorë dhe të Njësive Administrative Orikum, Qendër, Novoselë dhe Shushicë, nuk është vepruar që për subjektet që kanë seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe Njësive Administrative dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimi për tarifën e ndriçimit, të pastrimit dhe tarifën e gjelbërimit në masën prej 30,000 lekë/vit. Bazuar në evidencën e subjekteve që kanë ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë për periudhën e viteve 2015, 2016 dhe të vitit 2017 dhe selinë kryesore administrative të tyre e kanë jashtë territorit të Bashkisë Vlorë pasqyrohen në aneksin 5/4 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***

*-Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Vlorë dhe të Njësive Administrative Orikum, Qendër, Novoselë dhe Shushicë, nuk është vepruar që për subjektet që kanë seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë dhe Njësive Administrative dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimi për tarifën e ndriçimit, të pastrimit dhe tarifën e gjelbërimit në masën prej 30 000 lekë në vit, për çdo vit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike, sipas aneksit nr.5/4, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.44, datë 28.12.2015, protokolluar me nr.10, datë 05.01.2016, kreu i Tarifave Vendore pika 3, germa "c" nënpika 6, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e Bashkisë Vlorë* ***në vlerën 1,435,000 lekë.***

**Ngarkon me përgjegjësi**:

T. Z. me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar.
LL. M me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.10.2015 deri 31.12.2017
K. M me detyrë inspektor terreni për periudhën 11.05.2004 deri 31.12.2017
D. K me detyrë inspektor terreni për periudhën 02.12.2013 deri 31.12.2017
L. Y me detyrë inspektor terreni për periudhën 18.06.2007 deri 31.12.2017
E. P me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.04.2015 deri 31.12.2017
P. R me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.10.2015 deri 31.12.2017
M. P me detyrë inspektor terreni NjA Novoselë periudha 14.10.15-31.12.2017
O. A. me detyrë inspektor terreni NjA Novoselë periudha 14.10.2015-31.12.2017

P. L me detyrë inspektor terreni NjA Qendër periudha 14.10.2015-31.12.2017
M. L me detyrë inspektor terreni NjA Shushicë periudha 14.10.2015-31.12.2017
V. P. me detyrë inspektor terreni NjA Shushicë periudha 14.10.2015-31.12.2017.

*-Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë, për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektesh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj. dhe për këto qëllime janë pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Vlorë.
Nga subjektet e ndërtimit është ushtruar aktivitet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në objekte të ndryshme për periudhën e vitit 2015, të vitit 2016 dhe të vitit 2017 të cilat janë trajtuar në akt konstatim dhe në projekt raportin e auditimit ku paraqiten emri dhe mbiemri i zhvilluesit, numri dhe data e lejes së ndërtimit, vendndodhja e objektit ku janë kryer punime ndërtimi, subjekti i ndërtimit, sipërfaqja e truallit dhe sipërfaqja e ndërtimit.
Konstatohet se kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit dhe janë pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Vlorë 56 subjekte. Nga inspektorët e taksave dhe tarifave vendore nuk është vepruar që, për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektesh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj. dhe për këto qëllime janë pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Vlorë, të nxjerrin njoftim detyrimi për tarifën e ndriçimit, të pastrimit dhe tarifën e gjelbërimit në masën prej 40,000 lekë/vit.
Bazuar në evidencën e subjekteve që kanë ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë për periudhën e viteve 2015, 2016 dhe vitin 2017 pasqyrohen në aneksin 5/5, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Pasqyra e subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë pajisur me leje ndërtimi, që nuk është aplikuar tarifa e ndriçimit, pastrimit dhe e gjelbërimit, për periudhën 01.01.2015-31.12.2017, trajtuar në akt konstatim dhe në Projekt Raportin e Auditimit.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
*Nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën e ndriçimit, të pastrimit dhe tarifën e gjelbërimit në masën prej 40,000 lekë/vit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Vlorë dhe Njësive administrative në vartësi dhe janë pajisur me leje ndërtimi për objekte të ndryshme private, ku për 51 subjekte ndërtimi nuk janë ngarkuar me detyrime me këto tarifa, sipas aneksit nr.5/5, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.44, datë 28.12.2015, protokolluar me nr.10, datë 05.01.2016, kreu i Tarifave Vendore pika 3, germa "c" nënpika 6, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Vlorë në vlerën 2,240,000 lekë.*

**Ngarkohen me përgjegjësi**:
T. Z. me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar.
LL. M me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.10.2015 deri 31.12.2017.
K. M me detyrë inspektor terreni për periudhën 11.05.2004 deri 31.12.2017.

D. K me detyrë inspektor terreni për periudhën 02.12.2013 deri 31.12.2017.
L. Y me detyrë inspektor terreni për periudhën 18.06.2007 deri 31.12.2017.
E. P me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.04.2015 deri 31.12.2017.
P. R me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.10.2015 deri 31.12.2017.
M. P me detyrë inspektor terreni NjA Novoselë periudha 14.10.2015-31.12.2017.
O. A. me detyrë inspektor terreni NjA Novoselë periudha 14.10.2015-31.12.2017.
A. L me detyrë inspektor terreni NjA Orikum periudha 14.10.2015-31.12.2017.
F. B me detyrë inspektor terreni NjA Orikum periudha 15.10.2015-31.12.2017.
H. K me detyrë inspektor terreni NjA Orikum periudha 15.10.2015-31.12.2017.
P. L me detyrë inspektor terreni NjA Qendër periudha 14.10.2015-31.12.2017.

*-Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si dhe nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë, për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektesh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj. dhe për këto qëllime janë pajisur me Leje Ndërtimi dhe kanë përfunduar afatet e ndërtimit të punimeve të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi objekti ose leje përdorimi objekti nga Bashkia Vlorë.
Nga subjektet e ndërtimit është ushtruar aktivitet për kryerjen e punimeve të ndërtimit në objekte të ndryshme për periudhën e vitit 2015, të vitit 2016 dhe të vitit 2017 të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi objekti ose leje përdorimi objekti nga Bashkia Vlorë, paraqiten në tabelën në vijim. Gjithashtu në tabelën në vijim paraqiten emri dhe mbiemri i investitorit, numri dhe data e lejes së shfrytëzimit ose lejes së përdorimit, vendndodhja e objektit ku janë kryer punime ndërtimi dhe vlera për tarifën e ndriçimit, të pastrimit dhe tarifën e gjelbërimit në masën prej 40 000 lekë në vit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë pajisur me leje shfrytëzimi për objekte të ndryshme në territorin e Bashkisë Vlorë dhe Njësive administrative në vartësi.
Pasqyra e lejeve të shfrytëzimit periudha 01.01.2015 deri 31.12.2017, paraqiten sipas Aneksit nr.5/6 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
*Nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën e ndriçimit, të pastrimit dhe tarifën e gjelbërimit në masën prej 40,000 lekë/ vit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë pajisur me leje shfrytëzimi për objekte të ndryshme në territorin e Bashkisë Vlorë dhe Njësive administrative në vartësi, ku për 42 subjekte ndërtimi nuk janë ngarkuar me detyrime për këto tarifa, sipas aneksit nr.5/6, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.44, datë 28.12.2015, protokolluar me nr.10, datë 05.01.2016, kreu i Tarifave Vendore pika 3, germa "c" nënpika 6/1/1 dhe 6/1/3, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Vlorë* ***në vlerën 1,640,000 lekë.***

**Ngarkohen me përgjegjësi**:
T. Z. me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar.
LL. M me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.10.2015-31.12.2017
K. M me detyrë inspektor terreni për periudhën 11.05.2004-31.12.2017
D. K me detyrë inspektor terreni për periudhën 02.12.2013-31.12.2017
L. Y me detyrë inspektor terreni për periudhën 18.06.2007-31.12.2017

E. P me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.04.2015-31.12.2017
P. R me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.10.2015-31.12.2017
M. P me detyrë inspektor terreni NjA Novoselë periudha 14.10.15-31.12.2017
O. A. me detyrë inspektor terreni NjA Novoselë periudha 14.10.15- 31.12.2017
P. L me detyrë inspektor terreni NjA Qendër periudha 14.10.15-31.12.2017.

*-Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Drejtoria e Menaxhimi Financiar, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë, për subjektet e përcaktuara me kërkesën e datë 01.02.2018 drejtuar Bashkisë për paraqitje dosje subjektesh të biznesit të vogël, pasqyrat nr.1, nr.2 dhe nr.3, u krye auditimi për vendosjen, aplikimin e taksës së truallit nga Bashkia Vlorë. Në auditimin e kryer për subjektet me aktivitet tregti, bare, restorante dhe të hotelerisë, që kanë detyrimin për pagesë e taksës së truallit, për periudhën e viteve 2016-2017, konstatohet se, nga inspektorët e sektorit të Taksave dhe Tarifave vendore nuk është aplikuar vlera e taksës së truallit për qëllime biznesi të subjektet të hotelerisë dhe të bareve e restoranteve të cilat kanë detyrimin për të paguar taksën truallit, të cilat janë trajtuar në akt konstatim dhe në Projekt Raportin e Auditimit.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
*Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Vlorë, nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën e taksës së truallit për qëllime biznesi për 11 subjekte që kanë detyrimin për të paguar, sipas Aneksit nr.5/7, në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Kreu II, nenit 9, pika 2; neni 21, pika 2; neni 23/1; dhe të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.44, datë 28.12.2015, protokolluar me nr.10, datë 05.01.2016, kreu i Tarifave Vendore pika 2, germa "c", me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Vlorë, sipas aneksit nr.5/7,* ***në vlerën 169,960 lekë.***

**Ngarkohen me përgjegjësi**:
XH. K me detyrë inspektore e Sektorit të Taksave e Tarifave Vendore.
A. L me detyrë inspektor terreni Nj A Orikum
F. B me detyrë inspektor terreni Nj A Orikum
H. K me detyrë inspektor terreni Nj A Orikum

*III/5.1.3.-Krijimi i regjistrit të tatim paguesve në mënyrë manuale dhe elektronike. Kontrollet e bëra për grumbullimin e taksave, rakordimi me agjentët tatimorë, problemet e dala dhe masat e mar*ra;

Nga zyra e tatim taksave dhe tarifave vendore janë hapur regjistrat në mënyrë manuale dhe elektronike ku janë regjistruar të gjithë tatim paguesit që kanë detyrimin për pagimin e taksave dhe tarifave vendore. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga personeli i Drejtorisë së të Ardhurave të Bashkisë, u përzgjodhën për auditim 70 subjekte me aktivitet të ndryshme, të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, për përcaktimin dhe llogaritjen detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore si për tarifën e pastrimit urban, për tarifën e ndriçimit, për tarifën e gjelbërimit, për taksën e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi, për taksën mbi ndërtesën. Për periudhën objekt auditimi nga data 01.01.2015 deri 31.12.2017 nga inspektorët e taksave dhe tarifave vendore nuk është vepruar për të dërguar shkresë për secilin subjekt që kanë sipas ndarjes administrative territoriale, ku të përcaktohej detyrimi për çdo taksë apo tarifë vendore që tatim paguesi detyrohet për të paguar për llogari të bashkisë. Kjo praktikë nuk është zbatuar dhe nuk është në praktikën e punës së çdo inspektori që në fillim të çdo viti të njoftojë të gjithë subjektet taksa pagues për llojet e detyrimeve dhe afatin ose kohën e pagesës që duhet të kryej në bankat e nivelit të dytë.

Nga administrata tatimore e bashkisë dhe e Njësive Administrative nuk janë plotësuar njoftimet e detyrimit dhe nuk u janë dërguar në rrugë postare subjekteve tatimpagues, që kanë detyrimin ligjor për të paguar, taksat dhe tarifat vendore si, për tarifën e pastrimit urban, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës dhe për taksën mbi ndërtesat dhe për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Neni 23 Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin, pika 2 ku citohet: "Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare, drejtuar tatimpaguesit, i dërgohen në adresën e shënuar në dosjen e tatimpaguesit, duke përdorur shërbimin postar rekomande".

-Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk është bërë miradministrimi i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të Biznesit të Vogël, për të gjitha detyrimet tatimore dhe nuk janë vendosur në dosjen e çdo tatim paguesi, ka mangësi përditësimi të dhënave dhe mungesë të dokumentacionit, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim, me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Neni 29 Dosja e detyrimeve tatimore, pika 1, ku citohet : "Administrata tatimore krijon dhe përditëson dosjen e detyrimeve tatimore, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit".

-Pas kryerjes së reformës administrative dhe kalimi i aktivitetit të bizneseve në Bashkinë e madhe Vlorë nga punonjësit zyrës së taksave të ish Bashkisë Orikum dhe ish-Komunave Qendër, Novoselë dhe Shushicë, të cilët janë larguar apo janë emëruar të rinj, nuk kanë marrë detyrën dhe listat apo dosjet e bizneseve me proces verbal. Nuk kanë dorëzuar detyrën pas shkrirjes së tyre me procesverbal, pra numrin e bizneseve me Inventar në Zyrën e Bashkisë Vlorë, si: dosjet e bizneseve, (etj. kontrata) regjistrat e tatimpaguesve, pasqyrën e debitorëve të krijuar sipas viteve, llojin e aktivitetit, ngarkesat dhe arkëtimet veçanërisht debitorët e taksës së tokës të cilët nuk disponohen me lista emër për emër, detyrimi dhe pagesa për secilin vit, të cilët zëne një volum të madh pune, veprime në shkelje të VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 47, datë 30.06.2015 "Për procedurat e mbylljes së llogarive të njësive të qeverisjes vendore që do të shkrihen", Udhëzimi i përbashkët i ministrit për çështjet vendore dhe Ministrit të Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 "Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial", si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap I. Të Përgjithshme-përgjegjësitë e menaxhereve te tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike, -Pika 13. "Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit te përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues I njësisë respektive sipas specifikave te aktiveve. Kur këta punonjës nuk mund të jenë të pranishëm për shkaqe objektive, dorëzimi bëhet në prani të një komisioni të caktuar nga nënpunësi autorizues duke thirrur edhe një anëtar madhor të familjes së tyre. Kur punonjësit kundërshtojnë, dorëzimi bëhet vetëm në prani të komisionit".-Pika 10. "Çdo menaxher, nëpunës apo punonjës i njësisë publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar te tyre sipas kompetencave qe mbulon".

-Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk është vepruar për inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi e konkretisht:
-të gjitha praktikat nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit. -i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë. -praktikat e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim, me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" neni 24, dhe me rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave "Për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" kapitulli II-Rregulla për punën me dokumentet administrative në subjektet shtetërore dhe jo shtetërore, neni 21dhe neni 27.

*III/5.1.4-Gjendja e debitorëve për taksat vendore, në numër dhe vlerës, sipas bizneseve, taksës tokës, taksat e popullatës, etj.;*
Në auditimin e evidencave të paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se gjendja e debitorëve për periudhën 2015 -2017, paraqitet sipas pasqyrës si vijon:
Pasqyra e gjendjes së debitorëve në fund të çdo viti 2015,2016 dhe 2017. Në 000 / lekë

| EMËRTIMI | 31.12.2015 | | 31.12.2016 | | 31.12.2017 | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Vlerë | Nr. | Vlerë | Nr. | Vlerë |
| Biznesi Vogël | 564 | 129,777,502 | 474 | 114,625,301 | 443 | 102,151,809 |
| Biznes i Madh | 2099 | 125,862,817 | 2245 | 132,408,963 | 2427 | 141,396,636 |
| TOTALI | 2663 | 255,640,318 | 2719 | 247,034,264 | 2870 | 243,548,445 |

Lista analitike e debitorëve të biznesit të vogël dhe të biznesit të madh, për periudhën e viteve 2015, 2016 dhe vitin 2017, duke qenë se janë voluminoze nuk u printua nga ana e grupit të auditimit, por janë mbajtur në format Exel, nga zyra e tatim taksave vendore.

Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2017.

| Nr | Emërtimi | Viti | Gjendja Në fillim | Regjistrime Reja | Mbyllur Aktivit | Gjendja në fund të Vitit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| (1+2) | Totali Bizneseve | 2015 | 2987 | 722 | 496 | 3638 |
| | | 2016 | 3571 | 394 | 450 | 3761 |
| | | 2017 | 3692 | 337 | 354 | 3643 |

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se niveli i debitorëve në numër dhe në vlerë paraqitet pothuajse me ndryshime shumë të vogla. Në vitin 2015 nga 3638 subjekte aktive gjendje në fund të vitit, janë debitorë 2663 subjekte ose 73,1%. Në vitin 2016 nga 3761 subjekte aktive gjendje ne fund të vitit, janë debitorë 2719 subjekte ose 72,3%.Në vitin 2017 nga 3,643 subjekte aktive gjendje në fund të vitit, janë debitorë 2,197 subjekte ose 78,8% .
Të dhënat e mësipërme flasin për një performancë jo të mirë të nivelit të arkëtimeve nga Drejtoria e Tarifave Vendore Bashkia Vlorë.
Pasqyra e debitorëve për familjet për taksën e tokës bujqësore, banesave, pastrimit, ndriçim dhe gjelbërim sipas Njësive Administrative, periudha 2015-2017 dhe përmbledhësja e detyrimeve për

familjarët sipas Njësive Administrative periudha 2015-2017, paraqitet në anekse të veçanta bashkangjitur Projekt Raportit.

*III/5.1.5.-Nëse për familjet të cilat nuk paguajnë taksat është nxjerrë njoftim vlerësimi dhe bërë njoftimi sipas pikës 52, të Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03,datë 17.01.2014 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014";*

Sipas evidencave të nxjerra nga Drejtoria e Tatim Taksave Vendore konstatohet se detyrimet e papaguar për taksat për familjet paraqiten në pasqyrën në vijim:

Përmbledhja e debitorëve për familjarët sipas Njësive Administrative periudha 2015-2017.

| Nr | Njësia Administrative | Viti 2015 | | Viti 2016 | | Viti 2017 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nr Familje | Vlera lekë | Nr Fam | Vlera lekë | Nr Fam | Vlera lekë |
| 1 | Bashkia Vlorë | 375 | 355,387 | 1055 | 424,800 | 1087 | 815,110 |
| 2 | Nj A Novosel | 3976 | 15,949,037 | 3073 | 6,851,720 | 2934 | 13,648,790 |
| 3 | Nj A Orikum | 1404 | 16,304,424 | 1384 | 7,276,520 | 1490 | 14,463,900 |
| 4 | Nj A Shushicë | 1855 | 42,081,662 | 2143 | 9,162,050 | 2165 | 9,244,550 |
| 5 | Nj A Qendër | 2151 | 9,416,950 | 1246 | 3,991,000 | 2549 | 7,999,840 |
| | TOTALI | 7931 | 84,107,460 | 8901 | 27,706,090 | 10225 | 86,377,784 |

Nga administrata tatimore e bashkisë dhe e Njësive Administrative nuk janë plotësuar njoftimet e detyrimit dhe nuk u janë dërguar në rrugë postare subjekteve tatimpagues, që kanë detyrimin ligjor për të paguar, taksat dhe tarifat vendore si, për tarifën e pastrimit urban, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës, për taksën mbi ndërtesat dhe taksën e tokës bujqësore, për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues. Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Neni 23 Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin, pika 2 ku citohet: " Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare, drejtuar tatimpaguesit, i dërgohen në adresën e shënuar në dosjen e tatimpaguesit, duke përdorur shërbimin postar rekomande".

*III/5.1.6-Nëse nga ana e Bashkisë apo Njësisë Administrative, janë lidhur kontratat për shfrytëzimin e sipërfaqes dhënë sipas Lejeve Minerare, apo Lejeve Koncesionare për pasurinë në administrim të tyre;*

Bazuar në dokumentet e Lejeve Minerare të dhëna nga Ministria e Energjetikës që ndodhen në territorin e Bashkisë Vlorë, të ish Bashkisë Orikum, të ish Komunës Shushicë dhe ish Komunës Qendër Vlorë, për periudhën 01.01.2013 – 31.12.2017, u krye auditimi për arkëtimin e të ardhurave nga qiratë për sipërfaqet e tokave pyjore e kullosore që ndodhen në territorin e Bashkisë Vlorë dhe të ish Komunave sot Njësi Administrative në vartësi të bashkisë Vlorë.

Nga auditimi i kryer për procedurat e dhënies me qira të objekteve pronë e bashkisë dhe e ndërmarrjeve shtetërore në varësi ose nën juridiksionin e bashkisë, u auditua dokumentacioni për periudhën 01.01.2013 deri më datën 31.12.2017, në lidhje me dhënien me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, nga ku konstatohet se nga Bashkia Vlorë dhe ish Bashkia Orikum, ish Komuna Shushicë dhe ish Komuna Qendër Vlorë, nuk është vepruar për të dhënë me qira, sipërfaqet pyjore dhe kullosore për të cilat të lidhte kontrata qiraje, të cilat janë miratuar me leje nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë me subjektet e trajtuara në Aneksin nr.1 bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit.

Subjekti "K.....e" me Leje nr. 964, datë 04.09.2006, me vendndodhje Njësia Administrative Orikum, lloji i lejes "Shfrytëzim", sipërfaqja që shfrytëzohet 43 ha * 78,000 lekë / ha / vit =detyrimi vjetor 3,354,000 lekë* 5 vjet = Totali vlera 16,770,000 lekë me pasojë, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.
Subjekti "C.....n" me Leje nr. 1066, datë 20.08.2007, me vendndodhje Njësia Administrative Orikum, lloji i lejes "Shfrytëzim", sipërfaqja që shfrytëzohet 20 ha * 440,000 lekë / ha / vit =detyrimi vjetor8,800,000 lekë* 5 vjet = Totali vlera 44,000,000 lekë me pasojë, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.
Subjekti "A.....a" me Leje nr. 1132, datë 08.01.2008, me vendndodhje Njësia Administrative Orikum lloji i lejes "Shfrytëzim", sipërfaqja që shfrytëzohet 2,5 ha * 78,000 lekë / ha / vit =detyrimi vjetor 195,000 lekë * 5 vjet = Totali vlera 975,000 lekë me pasojë, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.
Subjekti "A.....N" sh p k me Leje nr.1538, datë 04.03.2011, me vendndodhje Njësia Administrative Shushicë lloji i lejes "Shfrytëzim", sipërfaqja që shfrytëzohet 15 ha * 440,000 lekë / ha / vit =detyrimi vjetor 6,600,000 lekë* 5 vjet = Totali vlera 33,000,000 lekë me pasojë, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.
Subjekti "K.....n" me Leje nr. 1550, datë 06.01.2012, me vendndodhje Njësia Administrative Orikum lloji i lejes "Shfrytëzim", sipërfaqja që shfrytëzohet 48,1 ha * 440,000 lekë / ha / vit =detyrimi vjetor 21,164,000 lekë* 5 vjet = Totali vlera 105,820,000 lekë me pasojë, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë.
Subjekti "G.....n" me Leje nr. 1786, datë 24.12.2015, me vendndodhje Njësia Administrative Qendër, lloji i lejes "Shfrytëzim", sipërfaqja që shfrytëzohet 41,7 ha * 440,000 lekë / ha / vit =detyrimi vjetor 18,348,000 lekë* 2 vjet = Totali vlera 36,696,0000 lekë me pasojë, të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Vlorë. Veprimi dhe mosveprimi është në shkelje të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2 "Tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjorë dhe kullosorë publik për ushtrimin e veprimtarive", pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë), tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit, 6-10 vjet, Inproduktive është 440 000 lek/ha/vit dhe pika 9. Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe Pyll cungishte, Pyll shkurre, Kullota, tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit, 6-10 vjet është 78,000 lek/ha/vit.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
*-Nga Bashkia Vlorë, ish Bashkia Orikum, ish Komuna Shushicë dhe ish Komuna Qendër Vlorë, nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, duke bërë që buxheteve të këtyre njësive vendore t'ju mungojnë të ardhurat me një vlerë prej 237,261,000 lekë, sipas Aneksit nr.5/1, në kundërshtim me VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6 dhe 9.*

**Ngarkohen me përgjegjësi**:
G. Ç. me funksion ish Kryetar i Bashkisë Orikum.
F. B. me funksion ish- Kryetar i Komunës Qendër.

L. P me funksion ish- Kryetar i Komunës Shushicë.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Shpjegimet e paraqitura me shkresën nr.1201/4 prot. datë 06.04.2018 protokolluar në KLSH me nr.1029/11 prot, datë 10.04.2018 të paraqitur nga D. L., G. C, F. B dhe L. P, ku citoni: -Përfundimi i mësipërm i grupit të auditimit është i interpretueshëm dhe duhet të konsultohet me juristë/specialistë tjerë që merre me këtë çështje. Njëkohësisht Bashkia Vlorë gjykon që ti drejtohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për sqarimin e kësaj problematike.....*
*-Veprimtaria minerare rregullohet nga ligji nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar ....neni 24, pika 10.....zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore dhe kalon si pasuri minerare në vartësi të ministrisë së linjës, sipas legjislacionit në fuqi .....*
*-Nga grupi i auditimit shpjegimet e dhëna nuk merret në konsideratë pasi në lejet minerare të dhëna nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, përcaktohet se është në territorin e Bashkisë Vlorë dhe pyjet dhe Kullotat kanë kaluar në përdorim ose në pronësi të Bashkisë me VKM përkatëse. Nisur nga fakti se pyjet dhe kullotat që ndodhen në territorin e Bashkisë Vlorë, ju jeni të detyruar të lidhni kontrata qiraje për sipërfaqet pyjore apo kullosore sipas rastit, bazuar kjo në kërkesat e VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6 dhe 9.*

*III/5.1.7.-Zbatimin e procedurave ligjore në arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për taksave e tarifave vendore, në zbatim të neneve 90 dhe 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;*

Sipas dokumenteve të paraqitura nga Drejtoria e Tatim Taksave konstatohet se detyrimet progresive për tatim taksat lokale deri më datën 31.12.2016, sipas llojit të detyrimeve dhe njësive administrative, sipas të dhënave që na u paraqitën, është në shumën totale për 445,633 mijë lekë, nga 2846 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël, 11,452 familje për taksën e tokës bujqësore dhe 46,434 familje ose numër kontrata të ujësjellësit për taksat familjare, e detajuar jepet sipas të dhënave të pasqyrës që vijon në 000/lekë:

| Njësia | Nr. Bizneseve. Shuma debitorë 000/ lekë | | | | Taksë tokë bujqësore | | T. ndërtesë dhe T. Familjare | | Shuma 000/lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. Biznese ushtruar aktivitet 2016 | | Gjithsej numër biznese debitorë (Madh Vogël) | Debi progresive 000/Lekë | Nr. familje | Debitorë 000/Lekë | Nr. Familje (Kontrata ujësjellësi) | Debi 000/ Lekë | |
| | B. Madh | B. Vogël | | | | | | | |
| Vlora | 804 | 2999 | 2719 | 247,034 | 1100 | 424 | 41515 | 43683 | 291,141 |
| Orikumi | 35 | 280 | 30 | 12,901 | 1,907 | 18,834 | 1586 | 1,610 | 33,345 |
| Novosele | 29 | 142 | 42 | 5,831 | 2,965 | 57,212 | 2013 | 1,151 | 64,194 |
| Shushicë | 5 | 64 | 35 | 670 | 1960 | 41,390 | 461 | 308 | 42,368 |
| Qendër | 28 | 161 | 20 | 1,015 | 3520 | 13,407 | 859 | 163 | 14,585 |
| Shuma | 901 | 3,646 | 2,846 | 267.451 | 11,452 | 131,267 | 46,434 | 46,915 | 445,633 |

Për vjeljen e detyrimeve për tatim taksat nga bizneset, nga ana e Sektorit të Borxhit, u janë bërë njoftim subjekteve dhe më pas janë dërguar shkresa për bllokimin e llogarive Bankare, për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, ZVRPP për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit. Lidhur me këto masa, na u paraqitën të dhëna për dërgim shkresë këtyre subjekteve.

Për debitorët e viti 2015, u janë dërguar shkresa në vitin 2016 këtyre institucioneve për 1216 subjekte debitorë me vlerë të debisë 189,834,274 lekë.

Në vitin 2017, u janë dërguar shkresat pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, ZVRPP për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit për 891 subjekte debitorë me vlerë të debisë për 119,826,912 lekë. Nga këto është nxjerrë masa e ekzekutimit në bankë për 186 subjekte me vlerë të debisë 39,697,804 lekë, nga të cilat janë arkëtuar vlera 12,093,154 lekë. Këto masa, shtrënguese administrative, janë vetëm për Njësitë Administrative të Bashkisë Vlorë, pa ato të Njësive Administrative ish Komunat.

Për debitorët në ish Komunat; Orikum, Novoselë, Shushicë dhe Qendër, nuk janë masa administrative shtrënguese.

Sipas dokumenteve të inspektorëve të terrenit konstatohet se:

-Për 1087 subjekte debitorë janë pa shpresë arkëtimi, pasi për tre vjet rresht gjatë kontrollit në subjekt ka rezultuar se subjekti ka mbyllur aktivitetin por nuk është çregjistruar në QKB, si dhe konstatohet se për 4 vjet rresht nuk kanë asnjë pagesë nga detyrimet e prapambetura.

-Për 197 subjekte debitorë me vlerë rreth 25,000 mijë lekë rezultojnë si të tillë(debitorë) për tre vite rresht, radhazi.

-Për 1087 subjekte debitorë janë pa shpresë arkëtimi, pasi për tre vjet rresht gjatë kontrollit në subjekt ka rezultuar se subjekti ka mbyllur aktivitetin por nuk është çregjistruar në QKB, si dhe konstatohet se për 4 vjet rresht nuk kanë asnjë pagesë nga detyrimet e prapambetura.

Për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura(borxhit) gjatë dy viteve 2016 dhe 2017 si rezultat e masave shtrënguese janë arkëtuar vlerat si vijon:

| Nr | Llojet e Masave | Vlera e arkëtuar e borxhit viti 2016 në 000 lekë | Vlera e arkëtuar e borxhit viti 2017 në 000 lekë |
|---|---|---|---|
| 1 | Njoftim për pagesë | 16,183 | 15,221 |
| 2 | Masa shtrënguese U Bllokim Banke, ZVRPP etj. | 34,285 | 26,549 |
| 3 | Urdhra ekzekutive | 11,584 | 13,449 |
| | TOTALI | 62,052 | 55,219 |

-Nga sektori i Taksave dhe tarifave vendore nuk ka dokumente që ti jetë kërkuar në Këshillin e Bashkisë, ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitor, siç parashikohet në nenin 5, shkronja "ç" nënpika "iii", të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore". Gjendja e debitorëve për tatim taksat lokale, nuk pasqyrohen në kontabilitetin e financës së Bashkisë Vlorë dhe rrjedhimisht nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare të fund vitit 2016, kjo me pretendimin se kontabiliteti i tyre ndiqen nga njësia e specializuar për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat lokale. Për vjeljen e detyrimeve debitorë, nuk është vazhduar për vjeljen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve, nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të

biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal sipas kërkesave të nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008" Për Procedurat tatimore në R.SH" ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

*III/5./1.9.-Në se ndaj subjekteve debitorë të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, janë llogaritur kamat vonesat gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë, bazuar në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH ", i ndryshuar.*

Sipas evidencave të taksave dhe tarifave vendore si dhe nga verifikimi në zyrën e kontabilitetit të sektorit të taksave konstatohet se, për detyrimet të cilat nuk janë paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimet e Këshillit Bashkiak, për periudhën e viteve 2015-2017, nuk është llogaritur dhe arkëtuar gjoba prej 0.06% për qind të shumës së detyrimit të papaguar. Për detyrimet të cilat nuk janë paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimet e Këshillit Bashkiak, nuk është llogaritur dhe arkëtuar gjoba prej 0.06% për qind të shumës së detyrimit të papaguar gjendje 31.12.2016, në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 114, pika 1, nga përllogaritjet e kryera rezulton, (detyrimi 244,704,685 lekë *0.06% * 365 ditë= 53,590,326 lekë) me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Vlorë, në vlerën 53,590,326 lekë. Veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Neni 114 Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit pika 1 ku citohet: "Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike".

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
*Detyrimet debitorë të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2015 janë në vlerën 255,355 mijë lekë nga 2,663 subjekte, me 31.12.2016 janë në vlerën 244,705 mijë lekë nga 2668 subjekte me 31.12.2017 janë në vlerën 193,002 mijë lekë nga 2197 subjekte.*
*Detyrimet debitorë të taksës së tokës bujqësore gjendje me 31.12.2015 janë në vlerën 84,107 mijë lekë nga 7,931 familje, më 31.12.2016 janë në vlerën 27,706 mijë lekë nga 8,901 familje, më 31.12.2017 janë në vlerën 86,378 mijë lekë nga 17,366 familje.*
*-Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk janë plotësuar njoftimet e detyrimit, nuk u janë dërguar në rrugë postare të gjithë subjekteve tatimpagues, që kanë detyrimin ligjor për të paguar, taksat dhe tarifat vendore si, për tarifën e pastrimit urban, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës dhe për taksën mbi ndërtesat dhe për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 23, pika 2.*
*-Nga administrata tatimore e bashkisë, nuk është vepruar për inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi si të gjitha praktikat nuk shoqërohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit, i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë, praktikat e*

*përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit, në kundërshtim, me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" neni 24, dhe me Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, kapitulli II, nenet 21,27.*
*-Nga punonjësit e ish Komunave Qendër, Novoselë dhe Shushicë, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Vlorë, me kryerjen e reformës administrative dhe kalimin e aktivitetit të bizneseve në Bashkinë e madhe Vlorë, nuk kanë dorëzuar dhe nuk i kanë dokumentuar me procesverbal me komision, dokumentacionin e bizneseve si dosjet e bizneseve me ngarkesat e detyrimeve përkatëse, regjistrat e tatim paguesve, pasqyrën e debitorëve të krijuar sipas viteve, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", pikat 1,2,3,4,5 të Kreut V, VKM nr.171,datë 26.03.2014" Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë pezullimin dhe lirimin", pikat 50,51,52, Urdhri i MF nr. 47, datë 30.06.2015 "Për procedurat e mbylljes së llogarive të njësive të qeverisjes vendore që do të shkrihen", Udhëzimin e përbashkët të Ministrit për çështjet vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 "Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial".*
*-Nga administrata tatimore e bashkisë, për detyrimet të cilat nuk janë paguar në afatet e përcaktuara në ligj dhe në Vendimet e Këshillit Bashkiak, nuk është llogaritur dhe arkëtuar gjoba prej 0.06% për qind të shumës së detyrimit të papaguar gjendje 31.12.2016, në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 114, pika 1, nga përllogaritjet e kryera rezulton, (detyrimi 244,704,685 lekë *0.06% * 365 ditë= 53,590,326 lekë) me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Vlorë, në vlerën 53,590,326 lekë.*

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**
T. Z. me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit Financiar.
LL. M me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.10.2015 deri 31.12.2017
K. M me detyrë inspektor terreni për periudhën 11.05.2004 deri 31.12.2017
D. K me detyrë inspektor terreni për periudhën 02.12.2013 deri 31.12.2017
L. Y me detyrë inspektor terreni për periudhën 18.06.2007 deri 31.12.2017
E. P me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.04.2015 deri 31.12.2017
P. R me detyrë inspektor terreni për periudhën 14.10.2015 deri 31.12.2017
F. LL. me detyrë inspektor borxhi për periudhën 14.10.2015 deri 31.12.2017
A. Z. me detyrë inspektor borxhi për periudhën 15.12.2013 deri 31.12.2017
M. P me detyrë inspektor terreni Nj A Novoselë periudha 14.10.2015-31.12.2017
O. A. me detyrë inspektor terreni Nj A Novoselë periudha 14.10.2015 - 31.12.2017
A. L me detyrë inspektor terreni Nj A Orikum, periudha 14.10.2015 - 31.12.2017
F. B me detyrë inspektor terreni Nj A Orikum periudha 15.10.2015 - 31.12.2017
H. K me detyrë inspektor terreni Nj A Orikum periudha 15.10.2015 - 31.12.2017
P. L me detyrë inspektor terreni Nj A Qendër periudha 14.10.2015 - 31.12.2017
M. L me detyrë inspektor terreni Nj A Shushicë periudha 14.10.2015-31.12.2017
z. V. P. me detyrë inspektor terreni Nj A Shushicë periudha 14.10.2015-31.12.2017

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Shpjegimet e paraqitura me shkresën nr.1201/4 prot. datë 06.04.2018 protokolluar në KLSH me nr.1029/11 prot, datë 10.04.2018 të paraqitur nga specialistët e tatim taksave vendore ku citohet se: .....kamat vonesat në masën prej 0.06% trajtuar në faqen 236 sqarojmë se në vitin 2017 është futur programi i USAID me emërtim "sistem të taksave vendore" i cili llogarit automatikisht detyrimet dhe penalitetit.*
*-Nga grupi i auditimit shpjegimet e dhëna nuk merret në konsideratë pasi kamat vonesat e përllogaritura nga grupi i auditimit janë për periudhën para vitit 2017*

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 215-239, të Projekt raport Auditimit)*

**III/5.2. Organizimi dhe funksioni i Policisë Bashkiake**

Sipas dokumenteve të paraqitur nga Kryeinspektori i Policisë Bashkiake dhe zyra e Burimeve Njerëzore për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake, të dosjeve dhe praktikave dokumentare për emërimet, vlerësimet me zgjedhje për efektivitetin e veprimtarisë kontrolluese të Policisë së Bashkiake, në zbatimin e urdhrave ekzekutive të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë, në marrjen e masave për ruajtjen e pasurisë, zbatimet e urdhrave për arkëtimin e detyrimeve për subjektet e parregullta, që nuk paguajnë detyrimet financiare dhe fiskale, në parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe detyra të tjera të përcaktuara me ligj, në zbatim të Ligjit nr. 8224, 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë", ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.03.1997, të VKM nr. 313, datë 01.07.2002 "Për caktimin e strukturës, numrit të punonjësve dhe të shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë", të Urdhrit të përbashkët të Ministrisë Rendit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal nr. 823, datë 11.04.2003 "Për miratimin e rregullores "TIP" të Policisë Bashkiake dhe të Komunës", për periudhën 01.01.2015 -31.12.2018, sipas nënpikave trajtohen si në vijim:

*III/5.2.1.-Emërimi i punonjësve të policisë Bashkiake nëpërmjet komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve, formimi nëpërmjet Akademisë Rendit Publik, dhe në se kanë kualifikimin e nevojshëm dhe plotësojnë kërkesat e përcaktuara në urdhrin e përbashkët të dy Ministrive*;

Në lidhje me emërimin e punonjësve të policisë Bashkiake nëpërmjet komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve, formimi nëpërmjet Akademisë Rendit Publik, dhe në se kanë kualifikimin e nevojshëm dhe plotësojnë kërkesat e përcaktuara në urdhrin e përbashkët të dy Ministrive, në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës", ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998, në Bashkinë Vlorë, është organizuar dhe funksionon Policia e Bashkisë, struktura e Policisë Bashkiake është organizuar edhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.313, datë 01.07.2002 "Për caktimin e strukturës të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë Bashkiake dhe të Komunës", ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës, në administratën e publike" dhe ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar. Policia Bashkiake funksionon dhe mbi bazën e Rregullores të Bashkisë Vlorë, për proceset dhe operacionet e punës për çdo pozicion punë, e cila është miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 29.03.2012, ku janë përcaktuar misioni, detyrat dhe të drejtat e të gjithë punonjësve, në mbështetje të "Rregullores së brendshme "TIP" e Policisë së Bashkisë dhe Komunës", të miratuar me urdhrin e përbashkët të dy ministrive, si ish Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe ish Ministria e Rendit Publik.

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2015 deri 31.12.2017, është krijuar dhe funksionon Policia Bashkiake e përbërë nga 23 (njëzetetre) punonjës, sipas Aneksit 5/9 bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit.
Emërimi i punonjësve të policisë, nuk është bërë në referim të dispozitave ligjore të përcaktuara me nenin 5 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, nuk është krijuar komisioni i posaçëm, i përbërë nga punonjësi i Bashkisë, i deleguari i prefektit, si dhe një përfaqësues i komisariatit të policisë (i plotfuqishmi i zonës), si dhe bazuar në pikën 2 të nenit 11 të urdhrit të përbashkët të MPVD nr. 1530 datë 07.4.2003" dhe MRP, nr. 823 datë 11.4.2003 "Për miratimin e rregullores "TIP" të policisë bashkiake dhe të Komunës", përzgjedhja e kandidatëve nuk është bërë me komision dhe procedurë testimi. Emërimi tyre është bërë pa kryer formimin në Akademinë e Rendit Publik, përveç Kryeinspektorit i cili rezulton të këtë mbaruar Akademinë e lartë të Marinës dhe një punonjësi policie me formimin në Akademinë e Rendit, Instituti i Policisë "A Zylyftari". Nga të dhënat e drejtorisë së Burimeve Njerëzore, konstatohet se 19 policët e marrë në punë, janë me shkollë të mesme por të gjithë janë pa formim policor, pa kurse ose shkollë policie.
Marrëdhëniet e punës janë të rregulluar sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodit të Punës", i ndryshuar, duke lidhur kontratë individuale pune mes punëdhënësit Bashkia Dropull dhe punëmarrësit, si dhe sipas ligji nr. 8224, datë 15.5.1997"Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës" i ndryshuar, neni 11, pika 7 i cili përcakton se periudha e kontratës duhet të jetë jo më pak se 3 vjeçare. Nga auditimi i praktikave dokumentare, rezultoi se nuk është kryer kualifikim i punonjësve të policisë, kërkesë e ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës", me ndryshime, dhe konkretisht neni 7, ku cilësohet se: "Punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës i nënshtrohen kualifikimit dhe trajnimit" si dhe "Rregullorja e brendshme "TIP" e Policisë së Bashkisë dhe Komunës", të miratuar me urdhrin e përbashkët të dy ministrive, si ish Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe ish Ministria e Rendit Publik, Kreu III "Marrëdhëniet e Punës dhe Funksionet Organike, neni 11 "Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi", pika 8.

*III/5.2.2.-Në se nga Policia Bashkiake janë ekzekutuar (zbatuar) Urdhrat e nxjerra nga Kryetari i Bashkisë për vjeljen e detyrimeve tatimore, në pajtim me nenin 8, pika 3, të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë/Komunës*";
Në lidhje me ekzekutimin e Urdhrave të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë për vjeljen e detyrimeve tatimore, në pajtim me nenin 8, pika 3 të, ligjit nr.8224 datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë " rezulton se në bashkëpunim me zyrën e tatim taksave të bashkisë, janë ushtruar kontrolle mbi territorin nën administrim të saj, ku janë dokumentuar me procesverbale të përbashkëta pune, ushtrimi i kësaj detyre.

*III/5.2.3.-Nëse blloqet e gjobave (vendimet) janë me numër seria dhe administrohen si letra me vlerë duke u bërë hyrje në magazinë;*
Në lidhje administrimin e blloqeve të gjobave rezultoi se, nga Policia Bashkiake janë tërhequr nga magazina blloqe gjobash me dokument fletë dalje të magazinës për çdo punonjës policisë.
*III/5.2.4.-Mbi gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake pasqyrimi i tyre në Regjistrin e gjobave, dërgimi i listës gjobave në fund të secilit vit në Zyrën e financës, masat e M.....A për arkëtimin e tyre dhe llogaritja e kamat vonesave për mos pagimin e tyre në afat*;

Në lidhje me gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake, pasqyrimi i tyre në Regjistrin e gjobave, dërgimi i listës gjobave në fund të secilit vit në Zyrën e financës, masat e marra për arkëtimin e tyre dhe llogaritja e kamat vonesave për mos pagimin e tyre në afat, konstatohet se nga punonjësi e policisë, për shkeljet e vërejtura, janë mbajtur procesverbale dhe janë aplikuar gjoba, ndaj subjekteve që nuk kanë paguar detyrimet ndaj zyrës së tatim/taksave, ambulantëve të ndryshëm që shesin në rrugë, parkime të gabuara të automjeteve, zënie të hapësirave publike, prishje të qetësisë publike, ndotje e mjedisit, ndalim në vende të ndaluara me automjete, si dhe janë orientuar subjektet shkelëse në mos përsëritjen e veprimeve si dhe ndjekjen dhe zbatimin e procedurave dhe detyrimeve ligjore, në të ardhmen.

Për periudhën objekt auditimi janë vendosur gjoba nga Policia Bashkiake, për shkelje të ndryshme në vlerë të përgjithshme prej 288,500 lekë, për 136 raste nga të cilat janë arkëtuar 261,000 lekë ose 80,4% e vlerës. Nga vlera e gjobave të vendosura janë te pa arkëtuara vlera 27,500 lekë, për 12 raste sipas aneksit nr.5/8 bashkangjitur Projekt Raportit të Auditimit.

-Sa më sipër konstatohet se nga Policia Bashkiake, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara ndaj subjekteve, ambulantëve të ndryshëm që shesin në rrugë, parkime të gabuara të automjeteve, zënie të hapësirave publike, prishje të qetësisë publike, ndotje e mjedisit, ndalim në vende të ndaluara me automjete për arkëtimin e tyre, nuk është ndjekur rruga ligjore me padi në gjykatë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" nenet 20, 30,me pasojë dëmin ekonomik në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 27,500 lekë, për 12 raste.

*III/5.2.5.-Për rastet e largimit të punonjësve nga puna në se kanë dorëzuar detyrën dhe blloqet e Gjobave me proces verbal.*

Në lidhje me rastet e largimit të punonjësve nga puna në se kanë dorëzuar detyrën dhe blloqet e gjobave me proces verbal, rezultoi se për periudhën objekt auditimi nuk ka patur raste të largimit nga puna ose detyra as të kryeinspektorit as edhe të punonjësve të policisë.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***

*Nga struktura e policisë bashkiake nuk është dokumentuar bashkëpunimi i veprimeve me strukturat e tjera, të bashkisë, pasi:*

*-Nga Policia Bashkiake në bashkëpunim me Zyrën e Tatim/Taksave, ka mbështetur dhe realizuar detyra, duke ushtruar kontrolle mbi territorin nën administrim të saj, por nuk është dokumentuar me procesverbale të përbashkëta pune, ushtrimi i kësaj detyre. Ndërmjet Policisë Bashkiake dhe Sektorit të Tatim Taksave, nuk ka këmbim informacioni zyrtar nëpërmjet zyrës së protokollit, por bashkëpunim verbal dhe nga punonjësit e policisë nuk njihet gjendja e debitorëve dhe numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Vlorë.*

*-Nga Policia Bashkiake në bashkëpunim me zyrën e Urbanistikës, ka mbështetur dhe realizuar detyra, duke ushtruar kontrolle mbi territorin nën administrim të saj, por pa u dokumentuar me procesverbale të përbashkëta pune, ushtrimi i kësaj detyre.*

*-Janë zbatuar aktet e nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak, që kanë të bëjnë me ruajtjen e rendit dhe qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike.*

*-Është organizuar puna nga ana e policisë bashkiake në bashkëpunim dhe me Komisariatin e Policisë, për ruajtjen gjatë gjithë kohës të pasurisë së bashkisë. Në përfundim nga Policia Bashkiake, duhet të kishte ndërmarrë të gjitha masat e duhura lidhur me bashkëveprimin dhe dokumentimin e procedurave të kryera nga kjo strukturë si në bashkëpunimin rutinë me strukturat*

*e tjera brenda bashkisë, ashtu dhe me institucionet e tjera, sipas rastit. Po ashtu duhet bërë më shumë punë dokumentuese lidhur me urdhrat, vendimet etj. të kryetarit së bashkisë, të përcaktuara në detyrat dhe kompetencat e miratuara sipas rregullores së bashkisë të miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 29.03.2012, ku janë përcaktuar misioni, detyrat dhe të drejtat e të gjithë punonjësve. Dokumentimi i punës dhe rezultateve të saj është detyrim i përcaktuar nga ligji nr. 8224, datë 15.5.1997, "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës", i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998, si dhe urdhri i përbashkët i MPVD nr. 1530 datë 07.4.2003" dhe MRP, nr. 823 datë 11.4.2003 "Për miratimin e rregullores "TIP" të policisë bashkiake dhe të Komunës".*
*-Nga Policia Bashkiake, nuk është vepruar për të arkëtuar vlerën e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara ndaj subjekteve, ambulantëve të ndryshëm që shesin në rrugë, parkime të gabuara të automjeteve, zënie të hapësirave publike, prishje të qetësisë publike, ndotje e mjedisit, ndalim në vende të ndaluara me automjete për arkëtimin e tyre, nuk është ndjekur rruga ligjore me padi në gjykatë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" nenet 20, 30,me pasoje te ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, në vlerën 27,500 lekë, për 12 raste.*

Vlera prej 27,500 Lekë, e cila përfaqëson mos arkëtim gjobat vendosura nga Policia Bashkiake, do të konsiderohet si të ardhura të munguara shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Vlorë.

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 239-244, të Projekt raport Auditimit)*

## III/6. Auditimi mbi planifikim dhe zhvillim territorin. Organizimi dhe funksionimi i IMTV.

*III/6.1. Planifikim dhe zhvillim territorin në Bashkinë Vlorë***.**

Në referim të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014, i ndryshuar, në Bashkinë Vlorë është organizuar dhe funksionin Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DKZHT), strukturë e cila sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Personelit në Bashkinë Vlorë.
Lidhur me detyrat funksionale të secilit sektor dhe pozicion pune, grupi i auditimit nuk mund të shprehet për faktin se Bashkia Vlorë nuk ka të miratuar një rregullore për funksionimin dhe organizimin e kësaj strukture, ku të jenë përcaktuar detyrat dhe kompetencat e secilit, rregullore e cila mungon për të gjithë bashkinë pasi ajo aktuale daton në vitin 2012.

Lidhur me aplikimet e kryera nga qytetarët përmes, sistemit e-leje, nga Autoriteti Përgjegjës dhe DKZHT, Bashkia Vlorë, nuk u mundësuar aksesi në sistem e-leje për grupin e auditimit të KLSH-së, duke mos lejuar auditimin nga KLSH të zbatimit të nenit 44 "shqyrtimi i kërkesës për leje ndërtimi", sipas të cilit:
Autoriteti përgjegjës, sipas nenit 27 të këtij ligji, shqyrton aplikimin për leje ndërtimi sipas parimit me një ndalesë, duke bashkërenduar punën me të gjitha autoritetet publike të specializuara që duhet të shprehen në lidhje me aplikimin. 2. Autoriteti përgjegjës vendos për lejen e ndërtimit brenda 60 ditëve nga dorëzimi i aplikimit për leje ndërtimi. Rregullorja e zhvillimit mund të përcaktojë afate më të shkurtra apo procedura të diferencuara për pajisjen me leje ndërtimi, për punime me impakt të ulët në territor apo për investime strategjike për vendin. 3. Në rast se autoriteti përgjegjës nuk merr vendim brenda afatit të mësipërm dhe struktura përgjegjëse e planifikimit pranë autoritetit vendor nuk ka dhënë mendim negativ lidhur me kërkesën, leja e ndërtimit konsiderohet e dhënë në heshtje. Miratimi në heshtje nuk zbatohet për lejet e ndërtimit që janë në kompetencë të KKT-së, si dhe për punime të

tjera, përfshirë ato me rrezikshmëri të lartë, që përcaktohen nga rregullorja e zhvillimit apo rregullohen në mënyrë të veçantë nga legjislacioni në fuqi. 4. Në rast refuzimi të kërkesës për leje ndërtimi ose kundërshtimi të deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve, vendimi duhet të jetë i arsyetuar.
Theksojmë se sipas shkresës nr. 1384/1, datë 21.02.2018 të Sektorit të Protokoll Arkivit, shkresë e nxjerrë në përgjigje të shkresës së grupit të auditimit datë 20.02.2018, administruar në Bashkinë Vlorë me nr. 1384, datë 20.02.2018, grupit të auditimit i është vënë në dispozicion vetëm fotokopje e faqes së parë të sistemit, pra jo regjistri i aplikimeve dhe as historiku i secilit aplikim. Më konkretisht dokumenti ilustrues:



Mos vënies në dispozicion të aksesit në e-leje dhe mos printimi i historikut të secilit aplikim, ka penguar evidentimin e saktë të numrit të lejeve tej afateve ligjore, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi e sanksione ligjore të drejtpërdrejta, DPKZH dhe Autoritetin Përgjegjës, sipas nenit 52 Kundërvajtjet administrative, pika 1/c, sipas të cilit "ç) mosrespektimi i afatit të dorëzimit të dokumentit të lejes, sipas nenit 47 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë".
I vetmi "dokument" i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton shkresa me nr. 1198, datë 12.02.2018, e Drejtorit të DPKZH, E. A, sipas të cilës grupit të auditimit u vihet në dispozicion:
Tabela përmbledhëse 1 janar 2015 -31 dhjetor 2017, për leje ndërtimi
Tabela përmbledhëse 1 janar 2015 -31 dhjetor 2017, për certifikata përdorimi
Tabela përmbledhëse për leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit në sistemin e –lejet në periudhën 1 janar 2015 -31 dhjetor 2017
Fotokopje të dosjeve leje ndërtimit (hotele e pallate)
Materialet elektronike të çdo dosje të sistemit e-lejet në usb
Tabela përmbledhëse me dosjet origjinale.

a/1.-Auditimi mbi zbatimin e procedurave ligjore në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Plani i detajuar vendor;
Në lidhje me auditimi mbi zbatimin e procedurave ligjore në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Plani i detajuar vendor, konstatohet se:
Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.107/2014 dhe të VKM nr.671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", Këshilli Bashkiak Vlorë me vendimin nr. 64, datë 31.08.2018 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor", ka vendosur të miratojë PPV Bashkia Vlorë, hartuar nga studio TH.....S and A.....c. dhe D.....o.

Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit me shkresën nr. 8594, datë 21.09.2017 "Kërkesë për miratim të dokumentit të PPV-së në KKT", rezulton se ka përcjellë në Agjencinë e Zhvillimit të Territorit dhe Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, kërkesën për miratimin e PPV-së nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Deri më 31.12.2017, rezulton se ka një vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit, por që ende nuk është zbardhur prej tij.
Konstatohet se Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit dhe Kryetari i Bashkisë Vlorë është vijuar me procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe miratimin e lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit, deklaratave paraprake të punimeve, ndryshimin e aktiviteteve/funksioneve, shtyrjen e afateve të lejeve të ndërtimit, certifikatave të përdorimit, etj.

a/2-Auditimi mbi organizimi dhe funksionimin e regjistrit të territorit. Organizimi dhe funksionimi i Sistemit GIS;
Në lidhje me auditimin mbi organizimi dhe funksionimin e regjistrit të territorit. Organizimi dhe funksionimi i Sistemit GIS, u konstatua se nga Bashkia Vlorë janë miratuar leje ndërtimi për periudhën objekt auditimi, por nuk na është krijuar aksesi në këtë sistem e për rrjedhojë nuk mund të shprehemi nëse është mbajtur dhe funksionon regjistri i sistemit GIS, edhe pse nga deklaratat verbale të punonjësve rezulton se nuk është aktiv. Gjatë periudhës 01.01.2015 deri 31.12.2017, sipas të dhënave të deklaruara nga DPKZH janë shqyrtuar dhe miratuar 56 leje dhe 42 certifikata përdorimi, por për të cilat nuk mund të shprehemi nëse janë hedhur të gjitha në regjistrin e integruar të territorit (RIT), në zbatim të kërkesave të ligji nr.107, datë 31.07.2014, i ndryshuar neni 55 "Organizimi dhe funksionimi i regjistrit" dhe neni 56 "Botimi në regjistër".
Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, si autoritete përgjegjëse vendore të planifikimit nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për funksionimin dhe botimin (e akteve, të dhënave, informacioneve, etj.) në regjistrin e territorit, si dhe për organizimin dhe funksionimin i sistemit GIS, në kundërshtim me Ligjin Nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar, Neni 55, Neni 56, si dhe nenin 52-Kundërvajtjet administrative, pika b) shkelja e afateve të botimit në regjistër të akteve dhe projektakteve, për të cilat botimi është i detyrueshëm sipas këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë.

a/3-Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private dhe publike;
Në lidhje me auditimin, mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private dhe publike, u konstatua se nga Bashkia Vlorë janë miratuar leje ndërtimi dhe leje zhvillimore në troje private dhe troje publike, për të cilat janë marrë vendime nga Kryetari i Bashkisë dhe janë botuar në regjistrin e integruar të territorit (RIT), por që nuk mund të shprehemi për numrin e saktë të tyre përsa nuk na është krijuar aksesi në sistem e-leje.
Vendimet janë marrë nga kryetari i bashkisë në zbatim të ligjit nr.107, datë 31.07.2014, i ndryshuar neni 29, Përgjegjësitë e kryetarit të bashkisë, Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për:
a) vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në territorin administrativ të bashkisë;
b) vlerësimin e respektimit të kërkesave ligjore për punimet e kryera mbi bazën e deklaratës paraprake për kryerje punimesh;

c) dhënien e certifikatës së përdorimit, sipas nenit 42 të këtij ligji, për lejet e ndërtimit të miratuara prej tij.

Dokumentacioni i kërkuar nga grupi audites nuk është dorëzuar në kohën e kërkuar, nuk është dorëzuar i plotë dhe nuk është dorëzuar në formën e kërkuar nga ligji.

Dokumentacioni i kërkuar prej DPKZH, Bashkia Vlorë, për shqyrtimin e kërkesave në zbatim të procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për lejet e zhvillimit, lejet e ndërtimit, deklaratave paraprake të punimeve, ndryshimin e aktiviteteve/funksioneve, shtyrjen e afateve të lejeve të ndërtimit, certifikatave të përdorimit, etj., nuk është i arkivuar dhe i administruar në formën e kërkuar nga ligji, si dokumentacioni i krijuar në periudhën pas konstituimit të njësive të reja të qeverisjes vendore, po ashtu edhe dokumentacioni arkivor i ish-bashkive dhe ish-komunave, i nevojshëm për vazhdimin e procedurave ligjore në veprimtarinë e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit.

Dokumentacioni i kërkuar nga grupi audites është dorëzuar i fragmentuar, pjesërisht shkresor dhe pjesërisht elektronik, duke limituar dhe penguar me qëllim procesin e auditimit.

**Bashkia VLORE**
**Pasqyra e lejeve te ndertimit periudha 01.01.2015 deri 30.09.2017**

| | | Leje Ndërtimi | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Emërtimi | Nr | Datë | Vendndodhja | Investitori | Subjekti Ndërtues | Sip Truallit | Sip Ndertimi | Nr.prot |
| 1 | Plester Sportive | 373 | 31.07.2017 | L. Pavaresia | Bashkia Vlore | | 1140 | 700 | 5347 |
| 2 | Projekti Rikualifikimi i qnedres historike | 545 | 14.11.2017 | L.Hajro Çakerri | Fondi Amerikan | Alb.Star | 70042 | | 10319 |
| 3 | L.Infrastrukture | 499 | 20.10.2017 | L.Pavaresia | Bashkia Vlore | | | | 9045 |
| 4 | L.Infrastrukture | 500 | 20.10.2017 | L.Pavaresia | Bashkia Vlore | | | | 9044 |
| 5 | L.Infrastrukture | 454 | 22.09.2017 | L.U.Ftohte | Bashkia Vlore | | 750 | 750 | 7951 |
| 6 | Rikonstruksion shtese kati | 437 | 19.09.2017 | L.10 korriku | Shkelqimi 07 | Shkelqimi 07 | 672 | 309 | 7395 |
| 7 | shtese kati | 423 | 11.09.2017 | L.Kushtrimi | Roland Mezani | Roland Mezani | 126 | 76 | 6562 |
| 8 | Banese individuale 3 kate | 415 | 05.09.2017 | Rajoni 1 8601 | Shuaip Breshanaj | Shuaip Breshanaj | 305 | 111.8 | 6144 |
| 9 | Shtese kati mbi objektin ekzistues | 362 | 20.07.2017 | Rajoni 5 8605,Kushtrimi | Lavdurim Jaupaj | Lavdurim Jaupaj | 242 | 110.7 | 5946 |
| 10 | Shtese kati ne ndertim ekzistues | 358 | 19.07.2017 | L. 24 Maj | Jeto Sinaj | Jeto Sinaj | 370.6 | 65 | 5566 |
| 11 | Leje ndertimi banese individuale | 348 | 11.07.2017 | Rr.Dervish Hekali | Fahri Muharremi | Fahri Muharremi | 220 | 150.2 | 5278 |
| 12 | Leje ndertimi per shtese ne dnertim ekzistues | 254 | 22.05.2017 | L.Partizani | Belere Ferraj | Belere Ferraj | 300 | 107.8 | 3191 |
| 13 | Leje ndertimi banese individuale 2 kate | 208 | 05.05.2017 | L.Hajro Çakerri | Gent Kolo | Gent Kolo | 370 | 96 | 2132 |
| 14 | Rikonstruksion shtese kati mbi objektin ekzsistues | 135 | 13.03.2017 | L.Isa Boletini | Lulezim Myrtaj | Lulezim Myrtaj | 272.6 | 157 | 1394 |
| 15 | Leje ndertimi per shtese ne dnertim ekzistues | 160 | 30.03.2017 | L.10 korriku | Demir Brokaj | Demir Brokaj | 200 | 104.8 | 1351 |
| 16 | Leje ndertimi banese individuale 3 kate | 122 | 03.03.2017 | L.24 Maj | Ilez Hyseni | Ilez Hyseni | 200+254.9 | 222.2 | 868 |
| 17 | L.Infrastrukture | 87 | 10.02.2017 | Rr.Demokracia-Janaq kilica | Bashkia Vlore | | 6000 | | 648 |
| 18 | Leje ndertimi per shtese ne dnertim ekzistues 1 kat | 80 | 07.02.2017 | Radhime | Viroi Group | Viroi Group | | 135 | 470 |
| 19 | Leje ndertim per ndertim te ri Hoteleri sherbime | 133 | 10.03.2017 | I.Uji i Ftohte | Ad.sinani 2015 | Ad.sinani 2015 | 2913 | 578 | 469 |
| 20 | Leje ndertimi shtese kati ne ndertim ekzistues 1 kat | 81 | 07.02.2017 | Radhime | Rei Royal | Rei Royal | | 135 | 468 |
| 21 | Godine banimi dhe sherbime 2-10-11 kate, me 1 kat nentoke, ne lagjen "Pavaresia" Vlore (objekti 2 seksioni 1) | 6 | 16.02.2017 | Lagja"Pavaresia" | Globus Konstruksion | Globus Konstruksion | | 345.5 | 1265 |
| 22 | Godine banimi dhe sherbime 8 kate, me 1 kat nentoke, ne lagjen "Deshmoret" Vlore | 10 | 04.07.2017 | Lagja "Deshmoret" | Desi.sh.p.k | Desi.sh.p.k | | 450 | 5858 |
| 23 | Godine banimi dhe sherbimi 1-8-9 kate, me 1 kat parkimi nentoke, ne lagjen "Pavaresia" Vlore(objekti 2) | 5 | 16.02.2017 | Lagja"Pavaresia" | Globus Konstruksion | Globus Konstruksion | | 672 | 1262 |

**Bashkia VLORE**
**Pasqyra e lejeve te ndertimit periudha 01.09.2016 deri 30.09.2017 (Sistemi e-lejet)**

| | | | Leje Ndërtimi | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| NR | Nr.prot | Emërtimi | Nr | Datë | Vendndodhja | Zhvillues | Subjekti Ndërtues | Sip Truallit | Sip Ndertimit m² |
| 1 | 273 | Objekt individual banimi 2kat + 1kat nentoke ne Tragjas Vlore, | 115 | 01.03.2017 | Tragjas Vlore, | Minella Malaj | "FETI" shpk | 250 | 190 |
| 2 | 935 | LEJE NDËRTIMI PËR RIKONSTRUKSION PA NDRYSHIM FUNKSIONI: Veshje fasade dhe fasade dekorative | 145 | 20/03/2017 | L.Kushtrimi | Ylli Shakaj | "GSM Klimaire" SHPK | 427 | 294 |
| 3 | 936 | Objekt individual banimi 2 dhe 3 kate | 159 | 30.03.2017 | L.Hajro Çakerri | Bejkush Osmenaj | "FETI" shpk | 360 | 228.51 |
| 4 | 1613 | Banese individuale njefamiliare 1 kat | 217 | 08.05.2017 | Fitore, Vlore | Agim Shakaj | / | 1365 | 56.5 |
| 5 | 3710 | Objekt 1 kat per magazinimin e materialeve elektrike, hidraulike dhe vegla | 302 | 14.06.2017 | Skrofotine, Vlore | Shoqeria Aksionere | / | 2305 | 230 |
| 6 | 3711 | Kompleks hotelier 3-4 kate dhe 1 kat nen toke | 314 | 19.06.2017 | Rradhime, Vlore | "Rinia 04" shpk | "Rinia 04" shpk | 4000 | 3729.5 |
| 7 | 3712 | Objekt individual Banimi 1 kat ne Hoshtime | 317 | 19.06.2017 | Hoshtime, Vlore | Agron Dano | / | 300 | 118.9 |
| 8 | 2820 | Objekt Individual banimi 4 kate me 1 kat nentoke | 321 | 20.06.2017 | L.Hajro Çakerri | Dhurata Imeraj | / | 500 | 1117.76 |
| 9 | 4280 | Rikonstruksion i plote i objektit 2-katesh | 334 | 03.07.2017 | L.Osman Haxhiu | Aljon Gjikaj, Ornela Latifi | "Desi" shpk | 155 | 128 |
| 10 | 4970 | Shtese kati me funksion banimi ne objektin ekzistues 2 kate | 356 | 18.07.2017 | L.Kushtrimi | Shufojt Stefani | / | 83.9 | 237 |
| 11 | 5670 | SShtese kati me funksion banimi ne objektin ekzistues 1 kat dhe rikonstruksion 1 katit perdhe | 376 | 02.08.2017 | L.28 Nentori | Vasil Dautaj | / | 200.6 | 101 |
| 12 | 6836 | Kapanon industrial 1 kat me 2 kate zyre ne Skrofotine | 398 | 23.08.2017 | Skrofotine, Vlore | SIROL | / | 10500 | 2026.6 |
| 13 | 6520 | Shtese anesore kati me funksion banimi ne objekt ekzistues 3 kati dhe rikonstruksioni i shkalleve ekzistuese | 414 | 05.09.2017 | L.Pavaresia | Pellumb Kekaj | / | 218.9 | 37.08 |
| 14 | 6526 | Objekt individual banimi 1kat me konstruksion druri | 436 | 18.09.2017 | Hoshtime, Vlore | Sergjio Giuffre | / | 300 | 32.44 |
| 15 | 7395 | Rikonstruksion shtese kati | 437 | 19.09.2017 | L.10 korriku | Shkelqimi 07 | Shkelqimi 07 | 672 | 309 |
| 16 | 6562 | shtese kati | 423 | 11.09.2017 | L.Kushtrimi | Roland Mezani | Roland Mezani | 126 | 76 |
| 17 | 6144 | Banese Individuale 3 kate | 415 | 05.09.2017 | Rajoni 1 8601 | Shuaip Breshanaj | Shuaip Breshanaj | 305 | 111.8 |
| 18 | 5946 | Shtese kati mbi objektin ekzistues | 362 | 20.07.2017 | Rajoni 5 8605,Kushtrimi | Lavdurim Jaupaj | Lavdurim Jaupaj | 242 | 110.7 |
| 19 | 5566 | Shtese kati ne ndertim ekzistues | 358 | 19.07.2017 | L. 24 Maj | Jeto Sinaj | Jeto Sinaj | 370.6 | 65 |
| 20 | 5278 | Leje ndertimi banese individuale | 348 | 11.07.2017 | Rr.Dervish Hekali | Fahri Muharremi | Fahri Muharremi | 220 | 150.2 |
| 21 | 3191 | Leje ndertimi per shtese ne dnertim ekzistues | 254 | 22.05.2017 | L.Partizani | Belere Ferraj | Belere Ferraj | 300 | 107.8 |
| 22 | 2132 | Leje ndertimi banese individuale 2 kate | 208 | 05.05.2017 | L.Hajro Çakerri | Gent Kolo | Gent Kolo | 370 | 96 |
| 23 | 1394 | Rikonstruksion shtese kati mbi objektin ekzsistues | 135 | 13.03.2017 | L.Isa Boletini | Lulezim Myrtaj | Lulezim Myrtaj | 272.6 | 157 |
| 24 | 1351 | Leje ndertimi per shtese ne dnertim ekzistues | 160 | 30.03.2017 | L.10 korriku | Demir Brokaj | Demir Brokaj | 200 | 104.8 |
| 25 | 868 | Leje ndertimi banese individuale 3 kate | 122 | 03.03.2017 | L.24 Maj | Ilez Hyseni | Ilez Hyseni | 200+254.9 | 222.2 |
| 26 | 470 | Leje ndertimi per shtese ne dnertim ekzistues 1 kat | 80 | 07.02.2017 | Radhime | Viroi Group | Viroi Group | | 135 |
| 27 | 469 | Leje ndertim per ndertim te ri Hoteleri sherbime | 133 | 10.03.2017 | I.Uji i Ftohte | Ad.sinani 2015 | Ad.sinani 2015 | 2913 | 578 |
| 28 | 468 | Leje ndertimi shtese kati ne ndertim ekzistues 1 kat | 81 | 07.02.2017 | Radhime | Rei Royal | Rei Royal | | 135 |
| 29 | 1051 | Shtese kati me funksion banim ne objekt ekzistues 1kat | 142 | 15.03.2017 | L. Kushtrimi | Imer Jahaj | / | 498 | 91.68 |
| 30 | 1355 | Ngritje kati dhe shtese anesore 1-2 kate ne banesen vetjake | 177 | 10.04.2017 | L. Kushtrimi | Perparim Veizaj, Fation | / | 493.82 | 208 |
| 31 | 2759 | Shtese kati dhe anesore ne objekt banimi individual 2 kat | 221 | 11.05.2017 | Rruga "Nermin Falaski - | Bejeko Stefa | / | 500 | 247.1 |
| 32 | 3214 | Banese individuale 2 kat per nevoja primare strehimi | 239 | 17.05.2017 | Radhime Vlore – Rruga | Robert Çelo | / | 455 | 193 |
| 33 | 5564 | Ngritje 1 kat me cati te banueshme ne banesen nje familjare 1 kat | 377 | 02.08.2017 | Vlorë Rajoni 5,L."Kushtrimi" | Safete Kamberi | / | 314 | 135.5 |
| 34 | 6998 | Shtese kati ne objektik ekzistues 1 kat me funksion banimi | 456 | 26.09.2017 | L. Hajro Çakerri | Bilbil Mehmeti | / | 161 | 16 |
| 35 | 6835 | Banese me dy kate ne pronesi te z. Niko Minga ne lagjen 24 maji Vlore | 457 | 26.09.2017 | L. 24 Maji | Niko Minga | / | 499.6 | 172 |
| 36 | 1555 | Struktura me funksion turistik 4 kate | 174 | 7/4/2017 | Radhime | alfred Hosha | / | 1530 | 786.2 |
| 37 | 6563 | Banese individuale nje familjare 3 kat | 496 | 17/10/2017 | 1 Maji | gezim Zeneli | / | 343 | 400.17 |
| 38 | 6730 | Banese individuale nje familjare gramos imeraj 4k | 443 | 19/09/2017 | Radhime | Gramos Imeraj | / | 1710 | 2874 |
| 39 | 6675 | Objekt banimi 1,2 dhe 3 kate me 1 kat bodrum | 451 | 22/09/2017 | Uji I Ftohte | Besnik Zotaj | / | 500 | 975.1 |
| 40 | 3954 | Shtese kati ne banesen individuale 1 kateshe | 449 | 21/09/2017 | 24 Maji | Panajot Rrapaj | / | 300 | 145 |
| 41 | 6733 | Shtese anesore dhe shtese kati ne objektin egzistues 2 kat | 442 | 19/09/2017 | Rilindja | Genci Veizaj | / | 193 | 242.5 |
| 42 | 3954 | Banese familjare 2-4 kate me podrum | 325 | 22/06/2017 | Hajro Cakerri | Ishet Leskaj, Kastriot | / | 326 | 724 |
| 43 | 5649 | Magazine frigoriferike produktete bujqesore te akuakultures | 368 | 28/07/2017 | Dukat Fushe | Vlora Fish | / | 7220 | 488.6 |
| 44 | 6465 | Banese individuale/njefamiljare per strehim primar 2 | 407 | 29/08/2017 | Cerkovine | Napoleon Dede | / | 3200 | 145 |
| 45 | 5495 | Shtese 2 kate banim mbi objektin ekzistues | 367 | 28/07/2017 | 15 Tetori | Marjo Beqiraj | / | 690 | 249 |
| 46 | 1970 | Shtese me funksion banimi ne objektin ekzistues 1 kat | 263 | 25/05/2017 | Hajro Cakerri | Shyqyri Haxhiraj | / | 230 | 177.65 |
| 47 | 3591 | Shtese 1 kat i godines egzistuese 5 kat | 313 | 19/06/2017 | Pavaresia | Kreanr Rushiti | / | 125 | 125 |
| 48 | 3217 | Banese individuale 2 kat | 249 | 18/05/2017 | Radhime | Julejda Gorshi | / | 455 | 193 |
| 49 | 2981 | Rikonstruksion dhe shtese katesh ne strukturen me funksion turistik 3 kate | 248 | 18/05/2017 | Duro Shaska | Tajar Myftari | / | 127.74 | 720 |
| 50 | 1351 | Rikonstruksion dhe shtesë 2 kat | 160 | 30/03/2017 | 10 Korriku | Demir Brokaj | / | 115 | 250 |
| 51 | 1890 | Objekt 3 dhe 5 kate, me nje kat nentoke, me destinacion hoteleri | 134 | 10/3/2017 | Jonufer | Antoneta Sota | / | 536 | 2425 |
| 52 | 253 | Rikonstruksion dhe shtese anesore 1 kat ne banesen individuale | 75 | 6/2/2017 | 28 Nentori | Dashnor Agaj | / | 328 | 99.75 |
| 53 | 252 | Shtese anesore 1 Kat ne objektin egzistues | 76 | 6/2/2017 | Lirimi | Augisto Shakaj | / | 97 | 30.7 |
| 54 | Vendim Gjy | Godine banimi dhe sherbime 2-10-11 kate, me 1 kat nentoke, ne | 6 | 16.02.2017 | Lagja"Pavaresia" | Globus Konstruksion | Globus Konstruksion | 345.5 | 1265 |
| 55 | Vendim Gjy | Godine banimi dhe sherbime 8 kate, me 1 kat nentoke, ne lagjen | 10 | 04.07.2017 | Lagja "Deshmoret" | Desi.sh.p.k | Desi.sh.p.k | 450 | 5858 |
| 56 | Vendim Gjy | Godine banimi dhe sherbimi 1-8-9 kate, me 1 kat parkimi nentok | 5 | 16.02.2017 | Lagja"Pavaresia" | Globus Konstruksion | Globus Konstruksion | 672 | 1262 |

Auditimi i aplikimit dhe shqyrtimit për lejen e ndërtimit "Objekt individual banimi 2kat + 1kat nëntokë në Tragjas Vlorë" me zhvillues M.....J - Vendim nr. 115, datë 01.03.2017.
Nga auditimi i materialit tekniko-ligjor konstatohet se:
Në dosje mungon dokumentin e miratimit të lejes së zhvillimit, si dokumenti që i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit, konform përcaktimeve të Ligjit nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar dhe VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 9, Leja e zhvillimit.
1. Dokumenti i lejes së zhvillimit i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit për ndërtime të reja, nga autoritetet e zhvillimit, dhe përmban, në nivel prone apo grup pronash, sa vijon: a) përdorimin e tokës dhe strukturat e lejueshme; b) intensitetin e ndërtimit;
c) koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim; ç) lartësinë maksimale në metra; d) distancat; dh) gjelbërimin publik;
e) parkimin; ë) fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese (genplani i azhurnuar); f) informacion rreth kufizimeve apo kushtëzimeve të veçanta në pronën përkatëse; g) hartën e infrastrukturës inxhinierike në zone; gj) projektidenë arkitektonike të zhvillimit.
Në dosje mungon dokumenti i konfirmimit nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
Në dosje mungojnë hartat me përditësimet e infrastrukturës rrugore, të kanalizimeve, atyre elektrike, telefonike, të pikave të depozitimit të mbetjeve, intensitetin e studimit sizmologjik.
Nuk rezulton që nga drejtori i DPKZH, të jetë kryer ndonjë veprim në përputhje me hapat ligjorë konform VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, që detyron autoritetin e zhvillimit të marrë vetë kryesisht gjithë dokumentacionin nga administrata publike dhe më pas të jetë njoftuar kërkuesi për pagesat e tarifave ndaj këtyre institucioneve të administratës publike.
Nuk rezulton të jetë hartuar nga drejtori i DPKZH, Raporti i Vlerësimit Teknik që i përcillet për vendimmarrje kryetarit të bashkisë.
Nuk rezulton të jetë hartuar nga Kryetari i Bashkisë vendimi i miratimit të kërkesës që përmban edhe vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë që duhet paguar sipas legjislacionit në fuqi.
Në dosje mungon dokumenti i konfirmimit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.
Nga auditimi konstatohet se shqyrtimi për marrjen e vendimeve për lejet e zhvillimit dhe lejet e ndërtimit është kryer në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar dhe VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar dhe për këtë ngarkohen me përgjegjësi drejtori i DPKZH, E. A.

Auditimi i aplikimit dhe shqyrtimit për lejen e ndërtimit "Banesë individuale/njëfamiljare 1-2-3-4-5 kate, në Vlorë," me zhvillues F.....I - Vendim Nr. 348, datë 11.07.2017.
Nga auditimi i materialit tekniko-ligjor konstatohet se:
Leja për këtë objekt është miratuar në kundërshtim me përcaktimet e VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 34 – Distancat minimale midis ndërtimeve dhe Neni 35 – Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës.
Në dosje mungon dokumentin e miratimit të lejes së zhvillimit, si dokumenti që i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit, konform përcaktimeve të Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar dhe VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 9, Leja e zhvillimit.

1. Dokumenti i lejes së zhvillimit i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit për ndërtime të reja, nga autorietet e zhvillimit, dhe përmban, në nivel prone apo grup pronash, sa vijon: a) përdorimin e tokës dhe strukturat e lejueshme; b) intensitetin e ndërtimit;
c) koeficientin e shfrytëzimit të tokës për ndërtim; ç) lartësinë maksimale në metra; d) distancat; dh) gjelbërimin publik;
e) parkimin; ë) fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese (genplani i azhurnuar); f) informacion rreth kufizimeve apo kushtëzimeve të veçanta në pronën përkatëse; g) hartën e infrastrukturës inxhinierike në zone; gj) projektidenë arkitektonike të zhvillimit.
Në dosje mungon dokumenti i konfirmimit nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
Në dosje mungojnë hartat me përditësimet e infrastrukturës rrugore, të kanalizimeve, atyre elektrike, telefonike, të pikave të depozitimit të mbetjeve, intensitetin e studimit sizmologjik.
Nuk rezulton që nga drejtori i DPKZH, Bashkia Vlorë, E. A, të jetë kryer ndonjë veprim në përputhje me hapat ligjorë konform VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, që detyron autoritetin e zhvillimit të marrë vetë kryesisht gjithë dokumentacionin nga administrata publike dhe më pas të jetë njoftuar kërkuesi për pagesat e tarifave ndaj këtyre institucioneve të administratës publike.
Nuk rezulton të jetë hartuar nga drejtori i DPKZH, Bashkia Vlorë, E. A, Raporti i Vlerësimit Teknik që i përcillet për vendimmarrje kryetarit të bashkisë.
Nuk rezulton të jetë hartuar nga Kryetari i Bashkisë vendimi i miratimit të kërkesës që përmban edhe vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë që duhet paguar sipas legjislacionit në fuqi.
Në dosje mungon dokumenti i konfirmimit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.
Nga auditimi konstatohet se shqyrtimi për marrjen e vendimeve për lejet e zhvillimit dhe lejet e ndërtimit është kryer në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar dhe VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar dhe për këtë ngarkohen me përgjegjësi drejtori i DPKZH, E. A.
Auditimi i aplikimit dhe shqyrtimit për lejen e ndërtimit "Hotel dhe shërbime turistike pranë Ujit të Ftohtë, Vlorë" me zhvillues A.....I 2015 . - Vendim Nr. 133, datë 10.03.2017
Nga auditimi i materialit tekniko-ligjor konstatohet se:
Leja për këtë objekt është miratuar në kundërshtim me përcaktimet e VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 34 – Distancat minimale midis ndërtimeve dhe Neni 35 – Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës.
Në dosje mungon dokumenti i konfirmimit nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
Në dosje mungojnë hartat me përditësimet e infrastrukturës rrugore, të kanalizimeve, atyre elektrike, telefonike, të pikave të depozitimit të mbetjeve, intensitetin e studimit sizmologjik.
Në dosje mungojnë dokumentet zyrtare të mendimeve të institucioneve publike, pavarësisht se janë listuar në formularin e dhënies së lejes së ndërtimit nga drejtori i DPKZH, Bashkia Vlorë, E. A.
Nuk rezulton që nga drejtori i DPKZH, Bashkia Vlorë, E. A, të jetë kryer ndonjë veprim në përputhje me hapat ligjorë konform VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, që detyron autoritetin e zhvillimit të marrë vetë kryesisht gjithë dokumentacionin nga administrata publike dhe më pas të jetë njoftuar kërkuesi për pagesat e tarifave ndaj këtyre institucioneve të administratës publike.
Nuk rezulton të jetë hartuar nga drejtori i DPKZH, Bashkia Vlorë, E. A, Raporti i Vlerësimit Teknik që i përcillet për vendimmarrje kryetarit të bashkisë.
Nuk rezulton të jetë hartuar nga Kryetari i Bashkisë vendimi i miratimit të kërkesës që përmban edhe vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë që duhet paguar sipas legjislacionit në fuqi.

Në dosje mungon dokumenti i konfirmimit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.
Nga auditimi konstatohet se shqyrtimi për marrjen e vendimeve për lejet e zhvillimit dhe lejet e ndërtimit është kryer në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar dhe VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar.
Për këtë ngarkohen me përgjegjësi drejtori i DPKZH, Bashkia Vlorë, E. A.

Auditimi i aplikimit dhe shqyrtimit për lejen e ndërtimit "Godinë banimi dhe shërbime 1-8-9 kate, me 1 kat nëntokë, në lagjen "Pavarësia" Vlorë (Objekti 2)" me subjekt ndërtues G.....N . - Vendim Nr. 5, datë 16.02.2017.
Nga auditimi i materialit tekniko-ligjor shkresor i dorëzuar nga drejtori i DPKZH, jo në formën e përcaktuar nga ligji, konstatohet se:
Në dosje mungon dokumenti i konfirmimit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe gjithë dokumentacioni tekniko ligjor konform ligjit në fuqi në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit nga KRRT, Bashkia Vlorë.
Vendimi dhe Leja e Ndërtimit Nr. 5, datë 16.02.2017, firmosur nga Kryetari i Bashkisë Vlorë. (fotokopje)
Planimetria e sheshit të ndërtimit, firmosur nga Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtori i DPKZH. (fotokopje)
Projekti arkitektonik. (fotokopje)
Nga auditimi konstatohet se:
Vendimi Nr. 5, datë 16.02.2017, është marrë bazuar në Vendimin Nr.1112, datë 22.07.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, i cili nuk është apeluar nga autoriteti përgjegjës.
Shqyrtimi i materialit për zbatimin e Vendimit Nr.1281, datë 02.10.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është kryer nga autoriteti përgjegjës i planifikimit në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar.

Auditimi i aplikimit dhe shqyrtimit për lejen e ndërtimit "Godinë banimi dhe shërbime 2-10-11 kate, me 1 kat nëntokë, në lagjen "Pavarësia" Vlorë (Objekti 2 Seksioni 2)" me subjekt ndërtues G.....N . - Vendim Nr. 6, datë 16.02.2017.
Nga auditimi i materialit tekniko-ligjor shkresor i dorëzuar nga drejtori i DPKZH, jo në formën e përcaktuar nga ligji, konstatohet se në:
Në dosje mungon dokumenti i konfirmimit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe gjithë dokumentacioni tekniko ligjor konform ligjit në fuqi në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit nga KRRT, Bashkia Vlorë.
Vendimi i formës së prerë, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, Nr.1281, datë 02.10.2015 (fotokopje)
Vendimi dhe Leja e Ndërtimit Nr. 6, datë 16.02.2017, firmosur nga Kryetari i Bashkisë Vlorë. (fotokopje)
Planimetria e sheshit të ndërtimit, firmosur nga Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtori i DPKZH. (fotokopje)
Projekti arkitektonik. (fotokopje)
Nga auditimi konstatohet se:
Vendimi Nr.1281, datë 02.10.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë nuk është apeluar nga autoriteti përgjegjës.

Shqyrtimi i materialit për zbatimin e Vendimit Nr.1281, datë 02.10.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është kryer nga autoriteti përgjegjës i planifikimit në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar.

Auditimi i aplikimit dhe shqyrtimit për lejen e ndërtimit "Godinë banimi dhe shërbime 8 kate, me 1 kat nëntokë, në lagjen "Dëshmorët" Vlorë", me subjekt ndërtues DESI . - Vendim Nr. 10, datë 04.07.2017
Nga auditimi i materialit tekniko-ligjor shkresor i dorëzuar nga drejtori i DPKZH, jo në formën e përcaktuar nga ligji, konstatohet se në përmbajtje të dosjes ndodhen:
Në dosje mungon dokumenti i konfirmimit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe gjithë dokumentacioni tekniko ligjor konform ligjit në fuqi në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit nga KRRT, Bashkia Vlorë.
Në dosje mungon Vendimi i Formës së Prerë të Gjykatës.
Planimetria e sheshit të ndërtimit, firmosur nga Kryetari i Bashkisë Vlorë dhe Drejtori i DPKZH (fotokopje).
Projekti arkitektonik. (fotokopje)
Shqyrtimi i materialit për zbatimin e Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është kryer nga autoriteti përgjegjës i planifikimit në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014, i ndryshuar. Nga auditimi i materialit shkresor për Vendim Nr. 5, datë 16.02.2017, Vendim Nr. 6, datë 16.02.2017, Vendim Nr. 10, datë 04.07.2017, ngarkohen me përgjegjësi drejtori i DPKZH, Bashkia Vlorë, A. M., Drejtori i Drejtorisë Juridike, Bashkia Vlorë, D. Z..
Nga auditimi në tërësi i materialeve (elektronike dhe hard copy) të vëna në dispozicion nga drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, Bashkia Vlorë konstatohet se:
Në çdo aplikim mungojnë dokumenti i konfirmimit nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
Në çdo aplikim mungojnë hartat me përditësimet e infrastrukturës rrugore, të kanalizimeve, atyre elektrike, telefonike, të pikave të depozitimit të mbetjeve, intensitetin e studimit sizmologjik. Nuk rezulton të jenë kryer veprime në përputhje me hapat ligjorë konform VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 10/1.
Në çdo aplikim nuk rezulton të jenë kryer veprime në përputhje me hapat ligjorë konform VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 4, Dokumentacioni i administratës publike, që detyron autoritetin e zhvillimit të marrë vetë kryesisht gjithë dokumentacionin nga administrata publike dhe më pas të jetë njoftuar kërkuesi për pagesat e tarifave ndaj këtyre institucioneve të administratës publike. Veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me këtë procedurë ligjore të detyrueshme sjellin dëm ekonomik për buxhetin e institucioneve në varësi të bashkisë dhe institucioneve të tjera shtetërore për shkak të mungesës së tarifave të shërbimeve.
Në çdo aplikim nuk rezulton të jetë hartuar nga specialisti përkatës, përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit, apo drejtori i DPKZH, Raporti i Vlerësimit Teknik që i përcillet për vendimmarrje kryetarit të bashkisë, në përputhje me hapat ligjorë konform VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 21, Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor.
Nuk rezulton të jetë hartuar nga Kryetari i Bashkisë vendimi i miratimit të kërkesës që përmban edhe vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë që duhet paguar sipas legjislacionit në fuqi sipas VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 23, Përmbajtja e Vendimit.
Autoriteti i planifikimit dhe zhvillimit në Bashkinë Vlorë miraton leje bazuar vetëm në projektet teknike, të shoqëruara nga licencat e projektuesve.

Autoriteti i planifikimit dhe zhvillimit në Bashkinë Vlorë kryesisht dhe përgjithësisht miraton leje bazuar vetëm në projektet teknike, të shoqëruara nga licencat e projektuesve.
Autoriteti i planifikimit dhe zhvillimit në Bashkinë Vlorë ushtron kryesisht dhe përgjithësisht veprimtarinë e tij në fushën e zhvillimit në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, sa më sipër dhe konform përcaktimeve të Nenit 52 "Kundërvajtjet administrative", "1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
c) miratimi i lejes së ndërtimit dhe lëshimi i certifikatës së përdorimit, në kundërshtim me këtë ligj ose me dokumentet e planifikimit në fuqi, dënohet me gjobë nga 1,000,000 lekë deri në 3,000,000 lekë.", ngarkojnë me përgjegjësi Drejtorin e DPKZH, A. M..

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga DPKZH, punonjësi S. A, sqarohet mos pasja e përgjegjësive lidhur me vendimin nr. 115, datë 01.03.2017 pasi leja e ndërtimit nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga specialisti në fjalë. Ky saktësim është bërë dhe nga Drejtori i DPKZH i cili saktën sa cituar. Pretendimi merret në konsideratë për përgjegjësinë.*

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 1701/2, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga DPKZH, punonjësi Jonela Haxhiraj, sqarohet mos pasja e përgjegjësive lidhur me sa trajtuar pasi me shkresën nr. 18.01.2017 prej saj është dokumentuar se nuk ka pas të përcaktuar pozicion pune, duke mos kryer një funksion të caktuar e për rrjedhojë nuk ka qenë pjesë e praktikës të konstatuar me shkelje apo parregullsi. Pretendimi merret në konsideratë për përgjegjësinë.*

a/4-Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve të përdorimit, hartimi dhe firmosja e procesverbaleve të kolaudimit nga kolaudatori, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve;

| Bashkia VLORE<br>Pasqyra e lejeve te shfrytezimit ose Certifikatave te Perdorimit, periudha 01.09.2016 deri 30.09.2017 (sistemi e-lejet) | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Nr.Prot | Emertimi Objektit | Leje Ndertimi Nr date | Leje Shfrytez nr dt | Vendndodhja | Investitori | Subjekti Ndertues | Sip Truallit | Sip Ndertim |
| 1 | 1128 | Certifikate perdorimi per Leje per ndryshim aktivitet/funksioni | Miratuar nga Kryetari i Bashkisë Z.Niko Veizaj | Nr 182, datë 18.04.2017 | L. Pavaresia | Skerdiana Rrugenaja | Skerdiana Rrugenaja | 0 | 63 |
| 2 | 2134 | Certifikate perdorimi per Leje per ndryshim aktivitet/funksioni | Nr.125 , datë 06/03/2017 | Nr 218, datë 09.05.2017 | L.Bashkimi | Lavdosh Ducja | Lavdosh Ducja | 0 | 58.6 |
| 3 | 2135 | Certifikate perdorimi per Leje per ndryshim aktivitet/funksioni | Nr.124 , datë 06/03/2017 | Nr 219, datë 09.05.2017 | L.Kushtrimi | Mariglen Troka | Mariglen Troka | 0 | 55.7 |
| 4 | 2136 | Certifikate perdorimi per Leje per ndryshim aktivitet/funksioni | Nr.124 , datë 06/03/2017 | Nr 220, datë 09.05.2017 | L.Kushtrimi | Manushaqe Ducja | Manushaqe Ducja | 0 | 55.7 |
| 5 | 2962 | Certifikate perdorimi per Leje per ndryshim aktivitet/funksioni | Nr. 141, datë 15/03/2017 | Nr 256, datë 22.05.2017 | L.Bashkimi | Mujsi Lamaj | Mujsi Lamaj | 0 | 70 |
| 6 | 5562 | Certifikate perdorimi per Leje per ndryshim aktivitet/funksioni | Nr. 270, datë 30.05.2017 | Nr 421, datë 11.09.2017 | L.24 Maji | Nazmi Shametaj | Nazmi Shametaj | 0 | 74 |
| 7 | 9282 | Rikonstruksion dhe shtese 1-kat ne obj 1-kat | nr 126, dt 07.10.2016 | nr576, dt 14.12.2017 | L.Partizani | Bujar Reshepi | Feti " sh.p.k | 226 | 306.7 |
| 8 | 10241 | God ban+sherb, 1-12 k+1-k parkim nentok (ob 4) | nr 3/87,dt 07.06.2010 nr | nr 573, dt 12.12.2017 | L. "Pavaresia" | Shoq"TOZAJ | Shoq"BRILANT"sh | 948.35 | 8699.1 |
| 9 | 994 | Obj social-kulturor 1-5-6 kate | nr 2/106, dt 28.9.2011 | nr. 140, dt 15.03.2017 | L. "28 Nentori" | Arjan Xhaferllari | Shoq "Demak"sh.p.k | 977.44 | 1904 |
| 10 | 1432 | Ndryshim funks nga mag mallrash ne mag per vajra | nr 2/106, dt 28.09.2011 | nr 140, dt 15.03.2017 | Novosele | TIR | AMANTIA | 3229 | 380 |
| 11 | 1554 | Mag per njajtje produkti akua kultura | nr 85, dt 26.02.2016 | nr 156, dt 28.03.2017 | Dukat Fushe | alb adriatika | Shoq. "ANSI" shpk | 2347 | 746 |
| 12 | 1557 | Banese 2 kate | nr 7/33, dt 30.07.2003 | nr 164, dt 03.04.2017 | Jalli Narte | Vilson Kamberaj | Jon | 360 | 308.5 |
| 13 | 1610 | Obj 8 kat+1 kat parkim nentoke | nr 5/43, dt 27.05.2005 | nr 144, dt 17.03.2017 | L. "10 Korriku" | Trashegimtar te Jani | Shoq"ERLAN' shpk | 1975 | 5590 |
| 14 | 1612 | Banese 2-3-7-8, +1ka dyqane | nr 5/39, dt 24.11.2008 | nr 163, dt 03.04.2017 | L. "28 Nentori" | Shoq"Toni | Shoq"Toni | 797 | 2132 |
| 15 | 2092 | Leje ndryshim funksioni | nr 110, dt 27.02.2017 | nr 195, dt 26.04.2017 | L." Osman Hashiu" | Bujar Veizaj | Bujar Veizaj | 63 | 63 |
| 16 | 2343 | Leje ndryshim funksioni | dt 20.02.2006 | nr 252, dt 19.05.2017 | L."29 Nentori" | Spiro Dhimitri | Spiro Dhimitri | 71 | 71 |
| 17 | 4027 | Objekt 2 kate | nr 103, dt 18.05.2016 | nr 338, dt 05.07.2017 | L."Partizani" | Njazi Xhemali | Njazi Xhemali | 362.5 | 235 |
| 18 | 4275 | God ban+sherb, 1-9 k+1-k parkim nentok | nr 2/456, dt 28.09.2011 | nr 285, dt 07.06.2017 | L."Uji I Ftohte" | Shoq'Oslo kompany' | Shoq"Oslo | 2520 | 18204 |
| 19 | 5563 | Objekt 1 kat | nr 26, dt 22.12.2016 | nr 399, dt 28.08.2017 | Panaja | Luftar Aliu | Luftar Aliu | 93 | 93 |
| 20 | 5734 | Leje ndryshim funksioni | nr 303, dt 14.06.2017 | nr 412, dt 05.09.2017 | Misto Mele | Gezim Zeneli | Gezim Zeneli | 63.6 | 63.6 |
| 21 | 5772 | Godin banim dhe sherbim 7kate+1kat parkim | nr 2/180, dt 28.09.2017 | nr 400, dt 28.08.2017 | L."Hajro Cakerri" | Ferdinad Xhasho, | Shoq "Feti' shpk | 451 | 2296.6 |
| 22 | 6084 | God banim dhe sherbim 9kat+1kat parkim nentok | nr 2/278, dt 28.09.2011 | nr 420,dt 08.09.2017 | L."28 Nentori" | Globus | Globus | 5435 | 5487.48 |
| 23 | 9023 | Leje ndryshim funksioni | nr 360, dt 20.07.2017 | nr 541, dt 13.11.2017 | Rrg"Kristo | Perllat Kananaj | Perllat Kananaj | 80 | 80 |
| 24 | 5127 | Godine banimi 1-kat me 1-kat parkim nentoke | 112 dt 30.06.2016 | Nr 365 datë 25.07.2017 | L. Lirim, Rruga | Mevlan Meta | "Ndertuesi" sh.p.k. | 330.4 | 364.735 |
| 25 | 5561 | Certifikate perdorimi per ndryshimin e funksioni nga apartament ne | 279 dt 05.06.2016 | Nr 374 datë 01.08.2017 | L. Bashkimi | Spiro Celaj | | 111 | 111 |
| 26 | 9950 | Shtese anesore ne objekti ekzistues ne rrugen | 2/210 dt. 28/09/2011 | 44 dt. 06.01.2017 | Transballkanike | FAED | FAED | 115m | 115m |
| 27 | 3339 | Kompleks banimi dhe sherbimesh 5,6 dhe 7 kate me 1 kat parkim | 3/102 dt. 07.06.2010 | 319 dt. 19.06.2017 | 1 Maji | K. R - AAL - | K. R - AAL - | 5475m | 10569.37m |
| 29 | 10370 | Godine banimi dhe sherbimi 9-kate kati perdhe dyqane, 1-kat parkim | 2/36 dt. 28.09.2011 | 43 dt. 06.01.2017 | Deshmoret | LAZAJ 2002 | LAZAJ 2002 | 1355m | 9947m |
| 30 | 1556 | Banese 2-kate | Nr.7/37 , datë 30/07/2003 | Nr. 240, datë 17/05/2017 | IALLI | Myzafer Begaj | Jon Konstruksion | 360m | 242m |
| 31 | 4271 | Rikonstruksion dhe shtese 1 kat ne banesen individuale 1 kateshe | 100 dt. 10.05.2016 | 332. dt. 30.06.2017 | 28 Nentori | Neship Çeçi | FETI | 247m | 328.865m |
| 32 | 5842 | Godine banimi dhe sherbimi 2-6- kate +papafingo me 1 kat nentoke | 1/11 dt 24.03.2015 | 445 dt. 20.09.2017 | Pavaresia | Gezim Feta | En-Bjo | 319m | 1472m |
| 33 | 2634 | Godine banimi dhe sherbime 12-kate me 1-kat parkim | 93 dt. 29.09.2014 | 247 dt. 18.05.2017 | 10 Korriku | Reno Construksion | Reno Construksion | 1423m | 10094,01m |
| 34 | 993 | Rikonstruksion dhe ngritje 2-kate | 9/9 dt. 07.09.2001 | 246 dt. 18.05.2017 | 28 Nentori | Vladimir Sopiqoti | | 48m | 218m |
| 35 | 5740 | Objkt Banimi 3k me dyqan | 7/17 dt 09.06.1988 | 7004 dt 28.08.2017 | L. Pavaresia | Sazan Selmanaj | Sazan Selmanaj | | |
| 36 | 5350 | Strukture banimi 4 kate me nje kat nentoke | 10 dt 14.10.2013 | 394 dt 23.08.2017 | Radhime | Hope | Hope | 2325 | 473 |
| 37 | 3476 | Banese 1-3-6 kate, 1 kat dyqane. -2-5 kate banim+ 1 kat nentoke | 2/39 dt 06.06.2008 | 277 dt 1.06.2017 | L. Pavaresia | Mertiri Tragjas | Mertiri Tragjas | 305 | 211 |
| 38 | 371 | Godine banimi 8 kate me 1 kat nentoke objekti 4 | 5/137 dt 17.08.2010 | 205 dt 04.05.2017 | L.Uji i ftohte | Delmondo 01 | Delmondo 01 | 5000 | 417 |
| 39 | 370 | Godine banimi 8 kate me 1 kat nentoke objekti 3 | 5/137 dt 17.08.2010 | 206 dt 04.05.2017 | L.Uji i ftohte | Delmondo 01 | Delmondo 01 | 5000 | 395 |
| 40 | 72 | Godine banimi dhe sherbime 7 kate+papafingo me 1 kat nentoke | 2/186 dt 28.09.2011 | 114 dt 01.03.2017 | L.Uji i ftohte | Globus | Globus | 1066 | 252 |
| 41 | 10463 | Çertifikat perdorimmi per ndryshim destinacioni | 138 dt 01.11.2016 | 63 dt 26.01.2017 | Rr.Sadik Zotaj | Shkelqim Lamaj | Shkelqim Lamaj | | |
| 42 | 10368 | Çertifikat perdorimmi per ndryshim destinacioni | 142 dt 02.11.2016 | 50 dt 16.01.2017 | L.Bashkimi | Jani Dapaj | Jani Dapaj | 269.63 | 269.63 |

Janë vendosur në dispozicion nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, Bashkia Vlorë 5 dosje (hard copy) të aplikimeve për certifikata përdorimi. Nga auditimi i materialeve

shkresore të vëna në dispozicion konstatohet se janë shqyrtuar kërkesat dhe janë marrë vendime për pajisjen me certifikata përdorimi si më poshtë:
Vendim Nr.119, datë 28.07.2016 – "Objekt 2-5-7 kate, kati i tetë papafingo, 1 kat dyqane, me 1 kat parkim nëntokë, në lagjen "Dëshmorët", Vlorë, me subjekt ndërtues "L.....I" . aplikuar më datën 13.04.2016, dhe dhënë Certifikatë Përdorimi Nr. Prot. 6310, datë 28.07.2016, firmosur nga D. L., Kryetar i Bashkisë Vlorë dhe E. A, Drejtor DPKZH.
Nga auditimi i dosjes konstatohet se:
Akti i Kolaudimit është firmosur nga drejtuesi teknik- U. F, Liç.Nr. Z....., Supervizori – V. GJ, Liç.Nr. MK....., Kolaudator "M.....n", me administrator Ing. A. G, Relacioni teknik për mbikëqyrjen e punimeve është firmosur nga mbikëqyrësit e punimeve V. GJ, Liç.Nr. MK..... dhe N. J Liç. 2507/1, Subjekti Ndërtues L.....I ., Liç. NZ ..... ka lëshuar Deklaratën e Përputhshmërisë, Aktet e kontrollove për realizimin e punimeve ndërtimore (1. Piketimi i objektit, 2. Përfundimi i themeleve, 3. Përfundimi i karabinasë, 4. Përfundimi i sistemimit të jashtëm, 5. Përfundimi i fasadave, rifiniturave, përfshirë sistemet e ngrohjes, hidraulike dhe komunikim elektronik) janë hartuar në datën 19.01.2016 nga specialistët e DPKZH, por mungojnë faturat e konfirmimeve për pagesat e tarifave të akteve të kontrollit të ushtruara nga specialistët e DPKZH.
Nuk është kryer kontrolli pas depozitimit në dosje të situacionit përfundimtar të punimeve dhe kontrollit të vlerës të tij sipas përllogaritjes së bërë në autorizimin e pagesës në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit,
Nga auditimi i dosjes konstatohet se:
Për objektin 2-5-7 kate, kati i tetë papafingo, 1 kat dyqane, me 1 kat parkim nëntokë, në lagjen "Dëshmorët", Vlorë, me subjekt ndërtues "L.....I" , është miratuar Shesh Ndërtimi me Vendim të KRRT Bashkia Vlorë Nr. 1/131, datë 24.02.2009 dhe Leje Ndërtimi Vendim Nr.1/172, datë 24.02.2009.
Leja e ndërtimit me Vendim Nr.1/172, datë 24.02.2009 nuk është dhënë në përputhje me sheshin e ndërtimi me Vendim të KRRT Bashkia Vlorë Nr. 1/131, datë 24.02.2009. Ky fakt nuk është pasqyruar në asnjë prej akteve të sipërpërmendura, të hartuara nga specialistët përkatës.
Në dosjen e subjektit kërkues për pajisjen me certifikatë përdorimi janë depozituar foto të objektit të përfunduar. Në foton që pasqyron anën veri-lindore të objektit (foto 1.) konstatohen qartë volume shtesë të realizuara në katin e fundit të objektit (foto 2. papafingo sipas projektit të miratuar nga KRRT Bashkia Vlorë). Këto volume shtesë nuk janë pasqyruar në asnjë prej akteve të kontrollit të mbajtur nga specialistët përkatës, apo mbikëqyrësit, supervizorit e kolaudatorit.



Nga auditimi i dosjes konstatohet se certifikata e përdorimit është miratuar në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, dhe konkretisht:
Neni 42-Certifikata e përdorimit- "1. Në fund të procesit të zhvillimit, autoriteti përgjegjës i planifikimit lëshon certifikatën e përdorimit të objektit, që vërteton përfundimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit, si dhe zbatimin e kritereve të dokumenteve të planifikimit e të kontrollit të zhvillimit."
Neni 52-Kundërvajtjet administrative-" e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera;
ë) kryerja e ndryshimeve në projekt apo e punimeve në shkelje të kushteve të lejes:
i) pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 300 000 lekë, pezullim të punimeve dhe me masën e përcaktuar në përfundim të procedurës, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni; ii) me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera pa leje.

Vendim nr.97, datë 21.04.2016 – "Godinë banimi dhe shërbimi 3-6-8 kate, me 1 kat nëntokë, në rrugën "Jeronim de Rada", Vlorë, me subjekt ndërtues "H.....T" .
Nga auditimi i dosjes konstatohet se mungojnë faturat e konfirmimeve për pagesat e tarifave të akteve të kontrollit të ushtruara nga specialistët e DPKZH, dhe nuk është kryer kontrolli pas depozitimit në dosje të situacionit përfundimtar të punimeve dhe kontrollit të vlerës të tij sipas përllogaritjes së bërë në autorizimin e pagesës në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit.

Vendim nr.116, datë 14.07.2016 – "Objekt 8 kate, 1 kat dyqane, 7 kate banim + 1 kat parkim nëntokë, në lagjen "Uji i Ftohtë", Vlorë, me subjekt ndërtues "E.....S" .
Nga auditimi i dosjes konstatohet se mungojnë faturat e konfirmimeve për pagesat e tarifave të akteve të kontrollit të ushtruara nga specialistët e DPKZH, dhe nuk është kryer kontrolli pas depozitimit në dosje të situacionit përfundimtar të punimeve dhe kontrollit të vlerës të tij sipas përllogaritjes së bërë në autorizimin e pagesës në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit.

Nga auditimi i dosjes konstatohet se afati i lejes së ndërtimit ka përfunduar në datën 31.12.2008 dhe pavarësisht kontrolleve nga specialistët e DPKZH, në datën 14.09.2009 dhe 14.04.2016, nuk është evidentuar ky fakt gjatë hartimit të akt kontrolleve apo të jetë informuar autoriteti përgjegjës për marrjen e masave administrative konform Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar, Neni 52-Kundërvajtjet administrative, dh) shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve, sipas nenit 40 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100,000 lekë deri në 500,000 lekë".

Vendim nr.117, datë 14.07.2016 – "Objekt 4-5-7-8-9-10 kate, me 1 kat dyqane, 3-4-6-7-8-9 kate banim + 1 kat parkim nëntokë, në lagjen "Pavarësia", Vlorë, me subjekt ndërtues "A.....I" .
Nga auditimi i dosjes konstatohet se mungojnë faturat e konfirmimeve për pagesat e tarifave të akteve të kontrollit të ushtruara nga specialistët e DPKZH, dhe nuk është kryer kontrolli pas depozitimit në dosje të situacionit përfundimtar të punimeve dhe kontrollit të vlerës të tij sipas përllogaritjes së bërë në autorizimin e pagesës në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit.

Vendim nr.4, datë 16.02.2017 – "Godinë banimi dhe shërbime 8-9-10 kate, me observator, me 1 kat parkim nëntokë, në lagjen "10 Korriku", Vlorë, me subjekt ndërtues "V.....A" ..
Nga auditimi i dosjes konstatohet se:
Mungojnë faturat e konfirmimeve për pagesat e tarifave të akteve të kontrollit të ushtruara nga specialistët e DPKZH, dhe nuk është kryer kontrolli pas depozitimit në dosje të situacionit përfundimtar të punimeve dhe kontrollit të vlerës të tij sipas përllogaritjes së bërë në autorizimin e pagesës në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit.
Afati i lejes së ndërtimit ka përfunduar në datën 31.07.2013 dhe pavarësisht kontrolleve nga specialistët e DPKZH, në datat 16.05.2016, 20.05.2016, 27.05.2016, nuk është evidentuar ky fakt gjatë hartimit të akt kontrolleve apo të jetë informuar autoriteti përgjegjës për marrjen e masave administrative konform Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar, Neni 52-Kundërvajtjet administrative-" dh) shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve, sipas nenit 40 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 100000 lekë deri në 500000 lekë".
Konstatohet se vendimi është marrë në kundërshtim me VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 45/1, Fillimi i funksionimit të sistemit elektronik të lejeve, Pika 3- Duke filluar nga data 1 shtator 2016, aplikimi, pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për leje dhe deklarata paraprake, sipas kësaj rregulloreje, sikurse edhe lëshimi i lejeve dhe ndërveprimi institucional do të kryhet, ekskluzivisht, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.
Në përgjithësi konstatohet se materiali shkresor i audituar nuk është i administruar dhe i arkivuar në formën e kërkuar nga ligji. Dokumentacioni i administruar për çdo dosje të audituar është i mangët në formë dhe përmbajtje, pjesërisht origjinal dhe kryesisht fotokopje.
Sa sipër ngarkohen me përgjegjësi, konform përcaktimeve të Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar, Neni 52-Kundërvajtjet administrative- "1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
c) miratimi i lejes së ndërtimit dhe lëshimi i certifikatës së përdorimit, në kundërshtim me këtë ligj ose me dokumentet e planifikimit në fuqi, dënohet me gjobë nga 1,000,000 lekë deri në 3,000,000 lekë.", Drejtori DPKZH, z E. A.

Grupit të auditimit i janë vendosur në dispozicion me usb nga drejtori i DPKZH, 32 dosje të aplikimeve për certifikata përdorimi, nga sistemi e-leje si dhe tabela e mëposhtme:

Nga auditimi i materialit elektronik (pdf) mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatim të procedurave ligjore në dhënien e lejeve të përdorimit, konstatohet se:
Informacioni mbi dokumentacionin elektronik është jo i plotë dhe nuk është vënë në dispozicion konform Ligjit Nr. 10273, datë 24.04.1010 "Për dokumentin elektronik", në kundërshtim të përcaktimeve të Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar dhe VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, pasi në asnjë rast nuk rezulton që autoriteti përgjegjës të ketë kërkuar nga autoritetet publike të specializuara, shprehjen e opinioneve, relacioneve dhe akteve të konfirmimit të nevojshme për lëshimin e certifikatës së përdorimit; në asnjë rast nuk rezulton që autoriteti përgjegjës të ketë verifikuar në terren konformitetin e akteve të kontrollit; mungojnë raportet e vlerësimit të hartuara nga autoriteti i planifikimit para lëshimit të certifikatës së përdorimit dhe mandatët e pagesave për taksën e certifikatës së përdorimit; në asnjë rast nuk rezulton të jetë kryer kontrolli pas situacionit përfundimtar të punimeve dhe kontrollit të vlerës të tij sipas përllogaritjes së bërë në autorizimin e pagesës në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit;
pasi autoritetet vendore të planifikimit dhe inspektimit nuk bashkëpunojnë dhe nuk bashkërendojnë veprimet ndërmjet tyre duke passjellë zhvillime abuzive në territor dhe dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Vlorë në mosndëshkimin e tyre për kundërvajtjet administrative duke ngarkuar me përgjegjësi, konform përcaktimeve të Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar, Neni 52- Kundërvajtjet administrative- "1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë: c) miratimi i lejes së ndërtimit dhe lëshimi i certifikatës së përdorimit, në kundërshtim me këtë ligj ose me dokumentet e planifikimit në fuqi, dënohet me gjobë nga 1,000,000 lekë deri në 3,000,000 lekë.", Drejtorin e DPKZH, A. M..

Theksojmë se duke qenë se nga Autoriteti Përgjegjës dhe Drejtoria e PKZH, Bashkia Vlorë, grupit të auditimit nuk ju krijuar aksesi në, sistemin e-leje, shprehim rezerva lidhur me numrin e aplikimeve dhe vendimeve të marra nga DPKZH Bashkia Vlorë.

a/4/1-Auditim mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatim të procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për shtyrjen e afateve të lejeve të ndërtimit, referuar nenit 40 dhe 52, të Ligjin nr.107, datë 31.07.2014, i ndryshuar.
Nga auditimi i materialeve shkresore të vëna në dispozicion nga Drejtori i DPKZH, Bashkia Vlorë A. M, si dhe atyre pak dokumenteve të vëna në dispozicion në formatin elektronik pdf, konstatohet se nga kjo strukturë vendimmarrëse në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit, janë shqyrtuar kërkesat dhe janë marrë vendime për shtyrjen e afateve të lejeve të ndërtimit të disa objekteve të cilat janë në shkelje të afatit të lejes.
Theksojmë se nga Drejtori i DPKZH, Bashkia Vlorë, grupit të auditimit të KLSH-së nuk ju dha akses në sistemin e-lejet, dhe për këtë auditimi është kufizuar vetëm të ato dokumente të vëna në dispozicion në formatin hardcopy apo pdf.

Më poshtë paraqiten lejet përkatëse, disa prej të cilave janë të ilustruara edhe me foto aktuale, të vëna në dispozicion të grupit të auditimit nga IMTV Bashkia Vlorë, në përmbushje të kërkesës të KLSH, por dhe detyrimit institucional e ligjor për mbulimin me kontroll të territorit:

Vendim Nr.149, datë 13.12.2016 – "Godinë banimi dhe shërbime 10 kate, me 1 kat dyqane, 9 kate banim dhe 1 kat parkim nëntokë, në lagjen "Pavarësia", Vlorë, me subjekt ndërtues "E.....9" . Afati kohor i lejes shtyhet deri në datën 13.12.2018.
Konstatohet se vendimi është bazuar në Vendimin Nr.804, dt. 24.05.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë (nuk ka dijeni për brendinë e vendimit të gjykatës dhe ky vendim i shkallës së parë nuk është apeluar).

Konstatohet se shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve është kryer nga autoriteti që ka miratuar lejen, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, i ndryshuar, Neni 40, Afati i lejes së ndërtimit, pasi nuk shoqërohet nga kërkesa e arsyetuar e subjektit dhe vërtetimi i pagesës së gjobës për shkeljen e afatit, sipas Nenit 52, Kundërvajtjet administrative, të këtij ligji.
Konstatohet se vendimi është marrë në kundërshtim me VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 45/1, Fillimi i funksionimit të sistemit elektronik të lejeve, Pika 3-Duke filluar nga data 1 shtator 2016, aplikimi, pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për leje dhe deklarata paraprake, sipas kësaj rregulloreje, sikurse edhe lëshimi i lejeve dhe ndërveprimi institucional do të kryhet, ekskluzivisht, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Vendim Nr.3, datë 15.02.2017 – "Pikë karburanti+Autogaz, në lagjen "1 Maji", Vlorë, me subjekt ndërtues "S.....D" . Afati kohor i lejes shtyhet deri në datën 15.02.2018.
Konstatohet se vendimi është bazuar në Vendimin Nr.2200, dt. 27.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë (nuk ka dijeni për brendinë e vendimit të gjykatës dhe ky vendim i shkallës së parë nuk është apeluar).

Konstatohet se shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve është kryer nga autoriteti që ka miratuar lejen, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 107, dt. 31.07.2014, Neni 40, Afati i lejes së ndërtimit, pasi nuk shoqërohet nga kërkesa e arsyetuar e subjektit, grafiku i punimeve dhe vërtetimi i pagesës së gjobës për shkeljen e afatit, sipas Nenit 52, Kundërvajtjet administrative, të këtij ligji.
Konstatohet se vendimi është marrë në kundërshtim me VKM 408 "Rregullore e Zhvillimit të Territorit", e ndryshuar, Neni 45/1, Fillimi i funksionimit të sistemit elektronik të lejeve, Pika 3-Duke filluar nga data 1 shtator 2016, aplikimi, pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për leje dhe deklarata paraprake, sipas kësaj rregulloreje, sikurse edhe lëshimi i lejeve dhe ndërveprimi institucional do të kryhet, ekskluzivisht, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.
Nga inspektimet në terren, konstatohet se punimet vazhdojnë, ndërkohë që shtyrja e afatit të lejes së ndërtimit ka përfunduar në datën 15.02.2018.

Vendim Nr.395, datë 23.08.2017 – "Godinë banimi 1-8-9 kate, me 1 kat dyqane+1 kat parkim nëntokë, në lagjen "Pavarësia", Rruga "Hasan Kushta" (Objekti B-D), Godinë banimi 1-8-11-12 kate, me 1 kat parkim nëntokë, në lagjen "Pavarësia", (Objekti C), Godinë polifunksionale 3 kate, +1 kat nëntokë, në lagjen "Pavarësia", (Objekti E)" me subjekt ndërtues "S.....O 1" . Afati kohor i lejes shtyhet deri në datën 23.08.2021.
Konstatohet se në dokumentacionin shkresor të dorëzuar nga DPKZH mungon formati i aplikimit prej sistemit elektronik të lejeve. Mungon kërkesa e arsyetuar e subjektit për shtyrjen e afatit të punimeve.
Konstatohet se ndodhet grafiku i ri i punimeve dhe është kryer pagesa e gjobës për shkeljen e afatit, sipas Nenit 52, Kundërvajtjet administrative, të këtij ligji, në vlerën minimale prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Vendim Nr.396, datë 23.08.2017 – "Objekt banimi dhe shërbime 2-12 kate, me observator, 2 kate dyqane, 1 kat nëntokë, në lagjen "1 Maji", Vlorë, me subjekt ndërtues "M.....A" . Afati kohor i lejes shtyhet deri në datën 23.02.2018.
Konstatohet se në dokumentacionin shkresor të dorëzuar nga DPKZH ndodhet formati i aplikimit prej sistemit elektronik të lejeve, kërkesa e arsyetuar e subjektit për shtyrjen e afatit të punimeve, grafiku i ri i punimeve dhe është kryer pagesa e gjobës për shkeljen e afatit, sipas Nenit 52, Kundërvajtjet administrative, të këtij ligji, në vlerën minimale prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Nga inspektimet në terren, konstatohet se objekti është i papërfunduar, ndërkohë që shtyrja e afatit të lejes së ndërtimit ka përfunduar në datën 23.02.2018.

Vendim Nr.405, datë 28.08.2017 – "Banesa 3-4 kate, në lagjen "Uji i Ftohtë", Vlorë, me subjekt ndërtues "H.....N" . Afati kohor i lejes shtyhet deri në datën 31.12.2018.

Konstatohet se në dokumentacionin shkresor të dorëzuar nga DPKZH ndodhet formati i aplikimit prej sistemit elektronik të lejeve, kërkesa e arsyetuar e subjektit për shtyrjen e afatit të punimeve, grafiku i ri i punimeve dhe është kryer pagesa e gjobës për shkeljen e afatit, sipas Nenit 52, Kundërvajtjet administrative, të këtij ligji, në vlerën minimale prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Vendim Nr.628, datë 17.01.2018 – "Banesa 4 kate, me 2 kate parkim nëntokë, në lagjen "Uji i Ftohtë", Vlorë, me subjekt ndërtues "F.....I" . Afati kohor i lejes shtyhet deri në datën 15.10.2020.
Konstatohet se në dokumentacionin shkresor të dorëzuar nga DPKZH ndodhet formati i aplikimit prej sistemit elektronik të lejeve, kërkesa e arsyetuar e subjektit për shtyrjen e afatit të punimeve, grafiku i ri i punimeve dhe është kryer pagesa e gjobës për shkeljen e afatit, sipas Nenit 52, Kundërvajtjet administrative, të këtij ligji, në vlerën minimale prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Vendim Nr.331, datë 30.06.2017– "Kompleks banimi dhe shërbimesh 5-6-7 kate, me1 kat parkim nëntokë, në lagjen "1 Maji", Vlorë, me subjekt ndërtues "K.....N" . Afati kohor i lejes shtyhet deri në datën 01.12.2018.
Konstatohet se në dokumentacionin shkresor të dorëzuar nga DPKZH ndodhet formati i aplikimit prej sistemit elektronik të lejeve, kërkesa e arsyetuar e subjektit për shtyrjen e afatit të punimeve, grafiku i ri i punimeve dhe është kryer pagesa e gjobës për shkeljen e afatit, sipas Nenit 52, Kundërvajtjet administrative, të këtij ligji, në vlerën minimale prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.
Konstatohet se në dokumentacionin shkresor të dorëzuar nga DPKZH ndodhet edhe Vendim Nr. 57, datë 29.04.2015 – Zgjatje afati për leje ndërtimi, vendim ky i pasqyruar edhe në Vendimin Nr.331, datë 30.06.2017.
Konstatohet se vendimi është marrë në kundërshtim me Vendimin e KKT, Nr.1, datë 30.07.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e PPV", i ndryshuar, Pika 6, "Për lejet e ndërtimit dhe lejet zhvillimore të miratuara, të cilave u ka përfunduar afati i zbatimit të punimeve, përcaktuar në formularin e lejes përkatëse, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, shtyrja e afatit mund të kryhet nga autoriteti përgjegjës vetëm një herë, për një periudhë jo më të gjatë se afati fillestar i përcaktuar në lejen e ndërtimit".
DPKZH në Bashkinë Vlorë operon me Vendimin e KKT, nr.1, datë 30.07.2015, pasi nuk ka akoma të miratuar PPV.

Leja e ndërtimit për -"Kompleks banimi dhe shërbimesh 5-6-7 kate, me1 kat parkim nëntokë, në lagjen "1 Maji", Vlorë, është miratuar nga KRRT Bashkia Vlorë me Vendim Nr.3/102, datë 07.06.2010, në favor të subjekteve ndërtuese "K.....N" . dhe "E.....N" .
Konstatohet se në faturat e dorëzuara elektronikisht grupit të auditimit nga DPKZH, është plotësuar Faturë Arkëtimi Nr. 200, datë 30.05.2017, taksa për pajisjen me certifikatë përdorimi, për të njëjtin objekt dhe subjekt, të cilit i është miratuar shtyrja e afatit të punimeve.
Konstatohet nga Pasqyra e certifikatave të përdorimit, periudha 01.09.2016 deri 30.09.2017 (sistemi e-lejet), e vënë në dispozicion nga Drejtori i DPKZH , se për këtë objekt është miratuar certifikatë përdorimi Nr. 319, datë. 19.06.2017.

Edhe nga inspektimet në terren konstatohet se certifikata e përdorimit është miratuar pa përfunduar punimet e ndërtimit. Në këtë mënyrë konstatohet se është lëshuar një akt "i pa vërtetë" apo janë plotësuar të dhëna të "pa sakta", përsa objekti edhe pse i pa përfunduar është pajisur me certifikatë përdorimi dhe më pas me leje zgjatje afati punimesh.

Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2014, dt. 31.07.2014, i ndryshuar, Neni 52 -Kundërvajtjet administrative "1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë: c) miratimi i lejes së ndërtimit dhe lëshimi i certifikatës së përdorimit, në kundërshtim me këtë ligj ose me dokumentet e planifikimit në fuqi, dënohet me gjobë nga 1,000,000 lekë deri në 3,000,000 lekë. Mosveprimet e pambështetura në ligj, me pasojë miratimin në heshtje në kundërshtim me ligjin, dënohen me gjobë nga 1,000,000 lekë deri në 5,000,000 lekë".

Së bashku me materialin shkresor të sipërcituar u vendosën në dispozicion të audituesve nga Drejtori i DPKZH, pasqyra e vendimeve për shtyrjen e afateve të lejeve të ndërtimit si më poshtë:

| Nr | nr vendimi | dt vendimi | lloji i lejes | miratim/refuzim | nr protokolli |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 241 | 17.05.2017 | Leje per shtyrjen e afatit te lejes se ndërtimit | miratim | 3463 |
| 2 | 333 | 30.06.2017 | Leje per shtyrjen e afatit te lejes se ndërtimit | miratim | 3877 |
| 3 | 331 | 30.06.2017 | Leje per shtyrjen e afatit te lejes se ndërtimit | miratim | 5130 |
| 4 | 337 | 23.08.2017 | Leje per shtyrjen e afatit te lejes se ndërtimit | miratim | 6089 |
| 5 | 405 | 28.08.2017 | Leje per shtyrjen e afatit te lejes se ndërtimit | miratim | 6521 |
| 6 | 395 | 23.08.2017 | Leje per shtyrjen e afatit te lejes se ndërtimit | miratim | 6561 |
| 7 | 396 | 23.03.2017 | Leje per shtyrjen e afatit te lejes se ndërtimit | miratim | 6679 |

Po në mënyrë elektronike u vunë në dispozicion edhe 6 vendime të tjera për shtyrje afati për të cilat mungon gjithë dokumentacioni ligjor, kërkesa e arsyetuar e subjektit, grafiku i punimeve dhe vërtetimi i pagesës së gjobës për shkeljen e afatit, sipas Nenit 52, Kundërvajtjet administrative, të këtij ligji dhe më konkretisht:

Vendim Nr. 397, datë 23.08.2017, për lëshimin e llojit të lejes "Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit", për projektin "Kapanon i prodhimit të transformatorëve në Oshtimë, Komuna Qendër, Vlorë", e pajisur me leje ndërtimi nr.2/12, datë 27.11.2007, me zhvillues S. L.

Vendim Nr. 333, datë 30.06.2017, për lëshimin e llojit të lejes "Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit", për projektin "Banim dhe hotel 4 kate, me 1 kat nëntokë, në Radhimë", e pajisur me leje ndërtimi nr.3, datë 16.06.2014, me zhvillues A.....i.

Vendim Nr. 629, datë 17.01.2018, për lëshimin e llojit të lejes "Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit", për projektin, e pajisur me leje ndërtimi nr.8/8, datë 17.12.2008, me kërkesë të A. D.

Vendim Nr. 241, datë 17.05.2017, për lëshimin e llojit të lejes "Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit", për projektin "Kompleks banimi dhe shërbimesh 2-3-4-kate + nënçati me 1-2-3 kate

nëntokë ne lagjen "Uji i Ftohte", e pajisur me leje ndërtimi nr.2/339, datë 28/09/2011, me zhvillues A.I.C. .
Vendim Nr. 659, datë 31.01.2018, për lëshimin e llojit të lejes "Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit", për projektin e pajisur me "leje ndërtimi nr. 1/53, datë 24.02.2009", me zhvillues V.....N .
Vendim Nr. 621, datë 15.01.2018, për lëshimin e llojit të lejes "Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit", për projektin e pajisur me "leje ndërtimi nr. 4/4, datë 28.12.2009", me zhvillues E.....A .

Duke qenë se lejet për shtyrjen e afatit të auditimit nuk janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH-së, por vetëm vendimet respektive, ka sjellë për pasojë mos vënien në dispozicion dhe mos auditimin e tyre nga KLSH, veprime apo mos veprime në kundërshtim me nenin 15/2 dhe nenit 25 të ligjit nr. Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", dhe për të cilat ngarkohet me përgjegjësi direkte A. M. me detyrë Drejtor i DPKZH, Bashkia Vlorë.

Shënim: Në përmbledhje të auditimit të materialit të vendosur në dispozicion, vlerësohet se edhe formati i miratimit të lejeve për shtyrjen e afatit të lejeve të ndërtimit (formulari i zbardhjes), i hartuar nga Drejtori i DPKZH është jo i plotë ligjërisht, si nga forma dhe nga përmbajtja, duke i hapur rrugë abuzimeve në marrjen e vendimeve dhe mosrespektimit në mënyrë direkte dhe indirekte të kuadrit ligjor që rregullon këtë fushë.
Lidhur me aplikimin e penaliteteve për lejet e ndërtimit të cilave u ka kaluar afati apo kanë vënë në përdorim objektin pa marrë certifikatën e përdorimit.
Pavarësisht kërkesave të përsëritura nga grupi i auditimit të KLSH-së, nga DPKZH nuk është përmbushur ky detyrim duke mos dhënë asnjë informacion shkresor grupit të KLSH.
Theksojmë se edhe pse sipas rregullores të Bashkisë Vlorë, miratuar me VKB nr. 11, datë 29.03.2012 "Për miratimin e rregullores së organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së bashkisë Vlorë", është organizuar dhe funksionon sektori i Arkivës Teknike/Elektronike, i cili administron të gjithë arkivës e Urbanistikës, kjo në referim të pikës 102 të rregullores, Drejtori i DPKZH ka deklaruar se ka të pa mundur të plotësojë një kërkesë të tillë.
a/5-Auditim mbi detyrimet financiare për marrjen e lejeve zhvillimore dhe të lejeve të përdorimit, rillogaritja nga DPKZH e vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar të objektit;
Në lidhje me auditimin e dokumenteve të DPKZH, mbi detyrimet financiare për marrjen e lejeve zhvillimore dhe të lejeve të përdorimit, rillogaritja e vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar të objektit, për periudhën 01.01.2015-31.12.2017, nga Bashkia Vlorë janë miratuar leje zhvillimore ndërtimi për objekte të ndryshme sipas tabelës së mësipërme.
Në lidhje me auditimin e dokumentacionit të paraqitur nga DPKZH, mbi shlyerjen e detyrimeve financiare për marrjen e lejeve të ndërtimit, rillogaritja nga ana e njësisë së urbanistikës të vlerës së investimit, që është kryer sipas situacionit përfundimtar prej subjekteve përkatëse, konstatohet se:
Taksa e ndikimit në infrastrukturë, është aplikuar në përqindjen sipas miratimit të paketës fiskale miratuar nga këshilli i bashkisë Vlorë, sipas periudha përkatëse:
Për vitin 2016-2018, paketa fiskale është miratuar me vendimin e këshillit të bashkisë. Sipas secilit vendim, niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është miratuar në tri nivele dhe konkretisht:

Taksë e ndikimit në infrastrukturë për deklaratë paraprake dhe ndryshim destiancioni, është në masën prej 3%
Taksë e ndikimit në infrastrukturë për leje ndërtimi zona qendër, është në masën prej 8%
Taksë e ndikimit në infrastrukturë për leje ndërtimi jashtë zonës qendër, është në masën prej 4%
Taksë e ndikimit në infrastrukturë për projektet e infrastrukturës është në masën prej 0.1%
Taksë e ndikimit në infrastrukturë për projektet e infrastrukturës, zona industriale është në masën prej 1%
Tarifë për ndërtimet e reja (mure perimetrale) është në vlerën prej 25 l/m2
Tarifë për leje përdorimi është në vlerën prej 35 l/m2
Tarifë aplikimi për leje ndërtimi është në masën 100/5000
Nga auditimi i praktikave të lejeve të ndërtimit të kaluara me usb në formatin pdf apo hardcopy, pasi ashtu siç e kemi theksuar edhe më parë, grupit të auditimit nuk ju tha akses në sistemin e-leje, dhe në këto kushte vetëm për rastet kur në dosje administrohej fatuara për arkëtim dhe pagesa përkatëse, nga ana jonë është mundur të verifikohen përllogaritja dhe kryerja e pagesës. Në këto kushte refuzojmë të japim një opinion të përgjithshëm për këtë proces.

a/6-Auditimi mbi mandatpagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Vlorë;
Në lidhje me auditimin mbi mandatpagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga DPKZH, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, konstatohet se përllogaritja e detyrimeve është trajtuar në pikën a/5-Auditim mbi detyrimet financiare për marrjen e lejeve zhvillimore dhe të lejeve të përdorimit, rillogaritja nga Drejtoria e Planifikim e Zhvillim Territorit e vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar të objektit;
Kjo pikë nuk është mundur të auditohet pasi nga Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë nuk kërkohet konfirmimi i situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, Vlorë
Theksojmë se pas kërkesave të përsëritura nga grupi i auditimit të KLSH-së, nga Drejtoria e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit, me shkresën nr. 1370, datë 19.02.2018, i është drejtuar zyrtarisht Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Vlorë dhe për dijeni Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën "Kërkesë për informacion", sipas të cilës kërkohet konfirmimi i situacioneve bashkëlidhur shkresës për subjektet ndërtuese dhe nëse janë deklaruar në tatime dhe në çfarë vlere, me ato që janë dorëzuar pranë institucionit tuaj.
Pavarësisht interesimit të vazhdueshëm, deri më sot, kjo përgjigje/konfirmim nuk është bërë i mundur, duke lënë të hapur për KLSH-në verifikimin e kësaj pike në momentin e paraqitjes nga DRT Vlorë, nëpërmjet DPKZH Bashkia Vlorë, të informacionit të kërkuar.

a/7-Auditimi në të gjitha dosjet për depozitimin në to të situacionit përfundimtar të punimeve dhe kontrollit të vlerës të tij sipas përllogaritjes së bërë në autorizimin e pagesës në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit;

Në lidhje me auditimin në të gjitha dosjet për depozitimin në to të situacionit përfundimtar të punimeve dhe kontrollit të vlerës të tij sipas përllogaritjes së bërë në autorizimin e pagesës në momentin e marrjes së lejes së ndërtimit, është trajtuar në pikën, a/4-Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve të përdorimit, hartimi dhe firmosja e procesverbaleve të kolaudimit nga kolaudatori, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve;
a/5-Auditim mbi detyrimet financiare për marrjen e lejeve zhvillimore dhe të lejeve të përdorimit, rillogaritja nga DPKZH e vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar të objektit.
a/8-Auditim mbi mbajtjen e akteve të kontrollit për lejet e miratuara.
Në lidhje me auditimin mbi mbajtjen e akteve të kontrollit për lejet e miratuara, është trajtuar në pikën, a/4-Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve të përdorimit, hartimi dhe firmosja e procesverbaleve të kolaudimit nga kolaudatori, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve. Kjo nën pikë është trajtuar gjatë pikës a/3 dhe a/4.

Duke qenë se nga Drejtori i DPKZH nuk u krijuar aksesi në sistemin e-leje dhe nuk u paraqit asnjë dokument lidhur me punonjësit të cilët kanë ndjekur praktikat e miratimit të lejeve të zhvillimit, lejeve të përdorimit apo zgjatjeve të afatit të lejeve, grupi i auditimit e ka të pa mundur për të evidentuar shkeljet dhe parregullsitë e kryera nga secili punonjës e për rrjedhojë, janë trajtuar me përgjegjësi për shkelje të ligjit nr.107/2014, datë 01.09.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" dhe VKM nr. 671, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", Drejtorit të Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, A. M., por dhe Drejtori Juridik D. Z., për praktikat e miratimit të lejeve me vendime gjyqësore të paankimuara.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 9276/8, datë 03.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga Drejtori i DPKZH E. A rast pas rasti janë paraqitur shpjegime e kundërshtime lidhur me konstatimet e grupit të auditimit në drejtim të mangësisë në dokumentacion, rasteve të lejeve të miratuara me vendim gjykate (pa sistem e-lejet), praktikave të miratimit të certifikatave në shkelje të lejes (afat apo volume), respektimit të distancave për leje, aplikimin e penaliteteve për vonesat në përfundim të objektit apo vënies në përdorim të tij pa u pajisur më parë me certifikatë përdorimi.*
*Nga grupi i auditimit ekzistenca e mandat pagesave (të vëna në dispozicion nga Natasha Rusha) merret në konsideratë edhe pse është në përgjegjësinë tuaj që dokumente të tilla nuk u vunë në dispozicion të grupit gjatë auditimit. Theksojmë se kjo problematikë është si rezultat i mos lejimit nga ana juaj të grupit të auditimit të eksesit në sistemin e-lejet. Përsa i përketvendimeve për shtyrje afati (6 raste) të cilat janë jashtë afatit të auditimit sqarimi juaj merret në konsideratë (praktika për tu audituar në auditimin e radhës). Përsa i përket mangësive të tjera, ato nuk merren në konsideratë pasi pavarësisht sqarimeve*
*Pretendimi merret në konsideratë pjesërisht vetëm për ekzistencën e dokumenteve të pagesës së taksave dhe 6 vendime për shtyrje afati leje.*

Auditimi i ndjekjes të proceseve gjyqësore me palë të paditur Bashkinë Vlorë, lidhur me detyrimin e institucionit për pajisjen e subjekteve ndërtimor me leje ndërtimi.
Sipas deklarimit të drejtorit përkatës dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Juridike, lidhur me proceset gjyqësore me objekt padie: "Kundërshtimin e refuzimit për zbardhje të lejeve të

ndërtimit dhe detyrimin e Bashkisë Vlorë për pajisjen me leje ndërtimore apo zgjatje të afateve të lejes ndërtimore" bashkia ka qenë palë në 28 procese gjyqësore.

Lidhur me sa sipër nga auditimi me zgjedhje i praktikave, në një rast u konstatua se:
Çështja me palë paditëse "B.....O" dhe palë të paditur Bashkinë Vlorë dhe objekt padie "Detyrimi i të paditurve të pajisin paditësin me formularët ligjorë të sheshit dhe lejes së ndërtimit", proces në të cilin Bashkia Vlorë është përfaqësuar nga Juristja A. P (L....o) sipas autorizimit nr. ekstra datë 21.09.2017, për të cilën u konstatua se:
Kërkesë padia është regjistruar më datë 01.08.2017 me nr. 1516 akti.
Më datë 05.10.2017, juristi i bashkisë ka paraqitur në formë shkresore diskutimet përfundimtare lidhur me çështjen objekt gjykimi duke parashtruar shkaqet ligjore përse padia nuk duhet pranuar; në DPKZH nuk evidentohet gjendja fizike e dokumentacionit tekniko-ligjor për vendimin nr. 2/226, datë 08.09.2011 në emër të "B.....o" ; vendimi nr. 35, datë 10.10.2013 të Kryetarit të KRRT (me numër rendor 30) është bërë revokimi i sheshit dhe lejes së ndërtimit miratuar përkatësisht me vendimin nr. 2/225 dhe 2/226, datë 28.09.2011 të KRRT Bashkia Vlorë për objektin 4-6-8 kate me 1 kat nëntokë në lagjen "Pavarësia" me pronar trualli I. B me subjekt ndërtues "B.....o" ; në kushtet e revokimit të lejes, mungesës totale të mbështetjes sipas përcaktimeve në dispozitat ligjore në fuqi mbi veprimtarinë ndërtimore, në kushtet që aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi e pengojnë dorëzimin e dokumentit të noterit "B.....o" ; të gjitha zhvillimet në territor do të shqyrtohen e miratohen bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi për veprimtarinë ndërtimore dhe në përputhje me PPV; pas miratimit nga KRRT e vendimeve të mësipërme, është miratuar ligji aktual 107/2014 i cili në dispozitat kalimtare ka përcaktuar si afat të përfundimit të procedurave mbi lejet e ndërtimit të miratuara më para datës 15.10.2017; duke kërkuar si përfundim rrëzimin e kërkesë padisë si të pa pabazuar në prova e ligj.
Më datë 16.10.2017, me nr. akti 1516 dhe vendimi 1318, Gjykata Administrative e Shkallës së parë Vlorë, ka vendosur "Pranimin e kërkesë padisë si të bazuar në prova dhe ligj; shfuqizimin e aktit administrativ nr. 35, datë 10.10.2013 të Kryetarit të KRRT Bashkia Vlorë; detyrimin e palëve të paditura DPKZH, Bashkia Vlorë dhe Kryetarit të Bashkisë Vlorë, të pajisin palën paditëse shoqëria "B.....O" , me formularët ligjorë të sheshit dhe lejes së ndërtimit, të miratuara respektivisht sipas vendimeve nr. 2/225 dhe 2/226, datë 28.09.2011 të KRRT Bashkia Vlorë"(në shpalljen e vendimit Bashkia Vlorë rezulton në mungesë).
Kundër vendimit me shkresën nr. 11043, datë 04.12.2017, rezulton të ketë bërë ankim Juristi A. P (Lamepetro), duke parashtruar të gjitha shkaqet e mundshme si: në DPKZH nuk evidentohet gjendja fizike e dokumentacionit tekniko-ligjor për vendimin nr. 2/226, datë 08.09.2011 në emër të "B.....O" ; vendimi nr. 35, datë 10.10.2013 të Kryetarit të KRRT (me numër rendor 30) është bërë revokimi i sheshit dhe lejes së ndërtimit miratuar përkatësisht me vendimin nr. 2/225 dhe 2/226, datë 28.09.2011 të KRRT Bashkia Vlorë për objektin 4-6-8 kate me 1 kat nëntokë në lagjen "Pavarësia" me pronar trualli I. B me subjekt ndërtues "B.....O" ; në kushtet e revokimit të lejes, mungesës totale të mbështetjes sipas përcaktimeve në dispozitat ligjore në fuqi mbi veprimtarinë ndërtimore, në kushtet që aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi e pengojnë dorëzimin e dokumentit të noterit "B.....O" ; të gjitha zhvillimet në territor do të shqyrtohen e miratohen bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi për veprimtarinë ndërtimore dhe në përputhje me PPV; pas miratimit nga KRRT e vendimeve nr. 2/225 dhe 2/226, datë 28.09.2011, është miratuar ligji aktual 107/2014 i cili në dispozitat kalimtare ka përcaktuar si afat të përfundimit të procedurave mbi lejet e ndërtimit të miratuara më para datës

15.10.2017 dhe pas përfundimit të këtij afati nuk mund të vijohet me lejes së lejeve të ndërtimit për subjektet të cilat nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore e financiare kundrejt bashkisë
E gjithë procedura dhe mbrojtja ligjore e përfaqësuesit të institucionit, pra parashtrimi i shkaqeve dhe rrethanave ligjore të cilat kanë detyruar bashkinë për mos pajisjen e subjektit me lejen ndërtimore, rezulton në përputhje me referencat ligjore. Pavarësisht sa cituar për rastin konkret ka rezultuar se:
Shkresën nr. 11043/1, datë 05.12.2017, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është paraqitur "Kërkesë për heqjen dorë nga ankimi datë 04.12.2017", shkresë e firmosur konceptuar nga zj. A. P dhe Miratuar nga Drejtori Juridik D. Z. dhe Drejtori i Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit A. M.. Sipas shkresës, bëhet me dije gjykata se më datë 04.12.2017 Bashkia Vlorë ka paraqitur ankim ndaj vendimit 1318, datë 16.10.2017, të gjykatës duke parashtruar kundërshtimet përkatëse. Palët e interesuara paraqitën kërkesë në Bashkinë Vlorë sipas të cilës dokumentacioni i subjektit "B.....O" është depozituar në DPKZH i plotë. Në këto kushte, u rishikua dokumentacioni i depozituar në DPKZH të bashkia Vlorë dhe në vlerësim të tyre u konkludua se duhet të heqim dorë nga ankimi. Në këto kushte i drejtohemi gjykatës me këtë kërkesë për heqje dorë nga ankimi nr. 04.12.2017.

**Në përfundim të sa cituar rezulton se:**
-Lidhur me procesin gjyqësor me palë të paditur "B.....O", ku ka rezultuar se juristi i autorizuar ka bërë ankim dhe të nesërmen e depozitimit të tij ka bërë shkresë për tërheqje ankimi, shkresë e firmosur nga D. Z dhe E. A. Nënshkrimi i shkresës nga Drejtori Juridik dhe Drejtori i DPKZH është bërë pa pasur një tagër të tillë të deleguar nga Kryetari i Bashkisë edhe pse shkresa e revokimit është nënshkruar proceduralisht prej tij.
Shkaqet ligjore të cilat Juristi ka mbrojtur çështjen dhe ka paraqitur ankimin rezultojnë të mirë mbështetura ligjërisht dhe të argumentuara me aq pak dokumente që ekzistojnë lidhur me praktikën (vetëm vendimi i revokimit të lejes), ndryshe nga shkaqet e revokimit të ankimit të cilat i referohen një ankimi të bërë nga palët e interesuara, ankim i cili nuk rezulton të jetë administruar gjëkundi, pra nuk ka të dhëna nëse ekziston apo jo (ose së paku nuk është vënë në dispozicion të grupit të auditimit). Arsyetimi i përdorur në kërkesën për revokim është kontradiktor me referencat ligjore të perënduara me të drejtë nga Juristi në ankim, paraqitën kërkesë në Bashkinë Vlorë sipas të cilës dokumentacioni i subjektit "B.....O" është depozituar në DPKZH i plotë, pasi pretendohet të jetë rishikua dokumentacioni i depozituar në DPKZH të Bashkia Vlorë dhe në vlerësim të tyre u konkludua se duhet të heqim dorë nga ankimi, kur nuk ka asnjë dokumente ekzistues në Arkivën Teknike të DPKZH. Në këto kushte nuk arrihet të konkuludohet konkluzion se çfarë të "rejash" kanë konstatuar Drejtori Juridik dhe Drejtori i DPKZH, si dhe nuk dihet çfarë dokumentacioni qenka rishikuar prej tyre në DPKZH, kur ekziston vetëm një faqe format A4 revokimi vendimi.
Po ashtu lidhur me këtë çështje rezulton se Drejtori i DPKZH A. M., ka qenë në kushtet e deklarimit të konfliktit të mundshëm të interesit pasi prona mbi të cilën kërkohet detyrimi i Bashkisë Vlorë të bëj zbardhjen e lejes së ndërtimit figuron e regjistruar në emër të bashkëshortes së tij dhe konkretisht: sipas kontratës së dhurimit nr. 1219 rep dhe 534 kol, datë 10.07.2017 të nënshkruar para noterit A. D, shoqëria A.....N me administrator M. K, përfaqësuar me prokurë nga E. A dhe F. H, kanë bërë kalimin e ½ pjesë të një pasurie të ndodhur në zk.8603 me sipërfaqe 895m2 dhe ndërtesë 102.3m2, me numër pasurie 28/566, regjistruar në volum 42, faqe 68, për të cilën është lëshuar certifikata e pasurisë më datë 12.04.2017. Më parë mbi këtë pasuri është regjistruar edhe kontrata e shkëmbimit nr. 417 rep dhe 254/1 kol, datë 10.04.2017, sipas të cilës pronari i mëparshëm i truallit I. B ka bërë shkëmbimin e

pasurisë së sipërcituar me një apartament regjistruar në me nr. 43/116+1-13, regjistruar në volum 38 faqe 141 në zk 8605. Përveç sa sipër nga verifikimi në terren rezulton se mbi truallin e sipërcituar ka filluar ndërtimi i një objekti shumëkatësh, por nga DPKZH Bashkia Vlorë, grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion dokumentacioni përkatës, për ta audituar.

Sa sipër veprimet apo mosvperimet e kryera janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64 "Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë" pika "gj", sipas të cilës: "Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët", Kodin e Proceduarve Civile, nenin 452 "Vendimet që mund të ankimohen", sipas të cilit "Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj. Nënshkrimi i ankimit Ankimi që i drejtohet gjykatës së apelit duhet të nënshkruhet nga vetë pala, avokati ose përfaqësuesi i pajisur me prokurë", si dhe ligji nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, "Dispozita kalimtare", shtuar me ligjin nr. 28/2017, datë 23.3.2017), sipas të cilit "Për lejet e ndërtimit, të cilave u ka përfunduar afati i zbatimit të punimeve, përcaktuar në formularin e lejes përkatëse, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, shtyrja e afatit mund të kryhet nga autoriteti përgjegjës, me kërkesë të zhvilluesit, me kushtin që të mos kenë kaluar më shumë se 10 vjet nga data e miratimit të lejes së ndërtimit dhe subjekti të ketë paguar paraprakisht penalitetet e parashikuara nga neni 52, i ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar. 2. Në rast se punimet e ndërtimit për këto leje nuk kanë filluar, në kuptim të nenit 9, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, deri në datën e hyrjes në fuqi të dokumentit të përgjithshëm vendor të planifikimit, shtyrja e afatit të lejes përkatëse bëhet pas përputhshmërisë me planin e përgjithshëm vendor".

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 1203/2, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga Drejtori i DPKZH E. A janë bërë sqarime lidhur me procesin gjyqësor me shoqërinë "B.....O", duke argumentuar se procedura aktuale nuk ka lidhje me lejen pasi ajo nuk pëson asnjë ndryshim dhe nuk ndikohet nga transferimi i pronës, dhe në bazë të këtyre të dhënave nuk jemi në kushtet e konfliktit të interesit.*
*Nga ana juaj duhet ti ishte bërë me dije titullarit të institucionit marrëdhënia konkrete midis pronarëve të truallit, shoqërisë sipërmarrëse dhe pozicionit tuaj konkret dhe më tej pas një vlerësimi të tij mund të kishit proceduar. Pavarësisht sa sipër nuk është KLSH institucioni i cili vlerëson nëse jemi apo jo para plotësimit të kushtit të konfliktit të interesit, por institucione të tjera të ngarkuara sipas ligjit. Nga grupi i auditimit vetëm sa janë cituar faktet dhe ekzistenca e mundshme e një konflikti interesi.*
*Pretendimi nuk merret në konsideratë.*

-*Auditimi i procedurave të zhvilluara në Bashkinë Vlorë, Drejtorinë Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, lidhur me ankesën e qytetarit Anesti Çaushaj*.
Në adresë të KLSH me shkresën e administruar me nr. 1042, datë 09.10.2017, nr. 1142, datë 01.11.2017 dhe nr. 68, datë 18.01.2018, qytetari A. C, ka bërë prezent shqetësimin lidhur me përfundimin e objektit "Banesë 7 kate, 2 kate Dyqane, 5 kate Banim + 1 kat Parkim", në lagjen "Hajro Çakërri" Vlorë, miratuar me lejen nr. 5/134, datë 17.08.2010, me investitor "D.....i" , Mbikëqyrës punimesh, V. GJ dhe Kolaudator Ing E. P dhe A. F. Objekt i pajisur me certifikatë përdorimi nr.

02.06.2015. Sipas ankesës nga qytetari njëherazi edhe pronar trualli mbi të cilin është ngritur edhe objekti, pretendon se objekti nuk ka përfunduar plotësisht apo së paku nuk është zbatuar sipas lejes, duke nënvizuar se: Trotuaret janë ende të pa përfunduar; Ashensorët të pa vendosur; Garazhet të pa përfunduar.
Referuar pretendimit të qytetarit, grupi i auditimit kërkoj dokumentacionin shoqërues të Certifikatës së Përdorimit, si dhe korrespondencat e mbajtura nga Bashkia Vlorë lidhur me kërkesat e qytetarit drejtuar këtij institucioni, pas miratimit të certifikatës së përdorimit si dhe verifikoj në vend objektin.
Foto të gjendjes aktuale të objektit "Banesë 7 kate, 2 kate Dyqane, 5 kate Banim + 1 kat Parkim", në lagjen "Hajro Çakërri" Vlorë, miratuar me lejen nr. 5/134, datë 17.08.2010, me investitor "D.....i" , ku përfshihet hyrja e ashensorit, hyrja e parkimit dhe një pjesë trotuari të objektit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi si vijon:
Me protokoll nr. 2188, datë 02.06.2015 dhe nr. 39, datë 02.06.2015 është miratuar nga ish-Kryetari i Bashkisë Vlorë, Certifikata e përdorimit për objektin "Banesë 7 kate, 2 kate Dyqane, 5 kate Banim + 1 kat Parkim", në lagjen "Hajro Çakërri" Vlorë, miratuar me lejen nr. 5/134, datë 17.08.2010, me investitor "D.....i" . Leja është dërguar për regjistrim në ZVRPP Vlorë me shkresën nr. 2953, datë 30.07.2015.
Për lëshimin e certifikatës së përdorimit Bashkia Vlorë është referuar/bazuar në dokumentin Relacion Supervizimi, të hartuar në vitin 2012 nga V. GJ, sipas të cilit, në përfundim të raportit citohet se "Objekti është gati për tu kolauduar".
Lidhur me këtë akt duhet theksuar se në asnjë rresh Mbikëqyrësja e Punimeve, nuk ka evidentuar mosfunksionimin e ashensorit, garazheve apo mos përfundimin e plotë të trotuareve rrethues të objektit.
Aktkontrolli për realizimin e punimeve ndërtimore (përfundimtare e karabinasë për të gjithë objektin) datë 09.02.2012, hartuar nga punonjësja e Drejtorisë të Planifikimit të Territorit Ing. M. T, ka saktësuar se Objekti në karabina është ndërtuar 1-kat nën tokë (podrum) dhe është ndërtuar dalja e kafazit të shkallëve dhe kullës së ashensorit, sipas projektit të miratuar.
Aktkontrolli nuk paraqet të dhëna të sakta përsa i përket katit nëntokë i cili sipas dokumentacionit teknik e ligjor të projektit dhe lejes ndërtimore nuk është podrum por parkim.
Aktkontrolli për realizimin e punimeve ndërtimore (përfundimin e sistemimit të jashtëm në sheshin e ndërtimit sipas projektit) datë 09.02.2012, ka saktësuar se Objekti në karabina është ndërtuar 1-kat nën tokë (podrum) dhe është ndërtuar dalja e kafazit të shkallëve dhe kullës së ashensorit, sipas projektit të miratuar, si dhe ka përfunduar trotuari përreth objektit dhe sistemi i ambientit të jashtëm sipas plan sistemimit të miratuar
Aktkontrolli nuk paraqet të dhëna të sakta përsa i përket katit nëntokë i cili sipas dokumentacionit teknik e ligjor të projektit dhe lejes ndërtimore nuk është podrum por parkim, po ashtu nuk ka evidentuar faktin se trotuari në të dy krahët hyrëse për në shkallë është pjesërisht i pa sistemuar dhe sigurisht nuk evidentuar se ashensori ka të instaluar vetëm kapakët e tij.
Aktkolaudimi shtator 2014, hartuar nga Kolaudatoret Ing. E. P dhe A. F, sipas të cilit në pikën 9 "Përfundimi i sistemimit të jashtëm të territorit", verifikimi i përfundimit të punimeve është kontrolluar më datë 29.09.2014. Ka përfunduar sistemimi i jashtëm në sheshin e ndërtimit sipas projektit dhe konkretisht:
"....Investitori ka respektuar...projektin e miratuar nga KRRT...".

"Objekti është ndërtuar një 1-kat nëntokë (podrum)..... është ndërtuar dalja e kafazit të shkallëve dhe kullës së ashensorit në tarracën e katit të shtatë sipas projektit".
"Është ndërtuar trotuari përreth objektit".
Në pikën 12 "Lidhja e objektit me rrjetin e infrastrukturës inxhinierike", sipas të cilit:
Nga sektori i PMNZZH...më datë 08.10.2012 është lëshuar akti teknik për zbatimin e detyrave të lëna dhe lejimin e shfrytëzimit të objektit e konkretisht: "Në garazhe ka të instaluar sistemin automatik të mbrojtjes kundra zjarrit...".
Në pikën 14 "Zbatimi i projektit teknik", sipas të cilit: "Objekti në karabina është ndërtuar një kat nën tokë (podrum)..., është ndërtuar dalja e kafazit të ashensorit....sipas projektit të miratuar".
Në pikën 15 "Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit", sipas të cilit:
"Objekti i ndërtuar ka një kat nën tokë bodrum".
"Në bodrumin e pallatit së bashku me pompën është vendosur një rezervuar..."
"Janë ndërtuar trotuaret përreth objektit dhe janë shtruar me pllaka trotuari dhe sistemuar ambienti përreth".
"Në objekt janë montuar një ashensor me kapacitet 500kg"
Në pikën "kati nëntokë, destiancioni Podrum" citohet se:
"Kati nëntokë i objektit ka sipërfaqe prej 355.8m2 dhe janë ndërtuar dy ambiente me sipërfaqe 75m2 dhe 245m2..."
Në përfundim të sa sipër, grupi i kolaudimit ka arritur në konkluzionin se ky objekt është ndërtuar dhe zbatuar konform projektit të miratuar dhe se plotëson kushtet teknike dhe funksionale për shfrytëzim.
Sipas dokumentacionit të paraqitur në KLSH rezulton se z. C.....i është drejtuar disa herë në Bashkinë Vlorë, duke paraqitur po të njëjtat probleme si dhe ato të bëra prezent KLSH-së, kërkesa për të cilat institucioni (Bashkia Vlorë) rezulton tu ketë kthyer përgjigje me shkresat nr. 1142/1, datë 18.07.2016, nr. 1688/1, datë 29.08.2016, nr. 2090/1, datë 24.04.2017, shkresa të punuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, specialistët Ing. A. C, F. D dhe të miratuara nga Drejtori E. A. Lidhur me këto shkresa rezulton se kanë karakter standard, nuk kanë analizuar e vlerësuar problematikën si dhe nuk kanë dhënë asnjë zgjidhje ligjore apo institucionale problemit, duke u përpjekur ta mënjanojnë atë.
Në përfundim, konstatohet se objekti nuk është zbatuar sipas lejes ndërtimore, përsa i përket katit nëntokë parkim i cili është zbatuar por pa realizuar rampën për të aksesuar hyrjen në parkim, dhe në mungesë të saj është bërë hyrje me shkallë për këmbësor
Ashensori ka të vendosur vetëm kapakët e jashtëm dhe nuk rezulton të jetë montuar plotësisht ndonjëherë apo edhe të ketë qenë ndonjëherë funksional.
Trotuari është rregulluar në pjesën më të madhe të objektit, por nuk është rregulluar për disa metra linear nga të dy anët e hyrjes për në pjesën e banimit.
Në këto kushte proceduar e kryera nga punonjësit e Bashkisë Vlorë, por dhe të tjerë të cilët kanë dhënë miratimin dhe pëlqimin e tyre duke deklaruar se objekti është i ndërtuar dhe është funksional sipas lejes së miratuar, nuk përkon me situatën faktike të tij, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi ish-Kryetari i Bashkisë Sh. Gj. në cilësinë e miratuesit të Certifikatës së Përdorimit dhe punonjësit E. P dhe A. F, të cilët kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 107/2017, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" si dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", si dhe Kryeinspektori i IMTV D. T., për mos zbatim të ligjit nr.

9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" pasi në referim të nenit 5 të ligjit dhe nenit 52 të ligjit nr. 107/2017, datë 31.07.2014, nuk ka aplikuar sanksione ndaj subjektit ndërtues përsa i përket zbatimit të projektit në kundërshtim me atë të miratuar.
Po ashtu me përgjegjësi ngarkohet edhe Drejtori i DPKZH Bashkia Vlorë A. M., lidhur me mos trajtimin korrekt të kërkesave të qytetarit, pasi edhe pse problematika e bërë prezent është lehtësisht e evidentueshme në terren, nuk ka marrë apo kryer asnjë lloj procedure konstatuese apo verifikuese, duke u kufizuar në përgjigje standarde e të pakuptimta, devijuar përmbajtjen e problematikës, duke mos marrë përsipër përgjegjësitë institucionale referuar ligjit nr. 107/2017, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", apo ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", si dhe ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga DPKZH, punonjësit A. B, N. R, E. A, A. C dhe F. D, lidhur me ankesën e qytetarit A. C, sqarohet mos pasja e përgjegjësive për aktin e kolaudimit dhe lëshimin e lejes përdorimit me arsyetimin se nuk ka qenë përgjegjësi funksionale e tyre.*
*Nga grupi i auditimit merret në konsideratë mos përgjegjësia lidhur me aktin e kolaudimit dhe certifikatën e përdorimit, ndërsa përsa i përket përgjegjësisë lidhur me ankesat e qytetarit mbetet në përgjegjësi të drejtorit të DPKZH. Pretendimi merret në konsideratë për përgjegjësinë.*
*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 1701/1, datë 06.03.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga punonjësit E. P dhe A. F janë sqaruar procedurat lidhur me objektin e ndërtuar nga "D.....i" , duke argumentuar se objekti sipas lejes së ndërtimit, formulari nr. 4, bën fjalë për një kat nëntokë por nuk ka përcaktuar pendus për parkim dhe përsa i përket ashensorit në momentin e mbajtjes së akt kolaudimit ashensori ka qenë i montuar fizikisht., por për shkak të moslikujdimit të vlerës të tij, montuesi ka bërë heqjen e elektromotorit duke lënë vetëm dyer e shina.*
*Nga grupi i auditimit merret në konsideratë sqarimi përkatës përsa i përket problematikave në lidhje me miratimin e lejes së ndërtimi e cila ka përcaktuar se objekti ka një kat nëntokë, por pa përcaktuar nëse është parkim apo shërbim, edhe pse në dokumentet/skicat e planimetritë e secilit kat, për katin nëntokë shënohet parkim, por jo në lejen përkatëse. Përsa i përket ashensorit, duke qenë se në dosje nuk ka dokumente që provojnë vënien në funksion të tij, por vetë sqarimin tuaj dhe faktin se sot jemi para ekzistencës vetëm të portave dhe shinave, grupi i auditimit nuk mund të shprehet ndryshe nga fakti. Argumentet merren në konsideratë pjesërisht.*

## III/6.2. Organizimi dhe funksionimi i IMTV

*b. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).*

Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IMTV Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Personelit, në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, për periudhën 01.01.2015 deri më 32.12.2017, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i përbërë nga:

| Nr | Emër Mbiemër | Funksioni sipas strukturës | Lloji i arsimit/dega | Data emërimit | Aktualisht në punë apo larguar, data |
|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | në detyrë | |
| 1 | K. R | Kryeinspektor | I larte Juridik | 01.03.2017 | Aktualisht ne pune |
| 2 | D. T | Kryeinspektor | I larte juridik | 19.03.2014 | 05.04.2016 |
| 3 | I. T | Kryeinspektor | I larte Ing | 07.04.2016 | 28.02.2017 |
| 4 | M. M | Inspektor | I larte juridik | 12.09.2013 | Aktualisht ne pune |
| 5 | R. F | Inspektor | I larte Juridik | 04.11.2013 | Aktualisht ne pune |
| 6 | A. S | Inspektor | I Larte Ekonomik | 12.09.2013 | Aktualisht ne pune |
| 7 | Z. S | Inspektor | I larte Juridik | 08.09.2017 | Aktualisht ne pune |
| 8 | U. H | Juriste | I larte Juridik | 11.09.2017 | Aktualisht ne pune |
| 9 | R. M. | Inspektore | I larte Ing | 08.04.2016 | Aktualisht ne pune |
| 10 | O. B | Inspektore | I larte Juridik | 09.03.2017 | 01.06.2017 |
| 11 | I. D | Inspektore | I larte Ing | 12.09.2012 | 22.05.2016 |
| 12 | O. B | Inspektore | I lartë Ekonimiks | 07.01.2014 | 05.04.2016 |

Në dy raste emërimet e dy inspektorëve të IMTV A. S dhe O. B, janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, neni 11, Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit. Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fakultetin e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

*VI/b/2-Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.*

Në lidhje me detyrat funksionale të strukturës së IMTV (ish INUV), nga kryeinspektori i IMTV u paraqitën të dhëna dokumentare mbi plane pune javore, mujore dhe vjetore mbi aktivitetin e kësaj strukture, për kryerjen e kontrollit në territorin administrativ të Bashkisë, për periudhën objekt auditimi. Konstatohet se planet e punës javore, mujore dhe vjetore janë të protokolluara dhe të nënshkruara nga titullari i Bashkisë, është programuar dhe planifikuar tematika e kontrollit që do të ushtrohet në territorin e bashkisë, ditët në të cilat do të ushtrohet kontrolli dhe zbatuesit e programit të kontrollit të cilët janë personat përkatës të zyrës së IMTV që do të ushtrojnë kontrollin e terrenit.
Në lidhje me auditimin e kryer të dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IMTV, për ushtrimin e kontrollit në terren të kontrollit mbi territorin e Bashkisë, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Vlorë për periudhën 01.01.2015 deri 31.12.2017 rezultoi se janë mbajtur gjithsej 392 nga të cilat 37 për vitin 2015, 234 për vitin 2016 dhe 121 për vitin 2017, procesverbale konstatimi për ndërtime pa leje, në zbatim të nenit 12, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, për të cilat kanë vijuar procedurat e mëtejshme ligjore, sipas nenit 13, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale IMTV Bashkia Vlorë, sipas evidencave të vëna në dispozicion rezultoi se:
- Nuk ka vendime për pezullimin e punimeve të ndërtimit për objekte të ndërtuar pa leje ndërtimi por ka 17 vendime për subjekte ndërtuese të pajisur me leje ndërtimi.
- Janë marrë 104 vendime për vendosje gjobe për ndërtimet pa leje ndërtimi nga të cilat për subjekte ndërtuese të pajisur me leje janë për vitin 2015 janë 3, për vitin 2016 janë 14 dhe për vitin 2017 janë 16, ndërsa nga subjekte private apo individë për vitin 2015 janë 16, për vitin 2016 janë 11 dhe për vitin 2017 janë 45.

- Për vitin 2015-2017 Janë marrë 305 vendime për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi apo për ndërtime që preken nga investime publike.

Nga IMTV dhe ish-INUV, Bashkia Vlorë, janë ushtruar kontrolle në terren dhe janë marrë vendime për pezullim punimesh, vendim për dënim me gjobë dhe vendime për prishje objekte të ndërtuara pa leje ndërtimi si vijon:

| Nr. | Emërtimi i vendimit | Sasia |
|---|---|---|
| 1 | Vendime për pezullim punimesh ndërtim me afat 10 ditor | 15 |
| 2 | Vendime për pezullim punimesh ndërtim me afat 60 ditor | 2 |
| 3 | Vendime për prishje objektesh | 305 |
| 4 | Vendime për gjoba | 104 |
| 5 | Vendim për kallëzim penal | 82 |

Në ushtrimin e detyrave funksionale të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Vlorë për periudhën objekt auditimi, aktiviteti i veprimtarisë së punës në terren i cili është pasqyruar dhe dokumentuar me procesverbale konstatimi dhe për më tej me vendime pezullimi punimesh dhe vendime për prishje objekti të ndërtuar pa leje ndërtimi, në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelat e bashkëlidhura aktkonstatimit dhe projektraportit.

Nga të dhënat pasqyruara në tabelë konstatohet se nga 30.750.000 lekë gjoba të vendosura është mundur të arkëtohen rreth 10% e tyre ose 2.900.000 lekë dhe mbeten për tu arkëtuar vlera prej 27.850.000 lekë shumë e cila përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë.

Vendime për prishje:

Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar, VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV" i ndryshuar, IMT Bashkia Vlorë ka marrë 305 vendim për prishje (sipas tabelës bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit), të cilat dhe janë ekzekutuar.

Kallëzim penal:

Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar, VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV" i ndryshuar, IMT Bashkia Vlorë ka bërë 42 kallëzim penal bazuar në kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar, VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV" i ndryshuar, sipas tabelës Projektraportit të Auditimit.

Nga ballafaqimi me punonjësit e IMTV dhe shqyrtimi i dokumentacionit shkresor të vënë në dispozicion, konstatohet janë rreth 120 procesverbale ekzekutimi mbajtur për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi, por gjithësisë jo për të gjitha praktikat e ekzekutimit, veprim jo në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative", neni 14, "Mënyra e mbajtjes së procesverbalit apo e një dokumenti tjetër të barasvlershëm me të".

Në lidhje me rivendosjen në afat në Gjykatën Administrative të vendimeve me gjobë të vendosura gjatë viteve të mëparshme, nga IMTV, bazuar në nenet 151 dhe 152 të "Kodit Procedurës Civile në RSH", u konstatua se nuk ka raste të rivendosjes në afat të detyrimeve.

Në lidhje me kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv, nga IMTV dhe Drejtoria Juridike, në zbatim të nenit 24 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", për gjobat e pa

arkëtuara vullnetarisht, u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë ndjekur apo janë në proces gjyqësor 41 praktika të cilat janë trajtuar apo janë në proces trajtimi e vlerësimi nga gjykata.
Në lidhje me përllogaritjen nga IMTV të vlerës së investimit për rastet e ndërtimeve pa leje dhe të vendosej gjoba përkatëse, u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer përllogaritje vlere investimi për ndërtimet pa leje.
Në lidhje me marrjen ose jo në konsideratë të vlerë së punimeve të ndërtimit pa leje ndërtimi dhe mbi bazën e vlerës të vendosej gjoba, u konstatua se nuk ka raste të vlerësimit të masës së vendosjes së gjobave nga IMTV për periudhën objekt auditimi, por ato janë vendosur përgjithësisht në nivel minimal.
Në lidhje me bashkëpunimin midis zyrave të IMTV dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në pajtim nenin 81-Inspektimi, pika 3, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, sipas ballafaqimit të kryer me punonjësit e IMTV u konstatua se në mjaft raste nuk është dokumentuar puna e bërë për inspektimin e punimeve të ndërtimit midis dy zyrave të Bashkisë.
Në lidhje me punën e IMTV për pajisjen me vërtetime likuidimi detyrimesh, u konstatua se ka pajisur zbatuesin e punimeve (subjektet ndërtuese), me vërtetim për likuidimin e gjobave dhe vërtetim për plotësim ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1008 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me ligjin nr. 10,324, datë 23.09.2010, u konstatua se rast pas rasti janë lëshuar vërtetime për këtë qëllim.
Në lidhje me mbajtjen e regjistrave nga IMTV për gjobat e vendosura dhe nëse janë regjistruar në kontabilitet si debitorë dhe (Lista te rakordohet me Zyrën e Financës), si janë ndjekur procedurat ligjore për vendosjen e gjobave dhe arkëtimin e tyre, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", përkatësisht: neni 9 "Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative" dhe neni 22, u konstatua se ato janë mbajtur në një database.
Në lidhje me vendimet e gjobave e të pa arkëtuara brenda afatit ligjor, përveç vlerës së gjobës, janë llogaritur edhe vlera e kamat vonesave në masën 2% të vlerës të gjobës për çdo ditë vonesë deri në 30 ditë, (ose në shumën 60% kamat vonesë mbi gjobën e vendosur), në zbatim të pikës 3, neni 30, të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", u konstatua raste ku janë vendosur gjoba për periudhën objekt auditimi, për rrjedhojë janë llogaritur kamat vonesa për këtë qëllim. E njëjta procedurë rezulton të jetë ndjekur edhe me titujt përmbarimor.
VI/b/12-Në se dokumentacioni që përdor IMTV, si proces verbalet e pezullimit dhe vendimet e ndryshme për gjobat, janë administruar si letra me vlerë dhe a janë bere hyrje ne magazinë.
Në lidhje me në se dokumentacioni që përdor IMTV, si proces verbalet e pezullimit dhe vendimet e ndryshme për gjobat, janë administruar si letra me vlerë dhe a janë bere hyrje ne magazinë, u konstatua se blloqet e gjobave kanë qenë të trashëguar nga vitet e mëparshme dhe janë gjendje në zyrën e IMTV së Bashkisë Vlorë.
Në lidhje me rastet e largimit të punonjësve nga puna në se kanë dorëzuar detyrën dhe blloqet e gjobave me proces verbal, rezultoi se për periudhën objekt auditimi midis tre kryeinspektorëve janë dorëzuar me proces verbal të nënshkruar mes palëve midis dorëzuesit të blloqeve dhe marrësit në dorëzim vetëm nga K. R.
Në lidhje me investimet e realizuara nga Bashkia Vlorë, pa marrë më parë miratimin e lejes zhvillimore ndërtimi u konstatuar se disa investime janë prokuruar pa marrë më parë miratimin për leje zhvillimi

(ndërtimi) të miratuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Kryetari i Bashkisë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e Territorit" i ndryshuar dhe ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 13 dhe 29 "Përgjegjësitë e Kryetarit të Bashkisë", neni 22 "Plani i detajuar vendor", neni 37 "Kushtet për zhvillim", neni 38 "Leja e zhvillimit"; neni 39 "Leja e ndërtimit", sipas të cilit, pika 1: "Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41, i këtij ligji", pika 3 "Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit"; nenit 41 "Deklarata paraprake për kryerjen e punimeve", pika 1 "Rregullorja e zhvillimit përcakton listën e ndërtimeve, instalimeve dhe punimeve që, për shkak të ndërhyrjeve jo thelbësore në objekt, natyrës së përkohshme së instalimeve ose rregullimit të kontrollit të zhvillimit nga një leje apo autorizim tjetër apo nga legjislacion i posaçëm sektorial, nuk kërkojnë pajisjen me një leje ndërtimi dhe janë objekt i një deklarate paraprake për kryerje punimesh" dhe pika 2 "Në rastet e përcaktuara, sipas pikës 1 të këtij neni, deklarata me shkrim e depozituar pranë autoritetit përgjegjës të kontrollit të zhvillimit, bashkërisht me projektin e punimeve, të hartuar dhe nënshkruar nën përgjegjësinë e profesionistëve të licencuar, është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për fillimin e punimeve të ndërtimit"; Neni 43 "Aplikimi për leje ndërtimi"; Neni 51 "Inspektimi" dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit.

Mos referimi në dispozitat ligjore të sipërcituara ka bërë që nga IMTV të mos gjej zbatim duke mos u aplikuar neni 52 "Kundërvajtjet administrative", pika "e", konkretisht pasqyra e investimeve pa leje zhvillimi:

| Nr | Objekti prokuruar | Dt. Zhvillim tenderi | Fondi limit pa TVSH në 000/lek |
|---|---|---|---|
| 1 | Rikonstruksion i shkollave të qytetit të Vlorës | 18.09.2015 | 2,505,726 |
| 2 | Rikonstruksioni i rrugës Llakatund | 19.10.2016 | 12,453,218 |
| 3 | Rikonstruksion i rrugëve "Zigur Lelo" dhe "Shefit Zenaj" | 17.11.2016 | 83,283,093 |
| 4 | Rikonstruksion i godinës se Njësisë Administrative Shushice | 19.10.2016 | 8,282,579 |
| 5 | Gjelbërim ne qytet (bime dekorative) | 29.03.2016 | 4,163,610 |
| 6 | Ndërhyrje riparimi ne shkollat e Bashkisë Vlorë 2016 | 16.08.2016 | 10,001,383 |
| 7 | Sistemi Multifunksional "Smart City" LUNGOMARE | 13.06.2017 | 53,539,200 |
| 8 | Rikonstruksioni i kopshtit nr.7 | 01.06.2017 | 9,575,334 |
| 9 | Ndriçimi i rrugëve ne qytetin Vlorë | 12.05.2017 | 25,000,923 |
| 10 | Mbjellje bime dekorative ne Bashkinë Vlorë | 31.03.2017 | 21,101,156 |
| 11 | Rikonstruksion i rrugës "Ura tek varrezat - Risili | 15.02.2017 | 95,889,850 |
| 12 | Rikonstruksion i shkollës së mesme "Halim Xhelo", Vlorë | 30.08.2017 | 60,644,928 |

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e Territorit" i ndryshuar dhe ligjin nr 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 13 dhe 29 "Përgjegjësitë e Kryetarit të Bashkisë", neni 22 "Plani i detajuar vendor", neni 37 "Kushtet për zhvillim", neni 38 "Leja e zhvillimit"; neni 39 "Leja e ndërtimit", sipas të cilit, pika 1: "Leja e

ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji", pika 3 " Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat "e" dhe "ë", të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit"; nenit 41 "Deklarata paraprake për kryerjen e punimeve", pika 1 "Rregullorja e zhvillimit përcakton listën e ndërtimeve, instalimeve dhe punimeve që, për shkak të ndërhyrjeve jothelbësore në objekt, natyrës së përkohshme së instalimeve ose rregullimit të kontrollit të zhvillimit nga një leje apo autorizim tjetër apo nga legjislacion i posaçëm sektorial, nuk kërkojnë pajisjen me një leje ndërtimi dhe janë objekt i një deklarate paraprake për kryerje punimesh" dhe pika 2 "Në rastet e përcaktuara, sipas pikës 1 të këtij neni, deklarata me shkrim e depozituar pranë autoritetit përgjegjës të kontrollit të zhvillimit, bashkërisht me projektin e punimeve, të hartuar dhe nënshkruar nën përgjegjësinë e profesionistëve të licencuar, është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për fillimin e punimeve të ndërtimit"; Neni 43 "Aplikimi për leje ndërtimi"; Neni 51 "Inspektimi". Mos referimi në dispozitat ligjore të sipërcituara ka bërë që të mos gjej zbatim duke mos u aplikuar neni 82 "Kundërvajtjet administrative", pika "e", sipas të cilës: "Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, ..." dhe duke llogaritur se numri i ndërtimeve pa leje me investitor po Bashkinë Vlorë është 12 objekte.

Për objektet e ngritura nën territorin e Bashkisë Vlorë nga IMT, rezulton se nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV" i ndryshuar, pasi nuk është e dokumentuar nga Kryeinspektori/inspektori vendor, procesi i kontrollit të ushtruar për zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi, pra nuk ka një vlerësim të shkeljeve të punimeve në ndërtim, si":
a) mospërputhjen e objektit ne ndërtim, me kërkesat e lejes se ndërtimit e te projektit teknik te zbatimit, te miratuar e konfirmuar nga organi i autorizuar si:
i) ndërtimi i volumeve te tepërta, ne lartësi ose ne gjeresi te objektit (shtese kati ose shtese anësore);
ii) ndryshime te përmasave ne gjatësi, gjeresi, lartësi me te mëdha ose me te vogla se ato te miratuara;
iii) ndryshime ne arkitekturën e fasadës se objektit, krahasuar me projektin e miratuar;
iv) rrethimi i objektit nuk është bere sipas planorganizimit te miratuar.
b) mosrespektimin e kuotave te lartësisë se kateve me ato te miratuara.
c) mungesat e masave te sigurimit teknik te objektit dhe te mbrojtjes se jetës se njerëzve.
ç) ndotjen e mjedisit nga ndërtimi i objektit.

Nga auditimi i prishjeve të objekteve për realizimin e investimeve publike, rezultoi se gjatë zbatimit në fakt të projektit "Rikonstruksion i Rrugës Transballkanike, Faza II", nga IMTV një pjesë e pasurive, të llojit "ndërtesë", me funksion "banim", "njësi" etj., janë prishur pjesërisht ose nuk janë prishur. Pjesërisht ato ndodhen brenda vijës së shpronësimit. Verifikimet për këto objekte janë kryer nga vetë Drejtoria e Menaxhimit të Pronës Publike dhe Aseteve, ku sipas azhornimit të kryer nga vetë projektuesit, të cilët kanë vendosur në dispozicion azhornimin faktit të objekteve dhe një projekt-ide për fazën tjetër të zbatimit, ka rezultuar se zbatimi projektit nuk është bërë sipas miratimit por është modifikuar gjatë ekzekutimit, kjo referuar situatës të bërë prezente në terren. Më poshtë listohen objektet e ndodhura në këtë situatë:

Zona Kadastrale 8605:
Pasuria numër 49/97-nd, objekti i prerë ndodhet mesatarisht 1.3 m brenda vijës së shpronësimit.
H. V, pasuria numër 49/197, objekti i prerë ndodhet brenda vijës së shpronësimit 3.4 m në veri dhe 5 m në jug.
Bp. Llanaj, 45/50-n, objekti nuk është prishur, ndodhet 3.7 m brenda vijës së shpronësimit.
Dy objekte në Jug të pasurisë më sipër ndodhen 2.6 m brenda vijës së shpronësimit.
E. GJ, pasuria numër 50/23, objekti i prerë ndodhet 3.7 m në veri dhe 3.15 m në jug, brenda vijës së shpronësimit.
A. D, pasuria numër 50/24, objekti i prerë ndodhet 3.2 m në veri dhe 2.3 m në jug, brenda vijës së shpronësimit.
Në jug të objektit të A. T, ndodhet një objekt 2.2 m brenda vijës së shpronësimit.
Zona kadastrale 8603
Pasuria 20/122-ND2 S. M, ndodhet 2.9m brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 20/122-ND1 F. M, ndodhet 2.9m brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 20/122-ND3 TH. M, ndodhet 2.9m brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 20/146 ndodhet 2.5m brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 20/22 ndodhet 5m brenda vijës së shpronësimit.
Ne jug te pasurisë 20/41/1 ndodhet objekt brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 20/230 ndodhet 2.5m brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 20/149 ndodhet 4 m brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 29/325 ndodhet brenda vijës së shpronësimit 0-3m.
Zona kadastrale 8604
A. F, disponon objekt brenda vijës së shpronësimit.
J. B, disponon objekt brenda vijës së shpronësimit.
F. B, pasuria 5/29-ND1 disponon objekt që ndodhet 2.5m ne jug dhe 1.5m në veri, brenda vijës së shpronësimit.
V. R, disponon objekt që ndodhet 4.6m brenda vijës së shpronësimit.
S. V, Pasuria 4/128-ND, disponon objekt që ndodhet 4.0m ne jug brenda vijës së shpronësimit.
J. V, Pasuria 4/120, ka rrethim që ndodhet brenda vijës së shpronësimit 2.7m.
A. T, objekt që ndodhet 4 m, brenda vijës së shpronësimit.
Tre objekte më në veri përkatësisht 3.7m, 1m dhe 2m brenda vijës së shpronësimit.

Lidhur me këto problematika rezultuan edhe shkresat e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit Finaciar nr. 6839, datë 17.08.2016 drejtuar IMTV, shkresa nr. 6849, datë 17.08.2016, Komisionit të Kompensimit për Efekt Shpronësimi dhe Komisionit drejtuar specialistëve të Rajoneve 3, 4 ,5, shkresa nr. 139, datë 21.07.2016 drejtuar Kryetarit të Bashkisë dhe shkresa nr. 4581, datë 06.06.2016, e Komisionit të Shpronësimeve, drejtuar IMTV, shkresa të cilat kanë në përmbajtje të njëjtën problematikë shqetësuese, atë të prishjes së objekteve jo sipas VKM-së por me prerje pjesore.
Sa sipër nga IMTV është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 345, datë 04.05.2016 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit Rikonstruksion i rrugës Transballkanike Vlorë, faza II".
Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në: Ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i

ndryshuar, Ligjin nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin e punimeve në ndërtim", i ndryshuar, VKM nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore";
5).Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005" Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"; dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001: "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me UKM nr.1, datë 16.6.2011; dhe ngarkojnë me përgjegjësi K. R me detyrë Kryeinspektor i IMTV, D. T. me detyrë Kryeinspektor i IMTV, I. T me detyrë Kryeinspektor i IMTV, M. M me detyrë inspektor, R. F me detyrë inspektor, A. S me detyrë inspektor, Z. S me detyrë inspektor dhe I. D me detyrë inspektor.

*-Mbi auditimin e zbatimit të procedurave për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për periudhën 01.01.2015 – 31.12.2017.*

Nga ana e punonjësve të Bashkisë Vlorë, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, ku thuhet se:

> "*Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.....*

si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë,* pika 3 , ku thuhet:

> . *……..Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.*

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon zyra e ALUIZNIT Bashkia Vlorë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Vlorë janë përcille zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP Vlorë.

Referuar të dhënave në dosjen e auditimit dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i audituar me shkresën *nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018),* konstatohet se për periudhën nga 01.01.2015 deri më 31.12.2017, rezulton nuk kanë bërë pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **126 persona** me vlerë **4,934,350 lekë**, **e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxheti e Bashkisë Vlorë** (*sipas listave që disponon vetë Bashkia)***,*** konkretisht pasqyra:

| Periudha | DETYRIME | | PAGUAR | | DIFERENCA | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Vlerë | Nr. | Vlerë | Nr. | Vlerë |
| Viti 2015 | 358 | 7,480,062 | 356 | 7,430,508 | 2 | 49,553 |
| 01.01.2016 - 30.06.2016 | 805 | 20,578194 | 748 | 18,728,408 | 57 | 1,849,786 |
| 01.07.2016 - 31.12.2017 | 2,353 | 73,252,824 | 2286 | 70,217,813 | 67 | 3,035,010 |
| **TOTALI……** | **3516** | **101,311,081** | **3390** | **96,376,730** | **126** | **4,934,350** |

Nga personat përgjigjes nuk është bërë asnjë punë për rakordimet me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNIT Vlorë dhe ZVRPP Vlorë për bllokimin e veprimtarisë ligjore në regjistrimin e objekteve, për mos shlyerjen e detyrimeve ndaje Bashkisë Vlorë të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë prej 4,934,350 lekë, veprime në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e

mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
*Nga strukturat përkatëse të Bashkisë Vlorë, nuk është bërë i mundur zbatimi i VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, duke sjellë të* ***ardhura e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën 4,934,350 lekë.***

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi**:
E. A me detyrë Drej. Planifikim Zhvillim Territorit, si personi përgjegjës në zbatim të VKB është ngarkuar për ndjekjen e kësaj takse.
L. M me funksion Specialiste e Taksës së Ndikimit të Infrastrukturë të objekteve të ALUZNIT (periudha Tetor 2016 e vazhdim).
S. A me funksion ish-Specialiste e Taksës së Ndikimit të Infrastrukturë të objekteve të ALUZNIT (periudha 2015 – Tetor 2016), si persona përgjegjës të ngarkuar.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH.*** *Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), merret në konsideratë fakti i rakordimeve të bërë nga ana juaj, në lidhje me pagesën e subjekteve që janë pajisur me leje legalizimi dhe që kanë paguar taksën e infrastrukturës, kjo pasi është shoqëruar dhe me dokumentacion mbështetës.* ***Pretendimi juaj qëndron***.

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 244-275, të Projekt raport Auditimit)*

## III/7. Auditimi mbi administrimin e Aseteve, procedurat e dhënies me qira të Aseteve të qëndrueshme në varësi të bashkisë dhe shitja e trojeve publike.

*-Administrimi, marrja në dorëzim, dokumentacioni përkatës, hartat etj., mbikëqyrja nga Bashkia/Komuna e Aseteve në varësi të saj, kontrollet e ushtruara, konstatimet, masat e marra. Inventarizimi dhe krijimi i regjistrit/data base të Aseteve të baskisë/komunës për periudhën e auditimit, auditimi i ndryshimeve të Aseteve të kryera (dhënie me qira, shitje troje etj.), ligjshmëria dhe Rregullariteti i veprimeve të kryera me asetet e qëndrueshme.*.**.**

Për administrimin dhe menaxhimin e Aseteve në zbatim të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore", bazuar në pikat 9,10,11 dhe 22, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore" në Bashkinë Vlorë, bazuar në rregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë *(miratuar me VKB nr. 40 datë 17.10.2008 të ndryshuar me VKB nr. 11 datë 29.3.2012)* është ngarkuar Drejtoria Juridike, sipas neneve 42 dhe 43.
Në bashkëpunim me drejtoritë e tjera sektorët po realizojnë gradualisht inventarizimin, vlerësimin, marrjen në dorëzim të pronave dhe regjistrimin e këtyre Aseteve në ZVRPP dhe në inventarin kontabël.

***PËR OBJEKTET NDËRTESA***
Këshilli i Bashkisë Vlorë me VKB nr. 31/1, datë 07.07.2006 "Për miratimin e inventarit të pronave të Bashkisë Vlorë" ka miratuar listën e pronave të paluajtshme publike të shtetit që fillon me nr. 1 dhe

mbaron me nr. 825, miratuar me VKM nr. 639, datë 29.9.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Vlorë, të Qarkut Vlorë".
Bazuar në VKB nr. 16, datë 8.5.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë" me shkresën nr. 1256, datë 19.5.2208 është dërguar në MB (AITPP) lista shtesë për disa prona që nuk janë pasqyruar në listën e miratuar me VKM nr. 639, datë 29.9.2007 të sipër përmendur me numër 1 deri 21.
Me shkresën 108/1 datë 8.1.2009, të MB (AITPP) është dërguar VKM nr. 1643 datë 17.12.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, të Qarkut Vlorë", ku është miratuar lista paraprake për 617 prona publike shtetërore brenda juridiksionit, si më poshtë:

| Nr. Rendor të pronave në listën e inventarit | F.....A e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 1-34 (34 objekte) | Për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 46,48,50-56,58-61 (13 objekte) | Për realizimin e veprimtarive sportive | Në pronësi |
| 44-45 (2 objekte) | Për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë | Në pronësi |
| 99-103, 118, 122 (7 objekte) | Për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social | Në pronësi |
| 79,83-87, 151-153 (9 objekte) | Për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës | Në pronësi |
| 116 (1 objekt) | Varrezat publike | Në pronësi |
| 104-115, 117, 119-121,123-150, 645-823 (224 objekte) | Infrastrukturë, (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike" | Në pronësi |
| 74,154,504,576 (4 objekte) | Për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik | Në pronësi |
| 155-471 (318 objekte) | Prona që përdoren në fushën e strehimit e mbrojtjes sociale | Në pronësi |
| 626-628, 630 (4 objekte) | Për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë e të ushqimit (toka produktive) | Në pronësi |
| 629 (1 objekt) | Për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë e të ushqimit ( kanale të treta dhe toka jo produktive) | Në pronësi |

Ka listë për objektet e hequra nga ato të miratuara me VKM nr. 639, datë 29.9.2007, në të cilën padrejtësisht janë përfshirë objekte të pronave si gjykata, komisariati i policisë, prokuroria, spitali etj. dhe shtuar objekte bazuar në VKB nr. 16 datë 8.5.2008 duke ndryshuar numri i pronave nga 825 në 617 prona.
Nga auditimi rezulton se nuk është hartuar regjistri i Aseteve me të dhënat e kërkuara për plotësim dokumentacioni, regjistrimi në kontabilitet, apo aplikim për regjistrim pranë ZVRPP Vlorë.
Me shkresën nr. 2358 datë 12.04.2010 Ministria e Brendshme, AITPP, i ka kërkuar Bashkisë Vlorë konfirmim pranë ZVRPP Vlorë për gjendjen e pasurive të listës shtesë të inventarit sipas VKB nr. 16 datë 8.5.2008.
Janë kryer konfirmimet në ZVRPP, të cilat kanë zgjatur në kohë dhe i janë dërguar AITPP Tiranë, informacionet e kërkuar me shkresat nr. 2235 datë 02.11.2011 dhe nr. 2460/2 datë 30.11.2011.
Meqenëse AITPP nuk ka kthyer përgjigje, Bashkia Vlorë i është drejtuar po AITPP me shkresat nr. 2943 datë 11.09.2013 "Kërkohet miratimi i listës përfundimtare e pronave publike që i transferohen Bashkisë Vlorë " dhe nr. 207 datë 23.01.2014 me objekt "Për rikujtues të kërkesave me shkresën nr. 2943 datë 11.09.2013"

Me shkresën 421/1 datë 26.1.2014 të MPB (Sekretari Përgjithshëm) është kthyer përgjigje Bashkisë Vlorë për kërkesën me nr. 207 datë 23.01.2014 ku theksohet se...”*Procedurat për miratimin e listave për fazën përfundimtare të transferimit të pronave....do të fillojnë pas shqyrtimit të problematikave me AKKP, lidhur me kompensimin fizik të ish pronarëve*.”

Nuk janë evidentuar, verifikuar dhe paraqitur të plota, në regjistra asetet, në zbatim të plotë me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” pikat 26, 30 germa “a, b, c” dhe pika 36.

Nuk ka rakordim me ZVRPP për pronat në pronësi, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Bashkisë, si dhe nuk janë kryer veprimeve kontabël për objektet, trojet, tokat bujqësore, pyjeve dhe kullotave, të kaluara në pronësi.
Nuk ka të dhëna të plota për ndërtesa, trojet private dhe ato shtetërore të lira ose të zëna nga ndërtimet pa leje për qëllime banimi ose biznesi, pasi mungon listimi i sipërfaqeve të trojeve me analizën përkatëse të pronësisë private dhe asaj shtetërore (harta e njollosur).
Veprim dhe mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me nenin 18, të ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984, me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore të cilat kanë sjellë keqadministrim e tyre, në bazë te ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, me ndryshime.
Për pronat e paluajtshme (Asete), në asnjë prej viteve objekt auditimi, nuk është kryer inventarizimi fizik për identifikimin e gjendjes fizike e teknike, për përdorimin dhe vënien në eficencë nga kjo Bashki, në plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga përdorimi i tyre.

*-Mbi regjistrimin e pasurisë në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP).*
Ne zbatim te VKM-se nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve te trupëzuara dhe te patrupëzuara, ..... te prekura nga Riorganizimi Administrativo - Territorial” kreu VI, pika 1 dhe 3, i cili ka përfunduar ne datën 31.12.2015; AITP, në Ministrinë e Brendshme, ka dërguar listën e inventarëve te ish bashkive/komunave, ne Bashkinë e Re Bashkia Vlorë (NJA Orikum, Novosele, Shushice dhe Qendër).
Ne te njëjtën kohe, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit te Aseteve, ka vijuar punën për procesin e regjistrimit te pronave te paluajtshme shtet, duke realizuar procedurat si me poshtë:

- Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit te Aseteve, ju është drejtuar institucioneve qendrore ne nivel vendor, brenda juridiksionit territorial te Bashkisë Vlorë, për informacion ne lidhje me statusin juridik te pronës.
- Me Urdhrin e Brendshëm të Kryetarit te Bashkisë nr. 104, datë 25.09.2015, është ngritur komisioni “Për inventarizimin dhe hartimin e dokumentacionit, për objektet shtetërore ne qytet”, i përberë me 3-anëtarë, për te 5-te rajonet.

- Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit te Aseteve, i është drejtuar ZVRPP-Vlorë, për informacionin e pronave *"Shtet"*, e cila është përgjigjur se; nuk mund te vihen ne dispozicion ky informacion, për shkak te volumit te punës qe ka.
- Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit te Aseteve, i është drejtuar ZVRPP-Vlorë, për te vijuar regjistrimin ne kartelat e pasurisë, ne përshkrimin e veçantë, për pronat e miratuara me VKM nr. 1643, datë 17.12.2008 "Mbi miratimin e listës paraprake te pronave te paluajtshme publike, shtetërore, qe transferohen ne pronësi ose ne përdorim te Bashkisë Vlorë". Procedure e cila është ne vijimësi.

Nga Bashkia Vlorë nuk është kryer asnjë veprim në hartimin e genplan i vendosjes së pronave dhe formularët e inventarizimit të pronave për kalimin e tyre në varësi të Bashkisë, për kalimin dhe regjistrimin e tyre në juridiksion të Bashkisë në zbatim të ligjit nr. 8744, datë 22/2/2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes Vendore" dhe VKM nr. 500, datë 14/8/2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes Vendore", pika 9, 10, 11, si dhe regjistrimin e tyre në ZVRPP Vlorë, në lidhje me objektet, rrugët, toka arë dhe pemëtore, lulishtet etj.

*-Menaxhimi i Aseteve, identifikimi i gjendjes fizike, teknike dhe juridike për përdorimin e vënien në eficencë për krijimin e të mirave publike për komunitetin, administrimin e plotë të tyre nga Bashkia/Komuna në plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga përdorimi i tyre*.

Për pronat e paluajtshme (Asete), në asnjë prej viteve 2015 - 2017, nuk është kryer inventarizimi fizik për identifikimin e gjendjes së tyre fizike e teknike, për përdorimin dhe vënien në eficencë në plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave nga përdorimi i tyre, prona si; objektet shtëpi kulture, ndërtesa me funksion aktual zyra me sipërfaqe funksionale që përdoren nga subjekte të tjera shtetëror e shoqëri, trojet dhe monumentet historike, vend strehimet publike dhe bodrume, trojet fushat sporti e ndërtesa, kapanone, etj., veprime në kundërshtim nenin 8, "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit" pika 1, 2, 3, 4, të nenit 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues" pika 1, 2, 3, 4/a, të nenit 12 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues" germa (d, dh, e), të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", si dhe pikat 9,10 dhe 13 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore".

Në zbatim të urdhrit nr. 104, datë 25.09.2015.2015 "Për inventarizimin dhe hartimin e dokumentacionit për objektet shtetërore në qytet sipas VKM nr. 1643, datë 17.12.2008" , nga grupet e punës janë dorëzuar dokumentacion ne DRPPMA nga këto grupe: -Me shkresat nr. 5057 prot., datë 03.11.2015, ka dorëzuar dokumentacion për objekte (arsimore) në rajonin 5; - Me shkresën nr. 5046 prot., datë 02.11. 2015, ka dorëzuar dokumentacioni nga grupi i punës rajoni nr.2 dhe rajoni nr. 5.
Mbas marrjes së këtij dokumentacioni Drejtoria e PPMA ka vijuar korrespodencën me ZVRPP Vlorë, si më poshtë:
Me shkresën nr. 1506 prot., datë 29.02.2016 lënda "*Kërkesë për bashkëpunim*", Bashkia Vlorë i është drejtuar ZVRPP Vlorë, në të cilën janë kërkuar gjendje juridike për çdo pasuri (në lidhje me objektet në funksion të sistemit arsimor), sipas plan vendosjeve të hartuara nga Bashkia Vlorë referuar VKM – së nr. 1643, datë 17.12.2008. Gjithashtu në këtë shkresë bazuar në VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes

vendore", pika 6, ku ZVRPP duhet të përgatisë listat e të gjitha pronave shtetërore në çdo zonë kadastral për miratimin e inventarit nga KM, ju është kërkuar lista e të gjitha pronave shtetërore në zonat kadastral 8601, 8602, 8603, 8604, 8605, 8602 Uji Ftohtë, zona të cilat ndodhen në juridiksion të Bashkisë Vlorë. Kjo shkresë është e shoqëruar edhe me plan vendosje të objekteve arsimore të verifikuara dhe saktësuara në terren.
ZVRPP Vlorë është përgjigjur me shkresën nr. 10065/1prot., datë 29.03.2016 për gjendjen juridike të këtyre pasurive dhe HTR e tyre.
*Këto objekte janë*:
Shkolla 9 vjeçare 4-Heronjtë ZK 8601; Kopshti nr. 5 ZK 8601; Shkolla 9-vjeçare Teli Ndini ZK 8601; Shkolla 9-vjeçare "28 Nëntori" ZK 8601; Shkolla 9-vjeçare "Ismail Qemali" ZK 8602; Shkolla 9-vjeçare "Muco Delo" ZK 8602; Shkolla e mesme "Qemal Ataturku" ZK 8602; Kopshti "1 Maji" ZK 8602; Shkolla P.A.K ZK 8602; Shkolla e mesme "Industriale Pavarësia" ZK 8602; Kopshti nr. 3 ZK 8605; Kopshti Nr. 1 ZK 8605; Shkolla "Rilindja" ZK 8605; Kopshti "Sulo Didi" ZK 8605; Shkolla "Halim Xhelo" ZK 8605; Shkolla e re "11 Janari" ZK 8605; Shkolla "11 Janari" ZK 8605; Shkolla 9-vjeçare "Zenel Murra" ZK 8602
Shkolla 9 vjeçare "Avni Rustemi" ZK 8602 dhe Shkolla "Tregtare" ZK 8602.
Me shkresën nr. 7273 prot., datë 07.09.2016, Bashkia Vlorë i është drejtuar ZVRPP për konfirmim të statusit juridik të kopshtit nr. 13 (sipas Plan dosjes), për të cilën ZVRPP Vlorë është përgjigjur me shkresën nr. 19577/1 prot., datë 14.09.2016, ku kjo pasuri është shtet.
Gjithashtu për objektet e miratuara me VKM nr. 1643, datë 17.12.2008 nga ana e bashkisë Vlorë është mbajtur kjo korrespodencë:
DPPMA me shkresën nr. 5694 prot., datë 08.07.2016, lënda "*Kërkesë për bashkëpunim*", i është drejtuar ZVRPP Vlorë dhe për dijeni Zyrës Qendrore të RPP, Tiranë, me anë të së cilës ka kërkuar që në kartelat e pasurive të evidentuar sipas listës paraprake të miratuar me VKM nr. 1643, datë 17.12.2008 të bëhet shënimi për çdo pasuri, deri në miratimin e listës përfundimtare të pronave paluajtshme të bashkisë Vlorë.
Me shkresën Nr. 7274 prot., datë 07.09.2016 Bashkia Vlorë i është drejtuar ZVRPP Vlorë për konfirmim të statusit juridik për "*hangarët*" ndodhur në ZK 8605, për të cilën ZVRPP Vlorë është përgjigjur se nuk ka informacion.
Me shkresën Nr. 2547 prot., datë 05.04.2016 lënda "*Kërkesë për bashkëpunim*", Bashkia Vlorë i është drejtuar ZVRPP Vlorë për objektin "*Pallati i sportit*", me nr. rendor 52 në VKM nr. 1643, datë 17.12.2008, institucioni i ZVRPP është përgjigjur me shkresën 11508/1 prot., datë 19.04.2016.
Me shkresën nr. 1182 prot., datë 19.02.2016 lënda "Kërkesë për konfirmim" Bashkia Vlorë i është drejtuar ZVRPP Vlorë për konfirmimin e pasurisë "Pishinë", e cila është përgjigjur me shkresën nr. 1807/1 prot., datë 15.03.2016.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
*Në lidhje me procesin e inventarizimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore të miratuara me VKM nr. 1643, datë 17.12.2008, procedura është në vijimësi por nuk është bërë aq sa duhet për regjistrimin e këtyre pasurive, veprime në kundërshtim nenin 8, "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit" pika 1, 2, 3, 4, të nenit 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues" pika 1, 2, 3, 4/a, të nenit 12 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues" germa (d, dh, e), të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e*

*paluajtshme të shtetit", si dhe pikat 9,10 dhe 13 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore".*

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi**: D. Z. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, A.M me detyrë ish-Drejtore e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve (periudha 29.12.2016 – 15.6.2017), E. B me detyrë dhe A. XH me detyrë specialiste në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen në shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.004.2018), nga personat përgjegjës Bashkia Vlorë, nuk është dhënë ndonjë sqarim më shumë se dokumentacioni që i është paraqitur grupit të auditimit, mbi bazën e të cilit kanë rezultuar problematikat e m mësipërme.*

**-Vlen të theksohet** se kjo drejtori si një nga drejtoritë kryesore të Bashkisë Vlorë e cila menaxhon një seri problemesh, si: administrimin e pronave publike të Bashkisë Vlorë (objekteve, trojeve dhe pyjeve), ndjekjen e te gjithë procedurës ligjore, shkresa, kthim përgjigje, verifikime, takime ne Ministritë e linjës të trojeve dhe objekteve që shpronësohen, përgatitjen e dokumentacionit ligjorë për regjistrimin e pasurive në ZVRPP, evidentimin e pronave të bashkisë mbi statusin dhe gjendjen e tyre, etj., është lënë pa Drejtues që nga muaj Qershor 2017, duke u bërë pengesë në organizimin e punëve dhe mos marrjen e përgjegjësive individuale, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 dhe ligjin nr. 152/2013, datë 01.10.2013 "Për Nënpunës Civil", i ndryshuar, VKM nr. 848, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionit të kabineteve ndihmës, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", ku përgjegjësi bie mbi nëpunësin autorizues D. L. dhe L .B. me detyrë Drejtoresh e Burimeve Njerëzorë**.**

*- Mbi procedurave dhe dokumentacionit të administruar për dhënien me qira të Aseteve të Bashkisë.*

**a. Mbi dhënien me qira të objektit "Parku i lojërave të qytetit Vlorë".**

Objektit *"Parku i lojërave të qytetit Vlorë"*, është një nga objektet e përfshira në listën paraprake të inventarit të pronave të paluajtshme të shtetit që kalojnë në pronësi apo përdorim të Bashkisë Vlorë, miratuar me VKM nr. 1643 datë 17.12.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, të Qarkut Vlorë" me një sipërfaqe gjithsej prej 16112 m², nga e cila 28 m² nën objekt, dhënë me qira shoqërisë "I.....D" , me seli në Tiranë, regjistruar në regjistrin tregtar me vendim të gjykatës së rrethit Tiranë nr. 29109 datë 31.1.2001, me certifikatë me kod fiskal nr. 3910239, lëshuar nga zyra e tatimeve e rrethit Tiranë, sipas vendimit të KB nr. 102 datë 24.12.2001 "Mbi dhënien me qira të Parkut Lojërave" me afat deri në 20 vjet.

-Nisur nga sipërfaqja, kontrata që mban **datën 4 Qershor 2002** lidhur midis palëve, Ministria e Ekonomisë, përfaqësuar nga G. GJ, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike në Ministri, bazuar në autorizimin e Ministrit nr. 1568/1 datë 28.5.2002, cilësuar si "*Qiradhënës*" dhe B. B, administrator i shoqërisë "I.....D" , të cilësuar si "*Qiramarrës*", në prani të noteres zyrës së noterisë Tiranë, E. K me nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 4 Qershor 2002.

Sipas kësaj kontrate (neni 1), sipërfaqja e dhënë me qira përcaktohet 16112 m², nga e cila 28 m² nën objekt, me kohëzgjatje (neni 3), për një periudhë 10 vjet, duke hyrë në fuqi nga data e nënshkrimit të

saj. Detyrimi mujore (neni 6, pika 1) është në vlerën prej 107,413 lekë/muaj dhe për objektin 28 USD në muaj.
Pagesat e shpërblimit periodik do të bëhen sipas përcaktimeve të VKM nr. 430, datë 9.7.1998, "Për dhënien me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive apo institucioneve shtetërore", VKM nr. 461 datë 6.10.1999 dhe akteve ligjore e nënligjore në zbatim të tij."
Megjithëse aneks kontrata ka datën 1 Nëntor 2004, neni 6 i kontratës fillestare nr. 2946 Rep. nr. 154 Kol. datë 4 Qershor 2002 ndryshohet si vijon: "*Qiramarrësi*" detyrohet ti paguaj Qiradhënësit detyrimin mujor në vlerën prej 114,127 lekë (85 lekë/vit x 16,112 $m^2$ :12) plus 28 USD në muaj, pagesë që fillon me datë 12.6.2003 datë kur VKM nr. 169 datë 13.3.2003 ka hyrë në fuqi pasi është shpallur në fletoren zyrtare.
-Me datë 01.7.2005, nr. 3873 Rep është lidhur Aneks Kontratë, bazuar në kërkesën datë 7.6.2005 të z. Besnik Braho, administrator i shoqërisë "I.....D" ,. të cilësuar si "*Qiramarrës*" për ndryshime në kontratën fillestare nr. 2946 Rep. nr. 154 Kol. datë 4 Qershor 2002, nga METE përfaqësuar nga S. K, Drejtor i Administrimit të Pronës Publike në Ministri, bazuar në autorizimin e Ministrit nr. 3574/1 datë 30.06.2005, ku neni 3 i kontratës riformulohet se .... *"Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzet) vjet duke filluar nga data e nënshkrimit të saj*"**,** duke zgjatur afatin e vlefshmërisë se kontratës nga 10 vjet në 20 vjet.

-Me datë 5.6.2006 është lidhur aneks kontratë, me palët kontraktuese METE përfaqësuar nga M. V, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare në METE, në cilësinë e Qiradhënësit, Shoqëria "ILIAD" ,. me seli në Tiranë, me kod fiskal 3910239 të cilësuar si "Qiramarrës" dhe Shoqëria "I....D" me seli në Vlorë, regjistruar në regjistrin tregtar si person juridik me vendim të gjykatës Tiranë nr. 34444 datë 30.11.2005.
Gjykata Tiranë me vendimet nr. 25109/4 datë 11.11.2005 dhe nr. 25109/5 datë 24.11.2005 ka vendosur ndarjen e Shoqërisë "I.....D" Tiranë në dy shoqëri:
-*Shoqëria "I.....D" Tiranë me administrator dhe ortak të vetëm P. K.*
-*Shoqëria "I....D" Vlorë me administratore dhe ortak të vetëm N. L.*
Shoqëria "I....D" Tiranë është dakord me kalimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kontrata nr. 2946 Rep. nr. 154 Kol. datë 4 Qershor 2002, për objektin "*Parku i lojërave të qytetit Vlorë*" në emër të Shoqërisë "I....D" Vlorë, e cila sipas pikës 2 është dakord me marrjen e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë.
METE është dakord me marrjen e përgjegjësive dhe kalimin e kontratës fillestare nr. 2946 Rep. nr. 154 Kol. datë 4 Qershor 2002 për objektin "Parku i lojërave të qytetit Vlorë" nga shoqëria "I....D" Vlorë.
Me shkresën e METE nr. 2527 datë 15.3.2013 (Drejtoria e Përgjithshme e Ofrimit të Shërbimeve) është njoftuar nga Bashkia Vlorë se bazuar në VKM nr. 529 datë 8.6.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe mënyrën e dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", nenin 6 të kontratës qirasë datë 1 Nëntor 2004, së sipërcituar, vlera e kontratë për 16112 $m^2$ nga 114,127 lekë në muaj që është aktualisht (114,127 lekë në muaj = 85 lekë/vit * 16112 m2 :12) ose $7.^{083}$ lekë/$m^2$ në muaj, do të bëhet 486,720 lekë në muaj ose $30.^{21}$ lekë/m2 në muaj , pa përcaktuar datën se kur fillon aplikimi i kësaj tarife.
Nuk është marrë parasysh ndryshimi i tarifës së qirasë me VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve" kapitulli III "Përcaktimi i tarifës dysheme për pasuritë shtetërore, që jepen me qira ose enfiteozë" pika 4 dhe VKM

nr. 529 datë 8.6.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe mënyrën e dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" kreu III "Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë" pika 1, i ndryshuar me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", me ndryshime, referuar nenit 6, pika 6.2 e kontratës datë 4.6.2012 (nr. 2946/154), ku thuhet se: *"Ndryshimet në legjislacion të vlerës së truallit do të pasqyrohen në këtë kontratë në vlerën e qirasë mujore për sipërfaqen funksionale"*..

-Me datë 3.7.2013 është lidhur Aneks Kontratë, me palët kontraktuese METE përfaqësuar nga G. M, Drejtor i Përgjithshëm i Ofrimit të Shërbimeve në Ministri, sipas autorizimit të Ministrit nr. 5033/1 datë 1.7.2013, në cilësinë e Qiradhënësit dhe Shoqëria "I....D" , me seli në Vlorë, përfaqësuar nga N. L në cilësinë e Qiramarrësit, me të cilën në kontratën fillestare nr. 2946 Rep. nr.154 Kol, datë 4 Qershor 2002, për objektin "Parku i lojërave të qytetit Vlorë" bëhen ndryshimet:
- neni 1 përcaktohet sipërfaqja totale prej 11890 m², nga e cila 28 m² sipërfaqe nën objekt dhe 11862 $m^2$ sipërfaqe funksionale, sipas një genplani. Ndryshimet janë kryer bazuar në shkresën e drejtorisë juridike të Bashkisë nr.1381/1 datë 21.5.2013 .
Në rastin e lidhjes së kësaj Aneks Kontratë, në pikën 6.1 përcaktohet se "*Qiramarrësi*" detyrohet ti paguaj "*Qiradhënësit*" detyrimin mujor në vlerën 360,000 lekë nga 486,720 lekë, duke ulur sipërfaqen nga 16112 m² në 11890 m², nuk ka vendim të Këshillit të Bashkisë dhe pa dokumentacion të hartuar me specialistë të fushës të emëruar nga Bashkia për të argumentuar bazuar me matje faktike sipërfaqet e zbritura, konkretisht:
*-Zbritur për ndryshim të sipërfaqes në matje nga 16,112 m2 të pasqyruar në kontratën fillestare në 15,653 m2 ose 459 $m^2$ më pak.*
*-Zbritur sipërfaqja e përgjithshme e rrugëve brenda objektit, duke e parcelizuar padrejtësisht atë për 2,763 $m^2$.*
*-Zbritur sipërfaqja lulishteve brenda objektit, për 1,000 $m^2$.*
Për ndryshimet e kryera gen-plani i përgjithshëm bashkëngjitur, nuk ka dimensione të përcaktuara sipas klasifikimit të sipërfaqeve të zbritura në rrugë, në lulishte dhe sipërfaqe e mbetur në përdorim.
- *neni 6 i ndryshuar me aneks kontratën datë 01.11.2004, riformulohet si vijon* :
-*pika 6.1* Qiramarrësi detyrohet t'i paguaj Qiradhënësit detyrimin mujor në vlerën 360,000 lekë.
Vlera e detyrimit mujor të qirasë do të ndryshojë kur qiramarrësi plotëson kushtet për treguesit e investimit dhe të punësimit të realizuar në nivelet që parashikohen në kapitullin IV "*Nxitja e biznesit*", të VKM nr. 529, datë 8.6.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe mënyrën e dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" i ndryshuar.
Në këtë rast, vlera e qirasë 360,060 lekë ( 30,[282] lekë/m2 në muaj) është vendosur pa u referuar në VKM në fuqi apo bazën ligjore të vlerës së detyrimit mujor të qirasë sipas kushteve të pikës 6.2 të kontratës fillestare datë 4 Qershor 2002 dhe të pikës 6.5 të Aneks Kontratës, datë 1 Korrik 2005 me përmbajtje: "Pas datës 4.6.2012 (datë e përfundimit të kontratës fillestare me afat 10 vjet) tarifa e qirasë do të aplikohet sipas akteve ligjore në fuqi".

Kjo kontratë i është bërë e njohur Bashkisë Vlorë me shkresën e METE nr. 2527 datë 15.3.2013 "Për vlerën e detyrimit mujor në kontratën e qirasë lidhur me shoqërinë "I....D" Vlorë", ku përcaktohet gjithashtu se vlera e detyrimit mujor të qirasë shprehur në nenin 6 të kontratës qirasë së sipër cituar nga 114,127 lekë në muaj që është aktualisht do të bëhet 486,720 lekë në muaj, vlerë që hyn në fuqi nga data 4.6.2012.

Subjekti "I....D" Vlorë për periudhën Qershor 2012 deri Dhjetor 2012 dhe Janar-Dhjetor të vitit 2013 ka pasur detyrimet dhe ka kryer pagesat në emër të Bashkisë Vlorë, nga rezultojnë diferenca nga arkëtimet e kryera, krahasuar me kontratat, sipas periudhave mujore, si vijon:

**Viti 2012**

-Detyrimi Qershor – Dhjetor 2012 në vlerën 3,977,675 lekë (5 muaj x 114,127 lekë + 7 muaj x 486,720);

-Likuiduar periudha Qershor – Dhjetor 2012 në vlerën 798,889 lekë, diferenca për likuidim në vlerën **3,178,786 lekë** (3,977,675 – 798,889), deri më 31.12.2012, shumë që kërkohet të arkëtohet.

**Viti 2013**

-Detyrimi Janar – Dhjetor 2013 në vlerën 5,080,680 lekë (6 muaj x 486,720 lekë + 6 muaj x 360,060);

-Likuiduar periudha Janar – Dhjetor 2013 në vlerën 2,845,122 lekë, diferenca për likuidim në vlerën **2,235,558 lekë (5,080,680 – 2,845,122), deri më 31.12.2013, shumë që kërkohet të arkëtohet.**

- Për periudhën Korrik- Dhjetor 2013 në rastin e lidhjes Aneks Kontratë, datë 3 Korrik 2013 ku në pikën 6.1 përcaktohet se "*Qiramarrësi*" detyrohet ti paguaj "Qiradhënësit" detyrimin mujor në vlerën 360,000 lekë nga 486,720 lekë, **ku pa vendim të Këshillit të Bashkisë,** padrejtësisht është ulur sipërfaqja nga 16112 m², në 11862 $m^2$, duke parcelizuar sipërfaqen e objektit të marrë me qira, pa dokumentacion të argumentuar dhe pa u bazuar me matje faktike por në një gen-plan të përgjithshëm pa dimensione, me efekte financiare negative në shumën 126,660 lekë/muaj * 6 muaj = **759,960 lekë**, **shumë që përbën dëm ekonomik dhe kërkohet të arkëtohet nga subjekti.**

**Në total** për periudhën 1 Qershor 2012- 31 Dhjetor 2013, paraqitet kjo situatë:

| PERIUDHA | Detyrimi sipas Bashkis/ KLSH | Likuiduar sipas Bashkis | Diferenca për likuidim |
|---|---|---|---|
| Qershor-Dhjetor 2012 | 3,977,675 | 798,889 | 3,178,786 |
| Janar-Dhjetor 2013 | 5,840,640 | *2,845,122* | 2,995,518 |
| Nga e cila: | | | |
| *-Sipas Bashkisë Vlorë* | *5,080,680* | *2,845,122* | *2,235,558* |
| *-Shtesë sipas KLSH* | *759,960* | *0* | *759,960* |
| **TOTALI deri 31.12.2013** | **9,818,315** | **4,016,604** | **6,174,304** |

Nga të dhënat e pasqyrës deri në fund të vitit 2013, vlera e mbetur për arkëtim paraqitet në shumën **6,174,304 lekë, e cila konsiderohet të ardhurash me dëm** dhe kërkohet të arkëtohet nga subjekti "I....D" Vlorë".

Nga Bashkia Vlorë, veç kërkesës nr. 4063 datë 27.12.2013 "Për vlerën e detyrimit mujor në kontratën e qirasë..." nuk është kryer veprim tjetër për të zbatuar sanksionet e përcaktuara në kontratë, konkretisht në nenin 7 "*Zgjidhja e kontratës*" pika 7.2 germa "c" ku përcaktohet se kontrata mund të zgjidhet para afatit kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate.

Problemet e mësipërme janë evidentuar dhe nga auditimi i fundit zhvilluar nga KLSH në Bashkinë Vlorë, ku me shkresën nr. 707/13, datë 30.06.2014 të Kryetarit të Kontrollit të lartë të Shtetit është rekomanduar Bashkisë Vlorë (Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve), për marrjen e masave për arkëtimin e vlerës 5,231,076 lekë, nga subjekti "I.....D" Vlorë", **,** për ulje të sipërfaqes të objektit të dhënë me qira duke e ndarë dhe parcelizuar objektin pa dokumentacion të argumentuar të bazuar me matje faktike, por në një genplan të përgjithshëm bashkëngjitur kontratës për periudhën 1 Qershor 2012-31 Dhjetor 2012.

Nga ana e subjekti është pranuar vetëm detyrimi qe lind nga ndryshimi i çmimit sipas shkresën e METE nr. 2527 datë 15.3.2013, kurse për detyrimin që vjen si rezultat i ndryshimit të sipërfaqes, subjekti është në proces gjyqësor, ku objekt i këtij gjyqi është akti administrativ i njoftimit lëshuar nga DPPMA.

Subjekti qiramarrës ka bërë kërkesë-padinë me vendim nr. 3, datë 12.01.2015 dhe nr. 1872 akti, datë 23.10.2014 me objekt: "*Anulim i aktit administrativ me nr. 3817 prot., datë 01.10.2014*"
Me shkresën Nr. 3154 prot., datë 17.08.2015, lënda "*Njoftim për vlerën e detyrimit të lënë nga K.LSH*", i është bërë me dije :
*a. akti-rakordimet me Drejtorinë e Financës për gjendjen e pagesës për vitin 2014 dhe 7-mujorin e vitit 2015*
b. *detyrimet e prapambetura*.
Subjekti "I.....D" me ankesë datë 16.09.2015, i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë për rishikim të kësaj çështje, pasi institucioni qiradhënës është METS dhe jo bashkia Vlorë.
Bashkia Vlorë me shkresën nr. 4820 prot., datë 23.10.2016 sqaron subjektin se detyrimi për të cilin njoftohet është lënë bashkisë nga KLSH-ja, ndërkohë që edhe Bashkia i është drejtuar METS-për situatën e krijuar.
Me shkresën nr. 6304 prot., datë 23.12.2015, lënda "*Njoftim për përmbushje detyrimi*" është njoftuar sërish subjekti, ku i është bërë me dije se bashkia do të vijojë procedurat ligjore.
Me shkresën nr. 6304 prot., datë 23.12.2015, të Bashkisë Vlorë, administratori i subjektit "I....D" është përgjigjur, duke kërkuar rishikim të detyrimit dhe bën me dije që është në proces gjyqësor.
Me shkresën nr. 2745/1 prot., datë 22.01.2016 lënda "Kthim përgjigje", Bashkia Vlorë i është drejtuar subjektit "I....D" , ku i është bërë me dije se pretendimeve tuaja do të ngrejë një komision me ekspert për vlerësimin e sipërfaqes që shfrytëzohet për "*Parkun e Lojërave*", objekt të kontratës dhe më tej do të përcaktojë procedurat e mëtejshme që do të ndiqen me MZHETTS.
Me shkresën nr. 3925/1, datë 01.10.2014 nga Bashkia Vlorë është kërkuar konfirmim nga ZVRPP mbi statusin juridik të pronës "*Parkun e Lojërave*", ku kjo e fundit me shkresën nr. 9265/1, datë 3.11.2014 ka kthyer përgjigje mbi fragmentet e pasurisë nr. 28/26, volum 20, faqe 39 *"Shtet".*
Nisur nga kjo situatë Bashkia Vlorë i është drejtuar MZHETTS me shkresën Nr. 4459/1 prot. datë 07.06.2016 lënda "*Kthim përgjigje*" ku kërkon nga institucioni qiradhënës si të vijojë me procedurën.
MZHETTS është përgjigjur Bashkisë Vlorë me shkresën nr. 4459/2 prot., datë 11.07.2016 ku ndër të tjera citon se jeni ju që duhet të ndërmerrni veprime ligjore mbi vijueshmërinë e kontratës së cituar duke marrë parasysh edhe orientimet e KLSH.
Referuar dispozitave ligjore në fuqi drejtoria e PPMA ka hartuar materialin për Këshillin Bashkiak, material i cili hartuar si draft nga drejtoria i është drejtuar për shqyrtim edhe drejtorisë juridike me shkresën nr. 8328 prot., datë 10.10.2016, shkresa shoqëruar me relacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm ligjor.
Korrespodenca e mbajtur me MZHETTS në lidhje me problematikat e krijuara për lënien e detyrimeve nga KLSH dhe për arkëtimin e tyre, ka qenë si më poshtë:
-Me shkresën nr. 3774/1 prot., datë 22.09.2014 lënda "Mbi derdhjen e detyrimit të vlerës së qirasë nga shoqëria "I....D" ", Bashkia Vlorë i është drejtuar ministrisë, ku përveç detyrimit ligjor që Bashkia Vlorë ka për raportimin çdo 3-muaj të vlerës së arkëtuar nga qiraja në bazë të kontratës së qirasë nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 01.06.2002 dhe anekseve të saj, ka bërë me dije ministrinë si subjekt qiradhënës (nënshkrues i kontratës) edhe për detyrimet që subjekti qiramarrës i është lëne nga KLSH.

-Me shkresën nr. 4697 prot., datë 20.10.2015 lënda "Mbi problematikën e krijuar në zbatimin e kontratës së qiramarrjes me objekt: "Parku i Lojërave të qytetit të Vlorës", drejtuar MZHETTS, Bashkia Vlorë ka kërkuar nga institucioni qiradhënës të shprehet se si do të vijojë me procedurën për detyrimin e lënë nga KLSH.
-Me shkresën nr. 6305 prot., datë 23.12.2015 "*Kërkesë e përsëritur*", Bashkia i është drejtuar sërish MZHETTS për problematikën e krijuar.
Në zbatim të rekomandimit të KLSH (shkresa nr. 707/13, datë 30.6.2014), ankesave të subjektit qiramarrës për sipërfaqen e shfrytëzueshme dhe përgjigjeve të MZHETTS (se jeni ju që duhet të ndërmerrni veprime ligjore mbi vijueshmërinë e kontratës së cituar duke marrë parasysh edhe orientimet e KLSH), Kryetari i Bashkisë Vlorë me urdhri të brendshëm nr. 15, datë 22.01.2016 "Për ngritjen e komisionit për rivlerësimin e sipërfaqes së pasurisë së paluajtshme në funksion të parkut të lojërave", është ngritur komisioni i verifikimit në terren në këtij objekt, i përbërë nga O. F me profesion ing. Gjeodet K. A me funksion topograf, A. L me funksion Administrativ Rajoni 3, E. B me funksion Jurist dhe R. H me funksion Arkitekt.
Ky komision në datën 27.01.2016 ka hartuar procesverbalin e matjeve faktike ne funksion te parkut te lojërave shoqëruar edhe me plan vendosje bashkëlidhur, të nënshkruar edhe nga përfaqësuesi i subjektit "I....D" . N. L, është konstatuar se subjekti "I....D" **ka në përdorim një sipërfaqe 14960 m$^2$**.
Në zbatim të këtij procesverbali Drejtoria e Pronave Publike dhe Drejtoria Juridike hartuar një relacion shpjegues për ndryshimin dhe saktësimin e sipërfaqes së shfrytëzueshme nga subjekti qiramarrës "I....D" (i cili ka rënë dakord), në të cilën thuhet, citoj:

*1-Të miratoj ndryshimin e sipërfaqes së truallit në funksion të Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës, bazuar në kontratën e qirasë nr. 2964, datë 4.6.2002, nënshkruar ndërmjet ME dhe shoqërisë 'I....D'',* ***me sipërfaqe trualli sipas matjeve faktike të kryera në terren.***

*2-Të miratoj sipërfaqen prej 14690 m2, në funksion të Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës, sipas matjeve faktike të kryera në terren, shoqëruar me genplani.*

*3- Ky vendim ti dërgohet për kompetencë MZHETTS, për vijimin e mëtejshëm të procedurave ligjore.*

*4-Efektet financiare, si rrjedhojë e ndryshimit të sipërfaqes të fillojnë nga data 03.07.2013.*

*5-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë.*

Këshilli Bashkiak me vendim nr. 60, datë 27.10.2016 ka bërë miratimin e projekt vendimin nr. 8582, datë 14.10.2016 (nënshkruar nga Drejtori juridik D. Z dhe Kryetari i Bashkisë D. L.) të shoqëruar me relacion shpjegues (hartuar nga D. Z. me detyrë Drejtor Juridik, A. SH me detyrë Drejtore në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe E. B e O. F, me detyrë specialist në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve. Ky vendim është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 3002, datë 10.11.2016, si i ligjshëm.
Sipas këtij vendimi të KB është miratuar ndryshimi i sipërfaqes funksionale të Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës, të kontratës nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 4 Qershor 2002, sipas matjeve në terren të bërë me grup pune, që ka në përdorim subjektit "I....D" (për të cilën ka rënë dakord), **një sipërfaqe prej 14960 m$^2$**, duke mos u shprehur për periudhën e shtrirjes së efekteve, siç thuhet në projekt-vendim nga data 3.7.2013.

*Sipas kontratës për sipërfaqen 11890 m$^2$ çmimi është 360,060 lekë, ndërsa për sipërfaqen faktike* ***14960 m$^2$*** *që subjekti ka në përdorim (me qira), çmimi përllogaritet në vlerën 453,027 lekë/muaj (sipas*

*vlerave të përllogaritur nga MZhETT),* ***tarifë të cilën subjekti duhej të paguaj pas matjeve faktike të kryera në terren mbi sipërfaqen e shfrytëzueshme (Tetor 2016).***

Me shkresën nr. 2153, datë 18.04.2017 Bashkia Vlorë i është drejtuar Ministrise së MZHETTS për modifikimin e kontratës e cila sjelle efekte financiare si rezultat i sanksionimit të sipërfaqes në përdorim të subjektit prej 14960 $m^2$, pas daljes së vendimit të KB nr. 60, datë 27.10.2016. Nga ana e MZHETTS akoma nuk është kthyer përgjigje në lidhje me shkresën e bërë**.**

Kështu referuar sa mësipërm (VKB nr. 60, datë 31.10.2016 dhe shkresës nr. 707/13, datë 30.6.2014 të KLSH për zbatim rekomandimi), detyrimi që i lind subjekti "L.....D" për sipërfaqen e marrë me qira të objekti; "*Parkun e Lojërave*" prej 14690 $m^2$, referuar dhe të dhënave të procesverbalit të komisionit datë 27.01.2016 (për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2017), paraqitet si vijon:

| **Muaj** | **Detyrim sipas viteve për sipërfaqen 16112 $m^2$ dhe 14960 $m^2$** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **2012** | **2013** | **2014** | **2015** | **2016** | **2017** | **Shuma** |
| JANAR | 114,127 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 2,514,034 |
| SHKURT | 114,127 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 2,514,034 |
| MARS | 114,127 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 2,514,034 |
| PRILL | 114,127 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 2,514,034 |
| MAJE | 114,127 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 2,514,034 |
| QERSHOR | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 2,886,627 |
| KORRIK | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 2,886,627 |
| GUSHT | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 2,886,627 |
| SHTATOR | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 2,886,627 |
| TETOR | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 453,027 | 2,852,934 |
| NENTOR | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 453,027 | 2,852,934 |
| DHJETOR | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 486,720 | 453,027 | 453,027 | 2,852,934 |
| **Detyrimi për periudhën Janar 2012 - Dhjetor 2017** | | | | | | | **32,675,480** |
| **Paguar periudha 01.01.2012 - 31.12.2017.....** | | | | | | | **25,691,994** |
| *Nga e cila:.....* | | | | | | | |
| *Paguar periudha Janar 2012 - Dhjetor 2013.....* | | | | | | | *4,016,604* |
| *Paguar periudha Janar 2014 - Dhjetor 2017.....* | | | | | | | *17,282,880* |
| *Detyrime të prapambetura likuiduar deri 31.12.2017.....* | | | | | | | *4,392,510* |
| **Gjithsej detyrim i mbetur për likuidim deri 31.12.2017.....** | | | | | | | **6,983,486** |

Në përfundim subjekti "I....D', i lind një detyrim deri me datë 31.12.2017 për likuidim të qirasë së objektit "Parku i Lodrave" **në vlerën 6,983,486 lekë,** si ardhur me dëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe të MZHETTS, sipas përqindjeve.

Në përllogaritjen e detyrimeve që rrjedhin nga administrimi i sipërfaqes së "Parkut të Lojërave" nga subjekti "L.....D", grupi i auditimit të KLSH, referuar kushteve të kontratave, VKB dhe të dhënave të paraqitura, shkresës 707/13, datë 30.6.2014 të KLSH, ka vlerësuar se subjekti "I....D" ka akoma detyrim nga Bashkisë Vlorë MZHETTS një vlerë prej **6,983,486 lekë** deri me datë 31.12.2017.
Në vlerësimin e këtij detyrimi është marrë për bazë ndryshimi i çmimit që ka ndodhur në muajin Qershor 2012 (si rezultat i ndryshimit të çmimit me VKM), ndryshim i cili në periudhat e mëvonshme të ndryshimit të VKM nuk janë reflektuar, respektivisht:

*VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve"*

*kapitulli III "Përcaktimi i tarifës dysheme për pasuritë shtetërore, që jepen me qira ose enfiteozë" pika 4 dhe VKM nr. 529 datë 8.6.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe mënyrën e dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" kreu III "Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë" pika 1, i ndryshuar me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", me ndryshime*

Nuk është marrë në konsideratë ndryshimi i sipërfaqes së objektit nga 16112 $m^2$ në 11890 $m^2$, pasi dokumentacioni sqarues ligjorë nuk ka (argumentet trajtuar mësipërm), por është marrë në konsideratë ndryshimi i sipërfaqes nga 16112 $m^2$ në 14960 $m^2$ , sipas VKB nr. 60, datë 27.10.2016 "Për një saktësim në VKB nr. 102 datë 24.12.2001 "Mbi dhënien me qira të Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës, ku është sanksionuar sipërfaqja dhe miratuar nga të gjitha palët.

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***
*-Në hartimin dhe zbatimin e kontratës së dhënies me qira të objektit "Parku i lojërave të qytetit Vlorë", u konstatuan shkelje ligjore si më poshtë:*
*-Është arkëtuar më pak për periudhën 1 Janar 2012 deri 31 Dhjetor 2017,* ***shuma 6,983,486 lekë****,* ***e ardhur me dëm dhe që kërkohet të arkëtohet nga subjekti "I....D" Vlorë",*** *kjo sipas procesverbalit të mbajtur nga administrata e Bashkisë Vlorë mbi saktësimin e sipërfaqes në shfrytëzim që subjekti ka.*
*-Bashkia akoma nuk e ka në pronësi objektin në fjalë, por është objekt në administrim të saj sipas VKM nr. 1643 datë 17.12.2008" "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, të Qarkut Vlorë".*
*-Nuk është zbatuar pika 6.3 e kontratës, pasi vlera e garancisë së kontratës nuk është derdhur nga qiramarrësi dhe nuk është ngurtësuar në emër të Bashkisë Vlorë, deri në përfundim të kontratës".*

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
L .B. me funksion Drejtoresh e Burimeve Njerëzore.
D. Z. me funksion Drejtor i Drejtorisë Juridike.
A. M me funksion ish-Drejtore e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve (periudha 29.12.2016 – 15.6.2017).
A. XH me funksion specialiste në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.
E. B me funksion Juriste në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH:*** *Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 1201/4, datë 06.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga ish-Drejtoresha e Drejtorisë së PPMA Bashkia Vlorë, merret në konsideratë fakti që nga ana e sajë është përgatitur materiali për në Këshillin Bashkiak për sipërfaqen në përdorim nga subjekti "I....D" prej 14960 m2, por që më pas është larguar nga ky pozicion sipas vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 1, datë 4.11.2016, duke u transferuar në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Shërbimit Publik dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe me shkresën nr. 11034/1, datë 5.01.2017 është njoftuar Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Kryetari i Bashkisë Vlorë mbi dorëzimin e detyrës, duke përjashtuar nga përgjegjësia.*
*Gjithashtu merret në konsideratë dhe mos përgjegjësia e z. O. F me detyrë ish-specialist në DRJ. Pronave Publike (ing. Gjeodet), paraqitur me shkresën nr. 1670/2, datë 06.03.2018.* ***Pretendimi merret në konsideratë për përgjegjësinë.***

*(Me personat përgjegjës sipas rasteve është mbajtur akt-konstatimi nr. 29, datë 27.02.2018)*

**Për Bashkinë Vlorë**

Referuar në dokumentacionin e disponuar/vënë në dispozicion nga Drejtoria e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar, rezulton se për periudhën 2015-2017, nga këto drejtori janë lidhur dhe ndjekur 2 kontrata qiraje afatshkurtër lidhur me lënien në përdorim të ambienteve të këtij institucioni subjekteve të ndryshme tregtare, dhe konkretisht:

| Nr. | Emërtimi subjektit | Objekti i Kontratës | Sip objekti m2 | Truall m2 | Vlera e objektit/ Vit | Vlera truallit funksional/vit | Totali | Vitet 2015-2017 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | KN<br>K.M<br>B. A | Dhënia me qira e ambienteve të objektit në rajonin nr.2 | 100 | 100 | 240,000 | 120000 | 360,000 | 1,080,000 |
| 2 | J.....S<br>TH. P | Dhënia me qira e njësie shërbimi në rajonin nr. 5 | 74 | 0 | 180,000 | 0 | 180,000 | 540,000 |
| | **Totali** | | **174** | **100** | **420,000** | **120,000** | **540,000** | **1,620,000** |

Kontratat e lidhura në vitin 2015-2017 rezultuan në referim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve , të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016.

Lidhur me kontratën e KN , me nr. 17, datë 05.01.2015, nr. 9775, datë 18.11.2016 dhe nr. 7472, datë 31.08.2017, rezulton se vit për vit është bërë shlyerja e menjëhershme e saj, në vlerën prej 306,000 dhe për të tri vitet, 918,000 lekë. Vlera e paguar për secilin vit është në shumën prej 306,000 lekë, pasi nga vlera e detyrimit prej 360,000 lekë është zbritur 15% tatim në burim (ose 54,000 për vit dhe 162,000 lekë), kjo sipas faturës për arkëtim të plotësuar nga përfaqësuesi i bashkisë.

Lidhur me këtë kontratë rezulton se për vitin 2017 në nenin 4 "Pagesa dhe regjimi i saj" nuk është përcaktuar vlera mujore e qirasë si për objektin ashtu dhe për truallin funksional të tij, veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi konceptuesi i saj P. Th..

Në asnjërën prej kontratave në nenin 2 "Qëllimi i dhënies me qira", nuk është përcaktuar qëllimi i përdorimit të saj, por thjesht është cituar se "qëllimi i kësaj kontrate është dhënia me qira i përcaktuar në nenin 1", nen i cili nuk përcakton qëllim përdorimi por vetëm sipërfaqen sipas kontratës, veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi konceptuesi i saj E. B dhe P. Th..

Lidhur me kontratën e "J.....s" , me nr. 2713, datë 01.07.2014, aneks kontratë nr. 441, datë 09.02.2015, kontratë me nr. 2589, datë 01.07.2015, për uljen e sipërfaqes në 75m2 dhe nr. 7472, datë 31.08.2017, rezulton se vit për vit, sipas nenit 10, në çdo 3 muaj është bërë shlyerja e detyrimeve, në vlerën prej 357,600 lekë. Për vitin 2017 për pjesën e mbetur (01.07.2017-deri më 31.12.2017) rezulton se është lejuar subjekti të ushtrojë aktivitetin pa kontratën përkatëse, veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014.

Lidhur me këtë kontratë rezulton se për vitin 2014 e pjesërisht 2015 sipërfaqja e dhënë me qira ka qenë prej 106 m2 dhe vlera e qirasë prej 254,400, por duke qenë se e ka prekur projekti i rrugës "Trans ballkanike" njëri nga dy objektet e dhëna me qira është prishur, çka është reflektuar dhe në kontratat pasardhëse.

Kjo kontratë ka trajtuar me qira vetëm pjesën e objekteve pasi përsa i përket truallit/fidanishtes rezulton se është rregulluar me aktmarrëveshjen nr. 2713, datë 01.07.2014 "Shërbimi i sipërfaqeve të gjelbërta në qytet", sipas të cilit objektet do të mbahen në ruajte dhe vetëm 106m2 do të jepet me qira, ndërsa fidanishtja prej 87070m2 do ti kalojë në shfrytëzim dhe ruajtje. Po sipas aktmarrëveshjes kontrata bazë është për vlerën prej 150,095,885 lekë dhe i shtrin efektet kohore për një periudhë 5 vjeçare.
Aktualisht rezulton se sipërfaqja është nga 87070m2 në 55194m2, nga e cila 33877m2 është tokë që shfrytëzohet dhe 21317 është tokë që mbetet në ruajtje. Zbritja e sipërfaqes është bërë sipas procesverbalit datë 20.02.2015 të nënshkruar nga përfaqësuesit e bashkisë G. SH, Drejtor, F. M Supervizor, TH. P, Administrator i Ndërmarrjes së Gjelbërimit, K. A specialist dhe F. D specialist, si dhe është miratuar nga Nënkryetari i Bashkisë A. M. Procesverbali referohet në investimin publik në proces realizimi nga Bashkia Vlorë nga ku për shkak të ndërtimit të rrugës që lidh rrugën Transballkanike dhe superstradën Vlorë-Fier, një pjesë e fidanishtes dhe objekteve prishen nga realizimi i investimit.
Për të dy kontratat referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga punonjësit e Bashkisë Vlorë, rezulton se:
Në asnjërën prej kontratave në nenin 2 "Qëllimi i dhënies me qira", nuk është përcaktuar qëllimi i përdorimit të saj, por thjesht është cituar se "qëllimi i kësaj kontrate është dhënia me qira i përcaktuar në nenin 1", nen i cili nuk përcakton qëllim përdorimi por vetëm sipërfaqen sipas kontratës, veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi konceptuesi i saj E. B dhe P. TH
Bashkia Vlorë nuk ka zbatuar plotësisht kërkesat e VKM nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" ndryshuar me VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kreu II "Procedurat e Dhënies me Qira ose Enfiteozë të Pasurisë Shtetërore", lidhur me përgatitjen e procedurave dhe dokumentacionit për vijueshmërinë e secilës kontrate, duke filluar:
a) propozimin e ndërmarrjes, shoqërisë apo institucionit shtetëror për dhënien me qira ose enfiteozë të objektit, i cili përmban edhe propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në objekt.
b) vendimin e organit drejtues të ndërmarrjes, shoqërisë apo institucionit;
c) miratimin e organit të varësisë administrative;
ç) genplani e objektit, ku të jenë shënuar sipërfaqja e truallit, gjithsej, sipërfaqja e truallit nën ndërtesë dhe sipërfaqja e truallit të lirë funksional (jo nën ndërtesë), të konfirmuar nga drejtori i ndërmarrjes, shoqërisë apo institucionit shtetëror dhe nga organi i prefekturës, në territorin e së cilës ndodhet pasuria;
d) tarifën dysheme të detyrimit mujor për sipërfaqet nën objekt, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim dhe, duke pasur parasysh edhe gjendjen fizike të objektit;
dh) vlerën e qirasë mujore për linjat teknologjike, galeritë minerare, depozitat, që janë të instaluara në objektin që jepet me qira ose enfiteozë, të llogaritur, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim;
e) konfirmimin nga ZRPP për pronësinë shtet të objektit dhe truallit, si dhe nga ATP për vendimet që mund të ketë dhënë për njohje ose kthim prone.
3. Për objektet e përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 6 të kapitullit I të këtij vendimi, ndërmarrja, shoqëria a institucioni shtetëror, pas përgatitjes së dokumentacionit, lidh kontratën e qirasë.

5. Në urdhrin e titullarit të institucionit për dhënien me qira ose enfiteozë me konkurrim të pasurisë shtetërore përcaktohen:
a) të dhënat e objektit: emërtimi, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, vlera dysheme e detyrimit mujor të llogaritur sipas tarifave të këtij vendimi, afati;
b) veprimtaria që mund të ushtrohet në objekt;
c) pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, të përcaktuara sipas pikave 3 ose 4 të kapitullit I të këtij vendimi, të cilat caktohen, rast pas rasti, nga titullari i institucionit;
ç) vendi, data dhe ora për paraqitjen e dokumenteve;
d) përbërja e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve, me tre veta, një kryetar e dy anëtarë;
dh) dokumentacioni, që do të paraqitet në procedurën e konkurrimit nga konkurrentët.
Po ashtu nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI "Monitorimi i Kontratave" lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozë procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozë dhe konkretisht pikës 2 "Njësitë monitoruese të kontratave të qirasë ose enfiteozë kryejnë këto detyra", kjo pasi në asnjë rast nuk rezultoi të jetë hartuar procesverbal dorëzimi, genplani i objektit, pamje fotografike, gjendja fizike dhe vlera kontabël, pasi nuk rezultoi të jetë dokumentuar me akte përkatëse ky detyrim; nuk janë dërguar periodikisht pranë degës së Shoqërive Publike Vlorë evidenca e objekteve të dhënë me qira si dhe në fillim të çdo viti ushtrimor, për vitin paraardhës evidencat e plota të qirave; si dhe në shumicën e kontratave të vëna në dispozicion nuk rezultoi bashkëlidhur genplani i objektit të dhënë me qira, sipërfaqes funksionale e truallit të lirë.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në realizimin e procedurave dhe marrëdhëniet kontraktuale të më sipërme ngarkohet me përgjegjësi E. B me detyrë Jurist në Drejtorinë e Menaxhimit të Pronave Publike dhe Aseteve dhe P. Th. me detyrë Përgjegjës Juridik i Njësisë së Prokurimit, sipas kompetencave dhe përgjegjësive përkatëse ligjore e institucionale.

**Për Njësinë Administrative Shushicë**
Referuar në dokumentacionin e disponuar/vënë në dispozicion nga Njësia Administrative Shushicë, rezultojë se kjo njësi ka në pronësi një objekt dhe truallin funksional të tij të quajtur "Thertore". Sipas dokumenteve të pronësisë (certifikatë pronësie të lëshuar nga ZVRPP Vlorë) objekti ka sipërfaqe prej 193.5 m2 dhe truall funksional 5200m2. Dokumenti i pronësisë rezulton të jetë regjistruar në favor të ish-Komunës prej vitit 2005, për pasurinë nr. 5/34, në volum 1 faqe 69.
Këshilli i Komunës Novosel me vendimin nr. 42, datë 16.03.2012 në referim të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 ka vendosur të japë me qira Thertoren e Komunës Novosel, si pronë dhe investim të vetë komunës, vendim i ndryshuar me VKK nr. 83, datë 15.03.2013, për të cilin Prefekti me shkresën nr. 624/1, datë 01.04.2013 rezulton se ka bërë shprehjen e ligjshmërisë të vendimit. Lidhur me zbatimin e këtij vendimi rezulton se ish-Kryetari K. SH ka nxjerrë urdhrin nr. 9, datë 02.04.2012 "Për ngritjen e grupit të punës për dorëzimin e objektit Thertore Qiramarrësit", grup i rezultuar i përbërë nga Sh. M. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Urbanistikës, R. H., me detyrë Juriste, Z. B me detyrë Veterinere, S. Z me detyrë Shef Shërbimesh dhe SH. M. me detyrë Llogaritare e parë.
Lidhur me sa sipër nga ish-Komuna me kontratën nr. 91, datë 30.03.2012 të lidhur ndërmjet Qiradhënësit Komuna Novosel e përfaqësuar nga ish-Kryetari K. SH dhe Qiramarrësit N. S, është lidhur kontrata e dhënies me qira të objektit Thertore me sipërfaqe 193.5 m2, për një periudhë vlefshmërie nga data 01.04.2012 deri më 31.03.2013 dhe vlerë kontrate prej 30,000 lekë/muaj.
Kontrata nr. 403, datë 01.04.2013 të lidhur ndërmjet Qiradhënësit Komuna Novosel e përfaqësuar nga ish-Kryetari K. SH dhe Qiramarrësit N. S, është lidhur kontrata e dhënies me qira të objektit Thertore

me sipërfaqe 193.5 m2, për një periudhë vlefshmërie nga data 01.04.2013 deri më 01.04.2014 dhe vlerë kontrate prej 30000 lekë/muaj.
Kontrata nr. 42, datë 27.03.2014 të lidhur ndërmjet Qiradhënësit Komuna Novosel e përfaqësuar nga ish-Kryetari K. SH dhe Qiramarrësit N. S, është lidhur kontrata e dhënies me qira të objektit Thertore me sipërfaqe 193.5 m2, për një periudhë vlefshmërie nga data 27.03.2014 deri më 31.03.2015 dhe vlerë kontrate prej 30000 lekë/muaj.
Kontrata nr. 63, datë 26.03.2015 të lidhur ndërmjet Qiradhënësit Komuna Novosel e përfaqësuar nga ish-Kryetari K. SH dhe Qiramarrësit N. S, është lidhur kontrata e dhënies me qira të objektit Thertore me sipërfaqe 193.5 m2, për një periudhë vlefshmërie nga data 26.03.2014 deri më 26.03.2018 dhe vlerë kontrate prej 30000 lekë/muaj.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i secilës kontratë rezulton se është dhënë me qira vetëm objekti, duke mos u përfshirë në kontratë truallin funksional të tij si dhe linjën e përpunimit të Thertores, pjesë integrale e objektit. Mos dhënia me qira e linjës së thertores ka sjellë për pasojë lejimin e subjektit të përdor ato pa kundërshpërblim.
Mos përllogaritja e vlerës së qirasë për truallin funksional dhe linjën e përpunimit/prodhimit është në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.6.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve , të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kapitullit III, Tarifat dhe Vlera Dysheme për Pasuritë Shtetërore që Jepen me Qira ose Enfiteozë, pikat 1/b, 2 dhe 5 dhe konkretisht:
1. Për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, vlera dysheme e detyrimit mujor përcaktohet si shumë e vlerës së qirasë mujore për ndërtesën dhe sipërfaqen funksionale që jepet me qira ose enfiteozë, të llogaritura si më poshtë vijon:
b) për sipërfaqen funksionale, tarifa dysheme e qirasë mujore është 20 për qind e tarifës dysheme të detyrimit mujor, të përcaktuar për ndërtesat. Trualli nën ndërtesë (objekti) përfshihet në tarifën e qirasë së ndërtesës.
2. Kur jepet me qira truall i lirë, pra kur jepet me qira ose enfiteozë vetëm truall, tarifa dysheme e qirasë mujore është 100 lekë/m2.
5. Për përcaktimin e vlerës së detyrimit mujor të qirasë, për pasuritë e luajtshme (makineritë, pajisjet, linjat teknologjike, makineritë e pajisjet në galeritë minerare etj.), që jepen me qira, institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore që ka në administrim pasurinë, përcakton vlerën e qirasë vjetore, që është sa 1/10 e VAM-it (vlerës aktuale minimale), të llogaritur si diferencë e vlerës fillestare të kontabilizuar minus amortizimin në vite, mbështetur në vendimin nr. 401, datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave (pjesa për investime), shumëzuar me indeksin e çmimeve të muajit përkatës, të publikuar nga INSTAT-i.
Sipërfaqja në përdorim e subjektit është 5200 m2 kjo sipas certifikatës së pronësisë dhe në referim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, si dhe duke marrë për bazë edhe kontratat e tjera të lidhura nga ky institucion me subjekte të tjera, tarifa minimale e përdorur duhet të ishte në vlerën prej 20 lekë/m2 në muaj. Për periudhën e lidhjes së kontratave (01.04.2012 deri më 26.3.2018), ose 72 muaj në rast se do të kishte një marrëdhënie kontraktore duhet të kishte derdhur për llogari të institucionit shumën prej 7,200,000 lekë (20lekë/m2 x 72muaj x 1200m2) shumë e cila

përbën të ardhura të munguara me dëm për buxhetin e shtetit si dhe lejimin e përdorimin e pronës shtetërore pa aktmarrëveshje dhe pa kundërshpërblim.
Po ashtu për linjën e përpunimit/prodhimit dhe inventarin e imët të objektit, sipas të dhënave kontabël të regjistruara sipas inventarizimit të objektit është në vlerën mesatare prej 7.200.000 lekë, nga ku vetëm dhoma frigoriferike është në vlerën e 6,900.000 lekë. Për periudhën e lidhjes së kontratave (01.04.2012 deri më 26.3.2018), ose 72 muaj, pra 5 ½ vjet në rast se do të kishte një marrëdhënie kontraktore duhet të kishte derdhur për llogari të institucionit shumën prej 3,960,000 lekë (7.200.000 lekë x 1/10 vlerës x 5.5 vite), shumë e cila përbën të ardhura të munguara me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit si dhe lejimin e përdorimin e pronës shtetërore pa aktmarrëveshje dhe pa kundërshpërblim.
Po ashtu nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI "Monitorimi i Kontratave" lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozë procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozë dhe konkretisht pikës 2 "Njësitë monitoruese të kontratave të qirasë ose enfiteozë kryejnë këto detyra", kjo pasi në asnjë rast nuk rezultoi të jetë hartuar procesverbal dorëzimi, genplani i objektit, pamje fotografike, gjendja fizike dhe vlera kontabël, pasi nuk rezultoi të jetë dokumentuar me akte përkatëse ky detyrim; nuk janë dërguar periodikisht pranë degës së Shoqërive Publike Vlorë evidenca e objekteve të dhënë me qira si dhe në fillim të çdo viti ushtrimor, për vitin paraardhës evidencat e plota të qirave; si dhe në shumicën e kontratave të vëna në dispozicion nuk rezultoi bashkëlidhur genplani i objektit të dhënë me qira, sipërfaqes funksionale e truallit të lirë.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në realizimin e procedurave dhe marrëdhëniet kontraktuale të më sipërme ngarkohet me përgjegjësi K. SH me detyrë ish-Kryetar i Komunës Novosel dhe aktualisht administrator i Njësisë Administrative Novosel.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH****: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 405, datë 07.03.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga ish-Komuna Novoselë, ish-Kryetari K. SH, ku sqarohet se nga 5200 m2 truall i Thertores, nuk ka qenë i gjithi në përdorim të sipërmarrësit pasi për sipërfaqen prej 4000 m2 nga ish-Komuna ka lidhur kontratë qiraje për 99 vjet me I. XH, për të cilin palët janë ende në proces gjyqësor (bashkëlidhur dokumentet).*
*Nga grupi i auditimit merret në konsideratë sqarimi përkatës duke u bërë dhe reflektimet përkatëse në raport dhe rekomandimin për shpërblim dëmi. Argumentet merren në konsideratë pjesërisht.*

**Për Qendrën e Artit, Kulturës dhe Turizmit**
Referuar në dokumentacionin e disponuar/vënë në dispozicion nga Qendra e Artit, Kulturës dhe Turizmit, rezulton se për periudhën 2015-2017, nga kjo drejtori janë lidhur kontrata qiraje afatshkurtër lidhur me lënien në përdorim të ambienteve të këtij institucioni subjekteve të ndryshme tregtare, kundrejt pagesës fikse prej 300 lekë/m2 me afat kohor kryesisht 1 vjeçar por dhe 6 mujor dhe konkretisht:

| Nr. | Emërtimi subjektit | Administratori | Sip m2 | Afati | Vlera 2015 | Vlera 2016 | Vlera 2017 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | M.L | M. G | 20 | 12 | 72,000 | 72,000 | |
| 2 | Zyra Info turistik | GJ. M | 40 | 12 | 144,000 | 144,000 | 144,000 |
| 3 | Bar FastFood Joni | F. R | 30.8 | 12 | 110,808 | 110,808 | 55,404 |
| 4 | Shoq "I.....a" | J. K | 113.4 | 12 | 408,240 | | |
| 5 | Q.....e | E. L | 55 | 12 | 198,000 | 198,000 | 198,000 |
| 6 | B.....i | K. M | 55 | 12 | 198,000 | 198,000 | 198,000 |
| 7 | Trans Urban Vlora | F.I | 30 | 12 | 108,000 | 108,000 | 108,000 |
| 8 | Bar | S. K | 45 | 6 | | | 81,000 |

| Nr. | Emërtimi subjektit | Administratori | Sip m2 | Afati | Vlera 2015 | Vlera 2016 | Vlera 2017 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Bar | S. K | 65 | 6 | | | 117,000 |
| | **Totali** | | | | **1,239,048** | **830,808** | **901,404** |

Për kontratat e lidhura në vitin 2015 lidhja e tyre si dhe ndjekja e zbatimi i kontratave ishte realizuar sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar me VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, përsa i përket kontratave të viteve 2016-2017, ato rezultuan të lidhura në referim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve , të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar si dhe kontratave respektive, rezulton se Qendra e Turizmit Artit e Kulturës nuk ka zbatuar plotësisht kërkesat e VKM nr. 529, datë 08.6.2011, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kreu II "Procedurat e Dhënies me Qira ose Enfiteozë të Pasurisë Shtetërore", lidhur me përgatitjen e procedurave dhe dokumentacionit për vijueshmërinë e secilës kontrate, duke filluar

a) propozimin e ndërmarrjes, shoqërisë apo institucionit shtetëror për dhënien me qira ose enfiteozë të objektit, i cili përmban edhe propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në objekt.

b) vendimin e organit drejtues të ndërmarrjes, shoqërisë apo institucionit;

c) miratimin e organit të varësisë administrative;

ç) genplani e objektit, ku të jenë shënuar sipërfaqja e truallit, gjithsej, sipërfaqja e truallit nën ndërtesë dhe sipërfaqja e truallit të lirë funksional (jo nën ndërtesë), të konfirmuar nga drejtori i ndërmarrjes, shoqërisë apo institucionit shtetëror dhe nga organi i prefekturës, në territorin e së cilës ndodhet pasuria;

d) tarifën dysheme të detyrimit mujor për sipërfaqet nën objekt, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim dhe, duke pasur parasysh edhe gjendjen fizike të objektit;

dh) vlerën e qirasë mujore për linjat teknologjike, galeritë minerare, depozitat, që janë të instaluara në objektin që jepet me qira ose enfiteozë, të llogaritur, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim;

e) konfirmimin nga ZRPP për pronësinë shtet të objektit dhe truallit, si dhe nga ATP për vendimet që mund të ketë dhënë për njohje ose kthim prone.

3. Për objektet e përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 6 të kapitullit I të këtij vendimi, ndërmarrja, shoqëria a institucioni shtetëror, pas përgatitjes së dokumentacionit, lidh kontratën e qirasë.

5. Në urdhrin e titullarit të institucionit për dhënien me qira ose enfiteozë me konkurrim të pasurisë shtetërore përcaktohen:

a) të dhënat e objektit: emërtimi, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, vlera dysheme e detyrimit mujor të llogaritur sipas tarifave të këtij vendimi, afati;

b) veprimtaria që mund të ushtrohet në objekt;

c) pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, të përcaktuara sipas pikave 3 ose 4 të kapitullit I të këtij vendimi, të cilat caktohen, rast pas rasti, nga titullari i institucionit;

ç) vendi, data dhe ora për paraqitjen e dokumenteve;

d) përbërja e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve, me tre veta, një kryetar e dy anëtarë;

dh) dokumentacioni, që do të paraqitet në procedurën e konkurrimit nga konkurrentët.

Po ashtu nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI "Monitorimi i Kontratave" lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozë procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozë dhe konkretisht pikës 2 "Njësitë monitoruese të kontratave të qirasë ose enfiteozë kryejnë këto detyra", kjo pasi në asnjë rast nuk rezultoi të jetë hartuar procesverbal dorëzimi, genplani i objektit, pamje fotografike, gjendja fizike dhe vlera kontabël, pasi nuk rezultoi të jetë dokumentuar me akte përkatëse ky detyrim; nuk janë dërguar periodikisht pranë degës së Shoqërive Publike Vlorë evidenca e objekteve të dhënë me qira si dhe në fillim të çdo viti ushtrimor, për vitin paraardhës evidencat e plota të qirave; si dhe në shumicën e kontratave të vëna në dispozicion nuk rezultoi bashkëlidhur genplani i objektit të dhënë me qira, sipërfaqes funksionale e truallit të lirë.
Nga verifikimi në vend i objektit rezultoi gjithashtu se në ambientet e Pallatit të Kulturës, ushtron aktivitetin edhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Vlorë, subjekti i cili ka selinë pikërisht në ambientet e këtij institucioni. Nga punonjësit e ngarkuar nuk na u vu në dispozicion kontratë qiraje apo ndonjë aktmarrëveshje të lidhur ndërmjet palëve. Theksojmë se ky subjekt ushtron aktivitetin prej vitesh dhe për seli dhe ambiente pune ka pikërisht ambientet e Qendrës të Turizmit, Artit dhe Kulturës.
Sipërfaqja në përdorim e subjektit është 115 m2 dhe në referim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, si dhe duke marrë për bazë edhe kontratat e tjera të lidhura nga ky institucion me subjekte të tjera, tarifa minimale e përdorur duhet të ishte në vlerën prej 300 lekë/m2 në muaj. Për periudhën objekt auditimit (vitet 2015-2017) subjekti në rast se do të kishte një marrëdhënie kontraktore duhet të kishte derdhur për llogari të institucionit shumën prej 1,242,000 lekë (300lekë/m2x36 muaj x 115m2) shumë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit si dhe lejimin e përdorimin e pronës shtetërore pa aktmarrëveshje.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara  në realizimin e procedurave dhe marrëdhëniet kontraktuale të më sipërme ngarkohet me përgjegjësi I. M me detyrë ish-Drejtor dhe D. F me detyrë Drejtor.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH****: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 9, datë 07.03.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga Drejtori i Qendrës së Kulturës dhe Artit është DH. F është sqaruar lidhur me arsyet e mos lidhjes së kontratës me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Vlorë, sqarime të cilat nuk merren në kondiseratë përsa nuk ka asnjë procedurë shkresore për të dokumentuar sa sipër. Argumentet nuk merren në konsideratë.*

Për pasuritë e administruara nga Institucionet e Varësisë dhe ato të kaluara në listë inventari.
Bashkisë Vlorë, sipas listë inventarit shoqërues të VKM nr. 1643, datë 17.12.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, Qarku Vlorë" u është miratuar lista e objekteve, trojeve dhe pasurive të tjera, të cilat kanë kaluar në administrim të institucionit.
Grupi i auditimit të KLSH në përmbushje të programit të auditimit nr. 1029/1, datë 09.10.2017 dhe shkresës nr. 06.01.2018, me shkresën nr. 1465, datë 21.02.2018 "Kërkesë për informim", ka kërkuar nga Bashkia Vlorë, Titullari i saj të ngrihet grup pune me specialistë të fushës për të verifikuar disa prej objekteve e trojeve sipas VKM-së. Grupi i punës të ngritur për këtë qëllim i përbërë nga specialistët e Drejtorisë të Menaxhimit të Pronave Publike dhe Aseteve E. B dhe A. XH si dhe Specialistin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike E. H, me shkresën nr. 1456/1, datë 23.02.2017, të vënë në dispozicion të grupit të auditimit më datë 26.02.2017, ka paraqitur informacionin si vijon:

Bashkisë Vlorë, me VKM nr. 1643, datë 18.12.2008, "Për miratimin e listës paraprake të pronave te paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim, Bashkisë Vlorë të Qarkut Vlorë ", i është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, e pashoqëruar me plan vendosjet përkatëse për secilën pasuri. Formularët për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore janë identifikuar nga specialistët: K. A Topograf dhe supervizuar nga L. J, ish-Drejtor i Urbanistikës në periudhën e hartimit të listës. Aktualisht DPPMA disponon fotokopje te inventarit të sipërcituar.

Për pasuritë sipas tabelës bashkëlidhur, ju sqarojmë se:

Stadiumi + aneksi i futbollit: Sipas VKM 1643 Datë 17.12.2008 , rezulton:

truall +ndërtese me sipërfaqe përkatësisht truall 40000m2 dhe ndërtese 680m2.

Sipas verifikimeve pranë ZVRPP rezulton:

Pasuria nr.12/26 Stadiumi, sipas ZVRPP Vlorë, gjendje juridike shtet me sipërfaqe 19486 m2.

Pasuria nr.12/34 Aneksi i Stadiumit, sipas ZVRPP Vlorë, gjendje juridike shtet me sipërfaqe 10721 m2.

Sipërfaqe totale Stadium +aneks është 30207 m2.

Përsa i përket administrimit të ambienteve dhe dhënies me qira, nuk kemi informacion dhe dokumentacion, në dijeninë tonë merret Drejtoria e Menaxhimit Financiar.

Palestra sipas VKM 1643 Datë 17.12.2008 , rezulton: truall +ndërtese me sipërfaqe përkatësisht truall 950 m2 dhe ndërtese 843m2.

Sipas matjeve ne harte figuron vetëm ndërtesë me sipërfaqe 940.8m2.

Nuk kemi informacion në lidhje me administrimin dhe dhënien me qira te saj.

Pishina Sipas VKM 1643 Datë 17.12.2008 , rezulton:

truall +ndërtese me sipërfaqe përkatësisht truall 2740 m2 dhe ndërtese 1166m2.

Pasuria nr.12/325 Pishine sipas ZVRPP Vlorë, gjendje juridike shtet me sipërfaqe 1881 m2.

Plan vendosja ndodhet ne dosjen nr.8 te dokumentacionit te inventarizimit.

Përsa i përket administrimit të ambienteve dhe dhënies me qira, nuk kemi informacion dhe dokumentacion, në dijeninë tonë merret Drejtoria e Menaxhimit Financiar.

Në dijeninë tonë, Libraritë tek 6-katëshi, tek Kapelja dhe tek Rruga e Re, kanë kryer procedurat për privatizim.

Ish Kinema Verore. Nr. Pasurisë sipas hartës treguese të hipotekës nuk figuron me Nr.54/40. Sipërfaqe e truallit sipas VKM nr. 1643 datë 17.12.2008 është 810m2 dhe ndërtesa 0m2. Trualli mbi te cilin ndodhet godina në ZK 8605, në dijeninë tonë është pronë private. Për ndërtesën nuk kemi informacion. Sipërfaqe e ndërtesës sipas hartës është 810m2.

Në Ish Ndërmarrjen "Perlat Rexhepi", aktualisht ndodhet Selia e PD. Me herët zyrat

janë përdorur nga Enti Kombëtar i Banesave. Dokumentacioni i plotë ndodhet pranë Drejtorisë së Menaxhimit Financiar. Në DPPMA nuk ka kontrata qiradhënie.

Selia e PS .Sipas VKM 1643 Datë 17.12.2008 trualli ka sipërfaqe 450 m2 dhe ndërtesa.

124.7m2. Kjo pronë administrohet nga vetë struktura e partisë. Përsa i përket administrimit të ambienteve dhe dhënies me qira, nuk kemi informacion dhe dokumentacion, në dijeninë tonë merret Drejtoria e Menaxhimit Financiar. Nga matjet ne harte trualli rezulton te jete 1477m2 dhe ndërtesa 379m2.

Nga verifikimet rezulton se Kabinat e Plazhit administrohen nga Ndërmarrja e

Shërbimeve Publike Vlorë. Aktualisht ekzistojnë 3 kabina 3-kateshe dhe 1 kabine 2-katëshe. Kabinat 1-katëshe janë prishur.
Aktualisht janë 103 ambiente banimi. Në kabinat ekzistuese janë vendosur familje të pastreha, kundrejt një qiraje mujore prej 4 000 lekë. Shumica e familjeve nuk paguajnë detyrimin mujor për shkak të pamundësisë ekonomike. Me shkresat nr. 137, datë 16.09.2016 me lëndë "Dërgohen pasqyrat e pagesës së qirasë në kabina plazhi" dhe nr. 167, datë 11.09.2017, drejtori E. H ka bëre me dijeni drejtoritë përkatëse për situatën e krijuar.
Përsa i përket informacionit që kërkohet nga ana juaj sipas tabelës bashkëlidhur, për zonat e plazheve nga verifikimet në hartë dhe projektet publike të zbatuara përgjatë vijës bregdetare (kjo sipas planimetrisë së shpronësimit) rezulton:
Truall rërë te Plazhi i Ri –rezulton se kjo pronë shtrihet nga ish-Vefa te Rrapi, por pa plan vendosje. Në këtë sipërfaqe është zbatuar projekti i Lungomares.
Truall (shesh + moli), kjo pronë ndodhet tek ish-Vefa, por pa plan vendosje. Kjo sipërfaqe është prekur nga zbatimi i projektit të Lungo-Mares.
Territor Plazh Aulona, rezulton se kjo pronë shtrihet nga Bolonja-Akademia por pa plan vendosje. Në këtë sipërfaqe është zbatuar projekti i Lungomares.
Territor Plazh i Vjetër, rezulton se kjo pronë shtrihet nga Moli-Ish kampi i Pioniereve por pa plan vendosje. Kjo është sipërfaqe rëre qe administrohet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale. Në këtë territor në periudhën e verës jepen SPL për plazhe.
Tregu i Vlorës, aktualisht në të ushtrohet aktivitet tregtar. Nuk disponojmë planvendosje. Subjektet paguajnë qira për zënie hapësire. Për informacion më të detajuar shërben Drejtoria e Menaxhimit Financiar.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion (listë inventarit, shkresës nr. 1456/1, datë 23.02.2018 dhe dokumenteve shoqëruese) rezultojë se për disa pasuri sipas VKM-së Bashkia Vlorë nuk ka përmbushur detyrimet ligjore lidhur me miradministrimin e pasurive publike, duke mos arkëtuar të ardhura për ato prona të cilat janë lëshuar në përdorim, mos rregullimit të marrëdhënieve nëpërmjet kontratave të qirasë
Shkresa e sipërcituar është shoqëruar edhe me shkresën nr. 167, datë 11.09.2017 të Drejtorit të Shërbimeve Publike E. H, drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve dhe Infrastrukturës dhe Drejtorisë së Menaxhimit Financiar, lidhur me problemin e disponimit dhe administrimit të kabinave të Plazhit të Vjetër, në të cilat janë strehuar qytetarë me autorizim të lëshuar nga bashkia. Sipas shkresës bëhet e ditur se vetëm dy qytetarë nga 103 kanë paguar detyrimet dhe pjesa tjetër e atyre të pajisur me autorizim nuk kanë lidhur kontrata me pretendimin se nuk kanë për çfarë të paguajnë. Listë e cila i bashkëlidhës shkresës drejtuar KLSH-së. Sipas shkresës rezulton se për vitin 2017 vetëm 37000 lekë janë të ardhurat financiarë të arkëtuara nga qiraja dhe mbetet pa arkëtuar detyrimi prej 4,984,000 lekë, ndërsa për vitet 2014-2016, detyrimet e pa mbledhura dhe të pa kërkuara janë në shumën prej 14,310,000 lekë nga ku shuma prej 4,326,000 lekë për vitin 2014, për vitin 2015 janë në shumën prej 4,992,000 lekë dhe për vitin 2016 në shumën prej 4,992,000 lekë, ndërsa të ardhurat për të tri vitet janë në shumën 22,000 lekë.
Mos vjelja e detyrimeve financiare përmban mos përmbushje të detyrimeve ligjore me pasojë krijimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e njësisë së qeverisës vendore Bashkia Vlorë në shumën prej 19,294,000 lekë.

Nga verifikimi në vend i secilit nga objektet e shënuara më sipër në ambientet e ish-Ndërmarrjes "Perlat Rexhepi", ka selinë subjekti politik Partia Demokratike. Sipas grupit të verifikimit në terren sipërfaqja në shfrytëzim e përdorim të këtij subjekti është 80m2. Lidhur me marrëdhënie që ekzistojnë ndërmjet Bashkisë Vlorë në cilësinë pronarit të objektit dhe PD, në cilësinë e përdoruesit të tij, grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë dokument shkresor të nënshkruar nga palët për këtë qëllim, por vetëm deklarime se ka vendim të këshillit bashkiak, vendim i cili nuk na është vënë në dispozicion për ta vlerësuar.
Veprimi i Bashkisë Vlorë, për mos lidhjen e kontratës së qirasë, duke lenë subjektin PD, të përdori sendin pa një marrëdhënie kontraktore e për rrjedhojë edhe pa kundërshpërblim, ka sjellë për pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë e cila për periudhën objekt auditimi përllogaritet në shumën prej 576,000 lekë (80m2 x 200lekë/m2 x 36 muaj = 576,000 lekë), veprime këto në kundërshtim me VKM nr. nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.
Po ashtu edhe subjekti politik Partia Socialiste rezulton se ka në përdorim një objekt me sipërfaqe prej 450m2 truall dhe ndërtesë 124.7m2, kjo sipas listë inventarit të VKM-së nr. 1643, datë 17.12.2008. në fakt pas matjeve të grupit të verifikimit rezulton se objekti në fakt ka një sipërfaqe më të madhe dhe konkretisht 379m2 dhe truall 1477m2.
Lidhur me marrëdhënie që ekzistojnë ndërmjet Bashkisë Vlorë në cilësinë pronarit të objektit dhe PS, në cilësinë e përdoruesit të tij, grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë dokument shkresor të nënshkruar nga palët për këtë qëllim, por vetëm deklarime se ka vendim të këshillit bashkiak, vendim i cili nuk na është vënë në dispozicion për ta vlerësuar.
Veprimi i Bashkisë Vlorë, për mos lidhjen e kontratës së qirasë, duke lenë subjektin të përdori sendin pa një marrëdhënie kontraktore e për rrjedhojë edhe pa kundërshpërblim, ka sjellë për pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë e cila për periudhën objekt auditimi përllogaritet në shumën prej 2,160,000 lekë (300m2 x 200lekë/m2 x 36 muaj = 2,160,000 lekë), veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.
Në këtë objekt përveç subjektit politik PS, rezulton se ushtron aktivitetin edhe subjekti privat "Bar kafe" A. ZH, person fizik, i cili ka në përdorim sipërfaqe objekti prej 80m2 dhe trualli funksional rreth 50m2. Për këtë subjekt rezulton se Bashkia Vlorë nuk ka lidhur kontratë qiraje, por ka lenë atë ta përdor sendin pa një marrëdhënie kontraktore e për rrjedhojë edhe pa kundërshpërblim, kanë sjellë për pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë e cila për periudhën objekt auditimi përllogaritet në shumën prej 576,000 lekë (80m2 x 200lekë/m2 x 36 muaj=576,000 lekë) ndërsa për truallin e lirë të ardhurat e munguara përllogariten në shumën prej 180,000 lekë (50m2 x 100lekë/m2 x 36 muaj = 180,000 lekë), veprime këto në kundërshtim me VKM nr. nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.
Veprimet dhe mosveprimet e tyre janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", si dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në mos administrimin e asteve dhe lënien e tyre në përdorim të subjekteve private, pa kontrata dhe pa kundërshpërblim mban përgjegjësi: A. SH me detyrë ish-drejtore e Menaxhimit të Pronave Publike dhe Aseteve, A. M me detyrë ish-drejtor i Menaxhimit të Pronave Publike dhe Aseteve, F. D me detyrë Drejtor i Shërbimeve dhe Kontrollit të Projekteve, G. Sh. me detyrë ish-Drejtor i Shërbimeve dhe Kontrollit të Projekteve. E. H, me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike, E. SH, me detyrë ish-Drejtor i Shërbimeve Publike dhe T. Z. me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar.

Mbi dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor e kullosor, zënë me ndërtime të karakterit social (shërbime hoteleri, bar, restorante, antena të telefonisë mobile etj.)
Në referim të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronës të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike", VKM nr. 799, datë 29.9.2010, "Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme", ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", VKM nr. 632, datë 11.6.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje", si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 20.7.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave, të livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje", çdo NJQV i lind e drejta dhe detyrimi i dhënies në përdorim dhe administrim e mbrojtje të fondit pyjor e kullosor.

Nga auditimi ka rezultuar se Bashkia Vlorë, në territorin e Njësive Administrative Shushicë dhe Orikum për sipërfaqet pyjore apo kullosore, ka ushtruar këtë të drejtë e detyrim ligjor, duke lidhur 55 kontrata qiraje për vitin 2016 dhe 41 kontrata për vitin 2017 për kullotje të bagëtisë.
Sipas kontratave, sipërfaqe e dhënë me qira për kullotje dhe kositje bari për vitin 2016 është 1655 ha, kullotë dimërore, 571 kullotë verore dhe 697 pyjore, për 3040 dhënë, 1135 dhi dhe 104 trasha për kullotat dimërore dhe 1080 dhënë, 220 dhi dhe 28 trasha për kullotat verore, sipërfaqja për qendër stani rezulton 1819m2 dhe vlera e qirasë sipas kontratave është në shumën prej 830,950 lekë.
Sipërfaqe e dhënë me qira për kullotje dhe kositje bari për vitin 2017 është 1513 ha, kullotë dimërore, 497 kullotë verore dhe 256 pyjore, për 3120 dhënë, 890 dhi dhe 16 trasha për kullotat dimërore dhe 1330 dhënë, 200 dhi dhe 15 trasha për kullotat verore, sipërfaqja për qendër stani rezulton 1839m2 dhe vlera e qirasë sipas kontratave është në shumën prej 724,100 lekë. (tabela përmbledhëse paraqitet në aktkonstatimin nr.40, datë 27.02.2018).

Në mënyrë të përmbledhur për të gjitha praktikat dhe procedurat e kryera nga struktura, për administrimi ne fondit pyjor e kullosor, konstatohet se:
Nga bashkia nuk është kryer procedura e aplikimit të regjistrimit të parcelave në ZVRPP, kjo sipas VKM nr. 799, datë 29.9.2010, "Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme" e cila citon se këto procedura për tokën pyjore e kullosore kryhen nga njësitë vendore pa tarifa aplikimi.
Për të gjitha kontratat konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë të secilit fermer që ka përfituar kontratë, si dhe nuk ka certifikatë nga Drejtoria e Shërbimeve Veterinare për numrin e regjistrit të bagëtive dhe matrikullin e tyre, duke mos u dokumentuar numri real i secilit blegtor.

Lidhur me administrimin e fondit të tokës ka rezultuar se:

Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes, sipas ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", neni 29 "Organet e kontrollit", neni 30 "Dokumentimi", por dhe 33 "Vlerësimi i dëmit" dhe 34 "Kundërvajtjet Administrative".
Mungon e nuk është bërë mbajtja, evidentimi, administrimi balancimit të fondit kullosor, në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", neni 5, pika 2/b "Pronësia", neni 7 "Inventarizimi", neni 8 "Regjistrimi", neni 9 "Regjistri i fondi kullosor", neni 14 "Planet e mbarështimit" dhe neni 15 "Bimët mjekësore".

Mbi praktikat për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore në referim të nenit 38 dhe 40, të ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, VKM nr. 22, datë 09.01.208 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal" dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", të ndryshuar, të kaluara nga ish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Vlorë).

Nga ish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Vlorë, i kanë kaluar Bashkisë Vlorë 2 kontrata të dhënies me qira të fondit pyjor e kullosor, të ndodhura në Njësinë Administrative Shushicë dhe konkretisht:

| Subjekti | Kontrata | Vjet | Qëllimi përdorimit | Sipërfaqe | Vlefta për vit | Detyrime pa shlyera | Penalitete | Detyrimi Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Blumar Skelë K. B | 1, dt 05.07.2013 | 10 | Pushim e argëtim | 1.6 ha | 162,000 | 0 | 0 | 0 |
| Nenaj V. N | 2, dt 12.09.2012 | 10 | Pushim e argëtim për zbatim | 1 ha | 105,000 | 105,000 | 10,500 | 115,500 |
| **TOTALI** | | | | **2.6 ha** | **26,700** | **105,000** | **10,500** | **115,500** |

Lidhja e Kontratave është referuar në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil", ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" dhe ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005"Për pyjet dhe shërbimin pyjor", dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2016 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave", ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, pika 5/1.
Aktualisht rezulton se deri për periudhën e kalimit nga DSHP Vlorë në Bashkinë Vlorë, subjektet kanë shlyer detyrimet përkatëse, për vitin 2016, ndërsa për vitin 2017 ka shlyer detyrimet vetëm subjekti "B.....ë" dhe është ende pa shlyer detyrimin subjekti "N.....j" , shumë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vlorë në shumën prej 105,000 lekë nga mos pagesa e detyrimit të qirasë dhe dëm ekonomik në shumën prej 10,500 lekë si penaliteti të përllogaritura nga mos shlyerja në kohë e detyrimit.
Lidhur me secilën kontratë rezulton se bashkia nuk ka mbajtur një akt inspektimi për sipërfaqen që subjekti ka vendosur në shfrytëzim me qëllim dokumentimin e saj.
Po ashtu nga momenti i kalimit të saj për ndjekje e zbatim, Bashkia Vlorë nuk ka bërë rinovimin e saj me të njëjtat kushte e përcaktime të kontratës bazë, kjo për faktin se tashmë subjekti juridik i cili duhet ti ndjekë ato nuk ka qenë përcaktuar në kontratën fillestare. Sa sipër duke qenë se subjekti juridik DSHP Vlorë i ka kaluar kontratat subjektit Bashkia Vlorë, është e drejtë e detyrim i kësaj të fundit për zëvendësimin e palëve kontraktore.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 1681/1, datë 12.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga Sektori i Pyjeve e Kullotave, LL. GJ, A. M.*

*dhe B. C është sqaruar mbi konstatimet e grupit të auditimit, sqarime të shoqëruara me dokumente bashkëlidhur. Sipas sqarimeve, si rrjedhojë e dokumentacionit jo të plotë të vënë në dispozicion kanë ardhur edhe konstatimet e grupit të auditimit.*
*Nga grupi i auditimit merren në konsideratë sqarimet përkatëse për ato raste kur konstatohet se keni bashkëlidhur dokumente. Pavarësisht sa sipër duhet të kishit dorëzuar gjatë auditimit të gjithë dokumentacionin e administruar nga ana juaj, po ashtu merret në konsideratë edhe mos pasja përgjegjësi për procese të cilat nuk kanë gjetur trajtim specifikim në ligj apo aktet nënligjore.. Pretendimi merret në konsideratë për përgjegjësinë.*

**Për ish-Komuna Qendër Vlorë**

Nga ish-Komuna Qendër rezulton se për periudhën 2010 deri më 2015 janë lidhur kontrata për dhënien me qira të fondit pyjor e kullosor. Lidhja e Kontratave është referuar në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil", ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar dhe ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005"Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar si dhe mbështetur në VKM nr. 754, datë 28.05.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje e kullota që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjeve vendore, Komuna Qendër Vlorë" dhe më konkretisht:

Kontrata nr. 528 rep, 471 kol datë 23.04.2010, përpiluar para noterit A. D, ndërmjet palës qiradhënëse Komuna Qendër përfaqësuar nga Kryetari F. B dhe qiramarrësit K. K, për dhënien me qira për një periudhë 30 vjet të fondit pyjor e kullosor, për vlerën prej 14000 lekë qira vjetore, të sipërfaqes prej 5 ha ndodhur në zonën kadastrale 3951 Zvërnec me nr. 4a (269/1). Dhënia me qira është referuar në vendimin e Këshillit të Komunës nr. 39, datë 02.12.2009 "Dhënie pëlqimi për kërkesën e K. K", vendim i konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti Ii Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1289/1, datë 15.12.2009. Qëllimi i përdorimit të saj rezulton për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme. Vlera e qirasë sipas kontratës është referuar në lidhjen 2/1 dhe 3 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", sipas të cilës për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, për një periudhë nga 21-30 vjet, për pyjet e ulëta, shkurret dhe kullotat është 14000 lekë/ha për vit. Prona figuron e regjistruar në ZVRPP Vlorë, në emër të Komunës Qendër me nr. Volum 6 faqe 74, në vitin 2009. Kontrata është regjistruar në ZVRPP Vlorë në volum 6 faqe 89, "Certifikatë për dhënie me qira".

Kontrata nr. 994 rep, 511 kol datë 25.03.2010, përpiluar para noterit N. I, ndërmjet palës qiradhënëse Komuna Qendër përfaqësuar nga Kryetari F. B dhe qiramarrësit DH. D, për dhënien me qira për një periudhë 30 vjet të fondit pyjor e kullosor, për vlerën prej 14000 lekë qira vjetore, të sipërfaqes prej 3 ha ndodhur në zonën kadastrale 3951 Zvërnec me nr. (269/1). Dhënia me qira është referuar në vendimin e Këshillit të Komunës nr. 40, datë 02.12.2009 "Dhënie pëlqimi për kërkesën e DH. D", vendim i konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti I Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1345/1, datë 30.12.2009. Qëllimi i përdorimit të saj rezulton për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme. Vlera e qirasë sipas kontratës është referuar në lidhjen 2/1 dhe 3 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", sipas të cilës për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, për një periudhë nga 21-30 vjet, për pyjet e ulëta, shkurret dhe kullotat është 14000 lekë/ha për vit. Prona figuron e regjistruar në ZVRPP Vlorë, në emër të Komunës Qendër me nr. Volum 6 faqe 87, në vitin 2009. Kontrata është regjistruar në ZVRPP Vlorë në volum 6 faqe 87, "Certifikatë për dhënie me qira".

Kontrata sipas aktmarrëveshjes noteriale nr. 3991 rep dhe 1971 kol, datë 27.08.2012 dhe kontratës datë 27.08.2012 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullosor" ka kaluar nga DH. D te P. G, i cili ka marrë përsipër të gjitha kushtet e përcaktuara në kontratën e mëparshme. Kontrata është regjistruar në ZVRPP Vlorë në volum 6 faqe 87, "Certifikatë për dhënie me qira".

Kontrata nr. 956 rep, 475 kol datë 24.03.2010, përpiluar para noterit N. I, ndërmjet palës qiradhënëse Komuna Qendër përfaqësuar nga Kryetari F. B dhe qiramarrësit H. XH, për dhënien me qira për një periudhë 30 vjet të fondit pyjor e kullosor, për vlerën prej 10000 lekë qira vjetore, të sipërfaqes prej 1.83 ha ndodhur në zonën kadastrale 3951 Zvërnec me nr. (169 dhe 170). Dhënia me qira është referuar në vendimin e Këshillit të Komunës nr. 42, datë 02.12.2009 "Dhënie pëlqimi për kërkesën e H. XH", vendim i konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1345/1, datë 30.12.2009. Qëllimi i përdorimit të saj rezulton për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme. Vlera e qirasë sipas kontratës është referuar në lidhjen 2/1 dhe 3 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", sipas të cilës për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, për një periudhë nga 21-30 vjet, për tokat me bimësi pyjore dhe sipërfaqe Inproduktive është 10000 lekë/ha për vit. Prona figuron e regjistruar në ZVRPP Vlorë, në emër të Komunës Qendër me nr. Volum 6 faqe 85 dhe volum 4 faqe 120, në vitin 2009. Kontrata është regjistruar në ZVRPP Vlorë në volum 6 faqe 85 dhe volum 4 faqe 120, "Certifikatë për dhënie me qira".

Kontratë qiraje datë 21.05.2015, për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullosor ndërmjet palës qiradhënëse Komuna Qendër përfaqësuar nga Kryetari F. B dhe qiramarrësit J. S, për dhënien me qira për një periudhë 30 vjet të fondit pyjor e kullosor, për vlerën prej 10000 lekë qira vjetore, të sipërfaqes prej 0.47 ha ndodhur në zonën kadastrale 3951 Zvërnec me nr. (169). Dhënia me qira është referuar në vendimin e Këshillit të Komunës nr. 7, datë 30.04.2015 "Dhënie pëlqimi për kërkesën e J. S", vendim i konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2247, datë 18.05.2015. Qëllimi i përdorimit të saj rezulton për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme. Vlera e qirasë sipas kontratës është referuar në lidhjen 2/1 dhe 3 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", sipas të cilës për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, për një periudhë nga 21-30 vjet, për tokat me bimësi pyjore dhe sipërfaqe Inproduktive është 10000 lekë/ha për vit. Prona figuron e regjistruar në ZVRPP Vlorë, në emër të Komunës Qendër me nr. Volum 6 faqe 86 dhe volum 6 faqe 76, në vitin 2009.

Kontratë qiraje datë 21.05.2015, për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullosor ndërmjet palës qiradhënëse Komuna Qendër përfaqësuar nga Kryetari F. B dhe qiramarrësit L. B, për dhënien me qira për një periudhë 30 vjet të fondit pyjor e kullosor, për vlerën prej 10000 lekë qira vjetore, të sipërfaqes prej 0.805 ha ndodhur në zonën kadastrale 3951 Zvërnec me nr. (169). Dhënia me qira është referuar në vendimin e Këshillit të Komunës nr. 8, datë 30.04.2015 "Dhënie pëlqimi për kërkesën e L. B", vendim i konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2247, datë 18.05.2015. Qëllimi i përdorimit të saj rezulton për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme. Vlera e qirasë sipas kontratës është referuar në lidhjen 2/1 dhe 3 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", sipas të cilës për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, për një periudhë nga 21-30 vjet, për tokat me bimësi pyjore dhe sipërfaqe Inproduktive është 10000 lekë/ha për vit. Prona figuron e regjistruar në ZVRPP Vlorë, në emër të Komunës Qendër me nr. Volum 6 faqe 78, në vitin 2009.

Kontratë qiraje datë 21.05.2015, për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullosor ndërmjet palës qiradhënëse Komuna Qendër përfaqësuar nga Kryetari F. B dhe qiramarrësit V. S, për dhënien me qira për një periudhë 30 vjet të fondit pyjor e kullosor, për vlerën prej 10000 lekë qira vjetore, të sipërfaqes prej 0.92 ha ndodhur në zonën kadastrale 3951 Zvërnec me nr. (169). Dhënia me qira është referuar në vendimin e Këshillit të Komunës nr. 9, datë 30.04.2015 "Dhënie pëlqimi për kërkesën e V. S", vendim i konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2247, datë 18.05.2015. Qëllimi i përdorimit të saj rezulton për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme. Vlera e qirasë sipas kontratës është referuar në lidhjen 2/1 dhe 3 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", sipas të cilës për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, për një periudhë nga 21-30 vjet, për tokat me bimësi pyjore dhe sipërfaqe Inproduktive është 10000 lekë/ha për vit. Prona figuron e regjistruar në ZVRPP Vlorë, në emër të Komunës Qendër me nr. Volum 6 faqe 86, në vitin 2010.
Kontratë qiraje nr. 999 rep, 504/2 kol, datë 21.05.2015, nënshkruar para noterit M. GJ, për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullosor ndërmjet palës qiradhënëse Komuna Qendër përfaqësuar nga Kryetari F. B dhe qiramarrësit E. M, për dhënien me qira për një periudhë 30 vjet të fondit pyjor e kullosor, për vlerën prej 10000 lekë qira vjetore, të sipërfaqes prej 2 ha ndodhur në zonën kadastrale 3951 Zvërnec me nr. (269/1). Dhënia me qira është referuar në vendimin e Këshillit të Komunës nr. 10, datë 30.04.2015 "Dhënie pëlqimi për kërkesën e E. M", vendim i konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 535, datë 12.05.2015. Qëllimi i përdorimit të saj rezulton për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme. Vlera e qirasë sipas kontratës është referuar në lidhjen 2/1 dhe 3 të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", sipas të cilës për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, për një periudhë nga 21-30 vjet, për tokat me bimësi pyjore dhe sipërfaqe Inproduktive është 10000 lekë/ha për vit. Prona figuron e regjistruar në ZVRPP Vlorë, në emër të Komunës Qendër me nr. Volum 6 faqe 74, në vitin 2009.
Aktualisht rezulton se deri për periudhën objekt auditimi subjektet nuk kanë shlyer detyrimet përkatëse përfituesit J. S, L. B, V. S dhe E. M, duke sjellë për pasojë mos respektimin e kontratës dhe të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë. Sipërfaqja totale e kontratave është 3.13 ha dhe në referim të vlerës së përllogaritur prej 10000 lekë/ha vit për 3 vjet dhe 4 kontrata detyrimi i pa paguar është në vlerën 120000 lekë, vlerë së cilës i duhet shtuar edhe aplikimi i kamatëvonesave sipas nenit 5 "pagesa dhe regjimi i saj", pika 6, ku është përcaktuar se në rast se qiramarrësi nuk do të krejt pagesën sipas afateve të vendosura, qiradhënësi përfiton kamat vonesë 0.01% për çdo ditë vonesë deri në masën 10% të vlerës, ose 12000 lekë.
Në këto kushte, nga Njësia Administrative duhet të aplikohet neni 6 "Të drejtat dhe detyrimet e Qiradhënësit", pika 4 sipas të cilës "Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi nuk shlyen vlerën e qirasë për vitin pasardhës, ....", si dhe nenit 10 "Zgjidhja e kontratës", detyrim ligjor ende i pa përmbushur nga bashkia.
Përsa i përket procedurave të ndjekura nga ish-Komuna Qendër Vlorë, rezultuan në referim të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor" dhe ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005"Për pyjet dhe shërbimin pyjor", ndryshuar së fundmi me nr. 48/2016, datë 05.05.2016, si dhe për çdo rast pasuritë e dhëna me qira figuronin në listën e pasurive të kaluara në pronësi të komunës sipas VKM nr. 754, datë 28.05.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje e kullota që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjeve vendore, Komuna Qendër Vlorë".

Lidhur me ndjekjen dhe monitorimin e kontratave, në referim të nenit 34 pika 2 të ligjit "Organi përgjegjës për vjeljen e të ardhurave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave është struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki", nuk ka përmbushur rregullisht këtë detyrim ligjor, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi F. B. me detyrë ish-Kryetar i Komunës, XH. H. me detyrë specialiste i Zyrës së Bujqësisë të Komunës dhe punonjësit aktual të NJA Qendër M.K me detyrë Administrator i NJA Qendër dhe P. L me detyrë Specialist i Tatim Taksave në NJA.

Mbi administrimin e kontratave për Tokat Bujqësore të pandara të kaluara në pronësi apo përdorim dhe të dhëna me qira, për 10-99 vjet, në referim të VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar, si dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", akt i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", lista e tokave të dhëna me qira nga Bashkia Vlorë, ish-Bashkia Orikum apo ish-Komuna Qendër, Novosel dhe Shushicë.

**<u>Për ish-Komuna Qendër Vlorë</u>**

Nga ish-Komuna Qendër për periudhën Janar 2008 –Dhjetor 2013, në referim të UKM nr. 3, datë 16.05.2007, "Për tokat bujqësore të pandara" është ngritur dhe ka funksionuar BQTBP, sipas vendimit nr. 27/1, datë 14.08.2007, i cili ka përcaktuar si Kryetar të Bordit F. B, Sekretar XH. H. me detyrë përgjegjës i zyrës së bujqësisë, anëtar E. B me detyrë përgjegjës i zyrës së urbanistikës, F. GJ Specialist i DRBU Vlorë dhe Dhimitër Opingari Specialist i ZKQ Vlorë.

Tokat e dhëna me qira kanë kaluar me VKM nr. 572, datë 28.5.2009 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Qendër Vlorë të qarkut të Vlorës" dhe VKM nr. 754, datë 28.05.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje e kullota që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjeve vendore, Komuna Qendër Vlorë", administrim e përdorim të NJQV, pra janë pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës.

Në bazë të mbledhjeve respektive kjo strukturë vendimmarrëse ka përcaktuar edhe përfituesit e tokës dhe më pas është lidhur edhe kontrata e qirasë së tokave bujqësore të pandara dhe konkretisht ato janë të paraqitura sipas pasqyrës bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga NJA Qendër dhe konkretisht Administratori M. K dhe Specialisti i Taksave P.L me të dhënat e vëna në dispozicion nga drejtoria e Bujqësisë në Bashki lista e subjekteve dhe atyre debitorë nuk përkon me njëra tjetrën, si përsa i përket numrit të kontratave ashtu edhe shumës së detyrimit të paguar apo mbetur pa paguar.

Një pjesë e kontratave të qirasë rezultojnë të jenë nënshkruar para noterit. Hartimi e nënshkrimi i kontratave të qirasë të redaktuara prej noterëve, N. E I, A. XH, dhe A. D, pa kërkuar dokumentin e pronësisë (certifikatë pronësie apo vërtetim pronësie) apo së paku VKM-në e cila ka bërë kalimin në pronësi të parcelave të dhëna me qira, vjen në kundërshtim me nenin 54 të ligjit nr. 7829 datë 01.06.1994 "Për Noterinë" i ndryshuar pasi noteri ka për detyrim ligjor tu kërkojë palëve dokumentin e pronësisë, i cili është thelbësorë në kryerjen e një transaksioni.

Nga sa më sipër, Objekti i këtyre marrëdhënieve kontraktuale nuk është sa përcaktuar në neni 678 të Kodit Civil, "Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet", për shkak se prona objekt i kësaj kontrate nuk është e regjistruar në pronësi të Komunës

edhe pse ka kaluar me VKM-në përkatëse. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga Komuna dhe mungesa e kompetencës ligjore për të vepruar dhe konkretisht për të kryer marrëdhënie kontraktuale e bën këtë marrëdhënie me produkt kontratë njëherësh të pavlefshme.

Në mënyrë të përmbledhur, referuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Bashkia Vlorë, NJA Qendër u konstatua se:
Lidhur me dosjet për secilin subjekt përfitues:
-Nuk ka të dhëna mbi burimet e financimit për garantimin e investimit i cili kërkohet të realizohet.
-Kërkesat për tokë janë të përgjithshme, nuk kanë të dhënë të plota lidhur me çfarë kërkohet të realizohet, sipërfaqja, si dhe afatin e qirasë.
-Nuk janë paraqitur aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohet në kulturën bimore dhe përpunimin e produkteve, si dhe për pemëtarinë.
-Investimet kryesore mbi infrastrukturën kullim vaditje etj., të shprehura në mjete fizike dhe vlerë monetare.
Lidhur me procedurat e kryera nga BQTBP dhe Komisioni:
-Nuk është përcaktuar periudha e vlefshmërisë së dhënies së tokës me qira, pra që nga momenti i miratimit të kërkesës, apo me nënshkrimin e kontratës, si dhe kur fermeri humbet të drejtën e tokës me qira, për rastet e mosparaqitjes në kohë për nënshkrimin e saj.
-Nuk ka Vërtetim nga zyra e bujqësisë të Komunës, ku vërtetohet se, toka bujqësore që do të jepet me qira është parcela me numër kadastral, në zonën kadastrale dhe është në pronësi të kësaj komune si dhe burimin e krijimit të titullit, apo zërin kadastral dokument-fakt, si dhe nuk ka të dhënat për regjistrimin e saj në ZVRPP.
Në shpalljen e ankandit, BQTBP nuk ka bërë publike parcelat në formatin hartografik për të kuptuar fermerët lidhur me vendndodhjen e saktë të tyre dhe formën gjeografike të saj, por vetëm nr. e parcelës me sipërfaqe dhe vlerë fillestare.
Nuk ka Njoftim të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare apo edhe në mediat vendore, si dhe nuk dokumentohet nëse është kryer shpallja në mjediset e njësisë së qeverisjes vendore.

Për të gjitha marrëdhëniet kontraktuale nuk është proceduar plotësisht në zbatim të VKM. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar, rezulton se nga BQTBP është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 16.5.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", i ndryshuar me nr. 01, datë 18.07.2012 dhe pezulluar me nr. 3, datë 27.11.2013 dhe konkretisht Kreut I pika 3b-d, Krue II pika 1, 3, 4, 5 dhe 6/c.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara  në realizimin e procedurave dhe marrëdhëniet kontraktuale të më sipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtaret e BQTBP-së, Kryetar të Bordit F. B, dhe Sekretar XH. H. me detyrë përgjegjës i zyrës së bujqësisë.
Në referim të secilës kontratë, po ashtu ka rezultuar se nga ish-Komuna Qendër apo NJA Qendër nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave, pra nëse subjektet përfituese të tyre kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj. Sa sipër nuk ka as edhe një rast të prishjes së kontratës pikërisht për mos përmbushje të kushteve të saj nga subjekti përfitues/qiramarrës.
Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezulton se nuk janë respektuar kushtet e kontratës duke mos realizuar plotësisht dhe në afatet e përcaktuara pagesën e qirasë, po ashtu nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë.

Veprimet e mësipërme bien ndesh me kërkesat ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" VKM nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqësore të pandara, UKM nr. 3 datë 16.05.2007, Udhëzimit të KM nr. 1, datë 18.07.2012 "Për tokat bujqësore të pandara", VKM nr. 500 datë 14.09.2001 "Për inventarizimin e pasurisë së paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore " me ligjin nr. 10263, datë 08.04.2010 "Për përdorimin e shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakulturuara", ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
Sipas pikës 2 të kontratës tip është përcaktuar se: "Qiramarrësi paguan gjobën 1% të detyrimit për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë përcaktuar në kushtet e kontratës dhe konkretisht në fund të çdo tremujori" e cila në asnjë rast nuk është zbatuar.
Sipas kontratave të qiramarrjes së tokës bujqësore të pa ndarë nga 63 kontrata për sipërfaqen prej 455050 m2, janë arkëtuar deri më 31.12.2017, shuma prej 1,840,345 lekë dhe nga 34 kontrata rezultojnë me detyrime të pa shlyera në vlerën prej 5,964,735 lekë gjithsej nga të cilat:
- Qira e tokës e pa paguar në vlerën 1,307,250 lekë,
- Mbështetur në pikën 2 të kontratës së qirasë: "ngarkohen me penalitet në masën 1% të vlerës për çdo ditë vonesë" ose në vlerën 4,657,485 lekë të analizuara në tabelën si më sipër.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatimin dhe monitorimin e detyrimeve kontraktuale të më sipërme ngarkohet me përgjegjësi F. B. me detyrë ish-Kryetar i Komunës, XH. H. me detyrë specialiste i Zyrës së Bujqësisë të Komunës dhe punonjësit aktual të NJA Qendër M. K me detyrë Administrator i NJA Qendër dhe P. L me detyrë Specialist i Tatim Taksave në NJA.

Pavarësisht informacionit mbetet për tu saktësuar numri i tyre, pasi ka raste kur për mospagime të detyrimeve është bërë prishja e njëanshme por dhe dyanshme e tyre. Kjo listë pavarësisht sa cituar mbetet për tu saktësuar edhe me listën e disponuar nga Drejtoria e Bujqësisë në Bashki e cila paraqet të dhëna më të sakta lidhur me kontrata ekzistuese, edhe pse ka nevojë për saktësime dhe përditësime konkrete, listë e vënë në dispozicion nga Merita Todor dhe Thanas Qerargjoni.
Në varësi të saktësimit të listave të kontratave, mbetet për tu saktësuar edhe lista e subjekteve të cilëve duhet tu aplikohet pika 2 e kontratës tip: "Qiramarrësi paguan gjobën 1% të detyrimit për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë përcaktuar në kushtet e kontratës dhe konkretisht në fund të çdo tremujori" e cila vlen për tu theksuar se deri më sot nuk rezulton të jetë zbatuar.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. ska, datë ska (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga ish-Komuna Qendër, ish-Kryetari F. B dhe Nën Kryetari XH. H., ku sqarohet mbi ekzistencën e dokumentacionit në arkivin e NJA dhe se dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga punonjësit aktual nuk ka qenë i plotë. Po ashtu bashkëlidhur është vënë në dispozicion fotokopje e procesverbalit të dorëzimit nr. 89, datë 27.10.2015. mbajtur ndërmjet XH. H, N. N dhe Administratorit M. K si dhe 29 shkresa nr. 1020, datë 12.11.2013, sipas të cilave është bërë me dije secili subjekt mbi detyrimin e pa paguar dhe kushtin e zbatimit të planbiznesi, pasi për mungesë të këtyre kontrata është shfuqizuar.*
*Nga grupi i auditimit merret në konsideratë mos përgjegjësia lidhur me mungesën e dokumentacionit, duke u bërë edhe rregullimit përkatëse, ndërsa përsa i përket mangësive të tjera mbetet po ato të trajtuara edhe më parë në aktkonstatimi dhe projektraport. Argumentet merren në konsideratë pjesërisht.*

**Për ish-Komuna Novosel Vlorë.**
Nga ish-Komuna Novoselë, mbi pronat dhe pasuritë e kaluara në pronësi apo përdorim me VKM-të e sipërcituara, ka lidhur marrëdhënie kontraktuale qiraje me të tretë në 40 raste për vitet 2010-2013. Trajtimi ligjor i tyre ka qenë edhe më parë objekt auditimi i KLSH-së. Më konkretisht kontratat e qirasë së tokave bujqësore janë të paraqitura sipas pasqyrës.
Tabela me listën e personave që kanë marre me qira toka të pandara dhe detyrimet kontraktore për vitet 2010-2013 e vijim paraqiten sipas tabelës bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.
Pavarësisht informacionit mbetet për tu saktësuar numri i tyre, pasi ka raste kur për mospagime të detyrimeve është bërë prishja e njëanshme por dhe dyanshme e tyre. Kjo listë pavarësisht sa cituar mbetet për tu saktësuar edhe me listën e disponuar nga Drejtoria e Bujqësisë në Bashki e cila paraqet të dhëna më të sakta lidhur me kontrata ekzistuese, edhe pse ka nevojë për saktësime dhe përditësime konkrete. Sipas listës të vënë në dispozicion në total numri i kontratave është 22 dhe sipërfaqja e dhënë me qira është 84.5 ha.
Në varësi të saktësimit të listave të kontratave, mbetet për tu saktësuar edhe lista e subjekteve të cilëve duhet tu aplikohet pika 2 e kontratës tip: "Qiramarrësi paguan gjobën 1% të detyrimit për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë përcaktuar në kushtet e kontratës dhe konkretisht në fund të çdo tremujori" e cila vlen për tu theksuar se deri më sot nuk rezulton të jetë zbatuar.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 406, datë 07.03.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga ish-Komuna Novoselë, ish-Kryetari K. SH, ku sqarohet se nuk është bërë arkëtimi i të ardhurave nga qiraja e tokave bujqësore pasi për të gjitha procedurat është kallëzuar penalisht ish komuna (bashkëlidhur dokumentet)*
*Nga grupi i auditimit merret në konsideratë sqarimi përkatës duke u bërë dhe reflektimet përkatëse në raport dhe rekomandimin. Argumentet merren në konsideratë pjesërisht.*

**Për ish-Komuna Shushicë Vlorë.**
Nga ish-Komuna Shushicë, mbi pronat dhe pasuritë e kaluara në pronësi apo përdorim me VKM-të e sipërcituara, ka lidhur marrëdhënie kontraktuale qiraje me të tretë në 52 raste për vitet 2012-2013. BQTBP, është mbledhur gjithsej 6 herë dhe në bazë të këtyre mbledhjeve janë përcaktuar edhe përfituesit e tokës dhe më pas është lidhur edhe kontrata e qirasë së tokave bujqësore të pandara dhe konkretisht ato janë të paraqitura sipas pasqyrës bashkëlidhur

Referuar në dokumentacionin e disponuar/vënë në dispozicion nga NJA Shushicë e administruar nga zyra e protokoll arkivit të ish-Komunës Shushicë, rezultoi se ka vendime të marra nga BQTBP, por ndryshimin e resurseve të tokës pyll, kullotë e livadh dhe kalimi i tyre në fond të tokës bujqësore, vendime të cilat rezultojnë të referohen në ligjin nr. 16/2012, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", ndryshuar me Udhëzimin nr. 01, datë26.09.2012 Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", neni 11/1, pika 4" dhe konkretisht: (nr. 47, datë 05.10.2012 për dhënin me qira të 10parcelavedhe vendimi nr. 64, datë 10.10.2012 për dhënin me qira të 75 parcelave për 75 përfitues.
Sipas procesverbaleve të secilit vit apo ankand, BQTBP është përbërë nga 5 anëtarë dhe konkretisht nga L.P me detyrë ish-Kryetar i Komunës dhe Kryetar i Bordit, S. L me detyrë Përfaqësues i Drejtorisë të Bujqësisë Vlorë, N. Q me detyrë specialiste i Zyrës së Bujqësisë të Komunës, B. SH me detyrë topograf i Komunës dhe S. H me detyrë Përfaqësues i Drejtorisë të Shërbimit Pyjor Vlorë.

Përveç sa sipër rezulton se Bordi ka marrë edhe vendime për prishjen e kontratave të qirasë për ato rate kur subjektet përfituese nuk kanë shlyer detyrimet dhe nuk kanë zbatuar kushtet e kontratës tip, dhe konkretisht vendimi nr. 23, datë 12.12.2014 "Për zgjidhje kontrate qiraje toke bujqësore" sipas tyre cilit u është zgjidhur kontrata 9 subjekteve, vendimi nr. 23/1, datë 12.12.2014, Për zgjidhje kontrate qiraje toke bujqësore" sipas të cilit u është zgjidhur kontrata 4 subjekteve, por dhe vendime për prishje kontrate individuale.

*Në mënyrë të përmbledhur u konstatua se*:

Të gjitha rastet kanë pasur vetëm një ofertues çka do të thotë se duhej respektuar procedura e njoftimit në qendër të komunës për dhënien me qira të tokave.

Në asnjë rast nuk u konstatua që subjektet qiramarrëse të kenë paraqitur planbizneset përkatëse, pasi ato të depozituar në secilën dosje janë thuajse identike (të hartuara nga njëjti person dhe jo më shumë se ½ fletë format A4). Mungesë i një Plan-Biznesi të detajuar për kultivimin e ullirit në lidhje me planifikimin dhe të ardhurat që do të parashikohen nga investimet, tregon mbi formalitetin e procedurave.

Kërkesat për tokë janë të përgjithshme, nuk kanë të dhënë të plota lidhur me çfarë kërkohet të realizohet, sipërfaqja dhe vendndodhja.

Nuk ka një vendim për tokat që do të jepen me qira por vetëm një datë ankandi të përcaktuar, pra nuk mund të gjykohet mbi mënyrën e përzgjedhjes së tokave të pandarë, të vlerësuara për tu dhënë me qira, si dhe burimin nga vjen ky fond i tokës.

Nuk ka dokument apo nuk dokumentohet se si është vlerësuar se toka e dhënë me qira, rezulton si tokë e pandarë nga ligji nr. 8312, datë 26.03.1998, apo tokë shtetërore, pasi nuk ka një korrespondencë me ZVRPP, si dhe nuk ka konfirmim nga DAMT Qarku lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e tokave bujqësore që mund të jepen me qira.

Nuk ka një vendim për çdo rast të miratuar, numri i vendimeve të dhëna thjesht i korrespondon nr. Rendor të miratimit të kërkesave sipas procesverbalit të BQTBP.

Nuk është përcaktuar periudha e vlefshmërisë së dhënies së tokës me qira, pra që nga momenti i miratimit të kërkesës, apo me nënshkrimin e kontratës, si dhe kur fermeri humbet të drejtën e tokës me qira, për rastet e mosparaqitjes në kohë për nënshkrimin e saj.

Lidhur me procedurat e kryera nga BQTBP dhe Komisioni:

Po ashtu në shpalljen e ankandit, BQTBP nuk ka bërë me dije lidhur me mundësinë apo jo të parcelimit të tokave të vlerësuara dhe shpallura për tu dhënë me qira, në mënyrë që fermerët të ishin më konkret dhe objektiv në kërkesat e tyre, pra në kërkim e një pjese të parcelës dhe pozicionimin e pretenduar apo për të gjithë atë.

Nuk ka një Vendim të BQTBP-së me numër dhe datë, për miratimin e dhënies me qira të tokës bujqësore me sipërfaqen përkatëse, për një periudhë maksimale 99 vjeçare.

Nuk është përcaktuar periudha e vlefshmërisë së dhënies së tokës me qira, pra që nga momenti i miratimit të kërkesës, apo me nënshkrimin e kontratës, si dhe kur fermeri humbet të drejtën e tokës me qira, për rastet e mosparaqitjes në kohë për nënshkrimin e saj.

Nuk ka një procesverbal të shpalljes së ankandit që të mund të vlerësohet e dokumentohet nëse është bërë publik realisht ai, pra nëse fermerët kanë pasur dijeni për mundësitë dhe të drejtën që kanë për të kërkuar tokë me qira. Kjo rezulton nga kontratat e lidhura ku çmimi i caktuar është ai minimal i kërkuar nga ligji, mos pasja në asnjë rast të konkurrimit për të njëjtën parcelë të dy apo më shumë

fermerëve, por dhe faktit se në asnjë rast nuk dokumentohet mënyrë e bërjes me dije të tyre lidhur me procedurat e ankandit dhe tokës.
Edhe pse në shpalljen për dhënien me qira të tokave, bujqësore, pyje, livadhe e kullota, është përcaktuar se Kërkesat pas kësaj periudhe nuk do të pranohen, nuk është e dokumentuar se cili ka qenë afati kohor për pranimin e kërkesave.
Nuk ka vendim për tokat që do të jepen me qira, pra nuk mund të gjykohet mbi mënyrën e përzgjedhjes së tokave të pandara, të vlerësuara për tu dhënë me qira, si dhe burimin nga vjen ky fond i tokës dhe aktin e përfitimit (VKM).
Nuk ka Vërtetim nga zyra e bujqësisë të Komunës, ku vërtetohet se, toka bujqësore që do të jepet me qira është parcela me numër kadastral, në zonën kadastrale dhe është në pronësi të kësaj komune si dhe burimin e krijimit të titullit, apo zërin kadastral dokument-fakt, si dhe nuk ka të dhënat për regjistrimin e saj në ZVRPP.
Në shpalljen e ankandit, BQTBP nuk ka bërë publike parcelat në formatin hartografik për të kuptuar fermerët lidhur me vendndodhjen e saktë të tyre dhe formën gjeografike të saj, por vetëm nr. e parcelës me sipërfaqe dhe vlerë fillestare.
Nuk ka Njoftim të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare apo edhe në mediat vendore, si dhe nuk dokumentohet nëse është kryer shpallja në mjediset e njësisë së qeverisjes vendore.
Nuk ka Shkresa përcjellëse drejtuar ZVRPP Vlorë për regjistrimin e kontratës së qirasë të tokës bujqësore në përdorim, kundrejt tarifës përkatëse.
Kontratat e Qirasë për N. S, me nr. 298, datë 19.01.2015, S. R, me nr. 744, datë 03.03.2015 S. B, me nr. 1018, datë 25.03.2015, L. A me nr. 100, datë 15.01.2015 dhe E. H, me nr. 1803, datë 11.06.2015, T. D, me nr. 046, datë 02.10.2014, R. A me nr. 423, datë 06.11.2014, E. A me nr. 749, datë 06.12.2014, P. L me nr. 888, datë 18.12.2014, S. D me nr. 1262, datë 13.06.2014, S. S me nr. 1928, datë 02.07.2013, I. T me nr. 1947, datë 04.07.2013, J. D me nr. 2156, datë 30.07.2013, F. A. Z, A. A. I me nr. 2090, datë 18.07.2013, E. D me nr. 2297, datë 22.08.2013, V. K me nr. 2412, datë 05.09.2013, M. B me nr. 2465, datë 10.09.2013, P. B me nr. 2741, datë 01.10.2013, S. T me nr. 3417, datë 10.12.2013, B. SH me nr. 176, datë 29.01.2014, DH. B me nr. 114, datë 12.01.2013, L. B me nr. 178, datë 16.01.2013, H. B me nr. 253, datë 22.01.2013, RR. C me nr. 406, datë 04.02.2013, L.F. D me nr. 1298, datë 24.04.2013, A. SH me nr. 1033, datë 01.04.2013, S. A me nr. 1137, datë 09.04.2013, G. L me nr. 1535, datë 21.05.2013, A. T me nr. 1726, datë 10.06.2013, V. B me nr. 1741, datë 11.06.2013, K. A me nr. 294, datë 19.01.2014, N. T me nr. 126, datë 20.01.2014, H. XH me nr. 178, datë 29.01.2014, A. M me nr. 844, datë 15.04.2014, D. B me nr. 494, datë 03.03.2014, R. L me nr. 1389, datë 01.07.2014, T. XH me nr. 1584, datë 25.07.2014, B. M me nr. 1584, rep 613, datë 25.07.2014, N. L me nr. 1677, datë 06.08.2014, N. B me nr. 1590, datë 25.07.2014, V.S.K me nr. 1957, datë 03.05.2011, A. M me nr. 2680, datë 26.09.2013, B. M me nr. 615, datë 11.02.2011, rezulton se janë nënshkruar para noterit N. I.
Kontrata në emër të D. R me nr. 3682, datë 03.12.2014, A. B me nr. 378, datë 01.02.2013, A. H me nr. 3994, datë 06.12.2013 (revokuar me nr. 3413, datë 10.10.2013), A. H me nr. 1229, datë 06.03.2012, V. B me nr. 2980, datë 19.06.2012, A. E dhe A. B me nr. 2619, datë 29.05.2012, (prishur kontrata sipas shkresës nr. 316, datë 04.09.2013 dhe vendimit të BQT nr.½, datë 04.09.2013 ) rezulton se janë nënshkruar para noterit L. C.
Hartimi e nënshkrimi i kontratave të qirasë të redaktuara prej noterëve, pa kërkuar dokumentin e pronësisë (certifikatë pronësie apo vërtetim pronësie) apo së paku VKM-në e cila ka bërë kalimin në pronësi të parcelave të dhëna me qira, vjen në kundërshtim me nenin 54 të ligjit nr. 7829 datë

01.06.1994 "Për Noterinë" i ndryshuar pasi noteri ka për detyrim ligjor tu kërkojë palëve dokumentin e pronësisë, i cili është thelbësorë në kryerjen e një transaksioni.
Tokat e dhëna me qira nuk kanë kaluar me VKM "Për miratimin e listës përfundimtarë të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Shushicë të Qarkut të Vlorë", pra nuk janë pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës, madje sipas disa prej pasurive të dhëna me qira janë dokumentuar se janë brenda sipërfaqes të fondit pyjor dhe kullosor, prona që po ashtu nuk kanë kaluar në pronësi me VKM "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore, Komuna Shushicë të Qarkut Vlorë".
Nga sa më sipër, marrëdhëniet kontraktuale mbi parcelat e dhëna me qira dhe të cilat nuk janë në pronësi apo përdorim të Komunës Shushicë të përcaktuara në VKM-në "Mbi miratimin e listës përfundimtare të pronave të pa luajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Shushicë", madje një pjesë e tyre janë në listën e fondit të tokës pyjore e kullosore apo VKM "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë të qeverisjes vendore, Komuna Shushicë të Qarkut Vlorë".
Objekti i këtyre marrëdhënieve kontraktuale nuk është sa përcaktuar në neni 678 të Kodit Civil, "Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet", për shkak se prona objekt i kësaj kontrate nuk është në pronësi të Komunës Shushicë.
Mos përmbushja e këtij detyrimi nga Komuna Shushicë dhe mungesa e kompetencës ligjore për të vepruar dhe konkretisht për të kryer marrëdhënie kontraktuale e bën këtë marrëdhënie me produkt kontratë njëherësh absolutisht të pavlefshme.
Vendimet e Bordit të dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara të Komunës Shushicë (BQTBP), mbi të cilin kanë lindur marrëdhëniet kontraktuale, janë absolutisht të pavlefshëm, pasi janë marrë në kundërshtim me sa përcakton neni 678 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 32/e i ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" i ndryshuar, VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar, Udhëzimi nr. 3, datë 16.5.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", i ndryshuar.
Nga shqyrtimi i praktikave dhe dokumentacionit të administruar në këtë komunë rezulton se nuk është zbatuar VKM nr. 176 datë 30.3.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr. 531, datë 21.8.1998, te Këshillit te Ministrave, "Për Tokat Bujqësorë te pandara" akt i cili në pikën 1 të tij, i cili ka përcaktuar mënyrën e evidentimit të tokave bujqësore të pandarë, si vijon:
"1. Në pikën 4, pas fjalisë "Sipërfaqet e tokave të pandara të evidentohen më vete", shtohet fjalia, me këtë përmbajtje: Sipërfaqet e evidentuara si të tilla, më 01.3.2001, nga Komisioni i Tokës në komunë apo në bashki dhe të vërtetuara nga përgjegjësi i zyrës së kadastrës, jepen me qira nga organet e qeverisjes vendore për personat, fizik e juridik, vendas apo të huaj. Procedurat për dhënien me qira të sipërfaqeve të tokës, të pandara, përcaktohen me UKM.
Në një vlerësim e analizë të plotë të kuadrit ligjor që rregullon marrëdhëniet juridiko civile mbi pronën e klasifikuar si tokë bujqësore, rezulton se me ligjin nr. 10263, datë 08.4.2010 "Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakulturuara" është bërë përcaktimi i rregullave dhe procedurave për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakulturuara, për të garantuar funksionin ekonomik të pronës, por pa cenuar të drejtën e pronësisë të përfituar sipas ligjit. Kjo referencë duhet të ishte ajo e aplikuar për praktikat objekt trajtimi, procedurë e cila duhet të kryhej më parë nëpërmjet

procesit të verifikimit, evidentimit dhe përcaktimit të tokave të pakulturuara, kjo sipas kreut II, neni 4 e vijues i tij. Kjo procedurë nuk rezulton e aplikuar e për rrjedhoje e pa zbatuar, për sa nuk është dokumentuar dhe nuk ka një vendim të marrë nga Këshilli i Komunës për kryerjen dhe klasifikimin e tyre, sipas përcaktimeve të nenit 7 të ligjit.
Për sa më sipër, referuar konstatimit se toka bujqësore e dhënë me qira nuk rezulton në pronësi të Komunës, procedura e kryer në referim të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar, Udhëzimi nr. 3, datë 16.5.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", është në kundërshtim të hapur me vet referencat të cilave u referohen.
Për të gjitha rastet, në marrëdhëniet kontraktuale konstatohet se nuk është proceduar në zbatim të VKM. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar, Udhëzimi nr. 3, datë 16.5.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", pikave II.3, 4, 6/b/c, pasi nuk janë shpallur njoftimet për dhënien me qira i cili duhet të përmbante qëllimin e dhënies me qira, sipërfaqen, vendin e paraqitjes së dokumenteve, afatin përfundimtar të paraqitjes së ofertave, vendin, datën dhe orën e ankandit, ofertat nuk kanë formularin tip, dhe nuk kanë një plan biznesi.
Sa më sipër, rezulton se nga BQTBP është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 16.5.2007"Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", i ndryshuar nr. 01, datë 18.07.2012 dhe pezulluar me nr. 3, datë 27.11.2013 dhe konkretisht:
Kreut I pika 3, Kreu II. Procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara, pikat 1, 3, 4, 5 dhe 6.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në realizimin e procedurave dhe marrëdhëniet kontraktuale të më sipërme ngarkohet me përgjegjësi anëtaret e BQTBP-së, L. P me detyrë ish-Kryetar i Komunës dhe Kryetar i Bordit, S. L me detyrë Përfaqësues i Drejtorisë të Bujqësisë Vlorë, N. Q me detyrë specialiste i Zyrës së Bujqësisë të Komunës, B. SH me detyrë topograf i Komunës dhe S. H me detyrë Përfaqësues i Drejtorisë të Shërbimit Pyjor Vlorë, anëtarë të BQTBP-së.

Kontratat e lidhura me afat vlefshmërie për 99 vjet, janë si më poshtë:
Në referim të secilës kontratë, po ashtu ka rezultuar se nga ish-Komuna Shushicë apo NJA Shushicë nuk është realizuar në asnjë rast monitorimi i kontratave, pra nëse subjektet përfituese të tyre kanë realizuar investimin sipas objektit të kontratës apo janë në kushtet e moszbatimit të saj. Sa sipër nuk ka as edhe një rast të prishjes së kontratës pikërisht për mos përmbushje të kushteve të saj nga subjekti përfitues/qiramarrës.
Nga auditimi i zbatimit të kontratës rezulton se nuk janë respektuar kushtet e kontratës duke mos realizuar plotësisht dhe në afatet e përcaktuara pagesën e qirasë, po ashtu nuk është bërë mbikëqyrja e përdorimit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë.
Veprimet e mësipërme bien ndesh me kërkesat ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" VKM nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqësore të pandara, UKM nr. 3 datë 16.05.2007, Udhëzimit të KM nr. 1, datë 18.07.2012 "Për tokat bujqësore të pandara", VKM nr. 500 datë 14.09.2001 "Për inventarizimin e pasurisë së paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore " me ligjin nr. 10263, datë 08.04.2010 "Për përdorimin e shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakulturuara", ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Sipas pikës 2 të kontratës tip është përcaktuar se: "Qiramarrësi paguan gjobën 1% të detyrimit për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë përcaktuar në kushtet e kontratës dhe konkretisht në fund të çdo tremujori" e cila në asnjë rast nuk është zbatuar.
Sipas kontratave të qiramarrjes së tokës bujqësore të pa ndarë 31 nga qiramarrësit e lartpërmendur në fund të vitit 2017 rezultojnë me detyrime të pa shlyera në vlerën 2956,764 lekë gjithsej nga të cilat:
- Qira e tokës e pa paguar në vlerën 582,820 lekë,
- Mbështetur në pikën 2 të kontratës së qirasë: "ngarkohen me penaliteti në masën 1% të vlerës për çdo ditë vonesë" ose në vlerën 2,373,944 lekë të analizuara në aktkonstatimin dhe projektraportin përkatës.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në zbatimin dhe monitorimin e detyrimeve kontraktuale të më sipërme ngarkohet me përgjegjësi L. P me detyrë ish-Kryetar i Komunës, N. Q me detyrë specialiste i Zyrës së Bujqësisë të Komunës, B. SH me detyrë topograf i Komunës dhe punonjësit aktual të NJA Shushicë B. A me detyrë Administrator i NJA Shushicë dhe V. P. me detyrë Specialist i Tatim Taksave në NJA Shushicë.

Sipas informacionit të NJA Shushicë, kontrata janë lëshuar nga viti 2008 e vijim, dhe kanë afat vlefshmërie 10, 30 apo 99 vjeçare dhe nga vlera totale e kontratave, mbeten pa arkëtuar 3,658,160 lekë, nga të cilat 2,220,570 lekë nga kantatat me afat vlefshmërie deri në 10 vjet dhe vlera 1,437,590 lekë për kontratat deri më 99 vjet.
Pavarësisht informacionit mbetet për tu saktësuar numri i tyre, pasi ka raste kur për mospagime të detyrimeve është bërë prishja e njëanshme por dhe dyanshme e tyre. Kjo listë mbetet për tu saktësuar edhe me listën e disponuar nga Drejtoria e Bujqësisë në Bashki e cila paraqet të dhëna më të sakta lidhur me kontrata ekzistuese, edhe pse duhet saktësuar dhe përditësuar. Sipas listës të vënë në dispozicion nga drejtoria e bujqësisë nga ish-Komuna Shushicë, për fshatin Risili janë lidhur 70 kontrata qiraje për sipërfaqen prej 52.2 ha, për fshatin Bunavi 32 kontrata për sipërfaqen 19.5 ha, për fshatin Beshisht 21 kontrata për sipërfaqen prej 14.7 ha dhe për fshatin Llakatund 1 kontratë për sipërfaqen 1 ha. Në total numri i kontratave është 124 dhe sipërfaqja e dhënë me qira është 87.5 ha.
Në varësi të saktësimit të listave të kontratave, mbetet për tu saktësuar edhe lista e subjekteve të cilëve u duhet aplikuar pika 2 e kontratës tip: "Qiramarrësi paguan gjobën 1% të detyrimit për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë përcaktuar në kushtet e kontratës dhe konkretisht në fund të çdo tremujori".

Mbi procedurat dhe dokumentacionin e administruar për shitjen/privatizimin e banesave.
Në referim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", i shfuqizuar, ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore" dhe VKM nr. 97, datë 03.2.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 dhe i ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004", për objektet të cilat kanë pasur kontrata qiraje para viteve 1990 dhe kanë realizuar privatizimin e tyre, Bashkia Vlorë gjatë periudhës 2015-1017, ka realizuar 13 kontrata kalimi pronësi për vlerën prej 2,140,005 lekë dhe konkretisht janë paraqitur në tabelën bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.
Procedurave e kryera nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Kontrollit të Projekteve dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar, rezultuan në përputhje me referencat ligjore të sipërcituara.

-Procedurat dhe dokumentacioni i administruar për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme.
Aplikimi i procedurave të shpronësimit, sipas kërkesave ligji nr. 8561, datë 22.12.1999"Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme", për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga ndërtimi i objekteve infrastrukturore.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe deklarimeve verbale të kryera gjatë takimeve me strukturat përkatëse, u konstatua se bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", Bashkia Vlorë, në cilësinë e subjektit në favor të cilit bëhet shpronësimi, ka paraqitur kërkesën për shpronësim pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, duke hartuar procedurat e shpronësimit për projektet e mëposhtme:

1.Projekti "Lungomare-Vija bregdetare e qytetit Vlorë".
Vlera e shpronësimit është miratuar sipas vendimeve të KM nr.661/2014 me vlerë 442.851.979 lekë, VKM nr.975/2015 me vlerë 9.689.768 lekë, me VKM 594/2016 me vlerë 356.185.311 lekë dhe VKM nr.633/2016 me vlerë 189.652.994 lekë.
Vlera totale e projektit është në shumën prej 998,380,052 lekë.
2.Projekti "Rishikim i projektit zbatimit faza I vija bregdetare qyteti Vlorë".
Vlera e shpronësimit është miratuar me VKM nr.412/2016 në shumën 68.483.455 lekë.
3.Projekti "Transballkanike faza II".
Vlera e shpronësimit sipas VKM 345/2016 është në shumën 332.987.201 lekë.
4.Projekti "Rruga Dhimitër Konomi".
Është miratuar vlera e shpronësimit me VKM nr.599/2016 në shumën prej 27,776,834 lekë.
5.Projekti "Ndërtim sistemim rruga Gjykata – Akademia Marinës dhe rruga Duro Shaska deri tek 7 pallatet Vlorë faza I".
Është miratuar vlera e shpronësimit me VKM nr. 595/2016, në shumën prej 131,087,366 lekë.
6. "Vlora - ACU, Rikualifikim urban në qytetin e Vlorës, përgjatë 'P4 C2 a, b, c'", dhe "ndërtim i rrugës - Vazhdimi i Unazës Vlorë - Uji i Ftohtë"
VKM nr. 490 Datë 19.07.2017 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Vlora - ACU, Rikualifikim urban në qytetin e Vlorës, përgjatë 'P4 C2 a, b, c'", dhe "ndërtim i rrugës - Vazhdimi i Unazës Vlorë - Uji i Ftohtë"
Vlera e shpronësimit me VKM nr.490/2017, është në shumën prej146,011,365 lekë.
7. "Rikualifikim Urban, Shesh, Park Publik, Teatri 'Petro Marko'", në Bashkinë Vlorë.
VKM nr.209, datë 15.03.2017, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim Urban, Shesh, Park Publik, Teatri 'Petro Marko'", në Bashkinë Vlorë.
Vlera e shpronësimit me VKM nr.209/2017, është në shumën prej 81,331,044 lekë.
8. "Rikualifikim urban në territorin e Bashkisë Vlorë", faza 1.
V.K.M Nr. 356, datë 19.4.2017 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim urban në territorin e Bashkisë Vlorë", faza 1.
Vlera e shpronësimit me VKM nr.356/2017, në shumën prej55,686,001 lekë.

9. "Ndërtim dhe asfaltim i rrugës nga Muzeu Historik-Spitali Vlorë" miratuar me VKM nr.1000, datë 09.12.2015, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim dhe asfaltim i rrugës nga Muzeu Historik-Spitali Vlorë".
Vlera e shpronësimit me VKM nr.1000/2015, në shumën prej 18,146,972 lekë.
10."Studim, projektim lidhja e rrugës "Transballkanike" me superstradën Fier-Vlorë".
VKM nr.54, datë 21.01.2015, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Studim, projektim lidhja e rrugës "Transballkanike" me superstradën Fier-Vlorë". Kjo V.K.M ka pësuar shtesa dhe ndryshime me V.K.M-në nr.599/2015, 163/2015 dhe 1098/2015.

Investimi publik, për të cilin është kërkuar kryerja e procedurave të shpronësimit të pasurive publike, për realizimin e tij, me objekt: "Rishikimi i projektit të zbatimit të fazës së Parë të Vijës Bregdetare të Qytetit të Vlorës", Vlorë. Sipas të dhënave vlera e shpronësimit është në shumën prej 68483455.76 lekë nga të cilat për shpronësimin e pasurive të llojit truall është në vlerën prej 5995778 lekë dhe objekt në vlerën prej 62,487,678 lekë, miratuar me VKM nr.412, datë 01.06.2016, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rishikimi i projektit të zbatimit të Fazës së Parë të Vijës Bregdetare të qytetit të Vlorës".
Investimi publik, për të cilin është kërkuar kryerja e procedurave të shpronësimit të pasurive publike, për realizimin e tij, me objekt: "Ndërtimi i rrugës "Dhimitër Konomi", në zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë", sipas të dhënave vlera e shpronësimit është në shumën prej 27776834.4 lekë nga të cilat për shpronësimin e pasurive të llojit truall është në vlerën prej 27776834.4 lekë dhe objekt në vlerën prej - lekë. Likuiduar në shumën 1284373.4 lekë, miratuar me VKM nr.599, datë 31.08.2016, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i rrugës "Dhimitër Konomi", në zonën e Ujit të Ftohtë, Vlorë".
Investimi publik, për të cilin është kërkuar kryerja e procedurave të shpronësimit të pasurive publike, për realizimin e tij, me objekt "Ndërtim dhe asfaltim i rrugës nga Muzeu Historik-Spitali Vlorë". Sipas të dhënave vlera e shpronësimit është në shumën prej 18 146 972 lekë nga të cilat për shpronësimin e pasurive të llojit truall është në vlerën prej 2 065 729 lekë dhe objekt në vlerën prej 16081243 lekë. Burimi i financimit të kostos të shpronësimit financohet nga të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Vlorë, me fondet e veta, pas miratimit në Këshillin Bashkiak të VKB nr. 15, datë 07.09.2015, miratuar me VKM nr.1000, datë 09.12.2015, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim dhe asfaltim i rrugës nga Muzeu Historik-Spitali Vlorë".
Investimi publik, për të cilin është kërkuar kryerja e procedurave të shpronësimit të pasurive të paluajtshme, pronë private, për realizimin e tij, me objekt: "Ndërtim i segmentit rrugor Skelë-Uji i Ftohtë" Bashkia Vlorë si dhe "Vija Bregdetare e qytetit të Vlorës, Faza 1", sipas të dhënave vlera e shpronësimit është në shumën prej 68,483,455.76 lekë nga të cilat për shpronësimin e pasurive të llojit truall është në vlerën prej 5,995,778 lekë dhe objekt në vlerën prej 62,487,678 lekë, miratuar fillimisht me VKM nr. 310, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Skelë - Uji i Ftohtë, Bashkia Vlorë" dhe më tej me: VKM Nr. 594, datë 31.8.2016;VKM nr. 661, datë 08.10.2014 Për disa ndryshime në vendimin nr. 310, datë 21.5.2014; VKM nr. 975, datë 2.12.2015 Për disa ndryshime në vendimin nr. 310, datë 21.5.2014;VKM Nr. 663, datë 07.09.2016,"Per disa

ndryshime me vendimin nr. 661, datë 08.10.2014, akte të cilat kanë shpronësuar pasuri të paluajtshme, pronë private, të llojit ndërtesë dhe truall, të cilat preken nga projekti i quajtur ndryshe "Lungomare".
Pas daljes së VKM-ve të sipërcituara, është vijuar me procedurat e likuidimit sipas kërkesës së paraqitur nga vetë subjekti i shpronësuar. Rezulton se disa prej subjekteve tu jenë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kontestuar vlerën e shpronësimit.

Nga auditimi rezulton se likuidimet e realizuara për gjithë shpronësimin e Lungomares, janë sipas tabelës së mëposhtme:
VKM nr. 594, datë 31.8.2016 Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të Paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Vija bregdetare e qytetit të Vlorës, Faza 1, shtesat, pjesa Lindore", Vlorë .

**Tabela me Listen e Pronareve te pasurive prone private dhe vlerat e shpronesimit, per realizimin e projektit:**

| NJ | ZK | Nr. Pasuri si | Adresa | Pronari | Sipërfaqe Truall m2 | Çmimi i Trualli Lek/m² | Vlera e Trualli Lekë | Sipërfaqe Ndërtimi m2 | Çmimi i Ndërtimit Lek/m² | Vlera e Ndërtimit Lekë | Vlera Totale Truall dhe Ndërtesë lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | Vlorë | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | | | | [illegible] | [illegible] |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | Vlorë | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | | | | [illegible] | [illegible] |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | Vlorë | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | | | | [illegible] | [illegible] |
| [illegible] | [illegible] | [illegible] | Vlorë | [illegible] | [illegible] | [illegible] | [illegible] | | | | [illegible] | [illegible] |
| | | | | **shuma Shqiptuar** | | | | | | | | **27,792,494** |

VKM Nr.975, datë 02.12.2015 Për disa ndryshime në vendimin nr. 310, datë 21.5.2014, të VKM, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Skelë-Uji i Ftohtë, Bashkia Vlorë", të ndryshuar.

**LISTA ME EMRAT E PRONAREVE PER PASURITE E PALUAJTSHME QE PREKEN NGA PROJEKTI "SKELE-UJI I FTOHTE " VLORE**

**Vlera e truallit me cmimin e miratuar me V.K.M- Nr. 80, date 03.02.2016**
**Zona Kadastrale 8002**

| Nr | Zona Kadastrale | Nr. Pasurise | Adresa | Pronari | Sipërfaqe Truall | Sipërfaqe ndërtimi | Çmimi i Truallit Lek/m2 | Çmimi i Ndërtimit Lek/m2 | Vlera e Truallit Lekë | Vlera e Ndërtimit Lekë | Vlera truall dhe ndërtese | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 8002 | 27/458 | Vlore | Ardian Dumi, Esmeralda Dumi | 28.1 | | 10,174.0 | | 288,959.0 | 0.0 | 288,959.0 | |
| 3 | 8002 | 27/377 | Vlore | Kedjan Kapllanaj,Leka Kapllanaj | 98.8 | 88.3 | 10,174.0 | 18,028.0 | 994,751.2 | 4,255,879.0 | 4,625,830.2 | |
| 7 | 8002 | 41/189 | Vlore | BP Çarçani | 86 | 32 | 10,174.0 | 66,607.0 | 897,052.0 | 1,611,856.0 | 2,610,908.0 | 2,610,908.0 |
| 9 | 8002 | 23/98+1-2 | Vlore | Namsie Liçaj | 17.5 | 57.2 | 10,174.0 | 18,028.0 | 178,045.0 | 2,158,641.0 | 2,336,686.0 | 2,336,686.0 |
| 12 | 8002 | 41/168-ND | Vlore | Simon Rraqi | | 54.1 | 10,174.0 | 66,607.0 | 0.0 | 2,748,598.0 | 2,748,598.0 | 2,748,598.0 |
| 13 | 8002 | 41/241-ND | Vlore | BP Rraqi, Meksi,Gjika, Gjondreka | | 81.6 | 10,174.0 | 66,607.0 | 0.0 | 4,113,552.0 | 4,113,552.0 | 4,113,552.0 |
| 15 | 8002 | 26/50 | Vlore | BP 49 Pronare | 1890.1 | | 10,174.0 | | 19,228,877.4 | 0.0 | 19,228,877.4 | 19,228,877.4 |
| 23 | 8002 | 26/57 | Vlore | BP 49 pronare | 1492.3 | | 10,174.0 | | 15,182,660.2 | 0.0 | 15,182,660.2 | 15,182,660.2 |
| 24 | 8002 | 36/29 | Vlore | Neta Hasani | 28.8 | | 10,174.0 | | 293,519.9 | 0.0 | 293,519.9 | |
| 28 | 8002 | 26/55 | Vlore | BP 49 Pronare | 450 | | 10,174.0 | | 4,578,300.0 | 0.0 | 4,578,300.0 | 4,578,300.0 |
| 31 | 8002 | 27/615 | Vlore | BP Llavanës | 49.7 | 75.36 | 10,174.0 | 18,028.0 | 505,847.8 | 1,520,140.0 | 4,025,787.8 | |
| 53 | 8002 | 23/98+1-4 | Vlore | BP Hasani | 41.1 | 41.1 | 10,174.0 | 18,028.0 | 417,842.0 | 1,885,841.0 | 2,403,583.0 | 2,403,583.0 |
| | | | | **VLERA TOTALE** | | | | | | | **42,445,041.5** | **53205944.6** |

-V.K.M nr. 661, datë 08.10.2014 Për disa ndryshime në vendimin nr. 310, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Skelë - Uji i ftohtë, bashkia Vlorë".

**LISTA ME EMRAT E PRONAREVE PER PASURITE E PALUAJTSHME QE PREKEN NGA PROJEKTI PER DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NE VKM 661 /2014 QE PREKEN NGANDERTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "SKELE-UJI I FTOHTE " BASHKIA VLORE**

**Vlera e trualli me cmimin e miratuar me V.K.M- Nr. 89, date 03.02.2016**
**Zona Kadastrale 8602**

| Nr | Zona kadastrale | Nr. Pasurise | Adresa | Pronari | Sipërfaqe Trualli | Sipërfaqe ndertimi | Cmimi i Truallit Leke/m2 | Cmimi i Ndertimi Leke/m2 | Vlera e Truallit Leke | Vlera e Ndertimit Leke | Vlera trualli dhe ndertesa | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 8602 | 27/534 | Vlore | Halil Cobo | 106.2 | 191 | 10,174.0 | 58,028.0 | 1,080,478.8 | 9,140,114.0 | 10,220,592.8 | |
| 17 | 8602 | 26/22-ND | Vlore | Sulejman Shehi | | 150 | 10,174.0 | 58,028.0 | 0.0 | 17,411,799.0 | 17,411,799.0 | |
| 33 | 8602 | 31/84 | Vlore | BP Mishgoni | | 200 | 10,174.0 | 58,028.0 | 0.0 | 17,038,795.0 | 17,038,795.0 | |
| 36 | 8602 | 27/47 | Vlore | BP Muço | 44 | 170 | 10,174.0 | 58,028.0 | 447,656.0 | 8,135,180.0 | 8,582,836.0 | 8,582,836.0 |
| 39 | 8602 | 27/48-N4 | Vlore | Posta Shqiptare | | 40 | 10,174.0 | 58,028.0 | 0.0 | 1,231,096.2 | 1,231,096.2 | |
| 39 | 8602 | 27/48-N1 | Vlore | Posta Shqiptare | | 10.5 | 10,174.0 | 58,028.0 | 0.0 | 323,162.8 | 323,162.8 | |
| 42 | 8602 | 27/48+1-2 | Vlore | Dhimitraq Ciro, Lauda Ciro | 36.7 | 69.25 | 10,174.0 | 58,028.0 | 576,865.8 | 3,315,889.5 | 3,890,755.3 | 3,890,755.3 |
| 45 | 8602 | 27/250+1-1 | Vlore | BP Pacaj | 16.2 | 22.4 | 10,174.0 | 58,028.0 | 164,818.8 | 1,071,929.6 | 1,236,748.4 | |
| | | | | | | | | | | | | |
| 1 | 8602 | 40/94 | Vlore | Zinie Kenella | 351.75 | | 204.0 | 60,607.0 | 71,757.0 | 0.0 | 71,757.0 | |
| 4 | 8602 | 77/5 | Vlore | Jalja Mici | 1012.1 | | 204.0 | 60,607.0 | 206,468.4 | 0.0 | 206,468.4 | 206,468.4 |
| 21 | 8602 | 42/307 | Vlore | Bedri Alla | 81.3 | 73.58 | 204.0 | 60,607.0 | 16,585.2 | | 16,585.2 | |
| 30 | 8602 | 41/168 | Vlore | BP Meksi Rrapi, Shehu,Strkdhima, Gjondeda, Gjika | 629.2 | 41.5 | 204.0 | 60,607.0 | 123,840.0 | | 123,840.0 | |
| 52 | 8602 | 23/99+2-1 | Vlore | BP Memaliaj, Rustemaj, Merkaj | | | | | | | 2,860,780.0 | 2,860,780.0 |
| 17 | 8602 | 26/22-nd | Vlore | Sulejman Shehi | | | | | | | 17,411,799.0 | 17,411,799.0 |
| 18 | 8602 | 26/22-e | Vlore | Sulejman Shehi | | | | | | | 10,659,300.0 | 10,659,300.0 |
| 11 | 8602 | 26/23-e | Vlore | Sulejman Shehi | | | | | | | 25,018.9 | 25,018.9 |
| | | | | **SHUMA TOTALE** | | | | | | | **91,313,392.0** | **43637015.6** |

Lidhur me këto procedura në një rast ka rezultuar se në V.K.M-në nr. 661, datë 08.10.2014, "Për disa ndryshime në VKM-në nr. 310, datë 21.05.2014, "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, Skelë-Uji I Ftohtë, Bashkia Vlorë me numër rendor 38, është shpronësuar pasuria numër 23/27-t, në emër të B.P Selimi, me sipërfaqe trualli 432 m2 dhe ndërtese 132.25 m2.
Subjekti i shpronësuar i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë duke kundërshtuar VKM në nr.661/2014 dhe vlerën e shpronësimit. Me Vendimin nr. 557, datë 24.04.2015, Gjykata ka vendosur për pavlefshmërinë absolute të VKM-së nr. 310/2014, të ndryshuar me VKM-në nr.661/2014, përsa i përket shpronësimit për pronën e palës paditëse, Kujtim dhe Shkëlzen Selimi si dhe ligjërimin e masës së sigurimit të padisë. Masa e sigurimit është marrë me Vendimin e ndërmjetëm të datës 19.02.2015.
Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, nr. 103, datë 26.10.2016, ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit të Ndërmjetëm nr. 1956/89 regj., datë 19.02.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për ligjërimin e masës së sigurimit të padisë.
Gjithashtu, me Vendimin nr. 2436, datë 18.11.2015, Gjykata Administrative e Apelit Tirane, ka vendosur ndryshimin e Vendimit nr. 557, datë 24.04.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke pranuar pjesërisht padinë, shfuqizimin e pjesshëm të VKM-së nr. 310/2014, lidhur me shpronësimin e pasurisë numër 23/27-t, zona kadastrale 8602, Vlorë si dhe ligjërimin e masës së sigurimit të padisë.
Lidhur me këtë pasuri nuk është vijuar më tej me shpronësimin dhe më tej prishjen e investimit edhe pse ndryshimi i projektit të Lungomare, ka bërë që ky objekt të përfshihet tërësisht në sipërfaqen e zënë nga investimi publik.

**Lidhur me objektin dhe truallin e subjektit S. A.**
Bashkia Vlorë, në zbatim të dispozitave ligjore të ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Per shpronësimet dhe marrjen ne përdorim te përkohshëm te pasurisë prone private per interes publik" dhe të urdhrit të brendshëm nr.103, datë 23.09.2015, ka kryer procedurat paraprake të pasurive të paluajtshme, pronë

private, të cilat janë prekur nga zbatim i projektit "Rishikim i projektit të zbatimit të Fazës së Pare të Vijës Bregdetare të qytetit të Vlorës".

Nga korrespodenca e kryer me zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Vlorë, është konfirmuar pasuria numër 26/25, e llojit truall, me sipërfaqe 2068 m2, në zonën kadastrale 8602, në emër të Safet Abazit. Lidhur me pasurinë e llojit ndërtesë, nga ZVRPP nuk është konfirmuar pasuria e llojit ndërtesë dhe ndodhur në këto kushte komisioni i vlerësimit paraprak nuk ka përfshirë në kërkesën për shpronësim, pasurinë e llojit "ndërtesë", pra duke u trajtuar vetëm sipërfaqja e llojit truall e duke mos u përfshirë ajo e llojit ndërtesë.

Përfshirja e qytetarit në listën e personave që preken nga shpronësimi është bërë bazuar në shkresën ne ZVRPP Vlorë me nr. 9140/1, datë 09.11.2015, administruar nga Bashkia Vlorë me nr. 4941/1, datë 09.11.2015 "Kthim përgjigje" ku dhe është bërë konfirmimi i statusit juridik të pronës me nr. 26/25 në pronësi të Safet Abazi, për sipërfaqen e truallit prej 2068m2.

Konkretisht sipas shkresës nr. 6497, datë 30.12.2015, drejtuar MZHU, Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve "Kërkesë për shtesë në VKM nr. 661, datë 10.08.2014 Për shpronësimin e pasurive të paluajtshme që preken nga zbatimi i projektit "Vija bregdetare e qytetit të Vlorës, faza 1" dërguar me shkresën nr. 5227/1, datë 27.11.2015", nga bashkia Vlorë është kërkuar ndryshimi i VKM-së nr. 661, datë 10.08.2014, ndryshuar me VKM nr. 310, datë 21.05.2014. Sipas shkresës, lista shtesë e pasurive është bërë pas marrjes së konfirmimit ligjor nga ZVRPP Vlorë. Në listën shoqëruese të shkresës me nr. rendor 1 figuron dhe subjekti për shpronësim S. A, për pasurinë e ndodhur në zonën kadastrale 8602, pasuria 26/25, e llojit truall me sipërfaqe 2068m2, me çmim trualli 6619m2 (përllogaritur sipas VKM nr. 514, datë 30.7.2014) dhe vlerë trualli 13,688,092 lekë.

Kërkesa është ripërsëritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit sipas shkresës nr. 326, datë 18.01.2016, "Kërkesë për shpronësim për pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti Vija Bregdetare e qytetit të Vlorës, faza 1" duke i bashkëlidhur tabelën ku për pasuritë që janë në pjesën perëndimore të rrugës dhe në pjesën lindore (pjesa e gjelbërimit) të projektit të vija bregdetare e qytetit të Vlorës, faza 1, qytetari figuron në tabelën 2/B me nr. rendor 1 me po të njëjtat të dhëna si dhe në shkresën e parë.

Po ashtu sipas shkresës nr, 3148, datë 25.04.2016, drejtuar MZHU, Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve "Dërgim i tabelës me emrat e pronarëve, pasuritë e paluajtshme të cilëve nga zbatimi i projektit "Vija Bregdetare e qytetit të Vlorës, faza 1" me çmimet e truallit të ndryshuar sipas VKM-së nr. 89, d atë 03.02.2016". Sipas tabelës, subjekti Safet Abazi, përfiton nga shpronësimi vlerën prej 22,547,404 lekë, shumë e cila është shtuar vetëm nga ndryshimin i vlerës për m2 sipas VKM-së nr. 89, datë 03.02.2016.

Së fundmi Komisioni i Vlerësimit Paraprak, me shkresën nr. 1082, datë 07.02.2018, "Kërkesë për vijim procedure për shpronësime të pasurive të paluajtshme pronë private, që janë prekur nga projekti "Vija Bregdetare e Qytetit të Vlorës", ka ripërsëritur kërkesën drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës, duke kërkuar shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit përfundimtar të dërguar nga Bashkia Vlorë dhe të ktheni një përgjigje përfundimtare për vijimin e procedurave të mëtejshme.

Sipas planvendosje të kufijve të pronësisë që preken nga zbatimi i projektit "Vija Bregdetare e Qytetit të Vlorës", të azhurnuar në hartën kadastrale në bazë të dokumentacionit të dërguar në ZVRPP Vlorë, shkalla 1:1000, punuar nga ing M. T, rezulton se subjekti ka të ndërtuar një objekt të përfunduar si karabina dhe rifiniturave, me numër total katesh 6.

Ky objekt rezulton i ndërtuar me leje ndërtimi të miratuar nga Këshilli i Rrethit Vlorë , sipas lejes së ndërtimit nr. 2/11, datë 02.02.1998, për dhënie shesh ndërtimi për Hotel Restorant "Aulona", në Skelë në 4-5-6 kate sipas projektit, me firmë ndërtuese "Union " dhe i financuar nga Safet Abazi.
Po ashtu rezulton se me vendim të KRRT Bashkia Vlorë nr. 7/63, datë 30.07.2003, është miratuar leje ndërtimore për subjektin "M.....g", dhe afat kohor leje deri më 30.07.2005.
Sa sipër rezulton se Bashkia Vlorë dhe Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve, në vlerësimin e procesit të shpronësimit të truallit dhe objektit, nuk ka marrë në shqyrtim e vlerësim dokumentacionin e subjektit, lidhur me lejen ndërtimore të përshkruar më lartë, por ka vijuar procedurat pa bërë vlerësimin e objektit. Përcaktimi i bashkisë se subjekti duhet trajtuar vetëm mbi bazën e korrespondencës me ZVRPP Vlorë, pa marrë në vlerësim dokumentacionin e poseduar nga institucione të tjerë e në veçanti ai i administruar nga vet bashkia (arkivi i institucionit) lidhur me lejen e ndërtimit, ka sjellë për pasojë mos përfshirjen në proces të shpronësimit të pasurisë së llojit truall, sikundër është vepruar në raste të tjera të ngjashme.

Investimi publik, për të cilin është kërkuar kryerja e procedurave të shpronësimit të pasurive të paluajtshme, pronë private, për realizimin e tij, me objekt: "Belvedere, Vlorë", sipas të dhënave vlera e shpronësimit është në shumën prej 9 561 931 lekë nga të cilat për shpronësimin e pasurive të llojit truall është në vlerën prej 9 561 931 lekë, miratuar me VKM nr. 721, datë 1.12.2017 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Belvedere Vlorë" .
Pas daljes së VKM-së së sipërcituar, nuk është vijuar me procedurat e likuidimit, pasi subjekti nuk ka paraqitur kërkesë për likuidim pasi i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
Më poshtë paraqitet tabela e plotë e vlerës së shpronësimit, me listën e përfituese/ personave të prekur plotësisht apo pjesërisht nga realizimi i veprës.
Tabela me listën e pronarëve sipas VKM nr. 721 DATE 01.12.2017

**LISTA E PRONAREVE TE PASURIVE PRONE PRIVATE QE SHPRONESOHEN NGA PROJEKTI:** **Shtocja 1**

**BELVEDERE NE LAGJEN UJI I FTOHTE VLORE**

**Cmimi i truallit sipas vkm 89 date 03.02.2016**
**Cmimi per objektet sipas VKM 138 Date 23.03.2000 dhe Udhezim Nr.3 date 28.12.2016 i EKB Tirane**

| NR | ZK | Nr. Pasurisë | Adresa | Pronari | Sipërfaq e Truallit | Çmimi i Truallit Lekë/m² | Vlera e Truallit Lekë | Sipërfaqe Ndërtimi | Çmimi i Ndërtimit Lekë/m² | Vlera e Ndërtimit Lekë | Vlera e Truall dhe Ndërtesë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Belvedere ne lagjen Uji I Ftohte Vlore** | | | | | | | | | | | | |
| 1 | 8602 | 43/560/3 | Vlore | Aglisi Dhima, Gjergji Dhima,Theodhori Dhima, Zaharulla Dhima,Leonora Hyso dhe Oliceta Shuka | 877 | 10903 | 9,561,931 | | | | 9,561,931.00 | Konfirmuar nga ZVRPP Vlore |
| | | | | | | | | | | | **9,561,931.00** | |

Lidhur me këto procedura, në adresë të KLSH është paraqitur ankesa e zotit TH. H, me nr. 1117, datë 24.10.2017 dhe 1117/1, datë 06.11.2017, të cilët kanë kundërshtuar procedurat e kryera nga Bashkia Vlorë për këtë shpronësim. Sipas ankesës qytetarët i janë drejtuar Bashkisë Vlorë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim që projektin dhe lejen infrastrukturore nr. 454, datë 22.09.2017, të realizohet me shpenzimet e tyre, pra nga vet pronarët, duke i kursyer shtetit vlerën e

shpronësimit. Po ashtu sipas ankesës pronarët janë dakord jo vetëm ta realizojnë atë por tija lënë në përdorim të lirë Bashkisë Vlorë.
Nga auditimi rezultojë se kërkesa dhe propozimi i pronarëve nuk është marrë në konsideratë nga institucionet e ngarkuara për zbatimin e procedurave të shpronësimit dhe realizimit të projektit të investimit.

Investimi publik, për të cilin është kërkuar kryerja e procedurave të shpronësimit të pasurive publike, për realizimin e tij, me objekt: "Ndërtim dhe sistemim i rrugës Gjykata-Akademia e Marinës+Rruga Duro Shaska deri tek 7 Pallatet Vlorë", sipas të dhënave vlera e shpronësimit është në shumën prej 134,550,898lekë nga të cilat për shpronësimin e pasurive të llojit truall është në vlerën prej 116,082,617lekë dhe objekt në vlerën prej 18,468,281lekë, miratuar me VKM nr.595, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi dhe sistemimi i rrugës "Gjykata – Akademia e Marinës" + rruga "Duro Shaska" deri tek 7 pallatet, Vlorë, faza I.".
Pas daljes së VKM-se së sipërcituar, është vijuar me procedurat e likuidimit sipas kërkesës së paraqitur nga vetë subjekti i shpronësuar. Sipas të dhënave subjektet të cilat nuk kanë qenë dakord me vlerën e investimit janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kontestuar vlerën e shpronësimit, procese të cilat rezultojnë të jenë në trajtim gjyqësor nga gjykata e Vlorës dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

Investimi publik, për të cilin është kërkuar kryerja e procedurave të shpronësimit të pasurive publike, për realizimin e tij, me objekt: "Studim, projektim lidhja e rrugës "Transballkanike" me superstradën Fier-Vlorë", sipas të dhënave vlera e shpronësimit është në shumën prej 584453 982.82 lekë nga të cilat janë likuiduar në vlerën prej 470,887,724.82 lekë, miratuar me VKM nr.54, datë 21.01.2015, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Studim, projektim lidhja e rrugës "Transballkanike" me superstradën Fier-Vlorë". Kjo VKM ka pësuar shtesa dhe ndryshime me VKM nr.599/2015, 163/2015 dhe 1098/2015.
Pas daljes së VKM-se së sipërcituar, shtesave dhe ndryshimeve të kryera, është vijuar me procedurat e likuidimit sipas kërkesës së paraqitur nga vetë subjekti i shpronësuar. Disa prej subjekteve i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kontestuar vlerën e shpronësimit dhe aktualisht konstatohen raste të vendimeve të Gjykatës në favor të palës paditëse. Me Vendim nr. 1098, datë 28.12.2015 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 54, datë 21.1.2015, të këshillit të ministrave, "për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i objektit "Studim, projektim, lidhja e rrugës Transballkanike me Superstradën Fier-Vlorë", të ndryshuar, vlerë e ndryshuar më pas në 582 288 595.82 lekë.

Investimi publik, për të cilin është kërkuar kryerja e procedurave të shpronësimit të pasurive të paluajtshme, pronë private, për realizimin e tij, me objekt: "Rikualifikim urban në qytetin e Vlorës, përgjatë shëtitores P4, C2"a,b,c", sipas të dhënave vlera e shpronësimit është në shumën prej 146011365 lekë nga të cilat për shpronësimin e pasurive për objektin Ndërtim Vazhdimi i Unazës Vlorë –Uji i Ftohtë është shuma 27,446,020 leke dhe për objektin "Rikualifikim urban në qytetin e Vlorës, përgjatë shëtitores P4, C2"a,b,c është në vlerën prej 118565346 lekë, miratuar me VKM nr. 490 datë 19.07.2017 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve pasurive të paluajtshme, pronë

private, që preken nga realizimi i projektit "Vlora - ACU, Rikualifikim urban në qytetin e Vlorës, përgjatë 'P4 C2 a, b, c'", dhe "ndërtim i rrugës - Vazhdimi i Unazës Vlorë - Uji i Ftohtë"
Pas daljes së VKM-se së sipërcituar, është vijuar me procedurat e likuidimit sipas kërkesës së paraqitur nga vetë subjekti i shpronësuar. Në disa raste rezulton se subjekteve i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kontestuar vlerën e shpronësimit. Po ashtu rezulton se pjesa e parë e VKM nr. 490, që përkon me shpronësimet e rrugës "Ndërtim i rrugës - Vazhdimi i Unazës Vlorë - Uji i Ftohtë", për shkak të ndryshimit të gjurmës së rrugës është ridërguar përsëri për shtesa dhe ndryshime në VKM, ndërsa për pjesën e dytë të VKM, kanë vijuar procedurat e likuidimit për subjektet e shpronësuara.

Investimi publik, për të cilin është kërkuar kryerja e procedurave të shpronësimit të pasurive publike, për realizimin e tij, me objekt: Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim Urban, Shesh, Park Publik, Teatri 'Petro Marko", në Bashkinë Vlorë. Sipas të dhënave vlera e shpronësimit është në shumën prej 81 331 044 (tetëdhjetë e një milionë e treqind e tridhjetë e një mijë e dyzet e katër)lekë nga të cilat shpronësimi i pasurive të llojit truall është në vlerën prej 10,203,027 lekë dhe objekt në vlerën prej 71,128,017 lekë, miratuar me VKM nr.209, datë 15.03.2017, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim Urban, Shesh, Park Publik, Teatri 'Petro Marko'", në Bashkinë Vlorë.
Pas daljes së VKM-se së sipërcituar, është vijuar me procedurat e likuidimit sipas kërkesës së paraqitur nga vetë subjekti i shpronësuar. Disa prej subjekteve i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kontestuar vlerën e shpronësimit.

Investimi publik, për të cilin është kërkuar kryerja e procedurave të shpronësimit të pasurive të paluajtshme, pronë private, për realizimin e tij, me objekt "Rikualifikim urban në territorin e Bashkisë Vlorë", faza 1, sipas të dhënave vlera e shpronësimit është në shumën prej 55 686 001 lekë nga të cilat për shpronësimin e pasurive të llojit truall është në vlerën prej 49,616,431 lekë dhe objekt në vlerën prej 6069570 lekë, miratuar VKM nr. 356, datë 19.4.2017 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim urban në territorin e Bashkisë Vlorë", faza 1.
Pas daljes së VKM-se së sipërcituar, është vijuar me procedurat e likuidimit sipas kërkesës së paraqitur nga vetë subjekti i shpronësuar dhe në rastet kur ka pasur kontestime mbi vlerën e shpronësimit subjektet i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kontestuar vlerën e shpronësimit, procese të cilat janë ende në proces në shkallë të parë dhe pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**LISTA E PASURIVE QE PREKEN NGA PROJEKTI:**

**"RIKUALIFIKIM URBAN, ME VENDNDODHJE NE TERRITORIN E BASHKISE VLORE" Faza I**

VKM 356 DATE 19.04.2017

| Nr | ZK | Nr. Pasurisë | Adresa | Pronari | Sipërfaqe Trualli | Siperfaqe Ndërtimi | Çmimi i Truallit Lekë/m² | Çmimi i Ndërtimit Lekë/m² | Vlera e Truallit Lekë | Vlera e Ndërtimit Lekë | Vlera e Truall dhe Ndërtesë | SHUMA LIKUJDUAR |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 8605 | 6/272 | Vlore | Bp. Gunbardhi, Velaj, Tartari | 1778 | 0 | 8,300 | 0 | 14,757,400 | 0 | 14,757,400.00 | 14757400 |
| 2 | 8605 | 6/240 | Vlore | Bp Agalliu | 1000.5 | 0 | 8,300 | 0 | 8,304,150 | 0 | 8,304,150.00 | 8,304,150 |
| 3 | 8605 | 6/241 | Vlore | Bp. Xhemali | 432 | 0 | 8,300 | 0 | 3,585,600 | 0 | 3,585,600.00 | |
| 4 | 8605 | 6/242 | Vlore | Bp. Xhemali | 572 | 0 | 8,300 | | 4,747,600 | 0 | 4,747,600.00 | |
| 5 | 8605 | 6/66-Nd/3 | Vlore | Agim Xhemali | 0 | 99 | 0 | 24,674 | 0 | 2,442,758 | 2,442,758.00 | |
| 6 | 8605 | 6/169 | Vlore | Bp Agalliu | 36 | 0 | 8,300 | 0 | 298,800 | 0 | 298,800.00 | 298,800 |
| 7 | 8605 | 6/159 | Vlore | Bp Agalliu | 113.5 | 0 | 8,300 | 0 | 942,050 | 0 | 942,050.00 | |
| 8 | 8605 | 11./92 | Vlore | Bp.Agalliu,Sorra,Graceni | 1329 | 0 | 8,300 | | 11,030,700 | 0 | 11,030,700.00 | |
| 9 | 8605 | 11./176 | Vlore | Bp.Agalliu,Sorra,Graceni | 61 | 0 | 8,300 | | 506,300 | 0 | 506,300.00 | |
| 10 | 8605 | 11./84 | Vlore | Bp.Lulja | 350 | 0 | 8,300 | | 2,905,000 | 0 | 2,905,000.00 | 1936666.69 |
| 11 | 8605 | 11/182 | Vlore | Bp.Kokona, Bino,Celaj,Polloj, Balili | 31 | 0 | 8,300 | | 257,300 | 0 | 257,300.00 | |
| 12 | 8605 | 11/139 | Vlore | Bp.Agalliu | 7.3 | 0 | 8,300 | | 60,590 | 0 | 60,590.00 | |
| 13 | 8602 | 2/16-nd | Vlore | Porina Mucaj | 29.5 | 29.5 | 10,903 | 46,963 | 321,639 | 1,385,409 | 1,707,047.00 | |
| 14 | 8602 | 4/21. | Vlore | Bp.Bojaxhi | 25 | | 10,903 | 0 | 272,575 | 0 | 272,575.00 | |
| 15 | 8602 | 4/9. | Vlore | Bp.Bojaxhi | 75 | | 10,903 | 0 | 817,725 | 0 | 817,725.00 | |
| 16 | 8602 | 4/2 -ND-T | Vlore | David Dema | 4 | 4 | 10,903 | 35,760 | 43,612 | 180,127 | 223,739.00 | |
| 17 | 8602 | 2/134/1 | Vlore | Sabit Rakipi | 70.2 | 49.6 | 10,903 | 41,558 | 765,391 | 2,061,277 | 2,826,667.40 | 2826667.60 |
| | | | | shuma totale | | | | | | | 55,686,001 | 28123684.3 |

Investimi publik, për të cilin është kërkuar kryerja e procedurave të shpronësimit të pasurive të paluajtshme, pronë private, për realizimin e tij, me objekt: "Rikonstruksion i rrugës Transballkanike Vlorë, Faza II", sipas të dhënave vlera e shpronësimit është në shumën prej 332987201 lekë nga të cilat janë likuiduar 276070236.02 lekë, miratuar me VKM nr. 345, datë 04.05.2016,"Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronës private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i rrugës Transballkanike Vlorë, Faza II".
Pas daljes së VKM-së së sipërcituar, është vijuar me procedurat e likuidimit sipas kërkesës së paraqitur nga vetë subjekti i shpronësuar. Disa prej subjekteve i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kontestuar vlerën e shpronësimit.

Bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit gjendjen të plota të gjitha tabelat e vlerës së shpronësimit, me listën e përfituese/ personave të prekur plotësisht apo pjesërisht nga realizimi i veprës si dhe likuidimet përkatëse.

Në përfundim, për të gjitha projektet e shpronësimeve, pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe botimit në Fletoren Zyrtare, nga Bashkia Vlorë, është dërguar në Z.V.R.P.P planimetria e Shpronësimit për secilën procedurë dhe më konkretisht për secilën V.K.M shpronësimi:
Me shkresat nr. 3891, datë 18.05.2016 dhe nr. 3856, datë 23.09.2015 janë dërguar planvendosje përkatëse të subjekteve të shpronësuar me VKM nr. 54/2015, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizmi i projektit "Studim, projektim, lidhja e Rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë", të ndryshuar.
Me shkresën nr. 6377, datë 29.07.2016 janë dërguar planvendosje përkatëse të subjekteve të shpronësuar me VKM nr. 412,/2016 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizmi i projektit "Rishikim I projektit të zbatimit të fazës së parë të vijës bregdetare të qytetit të Vlorës", pika 7.
Me shkresën nr. 5987, datë 18.07.2016 janë dërguar planvendosje përkatëse të subjekteve të shpronësuar me VKM nr. 345/2015 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të

paluajtshme, pronë private, që preken nga realizmi I projektit "Rikonstruksion I Rrugës Transballkanike Vlorë, Faza II, pika 7
Me shkresën nr 8977, datë 29.09.2017 janë dërguar planvendosje përkatëse të subjekteve të shpronësuar me V.K.M nr. 310/2014, "Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimi I segmentit rrugor, Skelë – Uji Ftohtë, Bashkia Vlorë" të ndryshuar me V.K.M nr. 661.
Me shkresën nr 11608 prot, datë 22.12.2017 janë dërguar planvendosje përkatëse të subjekteve të shpronësuar me V.K.M nr. 595/2016 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizmi I projektit "Ndërtimi dhe sistemimi I rrugës "Gjykatë-Akademi e Marinës" + " rruga Duro Shaska deri te 7 pallatet" Vlorë, Faza I
Me shkresën nr 11609 prot, datë 22.12.2017 janë dërguar planvendosje përkatëse të subjekteve të shpronësuar me V.K.M nr. 345/2015 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizmi I projektit "Ndërtimi i Rrugës "Dhimitër Konomi, në zonën e Ujit të Ftohtë" , Vlorë
Me shkresën nr 11636 prot, datë 22.12.2017 janë dërguar planvendosje përkatëse të subjekteve të shpronësuar me V.K.M nr. 209/2017 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizmi I projektit "Rikualifikim Urban, shesh, park publik, Teatri "Petro Marko", në Bashkinë Vlorë.

Nga auditimi rezulton se gjatë zbatimit në fakt të projektit "Rikonstruksion i Rrugës Transballkanike, Faza 11", nga IMTV një pjesë e pasurive, pronë private, të llojit "ndërtesë", me funksion "banim", "njësi" etj., janë prishur pjesërisht ose nuk janë prishur. Pjesërisht ato ndodhen brenda vijës së shpronësimit. Verifikimet për këto objekte janë kryer nga vetë Drejtoria e Menaxhimit të Pronës Publike dhe Aseteve, ku sipas azhornimit të kryer nga vetë projektuesit, të cilët kanë vendosur në dispozicion azhornimin faktit të objekteve dhe një projekt-ide për fazën tjetër të zbatimit, ka rezultuar se zbatimi projektit nuk është bërë sipas miratimit por është modifikuar gjatë ekzekutimit, kjo referuar situatës të bërë prezent në terren. Më poshtë listohen objektet e ndodhura në këtë situatë:
Zona Kadastrale 8605:
Pasuria numër 49/97-nd, objekti i prerë ndodhet mesatarisht 1.3 m brenda vijës së shpronësimit.
H. V, pasuria numër 49/197, objekti i prerë ndodhet brenda vijës së shpronësimit 3.4 m në veri dhe 5 m në jug.
Bp. Llanaj, 45/50-n, objekti nuk është prishur, ndodhet 3.7 m brenda vijës së shpronësimit.
Dy objekte në Jug të pasurisë më sipër ndodhen 2.6 m brenda vijës së shpronësimit.
E. GJ, pasuria numër 50/23, objekti i prerë ndodhet 3.7 m në veri dhe 3.15 m në jug, brenda vijës së shpronësimit.
A. D, pasuria numër 50/24, objekti i prerë ndodhet 3.2 m në veri dhe 2.3 m në jug, brenda vijës së shpronësimit.
Në jug të objektit të A. T, ndodhet një objekt 2.2 m brenda vijës së shpronësimit.
Zona kadastrale 8603
Pasuria 20/122-ND2 Stavri Meçi, ndodhet 2.9m brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 20/122-ND1 Filip Meçi, ndodhet 2.9m brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 20/122-ND3 Theofan Meçi, ndodhet 2.9m brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 20/146 ndodhet 2.5m brenda vijës së shpronësimit.

Pasuria 20/22 ndodhet 5m brenda vijës së shpronësimit.
Ne jug te pasurisë 20/41/1 ndodhet objekt brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 20/230 ndodhet 2.5m brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 20/149 ndodhet 4 m brenda vijës së shpronësimit.
Pasuria 29/325 ndodhet brenda vijës së shpronësimit 0-3m.
Zona kadastrale 8604
A. S disponon objekt brenda vijës së shpronësimit.
J. B disponon objekt brenda vijës së shpronësimit.
F. B, pasuria 5/29-ND1 disponon objekt që ndodhet 2.5m ne jug dhe 1.5m në veri, brenda vijës së shpronësimit.
V. R, disponon objekt që ndodhet 4.6m brenda vijës së shpronësimit.
S. V, Pasuria 4/128-ND, disponon objekt që ndodhet 4.0m ne jug brenda vijës së shpronësimit.
J. V, Pasuria 4/120, ka rrethim që ndodhet brenda vijës së shpronësimit 2.7m.
A. T, objekt që ndodhet 4 m, brenda vijës së shpronësimit.
Tre objekte më në veri përkatësisht 3.7m, 1m dhe 2m brenda vijës së shpronësimit.
Shënim: Më të detajuar prishjet e objekteve me prerje pasqyrohen në pikën VI/b, lidhur me auditimi e IMTV.
Në përfundim, procedurat e kryera kanë qenë në referim të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999"Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme", Vendimeve të Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban si dhe VKM-ve respektive për secilin projekt shpronësimi.

**Mbi ankesën e qytetarit N.... N... I....**
Nga KLSH është administruar me nr. 998, datë 25.09.2017, ankesa e qytetarit N. I, sipas të cilës pretendohet se Bashkia Vlorë, gjatë periudhës qershor-nëntor 2014 ka shkelur të drejta e tij mbi posedimin e ligjshëm e të pa cënuar të pronës private, duke shpallur si zonë informale të një parcele tokë private në pronësi të familjes Isaraj, zonë e miratuar si e tillë me Vendim të KKRRT nr. 2, datë 30.12.2015.
Lidhur me këtë praktikë ankimore, nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, me informacionin e datës 05.02.2018, është bërë me dije grupi i auditimit lidhur me të gjitha procedurat e realizuara nga bashkia për shpronësimin e pasurive të qytetarit, informacion i shoqëruar dhe me dokumentacionin përkatës, dhe konkretisht:
Relacion për procedurën e shpronësimit të B.P Isaraj, për pasurinë numër 7/140, volum 26, faqe 91, e ndodhur në zonën kadastrale 8605, e prekur nga zbatimi i 'Projektit Pilot për integrimin e zonën informale në lagjen 'Kushtrim', Vlorë.
Bashkia Vlorë, në kuadër të zbatimit të projektit "Rikonstruksioni i Rrugës Transballkanike Vlorë, Faza II ", bazuar në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", në Nenin të tij 10, "Kërkesat dhe dokumentet shoqëruese të kërkesës për shpronësim" ka paraqitur kërkesën për shpronësim, pranë ministrisë kompetente, te shoqëruar me aktet dhe dokumentacionin ligjor te kërkuar, për projektet, ne favor te se cilës behet shpronësimi, ka kryer procedurën e vlerësimit paraprak.
Projekti pilot "Për integrimin e zonës informale, lagjja "Kushtrimi, Vlorë", është një projekt i inicuar nga qeveria shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban. Bashkia Vlorë, ka paraqitur kërkesë

për shpronësim pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, sipas kërkesave të dispozitave ligjore te Nenit 10 të ligjit të sipërcituar, aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
Me shkresën nr.1934, datë 19.05.2015 me lëndë "Kërkesë për shpronësim", për zbatimin e "Projektit Pilot për Integrimin e Zonës Informale në Lagjen "Kushtrimi", Vlorë", Bashkia Vlorë ka dërguar kërkesën për shpronësim për pasuritë private që prekeshin nga zbatimi i këtij projekti. Ky projekt është realizuar nga Ministria e Zhvillimit Urban në bashkëpunim me Fondin e Zhvillimit te Rajoneve. Ky fakt vërtetohet nga shkresa nr.6397/2, datë 2.05.2014 te Ministrisë se Financave, drejtuar Drejtorisë se Përgjithshme te Shërbimeve Financiare, me lende "Akordim Fondi nga FZHR, për infrastrukturën vendore, për vitin 2014".
Bashkia Vlorë ka vijuar më tej korrespodencën me ministrinë kompetente, e cila ka kërkuar herë pas herë plotësim dokumentacioni, i cili ashtu siç rezulton dhe nga shkresat e dërguara nga Bashkia Vlorë, është ridërguar disa herë.
Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, pranë ministrisë kompetente, me shkresën nr. 4081, datë 14.07.2017, me lëndë "Kthim kërkese për shpronësim", ka kthyer pas dokumentacionin tekniko ligjor, për vlerësimin paraprak të pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila është prekur nga zbatimi i projektit të sipërcituar. Kjo kërkesë, është refuzuar pasi kërkesa për shpronësim është refuzuar sepse dokumentacioni shoqërues është me mangësi dhe jashtë afateve ligjore.
Në shkresën e sipërcituar, nuk janë argumentuara mangësitë dhe afatet ligjore të shkelura nga Bashkia Vlorë, të cilat kanë çuar në refuzimin e kërkesës për shpronësim. Në qoftë se i referohemi dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se kërkesa e parë për shpronësim është bere nga Bashkia Vlorë me shkresën nr,1934, datë 19.05.2015, dhe urdhri i brendshëm pranë Ministrisë se Zhvillimit Urban, për shqyrtimin e kërkesës për shpronësim, mban numrin 173 dhe datën 10.10.2016
Në përfundim rezulton se Bashkia Vlorë në respektim të detyrimit institucional ka filluar procedurën e shpronësimit sipas dispozitave ligjore ne fuqi, dhe se është Ministria e Zhvillimit Urban e cila nuk ka proceduar me shqyrtimin e dokumentacionit te dërgua, konstatim i cili pasqyrohet edhe në shkresën nr. 8951, datë 28.09.2017, që Bashkia Vlorë i ka kërkuar Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit pranë MIE-së, duke kërkuar sqarime mbi arsyet konkrete të kthimit të kërkesës për shpronësim.

Praktika të plotësimit të AMTP nga Bashkia Vlorë dhe Njësia Administrative Orikum.
Praktika të plotësimit të AMTP nga Bashkia Vlorë për periudhën 2015-2017, sipas ligjit nr. 171/2014 datë 18.12.2014 "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", VKM nr. 337, datë 22.04.2015 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", VKM nr. 253, datë 06.3.2013 "Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish -kooperativave bujqësore", VKM nr. 222 06.03.2013 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve" të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 07.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar me ligjin 58/2012, datë 05.06.2012 dhe nr. 172/2014, dhe ligjit nr. 57/2012, datë 05.06.2012 "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të tokës bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore", VKM nr. 994 datë 09.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi" i ndryshuar me VKM nr. 320 datë 27.04.2016, ligjin nr. 63/2016 për një

ndryshim në ligjin nr. 171/2014 "Për Përfundimin e Procedurave Ligjore të Kalimit të Tokës Bujqësore të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore në Pronësi të Përfituesve" si dhe në zbatim të VKM 814 datë 16.11.2016 për disa ndryshime në VKM nr. 337 datë 24.04.2015 "Për përcaktimin e Procedurave të Kryerjes së Procesit të Kalimit të Tokës Bujqësore të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore në Pronësi të Përfituesve", janë kryer praktika të lëshimit të AMTP-vë apo kalimit nga përdorimi në pronësi. Më konkretisht, sipas referencës së aplikuar dhe subjektit I cili rezulton ti ketë realizuar ato, paraqiten:
Tabela e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore të plotësuara nga Bashkia Vlorë, për ish K.B-të ligji 9948 /2008 – 58/2012, VKM-ja 253 /2013 i ndryshuar, në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme, si dhe në mënyrë të detajuar në tabelën bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.

| Nr | Njësia administrative | Nr. I titujve të pronësisë të plotësuara | Nr. i familjeve | Sipërfaqe e tokës bujqësore në (Ha) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Njësia Orikum | 29 | 3 | 8.5 |
| 2 | Njësia Shushicë | - | - | - |
| 3 | Njësia Novoselë | 5 | 5 | 2.6 |
| 4 | Njësia Qendër | - | - | - |
| 5 | Ish B/Vlorë | - | - | - |
| | Shuma | 14 | 8 | 11.1 |

AMTP-të e prodhuara bazuar në ligjin nr. 57/2012, ndryshuar me nr. 171/2014 dhe VKM nr. 222/2013, ndryshuar me VKM nr. 337/2015, në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme, si dhe në mënyrë të detajuar në tabelën bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.

| Nr | Njësia administrative | Nr. I titujve të pronësisë të plotësuara | Nr. i familjeve | Sipërfaqe e tokës bujqësore në (Ha) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Njësia Orikum | - | - | - |
| 2 | Njësia Shushicë | 7 | - | 2.3 |
| 3 | Njësia Novoselë | 17 | 8 | 16.5 |
| 4 | Njësia Qendër | 75 | 46 | 25.3 |
| 5 | Ish B/Vlorë | 20 | 15 | 12.8 |
| | Shuma | 14 | 8 | 57.1 |

Lidhur me praktikat e realizuara nga Bashkia Vlorë, Komisioni ka funksionuar si pjesë e Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve e drejtuar nga A. SH, me detyrë Ish-Drejtore, zëvendësuar me A. M, me detyrë ish-Drejtor dhe anëtar Komisioni zj. Merita Todor, me detyrë agronome, O. F, me detyrë ish-inxhinier, zëvendësuar me A. H dhe E. B, me detyrë Juriste.
Në përfundim të auditimit të praktikave me zgjedhje, rezultoi se procedurat e kryera nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Komisioni për kryerjen e procedurave të kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi, në drejtim të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit sipas kërkesave të qytetarëve, verifikimeve dhe hartimit të planvendosjeve për çdo dosje, janë zbatuar referencat ligjore të cilat rregullojnë procesin e lëshimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi.
Nga grupi i punës duhet të zbatoheshin më mirë afatet kohore në lidhje me përgatitjen e materialit për këshillin bashkiak, i cili bazuar në pikën 13 të VKM nr. 337, datë 22.04.2015 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në

pronësi të përfituesve", duhet të përgatitet brenda 10 ditëve pas marrjes së përgjigjeve nga institucionet e treta. Në të shumtën e praktikave ky afat nuk është respektuar.
Lidhur me dokumentacionin hartografi shoqërues të secilës AMTP të prodhuar nga Komisioni dhe të miratuar më tej në KB, përgjithësisht rezulton se u referohet përherë planvendosje të hartuar nga inxhier hartograf të licencuar dhe nuk ka konfirmim të specialistit hartograf të bashkisë, duke u rezervuar përherë vetëm në pretendimet e pronarit.

Lidhur me praktikat e realizuara nga ish-Bashkia Orikum, Komisioni është përbërë nga A. XH me detyrë Drejtore e Zyrës së Bujqësisë, TH. Q Inspektor i Menaxhimit të Tokave dhe A. C me detyrë Topograf.
Procedurat e kryera nga kjo strukturë rezultuan të miratuara me VKB nr. 22, datë 20.03.2013 (për 1 përfitues) dhe VKM nr. 7, datë 27.01.2014 (për 24 përfitues), vendime për të cilat rezulton se është marrë konfirmimi mbi ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Vlorë. Nga 25 përfitues rezulton se vetëm 4 persona kanë marrë titujt e pronësisë dhe janë dërguar për regjistrim në ZVRPP Vlorë, ndërsa përsa i përket personave të tjerë të përfshirë në VKB, nuk është vijuar me plotësimin e AMTP-vë dhe praktikat rezultojnë të kanë kaluar pjesërisht për trajtim në Bashkinë Vlorë.
Në një rast, lidhur me praktikën e përfituesit L. D, rezultoi se planrilevimet bashkëlidhur saj nuk ishin miratuar nga Kryetari i Bashkisë, sikundër përcaktohet në VKM nr. 253, datë 06.3.2013 "Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish -kooperativave bujqësore".
Lidhur me dy Vendimet e KB Orikum, nr. 22, datë 20.03.2013 dhe nr. 7, datë 27.01.2014, nuk na u vu në dispozicion relacioni përkatës dhe projektvendimi i paraqitur nga Drejtoria e Zyrës së Bujqësisë, po ashtu as regjistri i AMTP-ve.

Procedurat dhe dokumentacioni i administruar për kalimin e pronësisë të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga punonjësit por dhe deklarimeve shkresore e verbale, rezultoi se në Bashkinë Vlorë ka gjetur zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie si dhe për regjistrimin e tyre", ndryshuar me VKM nr. 133, datë 11.02.2015 dhe VKM nr. 812, datë 16.11.2016, paraqiten sipas tabelës bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.

*Praktikat e auditura dhe konstatuara me shkelje apo parregullsi*.
**1. Vendimi nr. 56, datë 06.12.2016**, saktësuar me vendimin nr. 31, datë 18.04.2017 "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, A. SH, A. R dhe A. P dhe R. H nga O. F.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti nuk ka paraqitur dokument hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij, që vërteton se pasuria e llojit truall është më e madhe se ajo e përcaktuar dhe vendosura me vendimin e sipërcituar. Konkretisht sipas konfirmimit ligjor të ZVRPP nr. 336, datë 19.01.2016, pasuria në fjalë është 106.4 m2 ndërtesë dhe trualli është 286.6 m2. Po ashtu të gjitha korrespondencat e afishimet përkatëse rezultojnë se janë bërë

për këtë sipërfaqe prone dhe jo për atë të përcaktuar në vendim dhe konkretisht për objekt 91m2 dhe truall 170.
Prona sipas fragment hartë të AQTN, për vitet 1964-1982 rezulton po e njëjtë me atë të paraqitur nga kërkuesi sipas planrilevimit dhe gjendjes aktuale të saj.
Në këto kushte rezulton se Vendimi nr. 56, datë 06.12.2016, saktësuar me vendimin nr. 31, datë 18.04.2017 "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", dhënë në favor të Musa Qemali nuk reflekton sipërfaqen reale të tij dhe as atë dokumentare, duke i kaluar në pronësi qytetarit më pak se sipërfaqja që i takon ti njihet e kthehet ligjërisht.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, A. SH, A. R, A. P dhe O. F.
**2. Vendimi nr. 5, datë 13.01.2017**, saktësuar me vendimin nr. 8, datë 06.02.2017 "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, A. M, dhe A. P dhe Relacioni Hartografik A. H.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij.
Lidhur me këtë pronë konstatohet se pozicionimi i saj para vitit 1991 nuk ekziston në këto kushte rezulton se nuk jemi para aplikimit të VKM-së nr. 608, përsa nuk plotësohet kushti i vërtetimit që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991.
Nga dokumentacioni provohet pjesërisht vetëm se qytetari me Vendimin nr. 18, datë 21.3.1991 i është miratuar kredi për ndërtimin e dy dhomave ngjitur me dhomën ekzistuese, pasi është 5 vetë në një dhomë.
Po ashtu konstatohet se pozicionimi i pronës/objektit sipas lejes së ndërtimit të vitit 1991 me gjendjen aktuale të saj është i ndryshëm.
Për këtë praktikë duke qenë se është konstatuar se nuk disponohet fragment harte e viteve para 1991 si dhe në njërën hartë/skicë atë të lejes së meremetim ndërtimit krahasuar me atë të miratuar nga Bashkia Vlorë, objekti paraqitet i ndryshëm, pra bëhet fjalë për ndërtim më të madh të ndërtuar pas viteve 1991.
Në këto kushte rezulton se vendimi nr. 5, datë 13.01.2017, saktësuar me vendimin nr. 8, datë 06.02.2017, në favor të A. D është dhënë në kapërcim të kompetencave ligjore.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, A. M, A. H dhe A. P.
**3. Vendimi nr. 30, datë 18.04.2017**, "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, A. M dhe A. P dhe Relacioni Hartografik nga A. G.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor dhe hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij.
Lidhur me këtë pronë konstatohet se pozicionimi i saj para vitit 1991 nuk ekziston në këto kushte rezulton se nuk jemi para aplikimit të VKM-së nr. 608, përsa nuk plotësohet kushti i vërtetimit që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991 po ashtu nuk jemi para aplikimit të VKM-së përsa nuk ka asnjë dokument që vërteton në një mënyrë apo tjetër lidhjen me pasurinë. I vetmi dokument i disponuar në dosje është planrilevimit aktual i pasurisë i cili nuk përbën dokument provues.

Në këto kushte rezulton se vendimi nr. 30, datë 18.04.2017, në favor të P. B është dhënë në kapërcim të kompetencave ligjore.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, A. M, A. G dhe A. P.
**4. Vendimi nr. 54, datë 06.12.2016**, "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, A. SH, A. P dhe A. RR si dhe Relacioni Hartografik nga O. F.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se nuk kemi një relacion hartografik të nënshkruar nga O. F si dhe se Relacioni Teknik përsëri nuk është nënshkruar prej tij.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij.
Lidhur me këtë pronë konstatohet se pozicionimi i saj para vitit 1991 nuk ekziston në këto kushte rezulton se nuk jemi para aplikimit të VKM-së nr. 608, përsa nuk plotësohet kushti i vërtetimit që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991. I vetmi dokument i disponuar në dosje është vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 1130, datë 24.07.2015 të Gjykatës Administrative Vlorë e cila ka vendosur detyrimin e Bashkisë Vlorë të nxjerrë aktin administrativ vendim për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme me nr. 27/91 ndërtese, me sipërfaqe ndërtimore 126.3 m2 dhe truall me sipërfaqe ndërtimore 126.3m2. Vendim për të cilin bashkia rezulton se nuk ka qenë pjesëmarrëse në procesin gjyqësor.
Pavarësisht vendimit gjyqësor dhe citimit në të autorizimit nr. 5, datë 22.02.1989 të Këshillit Popullor të Lagjes Pavarësia dhe regjistrit hipotekor nr. 1868, datë 09.02.1994 apo edhe vendimit gjyqësor të faktit juridik nr. 2596, datë 13.10.1995, bashkia nuk ka qenë në kushtet e daljes me vendim nr. 54, datë 06.12.2017, konkluzion ky i referuar në konfirmimin e ZVRPP nr. 694/1, datë 03.02.2016, sipas të cilit ky institucion ka të regjistruar në volum 10 faqe 67 truall me nr. 27/91 sipërfaqen prej 38.2 m2 dhe volum 10 faqe 68 ndërtesë me nr. 27/91-ND sipërfaqen po prej 38.2 m2.
Në këto kushte rezulton se vendimi nr. 54, datë 06.12.2016, në favor të Merita Kapllanaj është dhënë në kapërcim të kompetencave ligjore lidhur me sipërfaqen e pronësisë.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, A. M, A. G dhe A. P.
**5. Vendimi nr. 94, datë 05.12.2017**, "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, J. GJ dhe S. H dhe Relacioni Hartografik nga F. M.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor dhe hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij.
Lidhur me këtë pronë konstatohet se pozicionimi i saj para vitit 1991 nuk ekziston në këto kushte rezulton se nuk jemi para aplikimit të VKM-së nr. 608, përsa nuk plotësohet kushti i vërtetimit që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991 po ashtu nuk jemi para aplikimit të VKM-së përsa nuk ka asnjë dokument që vërteton në një mënyrë apo tjetër lidhjen me pasurinë. I vetmi dokument i disponuar në dosje është planrilevimit aktual i pasurisë i cili nuk përbën dokument provues, po ashtu edhe dokumenti i nxjerrë nga KQ Vlorë, DAMT, Planimetria e Ndërtimeve, miratuar me Vendim të KEKP

Rrethit nr. 274, datë 24.12.1980, shoqëruar me vendimin nr. 62, datë 30.05.1991 nuk paraqet asnjë të dhënë mbi objektin e pronësisë edhe pse qytetari pretendon se ka fituar pronësinë prej vitit 1978.
Në këto kushte rezulton se vendimi nr. 94, datë 05.12.2017, në favor të S. K është dhënë pa disponuar dokumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM-së.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, J. GJ, S. H dhe F. M.
**6. Vendimi nr. 55, datë 06.12.2016**, "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, A. SH dhe A. P dhe Relacioni Hartografik nga O. F.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor dhe hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij.
Lidhur me këtë pronë konstatohet se pozicionimi i saj para vitit 1991 nuk ekziston në këto kushte rezulton se nuk jemi para aplikimit të VKM-së nr. 608, përsa nuk plotësohet kushti i vërtetimit që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991 po ashtu nuk jemi para aplikimit të VKM-së përsa nuk ka asnjë dokument që vërteton në një mënyrë apo tjetër lidhjen me pasurinë. I vetmi dokument i disponuar në dosje është planrilevimit aktual i pasurisë i cili nuk përbën dokument provues.
Në këto kushte rezulton se vendimi nr. 55, datë 06.12.2016, në favor të Tarikë Bejo është dhënë pa disponuar dokumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM-së.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, A. SH, A. P dhe O. F.
**7. Vendimi nr. 43, datë 23.05.2017**, "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, A. M dhe S. H dhe Relacioni Hartografik nga G. H.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor dhe hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij.
Lidhur me këtë pronë konstatohet se pozicionimi i saj para vitit 1991 nuk ekziston në këto kushte rezulton se nuk jemi para aplikimit të VKM-së nr. 608, përsa nuk plotësohet kushti i vërtetimit që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991 po ashtu nuk jemi para aplikimit të VKM-së përsa nuk ka asnjë dokument që vërteton në një mënyrë apo tjetër lidhjen me pasurinë. I vetmi dokument i disponuar në dosje është planrilevimit aktual i pasurisë i cili nuk përbën dokument provues, po ashtu edhe dokumenti i nxjerrë nga ASHV Vlorë nga ku rezulton se në vitin 1979 M. Rr ka një shtëpi banimi, mbiemër i saktësuar në M.....j sipas vendimit gjyqësor nr. 750, datë 23.03.2008
Në këto kushte rezulton se vendimi nr. 43, datë 23.05.2017, në favor të M. M, është dhënë pa disponuar dokumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM-së përsa i përket pozicionimit të pronës, si dhe sipas dokumentacionit hartografi (planrilevimit të paraqitur) rezulton se objekti dhe trualli është në bashkëpronësi me R. M (Vendimi nr. 44, datë 23.05.2017).
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, A. M, S. H dhe G. H.
**8. Vendimi nr. 44, datë 23.05.2017**, "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe

përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, A. M dhe S. H dhe Relacioni Hartografik nga G. H.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor dhe hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij.
Lidhur me këtë pronë konstatohet se pozicionimi i saj para vitit 1991 nuk ekziston në këto kushte rezulton se nuk jemi para aplikimit të VKM-së nr. 608, përsa nuk plotësohet kushti i vërtetimit që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991 po ashtu nuk jemi para aplikimit të VKM-së përsa nuk ka asnjë dokument që vërteton në një mënyrë apo tjetër lidhjen me pasurinë. I vetmi dokument i disponuar në dosje është planrilevimit aktual i pasurisë i cili nuk përbën dokument provues.
Në këto kushte rezulton se vendimi nr. 44, datë 23.05.2017, në favor të M. M, është dhënë pa disponuar dokumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM-së përsa i përket pozicionimit të pronës, si dhe sipas dokumentacionit hartografi (planrilevimit të paraqitur) rezulton se objekti dhe trualli është në bashkëpronësi me M. M (Vendimi nr. 43, datë 23.05.2017).
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, A. M, S. H dhe G. H.

**9. Vendimi nr. 42, datë 23.05.2017**, "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, A. M dhe S. H dhe Relacioni Hartografik nga G. H.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor dhe hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij.
Lidhur me këtë pronë konstatohet se pozicionimi i saj para vitit 1991 nuk ekziston në këto kushte rezulton se nuk jemi para aplikimit të VKM-së nr. 608, përsa nuk plotësohet kushti i vërtetimit që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991 po ashtu nuk jemi para aplikimit të VKM-së përsa nuk ka asnjë dokument që vërteton në një mënyrë apo tjetër lidhjen me pasurinë. I vetmi dokument i disponuar në dosje është planrilevimit aktual i pasurisë i cili nuk përbën dokument provues.
Në këto kushte rezulton se vendimi nr. 42, datë 23.05.2017, në favor të A. M, është dhënë pa disponuar dokumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM-së përsa i përket pozicionimit të pronës, si dhe sipas dokumentacionit hartografi (planrilevimit të paraqitur) rezulton se objekti dhe trualli është në bashkëpronësi me Mamut dhe Ramadan Muhametaj (Vendimi nr. 43 dhe 44, datë 23.05.2017). Pra në kushtet kur një dokument provues për ekzistencën e objektit është përdorur për të tri pronarët.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, A. M, S. H dhe G. H.

**10. Vendimi nr. 49, datë 06.06.2017**, "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, A. M, dhe A. P dhe Relacioni Hartografik A. H.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij.
Lidhur me këtë pronë konstatohet se pozicionimi i saj para vitit 1991 nuk ekziston në këto kushte rezulton se nuk jemi para aplikimit të VKM-së nr. 608, përsa nuk plotësohet kushti i vërtetimit që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga qytetari (fotokopje) skicë planimetrike e shtëpisë bërë në vitin 1994 dhe planrilevimit aktual të konfirmuar nga bashkia rezulton se konfigurimi i objektit sipas dy akteve është i ndryshëm pra nuk jemi në kushtet e trajtimit ligjor. Po ashtu sipas relacionit hartografik të Adelina Ajdinaj konfirmohet se subjekti nuk dokumenton ekzistencën e ndërtimit para vitit 1991 pasi nuk ndodhet asnjë dokument hartografik por në dosje ndodhet deklaratë e vitit 1985 dhe vërtetim fakti juridik nr. 1477, datë 07.06.1996. këto dy dokumente të cituara nuk përbëjnë prova shkresore për pozicionimin e pronës objekt trajtimi.
Në këto kushte rezulton se vendimi nr. 49, datë 06.06.2017, në favor të L. J është dhënë pa disponuar dokumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM-së.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, A. M, A. H dhe A. P.
**11. Vendimi nr. 102, datë 18.12.2017**, "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, J. GJ dhe S. H dhe Relacioni Hartografik nga F. M.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument ligjor dhe hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij.
Lidhur me këtë pronë konstatohet se pozicionimi i saj para vitit 1991 nuk ekziston në këto kushte rezulton se nuk jemi para aplikimit të VKM-së nr. 608, përsa nuk plotësohet kushti i vërtetimit që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991 po ashtu nuk jemi para aplikimit të VKM-së përsa nuk ka asnjë dokument që vërteton në një mënyrë apo tjetër lidhjen me pasurinë.
Në këto kushte rezulton se vendimi nr. 102, datë 18.12.2017, në favor të F. K është dhënë pa disponuar dokumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM-së.
Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, J, GJ, S. H dhe F. M.
**12. Vendimi nr. 3, datë 12.01.2017**, "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, D. L. dhe përgatitur, hartuar e nënshkruar relacioni Teknik nga D. Z, A. SH, A. P dhe Relacioni Hartografik nga O. F.
Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se subjekti k ka paraqitur dokument hartografik mbi mënyrën e krijimit të sendit para vitit 1991 dhe dokumentimit të ekzistencës së tij, që vërteton se pasuria e llojit truall dhe objekt ka ekzistuar para vitit 1991 dhe konkretisht plansheteve për vitet 1976-1989.
Pavarësisht sa sipër rezulton gjithashtu se subjekti mbi pronën e sipër përshkruar ka ndërtuar pa leje pas vitit 1991, duke e rritur sipërfaqen e ndërtimit mbi dy fish të asaj të pasqyruar në hartat e para viteve 1990. Për këtë objekt sipas dokumenteve të disponuara në dosje dalë nga AQSH, shkresa 150, datë 20.02.1971, rezulton se ka vendim prishje objekti për ndërtim pa leje.
Pavarësisht sa cituar rezulton se trajtimi i kërkesës dhe vendimi nr. 3, datë 12.01.2017, është bërë në një kohë kur objekti sipas Vendimit nr. 232, datë 18.05.2016 të IMTV Bashkia Vlorë, marrë në bazë të VKM nr. 345, datë 04.05.2016, objekti "3 kate banimi dhe njësi shërbimi", është prishur për zbatimin e projektit të rrugës "Trans ballkanike faza e II-të".
Në këto kushte rezulton se Vendimi nr. 3, datë 12.01.2017 "Për kalimin në pronësi të pasurisë të paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të tij", dhënë në favor të S. B është dhënë pas prishjes së objektit nga IMTV.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në trajtimin e praktikës së më sipërme ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përbërë nga D. Z, A. SH, A. P dhe O. F.

Si konkluzion konstatohet se, praktikat e mësipërme nuk janë në zbatim të plotë të VKM-së nr. 608, datë 05.09.2012, "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie si dhe për regjistrimin e tyre", ndryshuar me VKM nr. 133, datë 11.02.2015 dhe VKM nr. 812, datë 16.11.2016, dhe konkretisht pikës 4 "Institucioni i autorizuar ngarkohet të kryejë procedurën paraprake për kalimin në pronësi të ndërtimeve, të pasurive të paluajtshme e të truallit funksional të tyre, subjekteve që plotësojnë kushtet e përcaktuara", si më poshtë vijon:
a) Objektit të ndërtuar t'i ketë përfunduar karabinaja dhe mbulesa deri më 10.8.1991;
b) Trualli funksional duhet të rezultojë fizikisht i lirë dhe i pazënë nga ndërtime pa leje, të cilat janë objekt i ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Madhësia e sipërfaqes së truallit funksional në posedim të përfituesit të jetë ajo që është miratuar sipas dispozitave ligjore ekzistuese deri në daljen e ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993 "Për urbanistikën".
c) Në rastet kur madhësia e sipërfaqes së truallit funksional në posedim të përfituesit është më e madhe se ajo që është miratuar sipas dispozitave ligjore ekzistuese deri në daljen e ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993 "Për urbanistikën", ajo sipërfaqe kalon në pronësi nga shteti tek individit sipas procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;
ç) Objekti, trualli nën të dhe trualli funksional, të mos jenë të regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme apo edhe kur janë të regjistruar, mungon akti i fitimit të pronësisë;
d) Objekti i ndërtuar dhe trualli funksional janë të pa trajtuar nga legjislacioni përkatës për njohjen, kthimin e kompensimin e pronës apo për legalizimin dhe urbanizmin e ndërtimeve pa leje.
5. Regjistrimi fillestar bëhet në mënyrë sistematike nga regjistruesi, një person ose grup personash të ngarkuar nga krye regjistruesi apo me kërkesë të individit. Nëse bëhet me kërkesë të individit, në zonat ku ka përfunduar regjistrimi fillestar, ajo depozitohet tek institucioni i autorizuar, e shoqëruar me dokumentet e mëposhtme:
ç) Dokumentin zyrtar, të lëshuar nga organet e pushtetit vendor brenda kompetencave të tyre, që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 1694/1, datë 06.03.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga ish-Drejtori i PPMA zj. A. C dhe ish-Inxhinieri O. F, sqarohet mbi procedurat e realizuara për vendimin nr. 31, datë 18.04.2017, vendimit nr. 55, datë 06.12.2016 dhe vendimit nr. 3, datë 12.01.2017, sqaroni procedurat e kryera nga ana juaj për të gjitha rastet si përsa i përket sipërfaqeve të dhëna, dokumentit hartografik të para viteve 1990, si dhe çdo dokumenti tjetër i cili ka shërbyer për vijim e praktikave. Po ashtu nga ana juaj është sqaruar edhe se për praktikën në emër të familjes B, procedura është bazuar në VKM nr. 608.*
*Nga grupi i auditimit merret në konsideratë sqarimi përkatës përsa i përket përgjegjësisë, por jo përsa i përket sipërfaqes së vendimit nr. 31, datë 18.04.2017 po ashtu edhe vendimit nr. 3, datë 12.01.2017, dhënë pas prishjes së objektit Argumentet merren në konsideratë pjesërisht*.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 1694/2, datë 06.03.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), nga Drejtori Juridik D. Z, A. P, A. G, A. H, J.*

*GJ, G. H dhe S. H, sqarohet mbi procedurat e realizuara për vendimet e marra sipas VKM nr. 608, datë 05.09.2012, sqaroni procedurat e kryera nga ana juaj për të gjitha rastet si përsa i përket sipërfaqeve të dhëna, dokumentit hartografik të para viteve 1990, gjendjes fizike të objekteve të verifikuara në terren, si dhe çdo provë apo dokumenti tjetër i cili ka shërbyer për vijim e praktikave.*
*Nga grupi i auditimit merret në konsideratë sqarimi përkatës përsa i përket përgjegjësisë, por jo përsa i përket sipërfaqes së vendimit nr. 31, datë 18.04.2017, vendimit nr. 3, datë 12.01.2017, dhënë pas prishjes së objektit, por dhe vendimeve të tjera të pasqyruara sa sipër. Argumentet merren në konsideratë pjesërisht.*

Procedurat dhe dokumentacioni i administruar për dhënien me qira të stacioneve të plazhit.
Në referim të VKM nr. 369, datë 18.05.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", VKM nr. 321, datë 28.5.2014 "Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore", ndryshuar me VKM nr. 436, datë 20.5.2015, 526, datë 17.6.2015 dhe 441, datë 17.5.2017, dhe konkretisht:
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në formatin hardcopy dhe elektronik (tabela me të dhënat e kontratave dhe pagesat respektive) nga punonjësit e Bashkisë Vlorë, dhe konkretisht, A. C, për vitin 2015, J. P për vitin 2016 dhe S. H për vitin 2017, ka rezultuar në referim të VKM nr. 369, datë 18.05.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", VKM nr. 321, datë 28.5.2014 "Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore", ndryshuar me VKM nr. 436, datë 20.5.2015, 526, dat2ë 17.6.2015 dhe 441, datë 17.5.2017, Bashkia Vlorë ka aplikuar dhënien në përdorim të përkohshëm të hapësirës së plazheve dhe konkretisht, sipas tabelave bashkëlidhur.
Më konkretisht, procedurat e realizuara nga Bashkia Vlorë, për secilin vit paraqitet si vijon:
Procedura e lidhjes së kontratave për hapësirë publike, Stacion plazhi viti 2015.
Referenca ligjore e përdorur nga Bashkia Vlorë për realizimin e 29 procedurave të vitit 2015, për sipërfaqen prej 11858 m2 dhe vlerë 2,325,000 lekë, rezulton VKM nr. 436, datë 20.05.2015 "Për disa ndryshime në vendimin nr.321, datë 28.05.2014 për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore", VKM nr. 526, datë 17.06.2015 "Për disa ndryshime në vendimin nr.321, datë 28.05.2014 për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore", të ndryshuar, VKB-së nr. 54, datë 11.12.2014 "Për sistemin e taksave vendore për vitin 2015",Urdhëri i Brendshëm nr. 68, datë 10.06.2015 i kryetarit të Bashkisë "Për dhënien me qira të hapësirave publike për përdorim stacion plazhi" i përbërë nga: A. M kryetar, A. SH anëtar, G. SH anëtar, O. F anëtar, LL. M anëtar, I. A anëtar dhe A. L anëtar sipas rajoneve, Autorizim nr. 2273 prot., datë 10.06.2016 me anë të cilit autorizohet nga kryetari i bashkisë A. M. për nënshkrimin e kontratave midis bashkisë dhe përdoruesit të hapësirës publike, Autorizim nr. 3092 prot., datë 12.08.2015 i kryetarit të bashkisë, me anë të cilit rikonfirmohet A. M personi i cili do të nënshkruajë kontratat, urdhër i brendshëm nr. 75, datë 29.06.2015 "Për verifikimin e sipërfaqeve dhe gjendjes reale në terren, të hapësirës publike për përdorim stacion plazhi", i përbërë nga O. F, F. D dhe A. Z anëtar.

Lidhur me procedurat e ndjekura për monitorimin e kontratave dhe verifikimet në terren për respektimin e kushteve dhe sipërfaqes të marrë në përdorim të përkohshëm:

Me shkresën e datës 30.06.2015, janë kryer verifikime në terren nga komisioni i ngritur me urdhërin e kryetarit nr. 75, datë 29.06.2015 për sipërfaqet faktike të subjekteve që kanë paraqitur kërkesë në bashki dhe kontratat ju janë lidhur sipas sipërfaqeve faktike, të cilat kanë rezultuar më tepër se çfarë ishte kërkuar në kërkesat e tyre.
Nga dokumentacioni i vënën në dispozicion nga A. SH, rezultoi se në lidhje me monitorimin e kontratave të lidhura në datën 22.07.2015, nga struktura e ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë është kryer verifikim në terren në zonën e Jonufrës, ku dhe kanë rezultuar subjekte të cilat ushtronin aktivitet pa u pajisur me kontratë nga bashkia.
Shkresa me A.K.B dhe institucione të tjera për bashkëpunim:
Nga dokumentacioni ka rezultuar se me shkresën nr. 2872, datë 24.07.2015 Bashkia Vlorë i është drejtuar AKB-së dhe për dijeni Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë për bashkëpunim ne lidhje me subjektet të cilat nuk kanë lidhur kontratë me Bashkinë Vlorë.
Po ashtu me shkresën nr. 2930 prot., datë 28.07.2015, Bashkia Vlorë i është drejtuar Hetimit Tatimor për Rajonin e Jugut për bashkëpunim, për subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me ligjin.
Me shkresat nr. 2871 prot., datë 24.07.2015 drejtuar Drejtorisë së Taksave dhe me shkresën nr. 2873 prot., datë 24.07.2015 drejtuar Policisë Bashkiake, rezulton se këto drejtori janë njoftuar për subjektet të cilat kanë lidhur kontratë me bashkinë për përdorim të hapësirës publike dhe është kërkuar nga komisioni i plazheve bashkëpunim deri në lirimin e hapësirave publike për subjektet të cilat ushtrojnë aktivitet sezonal pa u pajisur me kontratë nga bashkia.
Kontratat e lidhura për vitin 2015 janë sipas tabelës bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.

Nga shqyrtimi i procedurave dhe dokumentacionit të paraqitur nga vet subjektet kërkuese por dhe atij të prodhuar e administruar nga Bashkia Vlorë, strukturat përgjegjëse, si konstatim i përgjithshëm vlen të theksohet fenomeni i dhënies në përdorim të gjithë hapësirës së plazhit, duke mos respektuar kriterin bazë të VKM-së nr.321, datë 28.05.2014, lidhur me raportin 80% sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 20 % sipërfaqe në përdorim publike. Ky konstatim referohet në planvendosje respektive të depozituara nga subjektet kërkues ku në asnjë rast nuk përcaktojnë pjesën e sipërfaqes publike prej 20%. Po ashtu në asnjë rast nuk ka të dhëna në planvendosje lidhur me pozicionin fizik të vendosjes të çadrave, me qëllim për të ruajtur, respektuar e zbatuar distancat e përcaktuara sipas VKM-së nr.321, datë 28.05.2014 apo edhe vend depozitimin e mbetjeve ditore të krijuara nga pushuesit.

Nga auditimi rezultoi gjithashtu së në 6 raste, për subjektet e mëposhtme nuk janë lidhur kontrata për mosplotësim dokumentacioni edhe pse ju është vjelë detyrimi për sipërfaqen që kanë shfrytëzuar, kjo sipas konstatimeve të evidentuara nga grupi i monitorimit në terren dhe konkretisht:
M. T ka paguar detyrimin 230.000 lekë për 1150 m2
O. B ka paguar detyrimin 59.000 lekë për 295 m2
A. M ka paguar detyrimin për 16.000 lekë për 80 m2
S. M ka paguar detyrimin për 10.000 lekë për 50 m2
V. H ka paguar detyrimin për 100.000 lekë për 500 m2
E. M ka paguar detyrimin për 10.000 lekë për 200 m2
Në dosjen e vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultuan edhe subjekte kërkesat e të cilëve nuk ishin të miratuara për mungesë dokumentacioni, dhe konkretisht:

E. V për kërkesën me nr. 841, datë 16.07.2015, A. S për kërkesën me nr. 835, datë 14.07.2015, I. M për kërkesën me nr. 778, datë 19.06.2015. E. N për kërkesën datë 26.05.2015, T. B për kërkesën datë 03.07.2015, L. M për kërkesën datë 21.05.2015, Z. H, M. M, F. V dhe A. M, kërkesa të refuzuara kryesisht për mungesë në dokumentacion por edhe për shkak të konstatimit se territori objekt kërkesa ka rezultuar si hapësirë publike e përjashtuar nga harta e plazheve të miratuar sipas VKM-së.
Në secilën kontratë sipas nenit 3 "Vlefta e Kontratës", përcaktohet se sipërfaqja e hapësirës publike është sipas plan vendosjes bashkëngjitur kësaj kontrate. Ky referim rezulton i pa vërtetë pasi në asnjë nga praktikat e audituara, kontratat nuk kanë të bashkëlidhur ndonjë dokument hartografik apo planrilevimi si shtojcë të kontratës.
Për të gjitha praktikat e audituara, si ato me problematika të sipërcituara ashtu edhe ato të cilat nuk kishin mangësi në dokumentacionin e administruar, konstatohet se janë në kundërshtim me Urdhrin e Brendshëm nr. 68, datë 10.06.2015 dhe 75, datë 29.06.2015, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë D. L. "Për dhënien me qira të hapësirave publike për veprimtarinë e stacioneve të plazhit", pasi në asnjë rast nuk rezulton që nga komisioni i shqyrtimit të sipërfaqeve dhe gjendjes reale në terren të hapësirës publike, nuk ka hartuar planvendosje për çdo kërkesë e cila i duhej bashkëngjitur secilës kontratë, çka ngarkon me përgjegjësi Komisionin e shqyrtimit të kërkesave, pasi ka vepruar pa u realizuar ky proces por dhe komisionin e shqyrtimit të sipërfaqeve të cilët nuk kanë përmbushur urdhrin e titullarit të bashkisë.

Procedura e lidhjes së kontratave për hapësirë publike, Stacion plazhi viti 2016.
Referenca ligjore e përdorur nga Bashkia Vlorë për realizimin e 136 procedurave të vitit 2016, për sipërfaqen prej 48937 m2 dhe vlerë28,198,750 lekë, rezulton VKM nr. 369, datë 18.05.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", Urdhri i Brendshëm nr. 152, datë 27.05.2016 i kryetarit të Bashkisë "Për dhënien me qira të hapësirave publike për veprimtarinë e stacioneve të plazhit" i përbërë nga: J. P kryetar, A. SH anëtar dhe P. TH anëtar, si dhe urdhër i verifikimit në terren.
Mbas nënshkrimit të kontratave për hapësirë publike, subjektet qiramarrës janë njoftuar për detyrimet qe u lindin nga zbatimi i kontratës, njoftime të cilat janë bërë nga punonjësit e bashkisë LL. M dhe F. B, ku rezulton se çdo subjekt ka firmosur për njoftimin e marrë në datën 08.08.2016.
Nga komisioni i verifikimit të sipërfaqes në terren për subjektet të cilat kanë rezultuar se përdorin më tepër sipërfaqe janë njoftuar për pagesën e detyrimeve që lindin nga përdorimi i hapësirës publike.
Për çdo kontratë të lidhur bashkia Vlorë në zbatim të nenit 9, pika 4 e Shtojcës 2 "Kontratës së qirasë", miratuar me V.K.M-në 369, datë 18.05.2016 "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" ka njoftuar Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si dhe Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, Tiranë me shkresat si më poshtë:
Shkresa nr. 5817, datë 12.07.2016 AKB është njoftuar mbi numrin e kontratave të lidhura me objekt "Kontratë qiraje për përdorimin e hapësirës publike", duke ju vendosur edhe një kopje të kontratave 10 kontrata.
Shkresa nr. 5934, datë 15.07.2016 është njoftuar mbi numrin e kontratave të lidhura me objekt "Kontratë qiraje për përdorimin e hapësirës publike", duke ju vendosur edhe një kopje të kontratave 9 kontrata.
Me shkresën nr. 5952/1, datë 21.07.2016 është përgjigjur për AKB për shkresën 535, datë 13.07.2016 për 5 kontrata të lidhura, bashkë me një kopje të këtyre kontratave.

Shkresa nr. 8189, datë 05.10.2016 janë njoftuar institucionet e mësipërme për 63 kontrata të lidhura.
Nga shqyrtimi i tabelës së dërguar nga J. P dhe dokumentacionit të dorëzuar prej tij rezulton se ka subjekte të cilat kanë paguar detyrimin për hapësirën publike, por nuk ju është nënshkruar kontratë për mungesë dokumentacioni.
Kontratat që u pamë nga përfaqësuesit e KLSH vihet re në asnjë rast nuk përcaktohen në planvendosje e dorëzuara nga subjektet kërkues vendosja e çadrave duke ruajtur largësinë e përcaktuar në VKM nr. 321.
Kontratat e plazheve të lidhura për Bashkinë Vlorë në vitin 2016, janë sipas tabelës bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.
Lidhur me nivelin e zbatimit dhe arkëtimit të ardhurave nga qiraja rezultoi se 18 nga 136 subjekte nuk kanë shlyer pjesërisht apo plotësisht detyrimet sipas kontratës apo aktmarrëveshjeve tip, duke krijuar një efekt financiar negative si pasojë e mospërmbushjes të detyrimeve kontraktore në vlerën prej 2,675,500 lekë shumë e cila përbën të ardhura të munguara me dëm ekonomik për buxhetin e NJQV veprime në kundërshtim me VKM nr.369, datë 18.05.2016 dhe për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Stacioneve të Plazhit për vitin 2016, J. P, A. SH dhe P. TH si dhe Drejtori i Menaxhimit Financiar T. Z.
Në secilën kontratë sipas nenit 1 "Objekti i Kontratës", përcaktohet sipërfaqja e hapësirës së dhënë me qira, si dhe harta bashkëlidhur, si shtojca 1 e kontratës. Ky referim rezulton i pa vërtetë pasi në asnjë rast kontratat nuk kanë të bashkëlidhur ndonjë dokument hartografik apo planrilevimi si shtojcë të kontratës.
Për të gjitha praktikat e audituara, si ato me problematika të sipërcituara ashtu edhe ato të cilat nuk kishin mangësi në dokumentacionin e administruar, konstatohet se janë në kundërshtim me Urdhrin e Brendshëm 152, datë 29.07.2015, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë D. L. "Për dhënien me qira të hapësirave publike për veprimtarinë e stacioneve të plazhit", pasi në asnjë rast nuk rezulton që nga komisioni i shqyrtimit të sipërfaqeve dhe gjendjes reale në terren të hapësirës publike, nuk ka hartuar planvendosje për çdo kërkesë e cila i duhej bashkëngjitur secilës kontratë, çka ngarkon me përgjegjësi Komisionin e shqyrtimit të kërkesave, pasi ka vepruar pa u realizuar ky proces por dhe komisionin e shqyrtimit të sipërfaqeve të cilët nuk kanë përmbushur urdhrin e titullarit të bashkisë.

Procedura e lidhjes së kontratave për hapësirë publike, Stacion plazhi viti 2017.
Referenca ligjore e përdorur nga Bashkia Vlorë për realizimin e 155 procedurave të vitit 2017, për sipërfaqen prej 36250 m2 dhe vlerë17,238,200 lekë me referencë ligjore VKM nr. 369, datë 18.05.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", Urdhri i Brendshëm nr. 126, datë 07.07.2017, i Kryetarit të Bashkisë Vlorë D. L. "Për dhënien me qira të hapësirave publike për veprimtarinë e stacioneve të plazhit" i përbërë nga S. H, Kryetare dhe E. B e A. F anëtare, si dhe komision të shqyrtimeve të sipërfaqeve dhe gjendjes reale në terren i përbërë nga I. A, administrator i rajonit nr. 2, A. L, administrator i rajonit nr. 4, M. S NJA Orikum, M. K NJA Qendër, K. SH NJA Novoselë, LL. M, Inspektor Rajoni nr. 2, R. M, Inspektor Rajoni nr. 4, K. A dhe A. M.

Lidhur me sa proceduar është konstatuar se me shkresën nr. 222, datë 07.04.2017, të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, drejtuar Bashkisë Vlorë është informuar institucioni për:

Çdo njësi e qeverisjes vendore, qe ka në përgjegjësi administrimi dhe që është subjekt autorizimi për përdorim, të lërë në dispozicion për "plazh publik" 20% të territorit të përgjithshëm të plazhit. Plazhi publik të menaxhohet dhe të jetë në administrim të njësisë së qeverisjes vendore. Shpërndarja për stacionet e plazhit publik dhe privat të bëhet në mënyrë proporcionale, bazuar në VKM –në 321, datë 28.05.2014.
Për rinovimin e kontratës subjekti duhet të ketë përmbushur të gjitha detyrimet sipas kontratës së qirasë të lidhur me njësinë e qeverisjes vendore dhe ti paraqesë kësaj të fundit, bashkë me kërkesën edhe dokumentacion shoqërues si më poshtë:
Dokumentin monitorues të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Inspektoratit Përgjegjës për Turizmin në lidhje me zbatimin e rregullt të kushteve dhe kritereve për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit dhe të përmbushjes së detyrimeve sipas kësaj rregulloreje.

Me shkresën nr. 88/4, datë 19.04.2017, Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka dërguar në bashkinë Vlorë "Dokumente monitorimi për subjektet në plazhe" (shkresë e administruar në dosje si fotokopje e skanuar), ku bashkëlidhur saj janë tabelat me emrat e subjekteve për bashkinë Vlorë.
Me shkresën nr. 271, datë 25.04.2017 është njoftuar Bashkia Vlorë "Për zbatimin e VKM-së nr.369, datë 18.05.2016 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", ku në këtë shkresë AKB kërkon të mbahen parasysh dokumentet e monitorimit për vitin 2016, për subjektet përpara se të procedohet me lidhjen e kontratave për sezonin veror 2017.
Nga monitorimi i bërë nga AKB në këtë shkresë citohet se asnjë nga subjektet nuk ka plotësuar të gjitha detyrimet qe burojnë nga kontrata e qirasë së lidhur me njësinë vendore.
Kontratat e plazheve të lidhura për Bashkinë Vlorë për vitin 2017 janë sipas tabelave bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.

Konkretisht në shqyrtimin e kontratave të vitit 2017 situata referuar dokumentacionit të dorëzuar në format elektronik (lista e subjekteve dhe vlera e detyrimit të paguar) dhe dosjet fizike, nga S. H, me detyrë Specialiste Juriste në funksionin e Kryetares së Komisionit të Plazheve, rezulton si më poshtë:
**Kontrata me nr. 7134 prot., datë 14.08.2017 në emër të V. N** në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen 200 m2
Lidhur me këtë kontratë, rezulton se edhe pse kontrata është lidhur për 200 m2, vlera e pagesës nuk është bërë sipas saj por pagesa është bërë për 300 m2. Po ashtu në Mungon plan biznesi dhe planvendosje ku do të zhvillohet aktiviteti sezonal plazh. Për këtë subjekt vërehet se kontrata apo menaxhimi nuk është bërë në përputhje me sipërfaqen e shfrytëzuar, pasi konstatohet se për vitin 2015 ky subjekt ka pasur në përdorim sipas kontratës respektive 600më, për vitin 2016 ka lidhur kontratë për 330 m2 dhe aktualisht 200 m2 e paguar për 300 m2.
**Kontrata me nr. 6816, datë 02.08.2017 në emër të A. D** në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen 300 m2 me afat 4 mujor.
Lidhur me këtë kontratë rezulton se komisioni i vitit 2017, ndryshe nga dy komisionet e mëparshme (vitet 2015 dhe 2016) të cilët kanë lidhur kontrata me po të njëjtin subjekt për sipërfaqen e shfrytëzuar të hapësirës publike prej 700 m2, komisioni aktual e ka uluar atë në 300 m2. Duke qenë se sipërfaqja e shfrytëzueshme është po e njëjta për secilin vit, rezulton se subjektit i është lënë në përdorim pa kontratë diferenca prej 400 m2, çka përbën edhe të ardhura të munguara për vlerën prej 200,000 lekë (400m2x500lekë).

Lidhur me këtë kontratë nuk na u vu në dispozicion asnjë raport monitorimi lidhur me zbatimin e saj, për të saktësuar nëse sipërfaqja sipas kontratës me atë në terren i korrespondojnë të njëjës sipërfaqe të shfrytëzueshme, apo subjekti edhe pse ka me kontratë 300 m2, shfrytëzon 700 m2 apo edhe më shumë.
**Kontrata me nr. 6817, datë 02.08.2017 në emër të M. T** në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen 780 m2 me afat 15.05.2017 – 30.09.2017.
Lidhur me këtë kontratë rezulton se komisioni i vitit 2017, ndryshe nga dy komisionet e mëparshme (vitet 2015 dhe 2016) të cilët kanë lidhur kontrata me po të njëjtin subjekt për sipërfaqen e shfrytëzuar të hapësirës publike fillimisht për sipërfaqen prej 1150 m2, dhe 1300m2 në vitin 2016, komisioni aktual e ka uluar atë në 780 m2. Duke qenë se sipërfaqja e shfrytëzueshme është po e njëjta për secilin vit, rezulton se subjektit i është lënë në përdorim pa kontratë diferenca prej 520 m2, çka përbën edhe të ardhura të munguara për vlerën prej 260,000 lekë (520m2x500lekë).
Lidhur me këtë kontratë nuk na u vu në dispozicion asnjë raport monitorimi lidhur me zbatimin e saj, për të saktësuar nëse sipërfaqja sipas kontratës me atë në terren i korrespondojnë të njëjës sipërfaqe të shfrytëzueshme, apo subjekti edhe pse ka me kontratë për sipërfaqen 780 m2, shfrytëzon 1300 m2 apo edhe më shumë.
Po ashtu në dosjen përkatëse ka rezultuar se mungon plan biznesi lidhur me sipërfaqen e marrë në shfrytëzim si dhe mungon vërtetimi për detyrimet tatimore, pra kontratë është lidhur duke mos u disponuar sipas kërkesave të VKM-së.
Kontrata me nr. 6813, datë 02.08.2017 në emër të A. M, në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen 200 m2 me afat 15.05.2017 – 30.09.2017.
Për këtë kontratë konstatohet se në dosjen përkatëse mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore si dhe vërtetimet e lëshuara nga organi i prokurorisë dhe administrata e gjykatës.
**Kontrata me nr. 6798, datë 02.08.2017 në emër të F. S**, në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen 500 m2.
Lidhur me këtë kontratë, rezulton se në dosjen përkatëse, mungon i gjithë dokumentacioni ligjor e teknik, pra kontrata është lidhur vetëm në bazë të mandat pagesës dhe faturës për arkëtim pa respektuar asnjë kërkesë të VKM-së 369, datë 18.05.2016.
Kontrata me nr. 6821, datë 02.08.2016 në emër të V. H në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen 400 m2 me afat 15.05.2017 – 30.09.2017.
Lidhur me këtë kontratë, rezulton se në dosjen përkatëse, mungon i gjithë dokumentacioni ligjor e teknik, pra kontrata është lidhur vetëm në bazë të mandat pagesës dhe faturës për arkëtim pa respektuar asnjë kërkesë të VKM-së 369, datë 18.05.2016.
Lidhur me këtë kontratë rezulton se komisioni për vitet 2016 dhe 2017, për po të njëjtin subjekt dhe sipërfaqe territori të vënë në shfrytëzim, ka lidhur kontratë duke e ulur atë pasi nga 500 m2 në vitin 2015 sipërfaqja është zbritur me 100 m2 duke u kontraktuar vetëm për 400 m2.
Duke qenë se sipërfaqja e shfrytëzueshme është po e njëjta për secilin vit, rezulton se subjektit i është lënë në përdorim pa kontratë diferenca prej 100 m2, çka përbën edhe të ardhura të munguara për vlerën prej 170,000 lekë (100m2x500lekë për vitin 2017 dhe 100m2x200x3muaj për vitin 2016).
Lidhur me këtë kontratë nuk na u vu në dispozicion asnjë raport monitorimi lidhur me zbatimin e saj, për të saktësuar nëse sipërfaqja sipas kontratës me atë në terren i korrespondojnë të njëjës sipërfaqe të shfrytëzueshme, apo subjekti edhe pse ka me kontratë sipërfaqen 400 m2, shfrytëzon 500 m2 apo edhe më shumë se vitet e mëparshme.

**Kontrata me nr. 7136, datë 14.08.2017 në emër të S. S** në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen 550 m2 me afat 15.05.2017 – 30.09.2017.
Lidhur me këtë kontratë, rezulton se në dosjen përkatëse, mungon i gjithë dokumentacioni ligjor e teknik, pra kontrata është lidhur vetëm në bazë të mandat pagesës dhe faturës për arkëtim pa respektuar asnjë kërkesë të VKM-së 369, datë 18.05.2016.
**Kontrata me nr. 6815, datë 02.08.2017 në emër të D. D** në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen për sipërfaqen 700 m2 me afat 15.05.017 – 30.09.2017.
Lidhur me këtë kontratë, rezulton se në dosjen përkatëse, mungon i gjithë dokumentacioni ligjor e teknik, pra kontrata është lidhur vetëm në bazë të mandat pagesës dhe faturës për arkëtim pa respektuar asnjë kërkesë të VKM-së 369, datë 18.05.2016.
Pagesa në emër të subjektit "B.....L" , përfaqësuar nga B. B në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen 2500 m2 me afat 15.05.017 – 30.09.2017 dhe vlerë 1,250,000 lekë.
Lidhur me këtë kontratë, rezulton se në dosjen përkatëse, mungon i gjithë dokumentacioni ligjor e teknik, si dhe nuk ka kontratë të lidhur për këtë qëllim. Në dosje ndodhet vetëm mandatë pagesa për vlerën prej 1,250,000 lekë, bërë më datë 30.08.2017 nga subjekti i sipërcituar, si dhe fatura për arkëtim nr. 162, datë 07.08.2017 lëshuar nga S. H për subjektin B. B për sipërfaqen prej 1,250,000 lekë, me emërtimin "qira e përdorimit të hapësirës publike për plazh për sezonin turistik 15 maj-30 shtator 2017", veprime në kundërshtim të plotë me VKM-së 369, datë 18.05.2016 dhe për të cilat ngarkohet me përgjegjësi S. H.
Lidhur me këtë subjekt konstatohet se për vitin 2016, vlera e paguar është 900,000 lekë për sipërfaqen prej 1500m2. Për praktikë në dosjen e vënë në dispozicion nga J. P, për kontratat e vitit 2016, nuk rezultoi asnjë dokumentacion lidhur me kontratën e qirasë dhe dokumentet e tjera sipas VKM-së 369, datë 18.05.2016 edhe pse duhet të jetë hartuar një e tillë, supozim i referuar në Dokumentin Monitorues nr. 178, datë 05.09.2016 të MZHETTS, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, e cila rezulton se ka bërë monitorimin për subjektin "B.....R", B. B, pavarësisht sa cituar, rezulton se sipërfaqja e referuar në pagesa nuk është e njëjtë pasi për vitin 2016 ka paguar për sipërfaqen prej 1500m2 ndërsa për vitin 2017 për sipërfaqen prej 2500 m2, edhe pse kjo sipërfaqe rezulton po e njëjta përsa i përket përdorimit e shfrytëzimit të tij për këto periudha kohore, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për vlerën prej 600,000 lekë (1000m2x200lekëx3muaj), veprime në kundërshtim me VKM nr.369, datë 18.05.2016 dhe për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Stacioneve të Plazhit për vitin 2016, J. P, A. SH dhe P. TH, si dhe Drejtori i Menaxhimit Financiar T. Z..
**Kontrata me nr. 6358 prot., datë 19.07.2017 në emër të O. V** në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen prej 800 m2 me afat 15.05.2017 – 30.09.2017 (C.....O).
Lidhur me këtë kontratë rezulton se fillimisht komisioni për vitin 2015 ka lidhur kontratë në emër të A. R në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen prej 1020 m2. Më tej komisioni i vitit 2016, rezulton se nuk ka lidhur asnjë kontratë qiraje për këtë sipërfaqe të shfrytëzueshme, për këtë subjekt apo për ndonjë subjekt tjetër, duke sjellë për pasojë lejimin e subjekteve të përdorin pa kundërshpërblim sipërfaqen prej 1020m2 e për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për vlerën prej 612,000 lekë (1020m2x200lekëx3muaj), veprime në kundërshtim me VKM nr.369, datë 18.05.2016 dhe për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Stacioneve të Plazhit për vitin 2016.

Kontrata e vitit 2017 është për po të njëjtën pronë me të njëjtën sipërfaqe të shfrytëzueshme, por në ndryshim nga viti 2015, lidhja e saj nuk është bërë për sipërfaqen prej 1020 m2, por për sipërfaqen prej 800m2, ose më pak 220 m2.
Duke qenë se sipërfaqja e shfrytëzueshme është po e njëjta për secilin vit, rezulton se subjektit i është lënë në përdorim pa kontratë diferenca prej 220 m2, çka përbën edhe të ardhura të munguara për vlerën prej 110,000 lekë (220m2x500lekë).
Lidhur me këtë kontratë nuk na u vu në dispozicion asnjë raport monitorimi lidhur me zbatimin e saj, për të saktësuar nëse sipërfaqja sipas kontratës me atë në terren i korrespondojnë të njëjës sipërfaqe të shfrytëzueshme, apo subjekti edhe pse ka me kontratë sipërfaqen 800 m2, shfrytëzon 1020 m2 apo edhe më shumë se vitet e mëparshme.
Kontrata me nr. 6818, datë 02.08.2017 në emër të A. K në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen prej 500 m2 me afat 15.05.2017 - 30.09.2017.
Lidhur me këtë kontratë rezulton se komisioni i vitit 2017, ndryshe nga komisioni i mëparshëm të cilët kanë lidhur kontrata me po të njëjtin subjekt për sipërfaqen e shfrytëzuar të hapësirës publike prej 1200 m2, komisioni aktual e ka uluar atë në 500 m2. Duke qenë se sipërfaqja e shfrytëzueshme është po e njëjta për secilin vit, rezulton se subjektit i është lënë në përdorim pa kontratë diferenca prej 700 m2, çka përbën edhe të ardhura të munguara për vlerën prej 350,000 lekë (700m2x500lekë).
Lidhur me këtë kontratë nuk na u vu në dispozicion asnjë raport monitorimi lidhur me zbatimin e saj, për të saktësuar nëse sipërfaqja sipas kontratës me atë në terren i korrespondojnë të njëjës sipërfaqe të shfrytëzueshme, apo subjekti edhe pse ka me kontratë për sipërfaqen 500 m2, shfrytëzon 1200 m2 apo edhe më shumë.
Kontrata nr. 6793, datë 02.08.2017 në emër të D. N, në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen prej 200 m2, edhe pse rezulton me dosje dhe pagesë të shlyer, nuk rezulton e përfshirë në tabelën e dhënë nga S. H, çka tregon për mungesë të përgjegjësisë në raport me vet institucionin por dhe grupin e auditimit.
Kontrata me nr. 6352, datë 19.07.2017 në emër të A. S në cilësinë e palës qiramarrëse/përdoruese të stacionit të plazhit për sipërfaqen prej 800 m2.
Lidhur me këtë kontratë nuk na u vu në dispozicion asnjë dokumentacion i paraqitur nga subjekti, por vetëm ai i vitit 2016 (fotokopje e dokumenteve), pra në dosjen përkatëse, mungon i gjithë dokumentacioni ligjor e teknik, pra kontrata është lidhur vetëm në bazë të mandat pagesës dhe faturës për arkëtim, pa respektuar asnjë kërkesë të VKM-së 369, datë 18.05.2016.
Në mënyrë të përmbledhur për të gjitha praktikat e dhënies me qira të stacioneve të plazhit për Njësinë Orikum, në dosjet respektive mungojnë pagesat përkatëse, edhe pse nga Kryetarja e Komisionit janë deklaruar se nuk ka detyrime të papërmbushura.
Për dosjet e Njësisë Administrative Qendër, ka rezultuar se në 6 raste, janë lejuar subjektet të përdorin territorin e njësisë administrative, pa një kontratë përkatëse, edhe pse në 4 nga 6 raste subjektet kanë përmbushur detyrimin përsa i përket sipërfaqes së pretenduar si të marrë në përdorim të përkohshëm, por çka mbetet e pa vërtetuar përsa nuk ka asnjë aktkontrollit apo raport monitorimi.
Në secilën kontratë sipas nenit 1 "Objekti i Kontratës", përcaktohet sipërfaqja e hapësirës së dhënë me qira, si dhe harta bashkëlidhur, si shtojca 1 e kontratës. Ky referim rezulton i pavërtetë pasi në asnjë rast kontratat nuk kanë të bashkëlidhur ndonjë dokument hartografik apo planrilevimi si shtojcë të kontratës.

Për të gjitha praktikat e audituara, si ato me problematika të sipërcituara ashtu edhe ato të cilat nuk kishin mangësi në dokumentacionin e administruar, konstatohet se janë në kundërshtim me Urdhrin e Brendshëm nr. 126, datë 07.07.2017, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë D. L. "Për dhënien me qira të hapësirave publike për veprimtarinë e stacioneve të plazhit", pasi në asnjë rast nuk rezulton që nga komisioni i shqyrtimit të sipërfaqeve dhe gjendjes reale në terren të hapësirës publike, nuk ka hartuar planvendosje për çdo kërkesë e cila i duhej bashkëngjitur secilës kontratë, çka ngarkon me përgjegjësi Komisionin e shqyrtimit të kërkesave, pasi ka vepruar pa u realizuar ky proces por dhe komisionin e shqyrtimit të sipërfaqeve të cilët nuk kanë përmbushur urdhrin e titullarit të bashkisë.

Lidhur me subjektet debitorë, sipas informacionit të dhënë nga Kryetarja e Komisionit të stacioneve të plazheve për vitin 2017, zj. S. H, deklarohet se janë 4 subjekte, për vlerë të cilat nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore për sa i përket pagesës së vlerës së qirasë, dhe më konkretisht, sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr | Emër | Mbiemër | Vendndodhja | Sipërfaqja | Çmim | vlera | Detyrimi | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | E | B | ORIKUM | 600 | 500 | 300000 | 300000 | |
| 2 | E | Z | Jonufer | 800 | 500 | 400000 | 400000 | |
| 3 | A | D | Uji i Ftohte | 300 | 500 | 150000 | 150000 | Kristal |
| 4 | B | Z | Radhime | 76 | 500 | 38000 | 38000 | |
| | | | | 1776 | 500 | 888000 | 888000 | |

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se vetëm subjekti B. Z, figuron në listën e shënuar në tabelë dhe të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, ndërsa subjektet e tjera edhe pse janë pasqyruar si debitorë, nuk rezulton të kenë kontrata apo aktmarrëveshje për shfrytëzimin e territorit, duke sjellë për pasojë të ardhura të munguar në vlerën prej 888,000 lekë, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i vlerësimit të kërkesave Kryetarja e tij S. H dhe anëtarët A. F dhe E. B, si dhe Drejtori i Menaxhimit Financiar T. Z..

Në përfundim konstatohet se nga Bashkia Vlorë dhe në veçanti Komisioni i ngritur për zbatimin e VKM-së nr.369, datë 18.05.2016, nuk ka arritur të vë në shfrytëzim maksimal resurset e njësisë, për faktin se të ardhurat nga dhënia e stacioneve të plazhit ka rënie të konsiderueshme duke u krahasuar me vitin paraardhës kjo për faktin se sipërfaqja ka ardhur duke u zvogëluar ndjeshëm, kështu nga të dhënat tabelare të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, nga 4.9 ha në vitin 2016 është zbritur në 3.6 ha në vitin 2017, kjo edhe për faktin se një pjesë e kontratave të lidhura nga viti në vitin janë me ulje të sipërfaqeve; ka lejuar subjektet të përdorin pa kontratë por duke kryer pagesat në rastin më të mirë apo pa kontratë e pa kundërshpërblim në raste të tjera; ka lidhur kontrata me subjekte të cilët janë pa dokumentacionin e plotë apo në disa raste me subjekte të cilët nuk kanë të paraqitur asnjë lloj dokumentacioni të përcaktuar në VKM; nuk kanë kryer për asnjë rast verifikimin apo monitorimin e kontratave kjo si në fazën e para të shqyrtimit e miratimit të kërkesës asht edhe pas nënshkrimit të kontratave; nuk ka raportuar në AKB lidhur me kontratat e nënshkruara si dhe nuk ka administruar raportet e tyre të monitorimit; nuk ka marrë në vlerësim rekomandimet e AKB lidhur me monitorimin e kontratave të vitit paraardhës për subjektet të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet kontraktore e ligjore, kontratat nuk kanë të bashkëlidhur planvendosjen përkatëse si dhe nuk ka planvendosje të miratuar por vetëm planvendosje të paraqitur nga secili kërkues, veprime apo mosveprime në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.369, datë 18.05.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet

dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", Komisioni i Stacioneve të Plazhit, Kryetarja e tij S. H dhe anëtarët A. F dhe E. B.

Konstatime të përgjithshme lidhur me parregullsitë apo shkeljet e konstatuara në zbatimin e kritereve nga të tri komisionet dhe konkretisht atë të vitit 2015 të drejtuar nga A. M, dokumentacioni i të cilit grupit të auditimit ju vu në dispozicion nga A. SH (viti 2015), komisioni i vitit 2016 i drejtuar nga J. P, i cili vuri në dispozicion të grupit të auditimit dokumentacionin dhe procedurat respektive si dhe dokumentacione e procedurat e vitit 2017 të vëna në dispozicion të grupit të auditimit nga kryetarja e komisionit S. H, nga ku u konstatua se:
Për secilin vit të zbatimit të VKM-së për dhënien me qira të hapësirave publike për stacione plazhi, Urdhri i Brendshëm i Kryetarit të Bashkisë Vlorë, D. L., për ngritjen e komisionit të plazheve nuk i është përgjigjur në kohë kërkesave ligjore, përsa ky urdhër është ngritur pas fillimit të sezonit turistik, madje në muajin e tretë të tij. Ky fenomen ka sjellë për pasojë mos mbulim të plotë të territorit dhe mospasjen e kohës së mjaftueshme fizike nga komisioni për vlerësimin e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre si dhe verifikimit në terren të territorit të pretenduar për tu marrë me qira, që në momentin e vlerësimit të kërkesës dhe përllogaritjes së sipërfaqes së marrë me qira e më tej nënshkrimin e kontratës.
Konstatohen raste të mos zbatimit të pikës 7 të VKM-së nr. 369, datë 18.05.2016, sipas të cilës "Përveçse kur zbatohen kritere të tjera të përcaktuara në legjislacionin për vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për projekte investuese në zonat me përparësi turizmin, hapësirat e plazhit të dhënë në përdorim për stacione plazhi nuk mund të jenë më të vogla se 200 m² dhe më të mëdha se 5000 m²", pasi sipas tabelës, vetëm për vitin 2017 janë mbi 35 raste ku sipërfaqja në përdorim është më e vogël se 200m2.
Për kontratat 2015-2017, ka rezultuar gjithashtu se pagesa për sipërfaqen publike të marrë në shfrytëzim për stacione plazhi është kryer në muajt korrik deri në gusht edhe pse afatet sipas çdo kontrate respektive fillojnë në muajin maj. Për këtë arsye kontratat mbajnë numrin dhe datën e protokollit (muaji korrik) por në asnjë rast datën e nënshkrimit të saj, si dhe sipas nenit 3 "kohëzgjatja", pika 1 "kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme për një periudhë për 4 muaj e gjysmë 15.05.2017 deri më 13.09.2017".
Në planvendosje e dorëzuara nga subjektet kërkues për shfrytëzim të hapësirës publike stacion plazhi nuk përcaktohet vendosja e çadrave, por jepen vetëm kufijtë e sipërfaqes që kërkohet të shfrytëzohet, si dhe nuk përcaktohen sipërfaqet e hapësirat publike.
Në vitin 2017, nuk është dokumentuar asnjë rast kontrolli të kontratave të lidhura apo të jetë ngritur një komision verifikimi në terren, pasi grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë dokumentacion inspektimi, raporti monitorimi etj.
Në zbatim të VKM-së nr. 369, datë 18.05.2016, çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, ka për detyrim ligjor e institucional të njoftojë A.K.B për kontratat e lidhura për hapësirë publike për stacion plazhi. Për vitin2017, nga komisioni i stacioneve të plazhit nuk na u vu në dispozicion asnjë dokumentacion që provon përmbushjen e këtij detyrimi nga Bashkia Vlorë (në bazë të dok të dorëzuar), po ashtu nuk na u vunë në dispozicion as dokumentet e monitorimit të AKB dhe rekomandimet përkatëse për bashkinë dhe subjektet e konstatuara me shkelje të kushteve, sipërfaqes në përdorim dhe pagesave sipas kontratës.

Për kontrata e lidhura në vitin 2017, nuk është mbajtur asnjë korrespodencë me AKB referuar kjo neni 9, pika 4 të Shtojcës 2 "Kontrata e qirasë" miratuar me VKM nr. 369, datë 18.05.2016 "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", pasi grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë dokument provues apo korrespondencë për këtë qëllim.
Për vitin 2017 nuk ka asnjë rast të dokumentuar që nga Komisioni i Stacioneve të Plazhit dhe grupi i verifikimit, të jenë kryer verifikime në terren për kontratat e lidhura apo edhe për subjektet të cilat përdorin hapësirë publike pa u pajisur me kontratë nga bashkia.
Për vitin 2017 për rinovimin e kontratave, nuk janë mbajtur në shqyrtimin dokumentet monitorues të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, të cilat janë referuar edhe në shkresat e dërguara nga institucioni me kompetenca ligjore, dokumente të analizuara dhe vlerësuara nga grupi i auditimit dhe për cilat AKB ka konkluduar se asnjë subjekt nuk i plotëson kushtet sipas legjislacionit të sipërcituar.
Veprime në shkelje të VKM nr 369, datë 18.05.2016 "Për miratimin e rregullores 'Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", neni 8 "Rinovimi i Kontratës", pika 5 "Në rast të shkeljeve të rënda të gjetura nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe Inspektorati Përgjegjës për Turizmin dhe sipas rekomandimit të dhënë nga këto të fundit në dokumentin monitorues, njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të rinovojë kontratën e qirasë për përdorimin e plazhit".

Nga një vlerësim dhe matje e disa prej kontratave të pasqyruara më sipër, duke eliminuar në to një pjesë të sipërfaqeve funksionale, përsëri rezulton se sipërfaqet kontraktuara me ato reale janë shumë më të ndryshme nga njëra tjetra përsa i përket sipërfaqes në m2, dhe më konkretisht:
Vendi i quajtur Vironi.

Vendi i quajtur Coco Bongo

Vendi i quajtur Vajana

Vendi i quajtur Bora Vendi i quajtur Bojo

Siç vërehet qartazi, asnjë nga plazhet e dhëna me qira nga Bashkia Vlorë në vitin 2017 nuk përputhet me ato të përdoruara dhe shfrytëzuara në fakt nga përdoruesit e tyre, duke sjellë për pasojë lejimin e tyre të përdorin sipërfaqen publike, pa kundërshpërblim, si dhe lidhur kontrata dhe vendosur të dhëna për sipërfaqe jo reale në kontratat respektive të tyre.

***Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH**: Në shpjegimet që jepen me shkresën nr. 9276/8, datë 03.04.2018 (prot KLSH nr. 1029/11, datë 10.04.2018), janë dhënë sqarimet përkatëse lidhur me procedurat e kryera nga Komisionet e dhënies të stacioneve të plazheve (dokumentacioni bashkëlidhur).*
*Nga grupi i auditimit u vlerësua sqarimi lidhur me trajtimin e praktikave të konsideruara me dëm ekonomik për 5 subjekte në vlerën prej 326,000 lekë duke u marrë në konsideratë dhe bërë rregullimit përkatëse, po ashtu është marrë në konsideratë edhe praktika me nr. 7135, datë 14.08.2017, nr. 6822, datë 02.08.2017, nr. 7133, datë 14.08.2017, si dhe praktikat në emër të D. N dhe R. D. Përsa i përket subjekteve të cilat janë trajtuar se kanë shkaktuar të ardhura të munguara për Bashkinë Vlorë, dhe nga ju aktualisht deklarohen se kanë paguar detyrimet dhe se përfshirja në listën e subjekteve të cilët nuk kanë paguar është konsideruar lapsus (subjekti J. TH, S. K, K. M, H. GJ, A. GJ, K. GJ, L. Z, E. R dhe E. Z, merret në konsideratë)*
*Pretendimi merret në konsideratë pjesërisht për përgjegjësinë.*

*(Për sa trajtuar më sipër, gjerësisht është trajtuar në faqen 285-366, të Projekt Raport Auditimit dhe pasqyrat bashkëlidhur projekt raporiti)*

**III/8. Auditim me zgjedhje sipas analizës riskut në Ndërmarrjet dhe Institucionet në vartësi të Bashkisë, Vlorë.**

*-Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimin i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe Pretendimimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i produkteve në nivel programi e shprehur në terma sasiore dhe në vlerë kundrejt treguesve të planifikuar dhe të pasqyruara në raportet e monitorimit, për gjithë periudhën e auditivit.*

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Njësitë Vartëse të Bashkisë Vlorë, rezulton se nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë, në çdo fillim viti ka kryer shpërndarjen e fondeve buxhetore bazuar në vendimet e këshillit të Bashkisë të çdo viti përkatës.
Nga ana e njësive vartëse është hartuar dhe miratua projekt-buxheti për programin buxhetor afatmesëm 2015-2017, janë ngritur grupet e punës për menaxhimin strategjik (GMS), është përgatitur plan buxheti për vitet 2015,2016 dhe vitin 2017, duke parashikuar treguesit ekonomik dhe financiar të njësisë në lidhje me shpenzimet. Në hartimin e këtyre projektbuxheteve është pasur parasysh realizimi i vitit paraardhës, realizimi i pritshëm për vitin koherent si dhe parashikimi për vitin e ardhshëm. Veprimet janë në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore" dhe të ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
Pas miratimeve u janë dërguar Degës së Thesarit, ku në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Bashkia nëpërmjet Transfertë së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe e fondeve të krijuara nga burimet e veta për kryerjen e funksioneve të veta.
Në hartimin e planit të buxhetit të Njësive, është patur parasysh realizimi i viteve të fundit.
Ndarja e plan-buxheteve dhe detajimit e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli dhe respektimi i disiplinës buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit.
Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve janë respektuar sipas detajimeve të bëra në fillim të çdo viti ushtrimor duke reflektuar edhe ndryshimet e diktuara sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan - buxhetet për vitin 2015, 2016 dhe vitin 2017, u konstatua se është realizuar detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimet e financimit. Gjatë periudhë, ka patur ndryshime në planet buxhetore të Bashkisë dhe të Njësive vartëse, të cilat ndryshimet janë miratuar me vendime të Këshillit të Bashkisë dhe të miratuara nga Prefekti i Qarkut Vlorë.
Me miratimin e buxhetit të bashkisë Vlorë janë miratuar edhe buxhetet për njësitë vartëse përkatësisht:
Për vitin 2015 buxheti është miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.1, datë. 29.01.2015 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2015", ndryshuar me vendimet nr. 8, datë 13.08.2015, nr.13, datë 07.09.2015, nr.14, datë 07.09.2015, nr.15, datë 07.09.2015, nr.17, datë 07.09.2015 dhe nr.23, datë 07.10.2015, të miratuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë.
Për vitin 2016 buxheti është miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 2, datë. 04. 02.2016 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2016" të miratuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë.
Për vitin 2017 buxheti është miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 3 , datë 31 .01.2017 "Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2017", ndryshuar me vendimet nr.29, datë 27.04. 2017, nr.31, datë 27.042017, nr.57, datë 27.07.*2017,* nr. 79 , datë 26.10.2017 dhe nr. 95, datë 30 .11 .2017 të miratuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë.
Mbështetur në treguesit e programuar, nga zyra e financës janë ndjekur shpenzimet sipas artikujve duke mos tejkaluar kufijtë e shpenzimeve. Pasqyrimi i shpenzimeve është bërë në mënyrë të detajuar dhe sipas veprimtarisë përkatëse dhe klasifikimit buxhetor.
Disponibilitete në thesar (krediti) shuma e xhiros kreditore të llogarisë, është e njëjtë me situacionin e shpenzimeve për çdo muaj dhe në fund të periudhave ushtrimore, çka tregon qartë për mbajtjen e saktë të treguesve të buxhetit në llogarinë e thesarit dhe pasqyrimin në mënyrë korrekte të veprimtarisë sipas klasifikimit buxhetor. Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën

buxhetore sipas manualit të klasifikimit funksional dhe udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave.

Sipas dokumentacionit të shpenzimeve nuk u konstatuan raste të përdorimit të fondeve mbi limitet e përcaktuar në planifikimet mujore të shpenzimeve sipas artikujve dhe kapitujve.

U verifikuan situacionet mujore të rakorduar me Degën e Thesarit dhe rezultuan se janë të rakorduar me shpenzimet e kontabilizuar. Në lidhje me kryerjen e rakordimeve periodike dhe vjetore të Drejtorisë së Financës së Bashkisë me degën e thesarit, u konstatua se të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë dokumentuar në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit për çdo muaj dhe në mënyrë progresive, duke u konfirmuar nga të dy palët.

Realizimi i fondeve sipas programeve, pavarësisht nga burimi i financimit bazuar në akt-rakordimet e shpenzimeve me thesarin për vitet 2015, 2016 dhe vitin 2017 sipas njësive vartëse të Bashkisë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Teatri "Petro Marko" Vlorë

Realizimi i buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve paraqitet: **Në 000/ lekë**

| Nr. | Emërtimi i artikullit të shpenzimeve | Viti 2015 | | | Viti 2016 | | | Viti 2017 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % |
| 1 | Totali 600 | 14,400 | 14,093 | 97.8 | 14,760 | 14,686 | 99.5 | 15,949 | 15,942 | 99.9 |
| 2 | Totali 601 | 2,400 | 2,346 | 97.7 | 2,460 | 2,451 | 99.6 | 2,646 | 2,645 | 99.9 |
| 3 | Totali 602 | 5,851 | 5,603 | 95.7 | 4,750 | 4,198 | 88.3 | 5,340 | 2,844 | 53.3 |
| 4 | Investim (231) | 0 | 0 | **0** | 200 | 200 | **100** | 0 | 0 | **0** |
| | **T O T A L I** | **22,651** | **22,042** | **97,3** | **22,170** | **21,535** | **97,1** | **23,935** | **21,431** | **89,5** |

**Për vitin 2015**, nga institucioni Teatri "Petro Marko", fondet janë realizuar në vlerën 22,042 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 22,651 mijë lekë, ose në masën 97,3% me një mosrealizim në vlerën 609 mijë lekë, **për vitin 2016** fondet janë realizuar në vlerën 21,535 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 22,170 mijë lekë, ose në masën 97,1% me një mosrealizim në vlerën 635 mijë lekë, **për vitin 2017** fondet janë realizuar në vlerën 21,431 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 23,935 mijë lekë, ose në masën 89,5% me një mosrealizim në vlerën 2,504 mijë lekë. Nuk u konstatuan raste të përdorimit të fondeve mbi limitet e përcaktuar në planifikimet mujore të shpenzimeve sipas artikujve dhe kapitujve. Hartimi i akt-rakordimeve me Degën e Thesarit është në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe UMF nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Qendra e Kulturës Artit dhe Turizmit

Realizimi i buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve paraqitet: **Në 000/ lekë**

| Nr. | Emërtimi i artikullit të shpenzimeve | Viti 2015 | | | Viti 2016 | | | Viti 2017 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % |
| 1 | Totali 600 | 12,600 | 11,335 | 89.9 | 11,724 | 11,234 | 95.8 | 12,600 | 11,677 | 92.6 |
| 2 | Totali 601 | 2,100 | 1,887 | 89.8 | 1,970 | 1,853 | 94.1 | 2,124 | 1,948 | 91.7 |
| 3 | Totali 602 | 2,000 | 2,000 | 100 | 11,489 | 10,813 | 94.1 | 2,115 | 300 | 14.2 |
| 4 | Investim (231) | 0 | 0 | 0 | 200 | 195 | 97.5 | 12,315 | 9,607 | 78 |
| | **T O T A L I** | **16,700** | **15,222** | **91,1** | **25,383** | **24,095** | **95** | **29,154** | **23,532** | **90,7** |

**Për vitin 2015**, nga institucioni Qendra e Kulturës Artit dhe Turizmit, fondet janë realizuar në vlerën 15,222 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 16,700 mijë lekë, ose në masën 91,1% me një mosrealizim në vlerën 1,478 mijë lekë, **për vitin 2016** fondet janë realizuar në vlerën 24,095 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 25,383 mijë lekë, ose në masën 95% me një mosrealizim në vlerën 1,288 mijë lekë, **për vitin 2017** fondet janë realizuar në vlerën 23,532 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 29,154 mijë lekë, ose në masën 90,7% me një mosrealizim në vlerën 5,622 mijë lekë. Nuk u konstatuan raste të përdorimit të fondeve mbi limitet e përcaktuar në planifikimet mujore të shpenzimeve sipas artikujve dhe kapitujve.
Hartimi i akt-rakordimeve me Degën e Thesarit është në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe UMF nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Realizimi i buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve paraqitet: **Në 000/ lekë**

| Nr. | Emërtimi i artikullit të shpenzimeve | Viti 2015 | | | Viti 2016 | | | Viti 2017 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % |
| 1 | Totali 600 | 52,800 | 51,448 | 97.4 | 22,620 | 22,615 | 99.9 | 21,346 | 21,331 | 99.9 |
| 2 | Totali 601 | 8,571 | 8,516 | 99.4 | 3,798 | 3,741 | 98.5 | 3,546 | 3,546 | 100 |
| 3 | Totali 602 | 20,671 | 20,315 | 98.2 | 16,350 | 16,290 | 99.6 | 25,200 | 18,275 | 72.5 |
| 4 | Investim (231) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **T O T A L I** | **82,042** | **80,279** | **97.8** | **42,768** | **42,646** | **99.7** | **50,092** | **43,152** | **86.1** |

**Për vitin 2015**, nga institucioni Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, fondet janë realizuar në vlerën 80,279 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 82,042 mijë lekë, ose në masën 97,8% me një mosrealizim në vlerën 1,763 mijë lekë, **për vitin 2016** fondet janë realizuar në vlerën 42,646 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 42,768 mijë lekë, ose në masën 99,7% me një mosrealizim në vlerën 122 mijë lekë, **për vitin 2017** fondet janë realizuar në vlerën 43,152 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 50,092 mijë lekë, ose në masën 86,1% me një mosrealizim në vlerën 6,940 mijë lekë. Nuk u konstatuan raste të përdorimit të fondeve mbi limitet e përcaktuar në planifikimet mujore të shpenzimeve sipas artikujve dhe kapitujve.
Hartimi i akt-rakordimeve me Degën e Thesarit është në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe UMF nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Klubi Shumë Sportesh "Flamurtari"

Realizimi i buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve paraqitet: **Në 000/ lekë**

| Nr. | Emërtimi i artikullit të shpenzimeve | Viti 2015 | | | Viti 2016 | | | Viti 2017 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % |
| 1 | Totali 600 | 6,720 | 6,054 | 90 | 6,720 | 6,486 | 96,5 | 7,200 | 7,067 | 98,1 |
| 2 | Totali 601 | 1,102 | 1,006 | 91.2 | 1,140 | 1,083 | 95 | 1,200 | 1,182 | 98.5 |
| 3 | Totali 602 | 16,896 | 16,040 | 95 | 17,730 | 17,708 | 99.8 | 21,903 | 20,140 | 92 |
| 4 | Investim (231) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **T O T A L I** | **24,718** | **23,100** | **93.5** | **25,590** | **25,277** | **98.7** | **30,303** | **28,389** | **93.7** |

**Për vitin 2015**, nga institucioni Klubi Shumë Sportesh "Flamurtari", fondet janë realizuar në vlerën 23,100 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 24,718 mijë lekë, ose në masën 93,5%

me një mosrealizim në vlerën 1,618 mijë lekë, **për vitin 2016** fondet janë realizuar në vlerën 25,277 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 25,590 mijë lekë, ose në masën 98,7% me një mosrealizim në vlerën 313 mijë lekë, **për vitin 2017** fondet janë realizuar në vlerën 28,389 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 30,303 mijë lekë, ose në masën 93,7% me një mosrealizim në vlerën 1,914 mijë lekë. Nuk u konstatuan raste të përdorimit të fondeve mbi limitet e përcaktuar në planifikimet mujore të shpenzimeve sipas artikujve dhe kapitujve.

Hartimi i akt-rakordimeve me Degën e Thesarit është në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe UMF nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Shtëpia e Fëmijës,

Realizimi i buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve paraqitet: **Në 000/ lekë**

| Nr. | Emërtimi i artikullit të shpenzimeve | Viti 2015 | | | Viti 2016 | | | Viti 2017 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % |
| 1 | Totali 600 | 10,820 | 10,709 | 98.9 | 10,850 | 10,760 | 99.2 | 11,686 | 11,682 | 99.9 |
| 2 | Totali 601 | 1,810 | 1,788 | 98.7 | 1,812 | 1,797 | 99.2 | 3,092 | 2,951 | 95.4 |
| 3 | Totali 602 | 5,000 | 4,322 | 86.4 | 4,400 | 3,689 | 83.8 | 4,700 | 3,693 | 78.5 |
| 4 | Investim (231) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **T O T A L I** | **17,630** | **16,819** | **95.4** | **17,062** | **16,246** | 95.2 | **19,478** | **18,326** | **94.1** |

**Për vitin 2015**, nga institucioni Shtëpia e Fëmijës, fondet janë realizuar në vlerën 16,819 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 17,630 mijë lekë, ose në masën 95,4% me një mosrealizim në vlerën 819 mijë lekë, **për vitin 2016** fondet janë realizuar në vlerën 16,246 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 17,062 mijë lekë, ose në masën 95,2% me një mosrealizim në vlerën 816 mijë lekë, **për vitin 2017** fondet janë realizuar në vlerën 18,326 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 19,478 mijë lekë, ose në masën 94,1% me një mosrealizim në vlerën 1,152 mijë lekë. Nuk u konstatuan raste të përdorimit të fondeve mbi limitet e përcaktuar në planifikimet mujore të shpenzimeve sipas artikujve dhe kapitujve.

Hartimi i akt-rakordimeve me Degën e Thesarit është në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe UMF nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Qendra e Zhvillimit P.A.K. Vlorë,

Realizimi i buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve paraqitet: **Në 000/ lekë**

| Nr. | Emërtimi i artikullit të shpenzimeve | Viti 2015 | | | Viti 2016 | | | Viti 2017 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % | Plani | Fakti | % |
| 1 | Totali 600 | 3,369 | 3,368 | **99.9** | 4,522 | 4,188 | **92.6** | 4,800 | 4,336 | **90.3** |
| 2 | Totali 601 | 563 | 562 | **99.8** | 840 | 690 | **82.1** | 800 | 724 | **90.5** |
| 3 | Totali 602 | 1,575 | 1,315 | **83.5** | 3,090 | 3,073 | **99.4** | 4,070 | 2,259 | **55.5** |
| 4 | Investim (231) | 150 | 150 | **100** | 200 | 200 | **100** | 500 | 0 | **0** |
| | **T O T A L I** | **5,657** | **5,395** | **95.4** | **8,652** | **8,151** | **94.2** | **10,170** | **7,319** | **72** |

**Për vitin 2015**, nga Qendra e Zhvillimit P.A.K. Vlorë, fondet janë realizuar në vlerën 5,395 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 5,697 mijë lekë, ose në masën 95,4% me një mosrealizim në vlerën 302 mijë lekë, **për vitin 2016** fondet janë realizuar në vlerën 8,151 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 8,652 mijë lekë, ose në masën 94,2% me një mosrealizim në vlerën 501

mijë lekë, **për vitin 2017** fondet janë realizuar në vlerën 7,319 mijë lekë, ndërsa fondet e planifikuara janë në vlerën 10,170 mijë lekë, ose në masën 72% me një mosrealizim në vlerën 2,851 mijë lekë. Nuk u konstatuan raste të përdorimit të fondeve mbi limitet e përcaktuar në planifikimet mujore të shpenzimeve sipas artikujve dhe kapitujve.

Hartimi i akt-rakordimeve me Degën e Thesarit është në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe UMF nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:***

*Nga Institucionet e Vartësisë të Bashkisë Vlorë, përkatësisht, Teatri "Petro Marko", Qendra e Kulturës Artit dhe Turizmit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Klubi Shumë Sportesh "Flamurtari", Shtëpia e Fëmijës, Qendra e Zhvillimit P.A.K. Vlorë, janë hartuar projekt buxhetet për vitet 2015, 2016, 2017, të detajuar dhe programimi i buxhetit është mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015, "Për buxhetin e vitit 2016" dhe të ligjit nr.130 datë 15.12.2016 "Për Buxhetin e vitit 2017", janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë me vendimet përkatëse dhe janë konfirmuar për besueshmërinë ligjore nga Prefekti i Qarkut. Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve janë respektuar sipas detajimeve të bëra në fillim të çdo viti ushtrimor duke reflektuar edhe ndryshimet e diktuara sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Nuk u konstatuan raste të përdorimit të fondeve mbi limitet e përcaktuar në planifikimet mujore të shpenzimeve sipas artikujve dhe kapitujve. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë dokumentuar në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit për çdo muaj dhe në mënyrë progresive, duke u konfirmuar nga të dy palët.*

*(Gjerësisht trajtuar në faqen 366-371, të Projekt Raport Auditimit)*

**<u>Të ndryshme të konstatuara gjatë auditimit:</u>**

Me vendimin nr. 38, datë 01.06.2017, protokolluar me nr. 4821, datë 05.06.2017, "Për disa ndryshime në VKB nr. 44, datë 28.12.2015 për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave në territorin e Bashkisë Vlorë", Këshilli Bashkiak Vlorë rezulton se në referim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, 54/f, ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 5/a, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", VKB nr. 44, datë 28.12.2015 "Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave në territorin e Bashkisë Vlorë", ka vendosur të shtojë në pikën 5 "Tarifa për leke, autorizimeve dhe vërtetimeve të lëshuara nga administrata e bashkisë dhe njësitë administrative", nën pikën 19/a "Biletë hyrje për vizitë në ishullin e Sazanit, 200 lekë/person". Bileta të cilat do të shpërndahen nga Bashkia Vlorë pranë sportelit të vendosur, sipas lejes përkatëse të lëshuar nga Kapitaneria e Portit të Vlorës.

Ky vendim rezulton të jetë paraqitur në Këshillin Bashkiak (Projektvendimi dhe relacioni përkatës) nga T. Z. me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe J. P me detyrë Këshilltar, dhe ka marrë miratimin përkatës nga Kryetari i Bashkisë D. L. (shkresa nr. 4261, datë 23.05.2017).

Procedura e sipër cituar është referuar në Udhëzimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me nr. 4360, datë 28.04.2017 "Organizimin e vizitave turistike në ishullin e Sazanit", sipas të cilit, në pikën 4 është saktësuar se: "Të gjithë vizitorët mund të vizitojnë ishullin e

Sazanit, pasi të jenë pajisur me biletë hyrje, pranë sportelit të Bashkisë Vlorë të vendosur në portin ushtarak të ishullit. Nëpërmjet kësaj bilete ata kanë të drejtë të kryejnë vizitë të organizuar në grupe dhe të shoqëruar nga një person i autorizuar nga Bashkia Vlorë".
Nga auditimi është konstatuar se vendimi i Këshillit Bashkiak nuk ka gjetur zbatim, pasi nga strukturat e Bashkisë Vlorë nuk janë ndërmarrë hapat apo kryer procedurat për zbatimin. Duke qenë se VKB nr. 38, datë 01.06.2017, nuk ka përcaktuar strukturat Brenda bashkisë të cilat duhet të ishin angazhuar për përmbushjen e tij, përgjegjësia për këto mosveprime bie drejtpërdrejt mbi Hartuesit e Iniciuesit e Projektvendimit dhe Relacionit përkatës, T. Z. me detyrë Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe J. P me detyrë Këshilltar, të cilët me veprimet apo mosveprimet e tyre nuk kanë zbatuar vendimin e këshillit bashkiak dhe Udhëzimin e MZHETTS dhe në kundërshtim me nenin 64/b "zbaton aktet e këshillit" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

*Auditimi i procedurave të zhvilluara në Bashkinë Vlorë, Drejtorinë Juridike si dhe Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, lidhur me zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 2038, datë 05.07.2012.*
Në adresë të KLSH me shkresën e administruar me nr. 1174, datë 09.11.2017, qytetari Rami Isufaj, ka bërë me dije mbi vendimin nr. 2038, datë 05.07.2012, sipas të cilit është detyruar bashkia të lidhe kontratë me subjektin për një sipërfaqe trualli mbi të cilin subjekti ka realizuar një ndërtim me leje të KRRT Bashkia Vlorë nr. 9/33, datë 10.03.2000.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe masat e marra nga Bashkia Vlorë për zbatimin e vendimit gjyqësor konkretisht rezulton:
Me vendimin gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 1476, datë 27.06.2011, është vendosur: "Pranimi i padisë duke detyruar palën e paditur Bashkia Vlorë për të kryer procedurat përkatëse për lidhjen e kontratës së shitjes së truallit në trajtën e sipërfaqes funksionale prej 4232m2 përsa i përket objektit të ndërtuar mbi bazën e lejes së ndërtimit nr. 9/33, datë 10.03.2000 të KRRT Bashkia Vlorë me paditësin R. I duke respektuar tarifat përkatëse të vlerës së truallit në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit dhe planimetrisë përkatëse të aktit të inspektimit përpiluar gjatë gjykimit".
Vendimi rezulton i ankimuar nga Bashkia Vlorë në Gjykatën e Apelit Vlorë, duke parashtruar një sërë pretendimesh që për përfaqësuesit e bashkisë përbëjnë shkak të arsyeshëm për pranimin e kërkesës dhe prishjes së vendimit nr. 1476, datë 27.06.2011 dhe konkretisht:
"Bazuar në Kodin Civil, ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe UKM nr. 1, datë 30.07.2007, për të kryer shitje dhe regjistrimin e një trualli, si pasuri e paluajtshme, shitësi duhet të jetë në cilësinë e pronarit dhe të ketë regjistruar pronën në ZVRPP. Në rastin konkret Bashkia Vlorë asnjëherë nuk ka qenë dhe aktualisht nuk është pronare e truallit,. Prona është e regjistruar shtet dhe jo në emër të bashkisë dhe në një situatë të tillë është ME, Drejtoria përkatëse e shitjes së pronës shtetërore që kryhen shitjen.
Paditësi nuk ka provuar se ka shlyer në momenti ne marrjes së lejes së ndërtimit të gjitha detyrimet që përcaktohen nga neni 55 i ligjit nr. 8405, datë 17.08.1998, sipas të cilit lidhej kontrata dhe paguheshin detyrimet përkatëse financiare.
Pavarësisht këtyre, bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 8 dhe 32, të drejtën e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme e ka këshilli bashkiak i cili nuk mund tija delegojë këto kompetencë asnjë organi tjetër etj...".

Pretendimet e palëve në proces rezulton se janë marrë në shqyrtim e vlerësim nga organi gjyqësor i cili ka analizuar e vlerësuar të gjitha provat shkresore dhe pretendimet si dhe ka konkluduar se gjykata e faktit ka zbatuar dhe intepretuar në mënyrë të drejtë ligjin, duke dhënë një vendim të bazuar në prova. Në arsyetim gjykata ka referuar edhe faktin se objekti i ndërtuar nga paditësi "B.....L" është regjistruar në ZVRPP në emër të paditësit me nr. pasurie 27/79-ND1 e regjistruar në volum 35 faqe 33, edhe pse në kartelën e pasurisë së paluajtshme është vendosur shënimi në seksionin E "Mungojnë marrëdhëniet me truallin". Në përfundim të analizës të fakteve e rrethana, bazuar në provat shkresore, gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor Vlorë.
Aktualisht rezulton se Bashkia Vlorë nuk ka kryer asnjë lloj procedure ligjore për zbatimin e vendimit gjyqësor të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 1476, datë 27.06.2011, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me nr. 2038, datë 05.07.2012.
Sipas deklarimeve verbale të Drejtorit Juridik D. Z. dhe Drejtorit të Menaxhimit Financiar T. Z., vendimi gjyqësor nuk ka gjetur zbatim përsa Bashkia Vlorë ende nuk ka të miratuar listën përfundimtare të pronave dhe përsa ligji aktual nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ka si kusht të domosdoshëm për regjistrimin e një transaksioni shitblerje pasurie, që prona të jetë e regjistruar më parë në ZVRPP, nuk mund të veprohet.
Bashkia Vlorë, sipas dokumentacionit të disponuar ka të miratuar me VKM nr. 1643, datë 17.12.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, Qarku Vlorë" listën e objekteve, trojeve dhe pasurive të tjera, të cilat kanë kaluar në administrim të institucionit. Nga miratimi i listës paraprake e deri më sot Bashkia Vlorë nuk ka kryer asnjë procedurë për kalimin e pronave nga përdorimi në pronësi, përsa nuk ka një VKM për miratimin e listës përfundimtare. Nga të dhënat e vëna në dispozicion sipas listë inventarit të pasurive, dokument ky shoqërues i VKM nr. 1643, datë 17.12.2008, rezulton se trualli objekt trajtimi gjyqësor nuk rezulton të jetë i regjistruar, pra nuk është i përfshirë në listë inventarin paraprak.
Pavarësisht sa sipër, rezulton se përsa objekti i sipërcituar është ndërtuar referuar në një leje ndërtimi të nxjerrë nga organet kompetente dhe se regjistrimi i tij është bërë në ZVRPP, vetëm për llojin e pasurisë ndërtesë dhe jo truall, me shënim përkatës, Bashkia Vlorë pavarësisht mungesës së listë inventarit përfundimtar, lidhur me truallin nën objekt dhe atij funksional, duhet të kishte kërkuar nga Ministria e linjës, kalimin e tij në pronësi, për të vijuar më tej procedurat, sipas vendimit përkatës të Këshillit Bashkiak Vlorë.

## IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT:

**A. OPINIONI I AUDITIMIT.**

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë[2] e veprimtarisë së Bashkisë Vlorë (ISSAI 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë" [1]) e veprimtarisë së Bashkisë Vlorë.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë[2], sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti- Bashkia Vlorë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në ISSAI 4000 "Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë", "Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë", u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të cilat konsistojnë:

- Shkelje të kuadrit rregullator në fuqi në fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, lidhur me procedurat në kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik. Për arsye të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomikë në kundërshtim me kërkesat ligjore, pasi nuk plotësojnë kriteret e DST, duke përdorur fonde publike në kushtet e paligjshmërisë së shpalljes fitues të operatorëve në vlerën 50.5 milion lekë. Në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve, në 13 raste u konstatuan shkelje për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe llogaritje të gabuar të fondit limit, të cilat kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të njësisë vendore në vlerën totale 40.2 milionë lekë.

-Nga të dhënat konstatohet se detyrimet ndaj të tretëve, janë rritur nga viti në vit. Detyrimet e vitit 2017 krahasuar me ato të vitit 2015 (referuar vetëm të dhënave të bilanceve) janë rritur me 7(shtatë) herë, tregues të cilët sjellin risqe financiare për buxhetin e bashkisë dhe për një performancë jo të mirë likuiditetesh, pasi niveli i detyrimeve ka arritur në 640 milionë lekë në 31.12.2017. Ky risk është më i lartë edhe për shkak të nivelit të ulët në realizimin e treguesve financiarë të vitit 2017, kryesisht mosrealizimit të të ardhurave të vetë bashkisë. Nga mos ndjekja e procedurave ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, është krijuar një nivel i borxhit tatimor në vlerën totale 243.5 milion lekë.

- Nuk është krijuar regjistri i aseteve dhe nga mos menaxhimi i mirë i tyre janë shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën 27.8 milionë lekë. Në fushën e administrimit të aseteve, konstatohet se nga Bashkia Vlorë nuk është vepruar për zvogëlimin e sipërfaqeve pyjore/kullosor të subjekteve me leje minerale, si dhe nuk janë lidhur kontrata për shfrytëzimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, duke shmangur detyrimin për qiranë e tyre me një vlerë prej 237 milionë lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e kësaj njësie vendore dhe të dëmit ekonomik në vlerën 13.4 milionë lekë. Në fushën e Planifikim e Zhvillim Territorit dhe IMTV nuk janë marrë masa për arkëtimi e gjobave të aplikuara vlera e të cilave së bashku me kamatëvonesën përbën të ardhur të munguar në vlerën 4 milion lekë

[1] ***ISSAI 4000** – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë sigurie të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.*

[2] *Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH-së".*

[3] ***ISSAI 4000- 4200** – Audituesi shpreh një konkluzion të kualifikuar kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë materiale sa të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.*

**Opinioni**: Sipas mendimit tinë Nga auditimi i përputhshmërisë, i kryer në subjektin Bashkia Vlorë, u konstatuan devijime/shkelje materiale nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat japim **një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë**[3].

**B. MASA ORGANIZATIVE.**

**1. Gjetje nga auditimi**: Në auditimin e pagave, u konstatua se janë paguar 9 punonjës me kontratë të përkohshme, për të cilët nuk janë paguar sigurimet shoqërorë në vlerën 2,001,750 lekë (nga viti 2015 e vazhdim). Pagesa e këtyre punonjësve është mbuluar nën zërin e shpenzimeve art. 602 "shpenzime operative". Për këto punonjës nga Punëdhënësi është ndalur dhe derdhur tatimi në burim, por nuk janë ndalur dhe derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Punësimi i këtyre punonjësve në këtë formë, pa i deklaruar ato në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, duke iu shmangur detyrimeve të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, është në kundërshtim me nenet 13 pika 2 dhe 79 të ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësor" i ndryshuar duke shkaktuar dëm skemës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në shumën 2,001,750 lekë *(Trajtuar në faqen 39-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. <u>Rekomandimi</u>:** Bashkia Vlorë të marrë masa që punësimi i punonjësve me kontratë të përkohshme të bëhet në përmbushje të kushteve ligjore, duke bërë pagesat për detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësor" i ndryshuar.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi**: Për administrimin e arkave të Bashkisë dhe të njësive vartëse Novoselë e Shushicë, konstatohet se nuk janë hartuar rregullore dhe nuk ka procedura të aprovuara për lëvizjen e monedhës, fakt që lidhet me mungesën e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Mungojnë rregullat për qarkullimin e letrave me vlerë, ku u konstatua se vërtetimet "Për transportin e lëndës drusore" të bëra dalje nga magazina, nuk administrohen të dhëna për seritë e përdorura, që përbëjnë risk për tu përdorur në rrugë të kundra ligjshme, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin", neni 3, pika 1 dhe neni 9, pika 1 (*Trajtuar gjerësisht në faqen 49-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Nga nëpunësi autorizues të merren masa për hartimin e rregulloreve për lëvizjen e vlerave monetare duke përcaktuar procedura të qarta dhe përgjegjësi konkrete në këtë proces. Njëkohësisht të merren masa për vendosjen e rregullave për qarkullimin e letrave me vlerë duke përcaktuar mënyrën e kthimit në arkë apo në magazinë të pjesëve të përdorura për të saktësuar inventarin fizik në mënyrë periodike.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi**: Nga krahasimi i inventarit fizik të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara me inventarin kontabël, u konstatuan se disa artikuj janë të përfshirë në inventarin fizik dhe kontabël vetëm me emërtesë, pa çmime dhe për pasojë janë të pa përfshirë në bilancet e viteve respektive, gjithsej 117 artikuj, nga e cila Bashkia Vlorë 35 artikuj, Njësia Administrative Novoselë 36 artikuj dhe Njësia Administrative Qendër 46 artikuj, që i përkasin inventarit ekonomik llogaria nr. 218 "Inventarë ekonomik", veprime në kundërshtim me nenin 4/26, të ligjit 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin", i ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". *(Trajtuar gjerësisht në faqen 49-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi**: Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë, të marrë masa për saktësimin e inventarit ekonomik për 117 artikuj dhe përfshirjen në kontabilitet me vlerat përkatëse të inventarëve që aktualisht janë pa çmim.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2018**

**4. Gjetje nga auditimi**: Për të gjitha asetet e Bashkisë Vlorë dhe 4 njësitë administrative Qendër Vlorë, Shushicë, Novoselë dhe Orikum, nuk është hapur regjistri kontabël i aseteve, në kundërshtim me kapitullin III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pasi nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia Vlorë. Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, numri, data i kontratës së qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik *(Trajtuar gjerësisht në faqen 49-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi**: Bashkia Vlorë, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi sipas VKM respektive dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP në pronësi të Bashkisë, përkatësisht në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre në mënyrë elektronike si dhe të përditësojë regjistrin mbi pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira. Ku të përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes deri në daljen e tij jashtë përdorimit.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi**: Në vlerësimin e inventarëve për nxjerrje jashtë përdorimit për vitin 2015, u konstatuan veprime në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik", pasi nuk janë vendosur rregulla për përcaktimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të llojeve të ndryshme të aktiveve dhe nuk është përcaktuar kufiri monetarë, kështu:

-Në shkollën "Rilindja", janë vlerësuar për jashtë përdorimit laborator kimie me vlerë 257,430 lekë (pa analizë), laborator fizike me vlerë 422,488 lekë (pa analizë), laborator biologjie 447,326 lekë (pa analizë).

-Në subjektin "Shkolla e re" 5 (pesë) monitor, 5 (pesë) tastiera, 5 (pesë) njësi qendrore dhe 3 (tre) karrige rrotulluese, pa çmim të shkarkuar nga kontabiliteti sipas viteve si rezultat i tjetërsimit të aktiveve të qëndrueshme *(Trajtuar gjerësisht në faqen 49-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi**: Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë, të marrë masa për verifikimin me grup pune të veçantë të inventarëve të vlerësuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit dhe që ruhen akoma nëpër shkolla të tjera të pa asgjësuara.

**Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2018**

**6. Gjetje nga auditimi**: Nga grupi i punës për zbatimin e reformës administrative ngritur me urdhër të Kryetarit Bashkisë nr. 80, datë 25.08.2015, nuk është hartuar asnjë informacion apo raport i veçantë për njësitë e shkrira (NJSH), por është mjaftuar vetëm me të dhënat e ekipit "Star" të Ministrisë Financave. Nuk janë paraqitur të dhëna për arkivat e njësive, për gjendjen, kapacitetin,

dokumentacionin e arkivuar dhe të pa arkivuar, për gjendjen e arkave, sigurinë e lëvizjes të hollave në bankë etj. Nuk është dorëzuar dokumentacioni financiarë me shkrim nga nëpunësit e larguar nga puna si efekt i reformës administrative.
Në Komunën Shushicë nuk janë përfshirë në kontabilitet detyrimet e prapambetura nga kontratat e tokave bujqësore në 22 raste në vlerë 1,687,890 lekë *(Trajtuar gjerësisht në faqen 49-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**6.1. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Vlorë të marrë masa për arkivimin e dokumentacionit të financës në arkivat e Njësive Administrative që i përket periudhës para reformës administrative.
Të kontabilizohen detyrimet e prapambetura nga kontratat e tokave bujqësore në ish- Komunën Shushicë për **22 raste në vlerë 1,687,890 lekë**, dhe të hartohet regjistri pronave të dhëna me qira duke kryer verifikimin e detyrimeve të prapambetura për të gjithë bashkinë.

**Brenda datës 30.09.2018**

**7. Gjetje nga auditimi**: Në auditimin e dosjeve të procedurave të prokurimit për periudhën 2015 – 2017, u konstatua se 10 investime janë prokuruar pa marrë më parë miratimin për leje zhvillimi (ndërtimi) të miratuar nga Drejtoria e Planifikimit Zhvillim Territorit dhe Kryetari i Bashkisë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 13 dhe 29 "Përgjegjësitë e Kryetarit të Bashkisë", neni 22 "Plani i detajuar vendor", neni 37 "Kushtet për zhvillim", neni 38 "Leja e zhvillimit"; neni 39 "Leja e ndërtimit", dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit. *(Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit).*
**7.1 <u>Rekomandimi</u>**: Sektori i njësisë së prokurimeve Bashkia Vlorë, të marrë masa që para se të fillojë procedurat e prokurimit për punimet civile, të sigurojë miratimin e lejes së zhvillimit.

**Në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi**: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit (Sektori i ALUIZNIT) të Bashkisë Vlorë, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, , për objektet që legalizohen.
Konkretisht për periudhën nga 01.01.2015 deri më 31.12.2017, sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 126 persona me vlerë 4,934,350 lekë, e ardhur e munguar në buxheti e Bashkisë Vlorë, sipas listave që disponon sektori i AUIZNIT Bashkia Vlorë *(Trajtuar në faqen 241-259, të Raport Përfundimtar të Auditimit).*
**8.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit (Sektori e ALUIZNIT), në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të ALUZNIT Vlorë dhe ZVRPP Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **4,934,350 lekë ndaj 126 personave** të pajisur me leje legalizimi sipas listave që disponon Sektori e ALUIZNIT, Bashkia Vlorë.

**Brenda datës 30.09.2018**

**9. Gjetje nga auditimi**: Në Bashkinë Vlorë, ish Bashkinë Orikum dhe ish komunat Shushicë e Qendër Vlorë, u konstatua se nuk janë ndjekur procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, për subjektet e pajisura me leje minerare apo koncesionare nga ish- Ministria e

Energjisë dhe Industrisë për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznes, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10. 2008 "Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor", i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016 dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Vlorë, në vlerën 237,261,000 lekë *(Trajtuar më hollësisht në faqet 262-291, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve Bashkia Vlorë, t'i kërkojë Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme dhe kryerjen e pagesës së detyrimeve nga dëmtimi i fondit pyjor/kullosor dhe lidhjen e kontratave të qirave për të ardhurat e munguara për buxhetin e bashkisë në **vlerën 237,261,000 lekë**, sipas aneksit nr. 5.1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi**: Në auditimin e veprimeve me bankë, u konstatua se janë paguar me vendim gjykate për largim të padrejtë të punonjësve nga puna, gjithsej në **vlerën 2,601,720 lekë**. Për këto procese gjyqësore të humbura, Bashkia Vlorë nuk ka analizuar shkaqet e lindjes së tyre dhe të marrë masa ndaj personave përgjegjës, veprim në kundërshtim me pikën 62 dhe 102, të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 09.01.2015 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015", pika 6.1 "vendimet gjyqësore" *(Trajtuar më hollësisht në faqet 262-291, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë, të analizojë të gjitha proceset gjyqësore të cilat kanë sjellë ndikim negativ në buxhetin e Bashkisë Vlorë për **vlerën 2,601,720 lekë**, duke kërkuar nxjerrjen e përgjegjësisë ligjore ndaj personave shkaktarë të gjendjes, si dhe ndjekjen në të gjitha shkallët e gjyqësorit të proceseve.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi**: Sektori i Taksave e Tarifave vendore Bashkia Vlorë, nuk ka vepruar për inventarizimin e dokumentacionit që ndodheshin në dosjet e subjekteve taksapagues, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" neni 24, dhe me Rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, kapitulli II, nenet 21 dhe 27 *(Trajtuar më hollësisht në faqet 262-291, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. <u>Rekomandimi</u>**: Sektori i Taksave e Tarifave vendore, të marrë masa për gjatë vitit ushtrimor të kryejnë inventarizimin e çdo dosje të veçantë për çdo subjekt tatimpagues për taksa dhe tarifa vendore, ku të plotësohet me fletë inventari i gjithë dokumentacioni që ka çdo subjekt tatimpagues.

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi**: Punonjësit e ish komunave Qendër, Novoselë dhe Shushicë, aktualisht njësi administrative të Bashkisë Vlorë, me kryerjen e reformës administrative dhe kalimin e aktivitetit të bizneseve në Bashkinë e madhe Vlorë, nuk kanë dorëzuar dhe dokumentuar me procesverbal me komision, dokumentacionin e bizneseve si, dosjet e bizneseve me ngarkesat e detyrimeve përkatëse, regjistrat e tatim paguesve, pasqyrën e debitorëve të krijuar sipas viteve, veprime në kundërshtim me pikat 1, 2, 3, 4, 5 e Kreut V, të VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial", pikat 50,51,52, të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë pezullimin dhe lirimin", Urdhri i MF nr. 47, datë 30.06.2015 "Për procedurat e mbylljes së llogarive të njësive të qeverisjes vendore që do të shkrihen", si dhe Udhëzimin e përbashkët të Ministrit për çështjet vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 "Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial" *(Trajtuar më hollësisht në faqet 241-259, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Sektori e Tatim Taksave dhe Tarifave vendore, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe marrjen me procesverbal të dokumenteve të bizneseve, si dosjet e bizneseve me ngarkesat e detyrimeve përkatëse, regjistrat e tatim paguesve, pasqyrën e debitorëve të krijuar sipas viteve, të ish Komunave Qendër, Novoselë dhe Shushicë.

**Menjëherë**

**13. Gjetje nga auditimi**: Në auditimin e procedurave për vjeljen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, rezultoi se janë debitorë të taksave për bizneset me 31.12.2017, gjithsej **2870 subjekte** me vlerën **243,548 mijë lekë**, sipas listave që ndodhen në zyrën e taksave vendore.

Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Inspektorët e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë për arkëtimin e debitorëve të taksave vendore, nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", nenet 40, 41 90, 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve" *(Trajtuar më hollësisht në faqet 241-259 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Sektori e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vlorë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e **2870 subjektev**e debitor me vlerën **243,548 mijë lekë**.

Për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura, bazuar në nenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore", i ndryshuar, nga Sektori e Taksave Bashkia Vlorë, të nxirren njoftim vlerësimet tatimore duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a-T'u dërgohen bankave** të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

**b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit**, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore Republikan e Shqipërisë".

**c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat**, bazuar në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, si dhe të llogariten në vazhdimësi kamat vonesa.

**d-Në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset,** nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Bashkisë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike) të marrë masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

**e-Drejtoria e Taksave në Bashkinë Vlorë,** të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të popullatës, taksës tokës nga fermerët e 3 Njësive Administrative. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", pika 76 sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë dhe njësitë Administrative) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifat etj.

**Brenda datës 30.09.2018**

**14. Gjetje nga auditimi**: Bashkia Vlorë, në vitin 2017, në 6 raste ka lidhur kontrata për zënie të përkohshëm të hapësirave publike (plazhe), duke ulur në mënyrë të konsiderueshme sipërfaqen në m2 nga viti paraardhës edhe pse ajo figuron po e njëjtë nga njëri vit në tjetrin, duke krijuar të ardhura të munguara për shumën prej 1,690,000 lekë, konkretisht:

-Kontrata me nr. 6816, datë 02.08.2017 në emër të A. D, me diferencë nga viti i mëparshëm për sipërfaqen 400 $m^2$, me të ardhura të munguara për vlerën prej 200,000 lekë.

-Kontrata me nr. 6817, datë 02.08.2017 në emër të M. T me diferencë nga viti i mëparshëm për sipërfaqen 520 $m^2$, me të ardhura të munguara për vlerën prej 260,000 lekë.

-Kontrata me nr. 6821, datë 02.08.2016 në emër të V. H me diferencë nga viti i mëparshëm për sipërfaqen 100 $m^2$, me të ardhura të munguara për vlerën prej 170,000 lekë për vitet 2016 dhe 2017.

-Kontrata me subjektin B. B për të cilin është lidhur kontrata në vitin 2016 për 1500 m2 dhe vitin 2017 për 2500 $m^2$, me diferencë nga viti i mëparshëm për sipërfaqen 1000 $m^2$, me të ardhura të munguara për vlerën prej 600,000 lekë. Për këtë kontratë është konstatuar gjithashtu se ka në përdorim rreth 4500 m2 dhe jo 2500 $m^2$.

-Kontrata me nr. 6358, datë 19.07.2017 në emër të O. V me diferencë nga viti i mëparshëm për sipërfaqen 220 $m^2$ me të munguara për vlerën prej 110,000 lekë.

-Kontrata me nr. 6818, datë 02.08.2017 në emër të A. K me diferencë nga viti i mëparshëm për sipërfaqen 700 $m^2$ me të ardhura të munguara për vlerën prej 350,000 lekë *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. <u>Rekomandimi</u>**: Kryetari i Bashkisë Vlorë, të marrë në vlerësim të gjitha rastet e uljes të ndjeshme dhe të paargumentuar të sipërfaqeve të zënie të përkohshëm të hapësirave publike (plazhe), apo mosllogaritjes saktësisht të sipërfaqeve të stacioneve të plazhit, në dëm të interesave financiare të bashkisë për vlerën **1,690,000 lekë**, dhe mos lejimin e përdorimit të sipërfaqeve pa kontrata qiraje, në kundërshtim me VKM nr. 369, datë 18.05.2016, duke nxjerrë njëherazi edhe përgjegjësitë konkret.

**Brenda datës 30.09.2018**

**15. Gjetje nga auditimi**: Në investimin me objekt "Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian 2016" për të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes me OE "C....O" sipas aktit me nr. 3897 prot., datë 18.05.2016, me vlerë të kontratës 15,428,020 lekë dhe kontratës sipas aktit me nr. 5828 prot., datë 29.06.2017, me vlerë të kontratës 9,067,344 lekë, nga inspektimi në objekt i 25 banesave nga 52 në total, u konstatua se në të çdo njërën prej tyre punimet ishin me mangësi dhe me diferenca në volume pune të paguara, por të pakryera në fakt në vlerën 618,671 lekë.
Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 4, 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1 datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Vendimin Nr. 514 të Këshillit të Ministrave, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika 9 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", pika 4, paragrafi 4 *(Trajtuar gjerësisht në faqen 176-241, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**15.1. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Vlorë, të marrë masa që nëpërmjet një grupi specialistësh përkatës sipas nevojave të investimit, për verifikimin e objekteve të pa inspektuara në terren nga përfaqësuesit e KLSH-së, me qëllim identifikimin dhe arkëtimin e vlerës së punimeve për volumet e punës të likuiduara por të pakryera në fakt në 27 banesat e pa inspektuara, si dhe korrigjimin e mangësive të punimeve të amortizuara si pasojë e cilësisë së dobët të zbatimit në të gjitha banesat.

**Brenda datës 30.09.2018**

**16. Gjetje nga auditimi**: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Vendor Bashkia Vlorë, nuk ka vepruar për të vendosur gjoba, subjekteve që kanë shkelur afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit apo që shfrytëzojnë dhe e përdorin objektin pa marrë certifikatën e përdorimit, veprime në shkelje të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 40 dhe neni 52, me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë, vlera e cila është ende e pa përllogaritur për shkak të mos vënies në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH-së të dokumentacionit përkatës. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 262-291, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**16.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit (IMT), bazuar në dokumentacionin e administruar në zyrën e arkivit teknik të DPZHT dhe inspektimit në terren për secilin objekt, për subjektet që kanë shkelur afatin e fillimit dhe përfundimit të punimeve të ndërtimit apo që shfrytëzojnë dhe përdorin objektin pa marrë certifikatën e përdorimit, pas evidentimit të saktë të tyre, të aplikojnë sanksione, duke vendosur gjoba, sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara. E njëjta procedurë të realizohet për të gjitha objektet të cilat kanë shkelur afatet e lejeve të ndërtimit dhe objektet të cilat kanë përfunduar në afat, duke vënë në përdorim objektin pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

**Menjëherë**

**17. Gjetje nga auditimi**: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, para lëshimit të certifikatës së përdorimit të objektit nuk ka kërkuar konfirmimin e situacionit përfundimtar të punimeve nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Vlorë (këtu e vijim DRTV), duke mos ballafaquar

situacionin përfundimtar të paraqitur nga subjekti në DPZHT me atë të paraqitur në DRTTV. Në këto kushte, nuk është bërë përllogaritja e këtij detyrimi (nëse ka). Gjatë auditimit, bazuar në kërkesat e përsëritura të grupit të auditimit të KLSH-së, u bë i mundur që Bashkia Vlorë me shkresën nr. 1370, datë 19.02.2018, ti kërkojë Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë (DRTTV) që për secilin subjekt të pajisur me certifikatë përdorimi për periudhën 2015-2017, të konfirmohet situacionin dhe nëse janë deklaruar në tatime dhe në çfarë vlere *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 262-291, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Vlorë t'i kërkoj Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve (Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë), verifikimin e pasqyrimit të detyrimeve tatimore, bazuar në situacionit përfundimtar të paraqitur nga subjekti në DRTTV dhe administruar nga DPZHT, si dhe të konfirmuar prej tyre, për secilin subjekt të rillogarisë detyrimet përkatëse, duke ja bërë të njohur edhe KLSH. **Menjëherë**

**18. Gjetje nga auditimi**: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit ka lëshuar certifikata e përdorimit nr. 39, datë 02.06.2015, për subjektin ndërtues "D.....I" , për objektin e miratuar me leje të KRRT Bashkia Vlorë 5/134, datë 17.08.2010. Për këtë objekt është konstatuar se lëshimi i certifikatës është bërë në kushtet kur ky subjekt nuk ka përfunduar objektin sipas lejes së ndërtimit, pasi nuk ka bërë montimin e ashensorit, nuk ka përfunduar rampën hyrëse për në parkim si dhe pjesërisht nuk ka bërë sistemimin e territorit (trotuare). *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 262-291, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, bazuar në konstatimet e bëra nga grupi i auditimit, si dhe në zbatim të kompetencave ligjore të dhëna nga ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, të saktësojnë të gjitha shkeljet dhe parregullsitë e kryera nga subjekti ndërtues "D.....I" , të aplikojnë sanksionet përkatëse (gjobë), si dhe ti kërkojnë subjektit marrjen e masave të menjëhershme për përfundimin e objektit, sipas përcaktimeve teknike të bërë në lejen ndërtimore përkatëse.

**Brenda datës 30.09.2018**

**19. Gjetje nga auditimi**: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (këtu e vijim IMT), për periudhën 2015-2017 ka marrë 104 vendime me gjoba, në vlerën prej 30,750,000 lekë, duke u arkëtuar rreth 10% e tyre ose 2,900,000 lekë dhe mbeten për tu arkëtuar vlera prej 27,850,000 lekë.

Gjobat e vendosura kanë rezultuar si për subjektet juridike të cilat janë në shkelje të afateve të lejes së ndërtimit, apo ndërtimit pa leje në objekte me leje, por dhe për individë të ndryshëm të cilët kanë ndërtuar pa leje të autoritetit përgjegjës, DPZHT. Niveli i përcaktimit të gjobës, përsa i përket vlerës nuk është bërë mbi bazën e përllogaritjes së vlerës së investimit, veprime jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 107/2014,datë 01.10.2014"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 09.07.215, nr. 8/2017, datë 23.03.2017 neni 52, Kundërvajtjet administrative ku përcaktohet se:

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e mëposhtme, pavarësisht nëse përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera;

ë) kryerja e ndryshimeve në projekt apo e punimeve në shkelje të kushteve të lejes:

i) pa pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 300,000 lekë, pezullim të punimeve dhe me masën e përcaktuar në përfundim të procedurës, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni;
ii) me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe dhe vëllim ndërtimor, dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera pa leje *(Trajtuar më hollësisht në faqet 291-299, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1.<u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Vlorë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike bazuar në nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH", të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet me gjobë për ndërtimet e kundërligjshme, të vendosura në vite në vlerën 2,785,000 lekë, (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve") .Njëherazi të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

**19.2. <u>Rekomandimi</u>**: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, për çdo rast të vendimmarrjes me gjobë duhet të përllogarisë masën/nivelin e gjobës mbi bazën e vlerës së investimit në rastin e ndërtimit pa leje, ndërsa në rastet e shkeljeve të afatit të lejes apo vënies në përdorim të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi, në referim dhe të qëllimit të përdorimit/destinacionet të objektit, duke vendosur sanksione maksimale për objektet me karakter shërbimi, banimi etj., kryesisht të ndërtuara nga subjekte juridike dhe sanksione më minimale për objektet individuale (banesa vetjake).

**Menjëherë**

**20. Gjetje nga auditimi**: Nga Drejtoria e Administrimit të Pronave Publike dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar është lidhur vit për vit kontrata për dhënie me qira të pasurisë shtetërore me subjektin juridik privat "J.....S", me administrator z TH. P. Sipas kontratës dhe aktmarrëveshjes nr. 2713, datë 01.07.2014 "Shërbimi i sipërfaqeve të gjelbërua në qytet", subjektit i është lidhur kontrata qiraje për vetëm 106 $m^2$ objekt duke i lënë në ruajtje pjesën tjetër të godinës, po ashtu i është lënë në shfrytëzim pa kundërshpërblim sipërfaqja e fidanishtes prej 55194 $m^2$, nga të cilat 33877 $m^2$ është tokë në shfrytëzim dhe 21317 $m^2$ është tokë që mbetet në ruajtje *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, nisur nga konstatimi se për periudhën nga data 01.07.2017, subjektit nuk i është rilidhur kontrata e qirasë, të rishikojnë kushtet e kontratës përsa i përket sipërfaqes së objektit, truallit funksional dhe atij të lirë, si dhe sipërfaqes së fidanishtes të shfrytëzuar prej subjektit.
Gjithashtu të hartohet procesverbal konstatimi lidhur me sipërfaqen që subjekti ka në ruajte, duke evidentuar saktësisht atë përsa i përket pozicionimit në hartë dhe përdorimit apo jo prej tij. Për çdo rast për objektin, truallin dhe sipërfaqen e fidanishtes të aplikohen referencat ligjore në fuqi dhe konkretisht VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.

**Menjëherë**

**21. Gjetje nga auditimi**: Qendra e Artit Kulturës dhe Turizmit, si institucion në varësi të Bashkisë Vlorë, administron objektin ish-Pallati Kulturës. Nga ky institucion ka rezultuar se janë lidhur vit pas viti kontrata për dhënie me qira të pasurisë shtetërore me subjekte private për sipërfaqen totale prej 474 $m^2$. Në këtë godinë ushtron aktivitetin edhe Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Vlorë, subjekt i cili ka në përdorim një sipërfaqe prej 115 $m^2$, për të cilën nuk ka asnjë marrëdhënie kontraktore për përdorimin e saj, veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, duke sjell për pasojë të ardhura të munguara të cilat për periudhën objekt auditimi paraqiten në vlerën prej 1,242,000 lekë *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**21.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, nisur nga konstatimi se subjekti juridik "Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Vlorë", nuk ka kontratë qiraje për përdorimin e ambientit prej 115 $m^2$, në referim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, të marrë masat për hartimin e nënshkrimin e menjëhershme të kontratës, apo lirimin e sendit dhe vënien në përdorim të interesave të institucionit apo subjekteve të cilët mund të shprehin interes për ta marrë atë në përdorim.

Nisur nga mungesa e kapacitete të Qendrës së Artit Kulturës dhe Turizmit Vlorë, të gjitha kontratat të trajtohen nga Drejtoria e Administrimit të Pronave Publike dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar, apo të vendoset si kusht në kontratë, monitorimi i tyre nga këto dy struktura.

**Menjëherë**

**22. Gjetje nga auditimi**: Bashkisë Vlorë me VKM nr. 1643, datë 17.12.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, Qarku i Vlorës" është miratuar lista e objekteve, trojeve dhe pasurive të tjera, në administrim të institucionit. Nga verifikimi në terren i objekteve sipas VKM-së, verifikim i realizuar nga bashkia me kërkesë të grupit të auditimit, dhe bërë me dije KLSH me shkresën nr. 1456/1, datë 23.02.2017, ka rezultuar se:

Nga subjekti juridik "Partia Demokratike" është në përdorim sipërfaqja prej 80 m2 objekti i ndodhur në ambientet e ish-Ndërmarrjes "P. R", sipërfaqe për të cilën ky subjekt nuk disponon kontratë qiraje me institucionin, duke sjellë për pasojë të ardhura të munguara në vlerën prej 576,000 lekë (vitet 2015-2017)

Nga subjekti juridik "Partia Socialiste" është në përdorim sipërfaqja prej 300 m2 objekt dhe truall prej 1477 $m^2$, sipërfaqe për të cilën ky subjekt nuk disponon kontratë qiraje me institucionin, duke sjellë për pasojë të ardhura të munguara në vlerën prej 2,160,000 lekë (vitet 2015-2017).

Nga subjekti juridik privat "B.....E" me pronar z. A. ZH në të njëjtin objekt ku dhe ushtron aktivitetin subjekti juridik "Partia Socialiste", është në përdorim sipërfaqja prej 80 m2 objekt dhe truall funksional prej 50 m2, sipërfaqe për të cilën ky subjekt nuk disponon kontratë qiraje me institucionin, duke sjellë për pasojë të ardhura të munguara në vlerën prej 756,000 lekë (vitet 2015-2017), si dhe veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**22.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, nisur nga konstatimi se dy subjektet juridike "Partia

Demokratike", "Partia Socialiste" dhe z. A. ZH, nuk kanë kontratë qiraje për përdorimin e ambientit shtetërore të kaluara bashkisë, në referim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, të marrë masat për hartimin e nënshkrimin e menjëhershme të kontratave respektive, apo lirimin e sendit dhe vënien në përdorim të interesave të institucionit apo subjekteve të cilët mund të shprehin interes për ta marrë atë në përdorim.

**Menjëherë**

**23. Gjetje nga auditimi**: Bashkisë Vlorë me VKM nr. 1643, datë 17.12.2008 "Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, Qarku Vlorë" i është miratuar lista e objekteve, trojeve dhe pasurive të tjera, në administrim të institucionit. Nga verifikimi në terren i objekteve sipas VKM-së, verifikim i realizuar nga bashkia me kërkesë të grupit të auditimit, dhe bërë me dije KLSH me shkresën nr. 1456/1, datë 23.02.2017, ka rezultuar se nga Drejtoria e Shërbimeve Publike janë në administrim 103 kabina plazhi, në të cilat përkundrejt pagesës prej 4,000 lekë/muaj janë vendosur familje të pastreha. Nga 103 përdorues të tyre vetëm në 2 raste subjektet paguajnë vlerën e qirasë dhe 101 subjekte refuzojnë të paguajnë, duke sjellë për pasojë të ardhura të munguara në vlerën prej 19,294,000 lekë (vitet 2014-2017), veprime në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**23.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike, nisur nga konstatimi se familjet e pastreha refuzojnë pagesën e qirasë, edhe pse në vlera minimale, të kërkoj arkëtimin e tyre ose në të kundërt lirimin e ambienteve nga përdoruesit aktual dhe akomodimin në to të familjeve/personave të tjerë të cilët janë të përfshirë në listën e të pastrehëve dhe për të cilët bashkia nuk ka mundur tu siguroj ende një sistemim.

**Brenda datës 30.09.2018**

**24. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Vlorë, ish-Komuna Qendër, sot Njësia Administrative Qendër, janë lidhur kontrata qiraje 30 vjeçare për dhënien në përdorim të subjekteve private të sipërfaqes prej 3.13 ha, me qëllim mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, konkretisht: për z. Jorgo Subashi sipas kontratës datë 21.05.2015, për sipërfaqen 0.47 ha, L. B sipas kontratës datë 21.05.2015, për sipërfaqen 0.80 ha, V. S sipas kontratës datë 21.05.2015, për sipërfaqen 0.92 ha dhe E. M sipas kontratës nr. 999 rep dhe 504/2 kol, datë 21.05.2015, për sipërfaqen prej 2 ha, kontrata të lidhura në referim të ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar dhe ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005"Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".

Deri më datë 31.12.2017, ka rezultuar se asnjëri nga subjektet nuk ka shlyer detyrimin sipas kontratës, për vlerën prej 120,000 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin si dhe nuk është përllogaritur kamatëvonesat në masën 0.01% deri në 10% të vlerës, ose 12,000 lekë, si dhe nuk është bërë prishja e njëanshme e tyre. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**24.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, si dhe Njësia Administrative Qendër, të aplikojë dispozitat e Kontratës tip dhe konkretisht nenit 6 "Të drejtat dhe detyrimet e Qiradhënësit", pika 4, sipas të cilës "Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi nuk shlyen vlerën e qirasë për vitin pasardhës, ....", si dhe nenit 10 "Zgjidhja e kontratës".

**Brenda datës 30.09.2018**

**25. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Vlorë, ish-Komuna Qendër, sot Njësia Administrative Qendër, për periudhën 2008-2013 janë lidhur 63 kontrata për përdorimin e tokave bujqësore të pandara, me sipërfaqe 45.5 ha dhe afat vlefshmërie 99 vjet, kontrata të cilat kanë rezultuar në kundërshtim me nenin 678 e vijues të Kodit Civil, dhe VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar, si dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", shfuqizuar me UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", pasi pronat nuk kanë qenë të regjistruara në ZVRPP edhe pse kanë kaluar në pronësi të Komunës, si dhe kontratat janë lidhur për një periudhë 99 vjeçare dhe jo aq sa parashikuar nga Kodi Civil (30 vjet).

Nga auditimi i zbatimit dhe pagesës së vlerës së qirasë ka rezultuar se nuk janë paguar detyrimet për vlerën prej 5,964,735 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin, nga të cilat 1,307,250 lekë detyrim nga qiraja dhe 4,657,485 lekë si aplikim penaliteti në masën 1% të vlerës për çdo ditë vonesë *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**25.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, si dhe Njësia Administrative Qendër, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të secilës nga praktikat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara, rasteve të moszbatimit të kontratës sipas qëllimit të përdorimit (mos realizimit të investimit), referuar dhe në konstatimin e grupit të auditimit të KLSH-së, se lidhja e tyre për një afat 99 vjeçar është në kundërshtim me Kodin Civil, ti paraqesë Këshillit Bashkiak projektvendimin përkatës lidhur me vijueshmërinë ligjore të praktikave të qirasë, konfirmimi i cili për rastet e miratuara duhet të bëhet duke respektuar afatet kohore të sanksionuara nga Kodi Civil.

**Menjëherë**

**26. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Vlorë, ish-Komuna Novoselë, sot Njësia Administrative Novoselë, për periudhën 2010-2013 janë lidhur 40 kontrata për përdorimin e tokave bujqësore të pandara, dhe afat vlefshmërie 99 vjet, kontrata të cilat kanë rezultuar në kundërshtim me nenin 678 e vijues të Kodit Civil, dhe VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar, si dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", shfuqizuar me UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", pasi pronat nuk kanë qenë të regjistruara në ZVRPP, procedurat janë kryer në kundërshtim me referencat si dhe kontratat janë lidhur për një periudhë 99 vjeçare dhe jo 30 vjet aq sa parashikuar nga Kodi Civil *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**26.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, si dhe Njësia Administrative Qendër, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të secilës nga praktikat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara, rasteve të moszbatimit të kontratës sipas qëllimit të përdorimit (mos realizimit të investimit), referuar edhe në rekomandimet e mëparshme të KLSH-së, se lidhja e ka rezultuar në kundërshtim gjithë kuadrin ligjor rregullator, ti paraqesë Këshillit Bashkiak projektvendimin përkatës lidhur me vijueshmërinë ligjore të praktikave të qirasë, konfirmimi i cili për rastet e miratuara duhet të bëhet duke respektuar afatet kohore të sanksionuara nga Kodi Civil.

**Menjëherë**

**27. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Vlorë, ish-Komuna Shushicë, sot Njësia Administrative Shushicë, për periudhën 2008-2013 janë lidhur 124 kontrata për përdorimin e tokave bujqësore të

pandara, me sipërfaqe 88.4 ha dhe afat vlefshmërie 99 vjet, kontrata të cilat kanë rezultuar në kundërshtim me nenin 678 e vijues të Kodit Civil, dhe VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar, si dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", shfuqizuar me UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", pasi pronat nuk kanë qenë në pronësi të Komunës, si dhe kontratat janë lidhur për një periudhë 99 vjeçare dhe jo aq sa parashikuar nga Kodi Civil (30 vjet). Nga auditimi i zbatimit dhe pagesës së vlerës së qirasë ka rezultuar se nuk janë paguar detyrimet për vlerën prej 2,956,764 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin, nga të cilat 582,820 lekë detyrim nga qiraja dhe 2,373,944 lekë si aplikim penaliteti në masën 1% të vlerës për çdo ditë vonesë *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**27.1. Rekomandimi**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, si dhe Njësia Administrative Shushicë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të secilës nga praktikat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara, rasteve të moszbatimit të kontratës sipas qëllimit të përdorimit (mos realizimit të investimit), referuar dhe në konstatimin e grupit të auditimit të KLSH-së, se lidhja e tyre për një afat 99 vjeçar është në kundërshtim me Kodin Civil, si dhe komuna nuk ka rezultuar në cilësinë e pronarit, ti paraqesë Këshillit Bashkiak projektvendimin përkatës lidhur me vijueshmërinë ligjore të praktikave të qirasë, konfirmimi i cili për rastet e miratuara duhet të bëhet duke respektuar afatet kohore të sanksionuara nga Kodi Civil.

**Menjëherë**

**28. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Vlorë, Drejtoria e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, familja e të ndierit z. S. A, nuk është përfshirë në VKM-në nr. 89, datë 03.02.2016 "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që e subjekteve që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Vija Bregdetare e qytetit të Vlorës". Sipas tabelës së VKM-së nr. 89, datë 03.02.2016, subjekti është përfitues i vlerës prej 22,547,404 lekë, për truallin prej 2068 m2. Në procedurat e shpronësimit, Bashkia Vlorë e më tej Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve në ish- MZHU, nuk kanë përfshirë vlerën e objektit të ngritur nga qytetari sipas vendimit të KRRT nr. 2/11, datë 02.2.1998 dhe nr. 7/63, datë 30.07.2003, me arsyetimin se nuk është konfirmuar nga ZVRPP, praktikë kjo e cila ka rezultuar se nuk është zbatuar e njëjtë për të gjitha objektet e prekura nga ky projekt apo projekte të tjerë të realizuar në Bashkinë Vlorë, veprime në kundërshtim me kërkesave ligji nr. 8561, datë 22.12.1999"Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme" *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**28.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, lidhur me procedurën e ndjekur për familjen e të ndierit z. S. A, i cili rezulton i prekur nga shpronësimi për interes publik i pasurisë së paluajtshme, pronë private, jo vetëm për truallin prej 2068 $m^2$, por dhe objektin prej 4-5-6 kate, sipas projektit të miratuar nga Bashkia Vlorë, të përfshijë në listën e personave të cilët preken nga shpronësimi edhe objektin e ndërtuar nga familja e të ndierit z. S. A, si dhe ta paraqes atë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për të vijuar më tej procedurat deri në daljen e VKM-së përkatëse.

**Menjëherë**

**29. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Vlorë, është cenuar pasuria nr. 7/140, ZK 8605, në emër të subjektit Bashkëpronarët Isaraj, për realizimin e "Projektit pilot për integrimin e zonave informale në lagjen Kushtrim", procedura të cilat fillimisht nuk janë përfshirë në VKM-të respektive dhe vetëm aktualisht me kërkesën "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që e subjekteve që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Rikonstruksion i rrugës Transballkanike Vlorë, Faza II". Kërkesa e bashkisë për përfshirjen në procedurat e shpronësimit, është refuzuar nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimeve në MZHU, për mangësi në dokumentacion dhe tejkalim të afateve ligjore. Veprimet e Bashkisë Vlorë, për mos përfshirjen në kohë të subjektit edhe pse pjesërisht të argumentuara janë në kundërshtim me kërkesave ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme" *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**29.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, lidhur me procedurën e ndjekur për subjektin Bashkëpronarët Isaraj, i cili rezulton i prekur nga shpronësimi për interes publik i pasurisë së paluajtshme, pronë private, nr. 7/140, zk 8605, sipas "Projektit pilot për integrimin e zonave informale në lagjen Kushtrim" dhe "Rikonstruksion i rrugës Transballkanike Vlorë, Faza II", të bëj plotësimin e dosjes respektive dhe bashkë me të ti paraqesë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të gjitha shkaqet ligjor apo subjektive të cilat kanë penguar mospërfshirjen në kohë të subjekti në procedurën e shpronësimit, me qëllim për të vijuar më tej procedurat deri në daljen e VKM-së përkatëse.

**Menjëherë**

**30. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Vlorë është aplikuar VKM nr. 608, datë 05.09.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991. Nga auditimi i praktikave kanë rezultuar raste kur aplikimi i saj është bërë në cenim të drejtës së pronësisë, në rastin e vendimit nr. 31, datë 18.04.2017, ku edhe pse sipërfaqja sipas dokumentit është më e madhe, bashkia ka përgjysmuar atë, apo raste kur subjekti nuk figuron në fragmentet e hartave të para vitit 1991, si në rastin e vendimit nr.8, datë 06.02.2017, apo rastin e vendimit nr. 3, datë 12.01.2017, ku subjekti edhe pse rezulton me ndërtim të prishur nga bashkia për realizimin e investimi publik është përfshirë në trajtim, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 608, datë 05.09.2012 *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**30.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, lidhur me të gjitha procedurat e ndjekur për zbatimin e VKM nr. 608, datë 05.09.2012, "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991 (ato të audituara nga grupi i KLSH-së por dhe të tjerat) të marrë në vlerësim secilën praktikë, duke rregulluar rast pas rasti, problematikat, dhe për aty ku nuk është e munduar të kërkoj në rrugë administrative në Gjykatë rregullimin e pasojave të cilat mund të jenë krijuar.

**Menjëherë**

**31. Gjetje nga auditimi**: Bashkia Vlorë, në vitin 2017 ka lidhur 155 kontrata për zënie të përkohshëm të hapësirave publike (plazhe). Sipas informacionit të dhënë nga Kryetari i Komisionit të stacioneve të plazheve për vitin 2017, deklarohet se janë 4 subjekte me vlerë 888,000 lekë, nuk kanë paguar detyrimet për taksën e hapësirave publike, konkretisht;
zj. E. B për sipërfaqen 600 $m^2$ për detyrimin në vlerën 300,000 lekë në NJA Orikum.

z. E. Z për sipërfaqen 800 $m^2$ për detyrimin në vlerën 400,000 lekë në Jonufër.
z. A. D për sipërfaqen 300 $m^2$ për detyrimin në vlerën 150,000 lekë në Ujin e Ftohtë.
z. B. Z me sipërfaqe 76 $m^2$ për detyrimin në vlerën 38,000 lekë në Radhim *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**31.1. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Vlorë, të marrë të gjitha masat duke kryer të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **888,000 lekë nga 4 subjekteve**, të lindura nga mos shlyerja dhe mospërmbushja e detyrimeve kontraktore, procedura në referim të VKM nr. 369, datë 18.05.2016 dhe kontratave respektive.

**Brenda datës 30.09.2018**

**32. Gjetje nga auditimi**: Me shkresën nr. 1174, datë 09.11.2017, drejtuar KLSH-së, qytetari Rami Isufaj ka bërë prezent shqetësimin mbi mos zbatimin nga Bashkia Vlorë të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 2038, datë 05.07.2012. Nga auditimi ka rezultuar se moszbatimi i vendimit është pasojë e mos miratimit me VKM të listës përfundimtare të pronave në pronësi dhe përdorim të bashkisë e për rrjedhojë prona objekt trajtimi nuk rezulton e regjistruar në favor të bashkisë por si pasuri "shtet", pra me pronar të pa identifikuar. Për sipërfaqen objekt trajtimi gjyqësor, rezulton gjithashtu se nga paditësi është ndërtuar objekti "B.....L" si dhe është regjistruar në ZVRPP në emër të tij me nr. pasurie 27/79-ND1 në volum 35 faqe 33, si dhe në kartelën e pasurisë së paluajtshme është vendosur shënimi në seksionin E "Mungojnë marrëdhëniet me truallin" *(Trajtuar më hollësisht në faqet 374-375, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**32.1. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Vlorë, lidhur me masat ligjore konkrete, për zbatimin e vendimit gjyqësor nr. 2038, datë 05.07.2012, në listën që do të paraqitet për miratim KM-së "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë", në listën e trojeve të përfshijë edhe sipërfaqen e truallit sipas vendimit gjyqësor.

Lidhur me truallin mbi të cilin është ngritur ndërtimi me leje të miratuar nga organet kompetente, dhe i regjistruar në ZVRPP për llojin e pasurisë ndërtesë, Bashkia Vlorë pavarësisht listës të inventarit përfundimtar, ti kërkojë Ministrisë së linjës, kalimin e tij në pronësi, për të vijuar më tej procedurat ligjore në zbatim të vendimit nr. 2038, datë 05.07.2012.

**Brenda datës 30.09.2018**

**33. Gjetje nga auditimi**: Analizat e llogarive inventariale që ju përkasin shkollave në administrim të Bashkisë për llogaritë 214 "Instalime, makineri, pajisje e vegla pune", llogaria nr. 218 "Inventarë ekonomik" dhe 32 "Objekte inventari", si rezultat i mos bërjes hyrje në magazinat e njësive të shkrira dhe të Bashkisë Vlorë, por të furnizuar në mënyrë direkt nga DAR Vlorë adresuar drejtorive të shkollave nuk e kanë të saktë inventarin kontabël.

Nga Drejtoria Rajonale Arsimorë Rajonale Vlorë (DAR Vlorë), nuk janë kërkuar konfirmime për furnizimet që (kjo e fundit) i ka adresuar drejtorive të shkollave pa kaluar nëpërmes magazinave të ish-Bashkisë Orikum, ish-Komunës Novoselë, ish- Komunës Shushicë, ish-Komunës Qendër dhe Bashkisë Qendër. Kjo procedurë është ndjekur prej vitesh dhe pasaktësia e inventarëve kontabël dhe fizik është mbartur në bilancin e Bashkisë Vlorë.

Nuk mund të krahasohet inventari kontabël me inventarin fizik, pasi inventari kontabël nuk është rritur gjatë viteve pasi nuk janë bërë hyrje në njësitë vendore furnizimet e DAR Vlorë (pa kontabilizuar).

Sipas DAR Vlorë (me kërkesë të grupit të Auditimit), rezultuan të pa përfshira në inventarin kontabël dhe inventarin fizik të bashkisë 24 (copë ) fletë dalje me vlerë 20,978,071 lekë të periudhës 2013 – 2017, sipas pasqyrës Aneks 3/2 *(Trajtuar gjerësisht në faqen 49-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**33.1. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Vlorë të marrë masa për njoftimin zyrtarisht të 26 nënpunësve të DAR Vlorë, për sa kanë tërhequr nga DAR Vlorë inventarë në vlerë **20,978,071 lekë** dhe nuk janë bërë hyrje në magazinat e ish- Bashkisë Orikum, ish-komunave Novoselë, Shushicë, Qendër dhe vetë Bashkisë Vlorë. Personat përgjegjës që kanë firmosur në DAR Vlorë, t'ju kërkohet paraqitja e inventarëve për ti bërë hyrje në magazinën e Bashkisë Vlorë me qëllim përfshirjen në inventarin kontabël dhe fizik të shkollave. Në rastet kur nuk paraqesin inventarët të ngarkohen me përgjegjësi materiale (sipas pasqyrës Aneks 3/2).

**Brenda datës 30.09.2018**

**34. Gjetje nga auditimi**: Në adresë të KLSH me shkresën e administruar me nr. 1042, datë 09.10.2017, nr. 1142/1, datë 01.11.2017 dhe nr. 68, datë 18.01.2018, qytetari A. C, ka bërë prezent shqetësimin lidhur me përfundimin e objektit "Banesë 7 kate, 2 kate Dyqane, 5 kate Banim + 1 kat Parkim", në lagjen "Hajro Çakërri" Vlorë, miratuar me lejen nr. 5/134, datë 17.08.2010, me investitor "D.....I" .

Nga auditimi rezultoi se objekti nuk është zbatuar sipas lejes ndërtimore, përsa i përket katit nëntokë parkim i cili është ndërtuar, por pa realizuar rampën për të aksesuar hyrjen në parkim dhe në mungesë të saj është bërë hyrje me shkallë për këmbësor. Ashensori ka të vendosur vetëm kapakët e jashtëm dhe nuk rezulton të jetë montuar plotësisht ndonjëherë apo edhe të ketë qenë ndonjëherë funksional. Trotuari është rregulluar në pjesën më të madhe të objektit, por nuk është rregulluar për disa metra linear nga të dy anët e hyrjes për në pjesën e banimit. Pavarësisht sa cituar, Bashkia Vlorë ka lëshuar certifikatën e përdorimit, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 107/2017, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" si dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", si dhe IMTV në mos zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit", nuk ka aplikuar sanksione ndaj subjektit ndërtues përsa i përket zbatimit të projektit në kundërshtim me atë të miratuar *(Trajtuar më hollësisht në faqet 373-376, të Projektraportit të Auditimit).*

**34.1. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Vlorë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, të njoftojë shoqërinë "D.....I" lidhur me konstatimin mbi përfundimin e objektit jo sipas lejes së ndërtimit të miratuar, si dhe në referim të nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 dhe nenit 52 të ligjit nr. 107/2017, datë 31.07.2014, të bëj inspektimin në terren të objektit duke aplikuar penalitetet ligjore të përcaktuara sa sipër, duke vendosur edhe afate ligjore konkrete ndaj subjektit, lidhur me përfundimin e objektit sipas lejes ndërtimore. Bashkia Vlorë të njoftojë në vijimësi ankuesin për të gjitha hapat procedurale e ligjore.

**Menjëherë**

**35. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Vlorë, gjatë zbatimit të projektit të investimit "Rikonstruksion i rrugës Trans ballkanike faza e II-të", miratuar me VKM nr. 345, datë 04.05.2016 *"Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit Rikonstruksion i rrugës Transballkanike Vlorë, faza II"*, ka rezultuar se për zbatimin e projektit është marrë edhe pasuria e familjes B, pasuri e cila nuk është përfshirë në listën e personave

të prekur nga shpronësim, për shkak të mungesës të titullit të pronësisë të pronarit. Titulli i pronësisë rezulton të jetë përfituar nga qytetari me vendimin e Bashkisë Vlorë nr. 3, datë 12.01.2017, nxjerrë në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie si dhe për regjistrimin e tyre" *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raporti Përfundimtar të Auditimit).*

**35.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, në zbatim të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe referim të VKM nr. 345, datë 04.05.2016 *"Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga realizimi i projektit Rikonstruksion i rrugës Transballkanike Vlorë, faza II"*, të përfshijë në listën e subjekteve pasuria e të cilëve është marrë për nevoja të zbatimit të projektit *"Rikonstruksion i rrugës Transballkanike Vlorë, faza II"*, pronën e **S. B**, duke bërë vlerësimin e truallit dhe objekti të disponuar nga qytetari sipas titullit të pronësisë të lëshuar nga ZVRPP Vlorë dhe vendimit të bashkisë nr. 3, datë 12.01.2017.

Bashkia Vlorë, ti drejtohet në formë shkresore Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, duke kërkuar plotësimin e VKM-së aktuale nr. 345, datë 04.05.2016, për përfshirjen në listën e subjekteve të shpronësuar të pasurisë të familjes B, si dhe saktësuar vlerën përfundimtare të shpronësimit (vlera aktuale rezulton në shumën 332.987.201 lekë).

**Menjëherë**

**36. Gjetje nga auditimi**. Në auditimin e dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e fundit në Bashkinë Vlorë dhe ish- njësitë vendore Orikum dhe Novoselë (sot NJA Orikum dhe Novoselë), konstatohet se nga Bashkia Vlorë megjithëse është punuar në drejtim të zbatimit të tyre, akoma situata nuk është vlerësuar sa dhe si duhet, duke mos ndjekur deri në fund procedurat ligjore në zbatimin e rekomandimeve, kryesisht ato që kanë lidhje me shpërblim dëmi dhe kthimin e përgjigjes në afatin 20 ditor dhe 6 muaj, veprime në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit", konkretisht:

**<u>*- Për Bashkinë Vlorë</u>**.

-Nga 34 masa organizative janë zbatuar 17 masa, janë në proces 11 masa me vlerë 233,403,558 lekë, *nga e cila arkëtuar vlera 121,430,259 lekë dhe në proces arkëtimi vlera 111,973,299 lekë* dhe nuk janë zbatuar 5 masa organizative me vlerë 211,180,600 lekë.

-Nga 13 masa shpërblim dëmi me vlerë 77,180,444 lekë, janë zbatuar 7 masa me vlerë 8,444,732 lekë, janë në proces 5 masa me vlerë 24,325,811 lekë, *nga e cila arkëtuar vlera 10,191,784 lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 14,044,027 lekë* dhe nuk është zbatuar një detyrë me vlerë 44,499,901 lekë, që i përket subjektit "D.....A" , për punime të pakryera në zbatimin e kontratës për "Shërbimin e Pastrimit Urban të qytetit".

-Nga 13 masa administrative me vlerë 700,000 lekë, janë zbatuar 12 masa, në proces zbatimi 1 (një) masë me vlerë 700,000 lekë, *nga e cila arkëtuar vlera 650,000 lekë dhe në proces arkëtimi vlera 50,000 lekë.*

**<u>*- Bashkia Vlorë (koncesioni parkimit).</u>**

-Nga 4 masa shpërblim dëmi me vlerë 4,500,000 lekë, është zbatuar 1 (një) masë, janë në proces zbatimi 2 masa me vlerë 4,500,000 lekë dhe nuk është zbatuar 1 (një) masë.

**<u>*- Ish- Bashkia Orikum</u>**.
-Nga 11 masa organizative, janë zbatuar 7 masa, janë në proces 3 masa dhe nuk është zbatuar 1 (një) masë.
-Nga 6 masa shpërblim dëmi me vlerë 2,807,380 lekë, janë zbatuar 2 masa me vlerë 174,060 lekë, janë në proces zbatimi 4 masa me vlerë 2,633,320 lekë, *nga e cila arkëtuar vlera 836,000 lekë dhe në proces arkëtimi vlera 1,797,320 lekë* (gjithsej detyrimi në vlerën 1,797,320 lekë).
-Nga 2 masa administrative me vlerë 140,000 lekë, është zbatuar 1 (një) masë me vlerë 70,000 lekë dhe nuk është zbatuar 1 (një) masë me vlerë 70,000 lekë.
**<u>*- Ish- Komuna Novoselë</u>**.
-Nga 25 masa organizative me vlerë 90,969,000 lekë, është në proces një masë me vlerë 90,969,000 lekë, *nga e cila arkëtuar vlera 19,943,000 lekë dhe proces arkëtimi vlera 71,025,000 lekë*.
-Nga 11 masa shpërblim dëmi me vlerë 18,684,802 lekë, janë në proces zbatimi 10 masa me vlerë 18,684,802 lekë, *nga e cila arkëtuar vlera 206,850 lekë dhe proces arkëtimi vlera 18,477,952 lekë*.
-Nga 3 masa administrative me vlerë 150,000 lekë, nuk janë zbatuar 3 masa me vlerë 150,000 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 9-35, të Raport Auditimit).*
**36.1. <u>Rekomandimi</u>**: Nga Bashkia Vlorë, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe risin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërore. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu rikërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shpërblimit të dëmit në vlerën 79,139,200 lekë, si dhe të masave organizative me mungesë të ardhurash në vlerën 398,678,899 lekë, ndaj personave përgjegjës, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e parealizuara dhe rikërkuara nga KLSH-ja.

**Në vijimësi**

**C/1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**:
Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 85,871,776 lekë,** si më poshtë:
**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kontratave të punimeve nga dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, rezultuan diferenca në volume pune, në kundërshtim me preventivat e ofertës të fituar në tender dhe kontratat e lidhur me autoritetet kontraktore, me pasojë stacionimin dhe likuidimi e punimeve të pakryera në fakt me dëm ekonomik në vlerën **23,837,435 lekë,** respektivisht për 10 objektet e mëposhtme:
1- Në objektin ***"Rikonstruksion rruga Ura tek varrezat - Fshati Risili, L=3 km*** *"*, Vlorë, për vlerën **8,186,306 lekë,** në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2180 prot., datë 20.03.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE *"SH.....I – 07"* .

2-Në objektin ***"Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian 2016"***, Vlorë, për vlerën **835,350 lekë,** në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve 3897 prot., datë 18.05.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE *"C....O"* .
3-Në objektin ***"Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian 2017"***, Vlorë, për vlerën **411,220 lekë** në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5828 prot., datë 29.06.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE *"C....O"* .
4-Në objektin ***"Rikonstruksion i Rrugëve Xhebro Gjika, Veledin Kollozi dhe i bllokut te banimit mbas CONAD - it, faza I"***, Vlorë, për vlerën **1,688,863 lekë,** në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9211 prot, datë 03.11.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE *"A.....J"* .
5-Në objektin ***"Rikonstruksion i shkollës së mesme Ali Demi", Vlorë***, për vlerën **7,339,830 lekë,** në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9762 prot., datë 18.11.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe BOE *"C....O"* dhe *"F.....A"* .
6-Në objektin *"**Rehabilitimi dhe riasfaltimi i disa rrugëve kryesore të qytetit të Vlorës**"*, për vlerën **323,577 lekë** si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **1,613,760 lek,** në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 10951 prot., datë 27.12.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE *"C.....Y R.....A 2008"*
7-Në objektin ***"Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë", Vlorë***, për në vlerën **881,745 lekë,** në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 837 prot., datë 06.08.2014 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor për ish – Komunën Qendër dhe OE *"L.....N"* .
8-Në objektin *"**Ndriçimi i rrugëve në qytetin e Vlorës**"*, për në vlerën **374,580 lekë,** në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4611 prot., datë 01.06.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE *"E.....L C.....M"* .
9-Në objektin *"**Rikonstruksion Godina e Kopshtit nr. 7",*** për në vlerën **8,771 lekë,** në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve 6174 prot., datë 12.07.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE *"A.....I"* .
10-Në objektin ***"Rikualifikimi i bllokut të banimit të kufizuar nga rrugët "Tasim Jonuzi", "Demokracia", "Janaq Kilica", "Rruga e Paqes", Vlorë***, për në vlerën **2,173,433 lekë,** në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 749, Datë 30.01.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE *"C.....O" (Trajtuar më hollësisht në faqet 176-241, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**1.1. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 23,837,435 lekë,** ndaj subjekteve si vijon:
**- vlera 8,186,306 lekë,** ndaj subjektet *"SH.....I"* , në objektin *"Rikonstruksion rruga Ura tek varrezat - Fshati Risili, L=3 km "*, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 2180 prot., datë 20.03.2017.
**- vlera 835,350 lekë,** ndaj subjektit *"C.....O"* , në objektin *"Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian 2016"*, Vlorë, sipas kontratës së punimeve 3897 prot., datë 18.05.2016.
**- vlera 411,220 lekë,** ndaj subjekti *"C.....O"* , në objektin *"Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian 2017"*, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 5828 prot., datë 29.06..

**- vlera 2,173,433 lekë,** ndaj subjektit *"C.....O"* , në objektin *"Rikualifikimi i bllokut të banimit të kufizuar nga rrugët "Tasim Jonuzi", "Demokracia", "Janaq Kilica", "Rruga e Paqes"*, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 749, Datë 30.01.2017.
**- vlera 7,339,830 lekë,** ndaje subjekteve *"C.....O"* dhe *"F.....A"* , në objektin *"Rikonstruksion i shkollës së mesme Ali Demi"*, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 9762 prot., datë 18.11.2016.
**- vlera 1,688,863 lekë,** ndaje subjektet *"A.....J"* , në objektin *"Rikonstruksion i Rrugëve Xhebro Gjika, Veledin Kollozi dhe i bllokut te banimit mbas CONAD - it, faza I"*, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 10951 prot., datë 27.12.2016.
**- vlera 1,937,337 lekë,** *nga e cila penalitet në vlerën 1,613,760 lek,* ndaj subjekti *"C.....Y R.....A 2008"* , në objektin *"Rehabilitimi dhe riasfaltimi i disa rrugëve kryesore të qytetit të Vlorës",* sipas kontratës së punimeve nr. 10951 prot., datë 27.12.2016.
**- vlera 881,745 lekë,** ndaje subjekti *"L.....N"* , në objektin *"Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë"*, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 837 prot., datë 06.08.2014.
**- vlera 374,580 lekë,** ndajë subjekti *"E.....L C.....M"* , në objektin *"Ndriçimi i rrugëve në qytetin e Vlorës"*, sipas kontratës së punimeve nr. 4611 prot., datë 01.06.2017.
**- vlera 8,771 lekë,** ndaj subjekti *"A.....I"* , në objektin *"Rikonstruksion Godina e Kopshtit nr. 7"*, sipas kontratës së punimeve 6174 prot., datë 12.07.2017

**Brenda datës 30.09.2018**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në objektin *"Sistemi Multifunksional Smart City Lungomare"* Vlorë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por jo të kryera në fakt në përputhje me projekt – preventivin dhe specifikimet teknike të miratuara nga AK në vlerën **9,920,000 lekë** si dhe rritje fiktive e fondit limit në vlerën **5,959,800 lekë, me pasojë dëm ekonomik**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5995 prot., datë 10.07.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE *"C.....SS"* si dhe me Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9 *(Trajtuar më hollësisht në faqet 176-241, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 9,920,000 lekë** nga operatori ekonomik *"C.....SS"* .

**2.2. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 5,959,800 lekë,** ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurën me objekt: *"Sistemi Multifunksional Smart City Lungomare", Vlorë*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e rritjes fiktive të fondit limit të vënë në dispozicion të investimit.

**Brenda datës 30.09.2018**

**3. Gjetje nga auditimi**: Në auditimin e kontratës së qirasë nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 4 Qershor 2002 të objektit: "*Parku i lojërave të qytetit të Vlorës",* të lidhur midis Ministrisë së Ekonomisë, cilësuar si "*Qiradhënës*" dhe B. B administrator i shoqërisë "I.....D" , të cilësuar si "*Qiramarrës*", si dhe në zbatimi të rekomandimit të KLSH paraqitur me shkresën nr. 707/13 prot, datë 30.06.2014 të miratuar nga Kryetari i KLSH, *konstatohet se*:

Me vendim të Këshilli Bashkiak nr. 60, datë 27.10.2016 është bërë miratimi i sipërfaqes së marrë nga përdorim nga shoqëria "I....D".
Sipas këtij vendimi nga matjet e kryera në terren për saktësimin e sipërfaqes funksionale të marrë me qira nga shoqëria "I.....D" është miratuar ndryshimi i sipërfaqes funksionale të sipërfaqes së objektit "*Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës*" (kontrata nr. nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 4 Qershor 2002, për të cilën ka rënë dakord), **prej 14960 m$^2$**, ku detyrimi që i lind subjekti "I....D" në zbatim të VKB nr. 60, datë 27.10.2016 për sipërfaqen e marrë me qira të objekti: "*Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës*" prej 14690 m$^2$ , paraqitet në **vlerën 6,983,486 lekë**, si ardhur me dëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe të MZHETTS, aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë (këtu e vijim MFE), sipas përqindjeve (70% MFE dhe 30% Bashkia Vlorë).
Gjithashtu sipas pikës 3, të VKB nr. 60, datë 27.10.2016, Bashkia Vlorë duhet t'i dërgoj për kompetencë MFE për sipërfaqen e sanksionuar në përdorim nga shoqëria 'L.....D 1", veprim i cili nuk është kryer nga Bashkia Vlorë, për të bërë të mundur ndryshimin e kushteve të kontratës për pagesën e qirasë sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren dhe për të cilën ka rënë dakord dhe qiramarrës *(Trajtuar gjerësisht në faqen 299-310, të Projekt Raport auditivit*).
**3.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **6,983,486 lekë** ndaj subjektit **"I....D".**
**3.2. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë, të rinjoftojë MFE në zbatimin e VKB nr. 60, datë 31.10.2016 për modifikimin e kushteve të kontratës pasi sjelle efekte financiare për vlerën e qirasë mujore sipas sipërfaqes së sanksionuar me procesverbal datë 27.01.2016 prej 14690 m$^2$, për të cilën ka rënë dakort dhe subjekti "I....D".
**3.3. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë në bashkëpunim me MFE, të marrë masa që shoqëria "I.....D" për derdhë garancinë e kontratës në emër të subjektit "Bashkia Vlorë" sipas pikës 6.3 të kontratës së qirasë nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 4 Qershor 2002.

**Brenda datës 30.09.2018**

**4. Gjetje nga auditimi**: Në ish Komunën Shushicë dhe Bashkinë Vlorë, nuk është aplikuar saktë tarifa vjetore lekë/ha/vit për sipërfaqen pyjore dhe kullosore të dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit për qëllime biznesi në territor tokë inproduktive, si dhe arkëtimi i plotë i detyrimit nga shoqëria "**D.....A**" **në vlerën 6,570,350 lekë**, veprime në shkelje të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", pika 2, lidhja nr. 2, pikat 5; të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", pika 2, lidhja nr. 2, pikat *6 (Trajtuar më hollësisht në faqet 241-259, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**4.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 6,570,350 lekë** nga shoqëria "**D.....A**" .

**Brenda datës 30.09.2018**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Vlorë, ish-Komuna Novoselë, sot Njësia Administrative Novoselë, është dhënë me qira sipas kontratave respektive nr. 91, datë 30.03.2012, nr. 403, datë 01.04.2013, nr. 42, datë 27.03.2014 dhe nr. 63, datë 26.03.2015 të nënshkruara nga ish-Kryetari K.

SH dhe qiramarrës N. S, për objektin "Thertore", me sipërfaqe prej 193.5 $m^2$ dhe vlerë qiraje mujore prej 30,000lekë. Lidhja e kontratave nuk u është referuar bazës ligjore në fuqi në kohën e nënshkrimit të saj, pasi në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", ndryshuar me VKM nr. 739, datë 01.07.2009, VKM nr. 54, datë 05.02.2014, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, pasi sipas certifikatës së pronësisë të objektit "Thertore" të lëshuar nga ZVRPP, sipërfaqja funksionale e tij është 1200$m^2$, sipërfaqe për të cilën nuk është aplikuar tarifa prej 20% të tarifës dysheme, ose 20/lekë/$m^2$/muaj, me pasojë të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën prej 1,728,000 lekë (për të gjithë periudhën e vlefshmërisë), po ashtu nuk është dhënë me qira linja e përpunimit/prodhimit dhe inventarit të imët të objektit, i cili sipas regjistrimit kontabël të objektit është në vlerën mesatare 7,200,000 lekë, dhe në referim të kapitullit III, pika 5 të VKM, duhet të ishte lidhur kontratë qiraje, për pasuritë e luajtshme e cila është sa 1/10 e VAM-it, duke krijuar të ardhura me dëm ekonomik në vlerën prej 5,688,000 lekë *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **5,688,000 lekë**, shkaktuar nga ish-Kryetari i Komunës Novoselë K. SH dhe përdoruesi i pasurisë sipas kontratës **N. S**, si dhe të bëj përditësimin e kontratës me subjektin, sipas referencës ligjore aktuale.

**Brenda datës 30.09.2018**

**6. Gjetje nga auditimi**: Në auditimin e tenderi me objekt: *"Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve, fshatrat Llakatund dhe Shushicë"* të zhvilluar në ish- Komunën Shushicë, konstatohet se fondit limit prej 32,669,379 lekë është preventivuar më tepër për vlerën 1,158,300 lekë, pasi disa zëra cimet e preventivuar nuk janë sipas çmimeve të manualit teknik të miratuara në VKM nr. 407, datë 27.6.2012 "Për miratimin e manualeve teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike", i ndryshuar *(Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **1,158,300 lekë**, nga anëtarët e grupit të punës për hartimin e preventivit në mënyrë të barabartë: **Ing. N. B. dhe ing. E. I.**.

**Brenda datës 31.09.2018**

**7. Gjetje nga auditimi**: Në kontratën nr. 10284, datë 6.12.2016 në tenderi me objekti: "*Rikonstruksion i godinës Njësia Administrative (NJA) Shushicë, viti 2016*", afati për përfundimin e punimeve është 60 ditë kalendarike, nga data e nënshkrimit të kontratës ose deri me datë 18.6.2016. Referuar dokumentacionit në dosje, subjekti me datë 06.01.2017 ka paraqitur shkresën nr. *Ekstra*, për zgjatje afati për shkak të kushteve atmosferike deri me datë 20.01.2017. Me shkresën nr. 61/1, datë 10.01.2017 të titullarit të AK është bërë miratimi i zgjatjes së afatit të punimeve deri me datë 01.02.2017. Me datë 17.03.2017 subjekti sipërmarrës i punimeve "M.....I" ka njoftuar për përfundimin e punimeve, punime të cilat nuk kanë përfunduar në afatin e caktuar në kontratën dhe shtesës së afatit me datë 01.02.2017, pra punimet kanë përfunduar jashtë afatit prej **47 ditë kalendarike**.

Ndaj subjektit me datë 21.03.2017 është likuiduar detyrimi në shumën 6,982,932 lekë, por që nuk është llogaritur penaliteti për mos përfundimin në afat të punimeve sipas nenin 34 pika 34/1 të kontratës në **vlerën 1,312,791 lekë**, veprime financiare me efekt negativ me dëm në buxhetin e Bashkisë Vlorë *(Trajtuar në faqen 76-176 të Projekt Raport të Auditimit).*

**7.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **1,312,791 lekë** nga subjekti **"M.....I**".

**Brenda datës 30.09.2018**

**8. Gjetje nga auditimi**: Në ish- Komunën Qendër, referuar të dhënave të kontratës nr. 837, datë 06.08.2014 të lidhur midis ish- Kryetarit të Komunës përfaqësuar nga F. B. dhe subjektit "L.....N", konstatohet parregullsi në kushtet e veçanta të saj. Kështu në ofertën e paraqitur nga subjekti dhe shpallur fitues është përfshirë vlera e projektit prej 318,247 lekë dhe vlera e mbikëqyrësit prej 249,385 lekë, gjithsej për vlerën **567,632 lekë**, e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e ish komunës dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publike", i ndryshuar dhe ligjin nr. 8402, datë 19.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7 (në kushtet e veçanta të kontratës në nenin 3) *(Trajtuar në faqen 76-176, të Projekt Raport të Auditimit*).

**8.1 <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **567,632 lekë** ndaj subjektit "**L.....N**" .

**Brenda datës 30.09.2018**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "*Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja" Vlorë*, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë "C.....O" , u konstatua se:

- Janë likuiduar tepër në vlerën **282,180 lekë** (1,415,900 x 20%), si pasojë e përfshirjes në situacionin e punimeve të TVSH-së së pajisjeve Kalorifer në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, VKM Nr. 514, datë 15.08.2007, UKM Nr. 1, datë 16.06.2011, ku përcaktohet se formati i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimin e lartpërmendur parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar TVSH-në, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet.
- Nga auditimi në terren për verifikimin e realizimit të zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike të zbatimit, rezultojnë diferenca në volume zërash në **shumën 202,764 lekë** *(Trajtuar më hollësisht në faqet 176-241, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 484,944 lekë,** ndaj operatorit ekonomik "C....O" , të përfituar tepër për punime të pakryera dhe për përfshirjen e TVSH-së për pajisjet e stacionuara në zbatimin e kontratës me objekt "*Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Rilindja".*

**Brenda datës 30.09.2018**

**10. Gjetje nga auditimi**: Në ish - Komunën Qendër, u konstatua dëm ekonomik në vlerën 121,680 lekë, pasi gjatë muajit Korrik të vitit 2015, sipas fletë daljes nr. 31, datë 30.06.2015 është bërë

shpërndarja e karburantit, por mungon dokumentacioni shoqërues mbi mënyrën e përdorimit të tij (fletë udhëtimet), veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish- punonjësit XH. H për sasinë 80 litra me vlerë 13,520 lekë, TH. T. për sasinë 50 litra me vlerë 8,450 lekë, H. F. për sasinë 50 litra me vlerë 8,450 lekë, F. B. për sasinë 390 litra me vlerë 65,910 lekë, Z. M për sasinë 150 litra me vlerë 25,350 lekë, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2010 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik".
Gjithashtu nga ish- Kryetari i Komunës F. B. për vitin 2014 janë kryer shpenzime për bonus transporti pa mbështetje ligjore në vlerën 75,000 lekë. në kundërshtim me ligjin nr. 169/2013**,** datë 7.11.2013 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë", i ndryshuar me ligjin nr. 169/2013 miratuar më dt. 07.11.2013 *(Trajtuar gjerësisht në faqen 49-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**10.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur procedurat administrative për shpërblimin e dëmit në vlerën **196,680 lekë**, ndaje ish- punonjësve si vijon:

**-vlera 13,520 lekë** nga XH. H me detyrë ish- specialist në Zyrën e Bujqësisë;
**-vlera 8,450 lekë** nga TH. T. me detyrë ish- Përgjegjës i Zyrës së Taksave;
**-vlera 8,450 lekë** nga H. F. me detyrë ish- Jurist;
**-vlera 65,910 lekë** nga F. B. me detyrë ish- Kryetar Komune;
**-vlera 25,350 lekë** nga Z. M me detyrë ish- specialist në Zyrën e Shërbimeve, për sa kanë tërhequr karburant nga magazina sipas fletë daljes nr. 31, datë 30.06.2015 sipas planit të shpërndarjes dhe nuk kanë paraqitur dokumente justifikues (fletë udhëtime).
**-vlera 75,000 lekë** nga F. B. për vlerën e bonusit të transporti si ish- Kryetar Komune.

**Brenda datës 30.09.2018**

**11. Gjetje nga auditimi**: Në auditimin e kushteve të zbatimit të kontratës nr. 5893, datë 14.07.2016, në tenderi me objekti: *"Blerje pajisje (kompjuter, printer dhe fotokopje) për Bashkinë Vlorë, viti 2016",* rezulton se malli është marrë në dorëzim dhe bërë hyrje sipas FH nr. 16, datë 13.09.2016 (fatura tatimore nr. 3562, datë 31.07.20016) dhe likuiduar me urdhër shpenzimin nr. 715, datë 26.09.2016.
Nga të dhënat konstatohet se malli nuk është lëvruar sipas kushteve të kontratës me datë 24.07.2016 por është lëvruar me datë 31.07.2016 (konfirmuar nga fatura e TVSH nr. 3562, dt. 31.7.2016), pra me 7 (shtatë) ditë vonës, për të cilën nuk është llogaritur penaliteti (kamat vonesat) në vlerën **95,426 lekë**, veprime financiare me efekt negativ me dëm në buxhetin e Bashkisë Vlorë *(Trajtuar në faqen 76-176 të Raport Përfundimtar të Auditimit*).
**11.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **95,426 lekë** nga subjekti **"P.....E**".

**Brenda datës 30.09.2018**

**12. Gjetje nga auditimi**: Në ish- Komunën Qendër Vlorë me datë 18.6.2014 nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) është hartuar dhe dërguar për miratim Raporti Përmbledhës për procedurën me objekt "*Pastrim i Zonave Urbane, vit 2014*", duke shpallur fitues OE "M.....R" me ofertë 2,483,100 lekë , si operator i vetëm i rregullt nga dy pjesëmarrësit. Me shkresën nr. 30, datë

17.6.2014 (prot subjekt nr. 640, datë 18.6.2014), operatori "SH....A Al" është njohur me faktin se është shpallur fitues në procedurën *"Pastrim i zonave urbane"*, ku sipas DST është kërkuar kryerja e shërbimit për një afat një vjeçar, ku në ofertën e paraqitur nga shoqëria 'SH....A Al", është pasur parasysh se shërbimi i pastrimit është deri me datë 31.12.2014. Pra oferta është deri me 31.12.2014 dhe jo me afat njëvjeçar, duke bërë kështu kërkesë për tërheqje nga konkurrimi.
Nga verifikimi në sistem dhe dosje i DST, në lidhje me zbatimin e afateve të punimeve, konstatohet se afati i shërbimit të pastrimit nuk është një vit nga data e lidhjes së kontratës, siç pretendohet nga subjekti por është deri në fund të vitit 2014. Pra Pretendimi i përdorur nga subjekti për tu tërhequr nga gara është i pavërtetë, veprim në kundërshtim me nenin 49, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar. KVO duhet të kërkonte sekuestrimin e garancisë së ofertës në masën 2% ose vlerën **50,000 lekë, dëm ekonomik** në buxhetin e ish- Komunës Qendër Vlorë *(Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **50,000 lekë**, nga subjekti "**SH....A Al**".

**Brenda datës 30.09.2018**

**13. Gjetje nga auditimi**: Në auditimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave sipas funksioneve në Bashkinë Vlorë, u konstatua se është aplikuar dhe përllogaritur gabim vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar dhe për shtesën e pagës për vjetërsinë në punë për dy punonjës të Bashkisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 586, datë 17.07.2013 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 02.07.2008, të KM "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", lidhja nr. 2, dhe VKM nr. 165, datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 5, 6 dhe lidhja nr. 9, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Vlorë, në **vlerën 45,217 lekë** *(Trajtuar më hollësisht në faqet 43-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **45,217 lekë**, përkatësisht:

**-vlera 10,306 lekë,** ndaj punonjëses V. Z. me detyrë specialit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

**-vlera 34,911 lekë,** ndaj punonjëses A. B. me detyrë specialiste pagash në Qendrën Ekonomike.

**Brenda datës 30.09.2018**

**14. Gjetje nga auditimi**: Bashkia Vlorë, në vitin 2016 ka lidhur 136 kontrata për zënie të përkohshëm të hapësirave publike (plazhe), për vlerën prej 28,198,750 lekë dhe sipërfaqe prej 48937 $m^2$. Lidhur me nivelin e zbatimit dhe arkëtimit të ardhurave nga qiraja rezultoi se 18 nga 136 subjekte nuk kanë shlyer pjesërisht apo plotësisht detyrimet sipas kontratës apo aktmarrëveshjeve tip, duke krijuar një efekt financiar negative si pasojë e mospërmbushjes të detyrimeve kontraktore në vlerën prej 2,675,500 lekë shumë e cila përbën të ardhura të munguara me dëm ekonomik dhe veprime në kundërshtim me VKM nr. 369, datë 18.05.2016 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" dhe kontratave tip respektive, sipas tabelës bashkëlidhur *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Tatimeve e Taksave, të marrë të gjitha masat duke kryer të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve prej **2,675,500 lekë** të lindura nga mos shlyerja dhe mospërmbushja e detyrimeve kontraktore, procedura në referim të VKM nr. 369, datë 18.05.2016 dhe kontratave respektive.

**Brenda datës 30.09.2018**

**15. Gjetje nga auditimi**: Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluar në **Bashkinë Vlorë**, u konstatua se në **4 procedura** me vlerë të fondit limit 236,832,088 lekë, janë shpallur fitues operatorët ekonomikë me mangësi në plotësimin e kritereve të DST, miratuar nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), dhe skualifikuar operatorë ekonomike me ofertë më të leverdishme se operatori fitues, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë *"Çmimin më të leverdishëm midis operatorëve",* veprime të cilat kanë çuar në përdorimin me efekt negative të fondeve te prokuruar me dëm në shumën **16,926,338 lekë,** në kundërshtim me neni 1- "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (c, ç, d, dh), neni 2-"*Parimet e përzgjedhjes*", neni 24- "*Anulimi i një procedure prokurimi*", neni 53- "*Shqyrtimi i ofertave*", neni 55- "*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*", konkretisht praktikat:

**1- Tenderi me objekt**: "*Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2015*", me fond limit 14,931,285 lekë, ku fitues është shpallur OE "F....M" me ofertë 14,930,987 lekë . KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "F....M", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Vërtetimi i energjisë elektrike nuk është në përputhje me VKM (parregullt); -Kontrata e qirasë për vendin e selisë nuk është shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e palës qiradhënëse; -Në verifikimin e listëpagesave të subjektit me deklarimet e rojeve që janë të angazhuar në zbatimin e kësaj kontrate sipas deklarimeve të bërë nga vetë subjekti dhe drejtuesi teknik, konstatohet se disa prej tyre nuk janë të siguruar gjatë gjithë periudhës për të cilën është kërkuar, duke s' padrejtësisht fitues OE "APOLON-POL" me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike me dëm në vlerën **2,821,066 lekë**.

**2- Tenderi me objekt**: "*Ndriçimi i rrugëve në qytetin Vlorë*", me fond limit 25,000,923 lekë, ku fitues është shpallur OE "E.....L" me ofertë 24,949,484 lekë . KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "E.....L" me ofertë 24,949,484 lekë , pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Nuk paraqet grafikun e punimeve, sipas pikës 2.2/H të DST; -Nuk është plotësuar numri prej 4 elektricistë që kërkohen sipas pikës 2.2/F të DST, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "E.....L" me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike me dëm në vlerën **6,430,849 lekë**.

**3- Tenderi me objekt**: "*Rikonstruksion "Ura e Zvërnecit", Nartë-Vlorë", viti 2016*", me fond limit 30,670,398 lekë , ku fitues është shpallur OE "A.....J" me ofertë 27,446,183 lekë . KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "A.....J", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: Jo për të gjitha rastet kur janë paraqitur vërtetim për likuidimin e taksave vendore, të jenë shoqëruar me faturat e arkëtimit të tyre (Bashkia Kavajë, Vlorë). Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Shijak (nr. 26, dt. 26.4.2016) dhe Bashkia Vlorë (nr. 212, datë 26.4.2016) nuk është përcaktuar se kujt vit i përkasin detyrimet. Për Bashkinë HAS nr. 173, datë 01.08.2016 nuk është shoqëruar me mandat pagesë. Bashkia Shkodër është paraqitur për vitin 2015 dhe jo vitin 2016 për të cilën kërkohet në DST; -Në muajin Gusht 2016, numri i punonjësve sipas vërtetimit (226 punonjës), nuk përputhet me numrin e punonjësve sipas listpagesës (174 punonjës),

kriter për të cilën është skualifikuar dhe subjekti "E.....A". -Vërtetimi i lëshuar nga banka mbi gjendjen financiare nuk është brenda afati 5 ditor të kërkuar, fakt të evidentuar dhe nga vetë anëtarët e KVO, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "I.....I" me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike me dëm në vlerën **3,123,637 lekë.**

**4- Tenderi me objekt**: "*Rikonstruksion i shkollës së mesme "Halim Xhelo*", me fond limit 60,644,928 lekë, ku fitues është shpallur OE "I.....I" me ofertë 59,426,171 lekë . KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "I.....I", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: Nuk rezultojnë në listpagesës e sigurimeve shoqërore (F. B. dhe K. S. sipas kontratës datë 5.6.2017); -Për disa specialist të stafit teknik, paga sipas kontratës nuk përputhet me pagën në listpagesës dhe se nuk janë aktiv gjatë gjithë periudhës;

Nga verifikimi i bilanceve financiare të viteve 2015 dhe 2016, konstatohet se pasqyra e të ardhurave të bilancit të vitit 2015 është në vlerën 204,471,901 lekë, ndërsa nga pasqyra e të ardhurave të bilancit të vitit 2016 në ushtrimin paraardhës 2015, të ardhurat paraqiten në shumën 218,973,627 lekë, pra më pak në vlerën 14,501,726 lekë, gjë e cila tregon se bilancet nuk janë reale dhe të sakte, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "I.....I" me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ me dëm në përdorimin e fondeve publike nga mos menaxhimi i mirë i procedurës në **vlerën 4,550,786 lekë** *(Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **16,926,338 lekë,** ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurat e mëposhtme:

1- Tenderi me objekt: "*Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2015*", me efekt negativ me dëm në përdorimin e fondeve publike në vlerën **2,821,066 lekë**.

2- Tenderi me objekt: "*Ndriçimi i rrugëve në qytetin Vlorë*", me efekt negativ me dëm në përdorimin e fondeve publike në vlerën **6,430,849 lekë**.

3- Tenderi me objekt: "*Rikonstruksion "Ura e Zvërnecit", Nartë-Vlorë", viti 2016*", me efekt negativ me dëm në përdorimin e fondeve publike në vlerën **3,123,637 lekë**.

**5- Tenderi me objekt**: "*Rikonstruksion i shkollës së mesme "Halim Xhelo*", me efekt negativ me dëm në përdorimin e fondeve publike në vlerën **4,550,786 lekë**

**Brenda datës 31.09.2018**

**16. Gjetje nga auditimi**: Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluar në **ish- Komunën Shushicë**, u konstatua se në **2 procedura** me vlerë të fondit limit 33,502,712 lekë, janë shpallur fitues operatorët ekonomikë me mangësi në plotësimin e kritereve të DST, miratuar nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), dhe skualifikuar operatorë ekonomike me ofertë më të leverdishme se operatori fitues, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë *"Çmimin më të leverdishëm midis operatorëve",* veprime të cilat kanë çuar në përdorimin me efekt negative të fondeve te prokuruar me dëm në shumën **3,217,227 lekë,** në kundërshtim me neni 1- "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (c, ç, d, dh), neni 2-"*Parimet e përzgjedhjes*", neni 24- "*Anulimi i një procedure prokurimi*", neni 53- "*Shqyrtimi i ofertave*", neni 55- "*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*", konkretisht praktikat:

**1-Tenderi me objekt**: "*Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve, fshatrat Llakatund dhe Shushicë*", me fond limit 32,669,379 lekë, ku fitues është shpallur OE "B.....B" me ofertë 32,333,156 lekë. KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "B.....B", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Nuk paraqet vërtetim për likuidimin e taksave vendore, Bashkia Fier"; -Vërtetimi për taksën vendore

të lëshuar nga ish- Komuna Libofsh për vitet 2012, 2011, për deklarimin e numrit të siguruara dhe sigurimeve shoqërore për vitet 2011-2012, nuk është respektuar afati 3 mujor nga momenti i zhvillimit të tenderit; -Nuk plotëson numrin mesatar të punonjësve prej 45 punonjës për vitin 2010, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "B.....B" me mangësi në plotësimin e kritereve të DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike me dëm në vlerën **2,962,756 lekë**.
**2-Tenderi me objekt**: "*Rikonstruksion i pjesshëm i rrugës Risilisë*", me fond limit 833,333 lekë, ku fitues është shpallur OE "N.....V" me ofertë 832,352 lekë. KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "N.....V", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Vërtetimi i bankës është jashtë afatit 5 ditorë të kërkuar në DST. Për këtë fakt është skualifikuar OE "S.....K" me ofertë me të ulët se OE "N.....V" i kualifikuar, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "N.....V" me mangësi në plotësimin e kritereve të DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike me dëm në vlerën **254,471 lekë** *(Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit).*
**16.1. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 3,217,227 lekë,** ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurat e mëposhtme:
**1-Tenderi me objekt**: "*Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve, fshatrat Llakatund dhe Shushicë*", me efekt negativ në përdorimin e fondeve publike në vlerën **2,962,756 lekë**.
**2-Tenderi me objekt**: "*Rikonstruksion i pjesshëm i rrugës Risilisë*", me efekt negativ në përdorimin e fondeve publike në vlerën **254,471 lekë**.

**Brenda datës 31.09.2018**

**17. Gjetje nga auditimi**: Në tenderin me objekt: "*Rikonstruksion i rrugëve të brendshme fshati Fitore*", me fond limit 3,333,333 lekë të zhvilluar në **ish- Komunën Novoselë,** fitues është shpallur OE "S.....K" me ofertë 2,318,550 lekë. KVO ka shpallur fitues operatorin ekonomik me mangësi në plotësimin e kritereve të DST, miratuar nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), dhe skualifikuar operatorë ekonomike me ofertë më të leverdishme se operatori fitues (I.....A me ofertë 2,315,900 lekë), duke mos vlerësuar kriterin kryesorë *"Çmimin më të leverdishëm midis operatorëve",* veprime të cilat kanë çuar në përdorimin me efekt negative të fondeve te prokuruar me dëm në shumën **182,650 lekë,** në kundërshtim me neni 1- "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (c, ç, d, dh), neni 2-"Parimet e përzgjedhjes", neni 24- "Anulimi i një procedure prokurimi", neni 53- "Shqyrtimi i ofertave", neni 55- "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese" *(Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit).*
**17.1. <u>Rekomandimi</u>:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 182,650 lekë,** ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurën me objekt "*Rikonstruksion i rrugëve të brendshme fshati Fitore*".

**Brenda datës 31.09.2018**

**C/2. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**
**1. Gjetje nga auditimi**: Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluar në **Bashkinë Vlorë**, u konstatua se në **6 procedura** me vlerë të fondit limit 92,869,580 lekë, operatorët ekonomikë janë

shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, veprime të cilat kanë çuar në përdorimin me efekt negative për efiçencën e fondeve te prokuruar në shumën **30,250,156 lekë,** në kundërshtim me neni 1- "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, germa (c, ç, d, dh), neni 2- "*Parimet e përzgjedhjes*", neni 24- "*Anulimi i një procedure prokurimi*", neni 53- "*Shqyrtimi i ofertave*", neni 55- "*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*", e konkretisht praktikat:

**1-Tenderi me objekt**: *"Shtrim me bar sintetik i minifushës së futbollit Dukat i Ri",* me fond limit 3,336,000 lekë, ku fitues është shpallur operatori "2.....N" me ofertë 3,330,000 lekë. KVO, nuk ka vlerësuar drejt OE "2.....N, pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Nuk është paraqitur vërtetimi nga administrata tatimore për numrin e punonjësve për periudhën janar – dhjetor 2014 (sipas pikës "D" të DST); - Ing. Ndërtimit K. D me kontratë pune nr. 728/452, datë 15.6.2014 dhe afat 5 vjet, nuk është siguruar për kohën e plotë gjatë gjithë periudhës; Gjithashtu Ing. Gjeodet A. A me kontratë nr. 2063/1029, datë 22.10.2010 për muajit shkurt – korrik 2015 nuk rezulton në listpagesës e shoqërisë; -Nuk paraqet punime të ngjashme, pasi kontrata datë 7.10.2014 që ka paraqitur me ish-Komunën Hore-Vranisht" përfaqësuar nga S. P dhe JV "2.....N + J.....I" për objektin: "*Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Hore-Vranisht, Komuna Vranisht*" në vlerën 38,015,646 lekë, nuk përputhet me objektin e prokurimit, kjo referuar situacionit të punimeve në asnjë zë nuk korrespondon me zërat e objektit të prokuruar nga Bashkia Vlorë, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "2.....N" me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike nga mos menaxhimi i mirë i procedurës në **vlerën 450,000 lekë**.

**2- Tenderi me objekt**: "*Blerje mish dhe nënprodukte për kopshte, shkolla e çerdhe për vitin 2016*", me fond limit 8,267,300 lekë , ku fitues është shpallur operatori "E.....J" me ofertë 8,266,057 lekë . KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "E.....J", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Nuk përputhet xhiro e deklaruar sipas bilancit (viti 2014 për vlerën 20,701,975 lekë) me xhiron sipas vërtetimit të lëshuar nga administrata tatimorë me shkresën nr. 1173, dt. 05.02.2016 (vitin 2014 kjo xhiro është për vlerën 18,107,450 lekë), duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "E.....J" me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike nga mos menaxhimi i mirë i procedurës në **vlerën 155,467 lekë**.

**3- Tenderi me objekt**: "*Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2016*", me fond limit 18,513,976 lekë , ku fitues është shpallur operatori "F.....M" me ofertë 18,513,001 lekë. KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "F.....M", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Autorizimi për caktimin e frekuencave për sistem radio alarmi dhe radio komunikim zonë mbulimi Vlorë nga A.K.E.P, nuk është shoqëruar me faturë pagese viti 2016; -Drejtuesi teknik "B. R", nuk është i siguruar për gjithë periudhën për të cilën është kërkuar listpagesës; -Sipas të dhënave të vetë subjekti (deklarimit për punonjësit dhe deklarimit të numrit të punonjësve nga organet tatimore, si dhe deklarimit të aktivitetit), këto punonjës janë të angazhuar dhe në aktivitetet të tjera ku subjekti shtrihet, si: DRKK Vlorë, Qendra "V.....A", Spitali Rajonale Vlorë, etj., i cili kryhet me të njëjtin numër punonjësish, kriter në kundërshtim me DST, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "F....M" me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike nga mos menaxhimi i mirë i procedurës në **vlerën 2,548,113 lekë.**

**4. Në 2 procedurat me objekt**: "*Blerje bukë për kopshte, shkolla e çerdhe për vitin 2016* " me fond limit 1,042,800 lekë dhe "*Blerje ushqime koloniale për kopshte, shkolla e çerdhe për vitin 2016* " me

fond limit 3,679,105 lekë , ku fitues është shpallur i njëjti OE "E.....J" konkretisht për vlerat e kontratave 2,925,800 lekë , vlera 1,042,800 lekë dhe vlera 3,668,820 lekë . Në të tre rastet KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "E.....J", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Nuk përputhet xhiro e deklaruar sipas bilancit (viti 2014 për vlerën 20,701,975 lekë) me vërtetimin e lëshuar nga administrata tatimorë (nr. 1173, dt. 05.02.2016) për xhiron e viteve 2013, 2014 dhe 2015, ku për vitin 2014 kjo xhiro është për vlerën 18,107,450 lekë, pra më pak për vlerën 2,594,525 lekë (në vërtetim); -Nuk është paraqitur sigurimi i ofertës në masën 2% e fondit limit, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "E.....J" me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur përdorimin me efektivitet, eficentë dhe ekonomicitet të fondit të prokuruar në këto tre procedura **prej 5,172,266 lekë**.

**5- Tenderi me objekt:** "*Rikonstruksion i shkollës së mesme "Ali Demi", Bashkia Vlorë*", viti 2016", me fond limit 166,229,482 lekë , ku fitues është shpallur BOE "C....O + F.....A" me ofertë 165,534,546 lekë . KVO nuk ka vlerësuar drejt BOE "C....O + F.....A", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -"Një certifikatë të gjendjes financiare, që provon se i ka mundësitë financiare për realizimin e kontratës, në vlerën 10% të fondit limit, nga një ose më shumë banka, të lëshuar brenda 5 ditëve nga dita e tenderit"; - "Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje"; - "Vërtetim se i ka shlyer taksat vendore për vitin 2014, 2015, 2016 të shoqëruar me faturën përkatëse të pagesës", duke skualifikuar padrejtësisht fitues BOE "C....O + F.....A" me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike me dëm në vlerën **14,559,310 lekë**.

**6- Tenderi me objekt**: "*Realizim i dekorit në Bashkinë Vlorë me rastin e festave të fund vitit 2017*", me fond limit 7,365,000 lekë , ku fitues është shpallur OE "A.....R" me ofertë 5,545,400 lekë . KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "A.....R", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Mjeti me targë AA.....FF tip kosh nuk është i subjektit "A.....R" por i subjektit "P.....E', për të cilën nuk disponon kontratë huapërdorje (dokumente nuk ka);-Nuk paraqet listpagesës e periudhës janar 217 - Shtator 2017, por janë listpagesës të viti 2016; -Subjekti nuk ka aktivitet sipas QKB për realizimin e zbukurimeve me dekor, kjo pasi sipas QKB"; -Nuk plotëson kriterin e punimeve të ngjashme, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "A.....R" me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur përdorimin me efektivitet, eficentë dhe ekonomicitet të fondit të prokuruar **prej 7,365,000 lekë** *(Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/e shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **30,250,156 lekë,** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në tenderit me objekt "*Blerje projekti i rrugës Llakatund Bunavi – Bestrov, faza e parë*", me fond limit 2,083,000 lekë të zhvilluar në **ish- Komunën Shushicë,** fitues është shpallur OE "N.....V" me ofertë 2,050,000 lekë. KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "N.....V", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Vërtetimi i energjisë elektrike nuk është i rregullt, pasi nuk përfshin faturën e muajt korrent Tetor 2014; -Stafi teknik i kërkuar në DST (Ing.

Hidro G. D, Ing. Mjedisi/Kimist N. Th, Ing. Gjeodet B. C, etj.), nuk është i siguruar gjatë gjithë periudhës në listpagesës e muajve Janar – Tetor 2014, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "N.....V" me mangësi në kriteret e vendosura DST, duke mos anuluar procedurën dhe zhvilluar një procedurë të re, për të shmangur përdorimin pa efektivitet, ekonomicitet dhe eficencë të fondeve të prokuruar me **vlerë 2,083,000 lekë** *(Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/e shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **2,083,000 lekë,** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga zbatimi i punimeve civile të kontratës me objekt *"Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë" Vlorë*, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe BOE "L.....I & C....O", u konstatua se nga auditimi në terren për verifikimin e realizimit të zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike të zbatimit, rezultojnë diferenca në shumën **585,400 lekë** *(Trajtuar më hollësisht në faqet 176-241, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 <u>Rekomandimi</u>:** Mbështetur në shkronjën (i) dhe (f) të nenit 15 *–Të drejtat dhe detyrat e KLSH",* të ligjit nr. 154/2015, datë 22.10.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe nenit 25-*Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit*, të ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë Vlorë, të verifikojë në vend zbatimin e punimeve sipas zërave të preventivit të objektit *"Rehabilitimi i VLU-9 kanali ujitës Rezervuari Babicë" Vlorë* dhe kushteve të kontratës nr. 1850, datë 07.03.2017 për vlerën e punimeve të pakryera prej **585,400 lekë.** Në rast të mos kryerjes së punimeve, të konsiderohet dëm ekonomik dhe do arkëtohet nga BOE "L.....I & C....O".

**Brenda datës 30.09.2018**

## C/3. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA E TOKËS.

Nga auditimi e dokumentacionit ligjorë mbi administrimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, konstatohet se nga Bashkia Vlorë nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për aplikimin e detyrimeve për taksat e tarifat vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Kreu II, nenit 9 pika 2, neni 21 pika 2, neni 23/1, Kreut VII, nenit 35 pika 3, shkronja (c) nënpika 6, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë nr. 44, datë 28.12.2015 dhe arkëtimin e detyrimeve ne zbatim të neneve 40,41, 70, 90, 91, 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar në shumën **8,294,960 lekë**, respektivisht:

**-36 subjekte me vlerë 1,345,000 lekë**, që kanë seli jashtë territorit të Bashkisë Vlorë me aktivitet dytësore në territorin e kësaj bashkie për punime ndërtimi me fonde publike, *sipas aneksit nr. 5/4;*
**-56 subjekte me vlerë 2,240,000 lekë**, që janë pajisur me leje ndërtimi për objekte të ndryshme private, *sipas aneksit nr. 5/5*;
**-41 subjekte me vlerë 1,640,000 lekë,** që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë pajisur me leje shfrytëzimi për objekte të ndryshme, *sipas aneksit nr. 5/6*;
**-11 subjekte me vlerë 169,960 lekë**, të cilët nuk kanë paguar taks trualli, *sipas pasqyrës aneks 5/7;*
**-26 subjekte me vlerë 2,900,000 lekë,** me aktivitet *"Tregtim karburanti",* nuk është arkëtuar tarifa për dhënien dhe përsëritjen e licencave të karburantit, veprim në shkelje të VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, Kapitulli II dhe Kapitulli III, pika 4 dhe VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar Kapitulli II, pika 1 e shkronjë (b), sipas aneksit nr. 5/3 *(Trajtuar më hollësisht në faqet 241-259, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**1.1.<u>Rekomandimi</u>:** Bashkia Vlorë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa e nevojshme shtrënguese për vjeljen e detyrimeve për taksat e tarifat vendore në vlerën **8,294,960 lekë ndaj 170 subjekteve**.
Në rast se subjektet private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi**: Nga grupi i punës për zbatimin e reformës administrative ngritur me urdhër të Kryetarit Bashkisë nr. 80, datë 25.08.2015, nuk është hartuar asnjë informacion apo raport i veçantë për njësitë e shkrira (NJSH), por është mjaftuar vetëm me të dhënat e ekipit "Star" të Ministrisë Financave. Nuk janë paraqitur të dhëna për arkivat e njësive, për gjendjen, kapacitetin, dokumentacionin e arkivuar dhe të pa arkivuar, për gjendjen e arkave, sigurinë e lëvizjes të hollave në bankë etj. Nuk është dorëzuar dokumentacioni financiarë me shkrim nga nëpunësit e larguar nga puna si efekt i reformës administrative.
Në Komunën Shushicë nuk janë përfshirë në kontabilitet detyrimet e prapambetura nga kontratat e tokave bujqësore në 22 raste në vlerë 1,687,890 lekë *(Trajtuar gjerësisht në faqen 49-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**2.1. <u>Rekomandimi</u>**: Bashkia Vlorë të marrë masa të kontabilizojë detyrimet e prapambetura nga kontratat e tokave bujqësore në ish- Komunën Shushicë për **22 raste në vlerë 1,687,890 lekë**, dhe të hartohet regjistri pronave të dhëna me qira duke kryer verifikimin e detyrimeve të prapambetura për të gjithë bashkinë.

**Brenda datës 30.09.2018**

**3. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Vlorë, ish-Komuna Qendër, sot Njësia Administrative Qendër, janë lidhur kontrata qiraje 30 vjeçare për dhënien në përdorim të subjekteve private të sipërfaqes prej 3.13 ha, me qëllim mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme, konkretisht: për J. S sipas kontratës datë 21.05.2015, për sipërfaqen 0.47 ha, L. B sipas kontratës datë 21.05.2015, për sipërfaqen 0.80 ha, V. S sipas kontratës datë 21.05.2015, për sipërfaqen 0.92 ha dhe E. M sipas kontratës nr. 999 rep dhe 504/2 kol, datë 21.05.2015, për sipërfaqen prej 2 ha, kontrata të lidhura në referim të ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar dhe ligjin nr. 9385, datë

04.05.2005"Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, si dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".
Deri më datë 31.12.2017, ka rezultuar se asnjëri nga subjektet nuk ka shlyer detyrimin sipas kontratës, për vlerën prej 120,000 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin si dhe nuk është përllogaritur kamatëvonesat në masën 0.01% deri në 10% të vlerës, ose 12,000 lekë dhe prishja e njëanshme e tyre. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, si dhe Njësia Administrative Qendër, të aplikojë dispozitat e Kontratës tip dhe konkretisht nenit 6 "Të drejtat dhe detyrimet e Qiradhënësit", pika 4, sipas të cilës "Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi nuk shlyen vlerën e qirasë për vitin pasardhës, ....", si dhe nenit 10 "Zgjidhja e kontratës", në raste të mos pagesës së vlerës së qirasë **prej 120,000 lekë**.

**Brenda datës 30.09.2018**

**4. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Vlorë, ish-Komuna Qendër, sot Njësia Administrative Qendër, për periudhën 2008-2013 janë lidhur 63 kontrata për përdorimin e tokave bujqësore të pandara, me sipërfaqe 45.5 ha dhe afat vlefshmërie 99 vjet, kontrata të cilat kanë rezultuar në kundërshtim me nenin 678 e vijues të Kodit Civil, dhe VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar, si dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", shfuqizuar me UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", pasi pronat nuk kanë qenë të regjistruara në ZVRPP edhe pse kanë kaluar në pronësi të Komunës, si dhe kontratat janë lidhur për një periudhë 99 vjeçare dhe jo aq sa parashikuar nga Kodi Civil (30 vjet).
Nga auditimi i zbatimit dhe pagesës së vlerës së qirasë ka rezultuar se nuk janë paguar detyrimet për vlerën prej 5,964,735 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin, nga të cilat 1,307,250 lekë detyrim nga qiraja dhe 4,657,485 lekë si aplikim penaliteti në masën 1% të vlerës për çdo ditë vonesë *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**4.1. <u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, si dhe Njësia Administrative Qendër, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të secilës nga praktikat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të secilës nga praktikat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara, të marrë masa për arkëtimin e vlerës së kontratave të lidhura **prej 5,964,735 lekë**, si ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

**Brenda datës 30.09.2018**

**5. Gjetje nga auditimi**: Nga Bashkia Vlorë, ish-Komuna Shushicë, sot Njësia Administrative Shushicë, për periudhën 2008-2013 janë lidhur 124 kontrata për përdorimin e tokave bujqësore të pandara, me sipërfaqe 88.4 ha dhe afat vlefshmërie 99 vjet, kontrata të cilat kanë rezultuar në kundërshtim me nenin 678 e vijues të Kodit Civil, dhe VKM nr. 531, datë 21.8.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", i ndryshuar, si dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara", shfuqizuar me UKM nr. 1, datë 18.7.2012 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", pasi pronat nuk kanë qenë në pronësi të Komunës, si dhe kontratat janë lidhur për një periudhë 99 vjeçare dhe jo aq sa parashikuar nga Kodi Civil (30 vjet).
Nga auditimi i zbatimit dhe pagesës së vlerës së qirasë ka rezultuar se nuk janë paguar detyrimet për vlerën prej 2,956,764 lekë, të ardhura të munguara për buxhetin, nga të cilat 582,820 lekë detyrim nga

qiraja dhe 2,373,944 lekë si aplikim penaliteti në masën 1% të vlerës për çdo ditë vonesë *(Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi**: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Aseteve, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, si dhe Njësia Administrative Shushicë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të secilës nga praktikat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara, të marrë masa për arkëtimin e vlerës së kontratave të lidhura **prej 2,956,764 lekë**, si ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

**Brenda datës 30.09.2018**

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi**.

# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT